



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 31

Tiranë – E hënë, 1 mars 2021

PËRMBAJTJA

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 90, datë 17.2.2021

Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2021–2023.

Faqe

3963



VENDIM
Nr. 90, datë 17.2.2021

PËR MIRATIMIN E PLANIT
KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN
EVROPIAN, 2021–2023

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2021–2023 (PKIE 2021–2023), sipas tekstit dhe anekseve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ngarkohet të bashkërendojë dhe të monitorojë zbatimin e PKIE-së 2021–2023 me grupet ndërinstitucionale të punës (GNPIE) për çdo kapitull.

3. Ministrinë dhe institucionet e tjera koordinuese të GNPIE-së raportojnë çdo muaj pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe pranë Kryenegociatorit për negociatat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian për ecurinë e zbatimit të PKIE-së 2021–2023.

4. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ngarkohet t'i raportojë, çdo 3 (tre) muaj, Këshillit të Ministrave dhe kryenegociatorit për negociatat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian për ecurinë e zbatimit të PKIE-së 2021–2023.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të monitorojnë përfshirjen, nga ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, në programin buxhetor afatmesëm, të nevojave financiare për zbatimin e përparësive afatshkurtra dhe afatmesme të parashikuara në PKIE-në 2021–2023.

6. Legjislacioni i Bashkimit Evropian, për masat afatmesme të planifikuara në PKIE-në 2021–2023, t'i nënshtrohet procedurës të përkthimit nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

7. Vendimi nr. 151, datë 19.2.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2020–2022”, shfuqizohet.

8. Ngarkohen të gjitha ministrinë dhe institucionet qendrore në varësi të Këshillit të

Ministrave, për të cilat në PKIE-në 2021–2023 janë përcaktuar detyra të veçanta, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLANI KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN
EVROPIAN
2021–2023

PASQYRA E LËNDËS
HYRJE
ANËTARËSIMI NË BE
MENAXHIMI I PROCESIT TË
NEGOCIATAVE TË ANËTARËSIMIT
PLANI KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN
EVROPIAN 2021–2023

PJESA 2: KRITERI POLITIK
2.1 DEMOKRACIA DHE SHETËTI I SË
DREJTËS

- 2.1.1 Kuvendi
- 2.1.2 Zgjedhjet
- 2.1.3 Qeverisja
- 2.1.4 Reforma në administratën publike
- 2.1.5 Sistemi gjyqësor dhe reforma në sistemin e drejtësisë

2.1.6 Antikorrupsioni

2.2 TË DREJTAT E NJERIUT

2.3 ÇËSHITJET RAJONALE DHE
DETYRIMET NDËRKOMBËTARE

- 2.3.1 Bashkëpunimi rajonal
- 2.3.2 Marrëdhëniet Bashkimi Evropian–Shqipëri

PJESA 3: KRITERI EKONOMIK
3.1 FUNKSIONIMI I EKONOMISË SË
TREGUT

- 3.1.1 Zhvillimet ekonomike
- 3.1.2 Politikat monetare dhe fiskale
- 3.1.3 Ndërveprimi i forcave të tregut
- 3.1.4 Hyrja dhe dalja nga tregu
- 3.1.5 Sistemi ligjor (të drejtat e pronësisë; zbatimi i ligjit dhe i kontratave; efektshmëria e gjyqësorit)

3.1.6 Sektori financiar

3.2 KAPACITETET PËR TË PËRBALLUAR
PRESIONET KONKURRUESE DHE

FORCAT E TREGUT BRENDË BASHKIMIT
EVROPIAN

3.2.1 Kapitali njerëzor dhe kapitali fizik

3.2.2 Struktura sektoriale dhe ajo e ndërmarrjeve

3.2.3 Ndikimi i shtetit në konkurrueshmëri/
konkurrencë

3.2.4 Integrimi tregtar

PJESA 4

KAPITULLI 1: LËVIZJA E LIRË E
MALLRAVE

1.1 Përmbajtja e kapitullit

1.2 Struktura e kapitullit

1.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe
acquis të Bashkimit Evropian

1.4 Situata aktuale në Shqipëri

1.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

1.6 Lista e ministrive dhe institucioneve
përgjegjëse

1.7 Prioritetet

KAPITULLI 2: LËVIZJA E LIRË E
PUNËTORËVE

2.1 Përmbajtja e kapitullit

2.2 Struktura e kapitullit

2.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe
acquis të Bashkimit Evropian

2.4 Situata aktuale në Shqipëri

2.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore 102

2.6 Lista e ministrive dhe institucioneve
përgjegjëse

2.7 Prioritetet

KAPITULLI 3: E DREJTA E VENDOSJES
DHE LIRIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE

3.1 Përmbajtja e kapitullit

3.2 Struktura e kapitullit 105

3.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe
acquis të Bashkimit Evropian

3.4 Situata aktuale në Shqipëri

3.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

3.6 Lista e ministrive dhe institucioneve
përgjegjëse

3.7 Prioritetet

KAPITULLI 4: LËVIZJA E LIRË E
KAPITALIT

4.1 Përmbajtja e kapitullit

4.2 Struktura e kapitullit

4.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe
acquis të Bashkimit Evropian 116

4.4 Situata aktuale në Shqipëri

4.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

4.6 Lista e ministrive dhe institucioneve
përgjegjëse

4.7 Prioritetet

KAPITULLI 5: PROKURIMI PUBLIK

5.1 Përmbajtja e kapitullit

5.2 Struktura e kapitullit

5.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe
acquis të Bashkimit Evropian 122

5.4 Situata aktuale në Shqipëri

5.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

5.6 Lista e ministrive dhe institucioneve
përgjegjëse 124

5.7 Prioritetet

KAPITULLI 6: LEGJISLACIONI PËR
SHOQËRITË TREGTARE

6.1 Përmbajtja e kapitullit

6.2 Struktura e kapitullit

6.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe
acquis të Bashkimit Evropian

6.4 Situata aktuale në Shqipëri

6.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

6.6 Lista e ministrive dhe institucioneve
përgjegjëse

6.7 Prioritetet

KAPITULLI 7: E DREJTA E PRONËSISË
INTELEKTUALE

7.1 Përmbajtja e kapitullit

7.2 Struktura e kapitullit

7.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe
acquis të Bashkimit Evropian

7.4 Situata aktuale në Shqipëri

7.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

7.6 Lista e ministrive dhe institucioneve
përgjegjëse

7.7 Prioritetet

KAPITULLI 8: POLITIKA E KONKU-
RRENCËS

8.1 Përmbajtja e kapitullit

8.2 Struktura e kapitullit

8.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe
acquis të Bashkimit Evropian

8.4 Situata aktuale në Shqipëri

8.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

8.6 Lista e ministrive dhe institucioneve
përgjegjëse

8.7 Prioritetet

KAPITULLI 9: SHËRBIMET FINANCIARE

9.1 Përmbajtja e kapitullit

9.2 Struktura e kapitullit



9.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

9.4 Situata aktuale në Shqipëri

9.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

9.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

9.7 Prioritetet

KAPITULLI 10: SHOQËRIA E INFORMACIONIT DHE MEDIA

10.1 Përmbajtja e kapitullit

10.2 Struktura e kapitullit

10.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

10.4 Situata aktuale në Shqipëri/Përmbledhje

10.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

10.6 Lista e ministrive dhe institucionet përgjegjëse

10.7 Prioritetet

KAPITULLI 11: BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

11.1 Përmbajtja e kapitullit

11.2 Struktura e kapitullit

11.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

11.4 Situata aktuale në Shqipëri

11.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

11.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

11.7 Prioritetet

KAPITULLI 12: POLITIKAT E SIGURISË USHQIMORE, VETERINARISË DHE MBROJTJES SË BIMËVE

12.1 Përmbajtja e kapitullit

12.2 Struktura e kapitullit

12.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

12.4 Situata aktuale në Shqipëri

12.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

12.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

12.7 Prioritetet

KAPITULLI 13: PESHKIMI

13.1 Përmbajtja e kapitullit

13.2 Struktura e kapitullit

13.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

13.4 Situata aktuale në Shqipëri

13.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

13.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

13.7 Prioritetet

KAPITULLI 14: POLITIKA E TRANSPORTIT

14.1 Përmbajtja e kapitullit

14.2 Struktura e kapitullit

14.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

14.4 Situata aktuale në Shqipëri

14.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

14.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

14.7 Prioritetet

KAPITULLI 15: ENERGJIA

15.1 Përmbajtja e kapitullit

15.2 Struktura e kapitullit

15.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

15.4 Situata aktuale në Shqipëri

15.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

15.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

15.7 Prioritetet

KAPITULLI 16: TATIMET

16.1 Përmbajtja e kapitullit

16.2 Struktura e kapitullit

16.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

16.4 Situata aktuale në Shqipëri

16.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

16.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

16.7 Prioritetet

KAPITULLI 17: POLITIKA EKONOMIKE DHE MONETARE

17.1 Përmbajtja e kapitullit

17.2 Struktura e kapitullit

17.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

17.4 Situata aktuale në Shqipëri

17.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

17.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

17.7 Prioritetet

KAPITULLI 18: STATISTIKAT

18.1 Përmbajtja e kapitullit

18.2 Struktura e kapitullit

18.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

18.4 Situata aktuale në Shqipëri

18.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore



18.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

18.7 Prioritetet

KAPITULLI 19: POLITIKAT SOCIALE DHE PUNËSIMI

19.1 Përmbajtja e kapitullit

19.2 Struktura e kapitullit

19.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

19.4 Situata aktuale në Shqipëri

19.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

19.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

19.7 Prioritetet

KAPITULLI 20: NDËRMARRJET DHE POLITIKAT INDUSTRIALE

20.1 Përmbajtja e kapitullit

20.2 Struktura e kapitullit

20.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

20.4 Situata aktuale në Shqipëri

20.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

20.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

20.7 Prioritetet

KAPITULLI 21: RRJETET TRANSEVROPIANE

21.1 Përmbajtja e kapitullit

21.2 Struktura e kapitullit

21.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

21.4 Situata aktuale në Shqipëri

21.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

21.6 Lista e ministrive dhe Institucioneve përgjegjëse

21.7 Prioritetet

KAPITULLI 22: POLITIKAT RAJONALE DHE KOORDINIMI I INSTRUMENTEVE STRUKTURORË

22.1 Përmbajtja e kapitullit

22.2 Struktura e kapitullit

22.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

22.4 Situata aktuale në Shqipëri

22.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

22.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

22.7 Prioritetet

KAPITULLI 23: GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE

23.1 Përmbajtja e kapitullit

23.2 Struktura e kapitullit

23.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

23.4 Situata aktuale në Shqipëri

23.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

23.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

23.7 Prioritetet

KAPITULLI 24: DREJTËSIA, LIRIA, SIGURIA

24.1 Përmbajtja e kapitullit

24.2 Struktura e kapitullit

24.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

24.4 Situata aktuale në Shqipëri

24.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

24.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

24.7 Prioritetet

KAPITULLI 25: SHKENCA DHE KËRKIMI SHKENCOR

25.1 Përmbajtja e Kapitullit

25.2 Struktura e kapitullit

25.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

25.4 Situata aktuale në Shqipëri

25.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

25.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

25.7 Prioritetet

KAPITULLI 26: ARSIMI DHE KULTURA

26.1 Përmbajtja e kapitullit

26.2 Struktura e kapitullit

26.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

26.4 Situata aktuale në Shqipëri

26.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

26.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

26.7 Prioritetet

KAPITULLI 27: MJEDISI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

27.1 Përmbajtja e kapitullit

27.2 Struktura e kapitullit

27.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

27.4 Situata aktuale në Shqipëri

27.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore



27.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

27.7 Prioritetet

KAPITULLI 28: MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE SHËNDETTI

28.1 Përmbajtja e kapitullit

28.2 Struktura e kapitullit

28.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

28.4 Situata aktuale në Shqipëri

28.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

28.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

28.7 Prioritetet

KAPITULLI 29: BASHKIMI DOGANOR

29.1 Përmbajtja e kapitullit

29.2 Struktura e kapitullit

29.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

29.4 Situata aktuale në Shqipëri

29.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

29.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

29.7 Prioritetet

KAPITULLI 30: MARRËDHËNIET ME JASHTË

30.1 Përmbajtja e kapitullit

30.2 Struktura e kapitullit 440

30.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

30.4 Situata aktuale në Shqipëri

30.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

30.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

30.7 Prioritetet

KAPITULLI 31: POLITIKA E JASHTME, E SIGURISË DHE E MBROJTJES

31.1 Përmbajtja e kapitullit

31.2 Struktura e kapitullit

31.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

31.4 Situata aktuale në Shqipëri

31.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

31.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

31.7 Prioritetet

KAPITULLI 32: KONTROLI FINANCIAR

32.1 Përmbajtja e kapitullit

32.2 Struktura e kapitullit

32.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

32.4 Situata aktuale në Shqipëri

32.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

32.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

32.7 Prioritetet

KAPITULLI 33: DISPOZITAT FINANCIARE DHE BUXHETORE

33.1 Përmbajtja e kapitullit

33.2 Struktura e kapitullit

33.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

33.4 Situata aktuale në Shqipëri

33.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

33.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

33.7 Prioritetet

HYRJE

ANËTARËSIMI NË BE

Integrimi Evropian është objektivi gjeostrategjik dhe politik i Shqipërisë, që qëndron në thelb të politikës së brendshme dhe të jashtme të saj.

Avancimi në këtë objektiv kryesor për anëtarësimin e vendit në BE, nëpërmjet formalizimit të hapjes së bisedimeve të anëtarësimit, pas marrjes së vendimit politik të marsit 2020 për hapjen e negociatave ka qenë dhe mbetet prioriteti kryesor.

Shqipëria u bë pjesë e Procesit të Stabilizim-asociimit, të shpallur për vendet e Evropës Juglindore në Samitin e Zagrebit, në vitin 2000.

Shqipëria nënshkroi dhe ratifikoi në vitin 2006, Marrëveshjen e Stabilizim-asociimit me Komunitetet Evropiane dhe Shtetet Anëtare të tyre, e cila hyri në fuqi më 1 prill 2009. Siç përcaktohet në Nenin 1 të saj, Marrëveshja e Stabilizim-asociimit synon "... të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës; për të kontribuar në stabilitetin politik, ekonomik e institucional në Shqipëri, si dhe për stabilizimin e rajonit; të sigurojë një strukturë të përshtatshme për dialogun politik, duke lejuar zhvillimin e marrëdhënieve të ngushta politike ndërmjet Palëve; të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik dhe ndërkombëtar, gjithashtu dhe nëpërmjet përafrimit të legjislacionit të saj me atë të Komunitetit; të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë



për të përfunduar tranzicionin në një ekonomi tregu funksionale, të nxisë marrëdhënie ekonomike të harmonizuara dhe të zhvillojë gradualisht një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë; të nxisë bashkëpunimin rajonal në të gjitha fushat që mbulon kjo Marrëveshje”.

Gjithashtu, Shqipëria merr përsipër të respektojë parimet e përgjithshme të demokracisë dhe të drejtat e njeriut siç janë shpallur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe siç janë përkufizuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në Aktin Final të Helsinkit dhe Kartën e Parisit për një Evropë të Re.

Përveç kësaj, Shqipëria angazhohet të vazhdojë dhe të nxisë bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me vendet e rajonit, përfshi një nivel të përshtatshëm rregullimesh të ndërsjella në lidhje me lëvizjen e personave, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve, si dhe zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, sidomos ato që lidhen me luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parasë, emigrimit të paligjshëm dhe trafikimit, përfshi në veçanti trafikimin e qenieve njerëzore dhe tregtinë e drogës. Ky angazhim përbën një faktor kyç në zhvillimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërmjet vendeve të rajonit, duke kontribuar kështu në stabilitetin rajonal dhe bashkëpunimin e qëndrueshëm ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian.

Neni 70 i MSA-së përcakton përafrimin e legjislacionit të brendshëm me atë të Bashkimit Evropian. Hartimi i Planit Kombëtar të Integritimit Evropian është shprehje e këtij detyrimi që Shqipëria e plotëson që prej vitit 2005.

Plani Kombëtar i Integritimit Evropian ka reflektuar nga viti në vit, angazhimin e shtuar të Shqipërisë, në përputhje me statusin e saj përkundrejt BE-së, për të përafruar legjislacionin e BE, në mënyrë që të arrihet një kuadër ligjor, normativ dhe standardesh që do të bëjë të mundur marrjen përsipër të detyrimeve të anëtarësimit.

Në qershor 2014 Këshilli Evropian i akordoi Shqipërisë statusin e vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian.¹

Komisioni Evropian në Politikën e Zgjerimit të Bashkimit Evropian për vitin 2016, publikuar më 9

nëntor 2016, konkludoi se “Duke pasur parasysh përparimin e mësipërm në plotësimin e prioritetit kyç dhe në varësi të përparimit të besueshëm dhe të prekshëm në zbatimin e reformës në drejtësi, veçanërisht në rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve (*vetingu*), Komisioni rekomandon hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë”.²

Komisioni Evropian në Raportin për Shqipërinë³ dhe Strategjinë e Zgjerimit 2018⁴ publikuar më datë 17 prill 2018, vlerësoi përparimin e arritur nga Shqipëria gjatë periudhës shtator 2016–janar 2018 për përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit. Komisioni Evropian në Strategjinë e Zgjerimit 2018 dha rekomandimin e pakushtëzuar për Këshillin për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë. Komisioni Evropian e bazoi rekomandimin për hapjen e negociatave në njohjen e qartë të progresit të bërë për përmbushjen e pesë prioritetëve kyç.

Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së, i 26 qershorit 2018, vendosi që t'i përgjigjet pozitivisht progresit të bërë nga Shqipëria dhe hapi rrugën për hapjen e negociatave për anëtarësim në qershor 2019.

Komisioni Evropian në Paketën e Zgjerimit të datës 29 maj 2019, arriti në përfundimin se Shqipëria i është përgjigjur drejt inkurajimit të dhënë nga Komisioni dhe Këshilli, duke bërë përparim të mirë, duke treguar vendosmëri për të arritur rezultate të prekshme dhe të qëndrueshme në plotësimin e konkluzioneve të Këshillit të muajit qershor 2018. Komisioni Evropian i rekomandoi përsëri Këshillit hapjen e pakushtëzuar të negociatave të anëtarësimit, ashtu sikurse bëri edhe në Paketën e Zgjerimit të vitit 2018.⁵

Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme i Bashkimit Evropian, i 18 qershorit 2019 vendosi që të shqyrtojë hapjen e negociatave të anëtarësimit me

² https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20161109_strategy_paper_e_n.pdf

³ <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>

⁴ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417_strategy_paper_e_n.pdf

⁵ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-communication-on-eu-enlargement-policy_en.pdf

¹ <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-8288-2014-INIT/en/pdf>



Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, sikurse rekomanduar nga Komisioni, sa më shpejtë që të jetë e mundur, por jo më vonë se muaji tetor 2019.⁶

Këshilli Evropian në takimin e tij më 17–18 tetor 2019 vendosi që të rishqyrtojë procesin e zgjerimit përpara Samitit të Bashkimit Evropian me vendet e Ballkanit Perëndimor në Zagreb në maj 2020.⁷

Ndërkohë, bazuar në mandatin politik të Këshillit të muajit qershor 2018, Komisioni Evropian inicioi në muajin tetor 2018, takimet shpjeguese në kuadër të procesit *screening* si hapi i parë i negociatave të anëtarësimit. Procesi *screening* filloi me takimin shpjegues për kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore, në shtator 2018. Takimet shpjeguese për të gjithë kapitujt negociues u përfunduan brenda vitit 2019.

Takimet shpjeguese ishin një hap i madh përpara që i dhanë një shtysë të re procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së. Në vijim të takimeve shpjeguese, Shqipëria nisi përgatitjet për takimet bilaterale, të cilat nisën me një analizë të mangësive ligjore, administrative e institucionale përkundrejt legjislacionit të BE, sipas kapitujve negociues. Këto përgatitje u zhvilluan më tej gjatë vitit 2020.

Më datë 2 mars 2020, Komisioni Evropian në raportin e përditësimit vlerësoi se Shqipëria i kishte rritur përpjekjet dhe kishte arritur rezultate të tjera të prekshme dhe të qëndrueshme në fushat kryesore të identifikuar në Konkluzionet e Këshillit të qershorit 2018. Për këtë arsye, në linjë me rekomandimin e Paketës së Zgjerimit të vitit 2019, Komisioni rekomandoi hapjen e negociatave të anëtarësimit.

Më 25 mars 2020, Këshilli Evropian vendosi të hapë negociatat e anëtarësimit me Republikën e Shqipërisë, duke marrë parasysh progresin e arritur mbi reformat dhe përmbushjen e kushteve të përcaktuara në unanimitet nga Këshilli i qershorit 2018. Këshilli në Konkluzionet e tij vlerësoi se Shqipëria kishte demonstruar vendosmëri për të çuar përpara agjendën reformuese në kuadër të BE dhe kishte dhënë rezultate të prekshme dhe të

qëndrueshme, duke përmbushur kushtet e identifikuar nga Këshilli i Qershorit 2018 për hapjen e negociatave e pranimit.⁸

Këshilli përcaktoi se Konferenca e parë Ndërqeveritare do të thirret sa më shpejt pas miratimit të kuadrit negociues nga Këshilli, duke pasur parasysh që Shqipëria deri atëherë të ketë:

- Miratuar reformën zgjedhore në përputhje të plotë me rekomandimet e OSBE/ODHIR, duke siguruar financim transparent të partive politike dhe fushatave elektorale;

Siguruar zbatimin e vazhdueshëm të reformës në drejtësi, përfshirë sigurimin e funksionimit të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, duke marrë parasysh ekspertizën përkatëse ndërkombëtare, përfshirë opinionet e zbatueshme të Komisionit të Venecias;

- Përfunduar ngritjen e strukturave të specializuara kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar;

- Forcuar më tej luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, edhe nëpërmjet bashkëpunimit me shtetet anëtare të BE-së dhe përmes plan veprimit për të adresuar rekomandimet e Task-Forcës së Veprimit Financiar (FATF).

Komisioni i paraqiti Këshillit propozimet e tij për kuadrin negociues me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut në 1 korrik 2020. Këto propozime integruan dhe zhvilluan më tej përjasjen e përforcuar në procesin e zgjerimit.

Më datë 6 tetor 2020, Komisioni publikoi Raportin për Shqipërinë⁹ dhe Strategjinë e Zgjerimit të Bashkimit Evropian¹⁰. Në Strategjinë e Zgjerimit, Komisioni Evropian vlerësoi se “Shqipëria ka avancuar drejt objektivave të saj strategjike me vendimin e Këshillit për hapjen e negociatave të anëtarësimit në BE... Shqipëria ka bërë përparim vendimtar dhe është afër plotësimit të kushteve të vëna nga Këshilli në lidhje me Konferencën e parë Ndërqeveritare”.

Menaxhimi i procesit të negociatave të anëtarësimit

⁶ <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2019/06/18/council-conclusions-on-enlargement-and-stabilisation-and-association-process/>

⁷ <https://www.consilium.europa.eu/media/41123/17-18-euco-final-conclusions-en.pdf>

⁸ <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-7002-2020-INIT/en/pdf>

⁹ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf

¹⁰ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20201006-communication-on-eu-enlargement-policy_en.pdf



Roli i Kuvendit të Shqipërisë, në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian rregullohet me ligjin nr. 15/2015, datë 5.3.2015, “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”. Në përputhje me këtë ligj, është ngritur dhe funksionon Këshilli Kombëtar i Integritetit Evropian si struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin evropian. Këshilli Kombëtar i Integritetit Evropian nxit dhe garanton bashkëpunimin gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si dhe siguron rritjen e transparencës në vendimmarrjen për çështjet e integritetit.

Në zbatim të këtij ligji, Këshilli i Ministrave paraqet çdo vit në Kuvendin e Shqipërisë një raport të detajuar mbi ecurinë e zbatimit të detyrimeve në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, procesin e negociatave të anëtarësimit dhe menaxhimit të asistencës së Bashkimit Evropian. Këshilli i Ministrave paraqet edhe një raport të veçantë mbi Raportin vjetor të Komisionit për Shqipërinë.

Për sa i përket koordinimit ndërinstitucional, Qeveria shqiptare ndërmori një rikonceptualizim të strukturave përgjegjëse për integrimin evropian. Ky rikonceptualizim u krye duke pasur parasysh se negociatat e anëtarësimit janë një proces tepër teknik dhe i komplikuar, të cilat do të kërkojnë një koordinim sa më të mirë për një përdorim sa më eficient të burimeve institucionale të administratës publike shqiptare.

Për këtë qëllim u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 749, datë 19.12.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.

Për zbatimin e këtij Vendimi janë miratuar aktet e mëposhtme:

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 422, datë 6.5.2020, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”¹¹;

- Urdhri i Kryeministrit nr. 93, datë 20.5.2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Teknik të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës”;

- Urdhri i Kryeministrit nr. 94, datë 20.5.2019, “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian”;

- Urdhri i Kryeministrit nr. 113, datë 30.8.2019, “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin evropian”.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 749, datë 19.12.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, në maj 2020 u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 422, datë 6.5.2020, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.

U emërua kryenegociatori për aderimin e Shqipërisë në BE dhe grupi negociator i përbërë nga 18 negociatorë. Vendimi përcakton përgjegjësitë e tyre në procesin e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, përfshirë në hartimin dhe monitorimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 749, datë 19.12.2018, përcakton se grupi negociator “monitoron dhe bashkërendon zbatimin e detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit dhe të dokumenteve strategjike për procesin e Integritetit Evropian” dhe “drejton procesin e përditësimit të planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit”.

Për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme përditëson çdo vit Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, si instrumenti planifikues për përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2019–2021 u miratua me Vendimin e Këshillit të

¹¹ Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 994, datë 9.12.2020, “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të

grupit negociator dhe detyrat e kryenegociatorit, për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.



Ministrave nr. 201, datë 10.4.2019, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2019–2021”. Shkalla e zbatimit të tij për vitin 2019 ishte 60%.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2020–2022 u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 19.2.2020, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2020–2022”. Zbatimi i tij për vitin 2020 është në shkallën 87%.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2021–2023

Neni 70 i MSA-së përcakton angazhimin e Republikës së Shqipërisë për të përfunduar legjislacionin shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Njëkohësisht, përafrimi i plotë i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, dhe zbatimi i plotë dhe efektiv i tij, janë një nga kriteret e Kopenhagenit për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Procesi i negociatave të anëtarësimit është në vetvete procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Përafrimi i legjislacionit të brendshëm me *acquis* të BE-së konsiston në këta hapa:

- Analiza e legjislacionit të Bashkimit Evropian;
- Identifikimi i mangësive/akteve kontradiktore të legjislacionit shqiptar;
- Hartimi/rishikimi i akteve shqiptare të përfunduar;
- Monitorimi i zbatimit të legjislacionit të përfunduar.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian ka për qëllim të koordinojë këtë proces përafrimi duke synuar njëkohësisht plotësimin e detyrimeve në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit dhe detyrimet që lindin si pjesë e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Në këtë kuadër, Plani Kombëtar për Integrimin Evropian synon përcaktimin e prioriteteve të përafrimit të legjislacionit, ministritë përgjegjëse për hartimin e projektakteve shqiptare, shkallën e përafrimit, si dhe datën e miratimit. Hartimi në kohë dhe me cilësi i Planit dhe monitorimi i tij janë parakusht për përshpejtimin e procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme inicioi identifikimin e masave ligjore që do të përfshiheshin në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2021–2023. Identifikimi i masave të reja ligjore duhet të bëhet duke marrë në konsideratë përgjegjësitë e të gjitha institucioneve propozuese në strategjitë ekzistuese sektoriale dhe hapësirën fiskale, sikurse përcaktuar gjatë fazës së parë të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme inicioi projekt metodologjinë e hartimit të Planit Kombëtar, bazuar në eksperiencën e hartimit të Planeve të mëparshme. Metodologjia e hartimit të Planit Kombëtar të Integritit Evropian 2021–2023 u miratua nga Grupi Negociator me datë 8 tetor 2020.

Metodologjia e PKIE 2021–2023 paraqet këto ndryshime krahasuar me metodologjinë pararendëse:

- Jep udhëzime më të detajuara në lidhje me identifikimin e masave ligjore që do të planifikohen në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian;
- Qartëson lidhjen mes PKIE dhe dokumenteve strategjike, programit analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave dhe Programit Buxhetor Afatmesëm;
- Jep udhëzime më të detajuara për kostimin e veçantë të çdo mase ligjore dhe zbatuese, në përputhje me Programin Buxhetor Afatmesëm;
- Jep udhëzime më të detajuara për procedurën e konsultimit të projektakteve kombëtare me shërbimet e Komisionit Evropian përpara miratimit të tyre;
- Përditëson strukturat përgjegjëse dhe detyrat e tyre duke pasur parasysh kuadrin ligjor dhe institucional për procesin e negociatave të anëtarësimit;

- Ndihmon në hartimin e planit të përkthimit të akteve të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2021–2023 përfshin masa ligjore dhe zbatuese afatshkurtra dhe afatmesme që shtrihen deri në vitin 2023, duke synuar përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian.

PKIE-ja është e strukturuar në katër pjesë kryesore:

- Hyrja, në të cilën jepet një përshkrim i shkurtër i procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian,



strukturat e koordinimit në këtë proces dhe një përshkrim i vetë PKIE-së;

- Pjesa e dytë paraqet situatën aktuale dhe arritjet më të fundit në çështjet që kanë të bëjnë me Kriterin Politik. Kjo pjesë përfshin edhe arritjet në plotësimin e prioritetëve kyçe sikurse përcaktuar nga Këshilli Evropian në mars 2020;

- Pjesa e tretë përmbledh çështjet që kanë të bëjnë me Kriterin Ekonomik duke u fokusuar në situatën makroekonomike, stabilitetin financiar etj.;

- Pjesa e katërt është pjesa planifikuese e PKIE-së, e ndarë në 33 kapituj që u përgjigjen 33 kapitujve negociues.

Plani nuk përfshin Kapitullin 34: Institucionet dhe kapitullin 35: Çështje të tjera. kapitulli 34 rregullon pjesëmarrjen e shtetit anëtar në institucionet e Bashkimit Evropian, ndërsa, kapitulli 35 (aktet ligjore të BE-së që bëjnë pjesë në këtë kapitull) përvijon fazat e fundit të negociatave për anëtarësim.

PJESA 2 KRITERI POLITIK

Interesi kryesor kombëtar dhe qëllimi strategjik i Qeverisë të Republikës së Shqipërisë është anëtarësimi në BE. Kriteret e anëtarësimit – përcaktojnë stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut, si edhe ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale, të cilat përbëjnë shtyllat e politikës kombëtare dhe politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë është e vetëdijshme se përmbushja e Kriterit Politik ka një rëndësi thelbësore në procesin e anëtarësimit të BE-së dhe duhet të jetë në përputhje me parimet e të Drejtave Themelore. Gjithashtu, Qeveria është e vendosur të kryejë përpjekje të qëndrueshme në lidhje me prioritetet kyçe që kanë të bëjnë me reformën në drejtësi, luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe reformën në administratën publike.

2.1 Demokracia dhe shteti i së drejtës

Qeveria e Shqipërisë është plotësisht e angazhuar për të ndërmarrë dhe zbatuar të gjitha reformat e nevojshme për të forcuar procesin legjislativ, sistemin zgjedhor, qeverisjen qendrore dhe lokale, administratën publike, si dhe sistemin e drejtësisë. Fokusi i punës së Qeverisë Shqiptare do

të jetë zbatimi i reformave të nevojshme për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-asociimit (MSA) BE-Shqipëri dhe në veçanti për të adresuar rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian 2020 për Shqipërinë.

Për sa i takon administratës publike, Qeveria Shqiptare është e angazhuar për zbatimin e një reforme të mirëfilltë, për trajtimin dhe vlerësimin e bazuar në merita dhe angazhimin e punonjësve duke krijuar një rrjet institucional efektiv dhe efikas që ofron shërbime më të mira për qytetarët. Gjithashtu, Qeveria shqiptare ka si objektiv përfundimtar krijimin e një administrate publike efikase, të aftë për të zbatuar plotësisht angazhimet dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit.

Çdo veprim i ndërmarrë nga Qeveria në kuadër të reformës së sistemit të drejtësisë dhe sundimit të ligjit ka për qëllim përfundimtar krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, efikas dhe llogaridhënës në Shqipëri, i cili është në gjendje të ofrojë drejtësi në mënyrë të drejtë dhe transparente, si dhe për të zbatuar legjislacionin e përafuar me *acquis* e BE-së.

Lufta kundër korrupsionit është një prioritet kyç i Qeverisë Shqiptare. Drejtimet kryesore të politikës antikorrupsion përfshijnë një sërë veprimesh për parandalimin e korrupsionit, forcimin e institucioneve, monitorimin e përgjithshëm nga organizatat e shoqërisë civile, si dhe dënimin administrativ dhe penal të zyrtarëve të korruptuar. Zbatimi i Strategjisë Kundër Korrupsionit, i miratuar në vitin 2015, si dhe Planit të Veprimit të kësaj Strategjie, do të kontribuojë në reduktimin e qëndrueshëm të korrupsionit si dhe marrjen e masave efektive për parandalimin e korrupsionit në të gjithë nivelet.

Për më tepër, Qeveria Shqiptare angazhohet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe në veçanti për zbatimin e mëtejshëm të politikave kundër diskriminimit, për të përmirësuar situatën në lidhje me të drejtat sociale me fokus të veçantë në grupet e rrezikuara dhe të miturit. Reformat konsistojnë si në fushën e të drejtave të pronësisë ashtu edhe në planin e veprimit për zbatimin e vendimeve gjyqësore të GJEDNJ-së për kthimin dhe kompensimin e pronës.

2.1.1 Kuvendi

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë luan një rol themelor në funksionimin e sistemit demokratik dhe në proceset politike në Shqipëri, si organi më i



lartë përfaqësues dhe ligjvënës i vendit. Kuvendi përfaqëson vullnetin e popullit dhe është mbrojtësi i vlerave të demokracisë. Si organi i zgjedhur që përfaqëson popullin shqiptar, Kuvendi është organi më i lartë legjislativ që miraton ligje në dobi të interesave të shoqërisë dhe të zhvillimit të vendit. Kuvendi ushtron funksionin e kontrollit parlamentar ndaj ekzekutivit dhe monitoron institucionet e pavarura. Gjithashtu, Kuvendi luan një rol thelbësor në procesin e integritetit evropian të vendit, duke garantuar legjitimitetin demokratik dhe kontrollin ligjor dhe politik të procesit.

Gjatë periudhës janar–tetor 2020 Kuvendi ka bërë progres të rëndësishëm në plotësimin e rekomandimeve të Raportit 2019 të Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe të Komitetit të Stabilizim-asociimit BE-Shqipëri (2019), si dhe të prioritetëve të përcaktuara në përfundimet e Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 25 mars 2020, për të cilat Kuvendi është institucion përgjegjës apo kontribuues: funksionimi i Kuvendit, reforma zgjedhore dhe ngritja e organeve të reja të sistemit të drejtësisë.

Pas publikimit të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2019, Kuvendi hartoi dhe miratoi Planin e tij të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të këtij Raporti. Plani i Veprimit të Kuvendit përcaktoi 6 objektivat kryesorë të punës së Kuvendit për periudhën maj 2019–tetor 2020 si dhe masat konkrete (44 masa) për realizimin e këtyre objektivave. Zbatimi i masave të Planit të Veprimit është monitoruar në vazhdimësi përmes raporteve periodike që Shërbimet e Kuvendit i kanë dërguar Konferencës së Kryetarëve. Deri në përfundimin e afatit për zbatimin e Planit të Veprimit (tetor 2020), nga 44 masat e parashikuara, 37 masa (ose 84%) u realizuan plotësisht, 5 masa (ose 11%) u realizuan pjesërisht dhe për 2 masa (ose 5%) fillimi i zbatimit të tyre ishte i kushtëzuar me zbatimin e plotë të 2 masave të tjera.

Roli legjislativ i Kuvendit është forcuar më tej gjatë periudhës janar- tetor 2020, përmes shtimit të nismave ligjore të propozuara nga deputetët (33 nisma ligjore), shtimit të amendamenteve të propozuara drejtpërdrejtë nga deputetët (1300 amendamente) si dhe miratimit të numrit më të

lartë të akteve ligjore (121 ligje), krahasuar me të njëjtën periudhë të viteve të mëparshme. Veprimtaria ligjvënëse e Kuvendit në komisionet parlamentare dhe në seancë plenare ka vazhduar pa ndërprerje edhe në kushtet e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19. Mbledhjet e komisioneve parlamentare dhe të organeve të tjera të Kuvendit gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar *online* përmes mjeteve të komunikimit elektronik (*Cisco Webex Meetings*).

Gjatë periudhës janar–tetor 2020, Kuvendi shqyrtoi dhe miratoi 208 akte parlamentare nga të cilat 121 ligje, 61 vendime dhe 26 rezoluta. Nga 121 ligjet e miratuara gjatë kësaj periudhe, 70 ligje (ose 58%) janë miratuar me konsensus mes shumicës parlamentare dhe opozitës parlamentare. Nga 121 ligjet e miratuara gjatë kësaj periudhe, 1 ligj është miratuar me 2/3 (ligji nr. 115/2020, datë 30.7.2020, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”), 8 ligje¹³ janë miratuar me shumicë të cilësuar 3/5, 24 ligje janë miratuar me shumicë absolute dhe 88 ligje janë miratuar me shumicë të thjeshtë.

Kuvendi ka forcuar kontrollin e përputhshmërisë së projektligjeve të propozuara me *acquis* të BE-së, duke garantuar një cilësi më të mirë të legjislacionit të përafëruar. Gjatë periudhës janar- tetor 2020, Kuvendi ka miratuar 12 ligje që synonin përafrim të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së¹⁴. Komisioni për Integritetin Evropian

13 1) Ligji nr. 5/2020 “Për dhënie amnistie”; 2) Ligji Nr. 14/2020 “Për një shtesë në Ligjin Nr. 8577, datë 10.2.2000, ‘Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese’, të ndryshuar”; 3) [Ligji Nr. 15/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 96/2016, ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”](#); 4) ligji nr. 35/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995, ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”; 5) ligji nr. 96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”; 6) [Ligji Nr. 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 ‘Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë’ i ndryshuar”](#); 7) ligji nr. 113/2020 “Për shtetësinë”; 8) Ligji Nr. 118/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10019, datë 29.12.2008, ‘Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar”.

14 1) ligji nr. 4/2020, datë 30.1.2020 “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”; 2) ligji nr. 13/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 108/2013, ‘Për të huajt’, të ndryshuar”; 3) ligji nr. 21/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 89/2014 ‘Për pajisjet mjekësore’”; 4) ligji nr. 22/2020 “Për disa shtesa në ligjin nr.

¹² Të dhënat e Kuvendit mbulojnë periudhën 1 janar–12 tetor 2020.



(KIE) ka luajtur një rol të rëndësishëm në këtë proces. Gjatë shqyrtimit dhe miratimit të projektligjeve që synonin përafrimin me *acquis* e BE-së (13 projektligje gjatë periudhës janar–tetor 2020), KIE ka propozuar 109 amendamente, me qëllim për të siguruar një përafrimin më të saktë të projektligjeve me *acquis* të BE-së, të cilat janë miratuar edhe në seancën plenare.

Gjithashtu, transparenca në procesin legjislativ dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile në këtë proces është rritur më tej (96 përfaqësues të shoqërisë civile dhe grupe interesi gjatë periudhës janar- tetor 2020). Mendimet dhe sugjerimet e tyre të paraqitura në seanca dëgjimore, ose me shkrim janë shqyrtuar me kujdes dhe ky proces është pasqyruar në raportin që ka shoqëruar projektligjin në seancën plenare. Risi në drejtim të forcimit të mëtejshëm të transparencës në veprimtarinë e Kuvendit gjatë periudhës janar - tetor 2020, përbën fakti se në faqen e internetit të Kuvendit www.parlament.al filloi transmetimi *livestream* i mbledhjeve të komisioneve parlamentare. Ky transmetim *livestream* e forcon transparencën e procesit ligjvënës të Kuvendit si dhe aksesin e mediave dhe të qytetarëve në këtë proces.

Roli kontrollues i Kuvendit u forcua më tej gjatë periudhës janar - tetor 2020, përmes përdorimit më intensiv dhe cilësor të instrumenteve të mbikëqyrjes parlamentare të parashikuara në Kushtetutë, Rregulloren e Kuvendit dhe Ligjin Nr. 15/2015 (24 interpelanca me anëtarë të Këshillit të Ministrave, 72 seanca dëgjimore në Komisione me ministrat, zëvendësministrat dhe drejtues të institucioneve të tjera qendrore, 78 kërkesa për informacion me shkrim nga deputetët, 1 komision hetimor parlamentar). Ministrat, zëvendësministrat dhe drejtues të institucioneve të tjera qendrore u paraqitën në 72 seanca dëgjimore para komisioneve të përhershme parlamentare dhe iu përgjigjën 474 pyetjeve të deputetëve.

Komisioni për Integrimin Evropian (KIE) dhe Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian (KKIE) kanë luajtur një rol kyç për monitorimin e reformave të kërkuara dhe plotësimin e rekomandimeve në kuadër të procesit të integritimit evropian të Shqipërisë.

Gjatë periudhës janar - tetor 2020, KIE ka zhvilluar 2 seanca dëgjimore me Ministrin e Brendshëm lidhur me progresin e bërë në zbatim të masave për plotësimin e prioritetit “Lufta kundër krimit të organizuar” dhe me Ministrin në Detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme lidhur me Planin e Veprimit të Qeverisë për plotësimin e 15 kushteve të përcaktuara në Përfundimet e Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 25 mars 2020.

KKIE-ja ka vijuar të monitorojë ecurinë e procesit të integritimit evropian dhe përmbushjen e detyrimeve të anëtarësimit në BE përmes takimeve periodike me përfaqësues të qeverisë. Gjatë periudhës janar–tetor 2020 KKIE ka zhvilluar 5 takime, në të cilat është diskutuar mbi zbatimin e strategjisë së migracionit, me fokus mbi masat e marra nga qeveria për kufizimin e migracionit të parregullt të shtetasve shqiptarë drejt vendeve të BE-së, luftën kundër korrupsionit, masat e ndërmarra për të përmirësuar klimën e biznesit në vend, zhvillimet më të fundit në kuadër të përgatitjeve për procesin e negociatave në Bashkimin Evropian dhe prezantimi i projekt - planit gjithëpërfshirës të Masave të Integritimit Evropian”, si dhe progresin e realizuar dhe sfidat në kuadër të Kriterit Politik dhe Kapitullit 23 ‘Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore’, me fokusin në 15 kushtet e vendimit të Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 25 mars 2020 për hapjen e negociatave.

Kuvendi në seancën plenare të datës 18.6.2020 miratoi Rezolutën, “Për progresin e Shqipërisë në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian gjatë vitit 2019”, përmes së cilës vlerësoi progresin e arritur gjatë vitit 2019 në përmbushjen e detyrimeve, në kuadër të MSA-së dhe plotësimin e rekomandimeve për hapjen e negociatave të anëtarësimit në BE, si dhe i kërkoi qeverisë dhe të gjitha institucioneve të tjera përgjegjëse që të konsolidojnë reformat e arritura dhe të adresojnë me rigorozitet prioritetet e përcaktuara në përfundimet e Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 25 mars 2020. Kuvendi në seancën plenare të datës 29.9.2019 miratoi Rezolutën, “Për hapjen e

71/2016 “Për kontrollin kufitar”; 5) ligji nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”; 6) ligji nr. 41/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar”; 7) ligji nr. 55/2020 “Për shërbimin e pagesave”; 8) ligji nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”; 9) [Ligji Nr. 57/2020 “Për pyjet”](#), 10) ligji nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”; 11) ligji nr. 96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”; 12) ligji nr. 112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues”.



negociatave për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe planin e masave për përmbushjen e përparësive të përcaktuara nga Këshilli i Bashkimit Evropian”, përmes së cilës i kërkoi Qeverisë që të koordinojë institucionet përgjegjëse dhe ato të raportojnë në Kuvend një herë në tre muaj për zbatimin e këtij Plani Veprimi.

Kuvendi ka ushtruar kontroll parlamentar jo vetëm mbi ekzekutivin, por edhe mbi organet kushtetuese apo ato të krijuara me ligj për të verifikuar zbatimin e kuadrit ligjor të miratuar prej tij. Në zbatim të vendimit të Kuvendit nr. 49/2017, “Për mekanizmin ndërinstitutional Kuvend - institucione të pavarura - qeveri”, në datën 7 maj 2020, Kryetari i Kuvendit organizoi takimin vjetor periodik me 24 institucionet e pavarura, për të komunikuar vlerësimet mbi veprimtarinë e këtyre institucioneve, nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga ekzekutivi dhe trajtimin e problematikave apo çështjeve të evidentuara nga monitorimi, në funksion të zbatimit të mekanizmit ndërinstitutional dhe mbështetjes së vazhdueshme të Kuvendit ndaj institucioneve të pavarura. Në zbatim të Nenit 103 të Rregullores së Kuvendit, 24 institucione të pavarura kushtetuese apo të krijuara me ligj depozituan në Kuvend raportet e veprimtarisë vjetore institucionale për vitin 2019. Gjatë periudhës janar–tetor 2020, 23 institucione të pavarura kanë raportuar në komisionet parlamentare dhe në seancë plenare për veprimtarinë e tyre për vitin 2019. Kuvendi ka miratuar në seancë plenare 23 Rezoluta, përmes të cilave ka vlerësuar veprimtarinë vjetore të 23 institucione të pavarura për vitin 2019, si dhe u ka caktuar atyre detyra konkrete për vitin 2020.

Kuvendi në ushtrim të funksionit zgjedhës, gjatë periudhës janar–tetor 2020, miratoi 9 vendime për zgjedhje ose emërim në institucionet kushtetuese apo të krijuara me ligj, duke përfshirë vendimin nr. 2/2020, datë 20.1.2020, “Për zgjedhjen e Inspektorit të Lartë i Drejtësisë”, vendimet nr. 56/2020, nr. 57/2020, nr. 58/2020, nr. 59/2020, të datës 5.10.2020, “Për zgjedhjen e titullarëve dhe anëtarëve të strukturave të reja të KQZ-së”, të ngritura në zbatim të reformës së fundit zgjedhore; 2 vendime për shkarkim/emërim ministri si dhe 1 vendim për lirim nga detyra.

Prioritetet e Kuvendit për vitin 2021 janë:

- Rritja e cilësisë së ushtrimit të funksioneve parlamentare (*përfaqësimi, ligjberja, kontrolli parlamentar*);

- Forcimi i rolit të Kuvendit në procesin e integritetit evropian;

- Rritja e transparencës në veprimtarinë e Kuvendit;

- Forcimi i kapaciteteve administrative të Kuvendit.

Këto prioritate të Kuvendit do të ndiqen përmes realizimit të objektivave dhe masave të mëposhtjëm:

- Forcimi i funksionit ligjberës të Kuvendit, nëpërmjet monitorimit efektiv të përputhshmërisë së projektligjeve të propozuara Kuvendit me *acquis* të BE-së për të garantuar një cilësi më të mirë të legjislacionit të përafuar, hartimit dhe miratimit të manualit për veprimtarinë e komisioneve/nënkomisioneve, aktivizimit dhe përditësimit të vazhdueshëm të *database*-it parlamentar për ligjet me përaftrim të miratuara nga Kuvendi nga hyrja në fuqi e MSA-së e në vazhdim, krijimit të ciklit të punës (*workflow*) të dokumenteve të procesit ligjberës;

- Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit, nëpërmjet përdorimit më të shpeshtë dhe cilësor të instrumenteve të kontrollit parlamentar për monitorimin e reformave dhe plotësimin e rekomandimeve në kuadër të procesit të integritetit evropian, rishikimit të ligjit nr. 15/2015 për të parashikuar një mekanizëm efektiv të mbikëqyrjes së veprimtarisë së qeverisë (rishikimin e pozicionit negociues) gjatë procesit të negociatave të anëtarësimit, bazuar në praktikën më të mira në këtë fushë, organizimit të *workshop*-eve dhe sesioneve të informimit për orientimin e deputetëve në përdorimin efektiv dhe eficient të instrumenteve të kontrollit parlamentar, hartimit dhe miratimit të udhëzuesit të praktikave të mbikëqyrjes dhe kontrollit parlamentar, krijimit në Platformën Ndërinstitutionale të Kuvendit të një hapësire për rekomandimet e raportit vjetor të Komisionit Evropian për Shqipërinë, adresuar institucioneve të pavarura;

- Forcimi i transparencës në veprimtarinë e Kuvendit nëpërmjet zhvillimit të sesioneve të trajnimit me grupet e interesit dhe me OSHC-të që bashkëpunojnë me Kuvendin për procesin ligjberës, procesin e konsultimit dhe dëgjësat publike, organizimit të takimeve periodike të deputetëve me qytetarët për të prezantuar



veprimtarinë e Kuvendit, zhvillimit të seancave dëgjimore publike nga komisionet e përhershme të Kuvendit për marrjen e mendimeve edhe nga aktorët e shoqërisë civile dhe grupet e interesit, gjatë procesit vendimmarrës të Kuvendit, rinxhinierizimi i paraqitjeve publike *online* të informacionit parlamentar përmes teknologjisë së informacionit (IT) për të mundësuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, ngritja e platformës *online* “Rubrika Zëri i Qytetarit” sipas eksperiencave më të mira, rishikimi i Strategjisë së Komunikimit, publikimit të raportit të Kuvendit mbi pjesëmarrjen e publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit për vitin 2020, forcimit të bashkëpunimit të Kuvendit me shoqërinë civile, si një partner shumë i rëndësishëm në ecurinë e suksesshme të reformave të integritit, publikimit periodik *online* të *Newsletter*-it të Kuvendit lidhur me veprimtarinë e Kuvendit në procesin e integritit evropian;

- Forcimi i kapaciteteve administrative të Kuvendit nëpërmjet hartimit dhe miratimit të Strategjisë së Zhvillimit të Burimeve Njerëzore dhe rishikimit të strategjisë së trajnimit, modernizimit të shërbimeve të Kuvendit për të përballuar sfidat dhe kërkesat e reja për kapacitete dhe ekspertizë të nivelit të lartë gjatë procesit të negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, krijimit të Institutit Parlamentar (IP) si pjesë e shërbimeve të Kuvendit, trajnimit të vazhdueshëm të shërbimeve të Kuvendit në fusha të ndryshme, veçanërisht ato që lidhen me procesin e integritit evropian.

2.1.2 Zgjedhjet

Kuvendi miratoi në datën 23 korrik 2020 ndryshimet në Kodin Zgjedhor, duke adresuar rekomandimin e Raportit 2019 të Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe të Komitetit të Stabilizim-asociimit BE-Shqipëri (2019) lidhur me reformën zgjedhore, si dhe duke plotësuar një nga kushtet e përcaktuara në Përfundimet e Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 25 mars 2020 për thirrjen e Konferencës së Parë Ndërqeveritare BE-Shqipëri.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën zgjedhore është ngritur me Vendimin e Kuvendit Nr. 102 datë 13.10.2017 për hartimin e ndryshimeve të kuadrit ligjor zgjedhor, bazuar në rekomandimet e raporteve të OSBE/ODHIR-it për zgjedhjet e viteve 2013, 2015 dhe 2017 në Shqipëri, në rekomandimet e institucioneve përgjegjëse për zgjedhjet dhe të propozimeve të

partive politike që kanë marrë secila jo më pak se 1 për qind të votave në zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Shqipërisë. Në datën 14 Janar 2020, shumica qeverisëse dhe opozita parlamentare dhe jashtë parlamentare arritën një marrëveshje për zhvillimin e bisedimeve politike dhe teknike për realizimin e reformës zgjedhore, duke krijuar për këtë qëllim “Këshillin Politik”, i cili do ta ushtronte veprimtarinë e tij jashtë Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore. Këshilli Politik përbëhej nga dy bashkëkryetarët e Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore, përfaqësues të shumicës parlamentare dhe të opozitës parlamentare si dhe nga dy përfaqësues të opozitës jashtëparlamentare.

- në datën 5 qershor 2020, Këshilli Politik arriti marrëveshjen për ndryshimet në Kodin Zgjedhor, të cilat, ndër të tjera, konsistojnë në:

- parashikimin gradual të administratës zgjedhore të depolitizuar në linjë me rekomandimet e OSBE/ODHIR-it;

- identifikimin elektronik të të gjithë votuesve (kur kjo është teknikisht e mundur);

- ristrukturimin e KQZ-së;

- përbërjen e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor nga gjyqtarë që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar (*vetting*).

Kuvendi, në seancën plenare të datës 23.7.2020, miratoi ligjin nr. 101/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, i cili është në përputhje me marrëveshjen e arritur në Këshillin Politik në datën 5 qershor 2020 si dhe zbaton rekomandimet e OSBE/ODHIR-it për zgjedhjet në Shqipëri.

Më datë 15.6.2020 Opozita Parlamentare, depozitoi në Kuvend, nismën ligjore për ndryshime kushtetuese. Kjo nismë ligjore u shqyrtua nga Kuvendi në përputhje me parashikimet e Nenit 177 të Kushtetutës dhe nenit 77/a dhe 77/b të Rregullores së Kuvendit. Në seancën plenare të datës 30.7.2020 Kuvendi miratoi ligjin nr. 115/2020, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. Këto ndryshime kanë për qëllim krijimin e një kuadri ligjor zgjedhor në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare, ku zgjedhësi voton jo vetëm për subjektin zgjedhor, por edhe për kandidatin e parapëlqyer prej tij.



Këto ndryshime të Kushtetutës, të cilat nuk lidheshin me zbatimin e rekomandimeve të OSBE/ODHIR-it, kërkonin ndryshime të mëtejshme në Kodin Zgjedhor. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut ngriti një grupe pune për të hartuar ndryshimet në Kodin Zgjedhor, me qëllim për të reflektuar në Kodin Zgjedhor ndryshimet Kushtetuese të datës 30 korrik 2020. Gjithashtu edhe Këshilli Politik është mbledhur për të dakordësuar qëndrimin e tyre në lidhje me këto ndryshime. Pas hartimit të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Kuvendi në seancën plenare të datës 5.10.2020 miratoi ligjin nr. 118/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

2.1.3 Qeverisja

Qeveria qendrore përcakton vizionin dhe politikat kyçe dhe propozon legjislacionin për forcimin e demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit. Organizimi, funksionimi dhe kompetencat e Qeverisë/Këshillit të Ministrave (i përbërë nga Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe Ministrat e Kabinetit) parashikohet në dispozitat themelore kushtetuese dhe në ligjin nr. 9000 datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”. Përsheptimi i reformave dhe përgatitja e vendit për t’u bashkuar me Bashkimin Evropian mbetet një prioritet i madh i Qeverisë Shqiptare.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2020 përfaqëson dokumentin themelor strategjik që kombinon dhe integron agjendën e integritetit në Bashkimin Evropian me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit, përfshirë edhe ndërlidhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Strategjia Kombëtare aktuale për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020 (SKZHI II) është miratuar nga Qeveria e Shqipërisë me vendim të Këshillit të Ministrave VKM nr. 348, datë 11.5.2016.

SKZHI-ja përbën dokumentin arkitekturor më të lartë që siguron prioritetizimin e politikave në nivel afatmesëm dhe afatgjatë dhe shërben si orientim dhe kuadër për të gjitha strategjitë

sektoriale/ndërsektoriale. SKZHI-ja ka siguruar orientim për disa cikle të Programit të Buxhetit Afatmesëm (PBA), si dhe shpërndarjen e shpenzimeve publike, duke siguruar që objektivat e politikave të përfshihen në përgatitjen e buxhetit nga të gjitha ministratë dhe agjencitë, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. SKZHI II aktuale, bazohet në këto gjashtë përparësi strategjike:

1. Anëtarësimi në BE, si objektiv madhor i vendit (themeli);
2. Konsolidimi i qeverisjes së mirë, demokracisë dhe sundimit të ligjit (themeli);
3. Sigurimi i rritjes përmes stabilitetit makroekonomik dhe fiskal (shtylla 1);
4. Sigurimi i rritjes përmes rritjes së konkurrencës dhe inovacionit (shtylla 2);
5. Investimi në njerëz dhe kohezioni social (shtylla 3);
6. Sigurimi i rritjes përmes lidhjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve (shtylla 4).

Aktualisht, SKZHI II është në fazën finale të zbatimit dhe ka filluar procesi për hartimin e strategjisë së re kombëtare që do të shtrihet për periudhën 2021 - 2030 (SKZHI III). Në kontekstin e monitorimit të zbatimit të SKZHI 2020, është përgatitur në 2019, Raporti i Progresit të SKZHI II, i cili pasqyron progresin dhe rezultatet e arritura, si edhe sfidat, në zbatimin e reformave në kuadër të SKZHI II, gjatë periudhës 2015–2018. Aktualisht është hartuar metodologjia për procesin e hartimit të SKZHI 2021–2030, duke u bazuar në parimin e funksionimit të plotë të gjithë mekanizmave dhe proceseve aktuale të lidhura me Sistemin e Planifikimit të Integruar.

Duke qenë në sintoni me proceset planifikuese edhe me Bashkimin Evropian, SKZHI përfshin një hark kohor 10-vjeçar, ku 7 vjet është edhe cikli planifikues i politikave të vetë BE-së, ndërkohë që deri në 2030 është edhe harku kohor i zbatimit të Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Përafrimi në planifikim me praktikën e vendeve anëtare të BE, është një hap cilësor që siguron që vendi gjatë periudhës së negociatave të përafrohet tërësisht me ciklin e politikave të shteteve anëtare të BE-së. Në kuadër të financimit të BE-së për Shqipërinë, paralelisht me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, përgatitet dhe *Strategic Response for the Country*, si një dokument që është



kërkuar të përgatitet nga Qeveria Shqiptare, në ngjasim edhe me shtetet anëtare të BE-së.

SKZHI 2021–2030 do të sigurojë mbështetje veçanërisht për harmonizimin sa më të mirë me ciklin e Programimit Buxhetor Afatmesëm dhe me programimin e strategjisë së Bashkimit Evropian/Planin Kombëtar për Integrimin Evropian. Në veçanti, SKZHI parashikon:

- Lidhjen me prioritetet afatmesme të Qeverisë Shqiptare, ku prioritetet e parashikuara në programin e Qeverisë, si edhe sektorët prioritarë të Qeverisë, janë pjesë integrale e vizionit drejt të cilit duhet të zhvillohet vendi dhe politikat strategjike që përcaktohen në SKZHI, në funksion të vizionit;

- Lidhjen e plotë me agjendën e integritimit të vendit/MSA, ku aktivitetet, masat dhe angazhimet në kuadër të MSA-së janë pjesë integrale e SKZHI-së dhe planifikimit buxhetor afatmesëm. Në këtë mënyrë përcaktohet deri në detaje kostoja e integritimit evropian dhe angazhimeve në këtë kuadër;

- Harmonizimin më të mirë të PBA me SKZHI përmes:

- Hartimit të një kuadri makroekonomik për 2021–2030, që përfshin prioritetet e politikave për 2021 - 2030, financimin e huaj të parashikuar apo programuar, si edhe aspekte të tjera lidhur me financimin dhe të ardhurat;

- Qëllimet e politikave të mirëpërcaktuara për 2021–2030, të cilat përfshijnë edhe objektivat në kuadër të integritimit evropian. Për këtë qëllim, Udhëzimi për hartimin e Buxhetit përcakton detajet teknike të përfshirjes së politikave dhe zërthimin e objektivave në PBA e ardhshme në funksion të realizimit të qëllimeve 2021–2030.

- Strategjia Kombëtare 2030 siguron gjithashtu boshtin orientues për të gjitha programimet e fondeve të partnerëve për zhvillim, duke përfshirë financimin përmes IPAs, si instrument financimi i BE-së për Shqipërinë, apo edhe strategjitë për zhvillimin e vendit që kanë donatorët shumëpalësh (si BB, UN etj.) apo dypalësh (si: SIDA, SDC, Gjermania, Italia etj.).

- Në kuadër të prioritzimit afatmesëm dhe afatshkurtër Qeveria Shqiptare përdor disa instrumente për të siguruar prioritzimin afatmesëm dhe afatshkurtër të politikave. Në lidhje me prioritetet afatshkurtra të ministrave, shërbejnë Kontratat e Performancës së Kryeministrit me

ministrat, të cilat shprehin prioritetet afatshkurtra të ministrave.

- Gjithashtu, në terma afatmesëm, prioritetet e Qeverisë përcaktohen përmes Dokumentit të Politikave Prioritare, i cili siguron edhe buxhetimin e prioritetereve dhe përcaktimin e taveveve të PBA-së në terma afatmesëm. Dokumenti i Politikave Prioritare hartohet bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave lidhur me miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike edhe VKM nr. 185, datë 29.3.2019, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”. Ky Dokument diskutohet dhe miratohet në Komitetin e Planifikimit Strategjik dhe përbën një fazë të ndërmjetme përpara përcaktimit të taveveve buxhetore për Planifikimin Buxhetor Afatmesëm.

Sistemi i Planifikimit të Integruar

Një ndër prioritetet e qeverisë shqiptare është Sistemi i Planifikimit të Integruar në Shqipëri (SPI), i cili konsiston në një kuadër parimesh dhe strukturash operuese që ka si synim të sigurojë një kuadër të gjerë planifikimi brenda të cilit të gjitha politikat dhe planifikimi financiar i qeverisë të funksionojnë në mënyrë koherente, eficiente dhe të integruar. Dy janë proceset themelore ku mbështetet SPI-ja:

- Një proces afatmesëm deri në afatgjatë të planifikimit strategjik, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), e cila përcakton prioritetet kombëtare afatmesme dhe afatgjata, sipas një parashikimi afatmesëm dhe afatgjatë për kuadrin makroekonomik;

- Një proces buxhetimi afatmesëm, Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA), sipas së cilit çdo ministri përgatit një plan trevjeçar brenda taveveve të shpenzimeve buxhetore, për të arritur objektivat e politikave afatmesme dhe afatgjata, në përputhje me SKZHI.

Po kështu, në proceset e mësipërme të planifikimit strategjik dhe të buxhetimit duhet të pasqyrohen tërësisht edhe katër procese të tjera thelbësore:

Programi i Qeverisë;

Integrimi evropian dhe zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit dhe Planit të Veprimit për Integrim Evropian;

Investimet Publike përfshirë Ndihmën e Huaj.

Pjesë e mekanizmave të SPI-së janë edhe Grupet e Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP), ose mekanizmi i planifikimit sektorial të



politikave, të iniciuar nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes dhe BE-së. Për koordinimin e përgjithshëm teknik të mekanizmit është ngritur sekretariati qendror teknik i mekanizmit, që përbëhet nga DZHM, MEF dhe MEPJ, që koordinon punën për funksionimin e GMIP-ve.

Grupet e Menaxhimit të Integruar të Politikave (ose GMIP) luajnë ndër të tjera edhe rolin e Komiteteve Monitoruese Sektoriale për fondet e Instrumentit të Paraaderimit-IPA, duke siguruar monitorimin e fondeve IPA sipas sektorëve.

- Për vitin 2020 në zbatim të urdhrit nr. 157, datë 22.10.2018, të Kryeministrit, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen e funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”, është finalizuar Kalendar i Integruar për vitin 2020;

- Gjithashtu janë finalizuar dhe planet vjetore në bashkërendim me Kalendarin e Integruar, me qëllim bashkëveprimin me të gjithë aktorët brenda sektorëve të organizuara sipas GMIP/KDS/GT për të pasur mundësinë në këtë mënyrë të koordinimit dhe harmonizimit të proceseve në kuadër të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), si sistemi kryesor që përcakton mjetet dhe mekanizmat për një planifikim të integruar të politikave publike, duke siguruar një shpërndarje eficiente dhe efektive të burimeve financiare;

- Në kuadër të matjes së progresit gjatë vitit 2020 është finalizuar Raporti Vjetor 2019 për mekanizimin e menaxhimit sektorial/ndërsektorial të integruar në tri nivele raportuese:

- Grupet e menaxhimit të integruar të politikave në fushat prioritare (prioritetet);

- Komitetet drejtuese sektoriale brenda sektorëve me rëndësi të veçantë për reformat qeveritare;

- Grupet tematike brenda sektorëve specifike të fushës prioritare përkatëse.

Gjatë kësaj periudhe po bashkërendohet procesi me asistencën teknike me qëllim garantimin e një kuadri metodologjik të konsoliduar që do të validojë procesin për hartimin e Raportit të performancës/raport progresit për mekanizmin si dhe po krijohet gjithë infrastruktura e duhur për standardizimin e procedurave për funksionimin e GMIP/KDS/GT në zbatim të Urdhrit Nr. 157, datë 22.10.2018, të Kryeministrit, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë

sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen e funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”.

Sistemi IPSIS: qëllimi dhe përfitimi nga Platforma Qeveritare

Krijimi i bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS) i miratuar me vendim Këshilli të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020, përbën Platformën Sistemike të Qeverisë Shqiptare, siguron menaxhimin e politikave dhe financave publike në mënyrë të integruar. Platforma IPSIS krijon kushtet për të lidhur Politikat/masat legislative me buxhetimin, duke siguruar një informacion dhe monitorim në kohë reale të performancës, si edhe uljen e kohës së përpunimit të dokumenteve planifikuese nga administrata publike.

IPSIS-ja ndërvepron me një sërë sistemesh të tjera qeveritare si: Sistemi Informatik i Menaxhimit Financiar (SIMF), Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ), Sistemi Informatik i Menaxhimit të Ndihmës së Huaj (SIMNH), Regjistri Elektronik i Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike (RENKP), Sistemi i Arkivit të Akteve të Qendrës së Botimeve Zyrtare (sistemi i QBZ), Baza e të Dhënave Statistikore dhe Platformën për të Dhëna të Hapura.

Në kuadër të vlerësimit lidhur me disenjimin dhe përshtatjen e platformës IPSIS për përdorim dhe nga Njësitë e Qeverisjes Vendore janë zhvilluar hapat paraprake të analizës dhe hartimin të planit i cili do të garantojë në mënyrë të strukturuar pilotimin dhe më pas zbatimin dhe shtrirjen e sistemit për të gjithë Njësitë e Qeverisjes Vendore.

Platforma sistemike e njohurive afatmesme

Konsolidimi i sistemeve do të kërkojë nevojën për të hartuar një platformë për zhvillimin e kapaciteteve afatmesme dhe afatgjata të administrimit, duke synuar përmirësimin e njohurive të planifikimit strategjik me qëllim stimulimin lidhur me funksionet kryesore të SPI-së dhe zbatimit në drejtim të menaxhimit të sistemeve të performancës. Në këtë drejtim do të jetë e nevojshme për të vlerësuar kapacitetet e tanishme administrative sektoriale në vend në lidhje me hartimin e politikave (duke marrë parasysh sfidat e procesit të pranimit në BE), në mënyrë që të plotësohen boshllëqet për zbatimin më të mirë të



qasjes sistematike dhe politikave të lidhura me BE-në dhe legjislacionin që lidhet me *acquis*:

- Kapacitetet administrative duhet të tejkalojnë kërkesat teknike për forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore për përafrimin e *acquis* dhe të përqendrohet, gjithashtu, në elemente që përcaktojnë aftësinë e zbatimit të ligjeve dhe politikave të miratuara, siç janë mbivendosjet e mundshme institucionale;

- Aftësia për prodhimin dhe përdorimin e të dhënave administrative si dhe aftësi për politikë gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në prova dhe vendimmarrje, monitorim, raportim dhe komunikim të politikave etj.;

- Baza ligjore rregulluese e konsoliduar për politikat dhe ciklin e planifikimit strategjik;

- Forcimi dhe siguri i një sistemi të planifikuar të integruar të planifikimit, përmes bazës rregullatore të re/të përditësuar, si çështje prioritare, së bashku me udhëzime metodologjike gjithëpërfshirëse për ministrinë dhe sektorët respektivë, duke siguruar që legjislacioni të mbulojë të gjithë ciklin e planifikimit dhe të prezantojë kërkesat e qasjes sistematike;

Standardizimi i mjeteve të planifikimit dhe monitorimit të politikave, si dhe qasja e performancës, do të duhet të shtrihet gjithashtu në nivelin lokal, në mënyrë që të sigurojë një përafrim të politikave të nivelit kombëtar dhe rajonal/lokal;

- Disenjimi dhe zbatim pilot nga 3 deri në 5 NJQV për të zbatuar gradualisht qasjen sistematike të qeverisjes lokale përmes shtrirjes së sistemeve në të gjitha NJQV-të (IPSI & AFMIS) siç është parashikuar në strategjinë e menaxhimit të financave publike. Shtrirja e qasjes sistematike në nivelin lokal do të sigurojë standardizimin e instrumenteve dhe harmonizimin e kornizës së performancës në nivelin e njëjësive të qeverisjes së përgjithshme.

Kuadri rregullator për planifikimin strategjik

Draft ligji për planifikimin Strategjik bazohet në praktikat më të mira evropiane dhe të rajonit, lidhur me konsolidimin e kuadrit ligjor të mirërregulluar në lidhje me planifikimin strategjik:

- Gjatë vitit 2020 po përgatitet draft ligji për planifikimin strategjik, në zbatim të rekomandimeve të Nënkomitetit me Komisionin Evropian për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik/PAR *Special Group*. Ky rekomandim lidhet me konsolidimin ligjor për kuadrin e politikave me

qëllim konsolidimin e një kuadri ligjor të nivelit evropian;

- Kuadri strategjik për planifikimin strategjik do të përcaktojë parimet kryesore të planifikimit, drejtimit dhe proceset kryesore që lidhen me menaxhimin e politikave kombëtare si dhe instrumenteve kryesore që udhëheqin të tilla parime etj.

- Aktualisht draft ligji ka kaluar disa versione/modifikime dhe po konsultohen dhe me aktorë të brendshëm si fazë e parë për të marrë dhe opinione/*feedback* për përmirësimin e kuadrit rregullator.

Prioritetet e ardhshme në kuadër të qeverisjes

Mbështetje e vazhdueshme për Dialogun dhe Koordinimin e Politikave do të ofrohet për të përmirësuar mekanizmat institucionalë, kapacitetet dhe procedurat për planifikimin strategjik dhe të integruar si në nivelin qendror ashtu edhe në atë teknik. Fokusi do të jetë në forcimin e Sekretariatit të Përgjithshëm të Mekanizmit dhe gjithashtu forcimin e lidershit, si dhe planifikimin dhe aftësitë e programimit të secilit sekretariat teknik të GMPI/KDS-ve dhe të Grupeve Tematike të tyre.

Kuadri metodologjik lidhur me matjen e performancës së mekanizmit do të krijojë infrastrukturën e duhur për hartimin e raportit të progresit për Grupet e Menaxhimit të Integruar të Politikave.

Udhëzuesi metodologjik do të përmirësohet me mjetet e planifikimit dhe instrumentet zbatuese të cilat do të përmirësojnë cilësinë e veprimtarive të mekanizmit. Takime, trajnime dhe aktivitete të vazhdueshme do të ndërmerren për të arritur rezultate cilësore siç janë kalendar i integruar i aktiviteteve, planet vjetore të punës dhe raportet e progresit.

Qëllimi është të maksimizohet performanca e mekanizmit në të gjitha aspektet e tij, përfshirë koordinimin me donatorët dhe organizatat e tjera të rëndësishme si DBE dhe SIGMA.

Zbatim i plotë i Sistemeve të Menaxhimit të Informacionit do të digjitalizojë proceset e rëndësishme të bërjes së politikave dhe planifikimit, standardizimin e procedurave, përmirësimin e cilësisë së politikave dhe zbatimin e tyre si në kuadër të planifikimit, monitorimit, vlerësimit të politikave kombëtare sektoriale dhe ndërsektoriale.

Shoqëria civile



Udhërrëfyesi për Politikën e Qeverisë drejt një Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, i miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 539, datë 25.7.2019, ka tri drejtime strategjike dhe nëntë prioritete si më poshtë vijon:

Drejtimi Strategjik 1: Bashkëpunim i institucionalizuar qeveri-shoqëri civile në politikëbërje dhe në integrimin evropian:

- Prioriteti 1: Krijimi dhe ruajtja e një politike strategjike mbarëkombëtare për zhvillimin e shoqërisë civile;

- Prioriteti 2: Institucione qeveritare me mendësi shërbimi që vlerësojnë bashkëpunimin me OSHC-të;

- Prioriteti 3: Përfshirja e qëndrueshme dhe efikase e OSHC-ve në procesin e politikëbërjes;

- Prioriteti 4: Sigurimi i kontributit të OSHC-ve në procesin e aderimit në përputhje me praktikën e mira të BE-së;

- Prioriteti 5: Mbështetja e vullnetarizmit të OSHC-ve dhe qytetarisë aktive me fokus të veçantë në nivel lokal.

Drejtimi Strategjik 2: Mundësimi i mjedisit ligjor dhe qeverisjes së të dhënave:

- Prioriteti 6: Krijimi i një kuadri më mundësues për regjistrimin dhe funksionimin e OSHC-ve;

- Prioriteti 7: Mbledhja dhe disponueshmëria e të dhënave për zhvillimin e shoqërisë civile.

Drejtimi strategjik 3: Kuadër fiskal dhe finances i favorshëm:

- Prioriteti 8: Krijimi i një kuadri të financimit publik për mbështetjen e programeve të OSHC-ve në përputhje me praktikën e mira të BE-së;

- Prioriteti 9: Raportimi financiar/kontabilizimi dhe tatimi i OSHC-ve.

Zyra e Kryeministrit (ZKM) është përgjegjëse për bashkëveprimin e përgjithshëm dhe për monitorimin e zbatimit të aktiviteteve të Udhërrëfyesit nga ministratë e linjës dhe agjencitë shtetërore të përfshira. ZKM në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin Kombëtar për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (KKMSHC) siguron monitorimin e përgjithshëm të progresit.

Në kuadër të zbatimit të këtij Udhërrëfyesi, Kryeministria bashkëpunon me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri për zbatimin e projektit “Mbështetje për Zbatimin e Udhërrëfyesit për Politikën e Qeverisë” drejt një Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

(2019/413554). Periudha e zbatimit të projektit është janar 2020–korrik 2021.

Rezultatet e pritshme të projektit janë:

- Rritja e kapaciteteve të institucioneve kryesore dhe Grupeve të Punës Ndër Ministrorë për të drejtuar, monitoruar dhe raportuar mbi zbatimin e Udhërrëfyesit për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile mars 2020–shkurt 2021;

- Përmirësimi i kornizës legislative për regjistrimin dhe funksionimin e OSHC-ve për të krijuar një mjedis më të përshtatshëm.

Në këtë kuadër është hartuar Projektligji për Regjistrimin e OJF-ve, i cili pas përfundimit të procesit të konsultimit publik është miratuar nga Këshilli i Ministrave më 9.9.2020. Projekti tashmë është dërguar në Parlament. Projektligji erdhi si rezultat i një pune intensive mes palëve të përfshira, të drejtuar nga Ministria e Drejtësisë, që përveç ekspertizës pati edhe konsultime me organizatat e shoqërisë civile. Po kështu, në kuadër të projektit të bashkëpunimit me Delegacionin e BE-së, u mbështet edhe në dokumentin “*Analyses of possible models of NPOs registration and the Moneyval’s recommendations impacting on NPOs in Albania*” (Analizë e modeleve të mundshme të regjistrimit të OJF-ve dhe ndikimit të rekomandimeve të Moneyval mbi OJF-të në Shqipëri).

Në kuadër të zbatimit të projektit është hartuar për diskutim një paraqitje e kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile. Një kërkesë kjo edhe e Delegacionit dhe e komentuar edhe në Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë të vitit 2020.

Një element tjetër i rëndësishëm i projektit të bashkëpunimit është edhe zbatimi i një fushate ndërgjegjësimi, që për shkak të pandemisë do të zhvillohet *online*, me qëllim ndërgjegjësimin e organizatave të shoqërisë civile dhe publikut në tërësi për Udhërrëfyesin. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti është hartuar dhe Plani i Komunikimit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Shqipëri, Modalitete për grumbullimin e të dhënave të plota në lidhje me OJF-të në Shqipëri dhe rekomandimet për përmirësim të praktikës aktuale dhe opsione dhe modalitete për “Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit të udhërrëfyesit për politikën e qeverisë drejt një mjedisit mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile, 2019–2023”.



2.1.4 Reforma në administratën publike

Reforma në Administratën Publike është një proces thelbësor i lidhur ngushtë me rrugëtimin e vendit drejt Bashkimit Evropian dhe një prioritet i Qeverisë Shqiptare. Një administratë publike profesionale, e bazuar në meritokraci dhe e aftë për të ofruar shërbime cilësore ndaj publikut, është një parakusht për qeverisjen transparente dhe demokratike, si dhe është baza e implementimit të suksesshëm të reformave të ndërmarra.

Tashmë prej 6 vitesh vendi ka një kornizë strategjike të mirëpërcaktuar, e cila përbën themelet ku bazohet implementimi i Reformës së Administratës Publike. Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike (SNRAP 2015–2020), e miratuar në Prill 2015 shërben si një instrument planifikimi dhe monitorimi me qëllim krijimin e një administrate të qëndrueshme dhe të aftë për të përballuar sfidat e zhvillimit të vendit dhe prioritetet e anëtarësimit në BE.

Vizioni që udhëheq këtë Strategji është “Zhvillimi i një administrate publike që siguron shërbime me cilësi të lartë për qytetarët dhe bizneset në mënyrë transparente, efektive, dhe efikase, nëpërmjet përdorimit të teknologjive moderne dhe shërbimeve inovative dhe përputhet me kërkesat e integritetit evropian, nëpërmjet nëpunësve civilë të paanshëm, profesionalë dhe të përgjegjshëm, pjesë e strukturave eficiente.”

Gjatë vitit 2019, u miratua Plani i Ri i Veprimit 2018–2022 i SNRAP-së, i cili përfshin aktivitetet e planifikuara për t’u zbatuar nga institucionet shqiptare të përfshira në zbatimin e kësaj strategjie, për tri vitet e ardhshme, në katër shtyllat prioritare të saj, të cilat përbëjnë dhe fokusin kryesor të Reformës:

- Politikëbërja dhe cilësia e legjislacionit;
- Organizimi dhe funksionimi i Administratës Publike;
- shërbimi Civil dhe menaxhimi i Burimeve Njerëzore;
- Procedurat administrative dhe mbikëqyrja.

Me miratimin e Planit të Ri të Veprimit u realizua shtrirja e kuadrit strategjik të Reformës deri në vitin 2022 duke siguruar kështu dhe mbështetjen strategjike për programimin e fondeve IPA 2019–2020.

Zbatimi i reformës së shërbimit civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore

Një ndër komponentët më të rëndësishëm të Reformës në Administratën Publike është zbatimi i reformës së Shërbimit Civil dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore. Progresi në këtë fushë është vlerësuar pozitivisht nga strukturat ndërkombëtare dhe arrijtet konkrete e rendisin Shqipërinë në vend të parë në Ballkanin Perëndimor sa i përket avancimit domethënës në menaxhimin e burimeve njerëzore.

Kështu, gjatë vitit 2020 ka vijuar përmirësimi i vazhdueshëm i procesit të rekrutimit në shërbimin civil. Tashmë ky proces është tërësisht *online* në të gjitha fazat e tij që nga i. aplikimi për vendet vakante të shpallura; ii. kontrolli dhe menaxhimi i procesit përmes panelit të rekrutimit, iii. ndërtimi i Bankës së Pyetjeve për testimin me shkrim, iv. gjenerimi i testeve me shkrim në mënyrë automatike, v. korrigjimi i testeve elektronikisht (*scantron*); vi. zhvillimi i testeve në formë elektronike edhe përmes platformës Administrata.al; vii. si dhe intervistimi *online*.

Departamenti i Administratës Publike, pavarësisht situatës pandemike në vend ka punuar intensivisht në drejtim të zbatimit të Planit Vjetor të pranimit në shërbimin civil për institucionet e administratës shtetërore, me fokus kryesor rritjen e cilësisë së procesit të rekrutimit dhe plotësimin e vendeve vakante të planifikuara për rekrutim në shërbimin civil. Nga fillimi i vitit 2020 deri në shtator, janë zhvilluar 375 konkurse ku 90 janë për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese dhe 285 për kategorinë ekzekutive dhe janë emëruar gjithsej 389 nëpunës civilë.

Në Mars 2020, për shkak të kufizimeve për parandalimin e përhapjes së COVID-19, procedurat e rekrutimit në administratën publike u pezulluan. Gjatë muajit Prill, me qëllim adresimin e situatës dhe rifillimin e organizimit të procedurave të rekrutimit duke respektuar kufizimet e vendosura, Departamenti i Administratës Publike vlerësoi mundësitë e zhvillimit të procedurave të rekrutimit plotësisht *online* përmes përdorimit të mjeteve të teknologjisë së informacionit ku në veçanti u konsiderua mundësia për të kaluar në testimin elektronik *online* përmes përdorimit të platformës Administrata.al.

Më datë 22 prill 2020, DAP-i zhvilloi procedurën e parë të rekrutimit plotësisht *online*



duke mundësuar vijimin e rekrutimit në institucionet shtetërore pjesë e shërbimit civil, në respektim të masave të distancimit social, duke shënuar kështu një hap më tej në digjitalizimin e procesit të rekrutimit. Zhvillimi i çdo hapi të procesit të rekrutimit *online*, duke përfshirë testimin me shkrim dhe intervistën me gojë, shënoi një rast suksesi në rajon duke e bërë Shqipërinë një praktikë për t'u ndjekur në Ballkanin Perëndimor. Për t'u ardhur në ndihmë aplikantëve mbi ndryshimet e reja në mënyrën e zhvillimit të procedurave të rekrutimit si dhe rritjen e kuptueshmërisë së kandidatëve ndaj këtyre fazave të rekrutimit, DAP-i ka asistuar në kohë reale aplikantët dhe kandidatët në çdo fazë të rekrutimit si dhe ka hartuar dhe publikuar dhe udhëzues për testimin me shkrim dhe intervistën. Ndërkohë janë trajnuar në mënyrë të vazhdueshme ekspertët që janë pjesë e Komisioneve të Vlerësimit për rekrutimin në shërbimin civil.

Me qëllim përmirësimit të kapaciteteve për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil dhe menaxhimin e burimeve njerëzore është rritur dhe lehtësuar ndjeshëm komunikimi i nëpunësve të cilët punojnë në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucioneve në nivel qendror përmes përdorimit të platformës administrata.al. Kjo platformë, e krijuar për të unifikuar proceset e menaxhimit të burimeve njerëzore si: rekrutimi, plotësimi i përshkrimeve të punës, vlerësimi i rezultateve në punë, zbatimi i vendimeve gjyqësore, procedimet disiplinore etj. ishte një vlerë e shtuar dhe një instrument tejet i dobishëm gjatë periudhës së pandemisë gjatë së cilës platforma ka pasur një rritje të përdoruesve të saj.

Sa i takon shtrirjes dhe funksionimit të Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), ky sistem vijon të popullohet dhe përditësohet me të dhëna të nëpunësve të administratës publike dhe numëron tashmë rreth 63,000 dosje personeli. Sa u takon zhvillimeve për gjenerimin e pagave përmes SIMBNJ, gjatë vitit 2020 është realizuar lidhja me sistemin e thesarit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe janë kryer testimet e nevojshme për të finalizuar ndërveprimin. Gjithashtu kanë vijuar trajnimet dhe ngritja e kapaciteteve të nëpunësve civil në këtë drejtim duke asistuar përdoruesit e SIMBNJ përmes shpërndarjes së materialeve udhëzuese (video) për

përdorimin e funksionaliteteve të reja në *web* për lidhjen e thesarit me SIMBNJ-në.

Një zhvillim i rëndësishëm në fushën e shërbimit civil është gjithashtu dhe progresi në drejtim të harmonizimit të përshkrimeve të punës ku 80% e përshkrimeve të punës të ministrave të linjës janë standardizuar dhe parashikohet finalizimi i tyre në fund të vitit 2020. Përmirësimi i cilësisë së përshkrimeve të punës do të shërbejë për të unifikuar përcaktimet e kriterëve për pozicionet (grupet e ngjashme) duke ndikuar kështu dhe në rritjen e cilësisë së procesit të rekrutimit. Paralelisht është hartuar dhe metodologjia e përcaktimit të proceseve të punës si dhe ka përfunduar manuali për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve për të mundësuar një proces vlerësimi sa më objektiv dhe sa më real. Të gjitha këto zhvillime ndikojnë në përmirësimin e menaxhimit të shërbimit civil përmes unifikimit dhe standardizimit të proceseve kryesore në fushën e burimeve njerëzore.

Sa i përket implementimit të reformës së pagave është drejt finalizimit dokumenti analitik mbi Politikën e Pagave me mbështetjen e ekspertizës së projektit IPA 2014 “Zbatimi i reformës së shërbimit civil në administratën publike”. Në këtë dokument përcaktohen elementet e reja të sistemit të pagave, mënyra e implementimit dhe vënies në zbatim të këtyre përcaktimeve. Ky është një proces tejet i rëndësishëm për faktin se kërkon një transformim dhe një vullnet të përgjithshëm për të zbatuar një skemë pagash të drejtë dhe transparent.

Në lidhje me Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrjen, zbatimi i vendimeve gjyqësore është po ashtu një ndër prioritetet kryesore në implementimin e Reformës në Administratën Publike. Për të garantuar zbatimin e procedurave të përcaktuara në aktet nënligjore, Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme duke asistuar dhe monitoruar të gjithë procesin, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe afatet kohore për Komisionet e Posaçme të ngritura pranë çdo institucioni për ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore. Ndjekja e këtij procesi ka rritje të ndjeshme të numrit të vendimeve gjyqësore të ekzekutuara ku deri në muajin shtator 2020, rezultoi se janë ekzekutuar gjithsej 269 vendime gjyqësore.



Shërbimet publike

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) gjatë vitit 2020 ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për reformimin e mënyrës së ofrimit të shërbimeve publike në sportel. Disa nga arritjet kryesore gjatë kësaj periudhe renditen më poshtë:

Qendrat e integruara ADISA

Në periudhën janar–shtator 2020, ADISA vijoi me planin e shtrirjes në territor me dy qendra të reja të integruara në bashkitë Lushnjë (janar 2020) dhe Elbasan (qershor 2020). Në kuadër të ngritjes së Qendrës së Integruar të Ofrimit të shërbimeve publike në qytetin e Elbasanit, gjatë muajt qershor 2020 është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet ADISA-s dhe Bashkisë Elbasan, me qëllim ofrimin e shërbimeve vendore pranë qendrës së integruar ADISA, në qytetin e Elbasanit. Gjatë muajt Janar 2020, në kuadër të konsolidimit të qendrave të integruara të ofrimit të shërbimeve publike është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, e cila ka si qëllim ofrimin e shërbimeve të ASCAL-së nëpërmjet sporteleve të zyrave rajonale/vendore të ADISA-s, sipas parimit të ndarjes së zyrave pritëse nga ato përgjegjëse.

Zyrat e përbashkëta me një ndalesë pranë bashkive (kolokimet)

Gjatë periudhës janar–shtator 2020, ADISA vijoi me planin e shtrirjes në territor edhe nëpërmjet zyrave të përbashkëta me një ndalesë pranë ambienteve të bashkive. Përkatësisht u operacionalizuan zyrat e përbashkëta me një ndalesë në bashkitë Pogradec (korrik 2020), Mat (gusht 2020) dhe Roskovec (Shtator 2020). Gjatë muajve maj–korrik 2020, në kuadër të ngritjes së sporteleve të shërbimit pranë “One Stop Shop” të Bashkisë Kolonje, Mat, Roskovec dhe Pogradec janë nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit me secilën prej tyre, të cilat kanë si qëllim krijimin e mundësisë për ofrimin e shërbimeve qendrore në një ambient të përbashkët me shërbimet vendore.

Standardizimi i informacionit për shërbimet publike

Me qëllim sigurimin e cilësisë dhe aksesit në lëvrimin e shërbimeve publike, si dhe unifikimit të eksperiencës së qytetarëve në sportel, përgjatë vitit 2020, ADISA ka standardizuar 17 formularë të rinj aplikimi për 5 institucione publike. Në total,

ADISA ka standardizuar 349 formularë aplikimi për 46 institucione publike, nga të cilat 232 formularë janë në përdorim për 32 institucione. Në vijim, në mënyrë që informacioni rreth shërbimeve publike dhe elementeve përbërëse, të jetë lehtësisht i kuptueshëm dhe i aksesueshëm nga qytetarët, përgjatë vitit korrent, ADISA ka standardizuar 72 Kartela Informative të reja për 2 institucione publike me të cilat është bashkëpunuar. Totali i Kartelave Informative të standardizuara nga ADISA është 1127 kartela informative për 62 institucione publike.

Shtimi i numrit të qytetarëve të kënaqur

Gjatë periudhës Janar–Shtator 2020 janë realizuar matjet e kënaqësisë qytetare pranë Zyrës Rajonale Tiranë 1 (shkurt), “One Stop Shop” Librazhd (mars, qershor), Zyrës Rajonale Fier (Qershor), Zyrës Vendore Lushnjë (korrik), “One Stop Shop” Divjakë (Korrik), Zyrës Rajonale Tiranë 2 (shtator 2020) dhe Zyrës Vendore Kavajë (shtator). Gjithashtu, gjatë periudhës janar–shtator 2020 janë realizuar monitorimet e kohës së aplikimit dhe kohës së pritjes pranë “One Stop Shop” Librazhd (mars, qershor), Zyrës Rajonale Fier (qershor), Zyrës Vendore Lushnjë (korrik), “One Stop Shop” Divjakë (korrik), Zyrës Rajonale Tiranë 2 (shtator 2020) dhe Zyrës Vendore Kavajë (shtator).

Projekte inovative

- ADISA Lab është në proces të zhvillimit të paketave të informacionit kushtuar komunitetit Rom dhe Egjiptian, të cilat do të përmbajnë të gjithë informacionin përkatës për përfitimet e shërbimeve publike të dedikuara për këtë komunitet. Deri më tani, të gjitha shërbimet janë identifikuar dhe vijon procesi i vendosjes së të gjitha informacioneve në faqen e internetit.

- Online Chat ADISA - Për shkak të situatës pandemike të koronavirusit dhe pas urdhrit të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ADISA ishte e detyruar të mbyllte të gjitha zyrat e shërbimit si një masë për të parandaluar grumbullimet dhe për të shmangur përhapjen e mëtejshme të virusit. Pas kësaj mase, ADISA vendosi të promovojë kanalet e saj alternative informuese. Përveç email-it zyrtar dhe kanaleve të përbashkëta të mediave sociale, për shumë pak ditë u zhvillua një urë e re komunikimi midis ADISA dhe qytetarëve. Vendosja e Online Chat në faqen zyrtare të ADISA siguroi një mënyrë të re për të



komunikuar në mënyrë interaktive me qytetarët që kërkojnë informacion/ndihmë për përdorimin e tyre të përditshëm të shërbimeve publike.

Harta e aksesit - ADISA Lab po punon gjithashtu për një ide të re në lidhje me zhvillimin e një harte të aksesit, për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuara të gjejnë institucionet që ofrojnë akses në to përfshirë infrastrukturën, aspektet logjistike dhe komunikimin.

Në Qendrat e Integruara ADISA, është e mundur të aplikohet nëpërmjet portalit *e-Albania* për 750 shërbimet *online*, si dhe 70 shërbimet vendore.

Prioritetet e ADISA-s

Fokusi i ADISA-s do të jetë në prioritetet si më poshtë:

1. Realizmi i investimeve për të bërë të mundur shtrirjen e ADISA në territor nëpërmjet qendrave të integruara dhe zyrave të përbashkëta me një ndalesë pranë ambienteve të bashkive. Ky është një proces i cili nuk varet plotësisht nga vetë institucioni, por nga zhvillimi i procedurave të prokurimit dhe afatet ligjore.

2. Funksionimi i qendrave të integruara dhe kanaleve të tjera të shërbimit nuk do të ishte i plotë pa monitorimin dhe vlerësimin rigoroz të performancës për të ndihmuar në identifikimin e mënyrave për të përmirësuar vazhdimisht aktivitetin e qendrave/sporteve të shërbimit kundrejt objektivave dhe synimeve. Vlerësimi i performancës së ADISA për sportelet e shërbimit synon të përmirësojë ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët dhe rritjen e kënaqësisë së përgjithshme të përdoruesve të shërbimeve.

3. Tani që ADISA ka forcuar kapacitetet dhe ka arritur rezultate të prekshme, ka nevojë që të krijojë dhe zbatojë një kuadër të menaxhimit të cilësisë në të gjitha qendrat e integruara si dhe të investojë përpjekje për të siguruar që mjetet e kontrollit të cilësisë të paraqiten gjithashtu në të gjitha institucionet publike që ofrojnë shërbime në sportel.

Menaxhimi i financave publike

Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë vitit 2019 ka vijuar me zbatimin e reformave të ndërmarra në fushën e menaxhimit të financave publike, të cilat materializohen në Strategjinë e re të Menaxhimit të Financave Publike 2019–2022, e cila u miratua në 18 dhjetor 2019. Kjo strategji përbëhet nga shtatë objektiva specifike (OS), si:

- OS1: Kuadër fiskal i matur dhe i qëndrueshëm;

- OS2: Planifikim i mirintegruar dhe efikas;

- OS3: Mbledhja e të ardhurave;

- OS4: Zbatim efikas i buxhetit;

- OS5: Transparenca e financave publike;

- OS6: Kontroll i brendshëm efektiv;

- OS7: Mbikëqyrje efektive e financave publike.

Qeveria e Shqipërisë ka bërë progres në zbatimin e Strategjisë së Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2019–2022, dhe zhvillimet gjatë 2019 dhe gjenden të prezantuara në raportin e monitorimit të publikuara në faqen zyrtare të MFE-së¹⁵.

Përmbledhje e arritjeve kryesore

- Një sërë instrumentesh të Strategjisë së MFP në lidhje me ndryshimet legjislative, aktivitetet për zhvillim kapacitetesh, Sistemin e Menaxhimit të Integruar Financiar (SMIF), si dhe ndryshimet në kulturën e menaxhimit dhe procesit janë zhvilluar nëpërmjet zbatimit të masave të ndërmarra dhe kanë rezultuar në:

- Gjatë vitit 2019, monitorimi i NSH-ve u shtri më tej edhe në performancën e sektorit të ujësjellësit dhe përgatitjen e një baze të dhënash për performancën e tyre financiare dhe jofinanciare;

Procesi i analizës së cilësisë së prioritetëve strategjike shfaqti ecuri. U analizua procesi i zbatimit të Udhëzimit Standard për Përgatitjen e Buxhetit në njësitë e qeverisë qendrore dhe u konstatua se ka ende hendeqe dhe mospërputhje në zbatimin e udhëzimit nëpër sektorë të ndryshëm;

- Gjithashtu, u përgatit dhe u përfundua një modul i ri për programin buxhetor afatmesëm (PBA), si një zgjatim i Sistemit ekzistues Informatik për Financat Qeveritare (SIFQ) në Sistemin Informatik për Menaxhimin Financiar (SIMF), i cili u shtri në 25 ministri linje dhe Institucione Buxhetore, nga 45 që ishin planifikuar për vitin 2019. Drejtoria për Menaxhimin e Investimeve Publike kreu trajnime të thelluara mbi propozimet për investimet publike që dërgohen për aprovim dhe për modulin e ri për menaxhimin e investimeve publike (MIP);

- Në lidhje me PPP-të, u bënë ndryshime ligjore në vitin 2019 me qëllim ndalimin e propozimeve të

¹⁵ <http://financa.gov.al/raportet-e-monitorimit-2/>



pakërkuara dhe për të forcuar monitorimin e PPP-ve dhe koncesioneve;

- Në vitin 2019, administrata tatimore përfundoi dizajnin e procedurave të automatizuara me bazë riskun për të gjitha rimbursimet e TVSH-së dhe krijoi një regjistër, të saktë dhe të plotë, të tatimpaguesve;

- Për reformën në fushën e taksës mbi pronën, gjatë vitit 2019 filloi taksa e pronës për ndërtesat, sipas vlerës së zonës fiskale si dhe funksionalizimi i mbledhjes së taksës. Kuadri rregullator për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD), veçanërisht Informacioni i Detyrueshëm Tarifor (IDT) dhe Nomenklatura e Mallrave, u harmonizua më shumë me *Acquis*;

- Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit po punon për të përmirësuar parashikimin e likuiditetit dhe monitorimin, por nuk u përmbush çdo aktivitet sipas planit. Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit (DPB) miratoi dhe publikoi Strategjinë për Menaxhimin e Borxhit 2020- 2022 para fundit të vitit 2019;

- Ka pasur ecuri në ndryshimin e ligjit, “Për prokurimin publik” për ta harmonizuar më shumë me *acquis* (direktivat e reja të BE-së). Komisioni i ri për Prokurimin Publik (KPP) u bë funksional më 16 korrik 2018 dhe u plotësuan të tria vendet bosh, sipas planifikimit për vitin 2019;

- Grupi ndërinstitucional i punës (INSTAT, MoFE dhe Banka e Shqipërisë) gjatë vitit 2019 zhvilluan sistemet për shkëmbimin e të dhënave më synim krijimin e një sistemi statistikor të qëndrueshëm për njësitë e qeverisë qendrore. U rishikuan formatet dhe përmbajtja e raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit, siç dhe ishte synuar për vitin 2019;

- Gjithashtu, gjatë vitit 2019, u përgatit dhe u publikua Buxheti për Qytetarët. Organizatat e shoqërisë civile u trajnuan për të rritur kapacitetet e tyre për të kuptuar ciklin buxhetor. Bazuar në analizën e mangësive ndërmjet kuadrit aktual të kontabilitetit dhe Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në fushën e Sektorit Publik (IPSAS), në muajin tetor 2019, qeveria aprovoi një plan veprimi strategjik për vendin për kalimin drejt IPSAS;

- U krye një vlerësim në vitin 2019 për të kuptuar se deri në çfarë mase ishin zbatuar në praktikë sistemet e kontrollit të brendshëm dhe

llogaridhënies menaxheriale nga ana e institucioneve buxhetore;

- Audituesit e brendshëm kanë vlerësuar gjithnjë e më shumë përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm duke dhënë rekomandime për përmirësime. Gjatë vitit 2019, për të rritur rolin e inspektorëve financiarë, u organizuan trajnime vetëm për inspektorët e brendshëm;

- Për të rritur ndikimin e auditimit falë komunikimit më të mirë me të gjitha palët e interesit, u realizuan shumica e aktiviteteve të planifikuara në Strategjinë e Komunikimit 2017-2019. Gjithashtu, u krijua një Sekretariat i Përbashkët midis Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe MFE me qëllim kërkimin e formave për të përmirësuar shkallën e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së dhe të auditimit të brendshëm dhe një numër raportesh për aktivitetet e KLSH-së u dorëzuan në Parlament;

- Pas miratimit të Strategjisë, MFE rishikoi dhe përditësoi menaxhimin dhe monitorimin e strukturës institucionale të Strategjisë së MFP-së. Në përfundim të këtij procesi u përgatiten Termat e Referencës së Komiteteve të MFP-së, Pasaporta e Treguesve dhe Formatet e raportimeve, të cilat u miratuan në prill 2020. Pas miratimit të mekanizmit monitorues, MFE vijoi përgatitjen e raportit vjetor. Raporti i fundit i monitorimit i prodhuar është raporti vjetor i monitorimit i MFP-së për vitin 2019, i cili gjithashtu është publikuar në faqen e internetit të MFE-së;

- Komitetet e Koordinimit të Objektivave Specifikë (KKOS) u funksionalizuan dhe u vitalizuan për të koordinuar secilin objektiv specifik. Gjatë periudhës gusht–tetor 2020, u organizuan takime për secilin KKOS për të diskutuar për ndryshimet e propozuara.

Prioritetet

- Prioritet e qeverisë në fushën e financave publike, vijojnë të qëndrojnë të njëjta si para pandemisë, por me një angazhim në rritje, konkretisht si:

- reduktimi i borxhit publik;

- shlyerja dhe parandalimi i detyrimeve ta prapambetura;

- mobilizimi i vazhdueshëm për mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe doganore;



- përmirësimi i menaxhimit të projekteve të investimeve publike duke përfshirë Partneritetin Publik Privat dhe dhënien me koncesione;

- sigurimi i një lidhje më e mirë e planeve strategjike me Programin e Buxhetit Afatmesëm;

- një angazhim më të strukturuar dhe në kohë me qytetarët, me organizatat e shoqërisë civile dhe me akademinë në planifikimin, monitorimin dhe raportimin e buxhetit;

- rritja e përpjekjeve për të përmirësuar shkallën e zbatimit të rekomandimeve dhe gjetjeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

2.1.5 Sistemi gjyqësor dhe reforma në sistemin e drejtësisë

Për më shumë informacion referohuni te kapitulli 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”.

2.1.6 Antikorrupsioni

Lutemi referohuni te kapitulli 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”.

2.2 Të drejtat e njeriut

Lutemi referohuni te kapitulli 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”.

2.3 Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare

2.3.1 Bashkëpunimi rajonal

- Prioriteti kryesor i politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë në rajon është promovimi dhe kontributi në stabilitetin politik, paqen, sigurinë dhe zhvillimin ekonomik përmes bashkëpunimit si në nivelin dypalësh dhe në atë shumëpalësh. Një rajon i sigurt dhe i qëndrueshëm politikisht që zhvillon lidhje të duhura ekonomike brenda tij, dhe me pjesën tjetër të botës, u shërben interesave kombëtarë të Shqipërisë por është, gjithashtu, në interes të gjitha vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor dhe të fqinjëve tanë.

- Republika e Shqipërisë e sheh të ardhmen e të gjitha vendeve të Ballkanit si anëtare të BE. Nga kjo pikëpamje, Republika e Shqipërisë konsideron bashkëpunimin e mirë rajonal në të mirë të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe si një proces përgatitor për anëtarësimin e ardhshëm në BE. Duke qenë një pjesëmarrëse aktive e Procesit të Berlinit, Republika e Shqipërisë është përqendruar në mundësimin e qytetarëve të Ballkanit Perëndimor për të shijuar katër liritë themelore të BE (lëvizja e lirë e mallrave, kapitalit, shërbimeve dhe personave). Për këtë qëllim, Qeveria Shqiptare ka promovuar iniciativën e bashkëpunimit të zgjeruar rajonal që aktualisht ka tre pjesëmarrës

(Republika e Shqipërisë, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Republika e Serbisë), por që mbetet e hapur për pjesëmarrjen e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor (Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Republika e Kosovës). Gjithashtu Qeveria e Republikës së Kosovës ka deklaruar dëshirën e saj për t’iu bashkuar nismës. Pritet që Samiti në Sofje në nëntor të marrë vendime të rëndësishme në këtë drejtim.

- Plani i investimeve për Ballkanin Perëndimor do të jetë një mjet i rëndësishëm për të sjellë në jetë projekte kritike infrastrukturore (transporti, energjia, telekomunikacioni) që do të ndihmojnë në bashkimin e ekonomive të Ballkanit Perëndimor, do të rrisë integrimin dhe konkurrencën e tyre për tregjet globale dhe investimet direkte për vendet e huaja.

- Republika e Shqipërisë vazhdon të marrë pjesë aktivisht në iniciativa rajonale si Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), Traktati i Komunitetit të Energjisë, Marrëveshja e Zonës së Përbashkët të Aviacionit Evropian, Iniciativa Evropa Qendrore, Nisma Rajonale për Migrim dhe Azil dhe “Procesi Brdo - Brijuni”. Në Prill 2019 Shqipëria priti Samitin Brdo - Brijuni, ndërsa në gjashtë muajt e parë të 2021 do të kryesojë organizatën e Bashkimit Ekonomik të Detit të Zi. Shqipëria pret dy mekanizma rajonalë të bashkëpunimit Fondi i Ballkanit Perëndimor dhe Zyra Rajonale e Bashkëpunimit Rinor.

- Republika e Shqipërisë nuk ka mosmarrëveshje kufitare, apo ndonjë çështje tjetër kritike të pazgjidhur dypalëshe me vendet e saj fqinje. Çështjet ekzistuese të hapura trajtohen përmes dialogut në një frymë bashkëpunimi konstruktiv dhe kompromisi. Për çështjen e përhershme të përcaktimit të zonave detare me Greqinë është rënë dakord së fundmi që t’i kaloje për gjykim Gjykatës së Drejtësisë në Hagë.

- Republika e Shqipërisë vazhdon të forcojë marrëdhëniet dypalëshe me të gjitha vendet e rajonit, duke mbajtur një dialog intensiv me ta dhe duke zbatuar mekanizmin e takimeve të përbashkëta qeveritare që mundëson një bashkëpunim më efektiv dhe të thelluar. Ajo gjithashtu mban një marrëdhënie shumë të mirë me Shtetet Anëtare Fqinje të BE-së.

**Republika e Kosovës**

- Republika e Shqipërisë mban marrëdhënie të shkëlqyera me Republikën e Kosovës, bazuar në Traktatin dypalësh për Partneritet Strategjik. Të dyja vendet nuk kanë çështje të pazgjidhura, ndërsa punojnë së bashku për të promovuar bashkëpunimin ekonomik dhe për të rritur vëllimin e tregtisë;

- Bashkëpunimi midis dy vendeve konsiderohet strategjik, stabilizues për rajonin dhe orientues për perspektivën Euro- Atlantike;

- Partneriteti Strategjik gjithëpërfshirës me Kosovën zbatohet përmes marrëveshjeve dhe protokolleve të nënshkruara gjatë gjashtë takimeve Qeveritare që kanë ndodhur deri më tani. Ato kanë mundësuar një paketë për të zhvilluar marrëveshje bilaterale që mbulojnë të gjitha fushat e bashkëpunimit, përfshirë zhvillimin e tregtisë, bashkëpunimin midis autoriteteve doganore, infrastrukturën e transportit, bashkëpunimin energjetik, bujqësinë, turizmin, arsimin, bashkëpunimin kulturor, por edhe bashkëpunimin e sigurisë, lehtësimin e kontrollit të kufirit procedurat, luftën kundër krimit të rëndë dhe të organizuar, zbatimin e politikës së jashtme, dhe më shumë;

- Republika e Shqipërisë mbështet fuqimisht dialogun e drejtuar nga BE midis Kosovës dhe Serbisë, rezultati përfundimtar i së cilës duhet të jetë një marrëveshje e detyrueshme ligjërsh për normalizimin gjithëpërfshirës të marrëdhënieve midis dy shteteve, me njohje reciproke;

- Qeveria shqiptare mbështet përpjekjet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të sjellë stabilitet politik dhe ekonomik dhe dialogun me Serbinë;

- Republika e Shqipërisë mirëpret marrëveshjen e nënshkruar në Uashington në 4 shtator 2020 nga Kryeministri Hoti dhe Presidenti Vuçic si një hap i rëndësishëm drejt normalizimit të marrëdhënieve ekonomike dhe si mbështetjen e dialogut të drejtuar nga BE Kosovë-serbi;

- Ka tendenca inkurajuese të rritjes së vëllimit të tregtisë midis dy vendeve;

- Nuk kërkohet vizë për të udhëtuar për qëndrim të shkurtër midis dy vendeve. Shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës mund të udhëtojnë ndërmjet dy vendeve vetëm me kartë identiteti.

Bosnja dhe Hercegovina

- Marrëdhëniet me Bosnjë dhe Hercegovinën (BiH) janë të mira. Bashkëpunimi dhe gatishmëria për të intensifikuar dialogun politik kanë vazhduar të diskutohen midis autoriteteve në kuadrin e takimeve bilaterale, rajonale dhe ndërkombëtare;

- Republika e Shqipërisë mbështet fuqimisht sovranitetin, integritetin territorial, kohezionin shoqëror të Bosnjë dhe Hercegovinës, si dhe përparimin e saj në rrugën euroatlantike;

- Shqipëria është e vendosur kundër çdo përpjekje destabilizuese dhe retorikës “separatiste” që vjen nga brenda dhe jashtë Bosnje Hercegovinës;

- Shqipëria shpreh shqetësim në lidhje me rritjen e tensioneve etnike në Bosnje dhe po ndjek me kujdes situatën atje;

- Shqipëria mbështet aspiratat Euro Atlantike të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe mirëpret gatishmërinë e NATO-s për të pranuar dorëzimin e dokumentit të parë të Sarajevës, të ngjashëm me Programin Kombëtar Vjetor;

- Shqipëria pret nga Bosnja më shumë angazhim në bashkëpunimin rajonal, përfshirë përfshirjen e të gjashtë vendeve të BB në iniciativat rajonale, si dhe një qëndrim më të hapur ndaj përfshirjes së Republikës së Kosovës në mekanizmat e bashkëpunimit rajonal;

-Shqipëria beson se ka ardhur koha për të miratuar një pozicion të ri ndaj Kosovës dhe duhet të rishikojë njohjen e dokumenteve të Republikës së Kosovës dhe lehtësimin e regjimit të vizave për qytetarët e Kosovës;

- Shqipëria ka ende çështjen e hapur të anëtarësimit të Kosovës në Kartën SHBA-Adriatik, e kërkuar zyrtarisht gjatë Presidencës 2014 dhe deri më tani e bllokuar nga Bosnje si rezultat i konsideratave të njëanshme politike dhe presionit nga vendet e treta;

- Vëllimi i tregtisë midis Republikës së Shqipërisë dhe Bosnjë dhe Hercegovinës është akoma modest. Ndërsa një regjim pa viza ka qenë në fuqi që nga viti 2010, në vitin 2018 u mundësua udhëtimi i qytetarëve nga të dyja vendet gjithashtu vetëm me letërnjoftim.

Serbia

- Marrëdhëniet me Republikën e Serbisë kanë përparuar më tej, me gatishmërinë për t'i shërbyer bashkëpunimit dypalësh dhe rajonal, si dhe në përfitim të përforcimit të energjive drejt projektit të



bashkimit reciprok të integritimit Evropian. Pozicionet e kundërta të Republikës së Serbisë dhe Republikës së Shqipërisë ndaj Republikës së Kosovës kanë pasur ndikimin e tyre në dinamikën e marrëdhënieve dypalëshe, por qeveria shqiptare përpiqet të gjejë dhe eksplorojë në mënyrë të vazhdueshme rrugët e bashkëpunimit në përfitim reciprok, duke mbajtur çështjen e Kosovës si shumë e rëndësishme për rajonin, por si çështje bilaterale midis Kosovës dhe Serbisë, jo Shqipërisë dhe Serbisë;

- Shqipëria mirëpret përparimin e bërë nga Republika e Serbisë gjatë negociatave të pranimit në BE;

- Qeveria shqiptare e kupton që marrëdhëniet bilaterale me Serbinë kanë implikime dhe ndikime të shumfishta në nivel rajonal, përfshirë në Kosovë dhe për shqiptarët që jetojnë në rajon;

- Shqipëria mbështet fuqimisht dialogun Kosovë-serbi të udhëhequr nga BE. Rezultati përfundimtar duhet të jetë një Dokument i detyrueshëm ligjor për normalizimin gjithëpërfshirës të marrëdhënieve midis dy shteteve. Por Shqipëria pret që pala serbe të jetë e drejtpërdrejtë dhe e sinqertë në dialogun me Kosovën;

- Ekziston një ofensivë diplomatike e vazhdueshme nga Serbia kundër shteteve të ndryshme në mënyrë që të tërhiqet njohja e KS dhe të pengohet anëtarësimi i Kosovës në nismat më të rëndësishme rajonale. Kjo ofensivë është kundër frymës së bashkëpunimit rajonal, Procesit të Berlinit dhe Dialogut KS-sER të lehtësuar nga BE. Serbia duhet të ndalojë këtë ofensivë, në kundërshtim me Ligjin Ndërkombëtar dhe minimin e stabilitetit rajonal;

- Shqipëria shikon me një vëmendje të veçantë situatën e shqiptarëve që jetojnë në Serbinë e Jugut, kështu që ata marrin atë që u takon, më shumë respekt dhe përfshirje në jetën socio- ekonomike të vendit të tyre, në përputhje me detyrimet e Serbisë dhe në përputhje me normat ndërkombëtare dhe të drejtën evropiane;

- Ekziston një varg marrëveshjesh bilaterale në fuqi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Serbisë;

- Republika e Serbisë është partneri kryesor tregtar i Shqipërisë në rajon;

- Ka një regjim pa viza në fuqi midis dy vendeve, por shtetasit shqiptarë dhe serbë mund të udhëtojnë në të dyja vendet vetëm me pasaporta.

Mali i Zi

- Marrëdhëniet me Malin e Zi janë intensifikuar dhe vazhdojnë të jenë veçanërisht të mira dhe miqësore. Një marrëdhënie dinamike dhe produktive ka prodhuar një bashkëpunim dypalësh në rritje. Shqipëria mirëpret përparimin e bërë nga Mali i Zi gjatë negociatave të pranimit në BE;

- Pas mbledhjes së parë të përbashkët të të dyja qeverive në Shkodër (2018), të dyja vendet po punojnë për të përgatitur G2G të dytë këtë vit. Konsultimet për çështje të ndryshme janë mbajtur rregullisht;

- Ka pasur një shkëmbim intensiv gjithashtu në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, në kuadrin e pranimit në BE, NATO, Procesit të Berlinit dhe Iniciativa Trilaterale Shqipëri–Mali i Zi–Kroaci. Bashkëpunimi ndërkufitar u forcua me projekte konkrete që përmirësojnë infrastrukturën në të dyja anët e kufirit;

- Shqipëria vlerëson zgjedhjet e fundit të përgjithshme në Mal të Zi dhe thekson vullnetin për të punuar më tej me qeverinë e re në agjendën e përbashkët euroatlantike;

- Shqipëria dhe Mali i Zi bazohen në të dhënat pozitive ekzistuese, përmes shkëmbimeve dhe konsultimeve të rregullta politike dhe diplomatike;

- Të dyja qeveritë janë të përkushtuara për të punuar drejt rritjes së vëllimit të tregtisë që aktualisht mbetet modeste;

- Bashkëpunimi në sektorin e turizmit konsiderohet veçanërisht i rëndësishëm, ndërkohë një regjim i udhëtimit pa viza gjithashtu me karta identiteti ekziston që prej vitesh.

Maqedonia e Veriut

- Marrëdhëniet me Maqedoninë e Veriut janë intensifikuar dhe vazhdojnë të jenë veçanërisht të mira dhe miqësore. Dialogu ndërshtetëror midis qeverive është i qëndrueshëm, i fortë dhe i integruar përmes bashkëpunimit të gjerë dypalësh në shumë sektorë dhe fusha;

- Dialogu politik progresiv me shkëmbimet e vizitave në nivelet më të larta janë intensifikuar me vizitat e ndërsjella në nivelin e kreut të shtetit, kryetarët e parlamenteve, kryeministrat, ministrat e punëve të jashtme dhe të tjerë;

- Shqipëria mirëpret përpjekjet dhe arritjet e qeverisë së Maqedonisë së Veriut për të ndërtuar



një shoqëri funksionale multietnike bazuar në zbatimin e plotë të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit dhe ligjit për gjuhët dhe shpreson që autoritetet në Shkup të bëjnë përpjekje të mëtijshme për këtë çështje;

- Pas takimit të parë të përbashkët të të dyja qeverive më 2017-ën, të dyja vendet po punojnë për të përgatitur G2G të dytë këtë vit. Një agjendë ambicioze po diskutohet për takimin e dytë të përbashkët qeveritar në Maqedoninë e Veriut, i cili përfshin forcimin e lidhjes, përfundimin e korridoreve të infrastrukturës, energjisë dhe lëvizshmërisë, me një fokus të veçantë në projektet madhore të infrastrukturës dhe lidhjes së energjisë:

- Korridori i 8-të, Segmenti Durrës-Elbasan-Shkup;

- Rruga e Arbrit dhe shtrirja në segmentin Bllata-Shkup;

- Përfundimi i interkonektorit 400 KV;

- Ndërtimi i hekurudhës Kiçovo - Ohër me shtrirje deri në Lin;

- Pika e përbashkët doganore dhe e Kalimit Kufitar në Qafëthanë.

- Vëllimi i tregtisë megjithëse relativisht modest është në një trend rritës, ndërsa regjimi i udhëtimit pa viza gjithashtu me karta identiteti ekziston që prej viteve.

Greqia

- Marrëdhëniet me Greqinë mbetën të mira. Greqia është një fqinj i çmuar, por edhe partneri i Shqipërisë në rrugën e saj drejt demokracisë, progresit dhe integritetit evropian;

- Për vite Greqia ka qenë në krye të listës së partnerëve në tregti dhe investime të huaja direkte. Një pjesë e konsiderueshme e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Shqipërisë është orientuar drejt Greqisë, duke i bërë ekonomitë e të dyja vendeve fort të ndërlidhura ndërmjet tyre;

- Arritjet në bashkëpunimin dypalësh përfshijnë zbatimin e marrëveshjes për kërkimin, zhvarrosjen, identifikimin dhe varrosjen e ushtarëve grekë të rënë në territorin shqiptar gjatë Luftës italo-greke të 1940–1941, tërheqjen e rezervës Greke për pranimin e Shqipërisë në Konventa Apostille, finalizimi i suksesshëm i rishikimit të teksteve shkollore dhe nënshkrimi i marrëveshjes për njohjen reciproke të lejeve të drejtimit;

- Dialogu politik midis dy vendeve bëri një hap shumë pozitiv gjatë vizitës së fundit (20 tetor 2020) të Ministrit Grek të Punëve të Jashtme Dendias

gjatë së cilës të dyja vendet bënë publik vendimin e tyre për të referuar pranë Gjykatës së Drejtësisë në Hagë çështjen e caktimit të zonave të ndërsjella detare në Detin Jon, duke hapur kështu rrugën për zgjidhjen e çështjes bilaterale më të vështirë të hapur midis Shqipërisë dhe Greqisë;

- Ekziston një komunitet i madh shqiptarësh që jetojnë dhe punojnë në Greqi që nga fillimi i viteve 90, ndërsa ekziston një pakicë greke që jeton kryesisht në jug në Shqipëri. Si minoriteti grek, ashtu edhe komuniteti shqiptar në Greqi janë ura që u shërbejnë marrëdhënieve të mira midis vendeve tona.

Italia

- Marrëdhëniet me Italinë janë jashtëzakonisht të mira. Italia mbetet një nga partnerët kryesorë strategjikë të Shqipërisë;

- Bashkëpunimi bazohet në marrëdhënie të jashtëzakonshme historike, kulturore dhe ekonomike. Dialogu ndërshtetëror midis qeverive është i qëndrueshëm, i fortë dhe i integruar përmes bashkëpunimit të thellë dypalësh në shumë sektorë dhe fusha;

- U intensifikua dialogu progresiv politik me shkëmbimet e vizitave në nivelet më të larta (vizita e Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar z. Milanesi në Tiranë në 15 janar 2019, vizita e Kryeministrit z. Rama në Romë në 5 mars 2019, vizita e kryetarit të Kuvendit z. Ruçi në Romë më 16 prill 2019);

- Bashkëpunimi në fushat e mbrojtjes dhe drejtësisë dhe punët e brendshme u forcua më tej, veçanërisht në luftën kundër krimit të organizuar, trafikut të drogës, trafikimit të qenieve njerëzore, migracionit të paligjshëm dhe azilit. Shqipëria po bashkëpunon ngushtë me Italinë për migracionin e parregullt. Italia mbetet partneri i parë tregtar i Shqipërisë dhe një nga donatorët kryesorë të Shqipërisë.

Turqia

- Marrëdhëniet tradicionalisht të mira midis Shqipërisë dhe Turqisë kanë evoluar drejt një partneriteti të fortë dhe efektiv, i cili është reflektuar drejtpërdrejt në dialogun e shkëlqyeshëm politik në nivelin më të lartë të mundshëm;

- Ka një prani në rritje të investimeve turke, veçanërisht në fushat e energjisë, sistemit bankar, telekomunikacionit dhe infrastrukturës. Kompania Ajrore e Shqipërisë “Air Albania”, një ndërmarrje e



përbashkët me Turkish Airlines, filloi fluturimet Tiranë-Stamboll në 24 Prill 2019;

- Gjatë vitit 2019, bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe Turqisë në fushën e sigurisë, antiterrorizmit si dhe shkëmbimi i informacionit në lidhje me personat e dyshuar për lidhje me terrorizmin është intensifikuar, të dy ministrat e Brendshëm kanë bërë vizita zyrtare në të dyja kryeqytetet përkatëse.

2.3.2 Marrëdhëniet Bashkimi Evropian-Shqipëri

- Në 3 dekadat e fundit, integrimi evropian ka qenë një nga prioritetet më të rëndësishme të politikës së jashtme të Shqipërisë dhe forca shtytëse për arritjen e mirëqenies ekonomike, sociale dhe stabilitetin politik. Qeveritë shqiptare, pa marrë parasysh nga cili sfond politik vinin, kanë marrë vendime, duke e pasur integrimin në Bashkimin Evropian si një parim themelor dhe orientues.

- Shqipëria paraqiti kërkesën e saj për anëtarësim në BE në Prill të vitit 2009. Në tetor të 2013, Komisioni Evropian rekomandoi që Shqipërisë t'i jepej statusi i kandidatit për në BE, në varësi të ndërmarrjes së disa masave në kuadër të reformave kyçe që vendi ynë do të duhej të realizonte. Dokumenti i Strategjisë së Zgjerimit 2013- 2014, i Komisionit Evropian identifikoi pesë përparësi kryesore që duheshin adresuar përpara nisjes së negociatave zyrtare të pranimit:

- Zbatimi i vazhdueshëm i reformës në administratën publike;

- Reforma në sistemin gjyqësor dhe forcimi i pavarësisë, efikasitetit, paanshmërisë dhe llogaridhënies së institucioneve të drejtësisë;

- Forcimi i luftës ndaj korrupsionit;

- forcimi i masave për të luftuar krimin e organizuar;

- Përmirësimi i politikave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshirë personat që u përkasin minoriteteve dhe zbatimin e të drejtave pronësore (kolektivisht të quajtura “Pesë Prioritetet kryesore të integritetit në BE”).

- Në maj 2014, Qeveria shqiptare miratoi një udhërrëfyes gjithëpërfshirës për të strukturuar përpjekjet e Shqipërisë në përmbushjen e këtyre përparësive kryesore. Në korrik 2014, Qeveria miratoi një Plan Kombëtar për Integrimin Evropian për periudhën 2014–2020.

- Më 27 qershor 2014, Shqipërisë iu dha statusi i kandidatit për në BE. Më 9 nëntor 2016,

Komisioni Evropian publikoi Raportin e tij Vjetor për Shqipërinë dhe Politikën e Zgjerimit të Bashkimit Evropian për vitin 2016. Në këtë të fundit Komisioni Evropian arriti në përfundimin se: “Nën dritën e progresit në plotësimin e përparësive kryesore, progresit të prekshëm dhe të besueshëm në zbatimin e reformës në drejtësi, në veçanti rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve (vetëvlerësim), Komisioni rekomandon hapjen e negociatave të pranimit me Shqipërinë.

- Më 6 shkurt 2018, Komisioni Evropian publikoi Komunikatën “Një perspektivë e besueshme e zgjerimit dhe një angazhim i përforcuar i BE për Ballkanin Perëndimor”. Në prill 2018, Komisioni ripërsëriti rekomandimin për hapjen e negociatave të pranimit me Shqipërinë. Në maj 2019, në dritën e progresit domethënës të arritur dhe kushteve të plotësuara të vendosura unanimisht nga Këshilli i Qershorit 2018, Komisioni rekomandoi sërish hapjen e negociatave të pranimit me Shqipërinë. Në 26 Mars, 2020, Bashkimi Evropian vendosi të hapë negociatat e pranimit me Shqipërinë. Hapi tjetër i madh në marrëdhëniet Shqipëri-BE do të jetë mbajtja e Konferencës së Parë Ndërqeveritare.

- Qeveria Shqiptare ka vazhduar ndërkohë me programin e saj të reformës për të përmbushur kriteret e përcaktuara në Konkluzionet e Këshillit. Kryenegociatori i emëruar së fundmi dhe ekipi negociator kanë vazhduar në mënyrë intensive punën për realizimin e objektivave, me synimin që, deri në fund të vitit 2020 të bëhet i mundur zhvillimi i Konferencës së Parë Ndërqeveritare.

- Mes Qeverisë shqiptare dhe Komisionit Evropian ekziston një dialog i vazhdueshëm, ndërkohë që këtij të fundit i raportohet rregullisht mbi zhvillimet në lidhje me realizimin e prioritetëve kyçe dhe kriterëve të vendosura nga Këshilli Evropian. Për sa i përket përmbushjes së këtyre të fundit, është hartuar dhe po zbatohet një plan veprimi i cili monitorohet në mënyrë rigoroze nga Qeveria Shqiptare. Plan i parashikon ndërmarrjen e masave për realizimin e kriterëve prioritarë për mbajtjen e Konferencës së parë Ndërqeveritare, si edhe masa për përmbushjen e kriterëve të tjera që do të jenë pjesë e kornizës negociuese në planin afat-gjatë.



PJESA 3 KRITERI EKONOMIK

3.1 Funksionimi i ekonomisë së tregut

3.1.1 Zhvillimet ekonomike

Ekonomia shqiptare ka përjetuar dy goditje të njëpasnjëshme të forta negative, fillimisht nga tërmeti i muajit nëntor të vitit 2019, e më tej nga pandemia COVID-19. Ndikimi i kombinuar i tyre pritet të gjenerojë një kontraktim të thellë të ekonomisë në vitin 2020. Kontraktimi i ekonomisë vlerësohet të udhëhiqet nga rënia e konsumit privat, e investimeve dhe e eksporteve. Në anën tjetër, zvogëlimi i importeve si dhe politikat makroekonomike stimuluese vlerësohen të zbusin disi kontraktimin e ekonomisë. Me kalimin e emergjencës shëndetësore, aktiviteti ekonomik pritet të rikuperohet dhe të shpejtojë ritmet e rritjes gjatë viteve në vijim. Por, pasiguria për formën dhe shpejtësinë e rikuperimit të ekonomisë mbetet e lartë dhe efekti i goditjes në ecurinë afatgjatë të ekonomisë mbetet i vështirë për t'u vlerësuar.

Masat e ndërmarra nga qeveria dhe Banka e Shqipërisë kanë ndihmuar në lehtësimin e ndikimeve imediate të krizës dhe në ruajtjen e stabilitetit financiar, i cili është një parakusht i rëndësishëm për të ndihmuar rimëkëmbjen e ekonomisë. Sistemi financiar shfaqet i qëndrueshëm dhe sektori bankar vijon të karakterizohet nga mjaftueshmëri kapitali, mbetet likuid dhe me përfitueshmëri. Raporti i kredive me probleme ka vijuar trendin rënës, i ndihmuar nga politika për shtyrjen në kohë të pagesave të amortizimit, e ndërmarrë për të zvogëluar ndikimin e pandemisë. Në reflektim të paketave fiskale stimuluese në përgjigje të mbylljes së aktiviteteve ekonomike gjatë periudhës mars- maj 2020, por edhe të ndikimit të rënies ekonomike në të ardhurat buxhetore, deficitin dhe borxhi publik janë rritur në vitin 2020. Po ashtu, deficitin i llogarisë korrente ka ardhur në zgjerim duke reflektuar efektet nga pandemia COVID-19 në eksporte, kryesisht eksportet e shërbimeve e udhëtimit dhe në të ardhurat nga puna dhe prurjet e remitançave.

Deficitin i llogarisë korrente shënoi 611.9 milionë euro në gjysmën e parë të vitit 2020, duke u zgjeruar me 8.0% në terma vjetorë gjatë kësaj periudhe. Ai vlerësohet në nivelin 9.9% të PBB-së, nga niveli prej 8.4% i regjistruar në gjysmën e parë

të vitit 2019¹⁶. Zgjerimi i deficitit erdhi si pasojë e rënies së suficitit të nën- llogarisë së shërbimeve (me - 25.2%), si pasojë e rënies së fortë të eksportit të “shërbimeve të udhëtimit”. Nga ana tjetër, deficitin i llogarisë së mallrave u ngushtua me 11.3%, për shkak të rënies së importeve si rrjedhojë e kërkesës më të dobët agregate. Ngushtimi i deficitit të llogarisë së mallrave ka shkaktuar një përmirësim të përgjithshëm të deficitit tregtar (me 3.2%) në krahasim me një vit më parë. Ndërkohë, balancat janë përkeqësuar në nën- llogaritë e të ardhurave; ku, zgjerimi i deficitit të të ardhurave parësore është shkaktuar nga rënia e të ardhurave hyrëse nga puna dhe zvogëlimi i suficitit të të ardhurave dytësore është shkaktuar nga rënia e prurjeve të remitançave (me 18.6% në terma vjetorë).

Hyrjet neto në llogarinë kapitale regjistruan vlerën 48.9 milionë EURO në gjysmën e parë të vitit 2020, nga 30.2 milionë euro në gjysmën e parë të vitit të kaluar. Detyrimet neto në llogarinë financiare u zgjeruan me 29.3% në terma vjetorë. Ky zgjerim është ndikuar nga emetimi i Eurobondit, i cili ka rritur detyrimet në formën e investimeve të portofolit. Nga ana tjetër, Investimet e Huaja Direkte neto ranë me 17.0%. Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, struktura e financimit të deficitit korrent është zhvendosur drejt flukseve borxh-krijuese për periudhën në fjalë.

Borxhi i jashtëm bruto i Shqipërisë është zgjeruar në 68.1% ndaj PBB-së nominale në fund të gjysmës së parë të vitit 2020, nga 60.4% në fund të vitit 2019. Borxhi regjistron 8,908 milionë euro, duke regjistruar një rritje vjetore prej 6.8%. Rritja e detyrimeve si pasojë e emetimit të Eurobondit ka qenë faktori kryesor pas kësaj rritjeje. Sipas ndarjes sektoriale evidentohet një shpërndarje e borxhit si në vijim: i. qeveria e përgjithshme zotëron rreth 50.0% të tij; ii. korporatat depozitë- marrëse rreth 15.8% të tij; iii. sektorët e tjerë rreth 15.3% të tij; iv. investimet e huaja direkte (IHD) rreth 18.3% të tij; dhe v. autoriteti monetar rreth 0.01% të borxhit. Shpërndarja e borxhit sipas instrumenteve evidenton se “investimet e tjera” në formën e “huave” dhe “monedhave e depozitave” përfaqësojnë instrumentin kryesor të borxhit, i cili pasohet nga IHD- hua ndërkompani. Ndërkohë, emetimi i Eurobondit ka shkaktuar një rritje të

¹⁶ Për gjithë vitin 2019, raporti i deficitit të llogarisë korrente ndaj PBB- së vlerësohet në 8.0%.



peshës së “investimeve të portofolit”. Sipas maturitetit, borxhi afatgjatë përbën rreth 82.0% të totalit. Ai është zgjeruar në terma vjetorë me rreth 9.2%.

Niveli i rezervës valutore në muajin shtator 2020 qëndron në vlerën 4.128 milionë euro, duke shënuar rritje me rreth 20% nga një vit më parë. Treguesit e mjaftueshmërisë së rezervës valutore rezultojnë ndjeshëm mbi nivelet kritike. Raporti i stokut të rezervës ndaj borxhit të jashtëm afatshkurtër vlerësohet në nivelin 184%, dukshëm mbi nivelin kritik prej 100%. Rezerva valutore për të njëjtën periudhë vlerësohet e mjaftueshme për të mbuluar rreth 8.7 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

Inflacioni vjetor mesatar rezultoi 1.6% për nëntëmujorin e parë të vitit 2020, duke shënuar rritje të lehtë nga e njëjta periudhë e një viti më parë. Rritja e inflacionit ishte e përqendruar në tremujorin e dytë dhe u ndikua më së shumti nga efekti i masave të marra në kuadër të pandemisë, të çmimet e ushqimeve. Me relaksim të tyre, presionet rënëse nga ana e kërkesës u bënë më evidente. Inflacioni u reduktua në 1.4% në tremujorin e tretë, pasi u rrit në 1.9% në tremujorin e dytë nga 1.6% në tremujorin e parë.

Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2020, çmimet e ushqimeve, veçanërisht ato të pa përpunuara, shfaqën luhatje të forta. Rritja e tyre në tremujorin e dytë reflektoi zhbalancime të ofertës dhe të kërkesës për produktet ushqimore dhe, gjithashtu vështirësinë në tregtimin e tyre si pasojë e pandemisë dhe të masave të marra për parandalimin e saj. Me lehtësimin e masave në muajin maj, inflacioni i produkteve ushqimore të pa- përpunuara iu rikthye luhatjeve sezonale dhe erdhi në ngadalësim gjatë muajve në vijim. Nga ana tjetër, çmimet e ushqimeve të përpunuara kanë shtuar kontributin gjatë gjithë vitit, duke reflektuar rritjen e çmimeve të lëndëve të para ushqimore në tregjet ndërkombëtare. Çmimet e grupeve të tjera kryesore të shportës së inflacionit u luhatën në drejtime të ndryshme duke balancuar njëra-tjetrën. Çmimet e mallrave energjetike shënuan rënie për nëntë muajt e parë të vitit të ndikuara kryesisht nga ecuria e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare. Ndërkohë, inflacioni i shërbimeve rezultoi më i lartë kryesisht si pasojë e çmimeve të qerasë.

Në terma të komponentëve më të qëndrueshëm të inflacionit, inflacioni bazë erdhi në rritje gjatë tre

tremujorëve të parë të vitit 2020, duke shënuar 1.4% nga 0.7% një vit më parë. Njësoj si me inflacionin total, kjo rritje reflektoi kontribut më të lartë nga çmimet e ushqimeve të përpunuara dhe të shërbimeve.

Presionet e brendshme inflacioniste pritet të mbeten të ulëta në afatin e shkurtër si pasojë e dobësisë së kërkesës agregate dhe presioneve dizinflacioniste nga jashtë. Më tej, rikuperimi gradual i ekonomisë pritet të ndihmojë në afrimin e ekonomisë me potencialin e saj afatgjatë. Pas një përkeqësimi të shpejtë gjatë gjysmës së parë të vitit 2020, hendeku negativ i prodhimit projektohet të nisë një përmirësim të vazhdueshëm e gradual të nxitur nga politika monetare e fiskale stimuluese, nga reduktimi i pasigurisë dhe nga rinisja e procesit të rindërtimit pas tërmetit. Shfrytëzimi më i madh i kapaciteteve prodhuese pritet të ushtrojë presion për rritje më të lartë të pagave dhe të kostove të prodhimit. Kombinimi i efektit të këtyre faktorëve pritet të ndihmojë në shtimin e presioneve të brendshme inflacioniste në horizontin afatmesëm. Paralelisht me to, një ecuri më e qëndrueshme e kursit të këmbimit pritet të lehtësojë përcjelljen e presioneve inflacioniste të huaja. Inflacioni parashikohet të rritet gradualisht, duke konverguar drejt objektivit 3% brenda vitit 2022. Për të mbështetur ekonominë dhe rritjen e inflacionit drejt objektivit, politika monetare do të ruajë kahun stimulues në afatin e mesëm.

Politika monetare stimuluese dhe masat e marra nga Banka e Shqipërisë në përgjigje të krizës së pandemisë kanë kontribuar në ruajtjen e kushteve monetare të favorshme dhe të flukseve të kredisë për ekonominë. Tregu financiar operon i qetë, likuiditeti ka qenë optimal dhe primet e rrezikut kanë mbetur të ulëta. *Yield*-et e letrave me vlerë të qeverisë janë luhatur pranë mesatares së gjysmës së dytë të vitit 2019. Normat e interesit të kredisë kanë rënë krahasuar me një vit më parë, kryesisht për bizneset, duke reflektuar uljen e normës bazë dhe efektin e skemave të kreditimit me garanci sovraane të ofruara nga qeveria. Tregu valutor pësoi një goditje pasigurie në fund të muajit mars, të karakterizuar nga rënie e fortë e vëllimeve të tregtimit, rritje e *spread*-eve të tregtimit dhe të luhatshmërisë dhe nënçmim i shpejtë i lekut. Kushtet e tregut konvergjuan drejt parametrave normalë në muajin prill dhe prej këtij momenti kursi euro/lek është luhatur ngushtësisht rreth



vlerës 124.0 lekë/euro. Ky nivel përfaqëson një nënçmim të lekut prej 1.7% kundrejt vitit të mëparshëm.

Aktiviteti kreditues është shfaqur i qëndrueshëm, i mbështetur gjerësisht nga masat e marra nga Banka e Shqipërisë dhe qeveria, për nxitjen e kreditimit në ekonomi. E rregulluar për kursin e këmbimit dhe kreditë e nxjerra jashtë bilancit të bankave, kredia për sektorin privat deri në muajin gusht 2020, shënoi normë vjetore rritjeje mesatarisht prej 6.8%, pranë mesatares së vitit 2019. Masat e ndërmarra kanë ndihmuar veçanërisht në rritjen e portofolit të kredisë në lekë dhe kredisë për biznese. Ritmet e larta të rritjes së kredisë në leke (prej mesatarisht 10.3%), kanë ndihmuar në një balancim më të mirë të strukturës të kredisë, ku kredia në lekë përbënte 49.4% të totalit, ose 0.7 pp më shumë se në dhjetor 2019. Zgjerimi i kredisë për biznese ka rezultuar më i theksuar në segmentin e investimeve, ku është shënuar një rritje vjetore mesatare prej 9.2% deri në muajin gusht. Kredia për individë ka shënuar gjithashtu rritje, por me ritme më të përmbajtura se ajo për biznese, dhënë kryesisht në segmentin hipotekar. Ruajtja e kushteve të lehtësuara monetare, së bashku me masat e tjera të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë dhe qeveria në ndihmë të kreditimit, kombinuar edhe me lehtësirat e tjera mbikëqyrëse dhe fiskale pritet të ndikojnë pozitivisht në ecurinë e kredisë për sektorin privat.

Stabiliteti makroekonomik

Ekonomia shqiptare përjetoi dy goditje të forta brenda një harku kohor të shkurtër që përfshin tremujorin e katërt të vitit 2019 dhe gjashtëmujorin e parë të vitit 2020. Në muajin nëntor të vitit 2019, vendi u godit nga një tërmet tepër i fortë që solli viktima në njerëz dhe dëme në ekonomi, ndërsa në muajin mars të vitit 2020 pandemia e COVID-19 u përhap edhe në Shqipëri, masat e ndërmarra në luftën ndaj saj, impaktuan ndjeshëm aktivitetin ekonomik në vend. Viti 2019 shënoi rritje ekonomike prej 2.2 përqindësh, krahasuar me rritjen prej 4.1 përqindësh të një viti më parë, si pasojë e faktorëve të paqëndrueshëm apo të përkohshëm përgjatë vitit, por edhe si pasojë e goditjes nga tërmeti, ku PBB-ja reale u tkurr me 0.1 për qind në terma vjetorë në tremujorin e katërt, pas një rritje prej 4.2 përqindësh në tremujorin e tretë.

Sipas vlerësimit më të fundit të INSTAT-it, ekonomia, në tremujorin e dytë të vitit 2020, ka pësuar rënie me - 10.23 për qind krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2019, e ndjekur nga rënia prej 2.27 për qind në tremujorin e parë. Për të gjithë 6-mujorin e parë shënoi rënie me - 6.57 për qind. Shqipëria është veçanërisht e ekspozuar ndaj tkurrjes ekonomike prej pandemisë për shkak se mbështetet fort nga sektori i turizmit dhe për shkak të marrëdhënieve të saj intensive me disa ekonomi të BE-së të prekura rëndë nga pandemia.

Në anën e kërkesës agregate, rritja përgjatë vitit 2019 u gjenerua nga konsumi final si dhe nga kërkesa e brendshme. Në gjysmën e parë të vitit 2020, vlerësohet se të gjithë komponentët e kërkesës agregate kanë pësuar rënie duke reflektuar kështu tkurje të fortë të rritjes ekonomike. Pasojat e masave shtrënguese për frenimin e përhapjes së pandemisë, kanë sjellë ngadalësim të eksporteve të mallrave dhe shërbimeve, konsumit familjar dhe investimeve në ekonomi, kryesisht atyre private. Në këtë të fundit, një kontribut të konsiderueshëm negativ krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ka pasur dhe mbarimi i kontributit pozitiv të ardhur nga faza ndërtuese e projektit TAP që tashmë është pothuajse i përfunduar. Gjithsesi së shpejti ky projekt do të jetë operativ dhe pritet të japë një efekt të konsiderueshëm pozitiv në vijimësi për ekonominë tonë, kryesisht nëpërmjet mundësimit të një burimi alternativ dhe të lirë energjie.

Vetëm gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020, konsumi final ka shënuar një rënie prej 6.9 përqindësh, ndërsa investimet totale kanë pësuar një kontraktim të fortë prej rreth 13.16 përqindësh dhe për rrjedhojë kërkesa e brendshme agregate u tkurr me rreth 7.68 për qind. Duke marrë në konsideratë performancën e vitit 2019 dhe pritshmëritë për vitin 2020, i cili pritet të pasqyrojë si efektet e tërmetit që goditi Shqipërinë, dhe pasojat nga pandemia globale, rritja ekonomike për të gjithë vitin 2020 rishikohet në rënie nga parashikimet e mëparshme, në vlerën prej - 6.1 përqindësh.

Konsumi final total, i cili përbën peshën më të madhe në ekonomi, u rrit me rreth 3.3 për qind në terma realë vjetorë përgjatë vitit 2019, gjithashtu, dhe konsumi final i popullatës u rrit me të njëjtën vlerë. Ndërkohë për gjysmën e parë të vitit 2020, konsumi final total dhe ai i popullatës shënuan



rënie të ritmit krahasuar të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke shënuar respektivisht rënie prej - 3.07 dhe - 3.45 përqindësh.

Formimi i Kapitalit Fiks Bruto (investimet totale) pati rënie me rreth 3.8 për qind në terma realë vjetorë përgjatë vitit 2019, ndërkohë për 6-mujorin e parë të vitit 2020 kjo normë ishte - 13.16 për qind. Kjo rënie vjen kryesisht si pasojë e tkurrjes së investimeve në ndërtim, përfshirë projektin TAP, dhe ndikimit që kanë pasur masat shtrënguese kundër përhapjes së pandemisë në ekonomi.

Sipas optikës së ofertës agregate, kontribut pozitiv në 6-mujorin e parë të vitit 2020 dhanë degët e ekonomisë: Bujqësia, pyjet dhe peshkimi me rritje 3.0% dhe kontribut 0.60 pikë përqindjeje si dhe Aktivitete të pasurive të paluajtshme me rritje 4.2% dhe kontribut 0.25 pikë përqindje. Degët e tjera të ekonomisë kanë pasur rënie dhe kontribut negativ, sipas renditjes: Tregtia me shumicë dhe pakicë me rënie - 16.1% dhe kontribut prej - 2.34 pikë përqindje; Aktivitete financiare dhe të sigurimit me rënie - 14.6% dhe kontribut prej - 0.44 pikë përqindje; Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike me rënie - 14.1% dhe kontribut prej - 0.82 pikë përqindje; Ndërtimi me rënie - 13.8% dhe kontribut - 1.13 pikë përqindje; Industria me rënie - 8.6% në terma realë dhe kontribut prej - 1.16 pikë përqindjeje etj.

Stabiliteti financiar dhe përsheptimi i kreditimit të ekonomisë.

Qëndrueshmëria e sektorit financiar, në terma të kapitalizimit, likuiditetit dhe përfitueshmërisë, vazhdon të mbetet një fundament mjaft stabil dhe vijueshmërisht i përmirësuar i ekonomisë. Kreditë me probleme (NPL) kanë vijuar të ulen duke shënuar në fund të gjashtëmujorit të parë nivelin prej rreth 8.1% nga 24% që kulmuan rreth dy vite më parë. Gjithashtu, kreditimi i sektorit privat të ekonomisë, ka njohur tashmë për tre tremujorë rresht një zgjerim të qenësishëm, duke regjistruar një rritje prej mbi 7% kundrejt një viti më parë për kreditë ndaj bizneseve dhe mbi 5% për kreditë drejt konsumatorëve.

Pozicioni i jashtëm i ekonomisë dhe bilanci i pagesave mbetet i qëndrueshëm

Ka pasur një zgjerim të deficitit të llogarisë korrente në gjysmën e parë të këtij viti, duke reflektuar së bashku ngushtimin e suficitit tregtar në shërbime dhe balancën pozitive të të ardhurave

dytësore, si dhe njëkohësisht zgjerimin e balancës negative të të ardhurave parësore. Këto faktorë janë kompensuar pjesërisht nga rënia e deficitit tregtar në mallra, në reflektim të dobësimit të kërkesës së brendshme dhe bilancit të favorshëm të energjisë. Në të njëjtën kohë, flukset neto pozitive në llogarinë kapitale shënuan 23 milionë euro. Referuar vitit të kaluar, ky nivel vlerësohet rreth 2 herë më i lartë, dhe është ndikuar kryesisht nga zgjerimi i transfertave kapitale drejt sektorit privat. Fluksi i investimeve të huaja direkte në formën e zgjerimit të kapitalit, vijon i përqendruar në sektorin e energjetikës (në masën 38%), të ndërmjetësimit financiar (në masën 21%) dhe telekomunikacionit (në masën 11%). Rënia vërehet e përqendruar në ecurinë e sektorit të hidrokarbureve. Për rrjedhojë, bilanci i përgjithshëm i pagesave dhe pozicioni i jashtëm i ekonomisë mbetet i qëndrueshëm, ku stoku i rezervës valutore në fund të periudhës vlerësohet i mjaftueshëm për mbulimin e 9 muaj importe në mallra dhe shërbime.

Qëndrueshmëria e financave publike dhe vijimi i konsolidimit fiskal

Qëndrueshmëria e financave publike përbën një tjetër shtyllë të rëndësishme për perspektivën e ekonomisë, ndoshta më të rëndësishmen për tipologjinë e ekonomisë shqiptare, si dhe në kuadrin e një ndjeshmërie të lartë lidhur me këtë fundament, sidomos që nga kriza e fundit financiare globale.

Në vitet e fundit financat publike kanë hyrë në një trajektore të sigurt dhe optimale të konsolidimit fiskal, e materializuar në parametrat më kyç të qëndrueshmërisë. Së pari, kjo është materializuar në uljen e deficitit të përgjithshëm buxhetor nga 5% të PBB në 2013 në nivelin nën 2% në fund të vitit të shkuar (2019). Në vitin aktual 2020, bazuar në zhvillimet e lartpërmendura, deficit i përgjithshëm buxhetor pritet të shënojë 6.8%, 6.5% në vitin 2021 e më tej pritet përmirësim drejt nivelit prej 2% në fund të periudhës afatmesme.

Ndërkohë objektivi themelor për periudhën afatmesme do të jetë synimi i një trajektore rënese të borxhit publik duke targetuar si objektivi operativ vjetor rikthimin e buxhetit në një balancë primare të balancuar ose me suficit mundësisht që prej vitit 2022, por domosdoshmërisht prej vitit buxhetor 2023 dhe në vijim. Që nga korrikut 2020 ky objektivi tashmë është sanksionuar edhe në Ligjin



Organik të Buxhetit nëpërmjet përfshirjes së një rregulli të ri fiskal.

3.1.2 Politikat monetare dhe fiskale

Banka e Shqipërisë ka si objektiv parësor arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Për të realizuar këtë objektiv, ajo ndjek regjimin e inflacionit të shënjestruar me objektiv afatmesëm 3%. Kjo vlerë pikësore konsiderohet si norma vjetore e inflacionit e cila mbështet rritjen e shëndetshme të ekonomisë. Politika monetare zbatohet me operacione të tregut të hapur, nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes dhe ato të anasjella me afat një javor. Banka e Shqipërisë përcakton një regjim të kursit të lirë të këmbimit, në të cilin vlera e monedhës vendëse kundrejt atyre të huaja caktohet nga lëvizjet e kërkesës dhe ofertës në tregjet e valutës. Banka ruan të drejtën të ndërhyjë në këtë treg për të menaxhuar nivelin e rezervës së saj valutore, nëpërmjet ankandeve të lajmëruara në publik paraprakisht. Kuadri i politikës monetare dhe regjimi i kursit të këmbimit konsiderohen të përshtatshme dhe të dobishme për të arritur objektivin e bankës qendrore e nuk priten të ndryshojnë në afatin e mesëm. Instrumentet e përdorura janë në kalibrim të vazhdueshëm për të rritur efektivitetin e transmetimit të politikës monetare në treg.

Banka e Shqipërisë ka shtuar stimulimin e saj monetar gjatë vitit 2020, përballë krizës së pandemisë. Masat synuan mbajtjen në nivele të ulëta të kostove të huamarrjes dhe mbështetjen e flukseve të kredisë nëpërmjet garantimit të funksionimit normal të tregjeve financiare. Norma bazë e interesit u ul me 50 pikë bazë, duke e çuar atë në 0.50%, i cili është minimumi i saj historik. Banka ofroi likuiditet të pakufizuar në sistemin bankar.

Transmetimi i stimullit monetar në ekonomi ka qenë i mirë. Normat e interesit të huamarrjes janë në nivele të ulëta dhe kredia për ekonominë, e ndihmuar edhe nga skemat e garancisë sovraane, ka vijuar t'u përgjigjet nevojave të familjeve dhe bizneseve për financim. Po ashtu, stimuli i shtuar monetar, së bashku me sinjalizimin për të ardhmen, kanë reduktuar pasiguritë në tregjet financiare dhe tek agjentët ekonomikë në të ardhmen.

Krahas masave monetare, paketa e reagimit të Bankës së Shqipërisë ndaj krizës COVID-19 përfshin dhe masa të tjera mikro- dhe makroprudenciale (shih seksionin 3.1.6), të cilat, së

bashku me paketat ndihmuese të qeverisë, kanë zbutur efektin negativ të goditjeve në sistemin financiar dhe në ekonomi, duke krijuar premisa për rigjallërimin e aktivitetit ekonomik.

Projeksionet e Bankës së Shqipërisë presin tkurrjen e aktivitetit ekonomik gjatë vitit aktual dhe rimëkëmbjen e tij gjatë viteve në vijim. Kjo rimëkëmbje do të mbështetet nga stimuli makroekonomik, nga reduktimi i pasigurisë dhe përmirësimi i mjedisit të huaj ekonomik. Me rritjen e pandërprerë të ekonomisë dhe afrimin e saj me potencialin, presionet inflacioniste priten të forcohen duke mbështetur rritjen e qëndrueshme të inflacionit. Norma e inflacionit priten ta arrijë objektivin prej 3% brenda vitit 2022. Projeksionet përfshijnë ruajtjen e kahut stimulues të politikës monetare në afatin e mesëm, për të gjithë periudhën e parashikimit. Stimuli monetar konsiderohet si një kusht i nevojshëm për të mbështetur rimëkëmbjen e aktivitetit ekonomik dhe forcimin e presioneve të brendshme inflacioniste.

Prioritetet e Bankës së Shqipërisë në fushën e kriterit ekonomik përfshijnë:

- ruajtjen e stimullit monetar për një periudhë kohe, për të garantuar që sistemi bankar operon në një mjedis likuid, dhe është i mirëkapitalizuar;
- përmirësimin e mekanizmit të transmetimit duke vijuar masat për reduktimin e kredive me probleme, inkurajimin e përdorimit të monedhës vendëse në tregjet financiare dhe zhvillimin e tregut sekondar dhe të instrumenteve mbrojtës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit;
- modernizimin e sistemit të pagesave dhe zgjerimin e shërbimeve të ofruara;
- harmonizimin e vazhduar të politikës monetare, fiskale dhe asaj makroprudenciale;
- përsosjen e ekspertizës teknike dhe aftësive analitike për të siguruar një proces vendim- marrës të mirinformuar;
- plotësimin dhe implementimin e regjimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për të paraprirë daljen e disiplinuar nga tregu bankar.

Situata aktuale e ekonomisë ka kërkuar për një rritje të stimullit makroekonomik: fiskal, monetar dhe financiar. Kombinimi aktual i politikave ekonomike është i përshtatshëm dhe i nevojshëm për të ruajtur stabilitetin makroekonomik, për të mbështetur gjallërimin e aktivitetit ekonomik dhe



për kthimin e tij në një trajektore rritjeje të qëndrueshme.

Politika fiskale

Në përputhje të plotë edhe me rregullat fiskale në ligjin organik të buxhetit, politika fiskale do të vijojë të orientohet drejt konsolidimit fiskal në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Kjo në mënyrë të qenësishme për të ruajtur një nivel të investimeve publike në rreth 5 për qind të PBB-së në vitet 2021- 2023 në mënyrë që të stimulojë formimin e kapitalit fiks bruto në ekonomi, esenciale kjo për të mbështetur nivele relativisht të larta rritje në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Matësi më direkt i këtij fondamenti, pra pozicionit të financave publike, por edhe stabilitetit makroekonomik dhe perspektivës ekonomike në tërësi, është tregtimi i Eurobondit të shtetit shqiptar në bursat (tregjet financiare) ndërkombëtare, po gjithashtu edhe tregtimi (ankandet) i instrumenteve të borxhit të brendshëm të emetuara në tregun e brendshëm financiar. Eurobondi i shtetit shqiptar i emtuar përgjatë tremujorit të dytë të këtij viti është në vlerën emërore prej 650 milionë euro, i cili pason Eurobondin e marrë në Tetor 2018 (me maturim në 2025), i cili u emetua me një “yield” prej 3.5%, qenësisht më të ulët se sa të dyja eurobondet e mëparshme (Eurobondi 2010 dhe 2015).

Lidhur me balancën primare, një parametër shumë i rëndësishëm i qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike, së fundmi (Korrik 2020) u shtua edhe një rregull i ri fiskal në Ligjin Organik të Buxhetit, në linjë edhe me rekomandimet e Komisionit Evropian dhe me parimet kryesore të *acquis të* BE-së, i cili e bën të detyrueshme ligjërisht, duke filluar nga viti buxhetor 2023 e në vijim, që balanca primare faktike nuk mund të rezultojë

negative, pra duhet të jetë së paku e balancuar ose pozitive (suficit primar). Ky target i parametrit të balancës primare buxhetore do të përbëjë tashmë dhe në vijimësi objektivin kryesor operativ të politikës fiskale për të materializuar synimin e një trajektore vijimësisht rënese të borxhit publik, pra duke synuar konsolidim të vijueshëm fiskal me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së financave publike si një fundament kyç i stabilitetit makroekonomik dhe mbarë- vajtjes së ekonomisë së vendit.

Vlerësojmë se ekzistojnë premiset e duhura për një rikuperim të rritjes ekonomike, nisur nga viti i ardhshëm, në fashën e 5 përqindëshit dhe për periudhën afatmesme në vijim. Më specifikisht, parashikohet një rritje reale ekonomike prej 5.5% në vitin 2021 dhe një rritje prej 4.8% dhe 4.5% respektivisht për dy vitet e tjera në vijim (2022–2023).

Totali i fondeve/tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2021- 2023, të miratuara për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, miratuar me vendimin nr. 527, datë 22.7.2020 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2021- 2023”, për vitin 2021 janë 43 miliardë e 852 milionë lekë, krahasuar me fondet e rishikuara të vitit 2020 kanë një rritje prej 5.5%, në vitin 2022 janë 44 miliardë e 431 milionë lekë dhe në vitin 2023 arrijnë në 45 miliardë e 512 milionë lekë. Fondet e parashikuara për periudhën 2021–2023, kanë një rritje mesatare vjetore që shkon nga 5.5%, në 2.4% ndaj vitit paraardhës. Fondet e miratuara për vitin 2023, krahasuar me vitin 2020, sipas VMK-së nr. 527, datë 22.7.2020, kanë një rritje prej 9%.



Tabela: Fondet e realizuara për vitin 2018–2019, fondet e planifikuara për vitin 2020 si dhe fondet e parashikuara për periudhën 2021–2023, sipas programeve buxhetore, në 000 lek dhe në %

Emri i programit	Buxheti faktik 2018	Buxheti faktik 2019	Buxheti 2020	Tavanet e PBA-së 2021–2023, sipas VKM-së nr. 527, datë 22.7.2020					
				2021	2022	2023	2021/ 2020	2022/ 2021	2023/ 2022
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	665,751	754,889	689,000	762,000	763,000	765,000	10.6%	0.1%	0.3%
Zhvillimi i sportit	675,503	448,782	250,200	725,000	676,000	576,500	189.8%	- 6.8%	- 14.7%
Arsimi bazë	21,860,776	22,482,280	23,035,720	23,340,073	23,008,000	23,437,000	1.3%	- 1.4%	1.9%
Arsimi i mesëm i	6,855,455	7,161,886	7,024,043	7,549,000	7,802,000	7,722,000	7.5%	3.4%	- 1.0%
Arsimi universitar	7,204,009	8,766,493	10,030,000	10,796,000	11,451,000	12,230,000	7.6%	6.1%	6.8%
Fonde për shkencën	318,210	364,028	540,000	680,000	731,000	782,000	25.9%	7.5%	7.0%
TOTALI	37,579,705	39,978,357	41,568,963	43,852,073	44,431,000	45,512,500	5.5%	1.3%	2.4%



Fondet e miratuara në tavanet përfundimtare për MASR-në, pa përfshirë të ardhurat dytësore si dhe fondet e ministrive të linjës për arsimin si dhe fondet e njësive të vetëqeverisjes vendore për arsimin, ndaj totalit të shpenzimeve buxhetore për periudhën 2021–2023, parashikohet të arrijnë në 7.6% në vitin 2021, në 7.8% në vitin 2022, dhe në 7.6% në vitin 2023.

Fondet publike për arsimin, pa përfshirë të ardhurat dytësore si dhe fondet e ministrive të linjës për arsimin si dhe fondet e njësive të vetëqeverisjes vendore për arsimin, ndaj produktit të brendshëm bruto nga 2.4% në vitin 2019, në vitin 2021 arrijnë në 2.5%, në vitin 2022 në masën 2.4, si dhe në vitin 2023 arrijnë në masën 2.3%.



Tabela: Fondet e realizuara për vitin 2018–2019, fondet e planifikuara për vitin 2019, tavanet përgatitore sipas grup artikujve buxhetore për periudhën 2020–2022 në 000 lek si dhe në %.

Artikujt	Buxheti faktik 2018	Buxheti faktik 2019	Buxheti i rishikuar viti 2020	Tavanet e PBA 2021–2023, sipas VKM-së nr. 527, datë 22.7.2020					
				2021	2022	2023	2021/2020	2022/2021	2023/2022
Paga (600- 601)	30,816,274	31,998,243	26,901,580	26,662,293	26,852,293	26,852,293	- 0.9%	0.7%	0.0%
Korrente të tjera (602–606)	3,677,153	4,411,732	11,426,183	11,639,780	12,957,707	13,726,207	1.9%	11.3%	5.9%
Kapitale (230–232) Të brendshme	2,809,540	3,257,250	3,025,200	5,250,000	4,321,000	4,634,000	73.5%	- 17.7%	7.2%
Kapitale (230–232) të huaja	182,440	256,491	216,000	300,000	300,000	300,000	38.9%	0.0%	0.0%
Totali	37,485,407	39,923,715	41,568,963	43,852,073	44,431,000	45,512,500	5.5%	1.3%	2.4%
Buxheti MAS në % ndaj GDP-së	2.3%	2.4%	2.6%	2.5%	2.4%	2.3%	2023/2020		9%
Buxheti MAS në % ndaj shpenzimeve publike	7.9%	8.1%	7.2%	7.6%	7.8%	7.6%			



Fondet për “Sektorin e Arsimit”, parashikuar për periudhën afatmesme 2021- 2023, ku janë pjesë e fondeve të arsimit, të ardhurat dytësore të IAL- vë publike, si dhe të ardhurat e tjera nga të tretë, përfshirë fondet e parashikuara nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Financës dhe Ekonomisë “Fonde për arsimin”, fondet e parashikuara të njërive të vetëqeverisjes vendor, “Për shërbimet dhe funksionet në arsimin parauniversitar”, si dhe fondet nga projekte të veçantë të donatorëve (*pa përfshirë shpenzimet familjare dhe shpenzimet për arsimin nga institucione private), në vitin 2023 parashikohet të arrijnë në 63.3 miliardë lekë, krahasuar me shpenzimet publike fondet për arsimin parashikohet të arrijnë në 10.61% dhe ndaj produktit të brendshëm bruto në 3.21%



Tab. nr. 1: Fondet e realizuara për vitin 2018–2019, fondet e planifikuara/rishikuara për vitin 2020 si dhe fondet e parashikuara për periudhën 2021- 2023 sipas artikujve buxhetore dhe burimit të financimi (në 000 lek dhe në %)

Artikujt				2021	2022	2023	2021/2020	2022/2021	2023/2022
Fonde për personelin paga (600–601)	30,816,274	31,998,243	26,901,580	26,662,293	26,852,293	26,852,293	- 0.9%	0.7%	0.0%
Korrente të tjera (602–606)	3,677,153	4,411,732	11,426,183	11,639,780	12,957,707	13,726,207	1.9%	11.3%	5.9%
Fonde për shpenzime kapitale (230–232) Të brendshme	2,809,540	3,257,250	3,025,200	5,250,000	4,321,000	4,634,000	73.5%	- 17.7%	7.2%
Fonde për shpenzime, kapitale (230–232) Të huaja	182,440	256,491	216,000	300,000	300,000	300,000	38.9%	0.0%	0.0%
Totali	37,485,407	39,923,715	41,568,963	43,852,073	44,431,000	45,512,500	5.5%	1.3%	2.4%
Buxheti MAS në % ndaj GDP-së	2.3%	2.4%	2.6%	2.5%	2.4%	2.3%	2023/2020		9%
Buxheti MAS në % ndaj sh. publ.	7.9%	8.1%	7.2%	7.6%	7.8%	7.6%			
Fonde të tjera për “Arsimin” nga Min. Financës dhe Ekonomisë, Min. e Drejtësisë, Min. e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes.	3,716,000	3,716,000	4,095,000	4,095,000	4,188,779	4,428,779			
Totali	41,201,407	43,639,715	45,663,963	47,947,073	48,619,779	49,941,279	5.0%	1.3%	2.2%
Buxhet MAS + të ardh. IAL % ndaj GDP-së	2.5%	2.6%	2.9%	2.8%	2.6%	2.5%			
Buxheti MAS në % ndaj sh. publ.	8.7%	8.9%	7.9%	8.3%	8.6%	8.4%			
Plus të ardhurat e universiteteve	3,399,500.1	2,993,344.4	2,450,000.0	2,450,000.0	2,450,000.0	2,450,000.0	0.0		
Totali	44,600,907	46,633,060	48,113,963	50,397,073	51,069,779	52,391,279	4.7%	1.3%	2.1%
Buxhet MAS + të ardh. IAL % ndaj GDP-së	2.7%	2.8%	3.0%	2.9%	2.8%	2.7%			
Buxheti MAS në % ndaj sh. publ.	9.4%	9.5%	8.3%	8.7%	9.0%	8.8%			
Fonde e parashikuara për arsimin nga njësitë e qeverisjes vendore	8,207,000	9,000,000	9,450,000	9,922,500	10,418,625	10,939,556	0		
Totali “Fonde për arsimin” se bashku me nga Min. e Financës dhe Ekonomisë, Min. e Drejtësisë, Min. e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore	52,807,907	55,633,060	57,563,963	60,319,573	61,488,404	63,330,835	8.9%	1.9%	2.6%
Buxheti në % ndaj GDP	3.23%	3.31%	3.64%	3.50%	3.34%	3.21%			
Buxheti sektorit arsimit + ardhurat në % ndaj SH Publ	11.09%	11.31%	9.93%	10.44%	10.85%	10.61%			
GDP (000 lek), treg. fiskale VKM nr. 574, datë 22.7.’20	1,635,715,000	1,678,431,000	1,580,960,000	1,723,115,000	1,842,122,000	1,970,123,000	9.0%	6.9%	6.9%
Shpenzimet Publike, mijë lekë, VKM nr. 574, datë 22.7.’20	476,147,000	491,897,000	579,535,000	578,008,000	566,546,000	596,899,000	- 0.3%	- 2.0%	5.4%



3.1.3 Ndërveprimi i forcave të tregut

Procesi i privatizimit mbetet një prioritet, veçanërisht në sektorët strategjikë, duke synuar tërheqjen e kapitalit të huaj dhe vendës që do të kishte një ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik. Në privatizimet strategjike dhe jostrategjike nuk ka kufizime për pjesëmarrësit.

Privatizimi i paketave aksionare strategjike (shoqërive tregtare që operojnë në sektorë me rëndësi të veçantë për ekonominë) zbatohet në përputhje me ligjin nr. 8306, datë 14.3.1998, “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar.

Në kuadër të realizimit të objektivave lidhur me privatizimin e pasurive shtetërore, ministri përgjegjës për ekonominë rishikon çdo vit planin për privatizimin e pasurive shtetërore.

- “Plani i veprimit për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore në sektorët strategjikë për periudhën 2015–2020”, si dokument nr. 7476, datë 30.9.2015.

- “Plani i veprimit për privatizimin e pasurive për periudhën 2016–2020”, si dokument nr. 3459, datë 29.4.2016, ndryshuar për periudhën 2018–2020, me urdhrin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 88, datë 21.3.2018.

- “Plani i veprimit për privatizimin/likuidimin e ndërmarrjeve shtetërore në sektorët jostrategjikë 2017–2020”, si dokument nr. 2564, datë 29.3.2017.

Në kuadër të realizimit të objektivave lidhur me privatizimin e pasurive shtetërore, gjatë periudhës janar–tetor të vitit 2019, janë privatizuar në total 13 asete shtetërore, duke realizuar 95,886,874 lekë dhe 93,055,676 bono privatizimi (në lekë), pra në total 188,942,550 lekë. Shitja e aseteve shtetërore bëhet nëpërmjet procedurës së ankandit publik ku ish-pronarët e tokës kanë të drejtën e parablerjes. Disa nga këto pasuri janë blerë nga pronarët e tokave, duke ushtruar të drejtën e tyre të parablerjes.

Procesi i privatizimit në sektorë me rëndësi të veçantë ekonomike, si dhe në ato jostrategjike, nuk ka përfunduar ende.

Procesi i privatizimit për periudhën në vijim 2019–2020, do të bëhet sipas parashikimeve në planet e veprimeve, të raportuara.

Për më shumë informacion mbi privatizimin, ju lutem referojuni kapitullit 20: Sipërmarrja dhe politika industriale.

3.1.4 Hyrja dhe dalja nga tregu

Deri në vitin 2007, regjistrimi i personave juridikë bëhej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërkohë që regjistrimi i personave fizikë bëhej pranë Gjykatave të Rretheve. Për këtë arsye, duke qenë se regjistrimi ishte një procedurë tërësisht gjyqësore, krijimi i një biznesi në Shqipëri haste një numër të madh barrierash gjyqësore dhe administrative, të cilat shtonin kostot dhe krijojnë vështirësi në ushtrimin e aktivitetit tregtar. Për më tepër, në atë kohë, mungonte një regjistër tregtar lirisht i aksesueshëm nga publiku dhe informacioni nuk mund të merrej në kohë reale nga personat e interesuar.

Me qëllim thjeshtimin e procedurave dhe uljen e kostove, me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, u krijua Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR), e cila si funksion kryesor kishte trajtimin e procedurave të regjistrimit të biznesit, si dhe mbajtjen dhe administrimin e Regjistrit Tregtar.

Me krijimin e QKR-së, regjistrimi i biznesit nga një proces gjyqësor u transformua në një proces administrativ me vetëdeklarim, në një qendër me një ndalesë. Falë kësaj, u mundësua që me regjistrimin e subjekteve në regjistrin tregtar të realizohej edhe regjistrimi i njëkohshëm i tyre pranë administratës tatimore qendrore dhe vendore, skemës së sigurimeve shoqërore e shëndetësore, inspektoratit të punës dhe Agjencisë së Prokurimit Publik.

Reforma në fushën e regjistrimit u pasua me reformën në fushën e licencimit dhe lejimit të biznesit. Procesi i licencimit/lejimit deri në vitin 2009 ishte shumë i gjatë, burokratik, i kushtueshëm dhe jotransparent. Ekzistonte një numër i madh licencash/lejeshe dhe institucionesh të përfshira në këtë proces. Aplikimi bëhej në formë shkresore dhe procedurat, afatet dhe formatet e aplikimit ishin të pastandardizuara. Gjithashtu, nuk ekzistonte një regjistër kombëtar për licencat dhe lejet.

Krijimi i Qendrës Kombëtare të Licencimit, solli një përmirësim të mëtejshëm të klimës së biznesit në vend, reduktim të barrierave administrative, si dhe rritje të transparencës në procedurat e licencimit/lejimit. Një risi tjetër, ishte edhe transformimi i procesit të licencimit/lejimit nga një proces shkresor në një proces tërësisht elektronik, me anë të ngritjes dhe funksionimit të



Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

Në muajin dhjetor 2015, u miratua Ligji Nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB)”, i cili krijoi institucionin e ri, Qendrën Kombëtare të Biznesit ku ndër funksionet e kësaj qendre është edhe trajtimi i procedurave të regjistrimit dhe licencimit/lejimit të biznesit.

Bashkimi i QKR-së dhe QKL-së mundësoi krijimin e QKB-së, si një qendër e vetme me një ndalesë për ofrimin e shërbimeve të regjistrimit dhe licencimit të biznesit. Kjo ka sjellë një reduktim të mëtejshëm të barrierave administrative për bizneset që operojnë në Republikën e Shqipërisë. Krijimi dhe funksionimi i QKB-së u mirëprit nga subjektet, pasi tashmë procedurat dhe i gjithë informacioni i nevojshëm për të operuar në tregun shqiptar mund të gjendet lehtësisht në një qendër të vetme.

Shërbimet administrative të ofruara nga QKB ofrohen me procedura të thjeshta, në mënyrë elektronike, brenda afateve kohore të shkurtra dhe me tarifa simbolike.

Ndërkohë, nga fillimi i vitit 2020 QKB ka ofruar të gjitha shërbimet e saj vetëm në mënyrë elektronike, nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*, dhe për aplikimet *online* nuk zbatohet tarifa e aplikimit në QKB prej 100 ALL.

Regjistri Tregtar është një bazë të dhënash unike, e ndarë në dosje të veçanta elektronike për secilin subjekt që ka detyrimin e regjistrimit, sipas parashikimeve të këtij ligji, dhe mbahet në format elektronik. Të gjitha të dhënat, aplikimet dhe dokumentet shoqëruese, të paraqitura në format shkresor apo në format elektronik, sipas ligjit regjistrohen nga QKB -ja në format elektronik në dosjen e subjektit në regjistrin. Të gjitha të dhënat, aplikimet dhe dokumentet shoqëruese: a) të paraqitura nga aplikantët në format elektronik, sipas këtij ligji, ruhen dhe arkivohen nga QKB -ja vetëm në format elektronik; b) të paraqitura në format shkresor, sipas këtij ligji, konvertohen dhe ruhen nga QKB -ja në format elektronik. QKB -ja nuk ka detyrim të mbajë e të arkivojë aplikimet dhe dokumentet shoqëruese të paraqitura në format shkresor.

Regjistri përmban gjithashtu të dhëna, që i përkasin themelimit, veprimtarisë dhe çregjistrimit të subjekteve, çdo ndryshim në status dhe organizimin e subjektit, të dhëna, që i përkasin atij

në lidhje me përfaqësimin, si dhe të dhëna të tjera, të parashikuara me ligj.

Sipas ligjit nr. 9723/2007, subjektet që detyrohen të regjistrohen janë:

- subjektet tregtare;
- shoqëritë e thjeshta, sipas dispozitave të Kodit Civil;
- personat fizikë, sipas kuptimit të Kodit Civil, që nuk kanë cilësinë e tregtarit, që ushtrojnë veprimtari ekonomike apo një profesion të pavarur;
- zyrat e përfaqësimit të shoqërive shqiptare dhe të shoqërive të huaja;
- shoqëritë dhe unionet e kursim-kreditit;
- shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë;
- çdo subjekt tjetër, i cili me ligj detyrohet të regjistrohet pranë QKB-së.

Çdo person i interesuar mund të kryejë, sipas këtij ligji, pa pagesë, pranë çdo sporteli shërbimi, kërtime në bazën e të dhënave elektronike për çdo të dhënë të regjistruar, me përjashtim të adresës së banimit të individëve.

Aplikimi për regjistrim bëhet elektronikisht përmes sportelit elektronik (aplikimi *online*) ose në sportelet e shërbimit të QKB, të ndodhura në zyrat qendrore të QKB, si dhe në njësitë e qeverisjes vendore ose dhomat e tregtisë, si dhe në zyrat noteriale (vetëm *online* aplikim).

Aplikimi *online* mund të bëhet nga çdo individ/qytetar ose subjekt (i pajisur me NUIS/NIPT) (pa pasur nevojë që të paraqitet pranë sporteleve fizike të QKB), i cili së pari duhet të regjistrohet në portalin unik qeveritar *e-Albania*. Regjistrimi në këtë portal bëhet duke plotësuar të dhënat e kërkuara përkatësisht në varësi të faktit nëse aplikimi do të kryhet nga një individ ose një subjekt.

Në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, kapitali fillestar për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar është 100 lekë, me përjashtim të shoqërive aksionare, kapitali i parë fillestar i të cilave varion nga 3 500 000 lekë të shoqëritë aksionare me ofertë private në 10 000 000 lekë të shoqëritë aksionare me ofertë publike.

Miratimi i ligjit nr. 110/2012, “Për bashkimin ndërkufitar të ndërmarrjeve tregtare” mundësoi bashkimin ndërkufitar midis një kompanie të huaj dhe asaj shqiptare. Për më tepër, në përputhje me parashikimet e ligjit të sipërcituar, Qendra Kombëtare e Biznesit ka zhvilluar funksione të reja



në regjistrin elektronik, që mundësojnë aplikimin për bashkim ndërkufitar mes një shoqërie të huaj dhe një shoqërie shqiptare. Megjithatë, aktualisht aplikimi mund të bëhet vetëm për bashkimin ndërkufitar që rezulton në krijimin e një shoqërie të re shqiptare.

Ligji nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit” është ndryshuar në shkurt 2015 me ligjin nr. 8/2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, ‘Për regjistrimin e biznesit’, i ndryshuar”, me qëllim përafrimin e këtij ligji me direktivën 2009/101/EC, duke parashikuar depozitimin elektronik të pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të auditimit nga subjektet.

Njësia ekonomike regjistron dhe depoziton në regjistrin tregtar, pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, në rastet kur këto dokumente duhet të ruhen deri në 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar. Dorëzimi i tyre bëhet elektronikisht përmes portalit *e-Albania*.

Me ndihmën financiare të Bankës Botërore, QKB ishte pjesë e projektit “Përmirësimi i *software*-it ekzistues të QKB-së dhe krijimi i moduleve të reja për aksesin e publikut në informacionin financiar (që tashmë ka përfunduar dhe është duke u zbatuar), i cili ndër të tjera:

Mundëson një modul të ri të depozitimit të pasqyrave financiare përmes një sistemi *online*, ku informacioni financiar do të jetë i aksesueshëm për palët e treta;

Mundëson zbatimin e formatit (sistemit) të ri për depozitimin e pasqyrave financiare në QKB përmes portalit qeveritar *e-Albania*, duke përdorur një format të komunikimit elektronik (XML).

Aktualisht, janë bërë 18 807 aplikime duke përdorur sistemin e ri elektronik.

Brenda vitit 2020, Qendra Kombëtare e Biznesit do të nënshkruajë marrëveshjen për pjesëmarrjen e regjistrin tregtar shqiptar në portalin rajonal të regjistrave të biznesit të Evropës Juglindore. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) po mbështet Agjencisë Serbe të Regjistrimit të Biznesit (SRBA) dhe institucionet e saj homologe në Evropën Jug-Lindore për të krijuar një platformë rajonale IT që do të lejojë lidhjen e institucioneve përgjegjëse për regjistrimin e biznesit në rajon dhe ofrimin e të dhënave dhe shërbimeve me vlerë të shtuar për komunitetin e

biznesit, për të lehtësuar regjistrimet e mundshme ndërkufitare të biznesit dhe transferimin e selive të shoqërive përmes një portal rajonal *online*.

Ndërkohë, si rregull, çdo aktivitet ekonomik kryhet lirisht në Shqipëri. Sidoqoftë, disa aktivitete që mund të ndikojnë në shëndetin publik, sigurinë kombëtare etj., kërkohet që t'i nënshtrohen procesit të licencimit.

Në aneksin e ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohen fushat dhe kategoritë kryesore të licencave/autorizimeve/lejeve të lëshuara në Shqipëri nga institucionet qendrore.

Megjithatë, në VKM-në nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar, bëhet ndarja e mëtejshme e licencave dhe lejeve të lëshuara nga institucionet qendrore, në licenca/leje të trajtuara nga ose nëpërmjet QKB-së dhe në licenca/leje të trajtuara pa përfshirjen e QKB-së.

Të gjithë personat fizikë dhe juridikë, të regjistruar më parë në regjistrin tregtar, duhet të aplikojnë vetëm në sportelet e shërbimit të QKB-së për t'u pajisur me një nga licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB-së.

Megjithatë, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mjedisit të biznesit, Qeveria e Shqipërisë ka krijuar një grup pune, në të cilin QKB është një institucion kontribuues, për reformën e rregullimit në fushën e licencimit. Në kuadër të kësaj reforme, grupi i punës ka propozuar eliminimin e 22 licencave dhe përmirësimin e mëtejshëm të procesit të licencimit, me anë të riklasifikimit të licencave ose reduktimit të afatit të vendimmarrjes për 49 licencat e tjera. Aktualisht janë eliminuar 10 licenca.

3.1.5 Sistemi ligjor (të drejtat e pronësisë; zbatimi i ligjit dhe i kontratave; efektshmëria e gjyqësorit)

Për më shumë informacion në lidhje me kadastrën e tokës, ju lutemi shikoni kapitullin 23: “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, në seksionin gjyqësori dhe seksionin e të drejtave të pronës.

3.1.6 Sektori financiar

Veprimtaria e sektorit bankar u zhvillua në mënyrë të qëndrueshme gjatë gjysmës së parë të vitit 2020, pavarësisht sfidave që paraqiti situata e



pandemisë në vend. Masat operationale të marra nga bankat për sigurimin e vijueshmërisë së funksioneve kritike dhe marrëdhënieve me klientelën dhe masat e marra nga autoritetet publike për zbutjen e goditjes së pandemisë mbi veprimtarinë ekonomike dhe financiare të vendit, mundësuan që veprimtaria e ndërmjetësimit financiar të vijojë në mënyrë të përshtatshme dhe treguesit financiarë të sektorit bankar të mbeten në nivele të mira. Pasiguria për zhvillimet ekonomike në kushtet e pranisë së pandemisë mbetet e konsiderueshme, dhe të tilla mbeten edhe sfidat për veprimtarinë bankare e financiare. Megjithatë, vlerësimet e industrisë bankare dhe ushtrimet e provës së rezistencës, sugjerojnë që kapacitetet e sektorit bankar për t'u përballur me këto sfida janë aktualisht të mjaftueshme. Treguesit e performancës së sistemit financiar duke përfshirë ata të kapitalizmit, të përfitueshmërisë, të likuiditetit dhe të cilësisë së aktiveve mbeten në nivele të mira. Shkalla e ndërlidhjes mes institucioneve financiare mbetet e qëndrueshme dhe reflekton rëndësinë e qëndrueshmërisë së sektorit bankar për të gjithë

sistemin financiar. Ekspozimi i drejtpërdrejtë i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar vlerësohet të jetë i ulët, ndërsa ecuria e sektorit bankar mbetet kritike për veprimtarinë dhe qëndrueshmërinë e sektorit jobankar.

Sektori financiar dhe roli i tij ndërmjetësues, i matur me madhësinë e aktiveve të tij, ka vijuar të zgjerohet. Aktiviteti i sistemit financiar u zgjerua me gati 4.4 pikë përqindjeje (pp) gjatë gjysmës së parë të vitit 2020, duke u ngjitur në 111.6% të Prodhimit të Brendshëm Bruto.

Sektori bankar dhe kontributin më të lartë në zgjerimin e aktiveve të sistemit financiar, mbështetur kryesisht nga zgjerimi në kreditim dhe investimeve në titujt e qeverisë. Fondet e pensioneve dhe shoqëritë e kursim- kreditit vijuan të zgjerojnë aktivitetin e tyre megjithatë pesha e tyre ndaj PBB-së ruajti nivelin e fundit të vitit 2019. Segmenti i institucioneve financiare jobankare, shoqërive të sigurimit dhe fondeve të investimit shënuan rritje të aktivitetit të tyre.

Tabela 1. Pesha e aktiveve të segmenteve përbërës të sistemit financiar ndaj PBB-së¹⁷ së vendit

Banka e Shqipërisë	Bankat	88.1	92.1	94.8	97.6	97.3	100.5	99.4	96.0	95.5	99.4
	Institucione financiare jobankare	2.7	2.7	2.7	3.0	2.9	3.0	3.1	3.5	4.2	4.4
	Shoqëritë e Kursim- Kreditit	0.8	0.8	0.7	0.8	0.8	0.6	0.6	0.6	0.7	0.7
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Shoqëritë e sigurimit	1.5	1.6	1.7	1.9	2.1	2.1	2.1	2.1	2.2	2.6
	Fondet e pensioneve	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.2	0.2	0.2
	Fondet e investimeve		1.2	3.9	4.8	5.0	4.7	5.0	4.5	4.3	4.4
	Totali i aktiveve të sistemit financiar	93.1	98.6	103.8	108.2	108.0	111.0	110.3	106.9	107.2	111.6

Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, *Të dhënat më të fundit për bilanci të shoqërive të sigurimit, jobankave dhe shoqërive të kursim- kreditit i përkeasin tremujorit të parë të vitit 2020.

¹⁷ Burim zyrtar - INSTAT, mars 2020.



Sektori bankar shqiptar në strukturën e tij numëron 12 banka, nga të cilat 8 banka janë me kapital të huaj dhe 4 banka me kapital vendës.

Aktivitetet e sektorit bankar nga janari deri në gusht 2020¹⁸, u zgjeruan me 3.8% ose 57 miliardë lekë dhe arritën në 1,543 miliardë lekë. Kjo rritje u mbështet nga një zgjerim prej 19.7% në stokun e letrave me vlerë të sektorit bankar dhe 2.7% në stokun e kredisë. Nga ana e detyrimeve, rritja u mbështet nga një zgjerim prej 36 miliardë lekësh në stokun e depozitave dhe një rritje prej 17 miliardë lekësh në stokun e veprimeve me thesarin dhe ndër bankare. Depozitat e përgjithshme arritën në 1,239 miliardë lekë në fund të gushtit 2020 dhe përfaqësojnë rreth 80% të detyrimeve të sektorit bankar. Niveli i mirë i likuiditetit të sektorit bankar dhe zgjerimi i vazhdueshëm i bazës së depozitave, kanë ulur varësinë e sektorit bankar nga financimi i huaj. Në gusht 2020, detyrimet jorezidente zinin rreth 2.5% të totalit të detyrimeve të sektorit bankar, duke ruajtur këtë nivel përgjatë muajve të vitit 2020.

Gjatë vitit 2020 teprica e kredisë së sektorit bankar ka shënuar luhajtje të lehta dhe në fund të muajit gusht u ngjiti në nivelin 592 miliardë lekë (nga 576 miliardë lekë në dhjetor 2019).

Përveç kredisë afatshkurtër dhe asaj dhënë për sektorin publik, të cilat kanë shënuar rënie krahasuar me fundin e vitit të kaluar, të gjitha kategoritë e tjera të kredisë sipas sektorit, valutës dhe afatit janë zgjeruar krahasuar me dhjetorin 2019. Megjithatë, kontributin kryesor në ecurinë pozitive të stokut të kredisë për periudhën e dha zgjerimi i kredisë afatgjatë, kredisë për bizneset dhe asaj në monedhën vendëse. Sipas klasave të kredisë, zgjerim është vënë re kryesisht për klasën e parë të klasifikimit (ajo standard), ndikuar si nga fluksi i kredisë së re ashtu edhe nga rritja e vlerës së kredive të pashlyera në kohë brenda kësaj klase. Për muajt mars- gusht, Banka e Shqipërisë mori vendim për shtyrjen e afatit të pagesës së kësteve të kredisë për bizneset, në mënyrë zbutjen e efektit negativ të shkaktuar nga pandemia e COVID 2019. Për këtë arsye, muajt e fundit evidentojmë rënie të shlyerjeve në kohë, të kredive performuese. Krahas kredisë në klasën

standard, zgjerim i konsiderueshëm (me rreth 31%) është vënë re edhe për kredinë e klasifikuar si “e humbur”, si rezultat i riklasifikimit (në këtë klasë) të kredive nënstandard dhe të dyshimta.

Kredia e re e dhënë gjatë tetë muajve të parë të vitit 2020 ishte rreth 8% më e ulët në krahasim me atë dhënë për të njëjtën periudhë një vit më parë, ndërsa kredia e re e dhënë gjatë muajit gusht ishte më e lartë se mesatarja mujore e 12 muajve të fundit. Rreth 76% e kredisë së re (dhënë gjatë vitit 2020) është akorduar për subjektin biznes, të cilët kredinë e re e kanë marrë kryesisht për qëllime afatshkurtra (*overdraft* dhe kapital qarkullues). Ndërkohë, gjatë muajit gusht, fluksi i kredisë për investime në pasuri të paluajtshme është pothuajse trefishuar. Për shkak të peshës së konsiderueshme të kredisë në valutë (50%) zhvillimet në kursin e këmbimit luajnë një rol të rëndësishëm në kundërvlerën nominale të saj në monedhën vendëse. Efekti i kursit të këmbimit në ndryshimin e kredisë në valutë të konvertuar në lekë gjatë tetë muajve të parë të vitit 2020 ishte pozitiv për 4 miliardë lekë dhe ky efekt reflekton forcimin e Euros ndaj Lekut. Duke përjashtuar ndikimin e kursit të këmbimit ndryshimi i kredisë në valutë referuar fundit të vitit 2019, do të ishte - 0.3% nga +1.1%. Ecuria e kredisë në valutë ka reflektuar, ndër të tjera edhe masat e marra në kuadër të strategjisë së de-euroizimit.

Cilësia e kredisë ka vijuar të përmirësohet në harkun kohor të një viti dhe raporti i kredive me probleme (RKP) 8.1% shënoi nivelin më të ulët përgjatë dekadës së fundit (që prej muajit dhjetor 2009). Krahasuar me një vit më parë, teprica e kredive me probleme u tkurr me 23%, ndërsa RKP ka rënë me rreth 3 p.p. nga niveli prej 11% i regjistruar në muajin gusht të vitit 2019. Rënia më e fortë është regjistruar në kredinë më probleme në valutë (- 26%), kredinë për bizneset (- 27%) dhe kredinë afatshkurtër (- 35%). Gjatë 12 muajve të fundit, ecuria e kredive me probleme është përcaktuar nga shlyerjet e kredive të prapambetura, ristrukturimi midis klasave dhe fshirja e një pjese të kredive të humbura. Tepricat e kredive të humbura, të dyshimta dhe atyre nën standard janë zvogëluar me përkatësisht 11%, 22% dhe 38%.

Struktura e kredive me probleme dominohet nga kreditë e humbura (48%), ndërsa kreditë e

¹⁸ Sipas raportimeve më të fundit të balanceve të bankave pranë Bankës së Shqipërisë.



dyschimta dhe ato nën standard zënë përkatësisht 23% dhe 30% të totalit. Që nga fundi i vitit 2019 deri në gusht 2020, pesha e kredive të humbura ndaj totalit të kredive me probleme është rritur me rreth 11.5 p.p. në 48%. Gjatë kësaj periudhe bankat kanë raportuar transferim të një pjese të kredisë me probleme nga klasa më performuese (ajo e dyshimtë) në klasën “e humbur”. Ndërkohë, gjatë tetë muajve të parë të vitit, stoku i kredive me probleme ka mbetur i pandryshuar. Cilësia e kredisë mbetet për t’u monitoruar muajt e ardhshëm, pasi me shfuqizimin e masave të marra nga Banka e Shqipërisë për shtyrjen e pagesës së kësteve të kredisë nga ana e bizneseve, stoku i kredive me probleme mund të shënojë rritje.

Treguesit e likuiditetit shënuan rritje të lehtë gjatë muajit gusht, ndërkohë që të gjitha bankat ruajnë raporte dukshëm më të larta në krahasim me kufijtë e poshtëm rregullatorë, si për monedhat e veçanta, ashtu edhe për totalin e aktiveve likuide. Raporti kredi/depozita shënoi 47.7% duke rënë lehtë ndaj një muaji më parë. Për valutën raporti shënoi rënie ndërsa për monedhën vendëse ky raport u rrit lehtë ndaj një muaji dhe një viti më parë. Rezultati financiar i sektorit bankar në fund të gushtit ishte pozitiv (+10.4 miliardë lekë) por mjaft më i ulët (- 25%) ndaj një viti më parë. Rritja e shpenzimeve për provigjione, kryesisht për kredinë, në 3.5 miliardë lekë nga një vlerë minimale e raportuar një vit më parë, ishte faktori kryesor pas rënies së rezultatit financiar të sektorit. Të ardhurat neto nga interesat janë rritur lehtë si pasojë e rritjes së të ardhurave neto në lekë. Të ardhurat nga veprimtaritë e tjera nuk shënuan ndryshime, ndërsa shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë u rritën lehtë.

Sektori bankar paraqitet i mirëkapitalizuar dhe asnjë bankë e sektorit nuk rezulton me një normë mjaftueshmërie nën minimumin rregullator prej 12%. Në fund të gjysmës së parë të vitit 2020, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit shënoi 18.1% nga 18.5% në dhjetor 2019 dhe në qershor 2019. Në ecurinë e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, efekti negativ i rritjes së aktiveve të peshuara me rrezik ishte më i madh në krahasim me efektin pozitiv të rritjes së kapitalit rregullator. Gjatë periudhës, kapitali rregullator u rrit në nivelin 152 miliardë lekë,

duke dhënë një efekt pozitiv prej 0.8 pikë përqindjeje në normën e mjaftueshmërisë së kapitalit. Ecuria e tij u mbështet kryesisht nga rritja e rezervave dhe fitimit të pashpërndarë. Nga ana tjetër, aktivet e peshuara me rrezik arritën në rreth 839 miliardë lekë, duke u rritur me 54 miliardë lekë nga niveli i regjistruar në dhjetor 2019. Rritja në këtë tregues dha një kontribut negativ prej 1.2 pikë përqindjeje në raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

Në periudhën mars–qershor të këtij viti, në kushtet e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik për shkak të pandemisë dhe vështirësive të pritshme të kredimarrësve për të përballuar pagesat e kredive, Banka e Shqipërisë ndërmori disa masa dhe ndryshime rregullative të natyrës prudenciale, të cilat synojnë lehtësimin e barrës së kredimarrësve të ndikuar nga pandemia, rritjen e rezistencës financiare të bankave dhe vijimin e aktivitetit kreditues nga ana e sektorit bankar. Këto masa konsistojnë në:

- nxjerrjen e një moratoriumi, që mundëson pezullimin e përkohshëm të pagesave të shlyerjes së kredive për huamarrësit e ndikuar nga pandemia, fillimisht deri në fund të qershorit 2020 dhe më pas, deri në fund të gushtit 2020;

- miratimin e ndryshimeve rregullatore që iu mundësojnë bankave të ruajnë klasifikimin e kredive dhe nivelet e provigjioneve të kredive me probleme gjatë kësaj situatë. Qëllimi është që, deri në fund të këtij viti, bankat dhe klientët e tyre huamarrës të gjejnë forma ristrukturimi të kredive të caktuara që rivendosin shpejt aftësinë paguese të kredimarrësve të ndikuar nga pandemia;

- pezullimin e shpërndarjes së fitimit të bankave deri në fund të këtij viti, me qëllim që në rast të materializimit të humbjeve financiare, madhësia e kapitalit të jetë e përshtatshme jo vetëm për të përthithur këtë humbje, por edhe për të mbështetur kredidhënien e re.

Duke qenë se këto masa janë të përkohshme, edhe ecuria e pandemisë (intensiteti dhe kohëzgjatja e saj) mbetet e pasigurt, nuk përjashtohet mundësia që sfidat me të cilat mund të ndeshet sektori bankar të thellohen. Ustrimet e provës së rezistencës të kryera nga Banka e Shqipërisë, sugjerojnë që në rast të goditjeve ekstreme në kuadrin makroekonomik, do të ishte e nevojshme që banka të caktuara të forconin



pozicionin e tyre të kapitalit megjithëse në tërësi sektori bankar paraqitet i mirëkapitalizuar.

Rreziqet e sektorit bankar

Bankat kanë perceptuar rritje të rreziqeve ekonomike dhe financiare gjatë periudhës, por besimi i bankave në qëndrueshmërinë e sistemit financiar është ruajtur i pandryshuar në vijim të treguesve të mirë financiarë dhe masave të marra për ruajtjen e tyre. Stoku i kredive me probleme ka qenë i qëndrueshëm. Ndikimin kryesor në këtë qëndrueshmëri të vlerës së kredive me probleme e ofruan përcaktimet në moratoriumin e shlyerjes së kredive, të cilat iu kanë dhënë mundësi bankave të pezullojnë përkohësisht evidentimin e kredive me probleme dhe ndryshimet brenda tyre. Në kushtet e vijimit të rritjes së kredisë, raporti i kredive me probleme zbriti në 8.1%. Gjendja e likuiditetit të sektorit bankar paraqitet mjaft e mirë. Te rreziqet e tregut, sektori bankar mbetet i ndjeshëm ndaj rrezikut të kursit të këmbimit përmes segmentit të kredisë së pambrojtur në valutë. Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit mbetet i pranishëm dhe është rritur gjatë periudhës, por vlerësohet i kufizuar.

Rreziqet e veprimtarisë bankare reflektojnë dhe ndërthuren me zhvillime të natyrës strukturore. E tillë është ekzistenca për një kohë të gjatë e mjedisit me norma të ulëta të interesit, i cili ruan presionin mbi rezultatin financiar të bankave, nxit ndryshimin e strukturës së financimit të tij drejt burimeve më afatshkurtra dhe nevojës për aktive likuide të larta, si dhe ruan potencialin për rritje të stresit të veprimtarisë në rastin e një korigjimi të fortë e të papritur. Përdorimi i lartë i valutës në sektorin bankar shoqërohet me rreziqe për administrimin e rrezikut të likuiditetit në valutë. Në tërësi, indekset e vlerësimit të rrezikut sistemik shfaqin rritje gjatë periudhës.

Nëpërmjet veprimeve rregullatore të natyrës mikroprudenciale dhe instrumenteve të politikës makroprudenciale, Banka e Shqipërisë është përpjekur t'i adresojë këto rreziqe. Disa akte të reja rregullatore që janë futur në zbatim, ku përfshihen ai për raportin e mbulimit të likuiditetit, paketa e masave për deeuroizimin, si edhe rregullorja për zbatimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit, synojnë zbutjen e

rreziqeve dhe forcimin e rezistencës së sektorit bankar ndaj tyre.

Politika makroprudenciale

Nga pikëpamja e forcimit të rezistencës së sektorit bankar ndaj rreziqeve me natyrë ciklike e strukturore, dhe uljen e tyre, Banka e Shqipërisë ka miratuar Rregulloren, “Për Shtesat Makroprudenciale të Kapitalit”, si edhe paketën e masave për rritjen e përdorimit të monedhës vendëse në veprimtarinë financiare bankare.

- Rregullorja përmban një kornizë, për zbatimin e:

- Shtesës konservuese të kapitalit (KONS);
- Shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC);
- Shtesës për bankat sistemike (SIST);
- Shtesës për rrezikun sistemik (SRS).

Të gjitha shtesat makroprudenciale të kapitalit duhet të përmbushen me instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë dhe të shprehen si përqindje e ekspozimeve të peshuara me rrezik të bankës. Zbatimi i njëkohshëm i tyre përfaqëson shtesën e kombinuar makroprudenciale të kapitalit ose SHKOMAK.

Kërkesa për shtesën konservuese të kapitalit zbatohet për të gjitha bankat dhe hyri në fuqi me miratimin e rregullores së lartpërmendur. Vlera maksimale e kësaj shtese është 2.5%, dhe rregullorja parashikon që shtesa të plotësohet në hapa prej 0.5 pikë përqindjeje në vit duke filluar që nga muaji mars i vitit 2020. Shtesa kundërciklike e kapitalit për Shqipërinë aktualisht është e barabartë me 0% dhe shpallet në fund të çdo tremujori përmes një vendimi të Guvernatorit. Vendimi për përcaktimin e bankave sistemike dhe shtesat e kapitalit për rëndësinë sistemike, shpallet një herë në vit, në fund të tremujorit të parë. Në vijim të vendimit të qershorit 2019, Guvernatori mori vendimin e radhës në 25 mars të vitit 2020, i cili zgjeron nga katër në pesë numrin e bankave me rëndësi sistemike dhe përcakton shtesën e kapitalit për këto banka me vlera nga 0.5% në 1.5%. Për herë të parë, bankat raportuan përmbushjen e shtesave makroprudenciale të kapitalit për periudhën raportuese “mars 2020”. Raportimi do të kryhet mbi baza tremujore dhe raportimi i fundit i përket muajit qershor 2020. Nga ky raportim rezultoi se të gjitha bankat përmbushin shtesën e kombinuar të kapitalit–SHKOMAK,



duke qenë se raporti i përmbushjes rezulton mbi 100%.

Sektori bankar vijoi të shfaqë një trend të qëndrueshëm në drejtim të shpërndarjes dhe përdorimit të burimeve financiare. Kjo u pasqyrua edhe në Indeksin Herfindahl, i cili mat nivelin e përqendrimit në sektorin bankar. Treguesit e përqendrimit, të matur nga Indeksi

Herfindahl, për totalin e aktiveve, depozitave dhe huave, kanë dëshmuar për një përqendrim relativisht të lartë në sektorin bankar në terma të aktiveve, depozitave dhe më pak për kreditë. Megjithatë, ka një shpërndarje pak më të mirë të peshave në treg gjatë viteve të fundit që rrjedhimisht tregon rritjen e konkurrueshmërisë.



Tabela 2. Indeksi i përqendrimit Herfindahl i aktiveve, kredive dhe depozitave

HI_aktive	0.15	0.14	0.14	0.15	0.15	0.14	0.14	0.15	0.15	0.15	0.15	0.15	0.15
HI_depozita	0.17	0.15	0.16	0.16	0.15	0.14	0.14	0.14	0.14	0.15	0.15	0.15	0.14
HI_kredi	0.11	0.11	0.11	0.12	0.12	0.12	0.12	0.12	0.13	0.13	0.13	0.12	0.12

Tabela 3. Hua me probleme, në përqindje

Raporti i huave me probleme	6.64	10.48	13.96	18.77	22.49	23.49	22.8	18.22	18.27	13.2	12.9	8.4	8.1

Tabela 4. Diferenca e normave të interesit

Spread i normave të interesit (mesatarja e normave të kredisë dhe depozitave)	5.69	6.81	5.96	5.6	5.4	6.1	5.89	5.67	4.76	5.13	5.02	4.99	4.47

Tabela 5: Treguesit kryesorë të përfitueshmërisë, në përqindje (kumulative)

Të ardhura nga interesi/aktiveve mesatare që sjellin të ardhura	8.1	8.11	7.78	7.73	7.31	6.28	5.72	5.2	4.71	4.51	4.10	3.88	
Shpenzime interesi/pasive mesatare që shkaktajnë shpenzime	4.06	3.78	3.57	3.72	3.42	2.14	1.29	0.94	0.69	0.66	0.61	0.56	
Marzhi neto i interesave (NIM)	4.04	4.32	4.2	4.01	3.88	4.15	4.42	4.23	3.92	3.77	3.43	3.28	

Burimi: Banka e Shqipërisë

*Tregu i sigurimeve*

Tregu i sigurimeve më 31.12.2019 përbëhej nga 12 shoqëri sigurimesh. Në strukturën e tregut, 8 shoqëri sigurimesh ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimet e jojetës dhe 4 në sigurimet e Jetës. Një nga shoqëritë e jojetës kryen edhe aktivitet risigurimi. Bazuar në pasqyrën e llogarisë teknike të shoqërive të sigurimit të jojetës, edhe gjatë këtij viti vihet re se tregu i sigurimeve vazhdon të dominohet nga portofoli i MTPL së brendshme.

Totali i primeve të shkruara bruto, për tregun e sigurimeve të jetës dhe jojetës më 31.12.2019 është 17.62 miliardë lekë duke shënuar një rritje prej 689 milionë lekë ose e përkthyer në përqindje në masën 4.07% krahasuar me një vit më parë. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i një rritjeje të volumit të primeve të shkruara bruto në masën 616 milionë lekë ose 3.91% për tregun e sigurimeve të jojetës dhe tregu i sigurimeve të jetës, ka shënuar një rritje prej 72 milionë lekësh ose 6.33 %. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për tregun e jojetës më 31.12.2019 ishte i mjaftueshëm, me 67 milionë lekë mbi nivelin e kërkuar, ose 101,8%. Për tregun e Jetës treguesi është përsëri i mjaftueshëm me rreth 352 milionë lekë mbi nivelin e kërkuar, ose 123.8%. Për tregun e sigurimeve në total, ky tregues paraqitet në nivelin 108.15%.

Treguesit e rentabilitetit ROE dhe ROA për vitin 2019, ishin përkatësisht ROE në nivelin 7.73% nga 7.30% në vitin 2018 dhe ROA 2.40% nga 2.37% në vitin 2018. Të dy këta tregues kanë pësuar rritje të lehtë për vitin 2019, duke reflektuar një rritje të qëndrueshme dhe në përpjesëtim të drejtë të fitimeve, aktiveve dhe kapitaleve të veta të shoqërive të sigurimit.

Totali i aktivitet të tregut të sigurimit më 31.12.2019, sipas pasqyrave financiare, ishte 38.80 miliardë lekë dhe ka pësuar rritje në vlerën 7.23 miliardë lekë, ose 22.94% në krahasim me 31.12.2018. Kjo rritje ka ardhur kryesisht nga sektori i jojetës si rezultat i rritjes së pjesës së risiguruesve në provigjonet teknike të dëmeve, për dëmet e shkaktuara nga dy tërmetet e ndodhura gjatë vitit 2019. Totali i aseteve në tregun e Jetës u rrit me 778 milionë ose 23.4% më shumë krahasuar me vitin 2018. Licencimi në shtator 2019 i një shoqërie të re në tregun e Jetës, ka ndikuar në rritjen e investimeve nga shoqëritë pjesëmarrëse në këtë treg.

Rezultati financiar neto i tregut të sigurimeve për vitin 2019 ishte pozitiv në vlerën 843 milionë lekë.

Tregu i sigurimeve më 30.6.2020 përbëhet nga 12 shoqëri sigurimesh. Në strukturën e tregut, 4 shoqëri sigurimesh ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimet e jojetës dhe 4 në sigurimet e Jetës. Një nga shoqëritë e jojetës kryen edhe aktivitet risigurimi.

Në janar - gusht 2020 tregu i sigurimeve ka pasur një ulje prej 6.48%. Volumi i primeve të shkruara bruto arriti shifrën 10.63 miliardë lekë.

Totali i aktiveve të tregut të sigurimeve më 30.6.2020, sipas pasqyrave financiare, është 38.61 miliardë lekë dhe ka pësuar një ulje në vlerën 0.20 miliardë lekë, ose 0.51% në krahasim me 31.12.2019.

Rezultati financiar neto i tregut të sigurimeve më 30.6.2020 është pozitiv në vlerën 974 milionë lekë.

Tregu i fondeve të investimeve

Struktura e tregut të fondeve të investimeve deri më 31.12.2019 përbëhej nga gjashtë fonde investimi.

Sipas analizës së të dhënave për tregun e Fondeve të Investimeve më 31.12.2019, vlera neto e aseteve të Fondeve, ishte mbi 66.79 miliardë lekë me një rritje 1.06% krahasuar me 31.12.2018.

Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare brenda dhe jashtë vendit të cilat përbëjnë 66.82% të totalit të aseteve të fondeve.

Sipas analizës së të dhënave për tregun e Fondeve të Investimeve më 30.6.2020, vlera neto e aseteve të Fondeve, ishte mbi 65.47 miliardë lekë me një ulje prej 1.97% krahasuar me 31.12.2019.

Tregu i pensioneve private vullnetare

Struktura e tregut të pensioneve private vullnetare përbëhet nga katër fonde pensioni, të cilat administrohen nga tri shoqëri të ndryshme administrimi.

Analiza e të dhënave të tregut të pensioneve private vullnetare më 31.12.2019 tregon një total të aktiveve neto prej 2.91 miliardë lekësh me një rritje prej afro 621.34 milionë lekësh (27.14%) krahasuar me fundin e vitit 2018.

Gjatë vitit 2019, investimet e tregut të Fondeve të Pensioneve përbëhen nga Obligacione thesari të Republikës së Shqipërisë me afat maturimi 3, 5, 7 dhe 10-vjeçar.



Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 30.6.2020 tregon një total të aktiveve neto prej 3.24 miliardë lekë me një rritje prej afro 334.61 milionë lekësh (11.52%) krahasuar me fundin e vitit 2019.

3.2 Kapacitetet për të përballuar presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian

3.2.1 Kapitali njerëzor dhe kapitali fizik Funksionimi i tregut të punës

Dinamika e tregut të punës po përmirësohet vazhdimisht duke reflektuar efektivitetin e politikave të ndërmarra nga qeveria që shkon në favor të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe nxitjes së punësimit.

Referuar anketës tremujore të forcës së punës nga INSTAT- i, shkalla e punësimit për popullsinë 15–64 vjeç, në tremujorin e dytë të vitit 2020 është 59.6%. Gjatë këtij tremujori, në krahasim me të njëjtin tremujor të vitit 2019, numri i të punësuarve gjithsej u ul me 3.6%, ndërkohë krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2020, ky tregues u ul me 2.6%. Në terma vjetorë, sipas sektorëve kryesorë të ekonomisë, ritmi i punësimit ka pësuar rënie me 3.7% në sektorin e bujqësisë, me 3.7% në sektorin e industrisë dhe me 3.4% në sektorin e shërbimeve.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, për popullsinë 15–64 vjeç, është 68.1%. Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2019, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 1.7 pikë përqindjeje më e ulët,

ndërkohë krahasuar me tremujorin e mëparshëm ky tregues shënon një ulje prej 1.5 pikë përqindjeje.

Shkalla e punësimit të të rinjve është 39.7%. Për popullsinë 30–64 vjeç, në tremujorin e dytë të vitit 2020, shkalla e punësimit është 69.9%. Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për të rinjtë e moshës 15–29 vjeç është 50.5%. Për popullsinë 30–64 vjeç, në tremujorin e dytë 2020, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 77.2 %.

Në tremujorin e dytë të vitit 2020, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri, për popullsinë 15 vjeç e lart, është 11.9%. Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2019, shkalla zyrtare e papunësisë u rrit me 0.4 pikë përqindjeje, ndërkohë krahasuar me tremujorin e parë 2020, shkalla zyrtare e papunësisë u rrit me 0.5 pikë përqindjeje.

Shkalla zyrtare e papunësisë për të rinjtë është 21.4%. Në terma vjetorë shkalla e papunësisë së të rinjve shfaq tendencë në rritje. Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2019, shkalla e papunësisë për të rinjtë në tremujorin e dytë të vitit 2020 është 0.5 pikë përqindjeje më e lartë. Krahasuar me tremujorin e parë 2020, shkalla e papunësisë për të rinjtë është rritur me 1.4 pikë përqindjeje. Shkalla e papunësisë për grup-moshën 30–64 vjeç është 9.5%. Në terma vjetorë ky tregues është rritur me 0.7 pikë përqindjeje. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm për këtë grup-moshë shkalla e papunësisë u rrit me 0.4 pikë përqindjeje.

Tabela e të dhënave të tregut të punës (15 vjeç e lart)

2012	Q1	12.9	51.1	58.7
	Q2	13.3	50.2	57.9
	Q3	13.6	48.6	56.2
	Q4	13.6	48.7	56.4
2013	Q1	14.3	47.0	54.9
	Q2	16.0	44.1	52.5
	Q3	16.8	42.9	51.5
	Q4	16.8	42.4	50.9
2014	Q1	18.2	41.5	50.8
	Q2	17.2	44.4	53.6
	Q3	17.0	45.8	55.2
	Q4	17.6	45.6	55.3
2015	Q1	16.9	45.6	54.8
	Q2	17.0	45.8	55.2
	Q3	17.2	46.3	55.9
	Q4	17.3	47.0	56.8



2016	Q1	16.6	47.5	56.9
	Q2	15.5	48.4	57.2
	Q3	14.7	49.9	58.6
	Q4	14.2	49.1	57.2
2017	Q1	14.2	49.2	57.3
	Q2	13.9	50.0	58.1
	Q3	13.6	50.7	58.7
	Q4	13.4	51.2	59.1
2018	Q1	12.5	51.9	59.3
	Q2	12.4	52.0	59.3
	Q3	12.2	52.2	59.4
	Q4	12.3	52.3	59.6
2019	Q1	12.1	52.5	59.7
	Q2	11.5	53.6	60.6
	Q3	11.4	53.8	60.7
	Q4	11.2	53.8	60.6
2020	Q1	11.4	53.1	60.0
	Q2	11.9	51.7	58.8

Burimi: INSTAT

3.2.2 Struktura sektoriale dhe ajo e ndërmarrjeve

-statistikat për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) bazuar në rezultatet e vërtetimit të Statistikave Strukturore për vitin 2017, shprehin se:

- 99,8 % të ndërmarrjeve aktive e zënë NVM, nga 99,9 % që zinin vitin e kaluar. Sektori i tregtisë ka peshën më të madhe me 41,4 %, i ndjekur nga sektori i shërbimeve të tjera me 20,8 %. Përqindjen më të ulët e ka sektori i industrisë nxjerrëse me 0,4 % dhe sektori i energjisë elektrike, ujit dhe menaxhimit të mbetjeve me 0,6 %;

- 80,3 % e të punësuarve janë punësuar nga NVM-të nga 81,0 % që ishte në vitin e kaluar. Sektori i tregtisë punëson 29,2 % të NVM-ve, i ndjekur nga sektori i shërbimeve të tjera me 19,6 % dhe sektori i industrisë përpunuese me 18,7 %. Sektorët me numrin më të vogël të të punësuarve në NVM-të janë sektori i industrisë nxjerrëse me 1,7 % dhe sektori i energjisë elektrike, ujit dhe menaxhimit të mbetjeve me 2,4 %;

- 77,2 % të shitjeve neto realizohen nga NVM-të nga 77,8 % të realizuara vitin e kaluar. Sektori i tregtisë ka peshën më të madhe me 52,6 % të shitjeve neto, i ndjekur nga sektori i industrisë përpunuese me 11,4 % dhe nga sektori i ndërtimit me 11,2 %. Sektori me përqindjen më të ulët të shitjeve të realizuara nga NVM-të është sektori i industrisë nxjerrëse me 2,1 %;

- 60,1 % të investimeve në vend kryhen nga NVM-të nga 74,9 % të kryera vitin e kaluar. Sektori

me përqindjen më të lartë të investimeve të kryera në NVM-të është sektori i energjisë elektrike, ujit dhe menaxhimit të mbetjeve me 24,1 %. Nga ana tjetër, sektori i industrisë nxjerrëse ka përqindjen më të ulët të investimeve prej 1,3 %;

- Ndërmarrjet me 250+ të punësuar edhe pse përbëjnë vetëm 0,2 % të ndërmarrjeve gjithsej në vend, punësojnë 19,7 % të punonjësve, kryejnë 39,9 % të investimeve dhe realizojnë 22,8 % të shitjeve neto;

- 2,7 % e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme eksportojnë mallra nga 2,4 % që eksportuan në vitin 2016. Vlera e eksporteve të mallrave të NVM-ve përbën 59,6 % të vlerës së eksporteve gjithsej. Sektori me përqindjen më të lartë të ndërmarrjeve eksportuese është industria nxjerrëse, ku 24,4 % e ndërmarrjeve aktive të këtij sektori eksportojnë;

- 9,3 % e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme janë importuese nga 7,4 % që ishin në 2016, të cilat përbëjnë 81,6 % të vlerës së importeve të mallrave për 2017. Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, sektori me përqindjen më të lartë të numrit të ndërmarrjeve importuesve është sektori i industrisë nxjerrëse me 20,3 %

Për më shumë të dhëna dhe shpjegime metodologjike referojuni linkut në vijim: <http://www.instat.gov.al/media/5319/rezultatet-e-sme.pdf>.



3.2.3 Ndikimi i shtetit në konkurrueshmëri/konkurrencë

Raporti vjetor për ndihmën shtetërore për vitin 2019 jep një përshkrim të objektivave kryesore, që janë arritur në fushën e ndihmës shtetërore në Shqipëri, si dhe të instrumenteve kryesore të përdorur në periudhën 2015–2019. Shuma e ndihmave shtetërore të dhëna në Shqipëri gjatë viteve 2015–2019 është vlerësuar në rreth 25,562.79 milionë lekë (198.16 milionë €), prej të cilave 8,482.45 milionë lekë (68.97 milionë €) që përfaqësojnë 0.5 % të PBB-së, janë dhënë në vitin 2019. Në totalin e ndihmës së dhënë për vitin 2019, vendin kryesor (rreth 50.4%) e zënë ndihmat sektoriale, ndërsa ndihma horizontale përbën 49.6 % të ndihmës gjithsej. Megjithatë, pjesa më e madhe e skemave që japin ndihmë shtetërore nuk e tejkalon kufirin *de minimis* të Bashkimit Evropian dhe, si të tilla, përgjithësisht nuk paraqesin problem në këndvështrimin e tregtisë ndërkombëtare.

Instrumentet kryesore të ndihmës shtetërore në Shqipëri gjatë vitit 2019 janë A1 grantet dhe A2 përjashtimi nga taksat, rimbursimi apo reduktimi i shkallës tatimore.

Në vitin 2019, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) menaxhoi katër skema të granteve me qëllim të rritjes së aftësisë konkurruese dhe inovacionit të ndërmarrjeve shqiptare. U paraqitën 120 aplikime, dhe përfituan 94 biznese, me një shumë të disbursuar prej 67 milionë lekësh ose 92% të buxhetit të alokuar.

3.2.4 Integrimi tregtar

Shkëmbimet tregtare të Shqipërisë janë të përqendruara me vendet e BE-28. Gjatë vitit 2019, eksportet e mallrave drejt vendeve të BE-28 arritën në 228.9 miliardë ALL, ose rreth 76.6% të totalit të eksporteve. Këto eksporte u pakësuan me rreth 2.9% në krahasim me vitin 2018. Gjatë të njëjtës periudhë, importet e mallrave nga vendet e BE-28 arritën në 379.7 miliardë ALL, duke regjistruar një rënie në terma vjetorë në masën 3%. Importet nga këto vende zënë rreth 58.4% të importeve totale.

Italia përbën destinacionin kryesor të eksporteve shqiptare, ku gjatë vitit 2019 kanë shkuar 47.9% të eksporteve totale. Ndaj eksporteve totale, Spanja rezulton me 8%, Gjermania me 4.8% dhe Greqia me 4.3%. Vende partnere të rëndësishme brenda BE-28 janë Italia me 62.5%, Spanja 10.5%, Gjermania 6.2%, Greqia 5.6% dhe Franca me 2%. Në të njëjtën kohë, peshën kryesore në importet e

ardhura nga vendet e BE-28 e zënë Italia me 43.2%, Greqia me 14.3% dhe Gjermania me 12.3%. Ndaj importeve, në total Italia zë 25.2%, Greqia 8.4%, dhe Gjermania 7.2%.

Gjatë vitit 2019, eksportet e mallrave drejt vendeve të CEFTA-s arritën në ALL 51.4 miliardë me një rritje vjetore prej 1.3%. Ato përbënin 17.2% të totalit të eksportuar të mallrave. Importet nga vendet e CEFTA-s arritën në ALL 44.5 miliardë, ose rreth 6.9% të totalit të importit, me një rënie në terma vjetorë prej 1.4%.

Eksportet e mallrave janë të përqendruara në kategorinë “Tekstile dhe këpucë”, e cila përbën mbi 54% të totalit të eksportuar për vitin 2019. Eksportet e kësaj kategorie ranë me 5% në terma vjetorë. Volumi eksporteve në vlerë të kategorisë “Lëndë djegëse” është pakësuar në 19.1% ndaj vitit 2018, si rezultat i rënies së eksportit të energjisë elektrike. E njëjta gjë vlen për kategorinë “Metale dhe artikuj prej metali” e cila është goditur nga koniunktura e pafavorshme ndërkombëtare si për kërkesën dhe për çmimet.

PJESA 4

KAPITULLI 1

LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE

1.1 Përmbajtja e kapitullit

Parimi i lëvizjes së lirë të mallrave nënkupton që produktet duhet të tregtohen në mënyrë të lirë nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian në një tjetër. Në një numër sektorësh ky parim i përgjithshëm plotësohet nga kuadri rregullator i harmonizuar në “qasjen e vjetër” (vendosja e specifikave të sakta në mallrat) ose “qasja e re” (vendosja e kërkesave të përgjithshme në mallrat). Legjislacioni i harmonizuar evropian në lidhje me mallrat, i cili duhet të transpozohet, përfaqësohet në pjesën më të madhe të *acquis* në këtë kapitull. Përveç kësaj, kjo kërkon kapacitete të mjaftueshme administrative të cilat janë thelbësore në notifikimin e kufizimeve në tregti si dhe për të zbatuar masa horizontale dhe procedurale në fusha të tilla si standardizimi, vlerësimi i konformitetit, akreditimi, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut.

1.2 Struktura e kapitullit

1. Çështjet horizontale

1.1. Standardizimi

1.2. Akreditimi



- 1.3. Vlerësimi i konformitetit
- 1.4. Metrologjia
- 1.5. Mbikëqyrja e tregut
2. Direktivat e përqasjes së vjetër
 - 2.1. Mjetet motorike
 - 2.2. Kimikatet
 - 2.3. Produktet farmaceutike
 - 2.4. Produktet kozmetike
 - 2.5. Detergjentet
 - 2.6. Xhami i kristalit
 - 2.7. Tekstile
 - 2.8. Këpucë
 - 2.9. Plehra kimike
3. Direktivat e përqasjes së re
 - 3.1. Pajisjet elektrike brenda disa kufijve të tensionit
 - 3.2. Pajisjet e thjeshta nën presion
 - 3.3. Siguria e lodrave
 - 3.4. Siguria e makinerive
 - 3.5. Pajisjet mbrojtëse personale
 - 3.6. Lëndët plasëse për përdorime civile dhe fishekzjarrët
 - 3.7. Pajisjet dhe sistemet në ambiente potencialisht shpërthyes
 - 3.8. Ashensorët
 - 3.9. Instrumentet e peshimit joautomatik
 - 3.10 Instrumentet matës
 - 3.11 Pajisjet nën presion
 - 3.12 Bojlerët me ujë të nxehtë
 - 3.13 Pajisjet e gazit
 - 3.14 Pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacionit
 - 3.15 Përputhshmëria elektromagnetike
 - 3.16 Anijet çlodhëse
 - 3.17 Pajisje detare
 - 3.18 Sistemi hekurudhor i shpejtësisë së lartë
 - 3.19 Instalime teleferike të projektuara për transport personash
 - 3.20 Produktet e ndërtimit
 - 3.21 Paketimi dhe paketimi i mbetjeve
 - 3.22 Pajisjet mjekësore
 - 3.23 Pajisjet mjekësore aktive të transplantueshme
 - 3.24 Pajisjet mjekësore të diagnostifikimit *in vitro*
 - 3.25 Pajisjet e transportueshme nën presion
 - 3.26 Emetimi i zhurmave në ambient nga pajisjet për përdorim në mjedise të hapura
4. Përqasja e re dhe globale

4.1. Informacioni i konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera për produktet me ndikim në energji

4.2. Informacionin e tharëseve për përdorim shtëpiak në lidhje me konsumin e energjisë

4.3. Etiketimi i makinave larëse për përdorim shtëpiak në lidhje me konsumin e energjisë

4.4. Etiketimi i pajisjeve frigoriferike për përdorim shtëpiak në lidhje me konsumin e energjisë

4.5. Etiketimi i energjisë për kondicionerët e ajrit

4.6. Etiketimi i energjisë për llambat dhe ndriçuesit elektrike

4.7. Etiketimi i energjisë për furrat dhe aspiratorët

1.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar me kapitullin 1 të legjislacionit evropian buron nga neni 70 dhe 75 i MSA-së.

Këto dispozita detyrojnë Shqipërinë që teknikisht të sjellë legjislacionin e saj kombëtar në linjë me atë të BE-së, por gjithashtu të sigurojë që ai të zbatohet dhe të hyjë në fuqi. Kështu, tashmë në këtë fazë të procesit të para- anëtarësimit, organet e ndryshme shtetërore duhet të jenë të përfshira në ushtrimin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të *acquis* që është në fuqi.

Për më tepër, kur legjislacioni i BE-së është subjekt konstant zhvillimi, përafrimi i ligjeve nuk do të jetë i plotë me përshtatjen e legjislacionit shqiptar me atë të legjislacionit evropian aktualisht në fuqi. Monitorimi i vazhdueshëm i zhvillimeve të BE-së është i nevojshëm si për përpjekjet e parapranimit, ashtu dhe përgatitjen e Shqipërisë si realitet i përditshëm për anëtarësimin në të ardhmen në BE.

Në kuadër të MSA-së, Partneriteti Evropian me Shqipërinë është instrumenti kryesor për të ndihmuar autoritetet shqiptare në realizimin e perspektivës evropiane të vendit.

Parimi i përgjithshëm i lëvizjes së lirë të mallrave nënkupton se produktet duhet të tregtohen lirisht nga një vend i Bashkimit Evropian në një tjetër. Lëvizja e lirë e mallrave është faktor kyç në rritjen dhe zhvillimin e tregut të brendshëm. Ky parim është përcaktuar në nenet 34, 35 dhe 36 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), duke parandaluar Shtetet Anëtare të miratojnë ose



të ruajnë kufizime të pajustificuara në tregtinë brenda BE-së.

Dispozitat e TFBE-së nuk përjashtojnë ndalimet e justifikuara për shkak të moralit publik, politikës publike ose sigurisë publike, mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve ose bimëve, ose mbrojtjes së pronës industriale dhe tregtare, si dhe kërkesave të tjera të detyrueshme të njohura nga Gjykata e Drejtësisë (p.sh. mbrojtjen e mjedisit). Megjithatë, ndalesa të tilla duhet të mbeten proporcionale dhe nuk duhet të përbëjnë diskriminim arbitrar ose një kufizim të fshehtë në lidhje me tregtinë midis Shteteve Anëtare.

Masat që kanë efekt të njëjtë me kufizimet sasiore janë të ndaluara me përjashtim të një grupi të vogël masash kufizuese. Kjo konkretisht nënkupton eliminimin e pengesave teknike dhe përmbushjen e parimit të njohjes reciproke. Dispozitat administrative relevante duhet të miratohen për të zbatuar procedurat e njohjes reciproke të mallrave të tregtuara ligjërisht në një shtet tjetër anëtar, të përcaktuara në Rregulloren (EU) 2019/515 dhe shkëmbimit të informacionit në Rregulloren “Strawberry” (KE) nr. 2679/98.

Në një numër sektorësh parimi i përgjithshëm plotësohet nga një kornizë rregulluese e harmonizuar. Masat horizontale përcaktojnë infrastrukturën e cilësisë që Shtetet Anëtare duhet të vendosin në fusha të tilla si standardizimi, vlerësimi i konformitetit, akreditimi, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut.

Legjislacioni i harmonizuar në lidhje me produktet evropiane, i cili duhet të transpozohet nga çdo shtet anëtar, përfaqëson pjesën më të madhe të *acquis* të këtij kapitulli. Ajo bazohet në “përqasjen e vjetër” që imponon specifikimet specifike të produktit dhe “përqasjen e re dhe globale” (imponon kërkesat e përgjithshme të produktit).

Legjislacioni në kuadër të përqasjes së re përfshin pajisjet e tensionit të ulët (LVD), përputhshmërinë elektromagnetike (EMC), lodrat, makineritë, ashensorët, emetimet e zhurmave në ambient, shkarkimet ndotëse nga pajisjet motorike të lëvizshme në rrugë, pajisjet personale mbrojtëse (PPE) sistemet mbrojtëse të destinuara për përdorim në atmosfera shpërthyes (ATEX), pajisje mjekësore, aparate të gazit, enë nën presion, teleferikët, prodhime ndërtimore, anijet rekreative, kërkesat e projektimit ekologjik për produktet e

lidhura me energjinë (ERP). Legjislacioni i përqasjes së vjetër mbulon fushat e automjeteve dhe kimikateve.

Zbatimi në mënyrën e duhur i një sërë masash procedurale kërkojnë gjithashtu kapacitete të mjaftueshme administrative. Këto përfshijnë procedurën e njohjes në fushën e standardeve teknike dhe rregulloreve të përcaktuara në direktivën 1535/2015/EU, legjislacionin mbi tregtinë e armëve, produktet e mbrojtjes, xhamin e kristaltë, këpucët, etiketimin e tekstilit, çmimet e produkteve mjekësore dhe direktivën 2014/60/BE për kthimin e objekteve kulturore të zhvendosura në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti anëtar në atë të një shteti tjetër anëtar.

1.4 Situata aktuale në Shqipëri

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave. Gjatë periudhës raportuese ka pasur një progres të limituar në përafrimin sektorial me legjislacionin e produkteve të “përqasjes së re dhe globale” dhe në akreditimin e trupave të tjerë të vlerësimit të konformitetit.

Parimet e përgjithshme

Sa i përket fushës së paharmonizuar dhe aplikimit të parimeve të parashikuara nga nenet 34–36 të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian, Shqipëria është duke marrë masat për hartimin e një plani veprimi për heqjen e masave me efekt të barasvlershëm me kufizimet sasiore për tregtinë në mallra. Metodologjia për shqyrtimin e këtyre masave/barrierave është e finalizuar dhe puna për hartimin e Planit të veprimit ka nisur dhe pritët të finalizohet, sipas planifikimeve, deri në fund të vitit 2022 (më shumë informacion të detajuar në seksionin 4.1.1.5). Duhet thënë se plani i veprimit pritët të jetë një dokument që do të duhet të përditësohet periodikisht.

Çështjet horizontale

Parimet e tregtimit të produkteve dhe mbikëqyrjes së tregut në Shqipëri rregullohen në mënyrë horizontale:

- Në nivel strategjik nga Strategjia e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mbikëqyrjes së Tregut 2015–2020, dhe

- Në nivel legjislativ nga i. ligji nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtinë dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” (i cili harmonizon pjesërisht vendimin 768/2008/KE dhe Rregulloren 765/2008/KE, tashmë të ndryshuar me Rregulloren 2019/1020); si edhe ii. nga



legjislacioni specifik që rregullon veprimtarinë e institucioneve të infrastrukturës së cilësisë (standardizimi, akreditimi, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut).

Në Shqipëri janë realizuar disa hapa paraprakë për hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për fushën e lëvizjes së lirë të mallrave dhe finalizimi i një dokumenti të tillë strategjik pritet të finalizohet, sipas planifikimit, deri në fund të vitit 2022.

Mbikëqyrja e tregut

Rritja dhe forcimi i kapaciteteve zbatuese të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) është kryer nëpërmjet ndryshimit të struktura të ISHMT si dhe nëpërmjet rritjes së numrit të inspektorëve. Struktura e inspektoratit është e plotësuar në nivelin 85%, rekrutimi i vendeve vakante të mbetura është në proces dhe pritet të përfundojë në fund të vitit 2020. Përfshirja e ISHMT në projektin 3-vjeçar (trevjeçar) “Asistenca Teknike për zhvillimin e efektivitet të mbikëqyrjes së Tregut” me numër identifikimi EuropeAid/137616/IH/SER/A, ka ndihmuar në trajnimin e inspektoreve sipas fushave përkatëse, hartimin e dokumenteve standarde dhe në lehtësimin e procedurave të inspektimit sipas produkteve. ISHMT (së bashku me autoritete të tjera të mbikëqyrjes së tregut në WB6) është gjithashtu pjesë e projektit *South East Europe Quality Infrastructure (SEE QI)* i financuar nga PTB lidhur me kërkesat ligjore dhe implementimin e disa direktivave mbi sigurinë e produkteve joushqimore.

Standardizimi

Legjislacioni në fushën e standardizimit siguron qartë rregulla dhe procedura në përputhje me ato të përdorura nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit, si CEN, CENELEC, ETSI, ISO dhe IEC. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 382, datë 27.6.2018, “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e standardizimit” ka transpozuar pjesërisht Rregulloren e BE-së Nr. 1025/2012, “Për standardizimin evropian”. Përveç legjislacionit në fuqi, të gjitha proceset e standardizimit bazohen në rregulloret e brendshme të DPS që janë në përputhje me rregulloret evropiane dhe ndërkombëtare në këtë fushë.

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) është anëtare me të drejta të plota në Institutin Evropian të Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI) dhe anëtar i asociuar i Komitetit Evropian

për Standardizimin (CEN) dhe Komitetin Evropian për Standardizimin Elektroteknik (CENELEC), anëtar korrespondent në Organizatën Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO) dhe anëtare me të drejta të kufizuara vote (vetëm për 3 Komitete Teknike) në Komisionin Ndërkombëtar të Elektroteknikës (IEC). Janë adoptuar mbi 98% e standardeve të CEN&CENELEC dhe 93% të standardeve të telekomunikacionit të publikuara nga ETSI. Databaza e DPS është përmirësuar në lidhje me regjistrimin/arkivimin e standardeve, terminologjinë e standardeve për përkthimin e tyre, ndërlidhjen me databazat e standardeve.

Akreditimi

Ligji nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” ka harmonizuar në mënyrë të plotë dispozitat përkatëse për akreditimin të Rregullores (KE) nr. 765/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 9 korrik 2008 Kërkesat për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut. Ky ligj rregullon funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, bordit të saj të akreditimit, komitetet teknike dhe çështje të tjera procedurale si dhe është plotësisht në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 765/2008, prandaj nuk ka planifikim për përafrim të mëtejshëm. Të gjitha aktet dytësore në fushën e akreditimit janë miratuar në Korrik -shtator 2015.

Struktura administrative përgjegjëse për akreditimin është e ngritur dhe është funksionale që nga viti 2004. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) funksionon nën varësinë e Ministrisë e Financave dhe Ekonomisë si një organ i pavarur dhe i paanshëm.

Struktura administrative përgjegjëse për akreditimin është e ngritur dhe është funksionale që nga viti 2004. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) funksionon nën varësinë e Ministrisë e Financave dhe Ekonomisë si një organ i pavarur dhe i paanshëm.

DPA kryen veprimtarinë e akreditimit me kompetencë dhe është një anëtare me të drejta të plota në organizatën e Bashkëpunimit Evropian për Akreditim (EA) dhe anëtare nënshkruese e EA MLA në fushën e laboratorëve të testimit, organeve të certifikimit të sistemit të menaxhimit, certifikimit të personave dhe organeve të inspektimit. DPA është anëtare nënshkruese e ILAC MRA në fushën e



testimit dhe inspektimit dhe IAF MLA për certifikimin e sistemit të menaxhimit.

Metrologjia

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) është anëtar i EURAMET si dhe anëtar i asociuar i WELMEC. DPM ka implementuar dokumentacionin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë së DPM-së në laboratorët e DMSHI-së, në përputhje me standardin e ri SSH ISO/IEC 17025:2017 “Kompetencat teknike të laboratorëve të testimit dhe kalibrimit”, që prej fillimit të vitit 2019.

Në lidhje me vlerësimin e menaxhimit të cilësisë së DPM-së, u organizua dhe u realizua me sukses vlerësimi i laboratorëve të masës, volumeve, presionit nga Organizata Evropiane e Metrologjisë EURAMET dhe projekti EURAMET nr. 1465, në lidhje me plotësimin e kërkesave të standardit të ri ISO/IEC 17025:2017 dhe Marrëveshjes Ndërkombëtare të Njohjes së Ndërsjellë (CIPM MRA).

Sistemi i menaxhimit të cilësisë mori besueshmërinë e organizatës evropiane (EURAMET) në Prill të vitit 2019 dhe hapi rrugën për ripublikimin e aftësive matëse dhe kalibruese (CMC) të fushës së masës në databazën e Byrosë Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave, BIPM KCDB.

Zbatimi i projektit me PTB-në “Fondi Rajonal i Konsulencës të Infrastrukturës të Cilësisë është në proces, përkatësisht në laboratorin e temperaturës, laboratorin elektrik, laboratorin e gjatësisë, laboratorin e kimisë dhe fushën e testeve të zotësisë.

Janë në proces deklarimi Aftësitë matëse dhe kalibruese (CMC) të laboratorit të presionit dhe volumeve. CMC-të e Volumeve janë pranuar nga EURAMET si dhe nga 4 Organizata Rajonale (RMO) dhe janë në pritje të përgjigjes nga Sistemi i Metrologjisë Ndër Amerikan (SIM).

COVID-19 ka krijuar një situatë të vështirë, megjithatë laboratorët e DPM-së kanë nisur procesin e ndërkrahimeve laboratorike me institutet homologe, me qëllim akreditimin e laboratorëve. Gjithashtu, DPM është koordinatore në projektin me PTB për realizimin e ndërkrahimeve dhe testeve laboratorike sipas standardit ISO/IEC 17043: 2010. Ky proces ju vjen në ndihmë shumë laboratorëve dhe subjekteve vendës, pasi kushtin kryesor për t'u akredituar,

ndërkrahimin apo testin e zotësisë, do ta realizojnë brenda Republikës së Shqipërisë dhe me më pak kosto financiare.

Ka filluar ndërkrahimi në fushën e temperaturës dhe lagështisë si projekt i EURAMET-it me pilot INRIM, Itali.

Direktivat e Përqasjes së Vjetër

Në lidhje me legjislacionin e produkteve të “përqasjes së vjetër”, ligji nr. 27/2016, “Për Menaxhimin e Kimikateve” dhe akteve nënligjore të tij zbatuese janë pjesërisht në përputhje me dispozitat e Rregullores për Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (REACH) dhe akteve të tjera përkatëse të *acquis*. Paketa ligjore me bazë REACH (1 ligj dhe 3 VKM) ka transpozuar në legjislacionin kombëtar të gjitha elementet e mundshme të Rregullores së BE 1907/2006, të cilat mund të përafrohen nga vendet kandidatë. Legjislacioni kombëtar për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin kimik (CLP) është në përputhje me Sistemin e Harmonizuar të Kombeve të Bashkuara për Klasifikimin dhe Etiketimin e Kimikateve. Projekti “Mbështetje për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për Përmirësimin e Menaxhimit të Kimikateve”, ka filluar implementimin nga marsi 2019, me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze/SIDA, do të zbatohet nga Agjencia Suedeze e Kimikateve (KemI) për një periudhë 3-vjeçare, duke kontribuar në ngritjen e aftësive teknike dhe administrative të institucioneve të përfshira në fushën e kimikateve, si dhe zbatimin e legjislacionit të miratuar në këtë fushë.

Direktivat e Përqasjes së Re

Prioriteti për Shqipërinë ka qenë, është dhe do të vazhdojë të jetë krijimi i një mjedisi më të sigurt për qytetarët e tij dhe të huaj, bizneset dhe shoqërinë në përgjithësi. Posedimi i paautorizuar i armëve të zjarrit në vendin tonë aktualisht është shqetësim, për shkak të situatës së trashëguar ndër vite, por edhe për shkak të një rritje të qarkullimit të mallrave dhe njerëzve, gjë që sjell edhe rritje të aktivitetit kriminal në fushën e armëve të zjarrit, trafikimit të paligjshëm në armë dhe municione.

Parlamenti shqiptar ka miratuar një numër ligjesh të cilat synojnë një kontroll më efektiv të armëve. Me aktet normative të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimet e Ministrisë të Brendshme ose institucioneve të tjera të ngarkuara me ligj, paketa e akteve ligjore dhe nënligjore në



Shqipëri është e plotë për të lejuar aktivitete të ligjshme me armë për ato kategori që plotësojnë kushtet dhe kriteret, por edhe për të penalizuar ata qytetarë që synojnë të kryejnë dhe organizojnë veprimtari të paligjshme në këtë drejtim.

Vendi ynë ka marrëveshje të mëdha ndërkombëtare për kontrollin e armëve, duke përfshirë: Traktatin e Tregtisë së Armëve, Programin e Veprimit të Armëve të Vogla dhe Armët e Lehta, Protokollin e Armëve të Zjarrit, dhe ka përqafuar nismat rajonale për të forcuar kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta (SALW), në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në të gjithë rajonin.

Përqasja e re dhe globale

Ministria e Kulturës, në zbatim të ligjit 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” është përgjegjëse për hartimin dhe monitorimin e politikave për lëvizjen e lirë të pasurive kulturore.

Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK), ish-Qendra Kombëtare për Regjistrimin e Pasurive Kulturore (QKIPK), i ngritur me VKM-në nr. 432, datë 26.6.2019, “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore” është një institucion i specializuar zbatues, në varësi të Ministrisë së Kulturës, përgjegjës për zbatimin e ligjit 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, e Direktivës 2014/60/BE dhe Rregullores së Këshillit nr. 116/2009 për sa i përket lëvizjes së lirë të pasurive kulturore.

IKRTK vepron në gjithë territorin e Republikën e Shqipërisë dhe gjithashtu është përgjegjës në veçanti në fushën e regjistrimit, katalogimit digjital, dokumentimit, vlerësimit, promovimit të trashëgimisë kulturore, si dhe për respektimin/monitorimin e qarkullimit ligjor kombëtar/ndërkombëtar të pasurive kulturore. IKRTK dhe Ministria e Kulturës, ka aplikuar dhe përfutur projektin nga IPA Kombëtare me titull “Ngritja e kapaciteteve të Administratës Publike Shqiptare në lëvizjen e lirë të mallrave dhe luftën kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore”, i cili ka për qëllim përafrimin e plotë të legjislacionit vendës me *acquis* e Bashkimit Evropian në fushën e luftës kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore, si dhe ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale dhe rritjen e ekspertizës të stafëve të administratës publike

shqiptare përgjegjës për implementimin e procedurave për lëvizjen e lirë të pasurive kulturore dhe luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore, në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian, Rregulloret dhe legjislacionit vendës. Projekti po zbatohet në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore përgjatë vitit 2019–2020, por situata e shkaktuar nga COVID-19 dhe tërmetet, ka ndikuar në shtyrjen e afateve për përfundimin e këtij projekti deri në Mars 2021.

Kontrolli i lëndëve plasëse për përdorim civil dhe artikujve piroteknike realizohet nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Ministria e Mbrojtjes është përgjegjëse për prodhimin, importin eksportin dhe kontrollin mbi konformitetin të lëndëve plasëse për përdorim civil dhe artikujve piroteknike, ndërsa Ministrinë e tjera janë përgjegjëse për përdorimin, asgjësimin, magazinimin dhe transportin e këtyre mallrave.

1.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Parimet e Përgjithshme

- Gjatë vitit 2020, ka nisur puna për hartimin e Planit të Veprimit për identifikimin dhe heqjen e barrierave me efekt të barasvlershëm me kufizimet sasiore në tregtinë e mallrave. Ky Plan Veprimi pritet të sigurojë përputhshmëri me nenet 34–36 TFBE sa i përket legjislacionit ekzistues. Në periudhën shkurt–shtator 2020 janë realizuar:

- Hartimi i planit operacional të punës, ku janë detajuar hapat, afatet dhe roli/përgjegjësitë institucionale deri në finalizimin e pjesës së parë të planit të veprimit, ku do të pasqyrohen fillimisht vetëm me sektorët prioritarë; plani operacional do të shërbejë ndër të tjera edhe për të monitoruar dhe ndjekur ecurinë e hartimit të Planit të Veprimit;

- Organizimi 3 sesione trajnimi *online* për anëtarët e GNPIE (13, 14 dhe 16 korrik 2020) me synimin e dhënies së njohurive të domosdoshme për të realizuar me cilësi dhe eficiencë procesin e identifikimit dhe analizës së barrierave. Trajnimet trajtuan çështje mbi parimet dhe kërkesat e neneve 34–36 TFBE, mbi konceptin e njohjes reciproke, mbi jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë që ka bërë interpretimin e këtyre neneve, si edhe u shpjegua metodologjia;

- Hartimi i një dokumenti dyfaqësh me orientime praktike për të ndihmuar anëtarët e GNPIE-së në identifikimin e legjislacionit që mund



të përmbajë potencialisht masa me efekt të barasvlershëm;

- Përgatitja e modelit të tabelës që do të përdoret për identifikimin e legjislacionit që do të shqyrtohet.

Aktualisht janë në proces dhe pritet të përfundojnë deri në fund të vitit 2020:

- Finalizimi i Koncept dokumentit të Planit të Veprimit, ku do të paraqitet struktura dhe elementet në përmbajtje të tij;

- Identifikimi i legjislacionit nga ministritë/institucionet e linjës me qëllim krijimin e “inventarit” të plotë të akteve ligjore/nënligjore mbi bazën e të cilit do të vijojë puna për shqyrtimin dhe analizën e barrierave.

Hapat e tjerë të planifikuar në planin operacional të punës do të realizohen përgjatë vitit 2021.

Gjithë procesi i përgatitjes së Planit të Veprimit mbështetet nga projekti SANECA që zbatohet nga GIZ me asistencën financiare të Qeverisë Gjermane.

Çështje horizontale

Gjatë vitit 2020 ka nisur puna për hartimin e një dokumenti Udhërrëfyese për fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, i cili do të përfshijë aspektet e harmonizimit të legjislacionit dhe ngritjen/forcimin e kuadrit institucional përgjegjës për zbatimin. Në periudhën shkurt–shtator 2020 janë realizuar:

- Hartimi i planit operacional të punës, ku janë detajuar hapat, afatet dhe roli/përgjegjësitë institucionale deri në finalizimin e *roadmap*-it për lëvizjen e lirë të mallrave; plani operacional do të shërbejë ndër të tjera edhe për të monitoruar dhe ndjekur ecurinë e hartimit të këtij dokumentoi strategjik;

- Është finalizuar Analiza e Mangësive Ligjore dhe Analiza e Mangësive Institucionale dhe Administrative, të cilat ndonëse të përgatitura në kuadër të planit të hapave kyçë për përgatitjen e takimit bilateral, janë dokumente kyç që ushqejnë përgatitjen e *roadmap*. 6 sesione *coaching online* janë organizuar për të orientuar anëtarët e GNPIE-së në dhënien e *input*-eve cilësore për këto analiza.

Hapat e tjerë të planifikuar në planin operacional të punës do të realizohen deri në fund të vitit 2020 dhe përgjatë 2021–2022. Gjithë procesi i përgatitjes së *roadmap* mbështetet nga projekti SANECA i cili zbatohet nga GIZ me asistencën financiare të Qeverisë Gjermane.

Mbikëqyrja e tregut

Me qëllim rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së konsumatorëve ISHMT ka zhvilluar 804 inspektime, në fushat e parapaketimeve, instrumenteve matës, lodrave, detergjenteve, këpucëve, tekstileve, produkteve elektrike, produkteve mekanike etj. Janë marrë 84 masa administrative nga të cilat 23 gjoba, 16 paralajmërime dhe 45 masa urgjente (ndalim tregtimi dhe shkatërrim produktesh). Në total janë kontrolluar 10379 produkte, nga të cilat 816 kanë rezultuar jo në konformitet.

Metrologjia

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, për vitin 2020 ka realizuar të ardhura në vlerë 54 352 000 lekë (pa TVSH) përkatësisht për 21 303 instrumente matës të verifikuar dhe kalibruar deri më 31 gusht.

Gjatë vitit 2020 puna për harmonizimin e legjislacionit vendës me *acquis* i Bashkimit Evropian ka vazhduar dhe është miratuar ligji nr. 126/2020, datë 15.10.2020, “Për metrologjinë”. Janë në proces draftimi:

- Projekt vendimi, “Për njësitë e matjes”, i cili është dërguar për konsultim me ministritë e linjës;

- Drafti i ndryshimi të udhëzimit nr. 1897/3, datë 3.8.2016, “Për kërkesat dhe procedurat e miratimit të sistemit për parapaketimet”, i cili është në proces reflektimi të komenteve nga konsultimi i brendshëm.

Gjatë 2020 është rritur numri i verifikimeve dhe kalibrimeve të instrumenteve matës. Evidentohet një përmirësim i ndjeshëm i shërbimit metrologjik konkretisht në fushën e verifikimit dhe kalibrimit, duke ulur në nivelin zero, ankesat nga konsumatori dhe bizneset.

Janë realizuar ndërkrahime laboratorike dhe është marrë pjesë në Komitetet Teknike, sipas fushave përkatëse. Është realizuar trajnimi i stafit teknik të institucionit, “Për matësit elektrike”.

Standardizimi

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 382, datë 27.6.2018, “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e standardizimit” ka transpozuar pjesërisht Rregulloren e BE-së nr. 1025/2012, “Për standardizimin evropian”.

Për një transpozim të plotë të rregullores së mësipërme të BE-së nr. 1025/2012, “Për standardizimin evropian”, DPS ka planifikuar ndryshimet në VKM 382, datë 27.6.2018, e cila



pritet të miratohet dhe të hyjë në fuqi në 3-mujorin e katërt të vitit 2021. Transpozimi i plotë i Rregullores së BE-së nr. 1025/2012, “Për standardizimin Evropian” dhe ndryshimet që do të bëhen në VKM 382, datë 27.6.2018, janë parashikuar edhe në PKIE 2021–2023.

Në fushën e standardizimit, janë miratuar gjithsej 1714 standarde dhe dokumente standardizimi si Standarde Shqiptare (SSH) dhe Dokumente Standardizimi Shqiptare, nga ku:

- 597 standarde të publikuara nga CEN;
- 370 standarde të publikuara nga CENELEC;
- 356 standarde të publikuara nga ETSI;
- 288 standarde të publikuara nga ISO;
- 103 standarde të publikuara nga IEC.

Janë miratuar 100% të standardeve të harmonizuara evropiane si standarde të harmonizuara shqiptare. Janë shfuqizuar 385 standarde dhe dokumente standardizimi siç janë shfuqizuar nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardeve. Struktura e arkivit të standardeve shqiptare, sipas origjinës së tyre, përbëhet nga: 79% e EN, 15% e standardeve ndërkombëtare (ISO/IEC), 6% standarde puro shqiptare.

Akreditimi

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) e kaloi me sukses vlerësimin e ndërsjellët të EA, i cili u krye në Shtator 2019. Vendimi për statusin nënshkrues për certifikimin e personave është marrë në Qershor të vitit 2020.

Në kuadrin e procesit të derregullimit, DPA implementoi një sistem elektronik të shërbimit të akreditimit i cili përfshin aplikimin *online*, ngarkimin e dokumentacionit të akreditimit, dërgimin e faturave, raporteve dhe korrespondencave nga të dyja palët, dhe dërgimin e certifikatës së akreditimit në OVK. Ky sistem gjithashtu parashikon: thjeshtimin e procedurave dhe kursimin e kohës për komunikim, regjistrimin në çdo kohë të ndonjë veprimi të ndërmarrë, shkurtimin e afateve të procedurës së akreditimit, dhe do të jetë një mënyrë e mirë për të kontrolluar procesin e akreditimit për të siguruar paanshmërinë.

Aktualisht janë akredituar në total 79 organe të vlerësimit të konformitetit (përfshirë OVK-të e pezulluara) nga DPA- ja. Shifrat e akreditimit deri në Tetor 2020 janë si më poshtë:

- 37 laboratorë testues;
- 4 laboratorë mjekësorë;

- 1 laborator kalibrues;
- 26 trupa inspektues;
- 6 trupa certifikues të personave;
- 5 trupa certifikues të sistemeve të menaxhimit.

Në fushën e produkteve mjekësore për përdorim njerëzor (barnat), në zbatim të ligjit nr. 105/2014 datë 31.7.2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar, gjatë periudhës së sipërcituar nuk rezulton të jenë miratuar akte të tjera nënligjore, përveç atyre të miratuara gjatë vitit 2019, të cilat janë raportuar me herët.

Në fushën e produkteve kozmetike, në zbatim të ligjit nr. 26/2017, datë 16.3.2017, “Për produktet kozmetike”, janë miratuar aktet nënligjore në zbatim të ligjit të sipërpërmendur, të cilat janë:

- Udhëzim nr. 609, datë 6.11.2020, “Për rregullat e hollësishme për informacionin që duhet të përmbajnë paketimet e produkteve kozmetike, të cilat nuk janë të parapaketuara, që paketojnë në pikën e shitjes, sipas kërkesës së blerësit ose parapaketohen për shitje të menjëhershme”;

- Urdhër nr. 610, datë 6.11.2020, “Për miratimin e rregullores mbi përdorimin e nanomaterialeve në produktet kozmetike”.

Direktivat e përfaqësues së vjetër

Në zbatim të ligjit 27/2016, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, është ngritur Zyra e Kimikateve, e cila do të ketë në përbërje të saj një strukturë 1 përgjegjës sektori dhe 3 specialist.

Spektori kimik dhe i sigurisë së përgjithshme në ISHMT është përgjegjës për zbatimin e vendimit për:

Detergjentet, mbi të cilat gjatë 2020 ISHMT ka zhvilluar 27 inspekte, ku janë kontrolluar 131 produkte që kanë rezultuar të gjitha në konformitet në lidhje me etiketimin;

Tekstilet, për të cilat janë zhvilluar 18 inspekte, ku janë kontrolluar 292 produkte, dhe 218 prej tyre kanë rezultuar jo në konformitet mbi kërkesat për etiketimet. Në përfundim janë marrë 7 masa administrative (gjobë);

Këpucët, për të cilat ka zhvilluar 33 inspekte, ku janë kontrolluar 350 produkte dhe 9 rezultuan jo në konformitet mbi kërkesat për etiketimet. Në fund u vendosën 3 masa administrative paralajmërim;

Lodrat, mbi të cilat ka kryer 55 inspekte dhe janë marrë 44 masa administrative (5 gjoba, 6 paralajmërim dhe 33 masa urgjente ndalim



tregtimi dhe shkatërrim produkti). Në total janë kontrolluar 207 produkte nga të cilat 79 kanë rezultuar jo në konformitet. Pjesa më e madhe e jokonformiteteve u zbulua nëpërmjet testimeve në laboratorë të akredituar. Është realizuar procedura e shkatërrimit të produkteve joushqimore (lodra) të cilat kanë rezultuar në jokonformitet me kërkesat minimale të sigurisë sipas legjislacionit në fuqi (në total 50 modele—rreth 13 000 njësi).

Sektori i Produkteve Elektrike në ISHMT, është përgjegjës për kontrollin e produkteve elektrike/elektronike mbi të cilat ka kryer 76 inspekte dhe ka marrë 18 masa administrative nga të cilat, 2 gjoba, 8 paralajmëime dhe 8 masa urgjente (ndalim tregtimi). Në total janë kontrolluar 6656 produkte, nga të cilat 121 kanë rezultuar jo në konformitet. Është marrë masa ndalim i përhershëm tregtimi për mbi 43 modele produktesh (rreth 2000 njësi në total).

Sektori i Produkteve Mekanike në ISHMT, është përgjegjës për zbatimin e vendimit për:

- Makineritë dhe ka zhvilluar inspekte në 8 subjekte të cilat kanë rezultuar në konformitet. Inspektimet e thelluara në këtë fushë kanë filluar në shtator 2020;

- Ashensorët, ku ka zhvilluar 27 inspekte në operatorët ekonomikë në lidhje me informimin e tyre;

- Sektori i Inspektimit Metrologjik në ISHMT, është përgjegjës për zbatimin e vendimit për:

- Parapaketimet mbi të cilat janë zhvilluar 186 inspekte dhe janë marrë 2 masa administrative (gjobë);

- Instrumentet e peshimit joautomatik, në shtator 2020 kanë filluar inspektimet e para të thelluara në importues dhe prodhues të këtyre instrumenteve;

Instrumentet matës, në shtator 2020 kanë filluar inspektimet e para të thelluara në importues të këtyre instrumenteve.

Direktivat përqasjes së re

Me urdhër të Kryeministrit është ngritur Komisioni Kombëtar për Armët e Vogla dhe të Lehta (AVL), i cili është organizëm ndërministror përgjegjës për planifikimin, koordinimin, monitorimin dhe raportimin e të gjitha aktiviteteve të lidhura me kontrollin e armëve në Republikën e Shqipërisë, me qëllim për të siguruar një mjedis të sigurisë dhe për të krijuar në këtë mënyrë kushte të favorshme për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Strategjia dhe Plan i Veprimit të AVL-ve miratuar me vendimi të Këshillit të Ministrave nr. 50, datë 6.2.2019, siguron dhe monitoron përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë sipas marrëveshjeve dhe dokumenteve të ndryshme ndërkombëtare në fushën e kontrollit të armëve (duke përfshirë Programin e Veprimit të OKB-së, Dokumentin e OSBE-së për AVL, Traktati i Tregtisë së Armëve, Protokollin e Kombeve të Bashkuara kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të AVL, Kodi i Sjelljes i BE etj., si dhe përputhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së.

Qëllimi kryesor i kësaj Strategjie gjashtëvjeçare është kontrolli i plotë mbi armët e vogla dhe të lehta, municionet dhe eksplozivët, duke u bazuar në kërkesat vendore dhe standardet e BE-së, OKB-së dhe OSBE-së.

Strategjia e AVL 2019–2024 dhe planin e veprimit 2019–2021, janë miratuar me vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 50, datë 6.2.2019.

Me urdhër të ministrit të Brendshëm nr. 399, datë 10.5.2019 është ngritur një grup pune që drejtohet nga zëvendësministria e Brendshme, e cila po përgatit ndryshime dhe shtesa të ligjit aktual për armët. Në këtë grup pune ka përfaqësues të strukturave të MB-së dhe të Policisë së Shtetit.

Gjatë vitit 2020 ka vazhduar përafrimi i legjislacionit me *acquis* të BE-së dhe është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 29.4.2020, “Për miratimin e rregullit teknik, “Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionit” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, i cili përafron pjesërisht direktivën 2014/35/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e datës 26 shkurt 2014 për harmonizimin e legjislacionit të shteteve anëtare në lidhje me pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda kufijve të tensionit.

Përqasja e re dhe globale

Ligji 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” është pjesërisht i përafruar me Direktivën 2014/60/BE dhe Rregulloren e Këshillit nr. 116/2009 për sa i përket lëvizjes së lirë të pasurive kulturore. Në zbatim të ligjit, është miratuar VKM nr. 432, datë 26.6.2019., “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore”, si dhe urdhri nr. 136, datë 21.10.2019 i



Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organizimit të Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore”.

Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore është përgjegjës për administrimin e Bazës së të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”, me qëllim identifikimin, regjistrimin, ruajtjen dhe lidhjen në kohë reale *online* të këtij shërbimi me institucionet shtetërore, subjektet private (fizike/juridike) që posedojnë dhe administrojnë Fonde të Pasurive Kulturore për regjistrimin dhe pajisjen me certifikatë për objektet pasuri kulturore në pronësi publike dhe private, shërbimin doganor të Republikës së Shqipërisë për monitorimin e lëvizjeve dhe të pronësisë së objekteve të pasurive kulturore në pronësi publike dhe private brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe me Policinë e Shtetit për shkëmbim informacioni në sistem lidhur me rastet e grabitjeve dhe vjedhjeve të objekteve të trashëgimisë kulturore në vend dhe denoncimet nga institucionet ndërkombëtare që operojnë brenda dhe jashtë vendit, sekuestrimin e objekteve pasuri kulturore. Nëpërmjet këtij sistemi përgjatë vitit 2020 janë regjistruar 100.000 objekte pasuri kulturore, në posedim të institucioneve publike dhe private.

Gjithashtu, nëpërmjet këtij sistemi përgjatë vitit 2020 është realizuar:

Shqyrtimi i procedurave të praktikës “Ikonat”, në kuadër të kërkesës së Ministrisë së Kulturës të Republikës së Maqedonisë së Veriut për disa ikona që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë;

Shqyrtimi i procedurave lidhur me kërkesën drejtuar Departamentit Amerikan të Shtetit për një memorandum mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe SHBA-së, “Mbi mënyrat e ndalimit dhe parandalimit të importit, eksportit të paligjshëm dhe transferimit të pronësisë të pasurisë kulturore dhe konventës mbi ligjin për aplikimin e pasurisë kulturore”;

Praktika me Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, lidhur me deklarimin humbur të objektit “Jelek”, pjesë e fondit në ruajtje;

Deklarimin të humbur të Objektit në Bazën e të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar Pasurive Kulturore (RKPK)”;

Përgatitjen e dosjes së praktikës për Interpol Tiranën për deklarimin dhe regjistrimin e Objektit në Bazën e të Dhënave të objekteve të humbura pranë Interpol;

Praktika të shqyrtuara me Prokurorinë dhe Policinë e Shtetit lidhur me vlerësimin e objekteve arkeologjike të sekuestruara nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës lidhur me objektet: “Objekt funeral me relief” dhe “Amforë”;

Vlerësimi në lidhje me vlerën historiko-kulturore të një objekti “kryq i vjetër metalik me zinxhir”, praktika me Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, lidhur me procedimin penal Nr. 2189, të vitit 2020.

Për vitin 2021 është planifikuar përfundimi i projektit nga IPA Kombëtare me titull “Ngritja e kapaciteteve të Administratës Publike Shqiptare në lëvizjen e lirë të mallrave dhe luftën kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore”, i cili nëpërmjet komponentëve të tij parashikon:

- Përafrim të akteve ligjore dhe nënligjore shqiptare me ato të Bashkimit Evropian në fushën e luftës kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore dhe rishikimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Paligjshëm të Pasurive Kulturore, duke përfshirë këtu aktet e lidhura me Kapitujt 1, 3 dhe 29.

- Trajnimi teknik i stafit të Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve të tjera të interesuara, përfshirë Doganat, Policinë, Interpolin dhe Prokurorinë”.

Në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së lidhur me lëndët plasëse për përdorim civil dhe artikujt piroteknikë, gjatë vitit 2020 është punuar dhe është hartuar projekt- ligji “Mbi hedhjen në treg të produkteve piroteknike” dhe projekt- ligji “Mbi hedhjen në treg të lëndëve plasëse për përdorim civil” në bazë të direktivave të BE-së, komenteve/sugjerimeve të dhëna nga institucione të tjera të përfshira në grup pune, ministritë e linjës si dhe nga konsultimi publik. Të dyja projektligjet priten për miratim nga Këshilli i Ministrave brenda vitit 2020. Më pas do të vijojë miratimi në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Në lidhje me zonën jo të harmonizuar, është përfunduar një metodologji për ekzaminimin e rregulloreve teknike kombëtare për pajtueshmërinë me nenet 34- 36 TFEU. Lidhur me këtë çështje, u mbajt një trajnim, me qëllim pajisjen e anëtarëve të



GNPIE-së për Kapitullin 1 me njohuri mbi parimet udhëzuese të zonës jo të harmonizuar, llojet e barrierave që përbëjnë kufizime për lëvizjen e lirë të mallrave për të cilat nuk ka legjislacion në nivelin e BE-së dhe shpjegimi i çështjeve kryesore të GJED-së që kanë vendosur parimet. Planin përkatës i veprimit aktualisht është duke u përgatitur.

Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Sektori i Produkteve Elektrike në ISHMT që ka të rekrutuar 6 nga 7 punonjës. Për zbatimin e këtij legjislacioni nuk janë zhvilluar inspektime të dedikuara, por subjektet janë informuar mbi të gjatë kontrolleve që ka zhvilluar Sektori i Produkteve Elektrike në ISHMT. Deri tani kontrollet kanë qenë vetëm mbi dokumentacionin dhe nuk është konstatuar asnjë produkt jo në konformitet por që janë udhëzuar subjektet në lidhje me afishimin e duhur të etiketave përkatëse.

1.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë;
- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Brendshme/Policia e Shtetit;
- Ministria e Kulturës;
- Instituti Kombëtar i Regjistrimit të

Trashëgimisë Kulturore.

1.7 Prioritetet

Parimet e përgjithshme

Në terma afatmesëm (2021–2022) mbetet prioritet hartimi i dokumentit udhërrëfyës për fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, i cili do të përfshijë aspekte të harmonizimit të legjislacionit për këtë fushë, si edhe aspektet institucionale për realizimin e plotë të kuadrit institucional dhe administrativ për zbatimin efektiv të kërkesave në këtë fushë.

Përpjekje të mëtejshme në drejtim të përafrimit me *acquis* janë planifikuar në planin kombëtar për vitet 2016–2020 për integrimin Evropian si dhe në strategjinë 2020 për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut, e cila përfshin infrastrukturë

cilësore. Megjithatë nuk ka strategji të veçantë për lëvizjen e lirë të mallrave.

Fusha e pa-harmonizuar

- Për periudhën afatmesme prioritet vijon të mbetet hartimi i Planit të Veprimit për shqyrtimin dhe heqjen nga legjislacioni vendës i masave me efekt të barasvlershëm me kufizimet sasiore për të arritur përputhshmëri me nenet 34–36 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE).

- Me gjithë përfundimin e metodologjisë për analizën krahasimore të legjislacionit shqiptar, duhet përgatitur një plan veprimi për vetëmonitorimin (*self-screening*) e rregullave teknike kombëtare për të arritur përputhshmëri me nenet 34–36 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU).

Fusha e harmonizuar: infrastruktura cilësore

Legjislacioni në fushën e akreditimit dhe mbikëqyrjes së tregut është pjesërisht i përafruar me *acquis* të BE-së;

Është i nevojshëm rekrutimi i një stafi më kompetent dhe të specializuar për Inspektoratin e Mbikëqyrjes së Tregut;

Ligji i vitit 2014 për akreditimin e organeve të vlerësimit të përputhshmërisë është pjesërisht i përafruar me *acquis*.

Fusha e harmonizuar: legjislacioni sektorial

Çështje të tjera

- Rritja e angazhimit dhe përfshirjes së shoqërisë civile në procesin e negociatave të anëtarësimit, përmes ngritjes së Tryezës për Kapitullin 1, në kuadër të Platformës së Partneriteti për Integrimin Evropian;

- Rritja e kapaciteteve të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian, lidhur me përfundimin e fazës *screening* dhe me tej me procesin e bisedimeve të anëtarësimit për Kapitullin 1;

- Për sa i përket legjislacionit të produkteve të “Përqasjes së vjetër”, mjetet motorike, do të konsiderohen për t’u transpozuar 3 rregulloret evropiane kuadër në fuqi për mjetet motorike, motomjetet dhe traktorët bujqësorë, nga viti 2023 e më tej.

- Përafrimi i legjislacionit mbi gjurmimin e artikujve piroteknike;

- Për sa i përket legjislacionit të produkteve të ‘Përqasjes së vjetër’, ligji për menaxhimin e kimikateve është pjesërisht i përafruar me dispozitat e rregullores për Regjistrimin,



Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (REACH) dhe pjesë të tjera të lidhura me *acquis*. Legjislacioni kombëtar për klasifikimin e kimikateve, etiketimin dhe paketimin është i përafuar me Sistemin e Harmonizuar Globalisht të Klasifikimit dhe Etiketit të Kimikateve, të Kombeve të Bashkuara;

- Legjislacioni për produktet e mbrojtjes dhe prokurimin dhe për kthimin e objekteve kulturore të larguara në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti anëtar, nuk është i përafuar me *acquis*.

Masat ligjore të planifikuara 2021–2023

- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullit teknik ‘Për pajisjet mbrojtëse personale’”, që synon përafrimin e pjesshëm me Rregulloren (BE) 2016/425 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 9 mars 2016 mbi pajisjet personale mbrojtëse. Planifikohet të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2021.

- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullit teknik, “Për enët e thjeshta nën presion” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, që synon përafrimin e pjesshëm me Direktivën 2014/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 shkurtit 2014 për harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me bërjen të disponueshme në treg të enëve të thjeshta nën presion (SPVD). Planifikohet të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2022.

- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullit teknik, “Për pajisjet e gazit dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, që synon përafrimin e pjesshëm me Rregulloren (BE) 2016/426 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 9 Mars 2016 mbi pajisjet e gazit. - Planifikohet të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2023.

KAPITULLI 2

LËVIZJA E LIRË E PUNËTORËVE

2.1 Përmbajtja e kapitullit

Legjislacioni i Bashkimit Evropian në fushën e lëvizjes së lirë të punëtorëve parashikon që qytetarët e një Shteti Anëtar kanë të drejtë të punojnë në një Shtet tjetër Anëtar, duke u mundësuar atyre të njëjtat kushte pune dhe sociale si punëtorët vendës. Lëvizja e lirë e personave bazohet në parimet e përgjithshme që rrjedhin nga

Traktati i Bashkimit Evropian dhe Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian, si dhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Këto parime përfshijnë heqjen e pengesave për lëvizjen e lirë të punëtorëve, qasjen e barabartë në tregun e punës dhe ndalimin e diskriminimit. *Acquis* në këtë kapitull parashikon që shtetasit e BE-së kanë të drejtë të lëvizin dhe të punojnë në vende të tjera anëtare të BE-së, të qëndrojnë aty për këtë qëllim së bashku me familjet e tyre dhe të trajtohen në të njëjtën mënyrë si punëtorët kombëtarë sa u përket kushteve të punës, si dhe çështjeve sociale dhe tatimore. Për më tepër, *acquis* përfshin instrumentet e BE-së për koordinimin e sistemeve të ndryshme kombëtare të sigurisë sociale.

2.2 Struktura e kapitullit

- Aksesit në tregun e punës;
- Bashkërendimi i sistemit të sigurimeve shoqërore

2.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Marrëveshja e Stabilizim-asociimit përmban detyrime të shumta, që burojnë nga dispozitat e neneve 48 dhe 49 të MSA-së, në fushën e qasjes në tregun e punës për shtetasit e BE-së në Republikën e Shqipërisë, lëvizjen e punëtorëve, kushtet e punësimit dhe trajnimit profesional. Aspekte të tjera të lëvizjes së lirë të punëtorëve kanë të bëjnë me promovimin e shkëmbimeve rinore dhe përfundimin e marrëveshjeve dypalëshe për punësimin dhe formimin profesional ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian. Marrëveshja e Stabilizim-asociimit parashikon që, në përputhje me kushtet dhe modalitetet e zbatueshme, Shqipëria dhe Shtetet Anëtare të BE-së të sigurojnë që shtetasit e vendit partner të cilët janë të punësuar ligjërisht në territorin e tyre nuk janë objekt diskriminimi, për sa u përket kombësisë, kushteve të punës, shpërblyerimit apo pushimit nga puna.

Detyrimi i Shqipërisë për koordinimin e skemave të mbrojtjes shoqërore buron nga nenet 48 e 99 të MSA-së. Nenet 46, 47, 49, 50, 51, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 70 SAA përcaktojnë shtyllat e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në fushën e aksesit në tregun e punës për qytetarët e BE-së.

Trajtimi i punëtorëve që janë shtetas shqiptarë dhe të cilët janë të punësuar ligjërisht në territorin e



një shteti anëtar rregullohet sipas neneve 46 dhe 47 të MSA-së.

2.4 Situata aktuale në Shqipëri

Në raportin e KE për vitin 2020 për kapitullin 2, “Për lirinë e lëvizjes për punëtorët”, Shqipëria ka arritur njëfarë niveli të përgatitjes. Progres është bërë përparim në këtë fushë, veçanërisht me lëvizjen e lirë të anëtarëve të familjes së qytetarëve të BE-së; në përfundimin e marrëveshjeve të reja bilaterale të sigurimeve shoqërore dhe në përgatitjen për t’u bashkuar me Rrjetit Evropian të Punësimit (EURES) pas aderimit.

Aksesi në tregun e punës

Qytetarët e BE-së kanë të drejtë të punojnë në Shqipëri pa leje pune. Kjo mundësohet nga dispozitat e Ligjit për të Huajt dhe ndryshimeve pasuese, të cilat parashikojnë se të huajve nuk iu nevojitet leje pune apo certifikatë regjistrimi biznesi, nëse janë shtetas të një Shteti Anëtar të BE-së ose vendi *Schengen* dhe me qëndrim të ligjshëm në Shqipëri. Përshtatshmëria e skemave të sigurimeve shoqërore dhe njohja e pensioneve profesionale rregullohen nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe. Politikat e pranimit të emigrantëve nuk vendosin pengesa ndaj vendbanimit të përhershëm të familjarëve të punëtorëve nga vendet e BE-së.

Legjislacioni i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me detyrimet e integritetit evropian në kuadër të kapitullit 2, synon të krijojë mundësi për qasje të barabartë dhe pa diskriminim në tregun e punës, formimit profesional, lëvizjes së punëtorëve të BE, si dhe kushteve të punësimit, njësoj si shtetasit shqiptarë.

Ligji nr. 108/2013, “Për të huajt”, i ndryshuar, si dhe ligji nr. 13/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 108/2013, “Për të huajt”, i ndryshuar”, në lidhje me punësimin e shtetasve të BE dhe anëtarëve të familjes së tyre me shtetësinë e një vendi anëtar ose jo, krijojnë mundësinë e punësimit në tregun e punës në vend, pa qenë të kufizuar nga kuotat vjetore të punësimit, detyrimi për t’u pajisur me leje pune apo certifikatë regjistrimi në punë.

Ligji nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit” i cili përcakton rregullat dhe mënyrën e funksionimit të sistemit publik të shërbimeve të punësimit, programet aktive dhe pasive të tregut të punës dhe organet përgjegjëse për menaxhimin e tyre. Sipas këtij ligji, shtetasit e BE-së që hyjnë dhe qëndrojnë në mënyrë të rregullt në territorin e Republikës së

Shqipërisë për qëllime punësimi, kanë të drejtë të përfitojnë nga shërbimet e ofruara në strukturën rajonale/lokale (neni 4). Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, e ngritur me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.4.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, siguron përmbushjen e këtyre të drejtave.

Ligji nr. 7961/1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, zbatohet edhe ndaj shtetasve të BE dhe anëtarëve të familjeve të tyre njësoj si për shtetasit shqiptarë për çështje që lidhen me punësimin e tyre dhe marrëdhëniet e punës, të cilat nuk mbulohen nga ligji 108/2013 për të huajt (neni 4). Sipas nenit 9 të këtij Kodi: “1. Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. 2. Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët...”

Lidhur me përgatitjen për t’u bashkuar EURES (Rrjeti Evropian i Shërbimeve të Punësimit), Shqipëria ka krijuar një databazë të integruar për sistemin e shërbimit të punësimit. Kjo do të lehtësojë shkëmbimin e informacionit ndërmjet departamenteve TI të gjendjeve civile, të sistemit tatimor, sistemit të kujdesit të detyrueshëm shëndetësor dhe sistemit të ndihmës ekonomike.

Qytetarët italianë, të cilët përbëjnë numrin më të madh të qytetarëve të BE-së në tregun shqiptar të punës, janë të punësuar kryesisht në fushën e mjekësisë, shërbimeve, marketingut, tregtisë, industrisë përpunuese, informacionit dhe telekomunikacionit. Qytetarët rumunë, të cilët janë grupi i dytë më i madh i qytetarëve të BE-së që hyjnë në Republikën e Shqipërisë, janë të punësuar



kryesisht në fushën e tregtisë dhe shërbimeve dhe *call centers*.

Bashkërendimi i sistemit të sigurimeve shoqërore

Koordinimi i skemave të sigurimeve shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të tjera, në pajtim me nenin 48 të Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit, MFE ka ndërmarrë angazhimin për të koordinuar skemat e sigurimeve shoqërore, për të siguruar lirinë e lëvizjes së shtetasve shqiptarë dhe gjithashtu të drejtën e punëtorëve për të mbrojtur dhe garantuar me elementet e sigurimeve shoqërore. Procesi i koordinimit të skemave të sigurimeve shoqërore me vendet e tjera është një nga angazhimet thelbësore për t'u bërë pjesë e familjes evropiane.

Marrëveshjet dypalëshe mbi sigurimet shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve përkatëse janë ratifikuar dhe kanë hyrë në fuqi me: Republikën Turke, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Dukatin e Madh të Luksemburgut, Hungarinë, Republikën Çeke, Republikën Federale të Gjermanisë, Mbretërinë e Belgjikës, Republikën e Austrisë dhe Bullgari.

Marrëveshja me Republikën e Kosovës, “Për vërtetimin e periudhave të sigurimit për realizimin e së drejtës për pension” është ratifikuar nga Parlamenti me ligjin nr. 20 datë 12.4.2018 dhe ka hyrë në fuqi më datë 1.12.2018.

Priten të hyjnë në fuqi marrëveshjet dypalëshe me:

- Rumaninë, e ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me ligjin nr. 42, datë 14.4.2016;
- Kanadanë e ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me ligjin nr. 58, datë 12.9.2019.

Marrëveshja me Konfederatën Zvicerane, është miratuar me VKM-në nr. 533, datë 31.7.2019, “Për miratimin në parim të Marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane, për Mbrojtjen Shoqërore”.

2.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Aksesit në tregun e punës

Me VKM-në nr. 659/2019 u miratuan në tetor 2019 “Strategjia për Punësimin dhe Aftësitë” dhe Plani i saj i veprimt. Vizioni i Strategjisë së Punësimit dhe Aftësive është: “Aftësi më të larta dhe punë më e mirë për të gjithë gratë dhe burrat”. Strategjia rishikoi treguesit deri në vitin 2022, duke u bazuar në të dhëna të konfirmuara nga bashkëpunimi i ngushtë me INSTAT-in. Për më

tepër, Plani i Veprimt 2019–2022 dhe treguesit për zbatimin e tij, detajojnë buxhetin e planifikuar për secilën masë, në bashkëpunim dhe me kontributin e donatorëve. Secila masë do të zbatohet nga mbështetja e parashikuar në SRC, si dhe nga projektet e donatorëve që janë duke u zbatuar, si dhe nga projektet e aprovuara që do të fillojnë të zbatohen.

Miratimi i ligjit 13/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, sipas të cilit edhe anëtarët e familjes së shtetasve të një prej vendeve të BE-së, të cilët nuk kanë shtetësinë e këtyre vendeve, gëzojnë të drejta të barabarta me shtetasit shqiptarë për t'u punësuar në tregun e punës në vend, pa u detyruar të pajisen me leje pune apo certifikatë regjistrimi në punë si dhe pa kufizime të kuotave për pranimin dhe punësimin e tyre.

Ndryshimet patën si qëllim të arrijnë përafrim më të plotë me nenet 23 dhe 24 të direktivës 2004/38/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 29 prillit 2004 mbi të drejtën e qytetarëve të Bashkimit dhe anëtarëve të familjes së tyre për të lëvizur dhe për të qëndruar lirshëm brenda territorit të Shteteve Anëtare duke ndryshuar rregulloren (KEE) nr. 1612/68/360/EEC, 75/34/EEC, 75/35/EEC, 90/364/EEC, 90/365/EEC, dhe 93/96/EEC.

Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”.

Ndryshimi i programeve të nxitjes së punësimit dhe shërbimeve të punësimit, është realizuar nëpërmjet miratimit të 4 (katër) vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe 7 (shtatë) programeve, përfshirë edhe programet për të nxitur punësimin e personave të dalë të papunë për shkak të COVID-19.

Bashkërendimi i sistemit të sigurimeve shoqërore

Lidhur m shtetet e mëposhtme, statusi i lidhjes së marrëveshjeve, paraqitet sa vijon:

- Bullgaria – u hapen negociatat në Sofje, më 5.11–8.11.2019, për hartimin e një marrëveshjeje të re që do të zëvendësonte marrëveshjen e vjetër me Bullgarinë, hyrë në fuqi me dekretin nr. 1578, datë 20.11.1952. Për shkak të pandemisë COVID-19 nuk janë zhvilluar raundet e tjera të negociatave.

- Kosova-është rënë dakord për finalizimin e një marrëveshjeje më të plotë për koordinimin e skemave të sigurimeve shoqërore midis dy vendeve tona në përputhje edhe me standardet e



legjislacionit evropian. Raundi i pare i negociatave për dakordësimin e kësaj marrëveshje u zhvillua në Tiranë më 17–18 shtator 2020. Pritet që në një të ardhme të afërt të mbahet raundi i dytë i bisedimeve në Prishtinë.

- Malin e Zi – është shprehur interesimi i palës Malazeze për hapjen e bisedimeve për dakordësimin e një marrëveshjeje dypalëshe.

Në përgjithësi kuadri ligjor nuk është ende plotësisht i harmonizuar me *acquis* të BE-së.

2.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH);
- Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK);
- Instituti i Statistikave (INSTAT);
- Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH);
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH);
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF);
- Ministria e Brendshme;
- Ministria e Brendshme/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.

2.7 Prioritetet

Fokusi kryesor i Institucioneve të Qeverisë Shqiptare është:

Të përafrojnë legjislacionin e BE-së për lëvizjen e lirë të punëtorëve dhe të zhvillojë një sistem IT që të krijojë mundësinë e lidhjes me EURES. Kjo do të thotë se qytetarët e BE-së do të kenë akses për punësim në Shqipëri dhe do të trajtohen në mënyrë të barabartë me shtetasit shqiptarë në aspektin e punësimit, kushtet e punësimit, shpërblimit, studimit dhe formimit profesional.

Të zbatojnë legjislacionin në fuqi në fushën e të huajve, punësimit, formimit e arsimit profesional si dhe i kushteve të punës dhe marrëdhënieve të punës, për shtetasit e BE-së në Republikën e Shqipërisë, si dhe të punojë në përafrimin e vazhdueshëm të tij me *acquis* komunitare në fushën e lëvizjes së lirë të punonjësve.

Në adresim të rekomandimeve të Komisionit Evropian, Qeveria shqiptare ka përqendruar përpjekjet e saj në koordinimin e skemave të sigurimeve shoqërore për qytetarët shqiptarë që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit, si dhe punëtorët

e Shteteve Anëtare të BE-së të punësuar në Shqipëri. Kjo përfshin nënshkrimin e marrëveshjeve të mbrojtjes sociale me shumë vende. Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe me Ministrinë për Evropën dhe Punëve të Jashtme po punon për të forcuar koordinimin e skemave të sigurimeve shoqërore me vendet ku ka një numër të konsiderueshëm të qytetarëve shqiptarë, veçanërisht në Itali dhe Greqi. Për koordinimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore ekzistojnë marrëveshje dypalëshe për sigurimet shoqërore me: Belgjikën, Republikën Çeke, Gjermaninë, Luksemburgun, Hungarinë, Austrinë, Rumaninë, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Kanadanë, Kosovën dhe Turqinë.

KAPITULLI 3

E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE

3.1 Përmbajtja e kapitullit

Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që e drejta e krijimit të personave kombëtarë dhe juridikë të BE-së në çdo shtet anëtar dhe liria për të ofruar shërbime ndërkufitare nuk pengohet nga legjislacioni kombëtar, në varësi të përjashtimeve të përcaktuara në Traktat. *Acquis* harmonizon gjithashtu rregullat në lidhje me profesionet e rregulluara për të siguruar njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve dhe diplomave midis Shteteve Anëtare; për disa profesione të rregulluara duhet të ndiqet kurrikula e zakonshme minimale e trajnimit në mënyrë që kualifikimi të njihet automatikisht në një shtet anëtar të BE-së. Sa u përket shërbimeve postare, *acquis*, gjithashtu, synon hapjen e sektorit të shërbimeve postare për konkurrencën në një mënyrë graduale dhe të kontrolluar, brenda një kornize rregullatore që siguron një shërbim universal.

3.2 Struktura e kapitullit

- E drejta e vendosjes;
- Liria për të ofruar shërbime ndërkufitare;
- Shërbimet postare;
- Njohja reciproke e kualifikimeve profesionale.

3.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Nenet e MSA-së që kanë rëndësi për këtë kapitull janë: 50, 57, 58, 70 dhe 100.



Neni 50 kërkon që Shqipëria të lehtësojë krijimin e veprimtarisë në territorin e saj nga kompanitë dhe shtetasit e Komunitetit (duke përfshirë filialet dhe degët), duke u dhënë atyre trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u akordohet kompanive të tij ose ndonjë kompanie të vendit të tretë, cilado që është më e mirë. Neni 57 kërkon që të dyja palët të ndërmarrin hapa të domosdoshëm për të lejuar në mënyrë progresive ofrimin e shërbimeve nga kompanitë përkatëse ose shtetasit të cilët janë themeluar në një palë të ndryshme nga ajo e personit për të cilin shërbimet janë të destinuara. Në hap me këtë proces liberalizimi, palëve u kërkohet të lejojnë lëvizjen e përkohshme të personave fizikë që ofrojnë shërbimin ose që janë të punësuar nga ofruesi i shërbimit si personel kyç. Neni 58 kërkon që Shqipëria të mos vendosë ndonjë masë apo veprimi të ri që i bëjnë kushtet më të rrepta për ofrimin e shërbimeve nga shtetasit e BE-së në krahasim me situatën ekzistuese përpara hyrjes në fuqi të MSA-së.

Sipas nenit 70 të MSA-së, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë legjislacionin e saj kombëtar me *acquis* të BE-së, si dhe të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet siç duhet.

Shtetet anëtare duhet të sigurojnë se e drejta e vendosjes e shtetasve dhe personave juridikë të BE-së në çdo Shtet Anëtar dhe liria për të ofruar shërbime ndërkufitare, siç parashikohet në nenin 49 dhe 56 të Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian (TFBE) nuk pengohet nga legjislacioni kombëtar, duke iu nënshtruar përjashtimeve të përcaktuara në Traktat. Pjesa thelbësore e *acquis* në këtë fushë është Direktiva 2006/123 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për shërbimet në tregun e brendshëm (Direktiva e Shërbimeve). Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në lidhje me nenet 49 dhe 56 është gjithashtu pjesë e *acquis*.

Acquis në këtë kapitull është e natyrës horizontale dhe mund të ndahet në tri fusha të përgjithshme:

i. e drejta e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve (nenet 49 dhe 56 të TFBE dhe Direktiva e Shërbimeve);

ii. njohja ndërsjellë e kualifikimeve profesionale (kryesisht Direktiva 2005/36/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi njohjen e kualifikimeve profesionale e ndryshuar kohët e fundit nga Direktiva 2013/55/KE);

iii. shërbimet postare (kryesisht direktiva 97/67/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e ndryshuar) të cilat përbëhen nga një kornizë rregullatore specifike sektoriale që siguron ofrimin e shërbimeve postare universale dhe krijimin e një tregu të brendshëm postar.

Në lidhje me të drejtën e vendosjes dhe lirinë për të ofruar shërbime, Direktiva e Shërbimeve përmban dispozita që synojnë të lehtësojnë ofrimin e shërbimeve për ofruesit e shërbimit, si dhe të ofrojnë shërbime të përkohshme ndërkufitare në një Shtet tjetër Anëtar. Direktiva është një instrument horizontal që mbulon një gamë të gjerë shërbimesh të ndryshme dhe që ka gjasa të ndikojë në një numër të konsiderueshëm të ligjeve dhe rregulloreve kombëtare. Zbatimi i saj kërkon që Shtetet Anëtare të ndërmarrin një kombinim të masave legjislative dhe jolegjislative (masa organizative ose praktike).

Për këtë arsye, dhe sa i përket legjislacionit zbatues, kërkohet një përzjerje e masave legjislative horizontale dhe specifike që ka të ngjarë të përfshijë ndryshimin e ligjeve ekzistuese, si dhe miratimin e legjislacionit të ri specifik dhe të një ligji kuadër horizontal. Dispozitat e Direktivës bazohen në masë të madhe në jurisprudencën relevante të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, të cilat mbeten plotësisht të zbatueshme. Direktiva kërkon caktimin e një Pike të Vetme Kontakti (PVK), ku ofruesit e shërbimeve mund të marrin informacion elektronikisht dhe të plotë mbi procedurat administrative që kërkojnë për akses dhe ushtrimin e aktiviteteve të shërbimit. Për më tepër, autoritetet e shteteve anëtare duhet të marrin pjesë në një sistem elektronik të shkëmbimit të informacionit midis autoriteteve administrative (Sistemi i brendshëm i informacionit të tregut ose IMI) që lejon bashkëpunimin në mbikëqyrjen e aktiviteteve të shërbimeve dhe shkëmbimin efektiv të informacionit midis shteteve anëtare.

Për sa i përket njohjes reciproke të kualifikimeve profesionale, Direktiva 2005/36, e ndryshuar, përcakton rregullat në lidhje me njohjen e kualifikimeve profesionale ndërmjet shteteve anëtare për të lehtësuar aksesin në profesione të rregulluara për shtetasit evropianë që dëshirojnë të ushtrojnë profesionin e tyre në një Shtet Anëtar të ndryshëm nga ai ku kanë përfutur kualifiket respektive. Direktiva lehtëson gjithashtu ofrimin e shërbimeve të përkohshme dhe të rastësishme nga



profesionistët (që mbulohen nga titulli II i direktivës). Për disa profesione të rregulluara, duhet të ndiqet një program i përbashkët trajnimi minimal, me qëllim që kualifikimi të njihet automatikisht në një Shtet Anëtar të BE-së (mbuluar nga kapitulli III, i titullit III, të direktivës). Në rastin e profesioneve të sektorit të shëndetësisë, kërkesat minimale të trajnimit janë të detyrueshme në çdo Shtet Anëtar si kushte për aksesin në profesion edhe në nivel kombëtar. Përveç direktivës së lartpërmendur, njohja e kualifikimeve profesionale për disa profesione rregullohet nga legjislacioni specifik. Brenda Kapitullit 3 ekzistojnë 5 direktiva të tilla.

Dy direktiva kanë të bëjnë me profesionet që merren me produkte toksike: direktiva 74/557/KEE dhe direktiva 74/556/KEE, sepse disa shtete anëtare kërkojnë kualifikime specifike për profesionet që merren me produkte toksike. Sidoqoftë, profesionistët që vijnë nga një shtet anëtar i BE-së që nuk kërkojnë kualifikime të tilla ende mund t'i kryejnë këto aktivitete nëse ata ofrojnë dëshmi për përvojën profesionale. Direktivat mbulojnë profesionistët që merren me substancat toksike në vijim: pesticide, substanca helmuese, produkte medicinale (fito- farmaceutike dhe produkte të destinuara për përdorim si ruajtës të ushqimit), herbicide, produkte të dëmshme për përdorim në industri, gazra toksike, produkte mjekësore kirurgjikale, baktericide, germicide dhe dezinfektantë) dhe produktet kozmetike dhe ngjyruesit që përmbajnë substanca helmuese.

Dy direktiva të tjera mbulojnë profesionin e avokatit, direktiva 77/249/KEE dhe direktiva 98/5/KE, e para trajton ofrimin e shërbimeve dhe e dyta të drejtën e vendosjes.

Direktiva e fundit rregullon profesionin e agjentëve tregtarë, ndërmjetësve të vetëpunësuar të autorizuar për të negociuar shitjen dhe blerjen e mallrave, në emër për llogari të një personi tjetër (direktiva 86/653/KEE). Direktiva harmonizon rregullat për: të drejtat dhe detyrimet e agjentëve tregtarë dhe porositësve të tyre; shpërblimin e agjentëve tregtarë; dhe lidhjen dhe përfundimin e kontratave të agjencisë, si dhe çdo dëmshpërblim ose kompensim për agjentët k në rast të përfundimit të kontratës.

Acquis për shërbimet postare synon hapjen e sektorit të shërbimeve postare ndaj konkurrencës në mënyrë graduale dhe të kontrolluar, brenda një

kuadri rregullator i cili garanton ofrimin e shërbimeve postare universale. Pjesa kryesore e legjislacionit përfshin tri direktivat postare në vijim: i. Direktiva e parë (kornizë) është ajo 97/67/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e ndryshuar nga ii. Direktiva e dytë postare 2002/39/KE e Parlamentit dhe Këshillit, dhe iii. Direktiva e tretë postare 2008/6/KE. *Acquis* parashikon krijimin e një tregu të brendshëm për shërbimet postare dhe promovon një shërbim postar të cilësisë së lartë për përdoruesit fundor. Për sa i përket kapacitetit administrativ, krijimi i një Autoriteti Kombëtar Rregullator (AKR) të pavarur në këtë fushë, është vendimtar për zbatimin e duhur të legjislacionit përkatës të BE-së.

3.4 Situata aktuale në Shqipëri

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur. Ky vlerësim është i njëjtë me atë të vitit 2019. Përparimi ka rënë një nivel më poshtë krahasuar me vlerësimin e vitit 2019. Pati përparim të kufizuar në përgatitjen për analizën *screening* në legjislacionin për lirinë e ofrimit të shërbimeve.

Rekomandimet e vitit 2020 mbeten të njëjta me ato të vitit 2019: Finalizimi i procesit *screening* të legjislacionit ekzistues në identifikimin e barrierave në lidhje me të drejtën e vendosjes dhe lirinë për të ofruar shërbime, me qëllim harmonizimin e legjislacionit e tij me direktivën e shërbimeve, dhe shtimi i përpjekjeve për të përafruar legjislacionin me *acquis* e Bashkimit Evropian dhe sigurimi i kapaciteteve të duhura institucionale në fushën e njohjes reciproke të kualifikimeve profesionale.

Në lidhje me të drejtën e vendosjes dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve, legjislacioni për minierat dhe politikat sociale është gjerësisht në përputhje me direktivën e shërbimeve. Sidoqoftë, legjislacioni për sektorin veterinar kërkon ende ndryshime për të lejuar licencimin e klinikave dhe spitaleve veterinare private. Legjislacioni që rregullon profesionin e avokatit është përafruar pjesërisht me *acquis* ndërsa ende ka kufizime veçanërisht për noterët dhe përmbauesit gjyqësorë privatë.

Shqyrtimi i legjislacionit sektorial të shërbimeve (*screening*) monitorohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), e cila ndjek një qasje sektoriale për zhvillimin e procesit. Paraprakisht janë identifikuar 34 sektorë të shërbimeve dhe rreth 99 nënsektorë/aktivitete shërbimi. Aktualisht, procesi është duke u përqendruar në sektorët e mbuluar nga MFE, Ministria e Bujqësisë dhe



Zhvillimit Rural (MBZHR) dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM).

Analizat e para të mangësive ligjore dhe institucionale e administrative për këtë kapitull përfunduan paraprakisht në muajt prill- maj 2020, dhe u rishikuan e përmirësuan në muajin shtator 2020 duke mundësuar kështu prioritizimin e masave të mëtejshme për përafrim me *acquis*.

Në lidhje me lirinë e ofrimit të shërbimeve ndërkufitare, Qendra Kombëtare e Biznesit funksionon si *one-stop-shop* për regjistrimin e bizneseve dhe lëshimin e licencave, autorizimeve dhe lejeve. Ajo operon përmes pikave të shërbimit në të gjithë vendin, si dhe nëpërmjet portalit *e-Albania*. Në periudhën raportuese, rreth një milion përdorues të regjistruar të *e-Albania* përfituan nga mbi 500,000 shërbime elektronike në muaj.

Në fushën e shërbimeve postare, legjislacioni është i përafruar plotësisht me Direktivën 97/67/KE, të ndryshuar, me përjashtim të rregullores për ofrimin e shërbimeve ndërkufitare për pakot. Tregu postar është hapur ndaj konkurrencës që nga viti 2017. Ekziston një ofrues i shërbimit universal në treg (Posta Shqiptare sh.a.) dhe 17 ofrues të tjerë të shërbimesh postare. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) është institucioni rregullator përgjegjës për zbatimin e legjislacionit në këtë fushë, ndërkohë po hartohet një Strategji e re për Sektorin Postar 2020- 2025.

Për sa u përket kualifikimeve profesionale, ligji nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” është ndryshuar me ligjin nr. 90/2014, datë 17.7.2014 dhe ligjin nr. 10357, datë 16.12.2010, duke shtuar në listën aktuale të dhjetë profesioneve të rregulluara dy profesione të tjera: punonjësin social dhe psikologun (përpos profesioneve të parashikuara më parë në ligj si mjeku i përgjithshëm, stomatologu/dentisti, farmacisti, infermieri, mamija, fizioterapisti, veterineri, arkitekti, inxhinieri dhe mësuesi). Aplikantët për ushtrimin e këtyre profesioneve i nënshtrohen provimeve shtetërore të organizuara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).

Gjithashtu, Shqipëria është pjesë e planit shumëvjeçar të veprimit në Zonën Ekonomike Rajonale (MAP REA). Një nga shtyllat e këtij plani është njohja e ndërsjellë e kualifikimeve profesionale mes 6 vendeve të Ballkanit

Perëndimor. Planit shumëvjeçar i veprimit në zonën ekonomike rajonale (MAP REA) është nënshkruar nga kryeministrat e gjashtë vendeve të rajonit në Trieste.

Për këtë qëllim u miratua urdhri i Kryeministrit nr. 99, datë 16.7.2018, “Për ngritjen e grupit negociator në negocimin e projekt marrëveshjes rajonale ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale për doktorët, dentistët, arkitektët dhe inxhinierët e ndërtimit”. Negociatat e zhvilluara deri në qershor 2019 u ndërprejnë për shkak të mungesës së dakordësisë së 2 prej vendeve lidhur me formatin e marrëveshjes. Aktualisht është parashikuar në planin e ri për Ballkanin Perëndimor 2021–‘23 (MAP REA 2.0) rihapja e negociatave nën një format të ri të propozuar nga RCC-CEFTA.

Implementimi i plotë e direktivës 36/2005/CE parashikon jo vetëm ndryshimin e ligjit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë, por dhe një vlerësim të legjislacionit që në mënyrë indirekte bien ndesh me direktivën dhe ligjin e sipërcituar. Për këtë, në kuadër të mbështetjes së GIZ përmes Projektit: Mbështetje për zhvillimin e negociatave të anëtarësimit në kapitujt ekonomik të *acquis* (SANECA), parashikohet shqyrtimi tërësor i legjislacionit, me qëllim identifikimin dhe planifikimin e masave për përafrim me *acquis* në fushën e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve.

Në kuadër të përafrimit të kualifikimeve profesionale në fushën e drejtësisë janë miratuar dy ligje gjatë vitit 2018: ligji nr. 110/2018, “Për noterinë” dhe ligj nr. 55/2018, “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”.

Gjithashtu, është krijuar sporteli unik (PSC) nr. 1620, datë 10.8.2020, “Për administrimin, funksionimin dhe përdorimin e platformës *e-Lej*”. Sporteli unik funksionon si pjesë e strukturës të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore. Sporteli unik mundëson komunikimin dhe çështjet e ndihmës reciproke për sigurimin e shërbimeve siç parashikohet nga legjislacionin për trashëgiminë kulturore dhe muzetë. Shërbimet e ofruara nga kjo njësi janë të lidhura me Platformën Kombëtare Digjitale *e-Albania*.

3.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime ndërkufitare



Sa i takon së drejtës të vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime ndërkufitare, gjatë vitit 2020 është bërë progres me finalizimin e analizës së rishikuar të mangësive ligjore, institucionale e administrative të nivelit të përafrimit me *acquis*, e mbështetur nga Projekti i GIZ “Mbështetje për negociatat e anëtarësimit në kapitujt ekonomikë të *acquis* (SANECA)”. Përmes analizës së mangësive ligjore, institucionale e administrative është përfutur një pasqyrë e plotë e nivelit të përafrimit me *acquis* në fushën e shërbimeve, është identifikuar kuadri ligjor e rregullator vendës që adreson *acquis*, si dhe kuadri institucional përkatës, rolet e përgjegjësitë për transpozimin e *acquis* dhe zbatimin e tij, si dhe masat aktuale e të planifikuara për përafrim të mëtejshëm.

Në lidhje me shqyrtimin e legjislacionit sektorial ekzistues (*screening*) përkundrejt Direktivës së Shërbimeve dhe Ligjit 66/2016 për shërbimet dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, të cilët përafrojnë pjesërisht Direktivën në fjalë, me mbështetjen e Projektit të GIZ: Mbështetje për negociatat e anëtarësimit në kapitujt ekonomikë të *acquis* (SANECA), MFE vendosi të ndjekë një qasje sektoriale, duke filluar së pari me sektorë brenda fushës së rregullimit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe në Ministrinë së Turizmit dhe Mjedisit. Paraprakisht, janë identifikuar gjithsej 34 sektorësh shërbimesh, përfshirë rreth 99 nënsektorë/aktivitete shërbimi për t’u shqyrtuar. Sa i përket shqyrtimit të projektakteve të ardhshme (vendimi i Këshillit të Ministrave 300/2016), janë njoftuar 6 akte ligjore për të konfirmuar pajtueshmërinë me ligjin e shërbimeve.

Në korrik 2020, MFE hartoi një plan operacional për të menaxhuar, zhvilluar dhe monitoruar këtë procesin *screening*, duke priorizuar sektorë të caktuar shërbimi sipas rëndësisë që ata zënë për ekonominë e vendit, por dhe duke marrë parasysh ndjeshmërinë e tyre nga perspektiva e BE-së. Për 10 sektorët e parë të shërbimeve prioritare, si profesionet ligjore, shërbimet në fushën e minierave, shërbimet private të përkujdesjes shoqëror, shërbimet në fushën e tatimeve, doganave, veterinarisë, pronësisë industriale, *e-Commerce* (tregtisë elektronike), turizmit dhe zejeve, *screening* planifikohet të përfundojë në dhjetor 2020. Ndërsa për 10 sektorë të tjerë prioritare, si mjedisi, profesionet financiare dhe shërbimet financiare,

lojërat e fatit, ndërmjetësit në tregun e punës, arsimi dhe formimi profesional, infrastruktura e cilësisë, tregtia e kafshëve, tregtia e ushqimeve dhe tregtia e fidanëve dhe e produkteve fitosanitare, *screening* planifikohet të përfundojë në mars të vitit 2021. Me përfundimin e këtyre sektorëve MFE synon të planifikojë zhvillimin e procesit *screening* për sektorë të tjerë shërbimesh.

Me qëllim përmirësimit akoma edhe me tej të procesit të depozitimit të pasqyrave financiare në regjistrin tregtar, është zbatuar projekti “Përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar” me ndihmën e Bankës Botërore. Me anë të këtij projekti është mundësuar:

- përcaktimi qartësisht i dokumenteve që duhet të hartohen nga subjektet, në varësi të klasifikimit të tyre, gjatë procesit të raportimit financiar;
- rritja e mëtejshme të transparencës për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të subjekteve të regjistruara në regjistrin tregtar;
- përpunimi dhe gjenerimi i raporteve për të dhënat e pasqyrave financiare.

Në fillim të vitit 2020, është mundësuar pjesëmarrja e regjistrin tregtar të administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), në Portalin e Regjistrave të Biznesit të Evropës Jug- Lindore - BIFIDEX, i cili është një platformë elektronike që synon t’i ofrojë publikut, të dhëna për subjektet tregtare që operojnë në tregun rajonal, nga burimet zyrtare të të dhënave të regjistruara në regjistrat tregtarë të shteteve anëtare.

Në lidhje me lirinë e ofrimit të shërbimeve ndërkufitare, tashmë QKB ofron një funksionalitet të ri në regjistrin tregtar, i cili bën të mundur aplikimin për Bashkimin Ndërkufitar, ndërmjet një ose më shumë shoqërive shqiptare dhe një ose më shumë shoqërive evropiane, rezultati i së cilës është regjistrimi i një shoqërie shqiptare.

Për vitin 2015, Qendra Kombëtare e Biznesit ka ofruar shërbimet e saj *online* nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania* pa kosto. Ndërkohë, duke filluar nga vitin 2020, shërbimet e regjistrimit të personave fizikë, pezullimit dhe aktivizimit të aktivitetit të subjekteve, si dhe pajisjes me licencë/leje ofrohen vetëm *online* nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*.

Brenda vitit 2020, është planifikuar që të gjitha shërbimet funksionale të QKB të ofrohen vetëm *online* nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*.

Për këtë qëllim u miratua vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1147, datë 9.12.2020, “Për krijimin e



bazës së të dhënave shtetërore” portali unik qeveritar *e-Albania* “dhe miratimin e Rregullores” Për Pikën e vetme të Kontaktit”, e përafuar pjesërisht me Rregulloren (BE) 2018/1724 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 2 Tetorit 2018 që krijon një portë të vetme digjitale për të siguruar aksesin në informacion, procedurat dhe ndihmën dhe shërbimet e zgjidhjes së problemeve dhe ndryshimin e Rregullores (BE) Nr. 1024/2012.

- Në periudhën raportuese, rreth një milion përdorues të regjistruar të *e-Albania* përfituan nga mbi 500,000 shërbime elektronike në muaj.

- Në lidhje me licencimin në fushën e restaurimit dhe të arkeologjisë, për vitin 2020 janë miratuar edhe dy VKM, si më poshtë:

- vendim i Këshillit të Ministrave nr. 792 datë 7.10.2020, “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënie, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale”;

- vendim i Këshillit të Ministrave nr. 793 datë 7.10.2020, “Për përcaktimin e kushteve të posaçme e të kriterëve të licencimit, dokumenteve shoqëruese dhe procedurave për shqyrtimin ose revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore”;

- vendimi nr. 1099, datë 24.12.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për mënyrat e trajtimit, normat teknike, kriteret dhe modelet e ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore”;

- vendimi nr. 1125, datë 30.12.2020 i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse, mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes e kolaudimit të tyre”.

Njohja reciproke e kualifikimeve profesionale

Përafrimi i plotë i direktivës 36/2005/KE, e ndryshuar, për sa ka të bëjë me profesionet e rregulluara në lidhje me kualifikimet e arsimit të lartë, përmes ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është parashikuar për miratim në vitin 2022.

Me qëllim përafrimin e plotë me *acquis* në fushën e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale, në qershor 2020 MFE së bashku me MASR, të mbështetur nga Projekti i GIZ: Mbështetje për negociatat e anëtarësimit në kapitujt

ekonomikë të *acquis* (SANECA), kanë rakorduar një plan operacional pune për menaxhimin, zhvillimin dhe monitorimin e hartimit të një Udhërrëfyesi për harmonizimin me *acquis* në fushën e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale. Në kuadër të këtij plani pune parashikohet hartimi dhe miratimi i një koncepti të udhërrëfyesit brenda vitit 2020, mandej vijimi i punës për hartimin dhe finalizimin e udhërrëfyesit brenda vitit 2022.

Aktualisht është duke u vlerësuar kuadri ligjor mbi urdhrat profesionalë për të mundësuar një rishikim të tyre me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale dhe eliminimin e parashikimeve të cilat bien ndesh me parashikimet e direktivës dhe kuadrit ligjor në fuqi për profesionet e rregulluara. Është përgatitur për këtë qëllim projekt- ligji kuadër për Urdhrat Profesionalë. Gjithashtu janë draftuar dhe 2 projektligje për Urdhrin Profesional të Arkitektit dhe Urdhrin Profesional të Inxhinierëve. Projektligjet janë përgatitur nga grupi i punës i ngritur nga MIE dhe në konsultim me shoqatat e profesionistëve të sektorëve respektivë, si dhe u mbështetën me ekspertizën e siguruar përmes Ambasadës Italiane në Tiranë. Projektligjet do të kalojnë procedurat e konsultimit publik dhe me ministrinë e linjës, përpara miratimit të tyre konform kuadrit ligjor në fuqi.

Shërbimet postare

Në nënfushën e shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë rregullohen me Ligjin Nr. 46/2015, datë 7.5.2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, plotësisht i përafuar me Direktivën 97/67/KE, të ndryshuar nga direktiva 2002/39/KE dhe direktiva 2008/6/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 20 shkurt 2008, i cili përcakton rregullat për ofrimin e shërbimeve postare në një treg të hapur, të një shërbimi universal postar dhe të financimit të shërbimeve universale.

Bazuar në këtë ligj janë miratuar 3 vendime të Këshillit të Ministrave, si dhe 8 rregullore.

Pas miratimit të Ligjit të ri, skema e re për licencimin e operatorëve është në përputhje me nenin 9 të Direktivës Postare dhe zona e rezervuar nuk është më në vend që nga 1 janari 2017.

3.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE);
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR);



- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR);
- Ministria e Drejtësisë (MD);
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës (MIE);
- Ministria e Kulturës (MK);
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS);
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM);
- Ministria e Brendshme (MB);
- Banka e Shqipërisë;
- Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB);
- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP);
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);
- Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA);
- Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK);
- Instituti i Statistikave (INSTAT);
- Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK);
- Agjencia Kombëtare Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI);
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF);
- Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI);
- Qendra e Edukimit Shkencor (CES);
- Agjencia Kombëtare e Formimit Profesional (AKFP).

3.7 Prioritetet

E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime ndërkufitare

- Finalizimi i shqyrtimit të legjislacionit ekzistues për të identifikuar pengesat për lirinë e vendosjes dhe lëvizjen e lirë të shërbimeve;
- Përgatitja e planit të veprimit të integruar për rishikimin/heqjen e barrierave me qëllim harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit vendës me Direktivën e Shërbimeve/ligjin për shërbimet (objekt i përfundimit të procesit të shqyrtimit më lart);
- Plotësimi i kornizës ligjore për Pikën e Vetme të Kontaktit siç parashikohet me ligjin për shërbimet/Direktivën e Shërbimeve dhe Rregulloren 2018/1724 *Gateway Digital Single*;
- Legjislacioni për sektorin e veterinarisë kërkon ndryshime ligjore për licencimin e klinikave dhe spitaleve private veterinare; (Licencimi i klinikave dhe spitaleve veterinare aktualisht është i rregulluar

nga ligji nr. 10081 datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, shtojca - fusha II;

- Në sektorin juridik me miratimin e ligjit për avokatinë, legjislacioni në këtë fushë është pjesërisht i përafuar me *acquis* të BE-së, por ekzistojnë kufizime, sidomos për noterët dhe përmbaruesit privatë.

Njohja reciproke e kualifikimeve profesionale

- Përafrimi i mëtejshëm i direktivës së kualifikimeve përmes ligjit për profesionet e rregulluara dhe akteve nënligjore në zbatim të përcaktimeve të *acquis*, si dhe kuadrit ligjor që lidhet me profesionet e rregulluara;

- Autoritetet shqiptare duhet të forcojnë kapacitetet institucionale për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale.

- Përgatitja e Udhërrëfyesit për përafrim të plotë me *acquis* në fushën e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale dhe *screening* i legjislacioni ekzistues me qëllim përafrimin e plotë me direktivën 36/2005/KE.

Shërbimet postare

- Përgatitja e një dokumenti të ri politikash për zhvillimin e sektorit postar për periudhën 2020–2025, për të përcaktuar objektivat për zhvillimin e sektorit në mënyrë që t’u përgjigjet ndryshimeve, për shkak të ndikimit të zhvillimeve teknologjike në sektor, për të garantuar universale postare shërbimi, si dhe përcaktimi i rolit të sektorit postar në promovimin e zhvillimit të tregtisë elektronike.

- Përafrimi i Rregullores (BE) 2018/644 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 18 Prill 2018 mbi shërbimet e dërgesave ndërkufitare të pakove postare, brenda 3-mujorit të dytë të vitit 2021.

Njohja reciproke e kualifikimeve profesionale

- Përafrimi i mëtejshëm i Direktivës së Kualifikimeve përmes ligjit për profesionet e rregulluara dhe akteve nënligjore në zbatim të përcaktimeve të *acquis*, si dhe kuadrit ligjor që lidhet me profesionet e rregulluara;

- Autoritetet shqiptare duhet të forcojnë kapacitetet institucionale për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale.

- Përgatitja e Udhërrëfyesit për përafrim të plotë me *acquis* në fushën e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale dhe *screening* i legjislacioni ekzistues me qëllim përafrimin e plotë me direktivën 36/2005/CE.



KAPITULLI 4 LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT

4.1 Përmbajtja e kapitullit

Për sa u përket lëvizjeve të kapitalit dhe pagesave, Shtetet Anëtare duhet të heqin, me disa përjashtime, të gjitha kufizimet për lëvizjen e kapitalit si brenda BE-së, ashtu edhe midis Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta. Dispozitat përkatëse të Traktatit që rregullojnë lirinë e lëvizjes së kapitalit janë të sanksionuara në nenet 63 deri 66 të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU). Përkufizimi i llojeve të ndryshme të lëvizjes së kapitalit mbështetet në Aneksin I të Direktivës 88/361/KEE. Praktika relevante e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe Komunikimeve të Komisionit 97/C220/06 dhe 2005/C293/02 japin interpretim shtesë të neneve të mësipërme.

Liberalizimi i pagesave është një kërkesë thelbësore për lëvizjen e lirë të kapitalit.

Më konkretisht, ashtu si dhe për komponentët e tjerë, është e nevojshme që të eliminohen të gjitha kufizimet në lëvizjet e pagesave midis Shteteve Anëtare, si dhe midis Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta me përjashtime në rrethana të caktuara. Garantimi i lëvizjes së lirë të pagesave kontribuon gjithashtu në rritjen ekonomike duke mundësuar promovimin e përdorimit të euros si brenda Bashkimit Evropian, ashtu dhe si një monedhë ndërkombëtare. Në këtë kuadër, *acquis* e Bashkimit Evropian synon pikërisht krijimin e zonën unike të pagesave në euro (*Single Euro Payment Area*), e cila vepron në të njëjtat rregulla në të gjithë tregun për sa i përket rregullimit të shërbimeve të pagesave dhe mbrojtjes së konsumatorit dhe njëkohësisht promovon pagesat elektronike dhe nxitjen e konkurrencës nëpërmjet prezantimit të aktorëve të rinj.

Më konkretisht, direktiva 2015/2366/BE për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm¹⁹, ka për qëllim lehtësimin e transaksioneve të pagesave brenda BE-së, duke krijuar një kornizë ligjore për Zonën Unike të Pagesave në Euro (*Single Euro Payment Area -sEPA*). Një direktivë tjetër e rëndësishme është edhe Direktiva e Parasë

Elektronike 2009/110/EC²⁰, e cila parashikon kornizën legjislative për marrjen e hapave të mëtejshëm për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të biznesit dhe të parasë elektronike, si dhe krijon një treg të vetëm në shërbimet e parasë elektronike, duke synuar nxitjen e përdorimit të këtyre shërbimeve nga publiku i gjerë pavarësisht faktit se nuk disponon një llogari bankare.

Akt tjetër i rëndësishëm, i cili mbështet funksionimin e SEPA-s është rregullorja EC (Nr. 924/2009) për pagesat ndërkufitare, e cila rregullon tarifat e vendosura nga një institucion për transaksionet e pagesave elektronike në euro dhe valuta të tjera të njoftuara të Shtetit Anëtar (p.sh. transfertat e kredive, debitime të drejtpërdrejta, pagesa me karta, tërheqje nga ATM-të).

Gjithashtu, edhe Rregullorja (BE) nr. 260/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 mars 2012, që përcakton kërkesat teknike dhe të biznesit për transfertat e kreditit dhe debitë direkte në euro dhe ndryshimin e Rregullores (KE) nr. 924/2009, është një akt i rëndësishëm për rregullimin e transfertave të kreditit dhe debitimeve direkte në euro brenda Zonën Unike të Pagesave në Euro (*Single Euro Payment Area-s EPA*).

Pjesa kryesore e legjislacionit në fushën kundër pastrimit të parave është direktiva (EU) 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 maj 2015 mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, e cila ndryshon Rregulloren (EU) 648/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe shfuqizon direktivën 2005/60/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe direktivën e Komisionit 2006/70/EC. Direktiva kërkon që subjektet që i nënshtrohen asaj të zbatojnë kujdesin e duhur ndaj klientit dhe të raportojnë transaksione të dyshimta, si dhe të marrin masa të rëndësishme mbështetëse, të tilla si ruajtja e të dhënave, trajnimi dhe vendosja e procedurave të brendshme. Për më tepër, Rregullorja (EC) 1889/2005, e cila rregullon paratë *cash* që hyjnë ose dalin nga BE, dhe Rregullorja (EC) 1781/2006 (që do të zëvendësohet nga Rregullorja (EU) 2015/847) parashikojnë që transferimet e fondeve duhet të shoqërohen me

¹⁹ Që duke ndryshuar direktivat 2002/65/EC, 2009/110/EC dhe 2013/36/BE dhe rregulloren (BE) nr. 1093/2010 dhe shfuqizimin e direktivës 2007/64/EC.

²⁰ Që ndryshon direktivat 2005/60/EC dhe 2006/48/EC dhe ndryshon direktivën 2000/46/EC.



informacione kuptimplota mbi paguesin për të siguruar gjurmueshmërinë e plotë të fondeve.

Për të luftuar me sukses krimin financiar, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që të ketë një kapacitet efektiv administrativ dhe zbatues, duke përfshirë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse, të zbatimit të ligjit dhe prokurorisë.

4.2 Struktura e kapitullit

Lëvizjet e kapitalit dhe pagesat

- Sistemet e pagesave

- Lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

4.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Detyrimi për të përfunduar legjislacionin shqiptar në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit, me atë të Bashkimit Evropian rrjedh nga nenet 60–62 dhe 70 të MSA-së. Pastrimi i parave është parashikuar në nenet 4 dhe 82 të MSA-së.

Neni 62 i Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit parasheh që gjatë tri viteve të para pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Palët do të marrin masa që lejojnë krijimin e kushteve të nevojshme për zbatimin e mëtejshëm gradual të rregullave të Komunitetit për lëvizjen e lirë të kapitalit dhe që deri në fund të vitit të tretë pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Stabilizim-asociimit përcakton modalitetet për zbatimin e plotë të rregullave të Komunitetit për lëvizjen e kapitalit.

4.4 Situata aktuale në Shqipëri

Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit. Ky konstatim haset edhe në Progres Raportin e fundit të vitit 2020. Sipas këtij raporti, gjatë periudhës raportuese, janë shënuar përparime, veçanërisht në fushën e sistemit të pagesave përmes miratimit të Ligjit 55/2020, “Për shërbimet e pagesave”, i cili transponon direktivën 2015/2366/BE për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm. Gjithashtu, gjatë periudhës së kufizimit të lëvizjes për shkak të Pandemisë së COVID-2019, Banka e Shqipërisë ndërmoi disa masa me qëllim promovimin e shërbimeve *homebanking*, duke eliminuar komisionet e aplikuara nga bankat te klientët e tyre dhe njëkohësisht, duke eliminuar kostot e bankave për pjesëmarrjen e tyre në sistemet e operuara nga Banka e Shqipërisë. Raporti evidenton një progres edhe në fushën e parandalimit të pastrimit të parave, kryesisht

nëpërmjet krijimit të grupit ndërinstitucional të punës për të përmbushur rekomandimet e ICRG-FATF.

Gjithsesi po ky raport evidenton se angazhimi i rrjedhur nga MSA-ja në lidhje me liberalizimin e shitblerjes së pasurive të paluajtshme për shtetasit e BE-së, nuk është përmbushur ende, ndërkohë që edhe ligji, “Për investimet” është ende i pamiratuar.

Lëvizjet e kapitalit dhe pagesat

Projektligji ‘Për investimet’ nuk është miratuar ende. Aktualisht projektligji është në proces koordinimi me institucione të tjera të lidhura me këtë çështje, pas përfundimit të të cilit pritet miratimi i tij.

Lidhur me zbatimin e detyrimit të MSA-së, çështja e liberalizimit të shitblerjes së pasurive të paluajtshme për shtetasit e BE-së, nuk ka shënuar progres. Pas krijimit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si një organ në varësi të Kryeministrit, është dakordësuar krijimi i një Grupi Ndërinstitucional Pune, i cili do të ngarkohet me hartimin e projektligjit të ri, ku do të përfshihen të gjitha institucionet relevante.

Sistemet e pagesave

Bankat e huaja kanë të drejtë të hapin degë dhe agjenci në Shqipëri, si dhe të ofrojnë pagesa ndërkufitare. Pagesat jo *cash* trajtohen sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë për sistemin dhe instrumentet e pagesave. Kuadri ligjor dhe rregullator për pagesa elektronike në Shqipëri është i njëjtë si për pagesat kombëtare, ashtu edhe ato ndërkufitare.

Vlen të theksohet se direktiva e parasë elektronike 2009/110/EC është transpozuar në legjislacionin shqiptar nëpërmjet ligjit nr. 10481, datë 17.11.2011, Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe kuadrit rregullator në zbatim. Aktualisht, në tregun shqiptar operojnë 3 institucione të parasë elektronike, si dhe dy nga 12 bankat ofrojnë produkte të parapaguara. Gjatë viteve të fundit është evidentuar një prirje në rritje e instrumenteve të parapaguara të emetuara nga këto institucione, si dhe një zgjerim i konsiderueshëm i terminaleve ku mund të përdoren këto instrumente si mjet pagese.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi në datë 30.4.2020 ligjin nr. 55/2020, “Për shërbimet e pagesave në Republikën e Shqipërisë”. Ligji është botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së



Shqipërisë nr. 123, datë 2.7.2020. Ligji hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratimi dhe zbatimi i këtij ligji konsiderohet si një hap i rëndësishëm i integritetit në *Single European Payment Area (SEPA)* dhe kërkesave të kapitullit 4 në aspektin e shërbimeve të pagesave. Gjithashtu, nga pikëpamja e zhvillimit të tregut vendës vlerësohet se ligji do të ndikojë drejtpërdrejt në nxitjen e konkurrencës dhe të inovacionit në fushën e pagesave me vlerë të vogël, duke promovuar kështu efikasitetin e tyre dhe reduktimin e kostove, që mbart përdorimi i tyre. Ligji në fjalë synon të balancojë hapësirat për ofrimin e shërbimeve të pagesave midis bankave dhe institucioneve të pagesave, duke i lejuar këto të fundit të hapin llogari pagese dhe të emetojnë instrumente elektronike pagesash. Për më shumë, ligji vlerësohet të rrisë transparencën në shërbimet e ofruara nga tregu dhe të krijojë një kuadër të konsoliduar për mbrojtjen e konsumatorit.

Lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Duke filluar nga muaji shkurt i vitit 2020, Shqipëria ka ndërmarrë një angazhim politik për të punuar me Grupin e Posaçëm të Veprimit Financiar (*Financial Action Task Force*, ndryshe “FATF”) dhe Moneyval, me qëllim forcimin e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Përmes vendimit nr. 1, datë 19.2.2020, “Për krijimin e grupit ndërinstitucional të punës për të përmbushur rekomandimet e ICRG- FATF” të Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave, u ngrit grupi ndërinstitucional i punës, i kryesuar nga zëvendëskryeministri dhe me pjesëmarrjen e institucioneve dhe ministrive kryesore, të tilla si: MFE, MEPJ, MM, MPB, MD, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria Speciale, SPAK, BSH, AMF, DPSH dhe SHISH.

DPPPP-ja, në këtë grup pune ka rolin e sekretariatit teknik, me detyrën e raportimit në bazë javore të ecurisë së zbatimit të plan-veprimit të ICRG-së dhe masat dhe veprimet që Shqipëria duhet të përmbushë në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Gjatë periudhës së raportimit, qershor-shtator 2020, me gjithë pandeminë, institucionet shqiptare kanë vazhduar punën në një nivel të kënaqshëm për të përmbushur afatet e përcaktuara në planin e veprimit të ofruar nga ICRG/FATF.

Në periudhën e raportimit, korrik–shtator 2020, numri i raportimeve të transaksioneve të dyshimta është 335, ndërsa numri i shpërndarjeve në LEA është 52. Regjimi i STR-ve është në të vërtetë i kënaqshëm dhe në përputhje me rreziqet e identifikuar nga autoritetet përkatëse. Të dhënat e hollësishme mbi RVV-të, inspektimet midis njësive raportuese, referimet në QLA-të etj., janë raportuar nën kapitullin 24. Trajnim i vazhdueshëm sigurohet edhe për stafin.

Stafi i DPPPP-së është rritur nga 39 në 45 punonjës. Procesi i rekrutimit është duke u zhvilluar.

Banka e Shqipërisë, në zbatim të Rekomandimeve të Raportit të Moneyval, mbi vlerësimin e Raundit V për Shqipërinë, bazuar në standardet e FATF miratoi disa ndryshime rregullatore përkatësisht:

- me vendimin nr. 46, datë 3.7.2019, në rregulloren nr. 14/2009, “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”;

- me vendimin nr. 47, datë 3.7.2019, në rregulloren nr. 1/2013, “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobankare”;

- me vendimin nr. 48, datë 3.7.2019, në rregulloren nr. 104/2016, “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”;

- me vendimin nr. 49, datë 3.7.2019, në rregulloren nr. 31/2007, “Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor”;

- me vendimin nr. 50, datë 3.7.2019, në rregulloren nr. 2/2013, “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobankare”.

Ndryshimet rregullatore në rregulloret e licencimit, parashikojnë kryesisht kërkesa shtesë të Bankës së Shqipërisë për subjektet aplikuese, gjatë procesit të licencimit, lidhur me integritetin e aksionarëve/ortakëve (duke përfshirë edhe aksionarët/ortakët indirektë dhe përfituesit e fundit), por duke e zgjeruar fokusin edhe te personat e lidhur me aksionarët/ortakët, nëse kanë rekorde kriminale, si dhe kërkesa për subjektet mbi procesin e rivlerësimit në vazhdimësi të integritetit të aksionarëve/ortakëve dhe raportimin e rezultateve të paktën një herë në vit në Bankën e



Shqipërisë. Ndryshimet në rregulloren, “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka” konsistojnë në parashikimin e kërkesave për funksionin/njësinë e kontrollit të brendshëm dhe për funksionin e përputhshmërisë, si njësi të pavarura dhe pjesë të rëndësishme të sistemit të kontrollit, si dhe të përgjegjësi dhe detyrave të këtyre funksioneve.

Gjithashtu, me qëllim përshtatjen me dispozitat e reja dhe të rishikuara të ligjit, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, si dhe në zbatim të rekomandimeve të ekspertëve të Moneyval, Banka e Shqipërisë me vendimet nr. 78, 79 dhe 80, të datës 18.12.2019, miratoi edhe disa ndryshime, përkatësisht në:

- rregulloren, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”;
- rregulloren, “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”;
- rregulloren, “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”.

Ndryshimet në rregulloren, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, konsistojnë në forcimin e mëtejshëm të kërkesave të autoritetit mbikëqyrës për subjektet, në drejtim të një administrimi më të mirë të rrezikut të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, në nivel individual dhe në nivel grupi. Njëkohësisht, pjesë e ndryshimeve rregullatore janë edhe disa kërkesa më të shtrënguara për integritetin e punonjësve të subjekteve, si dhe kërkesa për trajnimin e vazhdueshëm të personave përgjegjës dhe të strukturës përgjegjëse për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Në rrjedhë logjike me ndryshimet në rregulloren e parandalimit të pastrimit të parave për zbatimin e vigjencës së zgjeruar ndaj klientëve, për të cilën kërkohet prania fizike e klientëve dhe e përfaqësuesve të tyre, para se të vendoset çdo lloj marrëdhënie biznesi, u shfuqizua dispozita në rregulloren, “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”, mbi praninë fizike të klientëve dhe të përfaqësuesve të tyre për hapjen e llogarive *e-Banking*, pasi kjo kërkesë është e rregulluar tashmë në rregulloren e sipërcituar, për çdo marrëdhënie biznesi, përfshirë edhe hapjen e llogarive *e-Banking*. Ndërkohë, ndryshimet e rregullores, “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”, synojnë të forcojnë kërkesat për subjektet e grupeve bankare/financiare, të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar të Bankës së Shqipërisë,

në drejtim të hartimit të programeve në nivel grupi nga ana e institucionit mbizotërues, për një administrim më të mirë të rrezikut të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit.

Ndryshimet në rregulloret e sipërpërmendura hynë në fuqi në datë 8 janar 2020.

Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë ka shënuar progres edhe në drejtim të efektivitetit të procesit të mbikëqyrjes së institucioneve të licencuara dhe të mbikëqyrura prej saj në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke siguruar monitorim dhe kontroll të shtuar në këto subjekte si nëpërmjet ekzaminimeve në vend dhe mbikëqyrjes e analizës nga jashtë.

4.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Gjatë vitit 2020, në fushën e sistemeve të pagesave janë shënuar zhvillime të rëndësishme. Më konkretisht, miratimi i ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave” ka transpozuar në legjislacionin vendës direktivën 2015/2366/BE, “Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm”, dhe përafruar më tej direktivën e Parasë Elektronike 2009/110/EC, duke shënuar përafrim të mëtejshëm me *acquis* e këtij kapitulli.

Gjithashtu, hartimi dhe miratimi i ligjit, “Për shërbimet e pagesave” përbën edhe një nga masat e parashikuara në planin e veprimit të Strategjisë Kombëtare e Pagesave me Vlerë të Vogël 2018-2023.

Në lidhje me zbatimin e kësaj strategjie, e cila synon nxitjen e përfshirjes financiare dhe të përdorimit të pagesave elektronike, janë ndërmarrë edhe një sërë masash të tjera, ku mund të përmendim “Përfshirjen e institucioneve financiare jobanka në sistemin AECH” dhe promovimin e përdorimit të transfertave elektronike nëpërmjet rregullimit të komisioneve të aplikuara për to nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Vlen të theksohet se strategjia është pjesë Programit për Reformat Ekonomike (ERP) 2019–2021.

4.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Banka e Shqipërisë;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;



Ministria e Financave dhe Ekonomisë/Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPP);

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Instituti i Statistikave (INSTAT);
- Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme (MEPJ);
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

4.7 Prioritetet

Zbatimi i planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare e Pagesave me Vlerë të Vogël 2018–2023. Kjo strategji, synon nxitjen e përfshirjes financiare të popullsisë dhe promovimin e përdorimit të pagesave elektronike në ekonominë shqiptare.

Të zbatohen rekomandimet e raportit të Moneyval, si dhe të vijojë përafrimi me *acquis* e BE-së në drejtim të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

Të ndërmerren masa afat-shkurtra dhe afatmesme për të zbatuar planin e veprimit për të drejtën e blerjes së pasurive të paluajtshme nga të huaj, si një detyrim që rrjedh nga MSA-ja që prej vitit 2016.

KAPITULLI 5 PROKURIMI PUBLIK

5.1. Përmbajtja e kapitullit

Rregullat e BE-së sigurojnë që prokurimi publik i mallrave, shërbimeve dhe punëve në çdo Shtet Anëtar është transparent dhe i hapur për të gjitha shoqëritë tregtare të BE-së mbi bazën e parimit të mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë.

Këto parime zbatohen për të gjitha procedurat e prokurimit duke përfshirë edhe ato që janë jashtë fushëveprimit të direktivave të prokurimit të BE-së për shembull, duke pasur parasysh vlerën e tyre (prokurimi nën kufijtë e BE-së) ose objektin e prokurimit.

5.2 Struktura e kapitullit

Kapitulli 5 nuk është i ndarë në nënkapituj.

5.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit përfshihen në nenin 74 “Kontratat Publike”, i cili përcakton se Shqipëria dhe BE do të konsiderojnë hapjen e dhënies së kontratave publike në bazë të mosdiskriminimit dhe reciprocitetit, veçanërisht në

kontekstin e OBT-së, si një objektiv të dëshirueshëm.

Neni 70 i MSA-së, në anën tjetër, përcakton detyrimin e përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë për të përafuar legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së.

Acquis e prokurimit publik bazohet në parimet e përgjithshme siç janë transparenca, trajtimi i barabartë, konkurrenca e lirë dhe mosdiskriminimi që rrjedhin nga Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), pjesa e tretë, titulli IV dhe titulli VII, direktiva 2014/23/EU, Direktiva 2014/24/EU, direktiva 2014/25/EU, direktiva 2009/81/EC, direktiva 2007/66/EC dhe nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED).

5.4 Situata aktuale në Shqipëri

Sipas raportit vjetor për 2020 të Komisionit Evropian, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në prokurimin publik. Legjislacioni i prokurimit publik është rishikuar në vitet e fundit në mënyrë që të përafrohet më tej me parimet e përgjithshme të BE-së dhe *acquis* përkatëse për dhënien e kontratave publike.

Në këtë kuadër, ndryshimet më të fundit në legjislacion i referohen masave për përafrimin me Direktivën 2014/23/EU në vitin 2019 me anë të rishikimit të ligjit 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, veçanërisht duke hequr bonusin për propozimet e pakërkua dhe duke kufizuar përdorimin e propozimeve të pakërkua në sektorë të veçantë, si edhe forcuar kontrollin mbi implikimet financiare të kontratave të koncesionit/PPP.

Gjithashtu një zhvillim të rëndësishëm shënon edhe miratimi i ligjit nr. 6/2020, “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë” në prill 2020, i cili plotëson kuadrin ligjor për këtë fushë nëpërmjet përafrimit të pjesshëm të direktivës 2009/81/EC.

Sa u takon kapaciteteve administrative, disa përparime janë bërë, sidomos për forcimin e kapaciteteve të Agjencisë së Prokurimit Publik. Përpjekje të mëtjeshme nevojiten për të përmirësuar respektimin e procedurave dhe për të parandaluar korrupsionin në ciklin e prokurimit.

Në lidhje me koncesionet dhe PPP-të, janë bërë përparime në shtimin e detyrave të ATRAKO-s si sekretariat teknik për Komitetin e Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP.



Gjithashtu është rritur kontrolli i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi dhënien dhe monitorimin e kontratave të koncesionit/PPP.

Sipas Raportit të Komisionit Evropian 2020, Shqipëria duhet veçanërisht:

- të përafrojë më tej direktivat e vitit 2014 të BE-së për prokurimin publik, përfshirë në fushën e shërbimeve utilitare dhe shërbimeve, si edhe direktivën e BE-së për prokurimet në fushën e mbrojtjes;

- të garantojë kapacitetet e duhura administrative të autoriteteve kontraktore dhe të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

5.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

1. Arritjet kryesore për vitin 2020 në këtë kapitull janë si më poshtë:

2. Miratimi i ligjit 36/2020, “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”, duke përafuar kështu pjesërisht direktivën përkatëse 2009/81/EC.

- Miratimi i akteve nënligjore në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve të nxjerra në zbatim të ndryshimeve ligjore të vitit 2019:

- VKM nr. 280, datë 7.4.2020, “Për miratimin e rregulloreve për mënyrën e funksionimit të komitetit të përzgjedhjes së projekteve të koncesionit/PPP dhe kriteret për vlerësimin e kërkesave të autoriteteve kontraktuese për mbështetje me ekspertizë të specializuar”;

- VKM nr. 285, datë 10.4.2020, “Për organizimin, funksionimin si dhe procedurat e niveli i tarifave të shërbimeve që do të ofrohen nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)”;

- VKM nr. 420, datë 27.5.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 575, datë 10.7.2013, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat’, të ndryshuar”;

3. Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2020–2023 dhe planit të saj të veprimit me VKM-në nr. 850, datë 4.11.2020;

4. Miratimi i ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, që transpozoi pjesërisht direktivat 2014/24, 2014/25, si edhe direktivat 89/665 dhe 92/13 të ndryshuara nga direktiva 2007/66;

5. Miratimi i VKM-së për rregullat e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, në datën 24 dhjetor 2020.

5.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Agjencia e Prokurimit Publik;
- Komisioni i Prokurimit Publik;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Agjencia për Trajtimin e Koncesioneve (ATRAKO);
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Brendshme;
- Agjencia e Blerjeve të Përqendruara;
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

5.7 Prioritetet

Duke pasur në konsideratë sa më sipër, sidomos rekomandimet e raportit të vitit 2020 të Komisionit Evropian për Shqipërinë prioritetet kryesore për kapitullin 5 për periudhën 2021–2023 paraqiten si më poshtë:

- Plotësimi i kuadrit ligjor për Prokurimin Publik nëpërmjet akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri për prokurimin publik, konkretisht VKM-në për miratimin e rregullave të prokurimit publik, VKM-në për fjalorin e përbashkët të prokurimit (kodet CPV) dhe VKM-në për zhvillimin e procedurave të prokurimit për shërbimet sociale dhe shërbimet e tjera specifike.

- Përafrimi i mëtejshëm i ligjit për koncesionet me direktivën 2014/23/EU.

- Në lidhje me procesin e përafrimit të ligjit me direktivën 2014/23/EU është parashikuar të amendohet ligji në tremujorin e parë të vitit 2023. Këto ndryshime do të synojnë përafrimin e kuadrit ligjor me atë të *acquis*, me qëllim unifikimin e procedurave me vendet e tjera të Bashkimit Evropian si dhe rritjen e transparencës dhe mos diskriminimit gjatë procesit të vlerësimit dhe dhënies së koncesionit/PPP.

- Në lidhje me procesin e përafrimit të vendimit, “Për miratimin e rregullave për sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale”, me direktivën 2013/488/BE, DSIK ka planifikuar të hartojë draftin e ri dhe ta propozojë për miratim në Këshillin e Ministrave, brenda katërmujorit të parë të vitit 2021. Vendim i ri synon plotësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë procedurave me kontrata të klasifikuara dhe përafrimin me standardet e BE.

KAPITULLI 6 LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE

6.1 Përmbajtja e kapitullit

Legjislacioni për shoqëritë tregtare përfshin rregulla mbi formimin, regjistrimin, bashkimin dhe ndarjen e kompanive. Në fushën e raportimit financiar, *acquis* përcakton rregulla për paraqitjen e llogarive vjetore dhe të konsoliduara, përfshirë rregullat e thjeshtuara për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit është i detyrueshëm për disa subjekte të interesit publik. Për më tepër, *acquis* përcakton rregulla për miratimin, integritetin profesional dhe pavarësinë e auditimeve ligjore.

Ky kapitull përfshin rregulla të harmonizuara në fushën e së drejtës së shoqërive tregtare, duke përfshirë kërkesat për raportim financiar, që synojnë lehtësimin e ushtrimit të së drejtës së themelimit.

6.2 Struktura e kapitullit

Legjislacioni tregtar

Kontabiliteti dhe auditimi

6.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Në përputhje me detyrimet e parashikuara në nenet 70 (3), 49, 50 (1), 51 (1), 55 (1) dhe 56 të Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit, Shqipëria është e angazhuar të përafrojë legjislacionin e shoqërive tregtare me *acquis* të BE-së.

Neni 49 kërkon që legjislacioni shqiptar të ketë koncepte të përcaktuara qartë për shoqëritë tregtare, filialet, degët dhe ndërmarrjet.

Përveç kësaj, neni 50 parashikon lehtësimin e fillimit të aktiviteteve në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga shoqëritë dhe qytetarët e BE-së, duke garantuar trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai i akorduar shoqërive të saj ose shoqërive në një vend të tretë, si dhe bashkëpunëtorët dhe degët e tyre.

Neni 51 i MSA-së parashikon që çdo Palë mund të rregullojë vendosjen dhe funksionimin e shoqërive dhe shtetasve në territorin e saj, për sa kohë që këto rregullore nuk krijojnë diskriminim ndaj shoqërive dhe shtetasve të Palës tjetër në krahasim me shtetasit dhe shoqëritë e saj. Krijimi dhe zbatimi i një kuadri ligjor tregtar në përputhje me standardet e BE-së, krijimi i shoqërive tregtare, zvogëlimi i barrierave të hapjes së biznesit,

thjeshtësimi dhe standardizimi i praktikave të biznesit në përputhje me praktikat ndërkombëtare.

Ky kapitull përfshin rregulla të harmonizuara në fushën e së drejtës së shoqërive tregtare, duke përfshirë kërkesat për raportim financiar, që synojnë lehtësimin e ushtrimit të së drejtës së themelimit.

Në fushën e së drejtës së shoqërive tregtare, Direktiva për bashkërendimin e masave mbrojtëse që kërkohej nga shoqëritë tregtare për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të palëve të treta (2009/101/KE - Direktiva e mëparshme për Shoqëritë tregtare) përfshin masat mbrojtëse që parashikojnë kërkesat e detyrueshme dhënien e informacioneve shpjeguese, duke kufizuar arsyet për pavlefshmërinë e detyrimeve të lidhura nga shoqëritë tregtare, si dhe duke kufizuar arsyet për pavlefshmërinë e shoqërive publike dhe private me përgjegjësi të kufizuar. Direktiva (89/666/KEE) parashikon gjithashtu kërkesat për dhënien e informacioneve shpjeguese në lidhje me degët e hapura në një Shtet Anëtar të qeverisur nga ligji i një shteti tjetër. Direktiva 2012/30/BE (e ndryshuar nga Direktiva 77/91/KEE) përmban rregulla për formimin e shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar dhe mirëmbajtjen dhe ndryshimin e kapitalit të tyre. Direktiva 2009/102/KE kërkon nga shtetet anëtare të sigurojnë që ligji i tyre i brendshëm të njohë shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar me një dege.

Direktivat 2011/35/BE dhe Direktiva 82/891/KEE harmonizojnë rregullat kombëtare për mbrojtjen e aksionarëve dhe kreditorëve në kontekstin e bashkimit të brendshëm dhe ndarjeve të shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar. Direktiva 2009/109/KE paraqet kërkesa të thjeshtuara për raportim dhe dokumentim në rastin e bashkimeve dhe ndarjeve. Direktiva 2005/56/KE për bashkimet ndërkufitare parashikon rregullat dhe procedurat për të lehtësuar bashkimet ndërkufitare të shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuara. Direktiva 2004/25/KE për marrjet e ofertave të blerjeve (*take over bids*) përcakton rregullat e harmonizuara për të lehtësuar blerjet ndërkufitare brenda BE-së, si dhe përmirësimin e transparencës dhe mbrojtjen e aksionarëve të pakicave në kontekstin e marrjeve të tilla. Direktiva 2012/17/BE për ndërldhjen e regjistrave qendrorë, tregtarë dhe të shoqërive përcakton krijimin e sistemit të interkoneksionit të



regjistrave të biznesit, që përfshin një platformë qendrore evropiane përmes së cilës regjistrat kombëtarë të biznesit do t'i bëjnë të disponueshme informacionet e tyre në lidhje me mekanizmat e zbulimit ndërkufitar, duke përfshirë edhe portalin e-Drejtësisë.

Acquis e BE-së gjithashtu parashikon forma të caktuara evropiane ligjore: p.sh. Grupimi Evropian i Interesit Ekonomik (GEIE - rregullorja 2137/85) dhe Shoqëria Evropiane (*Societas Europaea* ose SE - rregullorja 2157/2001), duke lënë disa aspekte të strukturës së tyre të brendshme dhe të funksionimit të rregullohen përmes legjislacionit të brendshëm të shteteve anëtare.

Direktiva 2007/36/KE e të drejtave të aksionarëve paraqet standardet minimale për ushtrimin e të drejtave të caktuara të aksionarëve në shoqëritë e listuara. Rekomandimet e Komisionit (2004/913/KE, 2005/162/KE dhe 2009/385/KE, dhe 2009/384/KE) adresojnë parimet e një qeverisjeje korporatash për institucionet financiare në lidhje me shpërblimin e drejtorëve, pavarësinë e drejtorëve joekzekutivë dhe komisionet e bordit. Rekomandimi i Komisionit 2014/208/BE mbi cilësinë e raportimit të qeverisjes së korporatave jep udhëzime se si shoqëritë e listuara duhet të shpjegojnë ndryshimet nga rekomandimet e kodeve përkatëse të qeverisjes së korporatave.

Direktiva 2004/109/KE kërkon harmonizimin e kërkesave të transparencës në lidhje me shoqëritë e listuara.

Në fushën e kontabilitetit, *acquis* përfshin njohjen, vlerësimin dhe shpalosjen e rregullave dhe skemave për bilancin dhe llogarinë e fitimit dhe humbjes për pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara (direktiva 2013/34/BE) të shoqërive publike dhe private me përgjegjësi të kufizuar. Kjo direktivë gjithashtu përcakton se kush ka nevojë për një auditim, si dhe detyrimet e publikimit. Përveç kësaj, Rregullorja (KE) nr. 1606/2002 mbi aplikimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, kërkon që shoqëritë tregtare të BE-së të listuara në një treg të rregulluar të hartojnë pasqyrat financiare të tyre të konsoliduara në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të cilat janë miratuar nga Bashkimi Evropian. Sipas kësaj rregulloreje, Shtetet Anëtare gjithashtu mund të vendosin të zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Faqe| 4044

pasqyrat financiare individuale dhe/ose të konsoliduara të shoqërive tregtare.

Direktiva 2006/43/KE për auditimet e ligjshme harmonizon rregullat duke përfshirë, ndër të tjera, miratimin dhe regjistrimin e audituesve ligjorë, sigurimin e jashtëm të cilësisë, mbikëqyrjen publike, pavarësinë e audituesit dhe zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Amendimi i direktivës 2014/56/BE përcakton kërkesat shtesë për të përmirësuar cilësinë e auditimit, me fokus në pavarësinë e audituesit, raportet e auditimit dhe mbikëqyrjen e auditimit publik. Rregullorja e re 537/2014/BE paraqet kërkesa specifike lidhur me auditimin ligjor të njësive të Interesit Publik (NJIP). NJIP-të janë institucione të kreditit, shoqëri të listuara, ndërmarrje të sigurimeve, dhe subjektet të tjera të përcaktuara si të tilla nga Shtetet Anëtare. Rregullorja gjithashtu parashtron kërkesa specifike për organizimin e sistemit të mbikëqyrjes publike të audituesve ligjorë dhe kontrollon firmat e auditimit të cilat auditojnë PIE-të.

6.4 Situata aktuale në Shqipëri

Sipas Raportit të Komisionit Evropian 2020 për kapitullin 6 konstatohet se Shqipëria është mesatarisht e përgatitur për anëtarësim. Ky vlerësim është i njëjtë me atë të vitit 2019. Niveli i përparimit të arritur është i njëjtë me atë të vitit 2019. Ka pasur njëfarë përparimi në zbatimin e ligjit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Rekomandimet e vitit 2019 u plotësuan vetëm pjesërisht. Komisioni rekomandon përsëri sigurimin e transparencës së plotë të deklaratave financiare të ndërmarrjeve në regjistrin e biznesit.

Përveç kësaj, duhet të rishikohet legjislacioni ekzistues në fushën e së drejtës së ndërmarrjeve duke synuar identifikimin e ndryshimeve ligjore të nevojshme për përafrimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Referuar rekomandimeve të adresuara nga Komisioni Evropian, në fushën e së drejtës së shoqërive tregtare, legjislacioni shqiptar është përgjithësisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Ligji nr. 9901 datë 14.4.2008, "Për sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare" rregullon formimin, organizimin dhe zhvillimin e organizatave të biznesit në Shqipëri. Ligji përputhet kryesisht me legjislacionin përkatës të BE-së, me amendamentet e bëra me kalimin e kohës. Progres i mëtejshëm është bërë me miratimin e ligjit nr. 110/2012, "Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive tregtare" që përafrojnë



legjislacionin shqiptar me kërkesat e direktivës 2005/56/KE të BE-së, datë 26 tetor 2005, “Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar” e ndryshuar.

Ligji nr. 110/2012, “Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare” ka përafruar direktivën 2005/56/KE, “Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar”, të amenduar. Ligji rregullon procedurat, autoritetet përgjegjëse të përfshira në rastet e shkrirjes së jashtme dhe të brendshme ndërmjet një shoqërie shqiptare dhe një shoqërie të themeluar në një shtet anëtar të BE-së, duke lehtësuar bashkimin pa kaluar në likuidim. Për të mundësuar zbatimin e ligjit në praktikë, janë hartuar:

- komentari i ligjit dhe ToT për noterët, meqenëse janë caktuar nga ligji me detyrën e shqyrtimit të ligjshmërisë lidhur me bashkimet; si dhe

- 15 forma të regjistrimit ndërkufitar të cilat janë në dispozicion të institucionit të QKB-së.

Ka përfunduar infrastruktura teknike për aplikimin e nënshkrimit elektronik (*e-Signature*). Janë akredituar dy ofrues të Shërbimit të Certifikimit (CSHC):

- një ofrues publik: Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI), dhe
- një ofrues CSHC privat “Aleat Ltd”.

Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) vepron si një qendër me një ndalesë për regjistrimin dhe licencimin/lejimin e biznesit. QKB administron regjistrin tregtar (i njohur si një bazë të dhënash shtetërore), i cili është një bazë të dhënash unike, e ndarë në dosje të veçanta elektronike për secilin subjekt që ka detyrimin e regjistrimit dhe ai mbahet në format elektronik, dhe Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimet dhe Lejeve (i njohur si një bazë të dhënash shtetërore), i cili është një bazë të dhënash unike për të gjitha licencat/lejet e lëshuara në Shqipëri.

Prej vitit 2015, Qendra Kombëtare e Biznesit ka ofruar shërbimet e saj *online* nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania* pa kosto. Ndërkohë, duke filluar nga vitit 2020, shërbimet e regjistrimit të personave fizikë, pezullimit dhe aktivizimit të aktivitetit të subjekteve, si dhe pajisjes me licencë/leje ofrohen vetëm *online* nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*.

AKSHI, në cilësinë e institucionit përgjegjës për administrimin e portalit qeveritar *e-Albania*, është angazhuar që brenda vitit 2020, të gjitha shërbimet

funksionale të QKB-së të ofrohen vetëm nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*.

ligji nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, është amenduar në shkurt të viti 2015 me ligjin nr. 8/2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007”, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, duke u përshtatur më tej me direktivën 2009/101/KE me qëllim dorëzimin në formë elektronike të balanceve vjetore dhe raporteve të auditimit nga shoqëritë tregtare.

Me qëllim përmirësimit akoma edhe me tej të procesit të depozitimit të pasqyrave financiare në regjistrin tregtar, është implementuar projekti “Përmirësimi i cilësisë së Raportimit Financiar” me ndihmën e Bankës Botërore. Me anë të këtij projekti është mundësuar:

- Përcaktimi qartësisht i dokumenteve që duhet të hartohen nga subjektet, në varësi të klasifikimit të tyre, gjatë procesit të raportimit financiar;

- Rritja e mëtejshme e transparencës për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të subjekteve të regjistruara në regjistrin tregtar;

Përpunimi dhe gjenerimi i raporteve për të dhënat e pasqyrave financiare.

Në fillim të vitit 2020, është mundësuar pjesëmarrja e regjistrin tregtar të administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në Portalin e Regjistrave të Biznesit të Evropës Juglindore - BIFIDEX, i cili është një platformë elektronike që synon t'i ofrojë publikut, të dhëna për subjektet tregtare që operojnë në tregun rajonal, nga burimet zyrtare të të dhënave të regjistruara në regjistrat tregtarë të shteteve anëtare.

Për sa u përket ofertave të marrjes në detyrë, Shqipëria ka transpozuar plotësisht direktivën 2004/25/KE, “Për ofertat e marrjes në detyrë” sipas Ligjit Nr. 10236 datë 18.2.2010, “Për marrjen nën kontroll të shoqërive me ofertë publike”.

Në fushën e kontabilitetit të korporatave, prej vitit 2008 janë shpallur të detyrueshme për zbatim Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (përfshirë përditësimet e vazhdueshme të tyre) dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit janë miratuar nga viti 2008 dhe ndryshimet e tyre janë miratuar që nga korriku 2014 me hyrje në fuqi më 1 janar 2015. Kërkesat e standardeve kombëtare të përmirësuar janë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të



Raportimit Financiar (SNRF) për Ndërmarrjet e Mesme dhe të Vogla (SME-të), ndërsa paraqitja e pasqyrave financiare është plotësisht e përafruar me kërkesat e Direktivës së BE-së 2013/34 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e amenduar (Direktiva e Kontabilitetit).

Në lidhje me këtë nënfushë, është arritur progres në drejtim të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* e BE-së në fushën e kontabilitetit të korporatave përmes miratimit të ligji të kontabilitetit Nr. 25 datë 10.5.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i cili synonte përafrimin e mëtejshëm me *acquis* në fushën e kontabilitetit të shoqërive tregtare, konkretisht me Direktivën Nr. 2013/34/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian të datës 26 qershor 2013, ku progres vihet re dhe në zbatimin e këtij ligji, si një nga rekomandimet e lëna nga Komisioni Evropian gjatë vitit 2019.

Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të harmonizuar legjislacionin me *acquis* për pasqyrat financiare vjetore dhe të konsoliduara.

Kapaciteti i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, i cili përkthen pa ndryshime nga origjinali SNRF-të, harton dhe mirëmban standardet e kontabilitetit si dhe monitoron zbatimin e të dyja seteve të raportimit financiar duhet të përfordhet dhe më shumë. Gjithsesi, theksojmë se në ndryshimet ligjore të reja, në ligjin e ri të kontabilitetit, është parashikuar detyrë specifike për Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, në nenin 24, pika “f” e cila përcakton “të monitorojë zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar”, e cila nuk ka qenë e përfshirë në ligjin e mëparshëm.

Ndërkohë, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit po rishikon shënimet shpjeguese për njësitë e vogla të përcaktuara në SKK, në mënyrë që t’i pakësojë ato në masën e parashikuar në direktivën 34/2013, art. 16 “Përmbajtja e shënimeve shpjeguese në pasqyrat financiare në lidhje me të gjitha ndërmarrjet” dhe pikat (a), (m), (p), (q) dhe (r) të artit. 17 (1) “Shënimet shpjeguese për njësitë e mesme dhe të mëdha dhe njësitë me interes publik”.

Në lidhje me fushën e auditimit, ligji nr. 10091 datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar synoi krijimin e bordit të mbikëqyrjes publike si një strukturë e përhershme

nga burimet e veta financiare. Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP), i themeluar si autoritet i pavarur rregullator me burimet e tij financiare shërben për të realizuar mbikëqyrjen publike dhe për të siguruar që audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit të jenë subjekt i një sistemi që jep siguri për cilësinë e auditimeve të kryera.

Gjatë vitit 2019, në mbështetje të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 të auditimit ligjor, është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 17, datë 16.1.2019, “Për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre”.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike, dy vitet e fundit 2018–2020, është fokusuar në krijimin e kuadrit të nevojshëm rregullator, si kërkesë e parashikimeve ligjore, duke hartuar e miratuar një sërë rregulloresh që lidhen me funksionimin e strukturës së tij mbështetëse, mbledhjen e të ardhurave, investigimin dhe disiplinën.

Kështu, Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka emëruar Komisionin e Investigimit dhe Disiplinës, i cili prej korrikut të vitit 2019 ka propozuar marrjen e masave disiplinore për auditues ligjorë/shoqëri auditimi si dhe në shqyrtim të kontabilistëve të miratuar në proces.

Në kuadër të zbatimit të aktiviteteve kryesore të tij, BMP-ja do të luajë rol aktiv për bashkëpunimin me institucione të tjera të tilla si, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe institucione të tjera rregullatore me qëllim realizimin e vizionit mbikëqyrës, si dhe është parashikuar që të zhvillohet më tej bashkëpunimi ndërmjet BMP-së dhe rregullatorëve financiarë (Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare) me fokus në çështjet e auditimit.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike është gjithashtu në proces të përmbushjes së gjithë kërkesave të parashtruara në rekomandimet e Moneyval dhe të planit të veprimit të ICRG/FATF. Në këtë kuadër, të tilla kërkesa janë përfshirë dhe në procesin e kontrollit të cilësisë së audituesve ligjorë dhe kontabilistëve të miratuar.

Vlen të përmendet që funksioni i auditimit të brendshëm është i mirërrregulluar në sektorin publik dhe funksionon në bazë të ligjit përkatës dhe kuadrit të tij rregullativ. Po ashtu, funksioni i



auditimit ligjor dhe rëndësia e tij për shoqëritë tregtare, kanë pasur fokus gjatë planit të mëparshëm dhe janë rregulluar në një ligj të veçantë me struktura dhe kuadër të mirëpërcaktuar.

Ligji i auditimit të brendshëm mbështetet në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm rregulluar me ligji nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

6.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Shoqëritë tregtare

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit (Moneyval), është ngritur grupi i punës, me urdhër të ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 286 datë 25.10.2018.

Gjatë vitit 2020 është miratuar ligji nr. 112/2020, “Për regjistrin e Pronareve Përfitues” ndër të tjera parashikon krijimin e Regjistrit të Pronareve Përfitues, i cili do të administrohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Më 14.5.2020 u miratua ligji 62/2020, “Për tregjet e kapitalit”, i cili hyri në fuqi më 1.9.2020. Ligji, “Për tregjet e kapitalit” është përafuar pjesërisht me direktivën e Tregjeve në Instrumentet Financiare (MIFID II), si dhe me direktivën 2004/109/KE mbi harmonizimin e kërkesave të transparencës në lidhje me informacionin, në lidhje me emetuesit, letrat me vlerë të cilëve pranohen të tregtohen në një treg të rregulluar.

Kontabiliteti

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit dhe Bankën Botërore ka miratuar ligjin nr. 25/2018, “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të cili synon përafrimin e mëtejshëm me direktivën nr. 2013/34/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian e datës 26 qershor 2013.

Gjatë vitit 2019, në mbështetje të ligjit të ri të kontabilitetit nr. 25/2018 është miratuar:

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, “Për miratimin e rregullores së brendshme së organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”;

- Gjithashtu, në qershor të vitit 2020, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit botoi “Udhëzuesin për hartimin e raportit jofinanciar”.

Auditimi

Gjatë vitit 2019, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, si anëtar i organizatës ndërkombëtare IFIAR, është bërë pjesë e task-forcës së këtij institucioni (ITRAM), në kuadër të monitorimit të tregut të audituesve ligjorë, të cilët veprojnë në të gjitha vendet anëtare të IFIAR-it. Gjithashtu, një nga arritjet kryesore të BMP-së, është hartimi dhe miratimi i rregullores Nr. 9 datë 27.2.2019, “Për rregullimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të profesionit të Kontabilistit të Miratuar dhe organizatave të tyre profesionale”, të ndryshuar, në bazë të cilit ka filluar dhe po zhvillohet procesi i verifikimit të kontabilistëve të miratuar dhe organizatave profesionale, të cilat veprojnë në vendin tonë.

Komisioni *Ad Hoc* u ngrit në funksion të zbatimit të rregullores nr. 9, datë 27.2.2019, “Për rregullimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të profesionit të Kontabilistit të Miratuar dhe organizatave të tyre profesionale”, i ndryshuar.

BMP-ja do të vijojë realizimin e veprimtarisë së vet, me fokus të veçantë kontrollin e cilësisë ndaj auditimeve të njëjësive ekonomike me interes publik, si dhe marrjen e masave disiplinore në rastet përkatëse.

6.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Qendra Kombëtare e Biznesit;
- Bordi i Mbikëqyrjes Publike;
- Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit;
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
- Banka e Shqipërisë;
- INSTAT;
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
- Instituti Shqiptar i Audituesve të Brendshëm.

6.7 Prioritetet

Shoqëritë tregtare

Do të punohet për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, i cili do të ketë si qëllim vlerësimin e legjislacionit të shoqërive tregtare dhe identifikimin e ndryshimeve të nevojshme për përafrimin me *acquis* të BE-së.

Kuadri ligjor dhe rregullativ i funksionimit të shoqërive tregtare në Shqipëri ka nevojë për përmirësim të qeverisjes korporative. Në këtë kuadër, zbatueshmëria e një Kodi të Qeverisjes Korporative, si dhe e modelit të “Tre Linjave



Mbrojtëse” (*3 lines of defense’ model*) do të ishin themele të forta për garantimin e mirëmbajtjes së qeverisjes korporative, midis të tjerash nëpërmjet koordinimit të funksioneve të menaxhimit të riskut dhe auditimit të brendshëm.

Kontabiliteti dhe auditimi

- Shqipëria duhet të përafrojë kornizën e saj ligjore në fushën e raportimit jofinanciar në përputhje me direktivën;

- Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike (POB) dhe harmonizmi me rregullat e auditimit ligjor të BE.

KAPITULLI 7

E DREJTA E PRONËSISË INTELEKTUALE

7.1 Përmbajtja e kapitullit

BE-ja ka rregulla të harmonizuara për mbrojtjen ligjore të të drejtave të pronësisë intelektuale (DPI), të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të. Rregullat për mbrojtjen ligjore DPI-së përfshijnë, për shembull, patentat dhe markat, disenjot, shpikjet bioteknologjike dhe produktet farmaceutike. Rregullat për mbrojtjen ligjore së drejtës së autorit dhe të drejtave që lidhen me të përfshijnë, për shembull, librat, filmat, programet kompjuterike dhe transmetimet.

Kapitulli paraqet një vështrim të situatës aktuale të pronësisë intelektuale në Shqipëri, duke përfshirë njohjen me legjislacionin në fuqi dhe ndryshimet përkatëse por dhe rezultatet konkrete të punës të dyja institucioneve përgjegjëse. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, si dhe Drejtoria e së Drejtës së Autorit pranë Ministrisë së Kulturës janë institucionet kryesore përgjegjëse, të angazhuara direkt me çështjet e Pronësisë Intelektuale në Shqipëri. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale bashkëpunon me Drejtorinë e të Drejtave të Autorit në aktivitete të përbashkëta, siç parashikohet në Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016–2020.

Të dy institucionet përgatisin, promovojnë, shpërndajnë materiale informative, organizojnë fushata sensibilizimi për institucionet, grupet e interesit dhe publikun nëpërmjet medias elektronike dhe të shkruar, si dhe aktivitete të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, si seminare, konferenca, trajnime etj. Ato bashkëpunojnë me një sërë institucioneve të tjera, siç janë Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së

Tregut, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve etj., të cilat janë pjesë e mekanizmit zbatues të këtyre të drejtave në Republikën e Shqipërisë.

7.2 Struktura e kapitullit

Kapitulli “Pronësia intelektuale” ndahet në tre nënkapituj si më poshtë:

- Pronësia industriale;
- E drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura;
- Zbatimi i të drejtave të pronësisë industriale.

7.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Sipas nenit 73 të Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë legjislacionin e saj kombëtar me *acquis* të BE-së.

Neni 73 Pronësia intelektuale, industriale dhe tregtare:

- në përputhje me dispozitat e këtij neni dhe shtojcën V, Palët konfirmojnë rëndësinë që i japin sigurimit të mbrojtjes së përshtatshme dhe efikase si edhe imponimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare.

- Shqipëria merr përsipër masat e nevojshme për të garantuar brenda katër viteve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje si dhe një nivel mbrojtjeje të të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të njëjtë me atë që ekziston në Komunitet, përfshirë mjetet e efektshme për realizimin e këtyre të drejtave.

- Shqipëria merr përsipër të bëhet palë brenda periudhës së përcaktuar më lart në konventat shumëpalëshe për të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të përmendura në shtojcën VI, paragrafi 1. Këshilli i Stabilizim-asociimit mund të vendosë për të detyruar Shqipërinë të bëhet palë në Konventa të veçanta shumëpalëshe në këtë fushë.

- nëse ndodhin probleme në fushën e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare që ndikojnë në kushtet e tregtisë, me kërkesë të një Pale, problemet i dërgohen urgjentisht Këshillit të Stabilizim-asociimit, me synim arritjen e zgjidhjeve të kënaqshme për palët.

- Forcimi i mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale dhe sigurimi i një niveli mbrojtjeje të njëjtë me atë të vendeve të BE, ka qenë një nga angazhimet e Qeverisë Shqiptare parashikuar në Marrëveshjen e Stabilizim-asociimit (neni 73). Në zbatim të këtij angazhimi, janë ndërmarrë masa



legjislative dhe aktivitete zbatuese, si në drejtim të përafrimit të legjislacionit kombëtar në fushën e pronësisë intelektuale me *acquis*, ashtu edhe në drejtim të forcimit të kapaciteteve administrative të institucioneve përgjegjëse në këtë fushë.

Lista e acquis:

- Ligji nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, ndryshuar me:

- Ligji nr. 10/2013, datë 1.3.2013, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, ‘Për pronësinë industriale’”;

- Ligji nr. 55/2014, datë 24.6.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, ‘Për pronësinë industriale’”;

- Ligji nr. 17/2017, datë 16.2.2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, ‘Për pronësinë industriale’”.

Ligji i lartpërmendur përafrohet plotësisht me *acquis* e mëposhtme të BE-së:

- Direktiva 98/44/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 6 korrikut 1998 mbi mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike;

- Direktiva 98/71/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 tetor 1998 mbi mbrojtjen ligjore të disenjove;

- Rregullorja e Këshillit (EC) nr. 6/2002 e datës 12 dhjetor 2001 mbi disenjot e Komunitetit;

- Direktiva 87/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 dhjetor 1986 mbi mbrojtjen ligjore të topografive dhe produkteve gjysmëpërçues;

- Direktiva 2004/48/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 29 prill 2004 mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale;

- Direktiva 2015/2436/EC, datë 16.12.2015, “Për harmonizimin e bazës ligjore të vendeve anëtare në lidhje me markat tregtare”;

- Rregullorja nr. 1151/2012/EC, të datës 21.11.2012, “Për skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore”;

- Rregullorja nr. (EEC) nr. 1308/2013/EC, datë 17.12.2013, “Për krijimin e një organizimi të përbashkët të tregjeve të produkteve bujqësore dhe shfuqizimin e rregulloreve (EEC) nr. 922/72, (EEC) nr. 234/79, (EC) nr. 1037/2001 dhe (EC) nr. 1234/2007”;

- Direktiva 2004/48/EC mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

- Ligji 35/2016, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to është përafëruar plotësisht me:

- Direktivën 2006/116/KE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 12 dhjetor 2006, “Mbi afatin e mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe disa të drejtave të lidhura” e amenduar”;

- Direktivën 2004/48/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 29 prill 2004, “Mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale”;

- Direktivën 2001/29/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 22 maj 2001, “Mbi harmonizimin e disa aspekteve të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të në shoqërinë e informacionit”;

- Direktivën 2001/84/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 27 shtator 2001, “Mbi të drejtën e rishitjes në dobi të autorit të një vepre origjinale të artit”;

- Direktivën 96/9/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 mars 1996, “Mbi mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave”;

- Direktivën 2009/24/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 23 prill 2009, “Mbi mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike”;

- Direktivën 2006/115/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 12 dhjetor 2006, “Mbi të drejtën e qirasë dhe të drejtën e kreditimit dhe mbi disa të drejta që lidhen me të drejtën e autorit në fushën e pronësisë intelektuale”.

Ky ligj është përafëruar pjesërisht me:

- Direktivën e Këshillit 93/83/KEE, datë 27 shtator 1993, “Mbi koordinimin e rregullave të caktuara në lidhje me të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit të aplikueshme në transmetimet satelitore dhe ritransmetimet kablore”;

- Direktivën 2014/26/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për menaxhimin kolektiv të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të dhe licencimi multiterritorial i të drejtave në veprat muzikore për përdorim në internet në tregun e brendshëm”.

7.4 Situata aktuale në Shqipëri

Në fushën e pronësisë industriale vizioni i DPPI-së, në lidhje me sistemin e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale është ndërtimi i një sistemi më të fortë të Pronësisë Industriale në Republikën e Shqipërisë, që siguron mbrojtje efektive të objekteve PI-së, inkurajon kreativitetin



dhe inovacionin në shërbim të nxitjes së rritjes ekonomike dhe kulturore si dhe zhvillimit shkencor në Republikën e Shqipërisë. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, me mbështetjen e vazhdueshme të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë iniciativa për reformimin e Sistemit të Pronësisë Industriale në vend.

Neni 189 i ligjit 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, përcakton Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) si një institucion publik jobuxhetor që regjistron, administron dhe promovon objektet e PI-së, dhe funksionon si një agjenci autonome nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë.

Aktualisht, në lidhje me iniciimin e procedurës mbi konsultimin paraprak të disa prej projektakteve të përfshira në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2020–22, DPPI ka përgatitur paketën e plotë të projektligjit për pronësinë industriale të përkthyer në gjuhën angleze në lidhje me direktivën e *Trade Secret* dhe e ka përcjellë pranë MEPJ dhe MFE. Pritet që ky projektligj të miratohet deri në fund të vitit 2020 ashtu siç dhe është parashikuar në PKIE 2020–2022.

Kapacitetet administrative të DPPI-së janë forcuar; me strukturën e re administrative numri i punonjësve është rritur në 39 dhe aktualisht DPPI është në proces rekrutimi të punonjësve të rinj.

Shqipëria është anëtare e shumë marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e pronësisë industriale. DPPI përfaqëson Shqipërinë në Organizatën Evropiane të Patentave (EPO), në Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale dhe ka filluar procedurat për anëtarësim në Zyrën e Pronësisë Intelektuale të Pronësisë Industriale (EUIPO).

Kuadri ligjor në fushën e së drejtës së autorit është përafëruar pothuajse plotësisht me direktivat e Bashkimit Evropian.

Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to sjell harmonizim të legjislacionit për të drejtën e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, me Direktivat e Bashkimit Evropian në këtë fushë, me qëllim garantimin dhe mbrojtjen e respektimit të të drejtave të autorit në të njëjtin nivel, nga pikëpamja juridike, me ato të vendeve të Bashkimit Evropian, detyrim që buron drejtpërdrejt nga neni 73 i Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit.

Drejtoria e të Drejtave të Autorit ushtron veprimtarinë në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”. Kjo drejtori bashkëpunon me autoritetet shtetërore kompetente, aktorë të cilët kanë një rol të rëndësishëm në fushën e të drejtave të autorit, në zbatim të ligjit.

Sporteli Unik në Administrimin e së Drejtës së Autorit–SUADA i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka qëllim kryerjen e funksionit të mbledhjes së tarifave të shpërblimit nga përdorimi i veprave të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to nga subjektet përdorues, si një sportel i vetëm në emër të të gjitha agjencive të administrimit kolektiv të licencuara, si dhe shpërndarjen e këtyre të ardhurave te këto agjenci në përputhje me legjislacionin në fuqi. Më pas, këto agjenci bëjnë shpërndarjen e të ardhurave te titullarët e të drejtave që përfaqësojnë.

Në zbatim të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to”, administrimi kolektiv kryhet nga agjencia e administrimit të të drejtave të autorit, që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre mbledhjen e të ardhurave për përdorimin e veprave dhe shpërndarjen e tyre te titullarët e së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to. Agjencia e administrimit kolektiv licencohet nga ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit pas propozimit nga Drejtoria e së Drejtës të Autorit (DDA). Licenca e agjencive të administrimit kolektiv për ushtrimin e veprimtarisë është e vlefshme për 3 vjet si dhe mund të jetë e rinovueshme.

Agjencitë e administrimit kolektiv mbikëqyren nga Drejtoria e së Drejtës së Autorit mbi të gjithë veprimtarinë e funksionimit të tyre. Përgjatë vitit 2020 kanë ushtruar aktivitetin e tyre tri agjenci të administrimit kolektiv, konkretisht: Agjencia “Albautor” për të drejtat e autorëve në fushën e të drejtave të autorëve të veprave letrare dhe artistike, Agjencia “AKDIE” për të mbrojtur të drejtat e artistëve interpretë dhe/ose ekzekutues të veprave, Agjencia “FMAA” - në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera audiovizuale.

Në fushën e zbatimit të pronësisë intelektuale:

Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut është përgjegjës për inspektimin, kontrollin dhe zbatimin e së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me to.



Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut është konstituar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 36, datë 20.1.2016. Organika e tij, përcakton ndër tjera Drejtorinë e Pronësisë Intelktuale të përbërë nga Sektori i së Drejtës së Autorit (SDA) dhe Sektori i Pronësisë Industriale (SPI). Sektori i së Drejtës së Autorit e mbështet veprimtarinë e tij mbi Ligjin nr. 35/2016, “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me To”. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe përkatësisht Sektori i së Drejtës së Autorit është garantues i mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, sipas përcaktimit të legjislacionit respektiv.

Gjatë vitit 2019 janë kryer 386 inspektime mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to dhe janë vendosur 40 dënime administrative kryesore. Po gjatë këtij viti janë informuar dhe këshilluar 600 subjekte përdorues në kuptim të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”. Gjatë vitit 2020 e deri më tani janë kryer 213 inspektime mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to dhe janë vendosur 20 dënime administrative kryesore. Të gjitha këto procese inspektimi janë kryer *online* me anë të sistemit *e-Inspection*.

Inspektorati është në proces të forcimit të kapaciteteve të tij. Në vitin 2020 ISHMT është ristrukturuar ku Sektori i së Drejtës së Autorit nga 8+1 inspektorë është bërë në 9+1 inspektorë, me qëllim rritjen e inspektimeve efektive të kryera pranë strukturave që ushtrojnë veprimtari që bie në zbatimin e ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

Gjatë vitit 2019 dhe gjatë vitit 2020 nga ana e Drejtorisë së Pronësisë Intelktuale janë kryer takime sensibilizuese me grupet e interesit me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Gjatë vitit 2019 janë kryer vetëm 4 inspektime mbi bazë ankese nga mbajtësit e së drejtës dhe 2 kanë rezultuar me masë administrative gjobë. Gjatë vitit 2020 numri i ankesave të shqyrtuara ka ardhur në rritje duke e çuar numrin e inspektimeve në 12 dhe masat administrative të vendosura në 7 (gjoba). Të gjitha këto procese inspektimi janë kryer *online* me anë të sistemit *e-Inspection*, duke i kushtuar rëndësi të veçantë procedurave të rregullta ligjore. Ndodhur në kushtet e mangësive ligjore ISHMT

gjatë vitit 2020 ka dhënë kontribut duke referuar gjithë problematikat që hasin inspektorët gjatë implementimit në terren të Ligjit 9947, “Për Pronësinë Industriale” ndaj janë parashikuar ndryshimet e nevojshme ligjore që do t’i krijojë ISHMT-së mundësinë e realizimit të inspektimeve *ex officio* dhe jo vetëm mbi bazë ankese nga mbajtësit e së drejtës. Në ndryshimet ligjore të parashikuara është parashikuar dhe ndryshimi i koncepteve mbi “cenimin e titujve të pronësisë industriale” dhe “falsifikimin e mallrave”, iniciativë që do t’i mundësojë ISHMT-së një numër më të lartë inspektimesh në këtë fushë dhe rregullimin e tregut të brendshëm nga mallrat e falsifikuara.

Inspektorati ka punuar vazhdimisht në drejtim të forcimit të kapaciteteve njerëzore. Në vitin 2020 u miratua struktura e re dhe u mundësua plotësimi i vendeve vakante, duke bërë të mundur që Sektori i Pronësisë Industriale të punojë me kapacitet të plotë njerëzor.

Sektori i Pronësisë Industriale ka në strukturë 1 (një) përgjegjës sektori dhe 6 (gjashtë) inspektorë. Aktualisht janë vetëm 2 (dy) vende vakantë.

ISHMT ka realizuar takime sensibilizuese dhe informuese në drejtim të rëndësisë së mbrojtjes të të drejtave të pronësisë intelektuale si gjatë vitit 2019 po ashtu edhe gjatë vitit 2020 duke pasur në fokus sidomos informimin e studentëve dhe operatorëve ekonomikë.

Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitjeje/është mesatarisht e përgatitur në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale. Disa përparime janë shënuar gjatë periudhës raportuese, sidomos me përafrimin me *acquis* të BE-së në fushën e të drejtave të pronësisë industriale si edhe në përmirësimin e funksionimit të agjencive të administrimit kolektiv. Rekomandimet e vitit të kaluar janë përmbushur pjesërisht dhe vazhdojnë të jenë të vlefshme.

Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet veçanërisht:

Të intensifikojë përpjekjet për të përafruar me *acquis* të BE-së legjislacionin për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të;

Të përmirësojë më tej funksionimin e agjencive të administrimit kolektiv dhe pagesën e honorarëve të mbajtësit e të drejtave.

Të përafrojë legjislacionin mbi të drejtat e Pronësisë Industriale dhe sistemin e zbatimit të këtyre të drejtave.



7.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Një angazhim ndër institucional që DPPI ka ndërmarrë, i cili është parashikuar në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian 2020–2022 është hartimi i Strategjisë së re Kombëtare për Pronësinë Intelektuale (2021–2025), duke përfshirë dhe institucionet e tjera ligjzbatuese, pjesë e sistemit të pronësisë intelektuale në Republikën e Shqipërisë. Ka vijuar puna me Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO) për draftimin e këtij dokumenti si dhe janë zhvilluar intervistat *online* me të gjitha institucionet shtetërore të përfshira dhe grupet e ndryshme të interesit. Gjithashtu, ka dalë urdhri i Kryeministrit nr. 118 datë 23.9.2020 për krijimin e grupit ndër institucional, i cili do të merret me draftimin e këtij dokumenti strategjik, i cili pritet të miratohet në 3-mujorin e dytë të 2021.

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale (2016–2020), DPPI-ja ka përmbyshur objektivin e përcaktuar në dokumentin strategjik për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit pranë biznesit në qarqet kryesore të vendit duke u shtrirë në të gjithë vendin me takime të shumta. Këto takime, për shkak të pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, kanë filluar në fund muajit qershor dhe do vijojnë deri në fund të vitit 2020.

Republika e Shqipërisë është bërë pjesë e *WIPO Global Brand & Design Database*, me mbi 18 000 mijë regjistrime, database ku bëjnë pjesë shumica e shteteve anëtare të WIPO.

Lidhur me të drejtat e pronësisë industriale, Këshilli i Ministrave më datë 16.12.2020 miratoi propozimin e projektligjit, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, i cili ndër të tjera përafron pjesërisht direktivën (BE) nr. 2016/943, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 8.6.2016, për sa i përket mbrojtjes së njohurive të fshehta dhe informacionit (sekretit tregtar) të shoqërive tregtare kundër përvetësimit, përdorimit e bërjes publike në mënyrë të paligjshme të tyre, duke përmbyshur në këtë mënyrë detyrimin dhe afatin ligjor të parashikuar në PKIE 2020–2022.

Gjithashtu është nënshkruar Marrëveshja e Punës me Organizatën Evropiane të Patentave. Avantazhi kryesor i marrëveshjes do të jetë reduktimi i tarifës së raportit të kërkimit të hartuar

nga ZEP për aplikantët shqiptarë në rastet kur kanë depozituar në DPPI për çdo:

- Aplikim Ndërkombëtar për patentë për shpikje, bazuar në marrëveshjen në fushën e patentave;

- Aplikim kombëtar për patentë të depozituar në DPPI;

Gjatë periudhës janar–shtator 2020, janë ekzaminuar 9.256 kërkesa dhe janë pranuar 3.070 dokumente plotësues, DPPI, ka hartuar dhe lëshuar në total 14.048 akte administrative, nga të cilat 3.262 janë regjistrime të objekteve të PI-së, dhe 4.780 janë pasqyrime në regjistër të ndryshimeve në lidhje me këto objekte.

DPPI, në këtë periudhë, ka përgatitur dhe publikuar në total 65 Buletinë për Pronësinë Industriale, konkretisht, 34 publikime të buletinit të markave tregtare, disenjove industriale, treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës, si dhe 31 publikime të buletinit të patentave për shpikje, si dhe të modeleve të përdorimit.

Në periudhën raportuese, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale janë paraqitur për regjistrim marke në total 798 aplikime. Nga Marrëveshja dhe Protokolli i Madridit janë depozituar 2.193 aplikime ndërkombëtare. Numri i aplikimeve kombëtare për regjistrim marke nga subjektet shqiptare në periudhën raportuese arriti në 503 aplikime.

Nëse do t'i referohemi periudhës (2015–2020), trendi i aplikimeve kombëtare dhe ndërkombëtare ka qenë një trend rritës. E njëjta tendencë në rritje vihet re dhe përgjatë një periudhe afatgjatë 10-vjeçare. Në numrin total të aplikimeve në % për periudhën janar–shtator 2020, aplikimet ndërkombëtare zënë 73%, aplikimet kombëtare nga aplikantë të huaj 10% dhe aplikimet vendëse zënë 17%.

Gjatë periudhës janar–shtator 2020, DPPI ka pritur 666 aplikime për patenta dhe 2 aplikime për model përdorimi. Nga këto aplikime, 7 aplikime janë aplikime kombëtare me aplikantë shtetas shqiptarë, dhe 659 aplikime për patenta, janë patenta të lëshuara nga Zyra Evropiane e Patentave, të cilat kërkojnë mbrojtje në Republikën e Shqipërisë.

Në funksion të një shërbimi sa më të shpejtë, DPPI vendosi që buletinet e markave, disenjove, treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës, të publikohen periodikisht çdo javë, nga një herë në



dy muaj që kryhej më parë. Publikimi i shpeshtë i tyre ndikon drejtpërdrejtë në shkurtimin e afateve të regjistrimit (ligji detyron DPPI-në të mbajë të publikuar çdo aplikim për tre muaj para regjistrimit, në pritje të kundërshtimeve).

Përmirësimi i cilësisë së shërbimit vazhdon me strukturimin e ri dhe krijimin e Zyrës së Pritjes dhe Informimit. Kjo zyrë thjeshton procedurat për aplikantët dhe shpejton dhënien e informacionit nga një personel i kualifikuar. Krijimi i Zyrës së Pritjes, sipas strukturës së re të DPPI-së ndikon edhe në shkurtimin e afateve të ekzaminimit të patentave, si dhe do të thjeshtojë dhe një sërë shërbimesh që më parë kryheshin në zyrën e patentave si hetime, ekstrakte apo inspektime dosjesh. Këto veprime thjeshtojnë dhe shkurtojnë kohën e marrjes së shërbimit nga qytetarët, bizneset apo palët e interesuara.

Tashmë prej 15 korrik 2020, të interesuarit për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale mund të kryejnë aplikimin e tyre edhe *online* përmes portalit të vetëm qeveritar www.e-Albania.al.

Zbatimi i nenit 138 të ligjit, “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”

Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit, në zbatim të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, nëpërmjet vendimit nr. 9, datë 11.5.2020, “Për transferimin e funksionit të mbledhjes së tarifave për të gjitha kategoritë të mbajtësve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në administrimin kolektiv dhe drejtimin e sporteli unik të administrimit të së drejtës së autorit–SUADA”, ka vendosur transferimin e funksionit të mbledhjes së tarifave për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në administrimin kolektiv, agjencisë së administrimit kolektiv “FMAA”.

Më datë 4.6.2020 është zbardhur vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pranimin e regjistrimit të vendimit nr. 9, datë 11.5.2020 të KKDA-së.

Gjithashtu Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit nëpërmjet vendimit nr. 10, datë 29.6.2020 “Mbi kërkesën e depozituar nga Agjencia Drejtuese e Sportelit Unik–SUADA, “Për plotësimin e vendimit nr. 9, datë 11.5.2020 të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit” ka vendosur plotësimin e pikës 1, të vendimit nr. 9, datë

11.5.2020, duke specifikuar drejtorin Ekzekutiv të SUADA-s, z. Saimir Kumbaro.

Ndjekja e proceseve gjyqësore

Procesi gjyqësor i regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt “Pavlefshmëria absolute e vendimit nr. 9, datë 15.5.2020, të Këshillit Kombëtar për të Drejtat e Autorit” është mbyllur në favor të Ministrisë së Kulturës, ku pala paditëse, Agjencia e Administrimit Kolektiv “Albautor” është tërhequr nga gjykimi dhe rrjedhimisht është pushuar gjykimi.

Gjithashtu, procedim gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me pala paditëse Agjencia AKDIE, gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës civile të paraqitur nga pala kërkuuese, pra në këtë proces KKDA dhe Ministria e Kulturës janë palë gjyqësore.

Regjistrimet për të drejtën e autorit

Gjatë vitit 2020, duke mbajtur në vëmendje kushtet e krijuara për shkak të pandemisë, janë kryer 146 regjistrime për të drejtën e autorit dhe kalim të drejtave të autorit, një rritje e konsiderueshme nga viti 2019, gjatë cilit janë regjistruar 69 regjistrime për të drejtën e autorit.

Me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor, por edhe më gjerë mbi aspekte të tjera sa i takon së drejtës së autorit, Drejtoria e të Drejtave të Autorit është përfshirë në dy projekte konkretisht:

- Projekti i binjakëzimit “*Forcimi i mbrojtjes dhe zbatimit të të drejtave të Pronësisë Intelektuale*”.
- Projekti për bashkëpunimin bilateral në Pronësinë Intelektuale.

Në portalin *e-Albania* ofrohet edhe shërbimi *online* për regjistrimin e së drejtës së autorit dhe kalimit të të drejtave. Përgjatë 6-mujorit të parë të vitit 2020, Drejtoria e të Drejtave të Autorit është angazhuar në ngritjen, por edhe testimin e këtij procesi për mbarëvajtje sa më të mirë. Tashmë, me funksionimin e këtij shërbimi *online*, regjistrimi dhe kalimi i të drejtave kryhet vetëm nëpërmjet këtij sistemi.

7.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Dy institucionet kryesore përgjegjëse për pronësinë intelektuale në Republikën e Shqipërisë janë Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) dhe Drejtoria e të Drejtave të Autorit (DDA).

DPPI është një agjenci autonome nën mbikëqyrjen e Ministrit të Ekonomisë, e cila



regjistrin, administron dhe promovon objektet e PI-së. Fokusi i DPPI-së konsiston në përmirësimin e funksionimit të sistemit të pronësisë industriale me qëllim, nxitjen dhe mbështetjen e inovacionit nëpërmjet nxitjes së punës kërkimore, në veçanti nga kompanitë shqiptare, universitetet vendëse dhe individët drejt zhvillimit ekonomik dhe standardeve më të larta. Në mënyrë specifike, do të shërbejë si një mjet për të inkurajuar investimet në kërkim dhe zhvillim, si dhe për të garantuar suksesin në treg.

Në Ministrinë e Kulturës, DDA-ja është drejtorja e ngarkuar me ligj për respektimin e së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në RSH. DDA-ja mundëson dhe ofron asistencë mbi rastet e cenimit të së drejtës së autorit ndaj autorëve si dhe bashkëpunon me Inspektoratin, i cili mbikëqyr zbatimin e ligjit nr. 35/2016.

Institucione të tjera, të përfshira në procesin e zbatimit, janë si më poshtë:

- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut;
- Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve;
- Drejtorja e Përgjithshme e Doganave;
- Autoriteti i Mediave Audiovizive;
- Policia e Shtetit–Drejtorja e Krimit Ekonomik;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- shkolla e Magjistraturës.

7.7 Prioritetet

Në kuadër të rekomandimeve të përcjella nga Nënkomiteti i Tregut të Brendshëm 22 prill 2020 citohet se:

- Shqipëria duhet të vazhdojë përpjekjet e saj për të zbatuar në mënyrë efektive të drejtat e pronësisë intelektuale, veçanërisht në luftën kundër mallrave të falsifikuara.

- Shqipëria inkurajohet të sigurojë që autoritetet e zbatimit të ligjit, si dhe gjykatat të trajnohen vazhdimisht në fushën e pronësisë intelektuale dhe forcohen më tej në lidhje me burimet financiare dhe njerëzore. Prioritet ndër institucional në këtë fushë mbetet hartimi dhe miratimi i strategjisë së re kombëtare për pronësinë intelektuale (2021- 2025) ku përfshihen institucionet ligj zbatuese.

Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit dhe të informimit të kategoritë e ndryshme dhe grupet e interesit si tek organizimi i aktiviteteve pranë shkollave të arsimit para- universitar.

Përfundimi dhe miratimi i strategjisë së re kombëtare 2021- 2025 mbetet një nga prioritetet

aktuale të DPPI për finalizimin e këtij dokumenti të rëndësishëm në fushën e pronësisë intelektuale. Organizata Botërore e pronësisë Intelektuale po ofron asistencën teknike në draftimin e tij, i cili pritet të miratohet në 3-mujorin II të 2021.

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale (2016- 2020) Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, si një prioritet në politikat e saj, ka përbushur pjesën e ndërgjegjësimit me komunitetin e biznesit dhe të sipërmarrjes me qëllim dhënien dhe shpërndarjen e informacionit sa i takon rëndësisë që mbart regjistrimi i të drejtave të pronësisë industriale. Këto aktivitete janë planifikuar për t'u zhvilluar deri në fund të vitit 2020 dhe janë shtrirë në të gjitha qarqet e vendit tonë. Prioritet mbetet trajnimi i vazhdueshëm i sistemit gjyqësor si një nga hallkat kryesore në gjithë këtë proces.

Ngritja dhe fuqizimi i Qendrës së Trajnimeve vijon të mbetet një tjetër prioritet dhe angazhim i institucionit tonë me qëllim ofrimin e trajnimeve të specializuara në fushën e pronësisë industriale.

Ligji nr. 35/2016, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” është një ligj i harmonizuar dhe i integruar me Direktivat e Bashkimit Evropian. Ministria e Kulturës ka parashikuar përafrimin e këtij ligji me tri direktiva të Bashkimit Evropian si më poshtë vijon:

Direktivën 2017/1564/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 13 shtator 2017, “Mbi disa përdorime të lejuara të veprave të caktuara dhe fusha të tjera të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to në përfitim të personave të cilët janë të verbër, me shikim të dëmtuar ose ndryshe me aftësi të kufizuara në leximin e materialeve të printuara, dhe amendimin e direktivës 2001/29/KE mbi harmonizimin e aspekteve të caktuara të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në shoqërinë e informacionit”;

Direktivën 2011/77/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 27 shtator 2011 “Amendimi i Direktivës 2006/116/KE mbi afatin e mbrojtjes të të drejtave të autorit dhe disa të drejtave të lidhura me to”, Celex 32011L0077, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 265/1, datë 11.10.2011”;

Direktivën 2012/28/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 25 tetorit 2012, “Për përdorime të caktuara të veprave pa autor”.



Aktualisht, projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura”, ka përfunduar fazën e konsultimit publik dhe është në fazën e bashkërendimit të komenteve dhe sugjerimeve me ministrinë e tjera të interesuara.

Projektligji për të drejtën e autorit, ka përfshirë edhe ndryshime dhe saktësime të dispozitave aktuale në lidhje me sistemin e menaxhimit kolektiv, mbledhjen dhe shpërndarjen e të ardhurave dhe me funksionimin e Agjencive të Administrimit Kolektiv.

Në vitin 2021 Ministria e Kulturës ka parashikuar aderimin me ligj në Traktatin e Marakeshit. Në vitin 2022 Ministria e Kulturës ka planifikuar të harmonizojë Rregulloren (BE) 2017/1563 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 13 shtator 2017, “Mbi shkëmbimin ndërkufitar midis Bashkimit dhe vendeve të treta, të kopjeve në format të përshtatur të veprave të caktuara dhe objekteve të tjera të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura me to në përfitim të personave të cilët janë të verbër, me shikim të dëmtuar ose ndryshe me aftësi të kufizuara në leximin e materialeve të printuara.”

KAPITULLI 8

POLITIKA E KONKURRENCËS

8.1 Përmbajtja e kapitullit

Politika e Konkurrencës në Evropë është një pjesë thelbësore e tregut të brendshëm. Qëllimi i saj është të sigurojë për të gjithë në Evropë mallra dhe shërbime me cilësi më të mirë dhe me çmime më të ulëta. Politika e konkurrencës ka të bëjë me zbatimin e rregullave për t’u siguruar që ndërmarrjet konkurrojnë në mënyrë të lirë dhe efektive me njëra-tjetrën. Kjo inkurajon ndërmarrjen dhe efikasitetin, krijon një zgjedhje më të gjerë për konsumatorët dhe ndihmon në uljen e çmimeve dhe përmirësimin e cilësisë. Këto janë arsytet pse BE lufton sjelljen antikonkurrese, analizon kontrollet e përqendrimeve dhe ndihmën shtetërore dhe inkurajon liberalizimin.

Qëllimi i ligjit nr. 9121/2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, është të sigurojë konkurrencën e lirë dhe efektive në treg. Dispozitat ligjore zbatohen si në rastet e marrëveshjeve të ndaluara midis ndërmarrjeve, abuzimit me pozitën dominuese dhe gjithashtu përfshijnë dispozita

lidhur me kontrollin e përqendrimeve midis ndërmarrjeve.

Rregullat e BE gjithashtu përcaktojnë një sistem të kontrollit të ndihmës shtetërore. Qeveritë lejohen të japin ndihmë shtetërore vetëm nëse plotësohen kushtet kufizuese, me qëllim parandalimin e shtrembërimit të konkurrencës.

8.2 Struktura e kapitullit

1. Politika e konkurrencës;
2. Ndihma shtetërore;
3. Liberalizimi.

8.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Bashkëpunimi ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë në lidhje me politikat e konkurrencës, rregullohet në disa nene të MSA-së. Së pari, në titullin IV “Përafrimi i legjislacionit, imponimi i ligjeve dhe rregullat e konkurrencës”, neni 70 përcakton se Shqipëria do të përpiqet që të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me *acquis* të Komunitetit dhe se do të sigurohet që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet.

Neni 71 (Konkurrenca dhe dispozitat e tjera ekonomike) përcakton qartë se dispozitat në vijim pjesë të këtij neni, si marrëveshjet e ndaluara ndërmjet sipërmarrjeve, vendimet e marra nga grupe ndërmarrjesh dhe praktika të koordinuara ndërmjet ndërmarrjeve të cilat kanë si objekt të tyre ose pasojë, parandalim, kufizim ose shtrembërim të konkurrencës; abuzim me pozitën dominuese, nga një ose më shumë ndërmarrje në territorin e Komunitetit apo të Shqipërisë si një e tërë ose në një pjesë të konsiderueshme të tyre; çdo ndihme shtetërore e cila shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar ndërmarrje të caktuara ose prodhime të caktuara, nuk janë në përputhje me funksionimin e duhur të Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit. Me qëllim përmbajtjes jo vetëm të dispozitave të MSA por edhe të legjislacionit të BE, Shqipëria është angazhuar në përafrimin e legjislacionit të saj të brendshëm me atë të BE.

8.4 Situata aktuale në Shqipëri

Konkurrenca

Kuadri ligjor në fushën e konkurrencës është gjerësisht në të njëjtën linjë me EU *Acquis* dhe me Marrëveshjen e Stabilizim-asociimit (SAA). Ligji nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të



ndryshuar është plotësisht i përfaruar me nenin 101 TFEU (Marrëveshjet e ndaluara) dhe nenin 102 TFEU (abuzimi me pozitën dominuese). Gjithashtu, ligji parashikon procedura paraprake për kontrollin e përqendrimeve, në linjë me Rregulloren e Përqendrimeve të BE. Kuadri ligjor zbatues është plotësisht i përafuar me Rregulloret përkatëse të BE dhe me Udhëzimet e Komisionit Evropian. Autoriteti i Konkurrencës ka miratuar udhëzime duke parashikuar procedura për ato ndërmarrje të cilat kanë pësuar dëme si rezultat i shkeljes së rregullave të konkurrencës.

Për sa i përket kuadrit institucional, AK është përgjegjës për zbatimin e ligjit nr. 9121/2003, 'Për Mbrojtjen e Konkurrencës', i ndryshuar. AK është një autoritet i pavarur i cili raporton pranë Parlamentit. AK mund të miratojë akte nënligjore zbatuese, të vendosë gjoba, të japë kushte dhe detyrime, të ndalojë përqendrimet e ndërmarrjeve ose të autorizojë këto përqendrime me ose pa kushte. AK mund të kryejë hetime të përgjithshme në një sektor të ekonomisë dhe me iniciativë të vet, mund të japë opinione dhe rekomandime për draft akte normative të cilat mund të ketë efekt mbi konkurrencën në treg.

Programi i lehtësimit nga gjobat është miratuar, për ndërmarrjet të cilat sigurojnë informacion për rastet e marrëveshjeve të ndaluara. Palët mund të apelojnë vendimin e AK para gjykatës. AK-ja ka ndërmarrë disa iniciativa për rritjen e ndërgjegjësimit midis ndërmarrjeve lidhur me rregullat e konkurrencës, iniciativa drejtuar sektorëve specifikë.

AK-ja ka rritur numrin e stafit në 46 punonjës, të cilët kanë përfutur nga një seri trajnimesh të organizuara nga Komisioni Evropian, UNCTAD, OECD, EBRD dhe Autoriteti Italian i Konkurrencës.

Ndihma Shtetërore

Kuadri legjislativ për ndihmën shtetërore përputhet gjerësisht me *Acquis* të BE-së dhe MSA-së. Ligji për ndihmën shtetërore pasqyron kryesisht nenet 107 dhe 108 TFEU. Legjislacioni zbatues është përafuar pjesërisht me *Acquis* të BE-së në disa fusha, p.sh. Rregullorja e Përgjithshme e Përfashtimit të Bllokut. Nevojitet një harmonizim i mëtejshëm me legjislacionin zbatues të BE-së për kontrollin e ndihmës shtetërore. Sa i përket kornizës institucionale, Komisioni i Ndihmës Shtetërore (KNSH) është përgjegjës për zbatimin e

Ligjit për ndihmën shtetërore, i mbështetur nga struktura tekniko-administrative sekretariati për ndihmën shtetërore në ministrinë përgjegjëse për ekonominë.

Sipas ligjit nr. 9374/2005, 'Për ndihmën shtetërore, i ndryshuar, masat e reja të ndihmës duhet t'i njoftohen KNSH-së, e cila duhet t'i vlerësojë ato në përputhje me ligjin e ndihmës shtetërore përpara se të zbatohen. KSA-ja mund të urdhërojë rikuperimin e ndihmës së paligjshme dhe të papajtueshme, por nuk e ka bërë atë deri më tani. Vendimet e tij i nënshtrohen apelit gjyqësor.

Në lidhje me liberalizimin, ligjet për mbrojtjen e konkurrencës dhe për ndihmën shtetërore janë të zbatueshme për ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet me të drejta të veçanta ose ekskluzive, përveç rasteve kur zbatimi i tyre pengon kryerjen e detyrave të veçanta të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik që u caktohen atyre.

8.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Autoriteti i Konkurrencës e mbështet veprimtarinë e tij në ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, 'Për Mbrojtjen e Konkurrencës', i ndryshuar si dhe në një set të plotë aktesh nënligjore, përfshirë rregullore dhe udhëzime konkrete. Ligji dhe kuadri ligjor dytësor janë plotësisht të përfaruar me kuadrin ligjor të BE-së në fushën e konkurrencës, ndër të tjera me nenet e TFEU, neni 101–102, 106 të Traktatit të Funksionit të BE-së; direktivën (EU) 2019/1 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 11 dhjetor 2018, 'Për fuqizimin e autoriteteve të konkurrencës që të jenë zbatues më efektivë dhe të sigurojnë funksionimin e duhur të tregut të brendshëm'; rregulloren e Këshillit Evropian (EC) nr. 1/2003, datë 16 dhjetor 2002, 'Për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit; Rregulloren e Këshillit Evropian (EC) nr. 139/2004, të datës 20 janar 2004, 'Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve' (Rregullorja e Përqendrimit të KE); njoftimin e Komisionit mbi përcaktimin e tregut përkatës për qëllimet e ligjit komunitar të konkurrencës; Njoftimin e Komisionit mbi imunitetin nga gjobat dhe uljen e gjobave në rastet e karteleve; udhëzimin për metodën e përcaktimit të gjobave të vendosura në përputhje me nenin 23(2) (a) të Rregullores nr. 1/2003; Njoftimin e Komisionit për marrëveshjet me rëndësi të vogël të cilat nuk e kufizojnë ndjeshëm konkurrencën sipas nenit 81 (1) të Traktatit themelues të Komunitetit



Evropian (*de minimis*) etj., si dhe akte të tjera ligjore të BE-së.

Aktet nënligjore të miratuara nga AK-ja, përcaktojnë në mënyrë të detajuar procedurat të cilat ndihmojnë Autoritetin e Konkurrencës në realizimin e misionit sipas objektit të ligjit, në kuadër të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Përgjatë 2019–2020, Autoriteti i Konkurrencës ka ndërhyrë në shumë tregje dhe sektorë të ekonomisë, në të cilat janë evidentuar dhe zbuluar praktika antikonkurrenciale, duke marrë masat e duhura për rikthimin e konkurrencës në treg. Gjithashtu, janë përdorur gjerësisht instrumentet e duhura për rritjen e kulturës dhe advokacisë së konkurrencës, në synim edhe të ndërgjegjësimi të aktorëve në treg për rregullat dhe parimet e konkurrencës. Autoriteti i Konkurrencës ka vijuar procesin e përafrimit të legjislacionit me atë të *acquis* të BE-së. Veprimtaria e institucionit ka qenë në zbatim të Ligjit dhe Politikës së Konkurrencës, duke trajtuar me kujdes ankesat lidhur me problematikat që shfaqen në tregje të ndryshme, si dhe të detyrave të përcaktuara në Raportet e Progresit nga Komisioni Evropian.

Për realizimin e misionit të përcaktuar në ligjin e konkurrencës, mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, AK përdor instrumentet ligjorë dhe nënligjorë siç janë procedurat hetimore për të zbuluar praktikant antikonkurrese. Këto praktika shfaqen në formën e: marrëveshjeve të ndaluara për fiksimin e çmimeve, ndarjen e tregjeve, kufizimin apo kontrollin e prodhimit; të abuzimit me pozitën dominuese në formën e vendosjes së çmimeve të padrejta, kufizimin e prodhimit apo të shërbimit, vendosjen në pozita jo të barabarta të klientëve, apo vendosja e kushteve dhe detyrimeve shtesë në kontratë me palët e treta etj. AK-ja mbikëqyr ndryshimin e strukturave të tregut nëpërmjet procedurave të kontrollit të përqendrimeve të ndërmarrjeve. Në vijim të aktivitetit të tij Autoriteti i Konkurrencës i ka dhënë një rëndësi të veçantë advokacisë së konkurrencës. Nxitja e konkurrencës së lirë të ndërmarrjeve në treg, përbën një nga objektivat e ligjit, i cili realizohet edhe nëpërmjet instrumentit të advokacisë dhe aktiviteteve për rritjen e kulturës së konkurrencës.

Në përgjithësi Shqipëria ka plotësuar detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-asociimit

në këtë fushë. Ligji shqiptar për ndihmën shtetërore, ligji nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën Shtetërore” është amenduar dhe është plotësisht i përfaruar me direktivat e mëposhtme të BE-së: Rregullore nr. 69/2001, (KE) e datës 12 janar 2001, “Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së për ndihmën *de minimis*; rregullore 70/2001, “Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së lidhur me ndihmën për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme; rregullore nr. 2204/2002, “Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të KE-së për ndihmën shtetërore për punësimin”; Rregullore nr. 68/2001, “Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së për ndihmën për trajnim”; Rregullore e Këshillit nr. 659/1999, “Për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të KE-së; Rregulloren e Komisionit, “Për ndihmën *de minimis*” nr. 1407/2013; Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 651/2014 e 17 qershor 2014, “Për deklarimin e disa kategori të ndihmës shtetërore në përputhje me tregun e brendshëm në zbatim të nenit 107 dhe 108 të Traktatit”, vendimi i Komisionit Evropian, “Për zbatimin e nenit 106(2) TFBE ‘Për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve publike dhënë ndërmarrjeve që janë mandatar për të ofruar shërbime të interesit të përgjithshëm ekonomik’”.

Baza ligjore e miratuar e ndihmon Strukturën e Ndihmës Shtetërore në veprimtarinë e tij dhe realizimin e misionit dhe të objektit të ligjit, në kuadër të ndalimit të çdo ndihme të dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e cila shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara.

Gjatë periudhës 1 janar 2020–30 shtator 2020, Komisioni i Konkurrencës ka aprovuar në total: 37 (tridhjetë e shtatë) vendime:

- për marrëveshjen e ndaluar - 5 vendime;
- për abuzimin e pozitës mbizotëruese - 3 vendime;
- për autorizimin e përqendrimit - 13 vendime;
- për masat e përkohshme - 2 vendime;
- për rekomandimet për institucionet publike dhe organet rregullatore - 4 vendime;
- për miratime akte nënligjore - 4 vendime;
- për kushte dhe detyrime - 3 vendime;
- për përjashtim nga ndalimi - 1 vendim;



- për vendime të tjera - 2 vendime.

Në lidhje me zbatimin e nenit 4, të ligjit 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, janë analizuar: tregu i importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit, tregu i shërbimeve celulare etj., si dhe po vijojnë procedurat në tregje si ai i barnave dhe i pajisjeve mjekësore, ku janë vlerësuar të drejtat e veçanta dhe ekskluzive të dhëna, tregu i gazit të lëngshëm, tregu i prokurimeve publike etj.

Në lidhje me zbatimin e nenit 9, të ligjit 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, janë analizuar tregu i shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së kontejnerëve në Terminalin e Kontejnerëve Durrës”, tregu i prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, tregu i sportit të futbollit etj.

Në lidhje me procedurat e kontrollit të përqendrimeve, janë zbatuar dispozitat ligjore për përqendrimet në tregje dhe sektorë të ndryshëm të ekonomisë të tillë si sektori bankar, tregu i importit të auto-veturave, tregu i komunikimeve elektronike në rrjetet e lëvizshme dhe tregu i komunikimeve elektronike në rrjetet fikse etj.

Gjatë periudhës 1 janar 2020–30 shtator 2020, Komisioni i Ndihmës Shtetërore ka aprovuar në total 5 vendime:

- vendim i KNSH-së nr. 94, datë 6.1.2020, “Autorizim i dhënies së Ndihmës Shtetërore ‘Për fondin e ekonomisë kreative (artizanatit)’”;

- vendim i KNSH-së nr. 95, datë 3.3.2020, “Autorizim i Ndihmës Shtetërore për zbatimin e projektit të gazsjellësit Trans Adriatik”;

- vendim i KNSH-së nr. 96, datë 27.3.2020, “Autorizim i Ndihmës Shtetërore COVID-19: Skema mbështetëse në formën e grantit”;

- vendim i KNSH-së nr. 97, datë 6.4.2020, “Autorizim i Ndihmës Shtetërore COVID-19: Skema e garancisë shtetërore të huas”;

- vendim i KNSH-së nr. 98, datë 28.4.2020, “Autorizim i Ndihmës Shtetërore COVID-19: Skema mbështetëse në formën e grantit 2”.

8.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Autoriteti i Konkurrencës;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (sekretariati i ndihmës shtetërore);
- Komisioni i Ndihmës Shtetërore;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimi Rural;

- Ministria e Kulturës;

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;

- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;

- Instituti i Statistikave.

8.7 Prioritetet

Autoriteti i Konkurrencës i kushton rëndësinë e duhur mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg nëpërmjet zbatimit të rregullave dhe parimeve të konkurrencës në zbatim të dispozitave të kuadrit ligjor në fuqi. Komisioni Evropian në Progres Raportin për vitin 2020 shprehet se Shqipëria ka një nivel të caktuar përgatitjeje/e përgatitur në mënyrë të moderuar në politikën e konkurrencës. Ka pasur një progres përgjatë periudhës raportuese, në veçanti lidhur me fushën e zbatimit të rregullave të konkurrencës.

Disa nga prioritetet e vitit të ardhshëm në fushën e konkurrencës janë hartimi i disa udhëzimeve për të plotësuar kuadrin ligjor dytësor në fushën e konkurrencës, të tilla si Udhëzues lidhur me praktikën më të mira për dorëzimin e dokumentacionit ekonomik dhe mbledhjes së të dhënave si në rastet e zbatimit të neneve 4 dhe 9, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) edhe në rastet e përqendrimeve, Udhëzues mbi praktikën më të mira në rastet e zbatimit të procedurave të kontrollit të përqendrimeve etj.

Progres Raporti për vitin 2020, në përshkrimin e situatës në Shqipërisë për sa i përket politikës së konkurrencës, ka vijuar me dhënien e disa rekomandimeve drejtuar Komisionit të Ndihmës Shtetërore, të cilat kanë të bëjnë me:

Rriten e ndjeshme të kapaciteteve administrative të sekretariatit të KNSH-së (Komisioni i Ndihmës Shtetërore), e cila aktualisht ngre shqetësime serioze.

- Rritjen dhe sigurimin i pavarësisë operacionale të KNSH.

- Rritja e ndërgjegjësimit e KNSH me ministrinë e linjës, autoritetet rajonale dhe lokale për të siguruar njoftimin paraprak të masave të ndihmës si dhe forcimin e zbatimit të rregullave të ndihmës shtetërore.

Për më tepër në takimin e Komitetit të Stabilizim-asociimit të vitit 2019 është ritheksuar rekomandimi për pavarësinë, aftësinë administrative dhe rekordet e zbatimit të KNSH-së-shqipërisë i kërkohet të sigurojë dhe garantoj



pavarësinë operationale të KNSH-së, në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes së SA-së.

Shqipëria inkurajohet të sigurojë që KNSH-së të ndërtojë një rekord të fuqishëm zbatimi, i cili aktualisht është shumë i ulët. Parakushti për këtë qëllim është forcimi i kapaciteteve administrative të institucionit.

Strukturat e ndihmës shtetërore do të punojnë për:

Zbatimin e urdhrit të Kryeministrit nr. 128/2019, “Për ngritjen e grupit ndërmësor të punës për ndihmën shtetërore”,

Zbatimin e masave të parashikuara në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2019– 2022, objektivin “Forcimin e efektivitetit të Ndihmës Shtetërore”. Ky objektivi parashikohet të rrisë efikasitetin e vendimeve për shpenzimet publike, politikën fiskale si dhe transparencën e burimeve shtetërore;

Dhënien e këshillimit dhe mbështetjes për njoftimin e skemave të dhënësive të ndihmës (ministritë e linjës dhe autoriteteve rajonale dhe lokale) me qëllim kuptimin dhe zbatimin e rregullave të ndihmës shtetërore.

Në këtë kuadër Komisioni për Ndihmën Shtetërore për ndjekjen e rekomandime të sipërpërmendur si dhe institucionet e tjera pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integritetin Evropian, do të përpiqen që të sigurojnë që kuadri ligjor ekzistues i këtij kapitulli dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me *acquis* të BE dhe se do të sigurohet që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet në mënyrën e duhur.

Drafti përfundimtar i strategjisë MFP 2019–2022 përcakton objektivin e forcimit të efektivitetit të Ndihmës Shtetërore. Është gjithashtu e rëndësishme të zgjerohet roli i Komisionit për Ndihmën Shtetërore në këshillimin e ministrive të linjës dhe autoriteteve rajonale dhe lokale. Zbatimi rigoroz i rregullave të ndihmës shtetërore në projekte të mëdha që përfshijnë Shqipërinë dhe vendet e tjera duhet të monitorohet më nga afër si dhe ndërmjetësi midis dhënësve të ndihmave duhet të rritet për të siguruar njoftimin paraprak të masave të ndihmës në Komisioni për Ndihmën Shtetërore. Track rekordi i kontrollit të ndihmës shtetërore përmes këtyre masave synohet të rritet.

KAPITULLI 9 SHËRBIMET FINANCIARE

9.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis në fushën e shërbimeve financiare synon të garantojë konkurrencën e barabartë midis institucioneve financiare dhe stabilitetin e tyre financiar, veçanërisht në fushat e veprimtarisë bankare, sigurimeve, pensioneve suplementare, shërbimet e investimeve dhe tregjet e titujve. *Acquis* i këtij kapitulli përfshin rregulla mbi licencimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e këtyre institucioneve.

9.2 Struktura e kapitullit

- Bankat dhe konglomeratet financiare;
- Sigurimet dhe pensionet;
- Infrastruktura e tregut financiar.

9.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Përafrimi i kuadrit ligjor në fushën e shërbimeve financiare me *acquis*, lind si detyrim për përmbushjen e angazhimeve të marra në kuadër të zbatimit të neneve 50, 57, 70, 82 dhe 89 të MSA-së.

Acquis në fushën e shërbimeve financiare përmban rregulla për licencimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në fushat e veprimtarisë bankare, sigurimeve, pensioneve suplementare, shërbimet e investimeve dhe tregjet e titujve.

9.4 Situata aktuale në Shqipëri

Raporti i Progresit i vitit 2020 i Komisionit Evropian për Shqipërinë vuri në dukje se Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e shërbimeve financiare dhe është bërë njëfarë progresi në fushën e mbikëqyrjes bankare si dhe në përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit në lidhje me rimëkëmbjen e bankës dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme. Ka pasur progres të kufizuar në finalizimin e zbatimit të strategjisë së huave me probleme dhe nuk ka pasur përparim lidhur me ligjin në sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit.

Bankat dhe konglomeratet financiare

Për sa u përket bankave dhe konglomerateve financiare, Banka e Shqipërisë (BSH) ka vazhduar përafrimin e mëtejshëm të kuadrit rregullativ mbikëqyrës me kërkesat e Bazel II dhe Bazel III. Janë miratuar dhe rishikuar rregullore dhe udhëzime që synojnë harmonizimin e mëtejshëm me *acquis* përkatëse të BE-së lidhur me



mjaftueshmërinë e kapitalit, ekspozimet e mëdha, treguesin e levës financiare të bankave, administrimin e rrezikut të likuiditetit etj.

Në kuadër të përmbushjes së objektivave strategjikë për zbatimin e kërkesave të Bazel III dhe të përafrimit të mëtejshëm me kërkesat e rregulloreve evropiane dhe të dokumenteve të Komitetit të Bazelit, Banka e Shqipërisë shënoi progres në përafrimin e kërkesave të Direktivës Evropiane 2013/36/EU dhe të Rregullores Evropiane 575/2013/EU (CRR), si dhe të ndryshimeve më të fundit në këtë rregullore (CRR²¹) në kuadrin rregullativ mbikëqyrës respektivisht për mjaftueshmërinë e kapitalit (rreziku i kredisë) dhe për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave, ndërsa është punuar dhe për hartimin e rregullave të reja për raportin e levës financiare të bankave dhe për raportin neto të financimit të qëndrueshëm të bankave.

Përgjatë vitit 2020, cilësia e portofolit të kredisë e vlerësuar nëpërmjet treguesit *“Kredi me probleme/Totali i portofolit të kredive”* ka qenë e qëndrueshme. Në gusht 2020 treguesi i cilësisë së kredisë ra në nivelin 8.13%, nga 8.37% në fund të vitit 2019, duke konfirmuar tendencën rënëse të këtij treguesi krahasuar me një vit më parë. Megjithatë, për shkak të përhapjes së pandemisë COVID-19 përgjatë vitit 2020 dhe vështirësive me të cilat po përballlet ekonomia, pritshmëritë janë për një rritje të kredive me probleme.

Në kushtet e krijuara, Banka e Shqipërisë ka marrë të gjitha masat e nevojshme dhe mbetet tërësisht e angazhuar të monitorojë me kujdes ndikimet fundore të pandemisë, në nivelin e kapitalit dhe të përfitueshmërisë së bankave dhe në veçanti në portofolin e kredive. Ndërkohë, nëpërmjet komunikimit me industrinë bankare, janë përcjellë udhëzimet për monitorimin me kujdes të rrezikut të kredisë, subjekt i ristrukturimeve të mundshme si pasojë e pandemisë.

Në kuadër të forcimit të rezistencës së sektorit bankar ndaj rrezikut ciklik dhe strukturor dhe uljes së tyre, Banka e Shqipërisë ka aprovuar Rregulloren, *“Për Shtesat Makroprudenciale të Kapitalit”*, si dhe paketën e masave për të rritur

përdorimin e monedhës vendëse në aktivitetin bankar. Rregullorja, e cila është në përputhje me rekomandimet e Bordit Evropian të Rrezikut Sistemik dhe direktivat e BE-së, ofron një kornizë për implementimin e: a) shtesës konservuese e kapitalit; b) shtesës kundërciklike të kapitalit; c) shtesës së kapitalit për bankat me rëndësi sistematike dhe d) shtesës për rrezikun sistematik. Shuma e agreguar e këtyre shtesave përbën shtesën e kombinuar makroprudenciale të kapitalit (SHKOMAK).

Metodologjitë që përshkruajnë llogaritjen e nivelit të shtesës kundërciklike për Shqipërinë dhe llogaritjen e nivelit të rëndësisë sistematike dhe shtesat e kapitalit për bankat me rëndësi sistematike janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë. Shtesat makroprudenciale të kapitalit shpallen përmes vendimit të Guvernatorit.

Lidhur me ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, Banka e Shqipërisë ka realizuar miratimin e një sërë rregulloresh, duke bërë progres të mëtejshëm në plotësimin e kuadrit rregullator në fushën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka dhe në harmonizimin me legjislacionin dhe kërkesat e BE-së. Ky progres, gjatë vitit 2019, lidhet me miratimin nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë i rregullores, *“Për përcaktimin e nivelit të ushtrimit të kompetencave në Bankën e Shqipërisë për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”*, si dhe rregullores, *“Për vlerësimin për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”*.

Gjatë vitit 2020, Banka e Shqipërisë ka plotësuar më tej kuadrin rregullator të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke synuar përafrimin me standardet dhe kërkesat e BE-së, përmes hartimit të rregullores, *“Për operacionalizimin e instrumentit të rikapitalizimit nga brenda dhe rastet përjashtimore”*, rregullores, *“Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit për Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme”*, *“Disa ndryshime në rregulloren për fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”*, që lidhen me miradministrimin e tij, përgatitjen e projektregullores, *“Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”* si dhe projektit për disa ndryshime në rregulloren ekzistuese, *“Për planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”*.

Në kuadër të monitorimit të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, gjatë vitit 2020,

²¹ Ndryshuar me rregulloren e BE- së 2019/876/EU, të quajtur CRR2.



Banka e Shqipërisë ka përlogaritur nivelin e synuar të fondit dhe kontributin vjetor për secilën bankë.

Sigurimet dhe pensionet

Objektivi i AMF-së për të konsoliduar tregjet nën mbikëqyrje është pasqyruar në Strategjinë, “Për zhvillimin e AMF-së dhe të tregjeve nën mbikëqyrje 2018–2022”. Ky objektivi është, gjithashtu, i lidhur ngushtë me procesin e integritetit të vendit në Bashkimin Evropian.

Objektivi kryesor i AMF-së janë mbikëqyrja, monitorimi, promovimi dhe zhvillimi i tregjeve. Ky objektivi është adresuar në kornizën ligjore dhe rregullatore për tregjet nën mbikëqyrje duke garantuar qëndrueshmëri në mbrojtjen e konsumatorit.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare e vlerëson si një nga përparësitë e veprimtarisë së tij informimin dhe edukimin e vazhdueshëm të investitorit/konsumatorit për përfshirjen e tij në tregjet financiare. Edukimi financiar është gjithashtu i rëndësishëm për rritjen e besimit të konsumatorit në tregjet financiare nën mbikëqyrje dhe për të mbështetur stabilitetin financiar në vend.

Autoriteti hartoi strategjinë, “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje”, e cila u implementua gjatë periudhës 2017–2020. Me qëllim vijimin e punës në drejtim të edukimit financiar të konsumatorit/investitorit për tregjet nën mbikëqyrje, Autoritetit ka ngritur grupin e punës për Hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për “Edukimin Financiar” për periudhën 2021–2023.

Strategjia ka synim të propozojë iniciativa dhe aktivitete për t’u zhvilluar nga Autoriteti për të rritur informacionin e publikut dhe forcuar besueshmërinë e tij për tregjet nën mbikëqyrje.

Tashmë pas një eksperience të fituar, programet apo metodat e edukimit financiar do të hartohen për të përmbushur nevojat dhe nivelin e njohurive financiare të audiencës së synuar, si dhe do t’i përgjigjen mënyrës se si kjo audiencë preferon të informohet. Duke qenë një proces i vazhdueshëm, do të marrë parasysh zhvillimin dhe rritjen e kompleksitetit të tregjeve financiare nën mbikëqyrje, si dhe nevojat informuese në faza të ndryshme të zhvillimit të këtyre tregjeve.

Në funksion të mbrojtjes konsumatore, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka hartuar dhe publikuar në faqen zyrtare “Kartën e të drejtave të konsumatorit dhe investitorit në tregjet nën

mbikëqyrje”. Kjo Kartë përcakton të drejtat themelore që gëzon konsumatori dhe investitori në marrjen e shërbimeve në tregjet financiare nën mbikëqyrjen e Autoritetit, në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e AMF-së dhe ligjeve specifike, që rregullojnë secilin nga tregjet financiare jobankare.

AMF-ja monitoroi rregullisht situatën në kushtet e COVID-19 dhe vlerësoi ndikimin e kësaj situatë në sektorin financiar jobankar. Kriza COVID-19 nuk pati një ndikim të ndjeshëm në shërbimet financiare të ofruara nga tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së. Gjithashtu, ndikimi në shlyerjen e kuotave të fondeve të investimeve ishte i ulët. Në lidhje me tregun e sigurimeve, kishte vetëm një rënie të primeve të shkruara bruto të tregut të sigurimeve gjatë bllokimit të pandemisë, e cila është rikuperuar shumë shpejt pas heqjes së bllokimit.

Në përgjigje të COVID-19 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Shqiptare (AMF), me vendimin e Bordit nr. 94 datë 29.7.2020 nxori udhëzimin për subjektet nën mbikëqyrje në mënyrë që ata të marrin masa parandaluese për shkak të situatës pandemike.

Në këtë drejtim, subjekteve nën mbikëqyrje u kërkohet:

- të marrin masa për të siguruar vazhdimësinë e biznesit, përfshirë rreziqet e shkaktuara nga pandemia. Subjekteve të mbikëqyrura iu kërkua të raportojnë tek autoriteti planin e masave të marra prej tyre në përgjigje të COVID-19, si dhe të rishikojnë dhe përditësojnë planet e tyre aktuale të vazhdimësisë së biznesit dhe menaxhimit e rreziqut;

- të mbajnë një nivel adekuat të likuiditetit dhe të marrin masa të tjera të nevojshme për të ruajtur pozicionin e treguesve financiarë si dhe të informojnë menjëherë Autoritetin në rast të shkeljeve të këtyre treguesve;

- të shikojnë mundësinë e ndryshimit të marrëveshjeve të risigurimit, për të kufizuar ekspozimin ndaj COVID-19;

- të rishikojnë kushtet e kontratave të sigurimit, për të pasqyruar çdo ndryshim të ekspozimit ndaj rreziqut gjatë periudhës pandemike. Për produktet që lidhen me mbulimin në rast pandemie, të sqarojnë mbulimin e tyre në rastet kur ndodhin ngjarjet;



- të sigurojnë që informacioni i ofruar klientit në lidhje me të drejtat e tij kontraktuale të jetë i qartë, i mjaftueshëm dhe në kohë, duke orientuar edhe ndërmjetësit që veprojnë në emër të tyre në lidhje me këtë detyrim;

- të merren hapa për të përditësuar faqet zyrtare të internetit, me seksione të dedikuara në lidhje me ndikimin e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, duke pasqyruar masat e marra nga subjektet nën mbikëqyrje;

- të kryhet një vlerësim i produkteve, të cilat mund të preken nga pandemia duke informuar personat e siguruar;

- të përditësohen procedurat në lidhje me procesin e marrjes në sigurime pas COVID-19;

- të vazhdohet zbatimi i kërkesave rregullatore për administrimin e rrezikut nga subjektet e mbikëqyrura.

Me qëllim forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse në funksion të një mbikëqyrjeje efektive të këtij tregu, sipas metodologjisë me bazë rrezikun dhe përmirësimit të zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator, Autoriteti, përgjatë viteve në vijim, me asistencën teknike të Bankës Botërore do të zhvillojë projektin e ri (SECO II), të aprovuar në vitin 2019 me titull: “Përmirësimi i Kapaciteteve Mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, i cili do të ketë si fokus edhe tregun e sigurimeve.

Infrastruktura e tregut financiar

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) ka intensifikuar vazhdimisht përpjekjet e saj për të përmirësuar infrastrukturën dhe për të krijuar një bazë të nevojshme rregullatore për zhvillimin e qëndrueshëm të tregut financiar jobankar. Sipas angazhimeve në kuadrin e MSA-së, AMF ka vazhduar punën për përmirësimin dhe përafrimin e legjislacionit ekzistues me direktivat e BE-së.

Pavarësisht situatës pandemike, gjatë periudhës Prill- Maj 2020, Parlamenti Shqiptar miratoi tri ligje të rëndësishme në fushën e tregjeve të kapitalit dhe sektorit të fondeve të investimeve, të cilat përfshijnë:

- Ligji nr. 62/2020, “Për tregjet e kapitalit”, miratuar më 14.5.2020 dhe hyrë në fuqi më 1 shtator 2020.

- Ligji nr. 56/2020, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, miratuar më 30.4.2020 dhe hyri në fuqi më 20.6.2020.

- Ligji nr. 66/2020, “Për tregjet financiare bazuar në Teknologjinë e Regjistrave të Shpërndarë”, miratuar më 21.5.2020 dhe hyri në fuqi më 1.9.2020.

Kjo paketë ligjore kontribuon në zhvillimin e tregut shqiptar të kapitalit dhe integritetin e tij, duke pasur një ndikim të dukshëm sektorial dhe ekonomik, si dhe në diversifikimin e sistemit financiar shqiptar. Ligjet e miratuara parashikojnë një larmi të instrumenteve financiare, si dhe krijimin e llojeve të ndryshme të fondeve të investimeve. Gjithashtu, përfshirja e *Fintech* në kornizën e re ligjore do të rrisë produktivitetin dhe hyrjen në tregun e kapitalit duke futur Teknologjinë e Regjistrave të Shpërndarë në tregun shqiptar të kapitalit.

Miratimi i këtyre ligjeve rrit besueshmërinë e investitorëve në tregjet financiare përmes një mbrojtjeje më të mirë të interesave të tyre. Pritet që besimi në tregjet financiare të përkthehet në një kërkesë më të lartë për produkte investimi duke rritur në të njëjtën kohë burimet e financimit të kompanive shqiptare dhe aksesin e tyre në kapital.

Bursa Shqiptare e Titujve (ALSE) filloi veprimtarinë e saj në 22 shkurt 2018 me kufizimin për të tregtuar vetëm tituj të Qeverisë gjatë vitit të parë të veprimtarisë. Edhe pse ky kufizim është hequr që prej muajit shkurt të vitit 2019, titujt e Qeverisë janë i vetmi instrument financiar që tregtohen aktualisht në Bursë. Aktualisht 4 anëtarë tregtojnë në Bursën e Titujve për llogari të portofolit apo klientëve të tyre (3 banka dhe 1 shoqëri komisionare jo bankë). Volumi i tregtimit gjatë periudhës shkurt 2018–shtator 2020 arriti në rreth 25.2 milionë euro, nga të cilat 12.1 milionë euro ishte volumi i tregtimit për periudhën janar–dhjetor 2019 dhe 1.8 milionë euro volumi i tregtimit gjatë janar-shtator 2020, ku kanë dominuar transaksionet e kryera midis bankave, në emër të klientëve institucionalë të tyre.

Në fund të vitit 2019 shoqëria aksionare “Regjistri shqiptar i titujve” - ALREG u licencua nga Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Shqiptare (AMF) për kryerjen e funksionit të klerimit dhe shlyerjes të titujve që do të tregtohen në Bursë.

Krijimi i një institucioni të tillë, i cili luan rolin e një Depozitari Qendror të Titujve, është një hap i rëndësishëm drejt krijimit të infrastrukturës së plotë të tregut të kapitalit.



Ndërkohë ka nisur puna për hartimin e “Strategjisë për zhvillimin e tregut të kapitaleve”, me pjesëmarrjen e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Grupi i punës do të analizojë situatën aktuale të tregut të kapitaleve dhe do të hartojë një dokument strategjik 5-vjeçar, shoqëruar me një plan konkret veprimi, për përmbushjen e hapave të nevojshëm për zhvillimin e tregut të kapitaleve.

9.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Bankat dhe konglomeratet financiare

Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2020, ka vijuar punën për hartimin e akteve të reja nënligjore dhe për rishikimin e kuadrit rregullativ mbikëqyrës në fuqi, duke synuar përafrimin e mëtejshëm me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe standardet e Komitetit të Bazelit si dhe praktikën më të mira në fushën e rregullimit dhe mbikëqyrjes bankare, si dhe të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin për Bankën e Shqipërisë nga dokumentet strategjike të integritetit evropian të tilla si Marrëveshja e Stabilizim-asociimit, raportet vjetore të Komisionit Evropian dhe Nënkomitetet e përbashkëta BE-shqipëri.

Banka e Shqipërisë, në kuadër të përafrimit të vazhdueshëm me kërkesat e Bazelit III, gjatë vitit 2020:

- me vendimin nr. 7, datë 5.2.2020, miratoi disa ndryshime në rregulloren, “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, të cilat synojnë përafrimin e mëtejshëm me Rregulloren Evropiane 575/2013/EU (CRR);

- me vendimin nr. 53, datë 2.9.2020, miratoi disa ndryshime në rregulloren, “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”, të cilat synojnë përafrimin e mëtejshëm me Rregulloren Evropiane 575/2013/EU dhe me ndryshimet më të fundit të kësaj rregulloreje (CRR2);

- me vendimin nr. 54, datë 2.9.2020 miratoi ndryshimet në rregulloren, “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”, të cilat janë në përputhje me ndryshimet më të fundit në rregulloren, “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave” dhe në rregulloren, “Për kapitalin rregullator”;

- rregulloren, “Për raportin e levës financiare të bankave”, në përputhje me dispozitat e rregulloreve evropiane 2019/876/EU (CRR2) dhe të

dokumentit të Komitetit të Bazelit “*Leverage ratio–LEV 30 Exposure measurement, December 2019*”.

Në kuadër të hartimit të kërkesave rregullatore në zbatim të dispozitave të ligjit 133/2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”, që përafron direktivën 2014/59/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e cila përcakton kuadrin për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në institucionet e kreditit dhe firmat e investimeve, Këshilli Mbikëqyrës miratoi:

- rregulloren, “Për përcaktimin e kushteve për dhënien e miratimit paraprak për marrëveshjen e mbështetjes financiare brenda grupit bankar”;

- rregulloren, “Për përcaktimin e kushteve kur zbatohen masat e ndërhyrjes së hershme dhe për kushtet dhe mënyrën e kryerjes së administrimit të përkohshëm”;

- rregulloren, “Për krijimin, licencimin, mbikëqyrjen, funksionimin dhe përfundimin e veprimtarisë të bankës urë”, e cila është një rishikim tërësor (dhe me një emërtim të ri) i rregulloreve në fuqi, “Për krijimin, licencimin dhe funksionimin e bankës urë”;

- rregulloren, “Për operacionalizimin e instrumentit të rikapitalizimit nga brenda dhe rastet përjashtimore”, që transpozon Rregulloren e Deleguar të Komisionit (E) 2016/860, të datës 4 shkurt 2016;

- rregulloren, “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit për Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme”;

- disa ndryshime në rregulloren, “Për Fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij”.

Deri në fund të vitit 2020, parashikohet të realizohet miratimi i rregulloreve, “Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar - MREL”, e cila përafron pjesërisht direktivën 2019/879 (BRRD II), që amendon direktivën 2014/59/BE dhe rregulloren (BE) 2019/876 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 20 maj 2019.

Deri në fund të vitit 2020, pritet të realizohet harmonizim i mëtejshëm i kuadrit rregullator për ndërhyrjen e jashtëzakonshme. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë ka hartuar rregulloren, “Për kërkesat minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar - MREL”, e cila përafron pjesërisht direktivën 2019/879



(BRRD II) që amendon direktivën 2014/59/BE dhe Rregulloren (BE) 2019/876 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 20 maj 2019. Rregullorja është në proces konsultimi me bankat dhe planifikohet të paraqitet në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në muajin dhjetor 2020.

Politika makroprudenciale

Për herë të parë, bankat raportuan përmbushjen e shtesave makroprudenciale të kapitalit për periudhën raportuese “Mars 2020”. Nga ky raportim rezultoi se të gjitha bankat përmbushën plotësisht shtesën përkatëse të kombinuar makroprudenciale të kapitalit sipas kërkesës së përcaktuar për periudhën.

Për herë të parë, për tremujorin e parë të vitit 2019, Banka e Shqipërisë përgatiti raportin e brendshëm periodik gjashtëmujor “Zhvillimet në treguesit e hartës makroprudenciale”. Harta makroprudenciale përmban një listë të treguesve të zgjedhur për zhvillimin e rrezikut sistematik, së bashku me pragjet përkatëse të paralajmërimit.

Në kuadrin e strategjisë së deeuroizimit dhe për vlerësimin e ndikimit të masave përkatëse që janë marrë, Banka e Shqipërisë ka publikuar një raport gjashtëmujor, i cili monitoron ecurinë e disa treguesve financiarë që pasqyrojnë nivelin e euroizimit.

Banka e Shqipërisë, në zbatim të rekomandimeve të ekspertëve të Moneyval, ka miratuar edhe disa ndryshime të tjera rregullative në kuadrin rregullativ mbikëqyrës, si dhe ka rritur efektivitetin e procesit mbikëqyrës, të cilat referohen në detaje në kapitullin 4 – Lëvizja e lirë e kapitalit.

Në përgjigje të situatës së krijuar në vend për shkak të pandemisë COVID-19, Banka e Shqipërisë ndërmori masa të menjëhershme për të zbutur ndikimet negative në ekonominë shqiptare në tërësi, si dhe në veçanti për individët, bizneset dhe institucionet financiare të licencuara dhe të mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë.

Në mars 2020, sipas urdhrit të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë dhe Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, të gjitha bankat dhe institucionet financiare jobanka, përfshirë edhe shoqëritë e kursim- kreditit, ofruan mundësinë për pezullimin e pagesave, për të gjithë klientët e prekur ekonomikisht dhe financiarisht nga COVID-19, që aplikuan për të përfutur nga lehtësia e parashikuar

për të shtyrë me tre muaj pagesën e kësteve. Në fund të muajit maj 2020, për të gjitha bankat efekti i urdhrit u zgjat edhe për tre muaj të tjerë, deri në fund të muajit gusht 2020.

Përveç masave të mësipërme, Banka e Shqipërisë ka miratuar disa ndryshime rregullative, me efekt deri në fund të vitit, kryesisht të lidhura me klasifikimin dhe ristrukturimin e kredive, që do t'u siguronin bankave kohën e nevojshme, por të kufizuar, për të administruar efektin e pandemisë në portofolin e tyre të kredisë dhe për të vlerësuar cilësinë e aktiveve të tyre.

Për periudhën mars–dhjetor 2020, Banka e Shqipërisë ka pezulluar shpërndarjen e dividendit nga bankat dhe ka kërkuar prej tyre: i. të kufizojnë dhe administrojnë me efikasitet shpenzimet administrative dhe ii. të vlerësojnë në mënyrë të kujdesshme dhe konservative, shpërblimet vjetore për të gjithë pozicionet drejtuese. Masa të tilla synojnë të ofrojnë mbështetje për bankat, kryesisht përmes forcimit të kapacitetit të tyre për të thithur humbjet e mundshme dhe për të mbështetur kreditimin e individëve dhe bizneseve gjatë kësaj periudhe.

Me gjithë ndërhyrjet rregullative, Banka e Shqipërisë ka monitoruar dhe kontrolluar situatën, nëpërmjet udhëzimeve për bankat dhe duke vendosur, në të njëjtën kohë, komunikim të ngushtë dhe duke ndarë informacionin me bankat, përmes kërkesave të shtuara të raportimit²².

Sigurimet dhe pensionet

Në fushën e shërbimeve financiare jobankare janë thelluar përpjekjet dhe është bërë progres në përafrimin e legjislacionit të tregut të sigurimeve me legjislacionin evropian. Kështu Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare gjatë vitit 2020 konsolidoi punën për hartimin dhe rishikimin e kuadrit ligjor rregullator e mbikëqyrës me qëllim përafrimin e mëtejshëm të tij me *acquis* e Bashkimit Evropian në fushën e tregut financiar jobankar, në zbatim të nenit 89 të MSA-së, rekomandimeve të Raportit të

²² Përveç anketimeve të kryera, fushat e raportimit të Regjistrimit të Kredive u rishikuan duke përfshirë informacione për kreditë nën moratorium dhe kreditë e garantuara nga qeveria. Formate të tjera raportimi janë përgatitur nga Banka e Shqipërisë, që lejojnë matjen e performancës së portofolit të prekur nga pamundësia e ripagimit për shkak të situatës. Ky informacion raportohet në baza mujore dhe monitorohet rregullisht nga Banka e Shqipërisë.



Progresit të Komisionit Evropian 2019, me synim përmirësimin e mëtejshëm të këtij tregu, forcimin e mbikëqyrjes dhe të kapaciteteve institucionale.

AMF-ja hartoi projektligjin, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, në zbatim të MSA-së, rekomandimeve të Progres Raporteve, si dhe rekomandimeve të dhëna nga misioni i përbashkët FMN dhe Banka Botërore në kuadër të programit të vlerësimit të sektorit financiar (FSAP). Me këtë projektligj synohet përafrim i pjesshëm me Direktivën 2009/103/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 shtator 2009, për sigurimin e përgjegjësisë civile në lidhje me përdorimin e mjeteve motorike dhe për zbatimin me forcë të detyrimit për të marrë një sigurim të tillë.

AMF-ja shqyrtoi komentet dhe sugjerimet e bëra nga Ministritë, Shoqata e Siguruesve dhe Banka Botërore lidhur me këtë projektligj.

Projektligji është dërguar nga Autoriteti në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të vazhduar procesin e miratimit.

AMF-ja do hartojë “Ndryshimet e ligjit nr. 10197, të datës 10.12.2009, “Për fondet e pensionit vullnetar”. Ndryshimet në ligj synojnë përafrimin me direktivën 2016/2341/BE të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës e 14 dhjetor 2016 “Mbi aktivitetet dhe mbikëqyrjen e institucioneve për dhënien e pensioneve profesionale”(IORP).

Infrastruktura e tregut financiar

AMF-ja ka vazhduar punën për përmirësimin e bazës rregullatore për sipërmarrjet e investimeve investimeve dhe tregjeve të kapitalit.

Aktualisht janë miratuar dy ligje që ishin parashikuar në tremujorin e tretë të PKIE 2020.

Ligji nr. 56/2020, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” u miratua nga Parlamenti në 30.4.2020 dhe hyri në fuqi më 20.6.2020.

Ligji nr. 56/2020, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” është përputhur me direktivat - Direktiva 2009/65/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 korrik 2009, “Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative që lidhen me sipërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm (SIKTI)” dhe direktiva 2011/61/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 8 qershor 2011, “Për administruesit e fondeve alternative të investimit” dhe që ndryshon direktivat 2003/41/KE dhe

2009/65/KE dhe rregulloret(KE) nr. 1060/2009 dhe (BE) nr. 1095/2010.

Ky ligj pritet t'i japë hov zhvillimit të mëtejshëm të këtij tregu dhe merr në konsideratë një mbikëqyrje më efektive dhe vendosjen e standardeve më të larta për një treg transparent dhe të mirërregulluar.

Në zbatim të ligjit nr. 56/2020, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, po punohet për hartimin e rregulloreve.

Ligji nr. 62/2020, “Për tregjet e kapitalit”, u miratua nga Parlamenti në 14.5.2020. Ky ligj hyri në fuqi në 1.9.2020.

Ligji nr. 62/2020, “Për tregjet e kapitalit” është përafruar me direktivat- direktiva 2014/65/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 maj 2014 mbi tregjet e instrumenteve financiare dhe duke ndryshuar direktivën 2002/92/KE dhe direktivën 2011/61/BE (MiFID II); direktiva 2004/109/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 dhjetor 2004, “Për harmonizimin e kërkesave për transparencë, në lidhje me informacionin rreth emetuesve, titujt e të cilëve janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar dhe që ndryshon direktivën 2001/34/KE”; direktiva 2014/57/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 prill 2014, “Për sanksionet penale për abuzimin e tregut”; rregullorja (BE) nr. 600/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 maj 2014 mbi tregjet e instrumenteve financiare dhe që ndryshon rregulloren (BE) nr. 648/2012 (MiFIR); rregullorja (BE) nr. 909/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 korrikut 2014 për përmirësimin e shlyerjes së letrave me vlerë në Bashkimin Evropian dhe depozitarëve qendrorë të letrave me vlerë dhe që ndryshon direktivën 98/26/KE dhe direktivën 2014/65/BE; Rregullorja (BE) 2017/1129 mbi prospektin që do të publikohet kur letrat me vlerë ofrohen për publikun ose pranohen për tregtim në një treg të rregulluar, që shfuqizon direktivën 2003/71/KE; rregullorja (BE) nr. 462/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 21 majit 2013 për ndryshimin e Rregullores (KE) nr. 1060/2009 për agjencitë e vlerësimit të kreditit.

Ligji synon t'u përgjigjet zhvillimeve të reja të tregut të kapitalit si dhe të kontribuojë në zhvillimin dhe integritetin e tregut të kapitalit.

Në zbatim të ligjit nr. 62/2020, “Për tregjet e kapitalit”, po punohet për hartimin e rregulloreve.



Ligji nr. 66/2020, “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë” u miratua nga Parlamenti në 21.5.2020. Ky ligj hyri në fuqi në 1 shtator 2020.

Ky ligj prezantoi konceptin *Fintech* në një përpjekje për të zhvilluar tregjet e kapitalit. Teknologjitë e Regjistrave të Shpërndarë në tregun shqiptar të kapitalit përfshijnë gjithashtu *Blockchain* si një formë specifike e një teknologjie të tillë.

Në zbatim të ligjit nr. 66/2020 po punohet për hartimin e rregulloreve.

Projekti “Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi te zhvillimi i tregut të kapitaleve” (SECO II) synon të mbështesë AMF-në në forcimin e kapaciteteve të saj në rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregut të kapitalit, si dhe të rrisë e zhvillojë tregun e kapitalit dhe produktet e tij përmes rritjes së vetëdijes dhe edukimit financiar dhe stimulimit të inovacionit financiar.

9.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
- Banka e Shqipërisë;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Instituti i Statistikave (INSTAT);
- Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD).

9.7 Prioritetet

Prioritetet e Bankës së Shqipërisë janë si më poshtë:

- përafrimi i kuadrit rregullator e metodologjik me legjislacionin e Bashkimit Evropian, përshtatja e parimeve të Komitetit të Bazelit dhe adresimi i problematikave të vërejtura dhe sugjerimeve të paraqitura nga ana e subjekteve të mbikëqyrura;

- konsolidimi i mëtejshëm i mbikëqyrjes së bazuar në rrezik;

- plotësimi dhe përafrimi i kuadrit rregullator dhe metodologjik për ndërhyrjen e jashtëzakonshme me legjislacionin e Bashkimit Evropian;

Prioritetet e AMF-së janë:

- Zbatimi i ligjit nr. 56/2020, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”;

- Zbatimi i ligjit nr. 62/2020, “Për Tregjet e Kapitalit”;

- Miratimi i projektligjit, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”;

- Hartimi i projekt- amendamenteve të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009, “Për fondet e pensionit vullnetar”;

Faqe | 4066

- Draftimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjeve të reja;

- Digjitalizimi dhe modernizimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit;

- Mbikëqyrja efektive dhe zhvillimi i mëtejshëm i tregjeve;

- Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator;

- Nxitja e besueshmërisë së konsumatorit, nëpërmjet stabilizimit të tregut dhe edukimi financiar;

- Promovimi i tregjeve, nxitja e transparencës dhe besueshmërisë në tregjet financiare;

- Ngritja e kapaciteteve për mbikëqyrjen e grupeve financiare dhe zhvillimin e mbikëqyrjes së konsoliduar;

- Ndërtimin e një mekanizmi për mbrojtjen e konsumatorëve ndaj falimenteve dhe daljeve nga tregu të operatorëve;

Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare janë institucione të pavarura të cilat financohet nga të ardhurat e veta dhe jo nga Buxheti i Shtetit.

KAPITULLI 10

SHOQËRIA E INFORMACIONIT DHE MEDIA

10.1 Përmbajtja e kapitullit

Ky kapitull përmban rregulla specifike për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, shërbimet e shoqërisë së informacionit, në veçanti tregtinë elektronike, shërbimet e aksesit të kushtëzuar, dhe shërbimet audiovizive. *Acquis* e Bashkimit Evropian, synon të eliminojë pengesat për funksionimin efektiv të tregut të brendshëm në shërbimet dhe rrjetet e komunikimeve elektronike, tregtinë elektronike dhe shërbimet audiovizive. Gjithashtu, synon të promovojë konkurrencën dhe të mbrojë interesat e konsumatorit, duke mbështetur qasjen universale ndaj shërbimeve moderne.

Sa i përket politikës audiovizive, *acquis* synon krijimin e një kornize rregullatore transparente, të parashikueshme dhe efektive për transmetimin publik dhe privat në përputhje me standardet evropiane.

10.2 Struktura e kapitullit

- Kapitulli 10, shoqëria e informacionit dhe media përbëhet nga tri fusha bazë si më poshtë:

- Komunikimet elektronike;



- Shërbimet e shoqërisë së informacionit;
- Politika audiovizuale.

10.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Nenet 102–104 të Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit parashikojnë detyrimin për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me *acquis* të BE-së dhe harmonizimin me politikat e BE-së. Neni 102 i MSA-së parashikon bashkëpunimin në fushën audio- vizuale. Kjo përfshin një detyrim që Shqipëria të harmonizojë politikat e saj në rregullimin e aspekteve të përmbajtjes së transmetimit ndërkufitar me standardet dhe legjislacionin e BE-së. Gjithashtu kërkon që vëmendje e veçantë t'i kushtohet respektimit të të drejtave të pronësisë intelektuale në transmetimin e programeve me mjete të ndryshme, përfshirë tokësore, satelitore, kablllore etj. Ndryshimet e shpejta në teknologjinë e mediave, realitetin aktual të televizionit digjital në Shqipëri dhe përditësimin e legjislacionit me standardet dhe praktikën më të mira evropiane në këtë fushë kanë shërbyer si një nxitje e fuqishme për të ndërmarrë hapat e duhur në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm dhe një vizioni afatgjatë të qasjeve rregullatore. Neni 103 i MSA-së mbulon bashkëpunimin në fushën e shoqërisë së informacionit. Neni 104 i Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit merret me bashkëpunimin që fokusohet në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.

Pjesa kryesore e *acquis* në fushën e komunikimeve elektronike përbëhet nga kodi i komunikimeve elektronike të BE-së, direktiva 2018/1972/EU e miratuar në dhjetor 2018, e cila ka zëvendësuar paketën e direktivave të komunikimeve elektronike të vitit 2002 dhe 2009. Kodi përfshin masa për nxitjen e investimeve në rrjetet e kapaciteteve shumë të larta, rregulla të reja për spektrin e frekuencave dhe rrjetet celulare 5G, ndryshime në regjimin e shërbimit universal, rregulla për mbrojtjen e konsumatorit, numeracionin dhe komunikimet e emergjencave. Përveç Rregullores së re të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave të Përgjithshme që hyri në fuqi në Maj 2018, rregullat e e-privatësisë në komunikimet elektronike janë duke ndryshuar. Pjesë e rëndësishme legjislative është gjithashtu Direktiva për sigurinë e sistemeve të rrjetit dhe informacionit.

Në fushën e politikës audiovizuale, pjesa kryesore legjislative është Direktiva 2010/13/BE

për shërbimet audiovizive dhe audiovizuale që mbulon transmetimet televizive tradicionale dhe shërbimet mediatike audiovizuale në kërkesë dhe vendos një sërë rregullash minimale për të dyja llojet e shërbimeve. Më datë 6 nëntor 2018, Këshilli i BE-së ka miratuar ndryshimet në Direktivën 2010/13/BE për shërbimet audiovizive. Këto ndryshime përfshijnë disa rregullime të reja që synojnë mbrojtjen më të mirë të minorenëve; rregulla të reja për platformat *online*, promovimin e punëve evropiane etj.

10.4 Situata aktuale në Shqipëri/ përmbledhje

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur për anëtarësim në Bashkimin Evropian për sa i përket shoqërisë së informacionit dhe medias audio-vizuale. Në vitet e fundit, Shqipëria ka bërë disa përparime në përafrimin e legjislacionit të saj për komunikimet elektronike me rregullat e BE-së. Miratimi i ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” shënoi një hap të rëndësishëm, duke arritur liberalizimin e plotë të tregut të telekomunikacioneve dhe reformimin e sistemit të licencimit bazuar në paketën e direktivave të viteve 2002 dhe 2009. Në veçanti, ky ligj eliminoi pengesat për sipërmarrësit ndaj hyrjes në tregun shqiptar të komunikimeve elektronike si edhe siguroi:

- të drejtën e çdo sipërmarrësi për të ofruar rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike, për të përmbushur kërkesat e autorizimit të përgjithshëm si edhe ato të autorizimit individuale të nevojshme vetëm në rastin e përdorimit të burimeve të fundme (frekuenca dhe numra);

- një mjedis rregullator të përshtatshëm, që respekton parimin e paanshmërisë teknologjike;

- futjen në treg të “lojtarëve” të rinj pa kërkuar përdorimin e burimeve të fundme, çka realizohet me procedura të thjeshta dhe të shpejta, pa qenë nevoja e ndonjë vendimi specifik paraprak;

- dhënien e të drejtave të përdorimit burimeve të kufizuara përmes procedurave transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale.

E ndërgjegjshme për rolin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në zhvillimin e shoqërisë dhe rritjen ekonomike, në promovimin e pjesëmarrjes përfshirëse dhe qeverisjes efikase, në respektimin dhe kontributin që jep në përmbushjen e parimeve bazë që



shërbejnë për demokraci cilësore, shtet ligjor funksional si dhe përfaqësim politik transparent, qeveria shqiptare ka ndërmarrë një sërë reformash për zhvillimin e shoqërisë së informacionit. Në përmbushje të angazhimeve të MSA-së që rrjedhin nga nenet 102, 103 dhe 104 të saj është punuar për planifikimin dhe implementimin e politikave në fushën e telekomunikacioneve dhe shoqërisë së informacionit. Strategjia ndërsektoriale për agjendën digjitale 2015–2020, e miratuar në prill 2015, përbën një dokument strategjik për zhvillimet në të ardhmen në Shqipëri në drejtim të një ekonomie të bazuar në njohuri. Strategjia mbulon një sërë aspektesh për zhvillimin e TIK-ut në sektorë të ndryshëm si dhe përfshin objektiva dhe aktivitete për përmirësimin e shërbimeve publike dhe *e-Shërbimeve*.

10.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Në fushën e komunikimeve elektronike, me anë të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 434, datë 3.6.2020, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale *Broadband* 2020–2025” është miratuar Plani i ri Kombëtar *Broadband*.

Me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 636 datë 29.7.2020, “Për miratimin e programit shumëvjeçar të politikës spektrale dhe plani i veprimit” është miratuar dokumenti i politikës spektrale i cili ka bërë transpozimin e vendimit të BE-së 243/2012/EU për miratimin e një programi shumëvjeçar për spektrën radio.

Gjatë vitit 2018 u amendua ligji për komunikimet elektronike për t’i hapur rrugë rregullimit të tarifave të *roaming*-ut nga AKEP mbi bazën e marrëveshjeve bilaterale, multilaterale. Në 1 korrik 2019, filloi zbatimi i marrëveshjes rajonale për *roaming* si në shtëpi. Në 2020, filloi faza e dytë e aplikimit të marrëveshjes rajonale të *roaming*-ut dhe më 1 korrik 2021 pritet zbatimi i plotë i *roaming* si në shtëpi. Gjatë vitit 2019 u dhanë dy autorizimet individuale në brezin 800 MHz, digjital dividend 1, që u lirua nga shërbimet televizive për mobile *broadband*. Me vendimin e politikës spektrale të miratuar me VKM-në nr. 636 datë 29.7.2020, “Për miratimin e programit shumëvjeçar të politikës spektrale dhe plani i veprimit” është përcaktuar afati për lirimin e digjital dividend 2, më 30 qershor 2022, sipas afatit maksimal në BE.

Në fushën e shoqërisë së informacionit ka progres në digjitalizimin dhe zhvillimin e

shërbimeve elektronike. Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit është fuqizuar. Zbatimi i agjendës digjitale të Shqipërisë dhe planit kombëtar për zhvillimin e *broadband* vazhdon. Shërbimet elektronike të ofruara institucioneve publike dhe qytetarëve janë rritur.

Mbi bazën e praktikës së BE-së, është hartuar Strategjia për 5G për Shqipërinë dhe është në proces rishikimi. Gjithashtu, po vijon puna për transpozimin e direktivës së re të Kodit të Komunikimeve Elektronike EECC (Direktiva 2018/1972/EU).

Në lidhje me direktivën 2013/37/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 26 qershor 2013, që amendon direktivën 2003/98/EC mbi ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, është përfunduar paketa për miratimin e Projektligjit për të dhënat e hapura dhe ripërdorim dhe me anë të vendimit të KM-së nr. 796, datë 12.10.2020, projektligji, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, është dërguar për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Shqipërisë.

Në fushën e medias ka vijuar puna për finalizimin e procesit të *switchover*-it dhe kalimit të plotë në transmetime numerike, për të adresuar rekomandimin nga raporti i progresit i KE për Shqipërinë në vitin 2019 për kalimin nga transmetimi analog në digjital. Në zbatim të ligjit 97/2013 dhe në përmbushje të detyrave të përcaktuara në strategjinë për kalimin nga transmetimet analoge në transmetimet numerike, AMA ka vijuar të ndjekë me prioritet procesin e digjitalizimit të transmetimeve audiovizive në vendin tonë.

AMA ka zhvilluar një sërë aktivitete në kuadër të këtij procesi me qëllim finalizimin e tij brenda vitit 2020. Për pasojë, transmetimet analoge janë mbyllur në të gjitha qarqet e vendit. Në 30 dhjetor 2020 transmetimet analoge u mbyllën edhe në tri qarqet e mbetura, duke bërë të mundur që procesi i digjitalizimit të përfundojë plotësisht në të gjithë vendin.

- Aktualisht, transmetimet televizive digjitale janë të aksesueshme në të gjithë territorin, të cilat sigurojnë cilësi të lartë dhe një numër të madh të programeve televizive pa pagesë.

- Autoriteti i Medias Audiovizive ka miratuar më 14 tetor 2020, dokumentin strategjik dhe planin e tij të veprimit për 2020–2022, duke përcaktuar



objektivat dhe prioritetet e punës së AMA-s në periudhën 2020–2022.

- Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) ka kryer një analizë vlerësimi për sigurinë kibernetike në Shqipëri sipas modelit *Cyber Maturity Model (CMM)* në kuadër të programit të Bankës Botërore për ndërtimin e kapaciteteve globale për sigurinë kibernetike. Raporti mbi nivelin e maturisë së Shqipërisë për sigurinë kibernetike është publikuar nga AKCESK në 1 mars 2019.²³ AKCESK ka hartuar draftin e strategjisë për sigurinë kibernetike i cili u miratua nga Këshilli i Ministrave me VKM-në nr. 1084, datë 24.12.2020, “Mbi miratimin e Strategjisë Kombëtare për sigurinë kibernetike dhe planin e veprimit 2020–2025”. Gjithashtu është miratuar VKM nr. 553, datë 15.7.2020, “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”.

10.6 Lista e ministrive dhe institucionet përgjegjëse

- Institucioni përgjegjës për kapitullin 10 është Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës (MIE).
- Institucione të tjera kontribuuese janë:
- Ministria e Brendshme;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Kuvendi i Shqipërisë;
- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP);
- Autoriteti Audiovizual i Medias (AMA);
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Instituti i Statistikave;
- Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI);
- Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK);
- Radio Televizioni Shqiptar

10.7 Prioritet

Prioritetet normative afatshkurtra dhe afatmesme përfshijnë adresimin e rekomandimeve të BE-së për përafrimin e mëtejshëm me *acquis* të BE-së të kapitullit 10, në përputhje me zhvillimet e *acquis* të BE-së dhe Agjendën Digjitale.

Prioritetet në Kapitullin 10 synojnë zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Komisionit 2020:

- miratimi i ndryshimeve në Ligjin për komunikimet elektronike në përputhje me Kodin e Komunikimeve Elektronike të BE. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare do të punojnë për transpozimin e Kodit të Komunikimeve Elektronike të BE-së;
- finalizimi dhe miratimi i strategjisë kombëtare për sigurinë kibernetike;
- hartimi i strategjisë për aftësitë digjitale;
- hartimi i dokumentit të ri të agjendës digjitale.

KAPITULLI 11

BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

11.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli 11 i bujqësisë përmban një numër të madh të rregullave të detyrueshme, shumë prej të cilave janë drejtpërdrejt të zbatueshme. Zbatimi i duhur i këtyre rregullave dhe kontrolli efektiv nga një administratë publike efikase janë thelbësore për funksionimin e politikës së përbashkët bujqësore (PPB). Politika e PPB-së kërkon ngritjen e sistemeve të menaxhimit dhe cilësisë të tilla si agjencia e pagesave, sistemi i integruar dhe i kontrollit të pagesave (IACS), dhe kapaciteti për të zbatuar masat e zhvillimit rural. Shtetet anëtare duhet të jenë në gjendje të zbatojnë legjislacionin e BE-së për skemat e mbështetjes direkte të fermave dhe për zbatimin e dispozitave për organizimin e përbashkët të tregut për produkte të ndryshme bujqësore.

Anëtarësimi në BE kërkon integrimin në Organizimin e Tregut të Përbashkët për një sërë produktesh bujqësore, përfshirë bimët e arave, sheqerin, produktet me origjinë shtazore dhe bimë të specializuara. Rregullat e CMO-së janë veçanërisht komplekse. CMO mbulon 21 produkte/grup produktesh bujqësore. Kjo rregullore ka një aspekt të brendshëm që mbulon ndërhyrjen në treg dhe rregullat e marketingut dhe organizatave të prodhuesve dhe një aspekt të jashtëm që mbulon tregtinë me vendet e treta.

Ky kapitulli gjithashtu përfshin legjislacionin për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe treguesit gjeografikë dhe specialitetet tradicionale për produktet bujqësore dhe ato ushqimore dhe kontrollin e kësaj mbrojtje; rregullat për bujqësinë



organike dhe kontrollin e inspektimin; ndihmat shtetërore në bujqësi; dhe krijimi dhe funksionimi i një sistemi për rrjetin e të dhënave të kontabilitetit në fermë, i cili është një mjet shumë i rëndësishëm për formimin e PPB.

Zbatimi, menaxhimi dhe kontrolli i Politikave të Përbashkëta Bujqësore (CAP) kërkojnë krijimin, modifikimin dhe/ose përforcimin e strukturave të përshtatshme administrative. Në disa raste, *acquis* paraqet specifikime të hollësishme për strukturat e kërkuara administrative. Në shumë raste, *acquis* thjesht përdor terma, të tillë si “autoriteti kompetent” për t’iu referuar strukturës administrative që është e nevojshme. Kjo do të thotë se i mbetet çdo shteti anëtar të vendosë se cili institucion është përgjegjës për zbatimin efektiv të *acquis*. Megjithatë, funksionet që shtetet anëtare të BE-së duhet të kryejnë përmes strukturave administrative që ato krijojnë janë të përcaktuara qartë në *acquis*.

11.2 Struktura e kapitullit

- organizimi i tregut të përbashkët;
- zhvillimi rural;
- prodhimi organik;
- politikat e cilësisë.

11.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Sipas nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë legjislacionin e saj kombëtar me *acquis* e Bashkimit Evropian.

Bashkëpunimi në fushën e bujqësisë dhe sektorit agroindustrial midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian është parashikuar në nenin 96 të MSA-së. Neni 96 përcakton se fokusi duhet të jetë në fushat prioritare që lidhen me *acquis* të Komunitetit në fushën e bujqësisë.

Bashkëpunimi do të synojë në mënyrë të veçantë modernizimin dhe ristrukturimin e sektorit bujqësor dhe sektorit agroindustrial shqiptar dhe mbështetjen e përafrimit gradual të legjislacionit dhe praktikave shqiptare me rregullat dhe standardet e Komunitetit.

Në lidhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian, politikat e bujqësisë janë pjesë e grupit të dytë të kompetencave të Bashkimit Evropian. Neni 4 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian përcakton se në këtë rast, Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare kanë të

drejtë të miratojnë akte ligjore. Shtetet anëtare mund të ushtrojnë kompetencat e tyre në rast se Bashkimi Evropian nuk i shtron kompetencat e tij ose ka vendosur që të mos i ushtrojë këto kompetenca.

Acquis e bujqësisë dhe zhvillimit rural përmban një numër të madh të rregullave të detyrueshme, shumë prej të cilave janë drejtpërdrejt të zbatueshme. Zbatimi i duhur i këtyre rregullave dhe kontrolli efektiv nga një administratë publike efikase janë thelbësore për funksionimin e politikës së përbashkët bujqësore. Kjo kërkon ngritjen e agjencisë së pagesave dhe sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të pagesave, të tilla si sistemi i integruar i administrimit dhe kontrollit, dhe kapaciteti për të zbatuar programet e zhvillimit rural. Shtetet anëtare duhet të jenë në gjendje të zbatojnë legjislacionin e BE-së për skemat e mbështetjes direkte të fermave dhe për zbatimin e dispozitave për organizimin e përbashkët të tregut për produkte të ndryshme bujqësore.

Zbatimi, menaxhimi dhe kontrolli i Politikave të Përbashkëta Bujqësore (PPB) kërkon krijimin, modifikimin dhe/ose përforcimin e strukturave të përshtatshme administrative. Në disa raste, *acquis* paraqet specifikime të hollësishme për strukturat e kërkuara administrative. Në shumë raste, *acquis* thjesht përdor terma, të tillë si “autoriteti kompetent” për t’iu referuar strukturës administrative që është e nevojshme. Kjo do të thotë se i mbetet çdo Shteti Anëtar të vendosë se cili institucion është përgjegjës për zbatimin efektiv të *acquis*. Megjithatë, funksionet që shtetet anëtare të BE-së duhet të kryejnë përmes strukturave administrative që ato krijojnë janë të përcaktuara qartë në *acquis*.

Duke ndjekur reformën e Politikës së Përbashkët Bujqësore pjesët kryesore të *acquis* të BE-së janë:

- Rregullorja (BE) nr. 1305/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 17 dhjetor 2013 në mbështetjen e zhvillimit rural nga Fondi Evropian Bujqësor për Zhvillim Rural (EAFRD) dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1698/2005;

- Rregullorja (BE) nr. 1306/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 17 dhjetor 2013 mbi financimin, menaxhimin dhe monitorimin e politikës së përbashkët bujqësore;



- Rregullorja (BE) nr. 1307/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 17 dhjetor 2013 në vendosjen e rregullave për pagesat direkte për fermerët nën skemat e mbështetjes në kuadër të politikës së përbashkët bujqësore dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 637/2008 dhe Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 73/2009 mbi financimin, menaxhimin dhe monitorimin e politikës së përbashkët bujqësore dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 352/78, (KE) nr. 165/94, (KE) Nr. 2799/98, (KE) nr. 814/2000, (KE) nr. 1290/2005 dhe (KE) nr. 485/2008;

- Rregullorja (BE) nr. 1308/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 17 dhjetor 2013 në krijimin e një organizate të përbashkët të tregjeve të produkteve bujqësore dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 922/72, (KEE) nr. 234/79, (KE) nr. 1037/2001 dhe (KE) nr. 1234/2007;

- Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 889/2008 e 5 shtatorit 2008 që përcakton rregulla të hollësishme për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 834/2007 mbi prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike në lidhje me prodhimin organik, etiketimin dhe kontrollin;

- Rregullorja (BE) nr. 1151/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 nëntor 2012 mbi skemat e cilësisë dhe artikujt ushqimorë për produkteve bujqësore.

11.4 Situata aktuale në Shqipëri

Shqipëria ka arritur njëfarë niveli përgatitjeje në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Ka pasur disa përparime në miratimin dhe zbatimin e kuadrit të ri ligjor në fushën e politikave të cilësisë, duke siguruar kapacitetet administrative për zbatimin e programit të instrumentit të asistencës së parazgjerimit për zhvillimin rural (IPARD II). Shqipëria paraqiti një masë të re “Asistenca teknike” për dhënien e besimit.

Autoriteti Menaxhues dhe Agjencia IPARD, gjatë periudhës 15–29 tetor 2019, organizuan fushatën informuese për thirrjen e dytë për aplikime në kuadër të Programit IPARD II, në 12 rajone të Shqipërisë.

Të dyja strukturat operative, si në thirrjen e parë për aplikime, përgatitën një seri dokumentesh të cilat u prezantuan në fushatën informuese dhe u botuan në faqet e internetit të MARD-së dhe Agjencisë IPARD siç janë: udhëzimet për aplikantët me të gjitha anekset, Plani i veprimtërisë që

detajon datat e fushatës informative, objektivi i pjesëmarrjes, përfshirja e specialistëve të zgjerimit në fushatën informative dhe përgjegjësitë e tjera që duhet të kryhen gjatë zbatimit të thirrjes së dytë për aplikim etj.

Fushata informuese u implementua nga Autoriteti Menaxhues dhe Agjencia e Pagesave duke përdorur të gjitha mediat në nivelin e duhur territorial. Spote televizive u transmetuan në stacione televizive duke siguruar informacione të përgjithshme në lidhje me masat IPARD II për ndërgjegjësimin dhe për përfituesit e mundshëm.

IPARD II:

Ka pasur dy thirrje të hapura nën IPARD II:

- thirrja e parë me 317 aplikime totale, nga të cilat janë kontraktuar 133 aplikime, si dhe 55 janë investime të përfunduara;

- thirrja e dytë në 371 aplikime totale, nga të cilat 86 kontrata të nënshkruara.

Po përpunohen 134 aplikime.

Shuma e parave të disbursuara (përfshirë 10% pagesa paradhënie dhe investime të përfunduara plotësisht për të dyja thirrjet) deri në fund të shtatorit 2020: 5,84 milionë euro granti i përgjithshëm, nga të cilat 4,38 milionë euro kontributi i BE, dhe 1,46 milionë euro kontributi kombëtar.

Drejtoria e Përgjithshme për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (DG AGRI), përmes letrës, datë 28 korrik 2020, konsideron se autoritetet në Shqipëri kanë adresuar çështjet kryesore që çuan në besimin për zbatimin e buxhetit për masën 9 asistenca teknike (Masa e AT).

- Masat e mbështetura nën Mbështetjen Kombëtare për vitin 2020:

- Mbështetje për dele/dhi të regjistruara 4,814 aplikime;

- Mbështetje për bletari 1,486 aplikime;

- Zëvendësimi i plastikës termike në serra 714 aplikime;

- Mbjellja e bimëve medicinale aromatike 480 aplikime;

- Bujqësia Organike 125 aplikime;

- Certifikimi Global GAP 34 aplikacione.

Investimet Agroturizëm 4 aplikime

Në total, kishte 7,657 aplikime.

Buxheti i Mbështetjes Kombëtare në total është 9.3 milionë euro, i cili mbulon 5,388 aplikime nga 7,657. Deri më tani realizimi i buxhetit për Skemat Kombëtare është 92.71% e buxhetit të



përgjithshëm. Shuma e disbursuar në total: 8,5 milionë euro.

Sa i përket fushës së zhvillimit rural, përparim i mirë është shënuar në dhënien e besimit të IPARD II. Më 26 tetor 2018 DG- AGRI i dorëzoi Autoriteteve Shqiptare letrën zyrtare lidhur me lehtësimin e kushteve për dhënien e detyrave të zbatimit të buxhetit Shqipërisë, sipas nenit 13 (4) të Marrëveshjes Kuadër IPA II për masat 1, 3 dhe 7 të programit IPARD II, siç përcaktohet në nenin 7 të Marrëveshjes së Financimit.

Në fushën e organizimit të tregut të përbashkët është miratuar legjislacioni zbatues për ligjin e ri për vajin e ullirit. Janë miratuar dy akte ligjore në sektorin e vajit të ullirit i cili pjesërisht harmonizon legjislacionin kombëtar përkatës me *acquis*.

Për bujqësinë organike, vazhdon përafrimi me legjislacionin e BE, ku është miratuar ligji 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre” dhe vazhdon plotësimi me akte nënligjore. Komisioni për Prodhimin Organik (KPB) është përgjegjës për miratimin dhe mbikëqyrjen e trupave të kontrollit për certifikimin e produkteve organike. Mbikëqyrja e trupave të kontrollit, për llogari të KPB-së, kryhet nga Sektori i Politikave të Sigurisë Ushqimore që është përgjegjës për hartimin e legjislacionit, regjistrimin e operatorëve organikë dhe mbledhjen dhe përgatitjen e informacionit statistikor për prodhimin organik.

Gjatë viteve të fundit ka vazhduar dhe është rritur mbështetja financiare për bujqësinë organike nëpërmjet skemave direkte, ku përfshihen fermat biologjike dhe ato në kalim drejt bujqësisë biologjike.

Për sa u përket politikave të cilësisë, gjatë vitit 2019 është miratuar ligji për skemat e cilësisë të produkteve bujqësore dhe artikujve ushqimorë. Ky ligj krijon skemat e cilësisë dhe përcakton institucionet përgjegjëse për njohjen dhe mbrojtjen e emërtimeve të origjinës, treguesve gjeografikë dhe specialiteteve tradicionale të garantuara për produktet bujqësore dhe ato ushqimore. Në zbatim të këtij ligji janë hartuar aktet nënligjore për të mundësuar zbatimin e ligjit.

11.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Në fushën e bujqësisë organike, në zbatim të ligjit nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, është plotësuar kuadri ligjor në lidhje me

rregullat për prodhimin dhe kalimin e produkteve bimore biologjike, rregullat për grumbullimin, ambalazhimin, transportin, ruajtjen, etiketimin, logon, njoftimin e aktivitetit dhe kontrollin e produkteve biologjike, si dhe përbërjen, funksionimin, organizimin dhe detyrat e Komisionit për Prodhimin Biologjik”, bazuar në legjislacionin e BE-së dhe po vazhdon plotësimi me aktet e tjera nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Për zbatimin e ligjit nr. 8/2019, “Për skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe artikujt ushqimorë” janë miratuar aktet nënligjore:

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 677, datë 16.10.2019, “Për miratimin e logos me “Specialitet Tradicional të Garantuar” për produktet bujqësore dhe artikujt ushqimorë”;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 860, datë 24.12.2019, “Për funksionimin, kohëzgjatjen, organizimin dhe detyrat e Komisionit për Skemat e Cilësisë”;

- Udhëzim nr. 7, datë 21.4.2020, “Për formën dhe përmbajtjen e regjistrit për produktet bujqësore dhe ushqimore me tregues specialitet tradicional i garantuar”;

- Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 299, datë 29.7.2020, “Për miratimin e listës së produkteve bujqësore dhe ushqimore për konsum njerëzor”;

- Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 424, datë 16.10.2020, “Për përcaktimin e formës dhe përmbajtjes së certifikatës së cilësisë për përputhshmërinë e produktit bujqësor ose ushqimor me specifikimet teknike të produkteve të regjistruara”;

- Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 425, datë 16.10.2020, “Për përcaktimin e formatit të aplikimit dhe kundërshtimit të produkteve bujqësore ose ushqimore si Specialitet Tradicional të Garantuar”.

Gjithashtu, projektligji, “Për vreshtarinë dhe verën” është miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave më datë 24 dhjetor 2020 dhe është në proces miratimi në Kuvendin e Shqipërisë.

Kapacitetet e AZHBR-së

Një strukturë e re organizative e AZHBR-së u miratua përmes urdhrit të Kryeministrit nr. 156 datë 18.1.2019, “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 140, datë 17.9.2018, “Për miratimin e strukturës dhe organogramit të Agjencisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (Agjencia e Pagesave)”.



Stafi i Agjencisë IPARD u rrit me 14 pozicione të reja IPARD, dhe rrjedhimisht numri i përgjithshëm i punonjësve u bë 183, të cilët u punësuan, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”. Ndërkohë, ngarkesa e punës është rishikuar në përputhje me rrethanat për vitin 2020, struktura do të rritet me njëzet punonjës të rinj.

11.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucioni lider për kapitullin 11 është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, që është edhe institucioni koordinues i grupit ndërinstitucional të punës.

Pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës për kapitullin 11 janë dhe institucionet e mëposhtme:

- Ministria e Drejtësisë (MD);
- Agjencia Shtetërore e Kadastrës (AK);
- Instituti i Statistikave (INSTAT);
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE);
- Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR);
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ);
- Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve (AKDC);
- Enti i Farave dhe Fidanëve.

11.7 Prioritetet

- Gjatë vitit të ardhshëm, Shqipëria synon këto prioritetet:

- Zhvillimin e Sistemit të Integruar të Administrimit dhe Kontrollit (IACS), përfshirë përmirësimin e regjistrit të fermave dhe kafshëve;

- Miratimin e planit të zbatimit për regjistrat e Rrjetit të të Dhënave Kontabël të Fermës (FADN), me qëllim sigurimin e të dhënave konsistente, sistematike dhe të certifikuar;

- Garantimin e kapaciteteve administrative të nevojshme për të marrë përsipër zbatimin edhe për masat e mbetura të Programit IPARD II dhe për të përthithur financimet e IPARD II;

- Plotësimin e kuadrit ligjor për produktet organike;

- Plotësimin e kuadrit ligjor për emërtimet e mbrojtura të origjinës, treguesit gjeografikë dhe specialitetet tradicionale të garantuar;

- Miratimin e ligjit për vreshtat dhe verën si dhe të akteve nënligjore;

- Garantimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative për zbatimin e legjislacionit.

KAPITULLI 12

POLITIKAT E SIGURISË USHQIMORE, VETERINARISË DHE MBROJTJES SË BIMËVE

12.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli 12 mbulon rregullat e hollësishme në fushën e sigurisë ushqimore. Politika e përgjithshme e produkteve ushqimore përcakton rregullat e higjienës për prodhimin e produkteve bujqësore. Më tej, legjislacioni i Bashkimit Evropian përcakton rregullat e hollësishme në fushën e veterinarisë, të cilat janë thelbësore për të ruajtur shëndetin e kafshëve, mirëqenien e kafshëve dhe sigurinë e produkteve ushqimore me origjinë shtazore në tregun e brendshëm. Në fushën e fitosanitetit, rregullat e Bashkimit Evropian mbulojnë çështje të tilla si cilësia e farërave, materialet e mbrojtjes së bimëve, organizmat e dëmshëm dhe ushqimin e kafshëve.

12.2 Struktura e kapitullit

- siguria ushqimore;
- Politika veterinarë;
- Politika fitosanitare;
- Farat dhe Fidanët;
- Ushqimi për kafshë;
- OMGJ-të.

12.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Sipas nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë ligjin e saj kombëtar me atë të BE-së.

Bashkëpunimi në fushën e bujqësisë dhe sektorit agroindustrial midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian është parashikuar në nenin 96 të MSA-së. Në nenin 96 përcaktohet se fokusi duhet të jetë në fushat me përparësi që lidhen me *acquis* e Bashkimit Evropian në fushën e bujqësisë. Bashkëpunimi do të synojë në mënyrë të veçantë modernizimin dhe ristrukturimin e sektorit shqiptar bujqësor dhe agroindustrial, dhe mbështetjen e përafrimit gradual të legjislacionit dhe praktikave shqiptare me rregullat dhe standardet e Bashkimit Evropian.

Acquis për politikën e sigurisë ushqimore, politikën veterinarë dhe fitosanitare pasqyron qasjen e integruar të BE-së në sigurinë ushqimore me



qëllim sigurimin e një niveli të lartë të sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve, mirëqenies së kafshëve dhe shëndetit të bimëve brenda Bashkimit Evropian nëpërmjet masave koherente nga ferma në tavolinë dhe monitorimit adekuat, duke siguruar funksionimin efektiv të tregut të brendshëm. Parakushtet kryesore për një vend kandidat në këtë fushë janë transpozimi i legjislacionit të BE-së, si dhe zbatimi i tij nga një administratë e strukturuar mirë dhe e trajnuar.

Acquis në këtë kapitull përmban një numër shumë të madh rregulloresh direktivash dhe vendimesh.

Për zbatimin e legjislacionit të sigurisë ushqimore, shteti anëtar duhet të ketë strukturat administrative të përshtatshme që të jetë në gjendje që të kryejë inspektimin dhe kontrollin e produkteve ushqimore duke përfshirë kapacitetet e duhura laboratorike. Rregullat bazë janë përcaktuar në Rregulloren e përgjithshme për ushqimet për njerëzit dhe kafshët Nr. 178/2002 për parimet dhe kërkesat e përgjithshme të prodhimit ushqimor, përpunimit, paketimit, etiketimit, parketimit dhe shpërndarjes. Në veçanti, ky akt përcakton përkufizimet, parimet dhe detyrimet që mbulojnë të gjitha fazat e prodhimit dhe shpërndarjes së ushqimit për njerëz dhe kafshë. Plotësimi i kërkesave të gjurmueshmërisë për të gjithë ushqimin për njerëz dhe kafshë, ashtu edhe për operatorët e biznesit, janë të detyrueshme për zbatim. Legjislacioni për sigurinë ushqimore mbulon paketimin, etiketimin, marketingun, aditivët, tretësit e nxjerrjes, aromatizuesit, materialet e kontaktit ushqimor, shtesat ushqimore, ujërat minerale dhe rrezatimet jonizuese, ndotësit, ushqimet e reja, ushqimet e ngrira të shpejta, cilësinë e farërave dhe materialit shumues, produktet, organizmat e dëmshëm, të drejtat e varieteteve të bimëve, si dhe organizmat e modifikuar gjenetikisht.

Në fushat e politikave të veterinarisë dhe fitosanitetit, legjislacioni i Bashkimit Evropian përcakton rregullat për tregtinë e brendshme dhe futjen e kafshëve të gjalla dhe produkteve nga vendet e treta, në sektorët e veterinarisë, shëndetit të bimëve dhe ushqimit të kafshëve, duke mbrojtur shëndetin publik, shëndetin e bimëve dhe kafshëve dhe mirëqenien e kafshëve, ashtu edhe sigurinë e ushqimeve me origjinë shtazore në tregun e përbashkët. Regjimi i Bashkimit Evropian bazohet

në zbatimin e rregullave të njëjta nga autoritetet e shteteve anëtare. Kontrollat veterinarë dhe të shëndetit të bimëve në kufijtë e brendshëm janë hequr. Zbatohet një regjim i përbashkët i kontroleve në kufijtë e jashtëm. Një pjesë thelbësore e *acquis* në këtë fushë mbulon aspektet e higjienës në lidhje me përpunimin dhe hedhjen në treg të ushqimeve me origjinë shtazore, kontrollin e sëmundjeve të kafshëve dhe mbrojtjen e bimëve.

Duke ndjekur reformën e Politikës së Përbashkët Bujqësore pjesët kryesore të *acquis* të BE-së në fushën fitosanitare janë:

- Rregullorja (BE) nr. 2016/2031, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 tetor 2016, “Për masat mbrojtëse kundër parazitëve të bimëve, që ndryshon rregulloret (BE) nr. 228/2013, (BE) nr. 652/2014 dhe (BE) nr. 1143/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe që shfuqizon direktivat e Këshillit 69/464/KEE, 74/647/KEE, 93/85/KEE, 98/57/KE, 2000/29/KE, 2006/91/KE dhe 2007/33/KE;

- Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) nr. 2019/2072, e datës 28 nëntor 2019, “Për krijimin e kushteve uniforme për zbatimin e Rregullores (BE) 2016/2031 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, në lidhje me masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve dhe shfuqizimin e Rregullores së Komisionit (KE) nr. 690/2008 dhe ndryshimin e Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2018/2019;

- Direktiva NR. 2009/127/EC, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 21 tetor 2009, për sa u përket makinerive për aplikimin e pesticideve;

- Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 2017/269, e datës 16 shkurt 2017, në lidhje me statistikën e pesticideve, sa i përket listës së substancave aktive;

- Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) nr. 540/2011, e datës 25 maj 2011 zbatimi i Rregullores (KE) nr. 1107/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me listën e substancave aktive të miratuara;

- Direktiva nr. 2009/128/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të 21 tetorit 2009, duke krijuar një kornizë për veprimin e Komunitetit për të arritur përdorimin e qëndrueshëm të pesticideve.

12.4 Situata aktuale në Shqipëri

Shqipëria në kapitullin 12 ka njëfarë niveli të përgatitjes në këtë fushë. Shqipëria ka hartuar politika lidhur me sigurinë ushqimore, veterinarinë dhe fitosanitetin. Shqipëria bëri disa përparime në



zbatimin e masave përkatëse në sektorin e sigurisë ushqimore dhe veterinarë, si dhe në regjistrin e kafshëve.

Në fushën e sigurisë ushqimore, për të katërtin vit radhazi, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka kryer kontrollet zyrtare në zbatim të Planit Kombëtar të Kontrollit me bazë risku të miratuar në fillim të vitit.

Gjatë vitit 2020, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit vazhdon të përdorë sistemin TRACES me qëllim lëshimin e certifikatave veterinarë të eksportit për produktet me origjinë shtazore.

Në lidhje me vendosjen në treg të ushqimit, ushqimit për kafshë dhe nënprodukteve të kafshëve, plani kombëtar i monitorimit të mbetjeve (që mbulon produkte mjekësore veterinarë, mbetje të pesticideve, metale të rënda dhe mikrotoksina në kafshë të gjalla dhe produkte me origjinë shtazore) u zbatua në përputhje me kërkesat dhe metodat e validuara analitike.

Në vazhdimësi të planit, “Për miratimin e planit kombëtar të kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe të marrjes së mostrave për ushqimin, ushqimin për kafshë, mbrojtjen e bimëve dhe inputeve bujqësore, si dhe planin e marrjes së mostrave në PIK”, është hartuar plani i monitorimit të qumështit për 2020 për qumështin lëndë e parë (të papërpunuar) në fermat e prodhimit të qumështit me mbi 15 krerë, për përmbajtjen e ngarkesës mikrobike dhe qelizave somatike.

Gjithashtu si shtesë të planit, “Për miratimin e planit kombëtar të kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe të marrjes së mostrave për ushqimin, ushqimin për kafshë, mbrojtjen e bimëve dhe inputeve bujqësore, si dhe planin e marrjes së mostrave në PIK”, janë hartuar programet vjetore të monitorimit të mbetjeve për substance të padëshiruara, që mbulojnë mbetjet e pesticideve në 12 produkte me origjinë bimë. Në Planin Kombëtar të Monitorimit të mbetjeve të pesticideve në fruta-perime I miratuar për vitin 2020, krahasuar me vitin 2019, janë planifikuar dyfishimi i numrit të mostrave për analizim të nivelit të pesticideve në fruta-perime.

Rregullat e higjienës sipas standardeve të BE-së të zbatuara për prodhimin e produkteve ushqimore kanë siguruar një nivel të lartë të sigurisë ushqimore.

- Në fushën e rregullave të sigurisë ushqimore, kanë vazhduar përgatitjet e legjislacionit dytësor.

- Për sa u përket politikave në fushën e veterinarisë, janë hartuar programet e mëposhtme:

- Program kontrolli i sëmundjes së Plasjes dhe vaksinimi i kafshëve në zonat e prekura;

- Program kontrolli i sëmundjes së Brucelozës në bagëti, duke gjurmuar fermat mbi 10 krerë, duke eliminuar dhe kompensuar kafshët pozitiv;

- Programi i kontrollit të Brucelozës së ruminantëve të vegjël përmes vaksinimit të kafshëve;

- Programi për kontrollin e sëmundjes së tuberkulozit në fermat e gjedhit mbi 10 krerë, eliminimi dhe kompensimi i kafshëve pozitive;

- Programi për kontrollin e sëmundjes së dermatozës modulare, vaksinim masiv në tufat e gjedhit;

- Vaksinimi i dhelpave të kuqe për sëmundjen e tërbimit;

- Përpjekje pozitive u bënë gjatë vitit 2020 për përditësimin e informacionit në sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve, ku ka filluar identifikimi individual i kafshëve të llojit derr.

12.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

- Me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor dhe përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së në fushën e sigurisë ushqimore, janë miratuar për vitin 2020 aktet e mëposhtme ligjore:

- Miratimi i ligjit 16/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008 ‘Për Ushqimin’”, i ndryshuar;

- Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 2, datë 24.2.2020, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Kontrollit Zyrtar të Rrezikut të Bazuar në Rrezik dhe Marrjen e mostrave për Ushqimin, Ushqimin e Kafshëve, Mbrojtjen e Bimëve dhe Inputet Bujqësore, si dhe planin e marrjes së mostrave në PIK”;

- Udhëzimi i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 4, datë 28.2.2020, “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 21, datë 25.11.2010, “Mbi Kërkesat specifike të higjienës dhe kontrollet zyrtare për produktet me origjinë shtazore, përafrimi i pjesshëm i Rregullores (BE) nr. 853/2004 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 29 prillit 2004 që përcakton rregullat specifike të higjienës për higjienën e produkteve ushqimore;

- Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 2/1, datë 14.4.2020, për një shtesë në udhëzimin nr. 2, datë 24.2.2020, “Për miratimin e



Planit Kombëtar të Kontrollit Zyrtar të Rrezikut të Bazuar në Rrezik dhe Marrjen e mostrave për Ushqimin, Ushqimin e Kafshëve, Mbrojtjen e Bimëve dhe Inputet Bujqësore, si dhe planin e marrjes së mostrave në PIK”;

- Udhëzimi ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 2/2, datë 4.5.2020, për një shtesë në udhëzimin nr. 2, datë 24.2.2020, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Kontrollit Zyrtar të Rrezikut të Bazuar në Rrezik dhe Marrjen e mostrave për Ushqimin, Ushqimin e Kafshëve, Mbrojtjen e Bimëve dhe Inputet Bujqësore, si dhe planin e marrjes së mostrave në PIK”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 417, datë 27.5.2020, “Për procedurat e organizimit dhe funksionimit të Komisionit për Rishikimin e Masave Administrative në ministrinë përgjegjëse për ushqimin”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 708, datë 9.9.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”;

- Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 12, datë 21.9.2020, “Për kazeinat dhe kazeinatet të destinuara për konsum njerëzor”, i cili ka përafruar në mënyrë të pjesshme direktivën (BE) 2015/2203 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të 25 nëntorit 2015 mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me kazeinat dhe kazeinatet e destinuara për konsum njerëzor dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 83/417/KEE.

Aktet nënligjore të mëposhtme janë përgatitur me qëllim përmirësimin e kornizës ligjore dhe përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së në fushën e veterinarisë:

- Urdhri i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 108, datë 28.2.2020, “Për disa ndryshime në rregulloren e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 328, datë 22.11.2011, ‘Mbi përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për certifikimin veterinar të disa llojeve kafshësh dhe mishit të freskët të tyre, të cilat hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga shtete të caktuara, si dhe nga territore të tjera, në administrim të këtyre shteteve”

- Urdhri i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 273, datë 23.9.2020, “Për miratimin e rregullores ‘Mbi masat e kontrollit të salmonelës dhe agjentëve të tjerë zoonotikë’ e përafruar pjesërisht me Rregulloren (KE) nr. 2160/2003 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 17 nëntorit

2003 për kontrollin e salmonelës dhe të agjentëve të tjerë zoonotikë specifik të ushqimit;

- Urdhri i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 405, datë 8.10.2020, “Për përcaktimin e kërkesave dhe metodave specifike të kontrollit, të programit kombëtar të salmonelozës në shpendë”, pjesërisht i përafruar me Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 1177/2006, të 1 gushtit 2006, zbatim i Rregullores (KE) nr. 2160/2003 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me kërkesat për përdorimin e metodave specifike të kontrollit në kuadrin e programeve kombëtare për kontrollin e salmonelës në shpendë;

- Urdhri i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 406 datë 8.10.2020, “Për masat për uljen e prevalencës së disa serotipeve të salmonelës në pulat për prodhimtari vezësh *gallus gallus*” përafruar pjesërisht me Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 200/2010 të 10 Marsit 2010 duke zbatuar Rregulloren (KE) Nr. 2160/2003 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me një objektiv të Bashkimit Evropian për zvogëlimin e prevalencës së serotipeve të Salmonelës në tufat e prodhimit të *gallus gallus*;

Për fushën fitosanitare, me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor dhe përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së, janë miratuar për vitin 2020 aktet e mëposhtme ligjore:

- Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 1 datë 10.3.2020, “Për rregullat dhe masat për trajtimin e ambalazheve dhe paletave prej druri”. Ky udhëzim i përbashkët përafron pjesërisht ISPM 15, “Për rregullimin e materialit të paketimit të drurit në tregtinë ndërkombëtare”;

- Urdhri i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 26 datë 22.1.2020, për “Përditësimin e urdhrit të ministrit nr. 72 datë 2.3.2017, “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, i ndryshuar. Ky urdhër përafron pjesërisht Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2019/1675 e 4 tetorit 2019, Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2019/1690 e 9 tetorit 2019, Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2019/2094 të 29 nëntorit 2019, Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/17 të 10 janarit 2020 dhe Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/18 e 10 janarit 2020;



- Urdhri i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 172 datë 4.5.2020, “Për përditësimin e urdhrit të ministrit nr. 72 datë 2.3.2017, “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, i ndryshuar. Ky urdhër përafrohet pjesërisht Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/421 e 18 Marsit 2020, Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/23 e 13 janarit 2020 dhe Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/29 14 janarit 2020, Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE);

- Urdhri i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 350 datë 4.9.2020, “Për përditësimin e urdhrit të Ministrit nr. 72, datë 2.3.2017, “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, i ndryshuar. Ky urdhër përafrohet pjesërisht Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/1004 e 9 korrikut 2020, Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/1018 e 13 korrikut 2020, Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/646 e 13 majit 2020, Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/642 e 12 majit 2020, Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/617 e 5 majit 2020, Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/1003 e 9 korrikut 2020, Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/968 e 3 korrikut 2020, Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/616 e 5 majit 2020, Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/869 e 24 gushtit 2020 dhe Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/892 e 29 gushtit 2020.

Në kuadër të kapaciteteve institucionale është miratuar akti ligjor i mëposhtëm:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 683 datë 2.9.2020, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve”.

12.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucioni lider për këtë kapitull është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR).

MARD është përgjegjëse për formulimin e politikave, legjislacionit dhe strategjive për kontrollin e cilësisë dhe sigurisë së produkteve ushqimore me qëllim integrimin e kontrollit të ushqimit si një funksion kyç në mbrojtjen e shëndetit dhe interesave të konsumatorit, duke siguruar konkurrencë të ndershme në tregun

kombëtar dhe futjen e ushqimit produkteve në tregun ndërkombëtar.

Pjesë e grupit ndërinstitucional të punës për kapitullin 12 janë dhe institucionet e mëposhtme:

- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU);
- Instituti i Statistikave (INSTAT);
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE);
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM);
- Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV);
- Agjencitë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve (ARSHVMB);
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ);
- Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve (AKDC);
- Enti i Farave dhe Fidanëve (EFF);
- Universiteti Bujqësor i Tiranës.

12.7 Prioritetet

Prioritetet afatshkurtra në fushën e sigurisë ushqimore përfshijnë:

- Forcimin e sistemit të sigurisë ushqimore dhe të sistemeve të kontrollit;
- Përforsimi i kapaciteteve laboratorike në fushën e sigurisë ushqimore;
- Plotësimin e kuadrit ligjor në fushën e ushqimeve për përdorime të veçanta ushqyese, Aditivëve të autorizuar dhe kriterit të pastërtisë, kontaminantëve etj.;
- Zbatimi i rregullave të sigurisë ushqimore përmes kontrolleve zyrtare të përmirësuar, përfshirë kushtet e kontrollit dhe kontrollet;
- Miratimi i një metodologjie të re me bazë risku për planifikimin e kontrolleve zyrtare të sigurisë ushqimore; zbatimi i kontrolleve zyrtare sipas planeve vjetore të përditësuar të inspektimit të bazuara në një metodologji të përmirësuar me bazë risku për planifikimin e kontrolleve zyrtare të sigurisë ushqimore;

Prioritetet në fushën e veterinarisë përfshijnë:

- Duhet të përfundojë riorganizimi i shërbimit veterinar për të rritur efikasitetin dhe për të siguruar një nivel të përshtatshëm të kapaciteteve administrative;
- Plotësimi i kuadrit ligjor mbi kontrollin e sëmundjeve në kafshë, higjienën e mirëqenien e kafshëve, kontrollet veterinarë në përputhje me aktet normative të BE-së dhe zbatimi i plotë i tyre;
- Përcaktim i qartë i përgjegjësisë të institucioneve të përfshira në mbrojtjen e shëndetit



të konsumatorit për të siguruar ruajtjen e shëndetit të kafshëve dhe sigurinë ushqimore të produkteve me origjinë shtazore;

- Funksionim i plotë i sistemit të identifikimit për kafshët gjedhe e të imta, regjistrimin dhe kontrollin e plotë të lëvizjeve të kafshëve; përfundimi i identifikimit të kafshëve të lloj derr dhe fillimin e identifikimit individual të njëthundrakëve;

- Kontroll i plotë i situatës epizootike, veçanërisht lidhur me sëmundjet zoonotike; një sistem të mirë informacioni mbi kafshët;

- shtimin e masave të mbrojtjes për parandalimit dhe zbulimit të sëmundjes së Murtajës Afrikane të Derrave;

- Miratimi i Planit Kombëtar i Salmonelozës në shpendë;

- Mirëmbajtjen e programeve të vaksinimit deri në çrrënjosjen e tërbimit;

- Të përmirësojë sistemin e kontrolleve të mbetjeve dhe ndotësve në kafshët e gjalla dhe produktet shtazore;

Prioritetet afatshkurtra në fushën e fitosanitare përfshijnë:

- Amendimi i ligjit të mbrojtjes së bimëve nr. 105/2016 për pjesën e shëndetit të bimëve duke bërë të mundur që nëpërmjet akteve nënligjore në zbatim të tij, të përafrojë në mënyrë të pjesshëm *acquis* -in e BE-së në këtë fushë. Nisur edhe nga fakti se që nga 14 dhjetori 2019, kanë hyrë në fuqi *acquis* të reja në Bashkimin Evropian në këtë fushë, me ndryshime thelbësore;

- Përforcimi i kapaciteteve laboratorike në fushën fitosanitare;

- Regjistrimi i operatoreve profesionist;

- Trajnimin dhe miratimin e operatoreve për lëshimin e pasaportës bimore;

- Monitorimi, kontrolli dhe evidentimin të dëmtuesit karatinorë dhe jokarantinorë;

- Forcimi i strukturave implementuese i shërbimit fitosanitar;

- Përmirësimi i kontrollit të produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe konsolidimi i kapaciteteve të monitorimit të pesticideve në produktet ushqimore.

KAPITULLI 13

PESHKIMI

13.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis për peshkimin përbëhet nga rregulloret, të cilat nuk kërkojnë ndryshime në legjislacionin kombëtar. Megjithatë, kjo kërkon futjen e masave për të përgatitur administratën dhe operatorët për zbatimin e Politikës së Përbashkët të Peshkimit, e cila përfshin politikën e tregut, menaxhimin e burimeve dhe flotës, inspektimin dhe kontrollin, masat strukturore dhe kontrollin e ndihmës shtetërore. Në disa raste, marrëveshjet dhe konventat ekzistuese në fushën e peshkimit me vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare është e nevojshme që të përshtaten.

13.2 Struktura e kapitullit

Kapitulli 13 nuk është i ndarë në nënkapituj.

13.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Sipas Nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë legjislacionin kombëtar me *acquis* e BE-së.

Detyrimi nga Marrëveshja e Stabilizim-asociimit rrjedh nga neni 96 i MSA-së. Neni përcakton rëndësinë e identifikimit të fushave me përfitim të ndërsjellët me interes të përbashkët me prioritetin që lidhet me *acquis* e BE-së për peshkimin, duke përfshirë respektimin e detyrimeve ndërkombëtare lidhur me rregullat e organizimit ndërkombëtar dhe rajonale të peshkimit për menaxhimin dhe ruajtjen e burimeve të peshkimit.

Në lidhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian, politikat e peshkimit (me përjashtim të ruajtjes së burimeve biologjike detare) janë pjesë e grupit të dytë të kompetencave të Bashkimit Evropian. Neni 4 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian përcakton se në këtë rast, Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare kanë të drejtë të miratojnë akte ligjore. Shtetet anëtare mund të ushtrojnë kompetencat e tyre në rast se Bashkimi Evropian nuk i shtron kompetencat e tij ose ka vendosur që të mos i ushtrojë këto kompetenca.

Acquis për peshkimin përbëhet nga rregulloret, të cilat nuk kërkojnë transpozimin në legjislacionin kombëtar, dhe kërkojnë marrjen e masave për të përgatitur administratën dhe operatorët për të zbatuar rregullat e Politikës së Përbashkët të Peshkimit. Fusha e veprimt, objektivat dhe



parimet e PPP-së janë të përcaktuara në Rregulloren kuadër të Politikës së Përbashkët të Peshkimit (Rregullorja e Këshillit (BE) nr. 1380/2013).

PPP-ja përcakton rregullat për ruajtjen e burimeve të gjalla ujore, kufizimin e ndikimit në mjedis të peshkimit dhe kushtet e aksesit në ujëra dhe resurse. Ai gjithashtu përfshin një politikë strukturore dhe rregulla specifike për menaxhimin e kapacitetit të flotës, kontrollin e aktivitetit të peshkimit dhe zbatimin e rregullave të saj. PPP-ja bazohet në këshilla të shëndosha shkencore dhe ofron një kornizë për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave të peshkimit. Masat specifike të menaxhimit për shfrytëzimin e qëndrueshëm të peshkimit në Detin Mesdhe përcaktohen në rregulloren (EC) nr. 1967/2006 (Rregullorja Mesdhetare). Rregulla të veçanta zbatohen gjithashtu për menaxhimin e disa specieve, si për shembull, për ngjallën evropiane (Rregullorja 1100/2007).

Në lidhje me menaxhimin e resurseve dhe flotës, *acquis* përmban rregulla specifike për rregullimin e kapacitetit të peshkimit me qëllim që të kërkojë një ekuilibër midis flotës dhe rezervave, ashtu edhe matjen e tonazhit. Shteteve Anëtare u kërkohet të mbledhin dhe përditësojnë të dhënat lidhur me kapacitetin e peshkimit në një regjistër të veçantë të flotës së peshkimit. Inspektimi dhe kontrolli janë kryesisht përgjegjësi e Shteteve Anëtare që kanë nevojë të sigurojnë kapacitetet administrative për zbatim efektiv, ndërsa korniza ligjore është përgatitur në nivel të BE. *Acquis* përcakton ndërmjet të tjerash rregulla të hollësishme për regjistrimin dhe raportimin e kapjeve dhe funksionimin e një sistemi monitorimi satelitor të anijeve.

Rregullorja (BE) nr. 508/2014 përcakton dispozitat për Fondin Evropian të Peshkimit Detar (EMFF) dhe përcakton masat financiare për zbatimin e Politikës së Përbashkët të Peshkimit, masat përkatëse në lidhje me Ligjin e Detit, zhvillimin e qëndrueshëm të fushës së peshkimit dhe akuakulturës, dhe peshkimin e brendshëm, si dhe Politikën e Integruar Detare. Për të përfituar nga Fondi Evropian i Peshkimit Detar, Shtetet Anëtare të BE-së duhet të miratojnë një dokument strategjik dhe një program operacional (OP). Shtetet anëtare, gjithashtu, duhet të kenë kapacitetet e nevojshme administrative dhe të

kontrollit, me qëllim që të sigurojnë një zbatim të shëndoshë dhe efikas të Programit Operacional.

Legjislacioni i Bashkimit Evropian për politikën e tregut përcaktohet nga Rregullorja nr. 1379/2013 e Parlamentit Evropian dhe i Këshillit si dhe është i bazuar në organizatat profesionale, standardet e përbashkëta të marketingut, informacionin për konsumatorin, rregullat e konkurrencës dhe inteligjenca e tregut.

Përveç rregulloreve të përgjithshme të ndihmës shtetërore, *acquis* përmban rregulla specifike të ndihmës shtetërore të zbatueshme për sektorin e peshkimit dhe akuakulturës.

Duke pasur parasysh kompetencën e saj ekskluzive në fushën e ruajtjes së burimeve biologjike detare, BE është pjesë e një numri të marrëveshjeve dhe organizatave ndërkombëtare. Në disa raste, marrëveshjet ekzistuese të peshkimit dhe konventat me vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare duhet të përshtaten ose të shfuqizohen përpara anëtarësimit.

Shqipëria ka harmonizuar kuadrin e saj ligjor dhe dispozitat e rregulloreve kombëtare me dispozitat e Politikës së Përbashkët të Peshkimit (CFP), me qëllim që në mënyrë adekuate të përgatisë sektorin dhe administratën për përmbushjen e plotë të detyrimeve të saj, në kuadër të politikës së përbashkët të peshkimit.

Pjesët kryesore të *acquis* të BE-së janë:

- Rregullorja (BE) nr. 1379/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 dhjetorit 2013 për organizimin e përbashkët të tregjeve në produktet e peshkimit dhe akuakulturës, duke ndryshuar rregulloret e Këshillit (KE) nr. 1184/2006 dhe (KE) nr. 1224/2009 dhe shfuqizimi i Rregullores së Këshillit (KE) nr. 104/2000;

- Rregullore nr. 1380/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 11 dhjetor 2013 mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit, duke ndryshuar Rregulloret e Këshillit (KE) nr. 1954/2003 dhe (KE) Nr. 1224/2009 dhe duke shfuqizuar Rregulloret e Këshillit (KE) nr. 2371/2002 dhe (KE) Nr. 639/2004 dhe vendimit të Këshillit 2004/585/EC;

- Rregullorja (BE) 2017/1004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 17 majit 2017 për krijimin e një kornize të Unionit për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetje për këshilla shkencore, në lidhje me politikën e përbashkët të



peshkimit dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 199/2008;

Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1224/2009 e datës 20 nëntor 2009 për krijimin e një sistemi të kontrollit të Komunitetit për të siguruar respektimin e rregullave të politikës së përbashkët të peshkimit, duke ndryshuar rregulloret (KE) nr. 847/96, (KE) nr. 2371/2002, (nr. 811/2004, (EC) nr. 768/2005, (EC) nr. 2115/2005, (KE) nr. 2166/2005, (KE) nr. 388/2006, (KE) nr. 509/2007 (KE) nr. 676/2007, (EC) nr. 1098/2007, (KE) nr. 1300/2008, (KE) nr. 1342/2008 dhe rregullat shfuqizuese (KEE) nr. 2847/93, (KE) nr. 1627/94 dhe (EC) nr. 1966/2006.

- Rregullore e Këshillit (KE) nr. 1100/2007 të 18 shtatorit 2007 për vendosjen e masave për rikuperimin e stokut të ngjave evropiane.

- Rregulloren (BE) nr. 508/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 maj 2014 mbi Fondin Evropian të Detarisë dhe Peshkimit dhe shfuqizimin e Rregulloreve të Këshillit (KE) nr. 2328/2003, (EC) nr. 861/2006, (KE) nr. 1198/2006 dhe (KE) nr. 791/2007 dhe Rregullorja (EU) nr. 1255/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit.

13.4 Situata aktuale në Shqipëri

Strategjia Kombëtare për Peshkimin dhe Akuakulturën 2016–2021, e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 701, datë 12.10.2016, e cila ka si qëllim harmonizimin dhe menaxhimin e politikës me legjislacionin e BE-së në fushën e peshkimit dhe Politikës së Përbashkët të Peshkimit, është në fazën e implementimit.

Për krijimin e një tregu funksional të shitjes me shumicë të peshkut dhe ngritjen e sistemit të informacionit për tregtimin e peshkut ka përfunduar ndërtimi i tregut të tregtimit të peshkut në Shëngjin dhe është në fazën e testimit teknik. Ndërsa ndërtimi i tregut të Vlorës është në proces ndërtimi.

Janë identifikuar zonat e lejuara të akuakulturës për hartimin e planeve shumëvjeçare strategjike kombëtare me qëllim zhvillimin e akuakulturës në Shqipëri.

Shqipëria ka përditësuar regjistrin e anijeve të peshkimit dhe ka bërë përparime për përmirësimin e statistikave të zbarkimit. Është vënë në zbatim sistemi i lëshimit të certifikatave të zënies për produktet e peshkimit.

Në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare, Shqipëria ka vazhduar të marrë pjesë në aktivitetet e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun dhe ka përmbushur rekomandimet e dhëna. Përpos kësaj, Shqipëria ka përmbushur të gjitha kërkesat e rekomandimet e Komisionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Peshkut Ton të Atlantikut. Shqipëria ka përmirësuar ndjeshëm raportimet në këto organizata në përputhshmëri me kërkesat e tyre.

Shqipëria ka përgatitur dhe dorëzuar Statlant37A_GFCM_FAO_2018 dhe Albania008A_2018, duke rishikuar të gjitha të dhënat e kapur që nga 2013. Nga ana tjetër, gjatë vitit 2018, Shqipëria dorëzoi të gjitha të dhënat sipas GFCM_DCRF- 2017, si dhe ICCAT - Task I + II (2014 - 2017).

Në kuadër të peshkimit, Shqipëria nënshkroi Deklaratën *MedFish4Ever* të Maltës në lidhje me qëndrueshmërinë e burimeve të peshkimit në Mesdhe (një iniciativë e BE-së për të kthyer peshkimin në Mesdhe për qëndrueshmëri dhe në këtë mënyrë të ruajë rritjen ekonomike dhe vendet e punës) si dhe deklaratën e konferencës së Nivelit të lartë të peshkimit artizanal (HL-sSF) në shtator 2018 në Maltë.

13.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Gjatë vitit 2020 janë miratuar aktet ligjore si më poshtë:

- Ligj nr. 42/2020, datë 23.4.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar”. Me ndryshimet e bëra nuk lëshohen leje të reja peshkimi për anijet e peshkimit që zhvillojnë format e peshkimit me rrjeta tërheqëse (fundore ose pelagjikë, veçmas ose së bashku), me rrethim (koshilok) për peshkimin e pelagjikëve të vegjël dhe të mëdhenj, dragat hidraulike (turbosofiantë), linja grepash dhe të gjitha format e peshkimit tregtar profesional;

- Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 216 datë 29.5.2020, “Për një plan menaxhimi shumëvjeçar për peshkimin fundor të qëndrueshëm në Detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18) [rekomandimi GFCM/43/2019/5]”;

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 625 datë 29.7.2020, “Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 407 datë 8.5.2013, “Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar



respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim”, të ndryshuar;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 772 datë 30.9.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 719 datë 12.10.2016, “Për menaxhimin e kapaciteteve të peshkimit tregtar dhe disa rregullime të mënyrës së funksionimit të regjistrit të anijeve të peshkim”;

- Rregullore e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 2, datë 3.8.2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren nr. 1, datë 7.3.2014, “Për zbatimin e ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, ‘Për peshkimin’”, të ndryshuar;

- Rregullore e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 3, datë 12.10.2020, “Për detajimin e rregullave në lidhje me përcaktimin e madhësisë së syzës dhe vlerësimin e trashësisë së fijës në rrjetat e peshkimit”, e cila përaftron në mënyrë të plotë Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 517/2008, e datës 10 qershor 2008 e cila përcakton rregullat e hollësishme për zbatimin e rregullores së Këshillit nr. 850/98, në lidhje me përcaktimin e madhësisë së rrjetës dhe vlerësimin e trashësisë së spangos së rrjetave të peshkimit;

- Rregullore e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 4, datë 24.10.2008, “Për pajisjet që mund t’u vendosen tratave tërheqëse, tratave të zallit dhe tratave të ngjashme me to”, e cila përaftron në mënyrë të plotë Rregulloren e Komisionit nr. (KEE) 3440/84, të datës 6 dhjetor 1984 mbi lidhjen e pajisjeve që mund t’u vendosen tratave, tratave të zallit dhe tratave të ngjashme me to;

- Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 334, datë 25.8.2020, “Për zbatimin e rekomandimit të ICCAT për ndryshimin e rekomandimit 18-02 për hartimin e një plani menaxhimi shumëvjeçar për tonin në Atlantikun lindor dhe Detin Mesdhe (REC. ICCAT 19-04)”;

- Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 11, datë 10.9.2020, “Për procedurat e monitorimit të zbatimit të kontratave për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme dhe akuakulturën tokësore dhe ujore;

- Urdhri i Kryeministrit nr. 95, datë 17.7.2020, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së drejtorisë së Shërbimeve të peshkimit dhe Akuakulturës”. Ky urdhër siguron shërbimin e inspektoratit të peshkimit 24/7 në katër portet e peshkimit.

13.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucioni lider për kapitullin 13 është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, që është edhe institucioni koordinues i grupit ndërinstitucional të punës.

Pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës për kapitullin 13 janë dhe institucionet e mëposhtme:

- Instituti i Statistikave (INSTAT);
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE);
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ);
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU).

13.7 Prioritetet

Shqipëria në zbatimin e këtij plani do të fokusohet veçanërisht në:

- Arritja e përputhjes së mëtejshme me kuadrin ligjor me rregullat e BE në fushën e peshkimit, akuakulturës dhe ujërat e brendshme;

- Forcimi administrativ i administratës së peshkimit, duke përfshirë shërbimet e inspektimit dhe kontrollit si dhe grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave të zënieve për hartimin e planeve të menaxhimit të peshkimit si dhe raportimin në organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit (GFCM); rekrutimi i monitoruesve dhe vëzhguesve për të bashkëpunuar me shërbimet e peshkimit;

- Zbatimi i strategjisë kombëtare të zhvillimit të peshkimit;

- Mbështetje për monitorimin vjetor të gjendjes së burimeve të peshkimit për të mundësuar zbatimin e politikës së peshkimit në Shqipëri;

- Zhvillimi i mekanizmave të duhur për grumbullimin e të dhënave në nivel kombëtar, e cila duhet të jetë plotësisht në përputhje me *acquis* të BE-së;

- Zbatimi dhe zhvillimi i politikave për organizimin e tregjeve të produkteve të peshkut me shumicë dhe pakicë për të arritur kontrollin 100% të produkteve të peshkut dhe promovuar përmirësimin e cilësisë së produkteve të peshkut;

- Ringritja sistemit të monitorimit satelitor të anijeve (VMS) për monitorimin dhe kontrollin e aktivitetit të peshkimit nga anijet me gjatësi mbi 12 m brenda vitit 2020 me fonde të buxhetit të shtetit;

- Zgjerimi i mëtejshëm i porteve të peshkimit ekzistuese, ndërtimin e shkallëve për riparimin e anijeve dhe ndërtimin e bankinave për anijet e peshkimit në Vlorë, Sarandë dhe Shëngjinit, në



mënyrë që të rritet gatishmërinë e treguesve teknike për flotën e peshkimit detar;

- Mbështetje për dhënien e kredive të buta për operatorët e peshkimit me qëllim riparimin dhe modernizimin e anijeve të tyre të peshkimit;

- Rritja e nivelit të përpunimit industrial të produkteve të peshkimit dhe të akuakulturës, përmirësimin e marketingut të tyre përmes rritjes së cilësisë dhe sigurisë;

- Ndërmarrja e hapave për të siguruar menaxhimin e duhur të burimeve peshkore, duke përfshirë shpërndarjen e burimeve të nevojshme në këtë fushë, duke ndërmarrë veprimet e duhura zbatuese, duke zhvilluar një sistem të përshtatshëm të mbledhjes së të dhënave, duke siguruar rregullimin e kapaciteteve të flotës së peshkimit për mundësitë e peshkimit me objektiv arritjen e një balance të qëndrueshme midis tyre, dhe mbledhjen e statistikave të sakta të zënies së peshkut;

- Forcimi i kapaciteteve të inspektimit, kontrollit, monitorimit dhe mbikëqyrjes.

KAPITULLI 14 POLITIKA E TRANSPORTIT

14.1 Përmbajtja e kapitullit

Legjislacioni i BE-së për sektorin e transportit synon përmirësimin e funksionimit të tregut të brendshëm duke promovuar shërbime të sigurta, efikase dhe miqësore me mjedisin. Legjislacioni i fushës së transportit mbulon sektorët e transportit rrugor, hekurudhor, ujor të brendshëm, transportin e kombinuar, transportin ajror dhe detar. Ai ka të bëjë me standardet teknike dhe të sigurisë, standardet sociale, ndihmën shtetërore dhe liberalizimin e tregut në kontekstin e tregut të brendshëm të transportit.

14.2 Struktura e kapitullit

- Transporti rrugor
- Transporti hekurudhor
- Transporti detar
- Transporti ajror

14.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Bashkëpunimi midis BE-së dhe Shqipërisë në lidhje me politiken e transportit rregullohet nga disa nene të Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit. Neni 106 “Transporti” parashikon që palët, d.m.th. Shqipëria dhe Bashkimi Evropian do të përqendrohen në fushat prioritare që lidhen me

acquis e BE-së, me qëllim ristrukturimin dhe modernizimin e mënyrave të transportit shqiptar, përmirësimin e lëvizjes së lirë të udhëtarëve dhe mallrave, lehtësimin e aksesit në tregun dhe infrastrukturën e transportit, duke mbështetur zhvillimin e infrastrukturave multimodale dhe lidhjen me rrjetet kryesore Transevropiane dhe arritjen e standardeve operative të krahasueshme me ato të Bashkimit Evropian.

Neni 59 i MSA-së në lidhje me protokollin 5, “Për transportin tokësor” përcakton detyrimet e palëve në lidhje me ofrimin e shërbimeve të transportit midis Komunitetit dhe Shqipërisë. Neni 59 parashikon se palët do të sigurojnë trafikun rrugor transit të pakufizuar bazuar në zbatimin efektiv të parimit të mosdiskriminimit. Në transportin detar, palët do të aplikojnë në mënyrë efektive parimin e aksesit të pakufizuar në treg dhe trafik në baza komerciale pa hyrë në marrëveshje për ndarjen e mallrave me shtetet e treta, duke eliminuar të gjitha masat e njëanshme dhe pengesat administrative, teknike dhe të tjera që mund të pengojnë aksesin në transportin detar dhe garantimin e trajtimit kombëtar ndaj anijeve të palës tjetër. Në transportin ajror, palët do të bien dakord mbi kushtet e aksesit të ndërsjellët në tregun e transportit ajror.

Neni 70 dhe Neni 59(6) përcaktojnë se Shqipëria do të përafrojë gradualisht legjislacionin e saj me *acquis* e BE-së me qëllim përmirësimin e sistemit të transportit dhe shërbimeve të transportit.

Në lidhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian, politikat në kapitullin 14 i përkasin grupit të dytë të kompetencave të Bashkimit Evropian, d.m.th. grupit të kompetencave të ndara mes Bashkimit Evropian dhe shteteve të tij anëtare. Sipas Nenit 4 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, si Bashkimi Evropian ashtu edhe shtetet anëtare mund të miratojnë akte ligjore në fushën e transportit. Shtetet anëtare e ushtrojnë kompetencën e tyre në rast se Bashkimi Evropian nuk e ushtron këtë kompetencë ose ka vendosur të mos e ushtrojë këtë kompetencë.

Politika e transportit e Bashkimit Evropian synon mobilitetin e qëndrueshëm, duke kombinuar konkurrueshmërinë e Evropës me mirëqenien e qytetarëve të saj, dhe duke kontribuar kështu në rritjen e sigurisë dhe forcimin e të drejtave. Ky



është një komponent thelbësor i Evropë 2020, dhe kontribuon në kohezionin social dhe territorial. Objektivat e politikës së transportit të Bashkimit Evropian janë: të përmirësojë funksionimin e tregut të brendshëm duke nxitur krijimin e një sistemi të integruar transporti të sigurt, konkurrues, me përdorim eficient të burimeve, që respekton mjedisin, lehtësisht të përdorshëm dhe efektiv, i cili ofron një nivel të lartë të lëvizjes së qëndrueshme në Bashkimin Evropian, duke mbrojtur mjedisin, duke promovuar standardet e punës dhe kualifikimeve për sektorin dhe duke mbrojtur sigurinë dhe shëndetin e qytetarëve. Politika e transportit të qëndrueshëm e Bashkimit Evropian kërkon një sistem transporti të integruar, ndërveprues dhe të ndërlidhur për të përballuar nevojat ekonomike, sociale dhe mjedisore të shoqërisë.

Politika e transportit e Bashkimit Evropian rregullohet nga titulli VI, nenet 90–100 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE). Një pjesë e rëndësishme e *acquis* përbëhet nga legjislacioni i detyrueshëm dhe i zbatueshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë në formën e rregulloreve dhe vendimeve. Pjesa e mbetur e *acquis* në këtë kapitull, përbëhet nga direktiva që kanë nevojë të transpozohen në sistemin ligjor të shtetit anëtar.

Acquis në këtë kapitull mbulon transportin rrugor, atë hekurudhor, transportin e brendshëm ujor, transportin e kombinuar, aviacionin, transportin detar dhe navigacionin satelitor.

Pjesë të *acquis* në këtë kapitull janë të mbuluara nga Marrëveshja për Zonën Evropiane të Përbashkëta të Aviacionit, konkretisht në aneksin I.

14.4 Situata aktuale në Shqipëri

Në përgjithësi, në fushën e politikës së transportit është arritur njëfarë niveli përgatitje. Gjatë vitit 2020, përparim është arritur në përgatitjen e raportit të tretë të monitorimit të Strategjisë së Transportit dhe në miratimin e Rishikimit të dytë pesëvjeçar të Planit Kombëtar të Transportit (PKT3).

Me ligjin nr. 8/2018, datë 26.2.2018, “Për ratifikimin e traktatit që themelon Komunitetin e Transportit” u miratua nga Parlamenti Shqiptar ky traktat, që është një nga dokumentet më të rëndësishëm për të gjithë sektorët e transportit, dhe që do të jetë udhërrëfyese për vitet në vijim. Zbatimi i Traktatit të Komunitetit të Transportit do të përmirësojë sektorin e transportit jo vetëm në

Shqipëri, por në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe shtrirjen e lidhjen e tij me rrjetin e transportit të BE-së. Traktati parashikon përafrimin e mëtejshëm të legjislacioneve kombëtare me *acquis* e BE-së, për të gjitha fushat e transportit. Qëllimi i këtij Traktati është krijimi i një Komuniteti Transporti në fushën e transportit si dhe zhvillimi i rrjetit të transportit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Palëve të Evropës Juglindore. Ky zhvillim do të bazohet mbi integrimin progresiv të tregjeve të transportit, mbi bazën e kuadrit ligjor përkatës të *acquis*, përfshirë edhe në sferat e standardeve teknike, ndërfunksionimin, sigurinë, politikën sociale, menaxhimin e trafikut, prokurimin publik dhe mjedisin.

Në transportin rrugor ka vazhduar puna për përafrimin e legjislacionit të fushës me *acquis* të BE-së.

Po vazhdohet puna për miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë i legjislacionit të ri për sektorin hekurudhor në zbatim të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”. Aktet përkatëse janë përgatitur në bashkëpunim me Asistencën Teknike të miratuar nga Delegacioni i BE-së.

Në transportin ajror, faza I e Marrëveshjes Shumëpalëshe për Krijimin e një Zone të Përbashkët të Aviacionit Evropian (ECAA), po zbatohet, në përputhje me kushtet e përcaktuara në protokollin I të kësaj Marrëveshjeje. Me vendimin nr. 1/2019, datë 31 korrik 2019, të Komitetit të Përbashkët të kësaj marrëveshjeje, është miratuar zëvendësimi i aneksit I të saj, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së, L 211/4, datë 12.8.2019.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me ligjin nr. 82/2019 ka ratifikuar Amendimet e Manilës në konventën ndërkombëtare, “Për standardet e kualifikimit, certifikimit dhe shërbimit për detarët (STCW) 1978” dhe me ligjin nr. 09/2020 ka ratifikuar aneksin VI të Konventës, “Për parandalimin e ndotjeve nga anijet MARPOL 73/78”. Në bashkëpunim me MTM në zbatim të Kodit Detar, me qëllim rregullimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e turizmit detar janë hartuar dhe miratuar aktet ligjore të rëndësishme.

14.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Strategjia e Sektorit të Transportit dhe Plani i saj i Veprimit 2016–2020, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 811, datë 16.11.2016, “Për miratimin e strategjisë së sektorit të transportit



dhe planit të veprimit 2016–2020” është duke u zbatuar. Raporti i tretë i Monitorimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Transportit 2016–2020 dhe Planit të Veprimit u përgatit dhe u aprovua më 23 korrik 2020, si dhe u botua në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë: <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/3rd-Monitoring-Report-of-sectorial-Transport-strategy-and-Action-Plan-2016-2020-June-2020.pdf>.

Shqipëria me financimin të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, ka përfunduar hartimin e dokumentit “Rishikimi i dytë i Planit Kombëtar të Transportit (PKT3)”, miratuar me urdhrin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 40, datë 21.1.2020.

Legjislacioni shqiptar në transportin rrugor është hartuar dhe vijon të përgatitet në përputhje me *acquis* të BE-së. Në janar të vitit 2020, hyri në fuqi udhëzimi nr. 8, datë 19.12.2019, “Për kriteret, rregullat dhe dokumentacionin për lëshimin e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve” dhe është miratuar urdhri i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 185, datë 18.6.2020, “Për zbatimin e strategjisë për aplikimin e sistemeve inteligjente në transportin rrugor”

Politikat në sigurinë rrugore janë përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Rrugore 2011–2020 të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 23.2.2011, “Për zbatimin e objektivave për përmirësimin e sigurisë rrugore”. Sipas këtij dokumenti, baza e vitit 2009 ishte 378 viktima. Objektivi 2020 është 250 vdekje në vit. Sipas të dhënave të Policisë Shtetit aksidentet rrugore në tetëmujorin e 2020-s janë ulur me 24.6% në krahasim me ato të ndodhura në të njëjtën periudhë të vitit 2019. Numri i fataliteteve në tetëmujorin e vitit 2020 është ulur me 16.7%, nga një vit më parë, ndërsa numri i të plagosurve respektivisht me 32.3%.

Në maj të vitit 2020 u miratua udhëzimi i përbashkët i ministrave përgjegjës për transportin dhe i brendshëm nr. 639 prot., datë 17.1.2020, “Mbi kontrollin për gatishmërinë teknike në rrugë të mjeteve tregtare”, i cili përafrohet plotësisht direktivën 2014/47/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 3 prill 2014 mbi kontrollin teknik në anë të rrugës për gatishmërinë teknike të

mjeteve tregtare, që qarkullojnë në Bashkimin Evropian dhe që shfuqizon Direktivën 2000/30/KE.

Legjislacioni në transportin hekurudhor po përmirësohet në mënyrë që të përafrohet me *acquis* të BE-së. Në zbatim të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë” u miratua nga Qeveria Shqiptare paketa ligjore (4 projektligje), të cilat priten të aprovohen nga Kuvendi i Shqipërisë në fillim të vitit 2021, duke përafrohet kështu pjesërisht pjesë të rëndësishme të *acquis* të BE-së, si: direktivën 2012/34, direktivën (BE) 2016/798, direktivën (BE) 2016/797, direktivën 2007/59, rregulloren (BE) 2016/796, rregulloren (KE) 1370/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 23 tetorit 2007, rregulloren (KE) nr. 1371/2007 etj.

Legjislacioni shqiptar për transportin detar po përafrohet me *acquis* të BE dhe, në të njëjtën kohë, Shqipëria po ratifikon konventat ndërkombëtare për transportin detar. Në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit në zbatim të Kodit Detar, me qëllim rregullimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e turizmit detar janë hartuar dhe miratuar aktet ligjore të mëposhtme:

1. Ligji nr. 43/2020, “Për aktivitetet e turizmit detar”;

2. Ligji nr. 127/2020, “Për regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese turistike dhe të argëtimit”;

3. Vendim i KM-së nr. 845, datë 28.10.2020, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e aktiviteteve turistike detare, që kryhen nëpërmjet mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi”.

Në kuadër të aderimit të RSH-së në Memorandumin e Parisit për Kontrollin Shtetëror Portual, MIE në bashkëpunim me institucionet e varësisë si DPD dhe RDSH janë duke zbatuar rekomandimet e lëna nga Grupi i Punës për përmirësimin e performancës së flotës detare shqiptare. Me zbatim të këtyre rekomandimeve është bërë ndryshimi i strukturës së sektorit të Kontrollit Shtetëror të Flamurit duke e shtuar numrin e inspektorëve nga dy në 4 inspektorë dhe është shtuar shefi i sektorit. Gjithashtu janë kryer inspektime të të gjitha mjeteve lundruese me flamur shqiptar si edhe duke monitoruar ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga ky sektor.



Legjislacioni shqiptar në transportin ajror është kryesisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Shqipëria është duke përmbushur kushtet në lidhje me përfundimin e fazës së parë të Marrëveshjes Shumëpalëshe për Themelimin e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit ECAA, duke përfshirë në legjislacionin kombëtar, kuadrin ligjor të BE-së, i përcaktuar në shtojcën I të ECAA, e përditësuar me vendimin e Komisionit Evropian nr. 1/2019 e 31 korrikut 2019. Me ligjin nr. 96/2020, datë 23.7.2020, u miratua Kodi i ri Ajrori i Republikës së Shqipërisë, përafuar me legjislacionin evropian. Gjithashtu gjatë vitit 2020 janë miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë edhe katër akte nënligjore, që përafrojnë akte të BE-së, si më poshtë:

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, i cili përafuron Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 2018/1139 e datës 4 korrik 2018, për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe krijimin e një Agjencie të Sigurisë së Aviacionit të Bashkimit Evropian dhe ndryshimin e Rregulloreve (KE) nr. 2111/2005, (KE) nr. 1008/2008, (BE) nr. 996/2010, (BE) nr. 376/2014 dhe direktivat 2014/30/BE dhe 2014/53/BE, dhe shfuqizimin e rregulloreve (KE) nr. 552/2004, (KE) nr. 216/2008 dhe të rregullores (KEE) nr. 3922/91.

- Urdhri i ministrit nr. 59, datë 31.1.2020, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore”, i cili përafuron Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 965/2012, e datës 5 tetor 2012, për përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative në lidhje me operacionet ajrore në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të ndryshuar me Rregulloret e Komisionit (BE) nr. 800/2013, 83/2014, 379/2014, 2015/140, 2015/640, 2015/1329, 2015/2338, 2016/1199, 2017/363, 2018/394, 2018/1042, 2018/1975;

- Urdhri ministrit nr. 141, datë 16.4.2020, “Për miratimin e rregullores mbi parashtrimin e kërkesave të përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurat operacionale në lidhje me lundrimin ajror në bazë të performancës”, që përafuron Rregulloren e Zbatimit të Komisionit (BE) nr. 2018/1048 e datës 18 korrik 2018, mbi

parashtrimin e kërkesave të përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurat operacionale në lidhje me lundrimin ajror në bazë të performancës;

- Urdhri ministrit nr. 167, datë 4.6.2020, “Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra”, i cili përafuron Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 1321/2014, e datës 26 nëntor 2014, mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra, e ndryshuar me rregulloret e Komisionit (BE) nr. 2015/1088, 2015/1536, nr. 2018/1142, 2019/1384.

14.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për Kapitullin 14, sipas urdhrit të Kryeministrit nr. 94, “Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian” janë si më poshtë:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Autoriteti Rrugor Shqiptar;
- Instituti i Transportit;
- Hekurudha Shqiptare Sh.a.;
- Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor;
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të

Transportit Rrugor;

- Drejtoria e Përgjithshme Detare;
- Regjistri Detar Shqiptar Sh.A.;
- Autoriteti i Aviacionit Civil;
- Instituti i Statistikave (INSTAT).

14.7 Prioritetet

Prioritetet e ministrive dhe institucioneve shqiptare të përfshira në kapitullin 14 janë:

- Fillimi i përgatitjes së Strategjisë Kombëtare të Transportit për periudhën 2021- 2026;

- Hartimi i strategjisë kombëtare për sistemet inteligjente të transportit;

- Zbatimi i Planit të rishikuar kombëtar të transportit (ANTP3);

- Miratimi nga Kuvendi i Shqipërisë i katër projektligjeve në zbatim të Kodit Hekurudhor, që i hap rrugë reformës në sektorin hekurudhor dhe ngritjes së institucioneve përkatëse.



KAPITULLI 15 ENERGJIA

15.1 Përmbajtja e kapitullit

Objektivat e politikës energjetike të BE-së përfshijnë përmirësimin e konkurrencës, sigurinë e furnizimit me energji dhe mbrojtjen e mjedisit. *Acquis* e energjisë përbëhet nga rregulla dhe politika, veçanërisht në lidhje me konkurrencën dhe ndihmat shtetërore (përfshirë sektorin e qymyrit), tregun e brendshëm të energjisë (hapjen e tregjeve të energjisë elektrike dhe gazit, promovimin e burimeve të rinovueshme të energjisë), eficiencën e energjisë, energjinë bërthamore dhe sigurinë bërthamore, si dhe mbrojtja nga rrezatimi.

15.2 Struktura e kapitullit

- siguria e furnizimit
- Tregu i energjisë
- Eficienca e energjisë dhe burimet e rinovueshme të energjisë
- siguria bërthamore dhe mbrojtja nga rrezatimet

15.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Kërkesat e MSA-së në sektorin e energjisë përfshihen në nenin 107, që përcakton se bashkëpunimi energjetik do të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me *acquis* të BE-së në fushën e energjisë, duke përfshirë aspektet e sigurisë bërthamore. Bashkëpunimi në sektorin e energjisë reflekton parimet e ekonomisë së tregut dhe do të bazohet në Traktatin Rajonal të Komunitetit të Energjisë të nënshkruar me qëllim integrimin gradual të Shqipërisë në tregjet e energjisë të Evropës. Përveç kësaj, neni 17(2) parashikon se tregtia e produkteve të mbuluara nga Traktati Themelues i Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike do të bëhet në përputhje me dispozitat e këtij Traktati. Neni 70 parashikon se Shqipëria do të përafrojë gradualisht legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së me qëllim përmirësimin e sektorit të saj energjetik.

Në lidhje me kërkesat e BE-së, politikat në këtë Kapitull hyjnë në grupin e II të kompetencave të BE-së, d.m.th., kompetencat e përbashkëta (neni 4 i TFEU) në fushat ku BE dhe vendet e BE-së janë në gjendje të hartojnë dhe miratojnë akte ligjërishit detyruese. Vendet e BE-së ushtrojnë kompetencat e tyre atje ku BE-ja nuk ushtron, ose ka vendosur të mos ushtrojë, kompetencat e veta.

Objektivat e politikave të energjisë të Bashkimit Evropian janë konkurrueshmëria, siguria dhe qëndrueshmëria e furnizimit. *Acquis* e energjisë përfshin rregullat dhe politikat që rregullojnë konkretisht konkurrencën dhe ndihmën shtetërore, duke përfshirë sektorin e qymyrit, kushtet për akses të barabartë në burime për shqyrtimin, kërkimin dhe prodhimin në sektorin e hidrokarbureve, tregun e brendshëm të energjisë, (hapja e tregjeve të energjisë elektrike dhe gazit), energjinë bërthamore dhe sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimet, ashtu edhe nxitjen e burimeve të energjisë së rinovueshme dhe eficiencës së energjisë. Për sa u përket marrëveshjeve ndërkombëtare, kapitulli përfshin Traktatin e Kartës së Energjisë dhe instrumente të lidhura me të.

15.4 Situata aktuale në Shqipëri

Në përgjithësi, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në sektorin e energjisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Gjatë dy viteve të fundit ka pasur njëfarë përparimi në sektorin e energjiave të rinovueshme, energjisë elektrike dhe gazit dhe në linjat e interkoneksionit. Zbatimi i masave të buta ka vazhduar dhe përgatitjet po bëhen për ngritjen e bursës së energjisë. Aktivitetet vazhduan për të garantuar qëndrueshmërinë ekonomike të sektorit të energjisë elektrike dhe zbatimin e legjislacionit të sektorit të energjisë.

Dokumenti kryesor i politikës në sektorin e energjisë është Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018–2030, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 31.7.2018”. Ajo është në përputhje me përpjekjet kombëtare për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe për të përmbushur angazhimet për Komunitetin e Energjisë, integrimin në BE dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, duke rritur sigurinë e furnizimit me energji dhe duke minimizuar ndikimet mjedisore me kosto të përballueshme për qytetarët shqiptarë dhe të gjithë sektorët e ekonomisë. Legjislacioni shqiptar në lidhje me sigurinë e furnizimit është kryesisht në përputhje me *acquis* e BE-së.

Ligji nr. 7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, ka përafruar pjesërisht Direktivën 94/22/EC, të datës 30 maj 1994 për kushtet për dhënie dhe përdorimin e autorizimeve për zbulim, kërkim dhe prodhimin e hidrokarbureve. Në këtë



ligj përcaktohen bazat mbi të cilat kryhet aktiviteti i kërkimit dhe prodhimit të hidrokarbureve në Shqipëri. Në të janë të përcaktuar procedurat që duhet të ndiqen për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, duke përfshirë si kusht edhe garantimin e sigurisë kombëtare në rastin e lidhjes apo transferimit të kuotave të marrëveshjes hidrokarbure. Në të janë të përcaktuar edhe parimet bazë që duhet të ketë një marrëveshje hidrokarbure.

Për zhvillimin e infrastrukturës së gazit në Shqipëri, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 87, datë 14.2.2018, “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektori të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”. Masterplani i Gazit përcakton linjat kryesore për zhvillimin e tregut dhe shërbimeve të gazit në Shqipëri bazuar në gazin natyror të furnizuar nëpërmjet Gazsjellësit Trans Adriatik Pipeline (Projekti TAP), por edhe vendburime potenciale të gazit të zbuluara dhe konkretizuara në vend, apo edhe nëpërmjet gazsjellësve të tjerë si gazsjellësi Jonian-Adriatik Pipeline (Projekti IAP), gazsjellësi Shqipëri-Kosovë (Projekti ALKOGAP).

Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, është ende në fuqi. Ligji është i përafuar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 2009/119/KE të datës 14 shtator 2009 që vendos një detyrim ndaj Shteteve Anëtare për të ruajtur rezervat minimale të naftës bruto dhe/ose produkteve të naftës. Ligji përcakton detyrimin për të mbajtur një rezervë sigurie për naftën dhe nënproduktet e naftës për 90 ditë të mesatares së shitjeve, duke filluar nga 2010.

Ligji nr. 9876, datë 14.2.2008, “Për prodhimin, transportin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, për transport”, i ndryshuar, është pjesërisht i përafuar me Direktivën 2009/28/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 23 prill 2009 për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme dhe ndryshimin dhe shfuqizimin e Direktivave 2001/77/KE dhe 2003/30/KE.

Legjislacioni shqiptar në tregun e energjisë është kryesisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” është pjesërisht i përputhur me Direktivën 2009/72/EC të Parlamentit Evropian

dhe Këshillit të datës 13 korrik 2009 lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe shfuqizimin e Direktivës 2003/54/EC. Në bazë të këtij ligji, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”. Miratimi i Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike ishte hapi i fundit drejt zhvillimit të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri në një treg të energjisë plotësisht konkurruese, në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Ligji nr. 102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, është pjesërisht i përafuar me direktivën 2009/73/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror dhe shfuqizimin e Direktivës 2003/55/KE. Në bazë të këtij ligji, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 590, datë 9.10.2018, “Për miratimin e modelit të tregut të gazit natyror”. Miratimi i Modelit të Tregut të Gazit është një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit të tregut të gazit në Shqipëri duke garantuar një treg plotësisht konkurruese, në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Ligji nr. 7/2017, datë 2.2.2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” u miratua pjesërisht i përafuar me direktivën 2009/28/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 23 prillit 2009 mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme dhe ndryshimin dhe shfuqizimin e direktivave 2001/77/KE dhe 2003/30/KE. Ligji ka për qëllim të nxisë përdorimin e energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë në Shqipëri, duke synuar në mënyrë indirekte rritjen e sigurisë së furnizimit.

Bazuar në ligjin nr. 7/2017, datë 2.2.2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, janë miratuar aktet nënligjore përkatëse për zbatimin efektiv të tij.

Këshilli i Ministrave ka miratuar Planin Kombëtar të Konsoliduar të Veprimit për Energjitë e Rinovueshme (NREAP) 2019–2020”, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 508, datë 28.8.2019, 738 mw i cili parashikon një rritje mesatare të gjeneruesve të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme në masën 738 mw, nga të cilët:



- 57 mw (HPP);
- 490 mw (PV, energji nga fotovoltaike);
- 150 mw (energji e erës);
- 41 mw (energji nga mbetjet).

Gjithashtu, për të nxitur përdorimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 12.6.2018, “Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe procedurat për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre”. Legjislacioni shqiptar mbi eficiencën e energjisë dhe burimet e rinovueshme të energjisë është në përputhje të pjesshme me *acquis* e BE-së.

Ligji nr. 124/2015, datë 12.11.2015, “Për eficiencën e energjisë”, transponon pjesërisht direktivën 2012/27/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 25 tetorit 2012 mbi eficiencën e energjisë, duke ndryshuar Direktivat 2009/125/KE dhe 2010/30/BE dhe shfuqizuar Direktivat 2004/8/KE dhe 2006/32/KE. Ky ligj, gjithashtu, synon krijimin dhe zbatimin e politikave dhe rregulloreve kombëtare për nxitjen dhe përmirësimin e përdorimit eficient të energjisë, me qëllim kursimin e energjisë sipas objektivave kombëtarë.

Ligji nr. 116/2016, “Për performancën energjetike të ndërtesave” është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2010/31/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 19 maj 2010 mbi performancën energjetike të ndërtesave. Ky ligj rregullon përmirësimin e performancës energjetike të ndërtesave, duke marrë parasysh kushtet lokale të klimës, nivelet e komoditetit të brendshëm të një ndërtese dhe gjithashtu efektivitetin e kostos për ndërtimin e ndërtesave të reja dhe rindërtimin e ndërtesave ekzistuese. Si një kërkesë e ligjit nr. 124/2015, “Për eficiencën e Energjisë”, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 852, datë 7.12.2016, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë për Eficiencën e Energjisë” si institucion përgjegjës për zbatimin e politikave dhe promovimit të masave për eficiencën e energjisë.

Duke synuar arritjen e qëllimeve që lidhen me eficiencën e energjisë në Shqipëri, në zbatim të ligjit nr. 124/2015, datë 12.11.2015, “Për eficiencën e energjisë” u miratua me vendimin e Këshillit të Faqe| 4088

Ministrave nr. 709, datë 1.12.2017, PKVEE i dytë dhe i tretë 2017–2020. Objektivi për eficiencën e energjisë në PKVEE është kursimi i energjisë me 6.8% deri në vitin 2020 dhe lidhet me zbatimin e masave të propozuara për përdorimin e energjisë në ndërtesa, proceset industriale dhe transport, si dhe respektimin e rëndësisë së rolit model që duhet të luajë sektori publik.

Kuadri i politikave në mbrojtjen e rrezatimit përfshin tri dokumente të politikave:

- Politika për menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë, e përgatitur si dokumenti nr. 1319/3 e 25.3.213 nga Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimi;

- Urdhri i ministrit të Shëndetësisë nr. 435, datë 14.10.2015, “Për miratimin e dokumentit ‘Hapat strategjikë për menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë’”. Dokumenti është i vlefshëm për periudhën 2017–2030, duke përcaktuar masat që duhen marrë për menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Shqipëri;

- Urdhri i ministrit të Shëndetësisë nr. 434, datë 14.10.2015, “Për miratimin e dokumentit ‘Arsimi dhe trajnimi për mbrojtjen dhe sigurinë nga rrezatimi jonizues dhe hapat për zbatimin e tij’”, që përcakton masat për trajnimin e personelit që merret me materiale radioaktive.

Akti kryesor ligjor në mbrojtjen e rrezatimit është ligji nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues”, i ndryshuar, pjesërisht i përafëruar me direktivën e Këshillit 2013/59/Euratom të 5 dhjetorit 2013 që përcakton standardet themelore të sigurisë për mbrojtjen kundër rreziqeve që dalin nga ekspozimi ndaj rrezatimit jonizues dhe shfuqizimin e direktivave 89/618/Euratom, 90/641/Euratom, 96/29/Euratom, 97/43/Euratom dhe 2003/122/Euratom. Kjo direktivë është e përafëruar pjesërisht me:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 7.1.2010, “Për miratimin e Rregullores për menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Shqipëri”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 9, datë 7.1.2010, “Për miratimin e Rregullores për kategorizimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 7.1.2010, “Për miratimin e Rregullores për



licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me rrezatim jonizues”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 877, datë 30.10.2015, “Për miratimin e rregullores për mbrojtjen fizike të materialeve radioaktive”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 957, datë 25.11.2015, “Për miratimin e rregullores mbi nivelet e përqendrimit të radonit të brendshëm dhe përqendrimin radioaktiv në mallra, me qëllim mbrojtjen e publikut”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 638, datë 7.9.2016, “Për miratimin e Rregullores për menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 16.11.2016, “Për miratimin e Rregullores për transportin e sigurt të materialeve radioaktive”;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 700, datë 21.11.2018, “Për miratimin e rregullores, “Për përgatitjen dhe reagimin në rast emergjence radiologjike për mbrojtjen e punonjësve dhe të publikut”;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 801, datë 11.12.2019, “Për miratimin e rregullores, “Për mbrojtjen e publikut dhe punëmarrësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimit jonizues, dhe sigurisë ndaj ekspozimeve mjekësore me burimet e rrezatimit jonizues”.

Përveç kësaj, në fushën e mbrojtjes bërthamore dhe rrezatimit, Shqipëria ka ratifikuar konventat e mëposhtme ndërkombëtare:

- Konventa e përbashkët për sigurinë e menaxhimit të lëndës djegëse të përdorur dhe për sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive, ratifikuar me ligjin nr. 10379, datë 24.2.2011, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e bashkuar, “Për sigurinë e menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar dhe për sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive” i cili hyri në fuqi më 27.9.2011;

- Konventa për Sigurinë Bërthamore, ratifikuar me ligjin nr. 10380, datë 24.2.2011, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Sigurinë Bërthamore”, që ka hyrë në fuqi më 27.9.2011;

- Konventa mbi Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore, ratifikuar me ligjin nr. 8853, datë 31.1.2002, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ‘Konventën për Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore”, hyrë në fuqi më

4.4.2002. Amendamentet e Konventës për Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore të ratifikuara me ligjin nr. 88/2013, datë 21.2.2013, “Për ratifikimin e ndryshimeve në Konventën për Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore”, hynë në fuqi më 6.3.2013;

- Konventa për njoftimin e hershëm të një aksidenti bërthamor, e ratifikuar me ligjin nr. 9026, datë 13.3.2003, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ‘Konventën për njoftimin e hershëm të një aksidenti bërthamor”, që hyri në fuqi më 30.10.2003;

- Konventa për ndihmën në rastin e një aksidenti bërthamor ose të emergjencave radiologjike, ratifikuar me ligjin nr. 9015, datë 20.2.2003, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për ndihmë në rast aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjik”, e cila hyri në fuqi më 31.5.2003;

- Konventa mbi protokollin shtesë, ratifikuar me Ligjin Nr. 10314, datë 16.9.2010, “Për ratifikimin e Protokollit Shtesë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike për zbatimin e garancive për të gjitha aktivitetet bërthamore në Shqipëri”, e cila hyri në fuqi më 3.11.2010.

15.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe Urdhrit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 157, datë 12.2.2018, “Për krijimin e tri kompanive të kontrolluara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, OSHEE sh.a., në cilësinë e Aksionarit Themelues ka themeluar tri kompani të reja të kontrolluara si më poshtë:

- Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU), me objekt të aktivitetit “Furnizimi me energji elektrike i klientëve fundorë që operojnë në tregun e rregulluar të përcaktuar me legjislacionin në fuqi”;

- Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL), me objekt të aktivitetit “Blerja dhe menaxhimi i energjisë elektrike dhe operimi në tregun e lirë etj.”;

- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), me objekt të aktivitetit “Shpërndarja e energjisë elektrike, ndërtimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për furnizimin me energji elektrike konsumatorëve, lidhja e konsumatorëve dhe shfrytëzuesve të rrjetit



të shpërndarjes së energjisë elektrike, shërbimet e matjes etj.”.

Nga 1 janari 2020, kemi ndarje ligjore dhe funksionale OSHEE sh.a., dhe 3 shoqëritë bija të cilësuara më lart operojnë sot në përputhje me licencat e lëshuara nga ERE-s sipas aktivitetit që ato ushtrojnë.

Gjithashtu, në përputhje me ndryshimet ligjore të ligjit për sektorin e energjisë, nr. 61/2020, datë 14.5.2020, neni 9 në pikat 1 dhe 2, u garantuan të drejta efektive të vendimmarrjes së operatorit të sistemit të shpërndarjes të pavarur nga ndërmarrja e integruar e energjisë elektrike, lidhur me asetet e nevojshme për funksionimin, mirëmbajtjen ose zhvillimin e rrjetit të Shpërndarjes, si dhe krijimi i një programi pajtueshmërie dhe një zyrtari pajtueshmërie përgjegjës për monitorimin e programit të pajtueshmërisë, i cili përcakton masat që do të merren për të siguruar ndalimin e veprimeve diskriminuese, dhe të sigurojë që respektimi i programit të monitorohet në mënyrën e duhur. Zyrtari i pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes është plotësisht i pavarur dhe paraqet çdo vit në ERE një raport vjetor.

Në mbështetje të nenit 57, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” (të ndryshuar), vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 322, datë 15.5.2019 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 609, datë 11.9.2019, është vendosur krijimi i Operatorit të Tregut (Bursa Shqiptare e Energjisë), si struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e tregut të organizuar nëpërmjet platformës së tregut, i cili do të operojë në fushën e shkëmbimit të energjisë elektrike në Shqipëri, në formën e një shoqërie aksionare, të ndarë financiarisht dhe ligjërisht nga “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a.

Gjatë vitit 2020 u krye përzgjedhja e personave të tjerë juridikë si pjesë e strukturën e pronësisë së kapitalit të Operatorit të Tregut (përveç “Operatorit të Sistemit të Transmetimit” sh.a. – OST sh.a.) u krye përmes procedurës konkurruese përzgjedhëse, nga Komisioni i Posaçëm i ngritur nga Ministri i MIE-s dhe ministri i MFE-së nëpërmjet urdhrit të përbashkët nr. 1851, datë 18.2.2020. Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a. dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës, nënshkruan më datë 5 tetor 2020 Marrëveshjen e Aksionarëve për

themelimin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) si dhe miratuan Statutin e saj.

Shqipëria synon të zhvillojë një venddepozitim nëntokësor të gazit natyror në Dumre, pranë Elbasanit (*Projekti UGS Dumrea*). Në dhjetor 2018 Komiteti Drejtues i WBIF miratoi një grant për financimin e projektit për përgatitjen e studimit të Fizibilitetit dhe të VNMS-së për projektin UGS Dumrea, në shumën 1 milion euro. Termat e referencës për përgatitjen e studimit të fizibilitetit dhe të VNMS-në për projektin WB20- ALB-ENE-01 “*Albania, Dumrea Underground Gas Natural Storage*” u përgatitën nga konsulenti dhe u miratuan nga WBIF-ja dhe BERZH- i më 24 tetor 2019. Konsulenti është në fazën e përgatitjes së Studimit të Fizibilitetit dhe Vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe social.

Në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018–2030, dhe urdhrit të Kryeministrit nr. 52, datë 7.3.2019, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për energjinë dhe klimën”, gjatë vitit 2020 vijoi puna për hartimin e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, i cili parashikohet të miratohet në tremujorin e fundit të vitit 2021.

Amendimi i ligjit nr. 124/2015, “Për eficiencën e energjisë” është në proces dhe parashikohet miratimi i tij brenda vitit 2020.

Në zbatim të ligjit nr. 116/2016, “Për performancën e energjisë së ndërtesave” janë miratuar katër vendime të Këshillit të Ministrave, përkatësisht:

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 537, datë 8.7.2020, “Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementeve të ndërtesave”;

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 256, datë 27.3.2020, “Për metodologjinë për llogaritjen e niveleve të koston optimale për kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave, njërive dhe elementeve të ndërtesave”;

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 2.12.2020, “Për procedurat dhe kushtet e certifikimit të performancës së energjisë së ndërtesave dhe modeli, përmbajtja, kushtet e regjistrimit të “Certifikatës për performancën e energjisë” të ndërtesave përkatëse;

4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 954, datë 25.11.2020, “Për kriteret dhe procedurat për mënyrën e përzgjedhjes dhe sasinë e certifikatave



që do të verifikohen, si dhe procesi i mbikëqyrjes së certifikatave të performancës së energjisë të ndërtesave”.

Ndërkohë është në proces miratimi brenda vitit 2020, projektvendimi i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa”.

15.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Agjencia Kombëtare Bërthamore;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimi;
- Enti Rregullator i Energjisë;
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;
- Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.

15.7 Prioritetet

- Diversifikimi i prodhimit të energjisë elektrike përveç burimeve hidrike dhe promovimi i burimeve alternative të energjisë së rinovueshme duke respektuar standardet mjedisore, si edhe ngritja e tregut të energjisë elektrike të ditës paraardhëse;

- Finalizimi i ndarjes së ndërmarrjeve energjetike dhe shfuqizimi i pengesave ligjore për të drejtën e klientëve për të ndryshuar furnitorin e energjisë elektrike;

- Përafrimi i plotë i Ligjit për Eficiencën e Energjisë me *acquis*, hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore që zbatojnë Direktivën e Performancës së Energjisë së Ndërtesave.

- Miratimi i Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (2022–2030) brenda viti 2021.

KAPITULLI 16

TATIMET

16.1 Përmbajtja e kapitullit

Rregullat e BE-së për tatimet mbulojnë tatimin mbi vlerën e shtuar dhe detyrimet e akcizës si dhe aspekte të tatimit të korporatave. Gjithashtu, këto rregulla disiplinojnë bashkëpunimin ndërmjet administratave tatimore, përfshirë shkëmbimin e informacionit për parandalimin e evazionit tatimor.

16.2 Struktura e kapitullit

- Tatimi i tërthortë: Tatimi mbi vlerën e shtuar dhe detyrimet e akcizës

- Tatimi i drejtpërdrejtë

- Bashkëpunimi administrativ dhe ndihma e ndërsjellë

16.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Neni 98 i Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit parashikon se, Shqipëria dhe BE-ja do të vendosin bashkëpunimin në fushën e tatimeve. Ky bashkëpunim përfshin masat që synojnë forcimin e reformave të mëtejshme në sistemin fiskal dhe ristrukturimin e administratës tatimore, me qëllim që të sigurohet efikasitet në mbledhjen e taksave dhe luftën kundër evazionit fiskal. Për më tepër, ky bashkëpunim duhet të marrë në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* e BE-së në fushën e tatimeve dhe të luftës kundër konkurrencës së dëmshme të tatimeve. Në këtë drejtim, Shqipëria dhe BE-ja e njohin rëndësinë e përmirësimit të transparencës dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i masave që parandalojnë mospagimin ose evazionin tatimor. Gjithashtu, ky nen kërkon konsultime ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve Anëtare të BE-së, me qëllim që të eliminohet konkurrenca e dëmshme e tatimeve midis tyre, për të siguruar një nivel të barabartë për sa i përket tatimit të biznesit.

Acquis në fushën e tatimeve mbulon gjerësisht fushën e tatimeve indirekte, që përfshin Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) dhe detyrimet e akcizës. Ai përcakton fushën e zbatimit, përkufizimet dhe parimet e TVSH-së. Detyrimet e akcizës mbi produktet e duhanit, pijet alkoolike dhe produktet energjike janë gjithashtu objekt i legjislacionit të Bashkimit Evropian (BE). Për sa u përket tatimeve direkte, *acquis* mbulon disa aspekte të tatimit mbi të ardhurat nga kursimet e individëve dhe tatimet e korporatave.

Acquis në fushën e tatimit të drejtpërdrejtë ka të bëjë me aspekte të caktuara të tatimeve të fitimit dhe shmangies së taksimit të dyfishtë. Fokusi është në eliminimin e parregullsive për aktivitetet ekonomike ndërkufitare ndërmjet ndërmarrjeve brenda Bashkimit. Kodi i Sjelljes për Taksimin e Biznesit përfaqëson një angazhim politik nga Shtetet Anëtare për të trajtuar konkurrencën e dëmshme tatimore. Shtetet Anëtare janë të detyruara të mos vendosin masa të reja të dëmshme tatimore dhe të rikthejnë ato ekzistuese.

Legjislacioni i BE-së në fushën e bashkëpunimit administrativ dhe asistencës së ndërsjellë midis autoriteteve tatimore dhe doganore të Shteteve



Anëtare siguron mjete për të shkëmbyer informacione me qëllim parandalimin e evazionit fiskal dhe shmangien e tyre dhe ndihmën e tyre në zbatimin e legjislacionit doganor. Informacione të caktuara lidhur me tatimet dhe doganat shkëmbehen automatikisht, informacione të tjera shkëmbehen në mënyrë spontane ose pas një kërkesë.

Acquis në fushën e kapaciteteve operacionale dhe kompjuterizimit mbulon fusha të ndryshme të taksimit. *Acquis* për Sistemin e Shkëmbimit të Informacionit mbi Vlerën e Shtuar (VIES) parashikon shkëmbimin e drejtpërdrejtë elektronik të të dhënave ndërmjet administratave kombëtare të TVSH-së. Kjo lejon që administratat kombëtare të monitorojnë dhe kontrollojnë tregtinë brenda BE-së dhe të zbulojnë parregullsi të mundshme. Lidhur me akcizat, *acquis* kërkon që sistemet e IT-së t'u lejojnë Shteteve Anëtare të shkëmbejnë informacion mbi prodhuesit dhe tregtarët e produkteve të akcizës. Sisteme të tilla janë Regjistri Evropian i operatorëve (Sistemi për Shkëmbimin e të Dhënave të Akcizave -SEED) dhe sistemi për monitorimin e Shërbimeve Qendrore/Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Akcizat (CS/MISE). Lëvizjet e mallrave të akcizës nën regjimin e pezullimit mbikëqyren brenda BE-së nëpërmjet Sistemit Elektronik të Lëvizjes dhe Kontrollit të Akcizës (EMCS). Në fushën e tatimit të drejtpërdrejtë, Shtetet Anëtare duhet të vendosin një sistem të shkëmbimit automatik të informacionit për pesë kategori të të ardhurave dhe kapitalit (të ardhurat nga punësimi, tarifrat e drejtorëve, pensionet, produktet e sigurimit të jetës dhe pronësia e të ardhurave nga pronat e paluajtshme (dividentë, fitime kapitale, të ardhura të tjera të gjeneruara në lidhje me pasuritë e mbajtura në një llogari financiare, çdo shumë në lidhje me faktin nëse një institucion financiar është obliguesi apo debitori, duke përfshirë pagesat e riblerjes, balancat e llogarisë) përmes formave të kompjuterizuara standarde.

16.4 Situata aktuale në Shqipëri

Shqipëria është përgjithësisht e përgatitur në fushën e tatimeve. Është bërë progres në përafrimin e legjislacionit me *Acquis* për TVSH-në, akcizat. Janë miratuar akte ligjore në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndihmën e ndërsjellë në fushën e tatimeve konkretisht: Konventa shumëpalëshe (MLI) për zbatimin e

masave që lidhen me marrëveshjet për shmangien e tatimit të dyfishtë për parandalimin e erozionit të bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit (BEPS), Shkëmbimi Automatik i Informacionit (AEOI) sipas standardit CRS të OECD-së, Regjistri i Llogarive Bankare (BAR) etj. Progrese janë arritur edhe në zhvillimin e mëtejshëm organizativ të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe ngritjes së kadasrës fiskale për administrimin e tatimit mbi pasurinë.

Performanca e të ardhurave tatimore për vitin 2019 është mbi nivelet e vitit 2018 +1.7 % ose +7 miliardë lekë me shumë.

Në fushën e tatimit të tërthortë, norma standarde e TVSH-së është 20%. Ndërkohë që, përveç normës standarde, aplikohet edhe norma e reduktuar e TVSH-së prej 6% për furnizimet e përcaktuara në nenin 49 të ligjit nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

Përfshirjet nga TVSH-ja për furnizimet pa të drejtë të zbritjes së TVSH-së janë përgjithësisht në përputhje me *Acquis*. Me ligjin nr. 85/2019, datë 18.12.2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019, u miratuan disa përfshirje nga TVSH-ja që lidhen me procesin e ndërtimit, të cilat konsistojnë në mbështetjen e procesit të rindërtimit të zonave të prekura nga fatkeqësia natyrore e datës 26 nëntor 2019.

Lidhur me kufirin minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar, nga 1 janar 2021, do të aplikohet si kufi minimal i regjistrimit, qarkullimi prej 10 milionë lekë në një vit kalendarik, bazuar në përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 576, datë 22.7.2020, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 139, datë 29 korrik 2020. Ndërkohë që, çdo person i tatueshëm që ka një qarkullim vjetor më të madh se 5 milionë lekë, ka të drejtë të zgjedhë të zbatojë regjimin normal të TVSH-së.

Akciza e duhanit është rritur gradualisht sipas kalendarit të përcaktuar në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, aktualisht është 6 250 lekë për 1 000 cigare dhe nga 1 janari 2021, do të jetë 6 500 lekë për 1 000 cigare.

Me ligjin nr. 98/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i cili është



në fuqi që nga 1 janar 2019 është vendosur për herë të parë si produkt akcize duhani me ngrohje. Për duhan me ngrohje, produkte duhani të riformuar dhe me substanca të tjera, që konsumohen nga një proces ngrohje nëpërmjet një aparati elektronik për ngrohje duhani, niveli i taksimit është 6 000 lekë/kg.

Ligji kombëtar për Akcizat përfshin të gjitha produktet energjetike të listuara në direktivën 2003/96/KE, përveç elektricitetit.

Sa u përket tatimeve mbi të ardhurat personale, institucionet financiare llogarisin, mbajnë në burim dhe transferojnë në llogarinë e buxhetit të qeverisë tatin mbi të ardhurat nga interesat e depozitave të kursimit.

Shqipëria i është bashkuar Kornizës Përfshirëse të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) mbi Erozionin e Bazës së Tatueshme dhe Transferimin e Fitimit në gusht të vitit 2019. Në këtë kuadër Konventa Shumëpalëshe (MLI), për zbatimin e masave që lidhen me Marrëveshjet për Shmangien e Tatimit të Dyfishtë për parandalimin e Erozionit të Bazës së Tatueshme dhe Transferimin e Fitimit (BEPS), u miratua në parlament me ligjin nr. 93 datë 16.7.2020 dhe u dorëzua instrumenti i ratifikimit pranë OECD. Kjo Konventë hyn në fuqi në datën 1.1.2021. Gjithashtu, do të vijojë puna për plotësimin e standardeve minimale të projektut ndërkombëtar BEPS.

Për bashkëpunimin administrativ dhe ndihmën reciproke, Shqipëria në plan afatgjatë pritet të nënshkruajë marrëveshje të taksimit të dyfishtë me Danimarkën, Qipron, Lituaninë, Portugalinë, Sllovakinë dhe Finlandën.

Lidhur me progresin në çështjet administrative dhe asistencë të ndërsjellë, do të hartohet një plan veprimi për negocimin e marrëveshjeve për taksimin e dyfishtë. Kështu, brenda vitit 2021 planifikohet të zhvillohet raundi i dytë i negociatave në nivel teknik me Finlandën dhe raundi i parë me Sllovakinë, sigurisht kjo duke u bazuar edhe në disponueshmërinë e palës tjetër. Gjithashtu do të rifillohet komunikimi me Danimarkën, Qipron, Lituaninë dhe Portugalinë.

Konventa për Ndihmën Administrative të Ndërsjellë në Çështjet Tatimore është ratifikuar në Parlament me ligjin nr. 146/2013, datë 6.5.2013. Bazuar në Konventën për Ndihmën Administrative të Ndërsjellë në Çështjet Tatimore,

të cilën vendi ynë e ka nënshkruar si vend anëtar i Këshillit të Evropës, Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe vendet anëtare të Organizatës për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik (OECD), nënshkruese në këtë konventë, i japin njëra-tjetrës ndihmë administrative të ndërsjellë në çështjet tatimore.

Shqipëria, më datë 29.10.2014, ka nënshkruar “Marrëveshjen shumëpalëshe të autoriteteve kompetente për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”, miratuar me VKM-në nr. 178, datë 9.3.2016. Është miratuar ligji nr. 4/2020, “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare” me objekt adoptimin dhe zbatimin e Shkëmbimit Automatik të Informacionit në llogaritë financiare për qëllime tatimore, sipas standardeve të përbashkëta të raportimit. Për arritjen e këtij angazhimi, DPT-ja është asistuar nga ekspertë të administratës tatimore italiane (*Agenzia delle Entrate*) nëpërmjet projektit të financuar nga Agjencia Italiane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe asistencës së ekspertit nga OECD.

Përpara shkëmbimit të parë të informacionit, nevojitet krijimi i bazës ligjore dhe i infrastrukturës së nevojshme, përfshirë sistemin e IT-së së DPT-së për zbatimin e këtij angazhimi. Për këtë qëllim është miratuar nga Këshilli i Ministrave vendimi nr. 613, datë 29.7.2020, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 4/2020, “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”. Infrastruktura IT është ngritur dhe është në fazën e testimit. Institucionet Financiare do t'i raportojnë DPT-së informacionin mbi llogaritë financiare brenda 15 nëntorit 2020, ndërsa DPT do t'ua raportojë këtë informacion autoriteteve tatimore homologe përkatëse brenda dhjetorit 2020.

16.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Me urdhrin nr. 33, datë 12.2.2020 të Kryeministrit është miratuar “Struktura organizative e Administratës Tatimore Qendrore” dhe me urdhrin e ministrit të Financave nr. 79, datë 27.3.2020 është miratuar “Organigrama e Administratës Tatimore Qendrore” me një numër prej 1450 punonjësish, nga të cilët 1122 trajtohen me status nëpunësi civil dhe 328 trajtohen me dispozita të Kodit të Punës. Në përfundim të implementimit të strukturës, aktualisht rezultojnë 181 vende vakante me status Nëpunësi Civil dhe 19 vende vakante me Kod Pune, duke sqaruar se



vakanca është relativisht e ndryshueshme. Për plotësimin e vakancës sqarojmë se janë pasqyruar dhe planifikuar në Sistemin HRMIS të DAP-it të gjitha vendet vakante.

Lidhur me strukturën e re organizative, rreth 75 vende të lira pune u pasqyruan në sistemin *online* të Departamentit të Administratës Publike.

Gjatë vitit 2020 janë punësuar gjithsej 43 punonjës/nëpunës, nga të cilët 7 nëpunës emëruar në pozicione pune me status nëpunësi civil, sipas procedurave të DAP-it, 5 nëpunës civil janë emëruar në zbatim të vendimeve gjyqësore dhe 31 punonjës të emëruar në pozicione që trajtohen sipas dispozitave të Kodit të Punës. Gjatë këtij viti, 3 punonjës/nëpunës janë larguar nga detyra për shkak të masave disiplinore.

Programi vjetor i trajnimeve për vitin 2020 u miratua nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, bazuar në nevojat e administratës tatimore. Gjithashtu, në bashkëpunim me Akademinë Fiskale u miratua me vendimin nr. 1, datë 21.1.2019 nga bordi i saj pranë MFE, Programi Vjetor i Trajnimit për vitin 2020, për të gjithë nivelet në Administratën Tatimore Qendrore. Ndërkohë që për vitin 2019 sipas programit të trajnimeve janë trajnuar gjithsej 1 367-nëpunës/punonjës, aktualisht janë trajnuar gjithsej 610 nëpunës/punonjës të administratës tatimore.

Administrata tatimore me strukturat e monitorimit në terren ka kryer 12 915 verifikime me shtrirje në të gjithë territorin e vendit ku janë konstatuar 3 797 subjekte me shkelje të legjislacionit tatimor. Referuar periudhës: 28 shkurt–10 mars janë mundësuar 90 kontrolle dhe janë konstatuar 21 shkelje të legjislacionit tatimore; dhe pas 14 marsit janë ushtruar 577 kontrolle në terren dhe janë konstatuar 328 shkelje të legjislacionit tatimor.

Nga të dhënat e marra deri më datë 31 gusht 2020, nga ana e strukturave të terrenit nga kontrollet e kryera në bashkëpunim me Task-Forcën Ndërinstitucionale janë plotësuar dhe formularët në Google-Form “Vlerësime të subjekteve tregtare ndaj masave të marra për parandalimin e COVID-19” në 6 042 raste, në të cilat janë raportuar me problem (moszbatimi i masave) vetëm 1 869 raste.

Gjatë periudhës tetor 2019–gusht 2020, si rezultat i planit operacional “Informaliteti në tregun e punës - Mosdeklarimi i saktë i pagës” dhe i

mënyrave të reja të komunikimit me tatimpaguesit, shohim një rritje të të ardhurave në vlerën 238.4 milionë lekë, përkatësisht +167.2 milionë lekë për kontribute dhe +71.2 milionë lekë për TAP-in.

DPT-ja finalizoi (datë 16.4.2020) nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit me OSHEE për shkëmbimin e të dhënave, duke i shtuar të dhëna të reja në dispozicion vlerësimit në bazë të riskut që do t’u bëhet tatimpaguesve. E njëjta gjë pritet të ndodhë brenda tetorit 2020, dhe me UKT dhe me Bashkinë e Tiranës.

Rimbursimi. Administrata tatimore ka përmirësuar ndjeshëm volumin, procedurat dhe afatet e rimbursimit të TVSH-së. Nëse në vitin 2018 u rimbursuan 14.4 miliardë lekë, në vitin 2019 u rimbursuan 23.5 miliardë lekë, ose 63% më shumë. Nëse stoku i TVSH-së së parimbursuar në afat në fund të vitit 2018 ishte 16.8 miliardë lekë, në fund të vitit 2019 ai u ul në 11.2 miliardë lekë ose me 34%. Në fund të vitit 2020 stoku do zbrësë në rreth 8 miliardë lekë ose rreth - 30% krahasuar me fundin e vitit 2019.

Duke filluar nga muaji dhjetor 2019, Administrata Tatimore rimbursos brenda afatit ligjor çdo tatimpagues të vogël dhe të mesëm, duke i dhënë prioritet kompanive eksportuese dhe atyre investuese. Stoku i mbetur i TVSH-së përfshin 2–3 investitorë të mëdhenj ku vetëm operatori TAP ka 73% të tij. Bazuar edhe në ndryshimet ligjore të miratuara, stoku i TVSH-së për këta 2–3 investitorë të mëdhenj vazhdon të paguhet me këste mujore, bazuar në marrëveshjet e arritura me ta. Parashikohet që ky stok të bëhet zero brenda 6-mujorit të parë të vitit 2021, që do të thotë se në vijim nuk do të ketë asnjë subjekt që nuk rimbursohet në afatet e përcaktuara ligjore. Pra administrata tatimore mbyll përfundimisht këtë problem shumëvjeçar.

16.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për këtë kapitull janë Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfaqësuar kryesisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Drejtorja e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale harton ligjet fiskale, duke respektuar programin ekonomik.



Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) është Institucioni kryesor tatimor në Republikën e Shqipërisë dhe ka autoritetin për të zbatuar ligjet tatimore, duke administruar taksat dhe tarifën kombëtare, të përcaktuara me ligjet përkatëse. Qëllimi kryesor i DPT-së është të ndihmojë tatimpaguesit që të paguajnë detyrimet e tyre tatimore në përputhje me ligjet e aplikueshme tatimore dhe të sigurojë që të ardhurat nga këto taksa të shkojnë në llogaritë e buxhetit të shtetit, duke u ofruar tatimpaguesve një sistem efektiv pagesash.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) është Institucioni kryesor doganor në Republikën e Shqipërisë dhe ka autoritetin për të zbatuar ligjin për Akcizat në RSH, duke administruar detyrimet e akcizës në prodhimin e brendshëm dhe në import.

16.7 Prioritetet

Është planifikuar që në vitin 2020 të ndryshojë ligji, “Për tatimin mbi të ardhurat”, me synim përafrimin e pjesshëm të direktivës 2009/133/EC. Me këto ndryshime do të përafrohet pjesërisht direktiva 2009/133/EC e datës 19 tetor 2009 mbi sistemin e përbashkët tatimor të zbatueshëm për bashkimet, shkëmbimet, shkëmbimet e pjesshme, transferimet e aseteve dhe shkëmbimet e aksioneve në lidhje me kompanitë e Shteteve të ndryshme Anëtare dhe për transferimin e zyrës së regjistruar të SE ose SCE ndërmjet Shteteve Anëtare.

Në këtë kuadër është draftuar projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998”, i cili synon përafrimin e pjesshëm të direktivës 2009/133/EC. Drafti i projektligjit pas konsultimeve me ministrin e linjës dhe grupet e interesit synohet të dërgohet për miratim në parlament brenda këtij viti, referuar kjo dhe afateve të përcaktuara në PKIE 2020–2022. Parashikohet që ky projektligj të hyjë në fuqi në vitin 2021.

Ligji i ri për tatimin mbi të ardhurat është planifikuar të prezantohet në vitin 2023. Ky ligj do të trajtojë çështje që lidhen me tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin mbi fitimin duke synuar harmonizimin me ndryshimet ekonomike gjatë viteve të fundit. Gjithashtu, synohet harmonizimi i mëtejshëm i direktivave në fushën e tatimeve direkte.

Një tjetër prioritet fokusohet te përpjekjet e mëtejshme për të negociuar marrëveshje të tatimit të dyfishtë, veçanërisht me shtetet e BE-së. Gjithashtu, për të adresuar përsëritjen e vonësve

në rimbursimet e TVSH-së dhe shmangien e shumave të mëdha të borxheve, objektivi i Administratës Tatimore për vitin 2021 është që stoku i TVSH-së të zerohet.

Lidhur me politikën tatimore, prioritet mbetet përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si edhe përmirësimi i administrimit të tatimeve në rritjen e bazës së tatueshme. Ky objektivi strategjik do të realizohet nëpërmjet:

- harmonizimit të mëtejshëm të politikave tatimore me *acquis* e BE-së;
- krijimit të klimës së biznesit të favorshme për zhvillimin dinamik të sipërmarrjes private dhe tërheqjen e investimeve të huaja;
- formulimit të politikave tatimore që mbështesin zhvillimin ekonomik dhe social në Shqipëri dhe nxisin formalizimin e ekonomisë;
- përmirësimit të menaxhimit të administratës tatimore, duke u bazuar në realizimin e të ardhurave me profesionalizëm, integritet dhe ndershmëri, me një standard që krijon besueshmëri te qytetarët dhe kredibilitet me partnerët ndërkombëtarë dhe komunitetin e biznesit vendës dhe të huaj.

KAPITULLI 17

POLITIKA EKONOMIKE DHE MONETARE

17.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis në fushën e politikës ekonomike dhe monetare rregullohet nga Titulli VIII (nenet 119 deri 144) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), dhe nga legjislacioni përkatës zbatues. Dispozitat e Traktatit që lidhen me miratimin e euros nuk zbatohen për Shtetet Anëtare me një përjashtim të përkohshëm siç përcaktohet në nenin 139 të TFEU.

Legjislacioni përmban rregulla specifike që kërkojnë pavarësinë e bankave qendrore në Shtetet Anëtare, duke ndaluar financimin e drejtpërdrejtë të sektorit publik nga bankat qendrore dhe duke ndaluar qasjen e privilegjuar të sektorit publik në institucionet financiare. Shtetet Anëtare i konsiderojnë politikën e tyre ekonomike si një çështje me interes të përbashkët dhe i nënshtrohen një mbikëqyrje më të gjerë fiskale, ekonomike dhe financiare. Ata janë të detyruar gjithashtu t'u përmbahen rregullave të detajuara në lidhje me karakteristikat e kuadrit të tyre kombëtar në fushën



e buxhetit. Shtetet e reja Anëtare duhet të përmbushin gjithashtu kriteret e përcaktuara në Traktat në mënyrë që të jenë në gjendje të adoptojnë euron në kohën e duhur pas anëtarësimit. Deri atëherë, ata do të jenë një Shtet Anëtar me përjashtim nga përdorimi i euros dhe do të trajtojnë politikat e tyre të kursit të këmbimit si një çështje me interes të përbashkët.

17.2 Struktura e kapitullit

- Politika ekonomike;
- Politika monetare.

17.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Neni 87 i MSA-së përcakton bashkëpunimin në fushat e politikave ekonomike dhe tregtare, duke theksuar se Komuniteti dhe Shqipëria do të lehtësojnë procesin e reformës ekonomike nëpërmjet bashkëpunimit për të përmirësuar të kuptuarit e bazave të ekonomive të tyre përkatëse dhe formulimit e zbatimit të politikës ekonomike në ekonominë e tregut. Me kërkesë të autoriteteve shqiptare, Komuniteti mund të ofrojë asistencë të disenjuar për të mbështetur përpjekjet e Shqipërisë për krijimin e një ekonomie tregu funksionale dhe përafrimin gradual të politikave të saj me politikat e orientuara drejt stabilitetit të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar.

Acquis përbëhet kryesisht nga dispozitat dhe protokollet e Traktatit, si dhe rregulloret dhe vendimet që nuk kërkojnë transpozim në legjislacionin kombëtar. Megjithatë, siç tregohet në nenin 131 të TFBE, secili Shtet Anëtar do të sigurojë që legjislacioni i tij kombëtar, duke përfshirë edhe statutet e bankës qendrore, të jetë në përputhje me TFBE dhe Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane (Statuti i ESCB/ECB). Rregulloret sipas këtij kapitulli u kërkojnë shteteve anëtare të identifikojnë rreziqet e mundshme, parandalojnë ose korrigjojnë çdo deficit fiskal të tepërt si dhe pabarazitë makroekonomike të dëmshme. Direktiva 2011/85 përcakton kërkesat për kuadrot buxhetore të Shteteve Anëtare dhe kërkon transpozimin në rendin juridik dhe administrativ të vendit.

17.4 Situata aktuale në Shqipëri

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e politikës ekonomike dhe monetare. Banka e Shqipërisë ka arritur të menaxhojë me sukses goditjet e krizës shkaktuar nga pandemia. Ligji Faqe| 4096

organik garanton funksionimin e rregullt, në mënyrë të pavarur dhe transparente të Bankës së Shqipërisë. Megjithatë, siç konstaton dhe raporti i fundit i Raport Progresit, përafrimi i mëtejshëm i Ligjit të Bankës së Shqipërisë me *acquis* mbetet një nga prioritetet kryesore.

Politika ekonomike

Në muajin prill dhe maj 2020, qeveria rishikoi buxhetin e vitit 2020, në mënyrë që të përfshinte shpenzimet shtesë për të përballuar rënien ekonomike, për shkak të pandemisë, duke rishikuar deficitin fiskal të planifikuar nga 2.2.% në 3.9%, duke pritur një rënie të ardhurave dhe për të parashikuar financimin shtesë të deficitit. Masat buxhetore kishin për qëllim sigurimin e fondeve shtesë në sektorin e shëndetësisë, mbështetje për bizneset dhe personat e vetëpunësuar të impaktuar nga kufizimet, si dhe të zbusin impaktin social dhe ekonomik të pandemisë. Për më tepër, qeveria lejoi të vonojë disa pagesa taksash, të heqë penalitetet për pagesat e vonuara të utiliteteve dhe ofroi garanci sovraane për huat për biznese. Shqipëria dorëzoi Programin e saj të Reformave Ekonomike 2020- 2022 në kohë, por kriza e COVID-19, i ktheu projeksionet makroekonomike dhe prioritetet e politikave, gjerësisht të tejkaluara.

Në kuadër të rekomandimit të Komisionit Evropian në Raport Progresin për Shqipërinë, të publikuar së fundmi (tetor 2020), Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF), në funksion të hartimit të dokumenteve që ajo prodhon/kontribuon (ERP dhe Buxheti Vjetor), kryen konsultime me palët e interesit. Për ERP-në kryhen konsultime dhe dëgjesa si me institucionet e tjera të Qeverisë (ministrinë e linjës) dhe institucionet e varësisë, po ashtu dhe me palët e interesit për çështje të ndryshme në varësi të politikave strukturore që janë prezantuar dhe propozuar. Pothuaj e njëjta procedurë ndiqet dhe për etapat e hartimit të Buxhetit Vjetor.

Në ndërlidhjen mes Qeverisë dhe palëve private, vijnë në ndihmë dhe struktura të pavarura që kanë për objektiv të lehtësojnë dialogun midis përfaqësuesve të komunitetit të biznesit, organizatave ndërkombëtare, donatorëve dhe qeverisë për zhvillimin e një klime të favorshme, jodiskriminuese dhe transparente të biznesit dhe investimeve, lehtësojnë zhvillimin e besimit të ndërsjellë midis komunitetit të biznesit dhe qeverisë në Shqipëri dhe kontribuojnë në një



institucionalizim në rritje të dialogut efektiv të politikave. Këtu mund të përmendim Këshillin e Investimeve (KI), mandati i të cilit përcaktohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 294, datë 8 Prill 2015. Krahas Këshillit të Investimeve, struktura të tjera që ndihmojnë për të njëjtin qëllim, janë: Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, Këshilli Konsultativ Qeveri Qendrore–Vetëqeverisje Vendore, Këshilli Kombëtar i Punës, Këshilli Konsultativ i Punësimit, Këshilli Ekonomik Kombëtar etj.

Statistikat e EDP dhe GFS në Shqipëri

Shqipëria, si vend kandidat për anëtarësim në BE ka detyrimin e hartimit dhe dërgimin në Eurostat të Tabelave të Njoftimit të EDP-së, si dhe të treguesve shtesë lidhur me statistikën financiare të qeverisë dhe po punon intensivisht prej disa vitesh tashmë edhe nëpërmjet projektit “Përmirësimi i Kapaciteteve për Statistikat Financiare të Qeverisë (GFS), në vendet e Evropës Juglindore”, i financuar nga SECO²⁴.

Në bazë të memorandumit të bashkëpunimit (viti 2016) midis INSTAT, BSH dhe MEF, këto tri institucione bashkëpunojnë për prodhimin konform standardeve evropiane të statistikave financiare të qeverisë dhe Tabelave të Njoftimit të EDP. Kështu, MEF është institucioni kryesor në burimin e të dhënave në kuadër të përgjegjësisë institucionale për prodhimin dhe shpalljen e statistikave financiare të qeverisë (GFS). INSTAT-i është përgjegjës për transmetimin në Eurostat të Tabelave të Njoftimit të EDP, dhe njëkohësisht harton statistikën jofinanciare të qeverisë të përgjithshme. Gjithashtu, në kuadër të hartimit të harmonizuar të Tabelave të Njoftimit të EDP, ka ndër marrë detyrimin për mbledhjen dhe hartimin e të dhënave financiare të institucioneve ekstra buxhetore, pjesë e sektorit të Qeverisë së Përgjithshme (ESA2010). Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për hartimin e një pjesë të rëndësishme në bllokun e statistikave financiare të Qeverisë së Përgjithshme, në kuadër të përgjegjësisë institucionale për hartimin e Llogarive Financiare të vendit. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka detyrimin

e raportimit pranë Eurostat dhe ECB të llogarive financiare të Qeverisë së Përgjithshme.

Baza për plotësimin e EDP është identifikimi i tërësisë së njësive institucionale për t'u klasifikuar nën Qeverinë e Përgjithshme, konform standardit ESA2010. Listat e njësive të sektorit publik dhe ato të institucioneve të përfshira në sektorin e korporatave financiare janë të hartuara konform ESA2010 dhe publikimi i tyre plotëson detyrimet e rrjedhura në kuadër të integritetit. Lista përditësohet çdo vit.

Shqipëria ka bërë progres lidhur me Procedurën për identifikimin e Zhbalancimeve Makroekonomike (MIP). Mbas përfundimit në muajin Korrik 2019 të projektit pilot mbi burimet e të dhënave për llogaritjen e treguesve MIP, Shqipëria raportoi në Eurostat, burimet e të dhënave të nevojshme për hartimin e treguesve kryesorë dhe ndihmës të MIP-it, shoqëruar me medatat përkatëse. Progres i mëtejshëm nevojitet në llogaritjen e dy treguesve kryesorë Indeksit të kostonë së punës për njësi nominale dhe indeksin e çmimeve të banesave.

Politika monetare

Objekti kryesor i Bankës së Shqipërisë është stabiliteti i çmimeve. Siç përmendet në raport progresin e fundit të Komisionit Evropian, Banka e Shqipërisë është financiarisht e pavarur dhe ka instrumente, kompetenca dhe kapacitete administrative të mjaftueshme për të funksionuar efektivisht dhe për të zbatuar një politikë monetare eficiente. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë është operacional dhe ka një vend vakant, për të cilin ka filluar procesi i rekrutimit.

17.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Politika ekonomike

Si vend kandidat për anëtarësim në BE, Shqipëria paraqet një herë në vit në Komisionin Evropian Programin e Reformave Ekonomike (ERP).

ERP për periudhën 2020–2022 paraqet prioritetet kryesore, politikat dhe reformat e qeverisë shqiptare dhe Bankës së Shqipërisë në aspektet ekonomike. Ky program bazohet në ligjin nr. 99/2018, “Për Buxhetin e 2019” dhe në kuadrin makroekonomik dhe fiskal 2021–2023, të miratuar në janar 2020²⁵.

²⁴ Swiss State Secretariat for Economic Affairs (SECO).

²⁵ Miratuar nga Këshilli i Ministrave, më datë 29.1.2020, nr. 53.



Ekonomia shqiptare përjetoi dy goditje të forta brenda një harku kohor të shkurtër, ku në muajin nëntor të vitit 2019, vendi u godit nga një tërmet tepër i fortë që solli dëme në njerëz dhe në ekonomi, ndërsa në muajin mars të vitit 2020 pandemia e COVID-19 u përhap dhe në Shqipëri, masat e ndërmarra ndaj së cilës, impaktuan ndjeshëm aktivitetin ekonomik në vend. Në kuadër të situatës aktuale të lartpërmendur, në korrik 2020, u miratua dokumenti i Kuadrit Makroekonomik e Fiskal²⁶ i rishikuar për periudhën 2021- 2023.

Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal i rishikuar, parashikon:

- PBB. Pas recensionit të fortë në vitin 2020, aktualisht i parashikuar në - 4.3 për qind, ekonomia pritet të rekuperohet në vitin 2021 dhe të vijojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme. Rritja ekonomike parashikohet në 5.9 për qind në vitin 2021 dhe parashikohet të vijojë të qëndrojë afër nivelit prej 4 përqindësh përgjatë periudhës afatmesme në vijim. Më specifikisht rritja ekonomike parashikohet në 3.8 dhe 3.9 për qind respektivisht për vitet 2022 dhe 2023.

- Deficiti fiskal. Ky kuadër fiskal synon një deficit fiskal të përgjithshëm prej 4.2 përqindësh të PBB-së për 2021, nga 8.4 për qind i programuar për vitin 2020; nivel prej 1.7 përqindësh të PBB-së në 2022; dhe 1.3 për qind në vitin 2023. Njëkohësisht, si rrjedhojë e dy goditjeve të njëpasnjëshme fillimisht nga tërmeti dhe më pas shumë më fort nga pandemia COVID-19, balanca primare pritet të shënojë vlera negative edhe për vitin 2021, në rreth 1.7 për qind, ndonëse me përmirësim të fortë nga niveli negativ prej 5.9 për qind që pritet për 2020, ndërkohë që targetohet në vijimësi rikthimi në vlera pozitive që në vitin 2022 me 1 për qind dhe 1.6 për qind në vitin 2023.

- Balanca primare, parametër shumë i rëndësishëm i qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike, për të cilin së fundmi (korrik 2020) u shtua edhe një rregull i ri fiskal në LOB, në linjë edhe me rekomandimet e KE dhe me parimet kryesore të *acquis* të BE, i cili bën të detyrueshëm ligjërisht tashmë që duke filluar që prej vitit buxhetor 2023 e në vijim, balanca primare faktike nuk mund të rezultojë negative, pra duhet të jetë së paku e balancuar ose pozitive (suficit primar). Ky

target i parametrit të balancës primare buxhetore do të përbëjë tashmë dhe në vijimësi objektivin kryesor operativ të politikës fiskale për të materializuar synimin e një trajktore vijimësisht rënëse të borxhit publik, pra duke synuar konsolidim të vijueshëm fiskal me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së financave publike si një fundament kyç, i stabilitetit makroekonomik dhe mbarë- vajtjes së ekonomisë së vendit.

- Borxhi publik. Duke marrë të mirëqena supozimet dhe projeksionet e tjera të këtij Kuadri aktual, respektimi në mënyrë të përvitshme i rregullit fiskal të shtuar rishtazi të parametrit të balancës primare, pritet të çojë në një reduktim të nivelit të borxhit publik në rreth 63 për qind të PBB deri në vitin 2025 nga rreth 80 për qind që pritet të rezultojë në 2020.

-shkalla e papunësisë. Në përputhje me parashikimet afatmesme të rritjes, punësimi pritet të rritet me një mesatare prej rreth 2.4 përqindësh në vit gjatë viteve 2021–2023. Shkalla më e lartë e pjesëmarrjes në forcat e punës do të jetë gjeneruesi kryesor i rritjes së ofertës së punës. Objektivi kryesor është që norma e papunësisë të vazhdojë të bjerë, pas një rritje prej 13.8% në vitin 2020, me një normë papunësie duke arritur nivelin prej 9.0% në vitin 2023.

Statistikat e EDP-së dhe të GFS-së në Shqipëri dhe procedura e identifikimit të zhbalancimeve makroekonomike

Për plotësimin e standardit metodologjik dhe rregullator, po vazhdon të punohet në drejtim të adresimit të mangësive lidhur me statistikën financiare të qeverisë.

Aktualisht, është punuar në drejtim të plotësimit të të dhënave të njësive ekstra- buxhetore dhe identifikimit të tyre dhe parashikohet që kjo bazë të furnizojë vlerësimin e përgjithshëm të tria institucioneve (INSTAT, BSH, MEF) sa u takon statistikave financiare të Qeverisë dhe Tabelave të Njoftimit të EDP për raportimin që parashikohet të bëhet në muajin tetor 2021. MEF ka iniciuar një projekt me Bankën Botërore dhe ka avancuar në drejtim të implementimit të Standardit Ndërkombëtar për Kontabilitetin Publik, i cili do të mundësojë vlerësimin dhe raportimin e saktë të deficitit dhe nivelit të borxhit të qeverisë së përgjithshme. Ndërkohë, në kuadër të projektit SECO, brenda vitit 2021, pritet që do të marrë

²⁶ Miratuar nga Këshilli i Ministrave, më datë 22.7.2020, nr. 574.

zgjidhje edhe çështja e hartimit të statistikave me frekuencë tremujore të Qeverisë së Përgjithshme (GFS). Ndërkohë, është në fazë testimi një sistem (IT) i qendëruar të dhënash, ku tri institucionet e përfshira do të jenë njëkohësisht furnizues dhe përdorues të informacionit. Sistemi do të përmbajë të dhëna të integruara dhe të harmonizuara me standardet GFSM201427, ESA2010, si dhe *output* i tij do të jenë Tabelat e Njoftimit të EDP për transmetim në Eurostat. Në të njëjtën kohë, sistemi do të mundësojë harmonizimin cilësor të raportimit të llogarive financiare të qeverisë së përgjithshme pranë Eurostat dhe ECB nga Banka e Shqipërisë dhe raportimet e GFS të MEF për Bankën Botërore dhe FMN-në me Tabelat e Njoftimit të EDP. Me sugjerimin e ekspertit, sistemi do të instalohet në serverat e INSTAT-it, i cili do të mbajë rolin e administratorit.

Në funksion të realizimit të objektivave të projektit statistikor mbi Macroeconomic Imbalances Procedure financiar nga Bashkimi Evropian, janë realizuar deri tani aktivitetet e mëposhtme:

- Mbledhja e informacionit dhe plotësimi i tabelave, sipas serive kohore të disponueshme, për 14 treguesit kryesorë të procedurës së identifikimit të zhbalancimeve makroekonomike dhe 28 treguesve ndihmës.

- Hartimi i metadatave për të gjithë treguesit kryesorë dhe dokumentimin për treguesit ndihmës.

- Ndërtimi dhe azhurnimi i raporteve të cilësisë për treguesit e kërkuar;

Përtej punës së konsiderueshme që është zhvilluar deri tani, mbetet ende për t'u plotësuar informacioni i nevojshëm për treguesit "Indeksit të kostos së punës për njësi nominale" dhe "Indeksi i Çmimeve të Banesave".

Politika monetare

Ligji aktual i Bankës së Shqipërisë është pjesërisht në përputhje me *acquis* të BE-së, specifikisht me Traktatin e funksionimit të Bashkimit Evropian dhe Statutin e SEBQ-së dhe BQE-së. Brenda kompetencave të dhëna nga ligji, Banka e Shqipërisë është e pavarur në arritjen e objektivave të saj dhe në kryerjen e detyrave të saj. Llogaridhënia, është një element i rëndësishëm, i cili shërben si faktor balancues i pavarësisë. Për më

tepër, ajo përbën një faktor thelbësor që garanton legjitimitetin e politikave të saj.

Ligji i Bankës së Shqipërisë parashikon përgjegjësinë e Bankës për të dhënë llogari para Kuvendit të Shqipërisë nëpërmjet një sërë instrumentesh raportuese si: Raporti Vjetor dhe pasqyrat financiare mbi veprimtarinë ekonomike dhe financiare të institucionit; raporti 3-mujor i detajuar i politikës monetare si dhe deklarata gjashtëmujore për kërcënimet mbi stabilitetin e sistemit financiar. Pjesë e raportimit në kuvend janë dhe raportet e Komitetit të Auditit, si dhe raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Megjithatë, pavarësisht kësaj kornize llogaridhënie, Banka e Shqipërisë është e përgjegjshme se, është e nevojshme të punohet më tej në lidhje me adresimin e rekomandimeve të KE-së lidhur me përgatitjen dhe miratimin e një ligji të ri për bankën qendrore në linjë të plotë me specifikimet e Traktatit të Funksionimit të BE dhe modelin e bankës qendrore të vendeve anëtare.

Për arritjen e objektivit të stabilitetit të çmimeve, Banka e Shqipërisë ndjek një politikë monetare e cila hartohet dhe zbatohet sipas parimeve të regjimit të inflacionit të shënjestruar. Në përputhje me këtë regjim, Banka e Shqipërisë ndjek një regjim të kursit të lirë të këmbimit. Tiparet kryesore të regjimit të politikës monetare janë publikuar në Dokumentin e Politikës Monetare. Banka e Shqipërisë e ka përkufizuar objektivin e inflacionit si ndryshim vjetor të çmimeve të konsumit në nivelin 3.0% gjatë një horizonti kohor afatmesëm. Vendimet e politikës monetare bazohen në devijimet e inflacionit të parashikuar nga objektivi dhe vlerësimi i pritjeve për inflacionin. Zbatimi i politikës monetare kryhet nëpërmjet një set-i instrumentesh të tregut të hapur: i. operacione të tregut të hapur; ii. lehtësirat njëditore; iii. rezerva minimale e detyruar. Kuadri i politikës monetare dhe ai i kursit të këmbimit janë të përshtatshëm për arritjen e objektivit të stabilitetit të çmimeve dhe nuk pritet të ndryshojnë në afatin e mesëm. Instrumentet e politikës monetare janë subjekt kalibrimi me qëllim rritjen e eficiencës së transmetimit të politikës monetare në tregje.

Në përgjigje të përkeqësimit të situatës ekonomike për shkak të përhapjes së pandemisë (COVID-19), në 25 mars 2020, Banka e Shqipërisë uli normën bazë të interesit me 50 pikë bazë në nivelin minimal 0.50%. Njëkohësisht, ajo ngushtoi

²⁷ Manuali i Hartimit të Statistikave Financiare të Qeverisë (FMN, 2014).



korridorin e lehtësirave njëditore duke ulur normën e kredisë njëditore nga 1.9% në 0.9%. Banka e Shqipërisë ka vijuar të sigurojë likuiditet të pakufizuar për sistemin bankar – kundrejt kërkesave të pandryshuara për kolateral – për të mbështetur rritjen e kredisë dhe qarkullimin normal të flukseve të likuiditetit në ekonomi. Normat e ulëta të interesit, likuiditeti i bollshëm dhe qëndrueshmëria e kursit të këmbimit kanë krijuar kushte të favorshme financimi për bizneset dhe familjarët.

Dhënia e stimullit monetar u kombinua me masa lehtësuese makroprudenciale dhe me një mbështetje të fortë nga politika lehtësuese fiskale. Ky reagim i paprecedentë ka zbutur pjesërisht efektet negative të pandemisë në ekonomi dhe ka ndihmuar ruajtjen e qëndrueshmërisë së tregjeve financiare.

Banka e Shqipërisë pret që ekonomia të tkurret në vitin 2020 dhe ringrihet në vitin 2021 e udhëhequr nga rimëkëmbja e kërkesës së brendshme. Rritja e kërkesës agregate pritet të shoqërohet me rritje të punësimit, të pagave dhe të fitimit, duke sjellë rritjen e inflacionit drejt objektivit 3.0% brenda vitit 2022. Politika monetare parashikohet të jetë në kahun lehtësues gjatë gjithë këtij horizonti kohor. Ajo do të japë stimulin kryesor për rritjen ekonomike, në kushtet kur stimuli fiskal pritet të reduktohet.

17.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Banka e Shqipërisë
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Instituti i Statistikave (INSTAT)
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)

17.7 Prioritetet

Prioritetet e kapitullit janë si më poshtë:

- Harmonizimi i mëtejshëm i ligjit të Bankës së Shqipërisë me *acquis*, në lidhje me pavarësinë dhe llogaridhënien e Bankës së Shqipërisë;
- Të përmirësojë mekanizmin për koordinimin dhe konsultimin e politikave shtetërore me aktorët joshëtetërorë, gjatë hartimit të politikave sektoriale dhe reformave ekonomike.
- Zhvillimi i mëtejshëm i kuadrit teorik dhe operacional të politikës monetare në drejtim të administrimit optimal të goditjeve potenciale negative;

- Mbështetja e zhvillimit të tregjeve financiare në funksion të përmirësimit të mekanizmit të transmetimit;

- Rritja e bashkërendimit të politikës monetare dhe asaj fiskale e makroprudenciale;

- Krijimi i Këshillit Fiskal si organ i pavarur, në objektivat afatmesëm të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave;

- Krijimi i një njësie ose sektori të veçantë pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit) i cili do të ketë si funksion primar dhe të vetëm përpilimin dhe diseminimin e statistikave financiare të qeverisë (GFS) sipas standardeve të aplikuara në BE (ESA 2010) si dhe ndjekjen dhe reflektimin në mënyrë sistematike e periodike të këtyre standardeve/metodologjive.

- Përafrimi i mëtejshëm me Direktivën mbi Kërkesat për Kuadrin Buxhetor;

- Harmonizimi i statistikave fiskale me ESA 2010.

KAPITULLI 18 STATISTIKAT

18.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis në fushën e statistikave kërkon ekzistencën e një infrastrukture statistikore bazuar në parime të tilla si paanshmëria, besueshmëria, transparenca, konfidencialiteti i të dhënave individuale dhe shpërndarja e statistikave zyrtare.

Instituti kombëtar i statistikave vepron si pikë referimi për metodologjinë, prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor. *Acquis* mbulon metodologjinë, klasifikimet dhe procedurat për mbledhjen e të dhënave në fusha të ndryshme si statistikat makro- ekonomike, statistikat demografike dhe sociale, statistikat rajonale dhe statistikat mbi biznesin, transportin, tregtinë e jashtme, bujqësinë, mjedisin, shkencën dhe teknologjinë. Asnjë transpozim në legjislacionin kombëtar nuk është i nevojshëm pasi shumica e *acquis* merr formën e rregulloreve.

18.2 Struktura e kapitullit

Struktura e kapitullit 18 “Statistikat” është si më poshtë:

- statistikat Demografike dhe Sociale;
- statistika Ekonomike;
- statistikat Sektoriale;
- statistikat e mjedisit dhe multidomain.



18.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar për statistikën zyrtare me atë të Bashkimit Evropian buron nga nenet 70 dhe 88 të MSA-së.

Neni 88 parashikon se “bashkëpunimi midis palëve do të përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me *acquis* të Komunitetit në fushën e statistikave”. Kjo do të synojë në veçanti zhvillimin e një sistemi statistikor efikas dhe të qëndrueshëm, të aftë për të siguruar të dhëna krahasimore, të besueshme, objektive dhe të sakta të nevojshme për të planifikuar dhe monitoruar procesin e tranzicionit dhe reformat në Shqipëri. Ai gjithashtu do t'i mundësojë Institutit të Statistikave të Shqipërisë që të plotësojë më mirë nevojat e përdoruesve të saj kombëtarë dhe ndërkombëtarë (si administratës publike, ashtu edhe sektorit privat). Sistemi statistikor duhet të respektojë parimet themelore të statistikave të miratuara nga Kombet e Bashkuara, Kodi i Praktikave të Statistikave Evropiane i dhe dispozitat e Ligjit Evropian Statistikor dhe të zhvillohet drejt *acquis* të Komunitetit.

Acquis në fushën e statistikave përbëhet pothuajse ekskluzivisht nga legjislacioni i cili është direkt i zbatueshëm në Shtetet Anëtare siç janë Rregulloret e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Vendimet dhe Rregulloret e Komisionit. Për metodologjinë, prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor parashikohen rregulla të zakonshme. *Acquis* statistikore përmban gjithashtu një gamë të gjerë të manualeve metodologjike në fusha të ndryshme statistikore si bujqësia, politikat ekonomike dhe monetare, statistikën demografike dhe sociale dhe kërkimet. Marrëveshjet ndërkombëtare ose standardet ndërkombëtare si kodi i praktikës në statistika ofrojnë një bazë tjetër për prodhimin statistikor.

Puna e Sistemit Kombëtar të Statistikave bazohet në Programin Kombëtar për Statistikat Zyrtare 2017–2021 të miratuar me VKM-në 10/2017, datë 9.2.2017. Ky është dokumenti kryesor që rregullon prodhimin e statistikave zyrtare nga Sistemi Statistikor Kombëtar i nevojshëm për të vëzhguar gjendjen ekonomike, sociale dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me parimet statistikore të parashikuara në nenet 4 dhe 5 të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikën zyrtare”, të cilat janë në përputhje

me Kodin e Prakt ikës së Statistikave Evropiane. Programi shërben gjithashtu për të orientuar INSTAT-in dhe agjencitë e tjera statistikore drejt cilësisë së prodhimit statistikor të kërkuar nga standardet e *acquis*.

Ligji nr. 17/2018, datë 5.4.2018, “Për statistikën zyrtare” është hartuar sipas Kodit të Praktikës dhe Rregullores Evropiane të Statistikave EC 223/2009 dhe parimeve të Kodit të Praktikës të Statistikave Evropiane.

Baza ligjore për zhvillimin, mbledhjen, përpilimin dhe publikimin e statistikave të Bankës së Shqipërisë është ligji nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i cili është pjesërisht në përputhje me Rregullorën 184/2005 KE.

18.4 Situata aktuale në Shqipëri

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e statistikave. Njëfarë progresi është bërë veçanërisht në përafrimin me standardet ESA 2010, në publikime më të shpejta dhe të reja mbi statistikat, si dhe ka pasur rritje në transmetimin e të dhënave në Eurostat.

Roli i Sistemit Kombëtar të Statistikave u forcua më tej dhe burimet e tij u përmirësuan; megjithatë, metodat e mbledhjes së të dhënave duhet të modernizohet si dhe proceset statistikore të prodhimit duhet të përmirësohen. Gjithashtu, komunikimet me palët e interesit u përmirësuan për disa fusha statistikore.

Vitet e fundit i është kushtuar vëmendje specifike zbatimit të kornizës ligjore nën të cilën INSTAT dhe Sistemi Kombëtar i Statistikave kryejnë aktivitetet e tyre statistikore. Në zbatim të Ligjit Nr. 17/2018, “Për Statistikën Zyrtare”, Qeveria Shqiptare ka miratuar VKM Nr. 699, datë 7.11.2018 për rregullimin e procedurave për kriteret e vlerësimit dhe afatet për zgjedhjen e kandidatëve që do të emërohen në pozicionin e “Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Statistikave”. Ky akt nxirret në bazë të frymës së ligjit për të forcuar pavarësinë profesionale të organit drejtues të INSTAT-it, dhe përcakton në detaje procedurat transparente dhe publike që duhet të ndiqen për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT-it. VKM-ja nr. 670, datë 7.11.2018, specifikon kriteret dhe procedurat për zgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të Këshillit të Statistikave, sipas kërkesave të ligjit të Statistikave zyrtare. Këshilli i Statistikave duhet të përbëhet nga përfaqësues të përdoruesve të statistikave zyrtare, si grup interesi i



drejtpërdrejtë për produktin statistikor. Anëtarët e saj përfshijnë përfaqësues të përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare, organeve të qeverisjes vendore, mediave, botës akademike, shoqërisë civile. Një tjetër vendim për këtë kornizë është VKM-ja nr. 671, datë 7.11.2018, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe shpërblimin e anëtarëve të Komisionit Kombëtar të Nomenklaturës”. Ky komision është përgjegjës për harmonizimin e klasifikimeve statistikore me ato ndërkombëtare.

Në zbatim të ligjit për statistikën zyrtare, është ngritur Bordi Drejtues i INSTAT-it. Detyrat e këtij bordi janë të përcaktojnë strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe të propozojnë plane për zbatimin e buxhetit dhe mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave. Si shtesë, bordi i propozon Drejtorit të Përgjithshëm projekt udhëzimet që sigurojnë harmonizimin e proceseve statistikore me standardet evropiane. Bordi Drejtues përbëhet nga të gjithë nëpunësit civilë të INSTAT-it, të cilët janë të paktën niveli i mesëm i menaxhimit, duke iu referuar strukturës së tij organizative. Nënkryetari i Bordit Drejtues mbulon detyrat dhe detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm në mungesë të tij.

Këshilli i Statistikave mbështet Sistemin Kombëtar të Statistikave dhe INSTAT-i në rolin e tij për të siguruar që programi është hartuar në përputhje me parimet themelore të statistikave zyrtare të Kombeve të Bashkuara dhe standardeve të tjera ndërkombëtare statistikore. Ka një rol këshillues për të siguruar informacionin përkatës gjatë përgatitjes së programit zyrtar të statistikave, planeve të punës për zbatimin e tij dhe monitorimin e veprimtarisë së Sistemit Kombëtar të Statistikave përmes raporteve periodike të paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it.

Në përputhje me PSZ 2017–2021, INSTAT-i ka mbledhur, përpunuar, analizuar dhe shpërndarë që prej 2017 të dhënat mbi të huajt me leje qëndrimi, të huajt e parregullt si dhe statistikën mbi azil kërkuesit në Shqipëri. Këto të dhëna bënë të mundur plotësimin e disa indikatorëve mbi azil kërkuesit të cilët kërkohen nga pyetësorët e Eurostat dhe janë transmetuar në Shkurt të 2019 për herë të parë.

Anketa e Buxhetit të Familjes është një vërtetues statistikor që kryhet pranë njësisë ekonomike familjare (NJEF) dhe jep një panoramë të situatës socio- ekonomike të NJEF në Shqipëri. Rezultatet

e kësaj ankete përdoren gjithashtu për përditësimin e peshave të përdorura në Indeksin e Çmimeve të Konsumit dhe Llogaritjen e Konsumit Final të NJEF si një agregat i rëndësishëm i PBB me metodën e shpenzimeve. Nga janari i vitit 2014, ABF është një anketë e vazhdueshme dhe me baza vjetore. Në vitin 2018, u testua një ndryshim në metodologjinë e mbledhjes së të dhënave nga Anketa e Buxhetit të Familjes, me anë të së cilës u studiua efekti i ndryshimit të metodës së mbledhjes së të dhënave nga 2 në 1 javë në ditarin e blerjeve. Gjatë ABF 2018 ditari mbledhi të dhëna me periudhë reference 1 javë për gjysmën e familjeve të kampionit dhe 2 javë për gjysmën tjetër. Për sa i përket ABF 2019, për të gjithë kampionin informacioni u mbledh në ditar me periudhë mbledhjeje të të dhënave 1 javore, rezultatet e së cilës u publikuan në Tetor 2020 së bashku me të dhënat e revizionuara të ABF 2018 pas zbatimit të metodologjisë së re. Aktualisht është duke u kryer në terren anketa e vitit 2020, kampioni së cilës është rritur krahasuar me vitet e mëparshme për shkak se do të studiohen dhe analizohen treguesit kryesorë të konsumit për 6 bashki kryesore.

Për sa i përket anketës së turizmit në familje “Pushime dhe udhëtime”, ka përfunduar grumbullimi i të dhënave për vitin 2019. Aktualisht, është duke u përgatitur publikimi i rezultateve kryesore për të dhënat e vitit 2019, të cilat do të bëhen publike në Nëntor 2020. Të dhënat e vitit 2019 po përgatiten për t’u transmetuar në Eurostat sipas kërkesave dhe udhëzimeve të tyre. Tremujori i dytë i anketës për vitin 2020 është duke u kryer në terren, ndërkohë ka përfunduar hedhja e të dhënave për tremujorin e parë.

Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Njësitë Ekonomike Familjare (NJEF), përfundoi procesin e mbledhjes së të dhënave në terren për vitin 2020 në periudhën Gusht- Tetor. Aktualisht, është duke u kryer procesi i hedhjes së të dhënave për vitin 2020.

Gjatë vitit 2019, INSTAT kreu valën e tretë të anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, (SILC) gjatë periudhës Prill - Korrik. Gjatë kësaj periudhe puna është fokusuar në pastrimin, e të dhënave si dhe përgatitjen e skedarëve agregat, përditësimin të programeve si dhe ndërtimit të skedarit të konsoliduar për të dhënat e SILC 2016 (konsideruar një pilot i madh), 2017 dhe 2018. Më



26 Dhjetor 2019, INSTAT publikoi rezultatet kryesore të Anketës SILC 2017 dhe 2018. Puna në terren për SILC 2020 është ende në proces sepse u shty nga muaji Prill në Korrik si rezultat i pandemisë: <http://instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-t%C3%AB-ardhurave-dhe-nivelit-t%C3%AB-jetes%C3%ABs-aanj/publikimet/2019/anketa-e-t%C3%AB-ardhurave-dhe-nivelit-t%C3%AB-jetes%C3%ABs-2017-2018/>.

Në përputhje me PSZ 2017- 2021, INSTAT prodhon dhe publikon statistika të përditësuara mbi shkaqet e vdekjeve dhe shëndetin publik. Me fillimin e implementimit të Nomenklaturës së miratuar të Shkaqeve të Vdekjeve (ICD-10) do reflektohen ndryshimet në statistikat e shkaqeve të vdekjeve sipas rekomandimeve të Eurostat. Në kuadër të projekteve IPA 2017, INSTAT-i gjatë vitit 2020 për herë të parë po zbaton Anketën e Shëndetit (EHIS). Procesi i mbledhjes së të dhënave pritet të përfundoj gjatë muajit Dhjetor 2020, me një shtrirje 4-mujore në terren. Rezultatet e anketës do plotësojnë dhe pasurojnë tërësinë e të dhënave të shëndetit publik sipas ECHI (*European Core Health Indicators*), si dhe do lehtësojnë krahasimin e të dhënave, të cilat do shërbejnë për të monitoruar shëndetin, kujdesin shëndetësor në nivelin e standardeve të BE-së.

Në kuadër të përmirësimit dhe përmbushjes së treguesve mbi statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale, INSTAT-i është asistuar vazhdimisht nga IPA 2014, 2015 dhe 2017. Klasifikimi ndërkombëtar i krimeve është ende në proces hartimi. Zbatimi i këtij klasifikimi nga INSTAT dhe institucionet përgjegjëse për prodhimin e statistikave të drejtësisë penale do sjell krahasueshmëri të dhënash në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Nga viti 2013, INSTAT transmeton në Eurostat pyetësor mbi statistikat e krimeve.

Sektori i tregut të punës kryen vlerësime për dy aktivitete statistikore me frekuencë tremujore: “Anketën tremujore të forcave të punës” dhe “Prodhimin e të dhënave administrative të tregut të punës”. Për të “Dhëna administrative mbi pagat”, me frekuencë tremujore dhe vjetore, do të vazhdojë publikimi duke përdorur të dhënat administrative të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Gjithashtu, INSTAT ka përfunduar vlerësimin e të dhënave të mbledhura nga “Anketa e Strukturës së të ardhurave nga Puna

dhe ka realizuar publikimin e rezultateve në nëntor 2020.

Gjatë vitit 2020, INSTAT ka arritur të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga PSZ-së 2017–2021, janë realizuar sipas moduleve objektivat si më poshtë:

- Tregues statistikorë mbi forcat e punës, punësimin dhe papunësinë sipas gjinisë, aktivitetit ekonomik, grup profesioneve, grup moshave, nivelit arsimor dhe qarqeve (Publikimi i fundit korrespondon me tremujorin e 3-të 2020);

- Tregues statistikorë mbi të papunët e regjistruar gjithsej dhe sipas gjinisë, grup moshave, nivelit arsimor dhe qarqeve, të papunët e regjistruar që përfitojnë pagesë papunësie, të papunët afatgjatë të regjistruar dhe shkalla e papunësisë së regjistruar;

- Tregues statistikorë mbi strukturën e të ardhurave nga puna për orë pune, mujore dhe vjetore sipas karakteristikave individuale të punonjësve (gjinia, mosha, profesioni, niveli më i lartë arsimor i arritur), dhe punëdhënësit (aktiviteti ekonomik, madhësia dhe pronësia e ndërmarrjes) (Publikimi i fundit korrespondon me tremujorin e 3-të 2020);

- Tregues statistikorë mbi pagën mesatare mujore për të punësuarit me pagë në sektorin shtetëror dhe për të gjithë sektorët ekonomikë sipas aktiviteteve ekonomike dhe grup profesioneve, hendekun gjinor në paga sipas aktiviteteve ekonomike dhe grup profesioneve (Publikimi i fundit korrespondon me tremujorin e 3-të 2020).

- Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna ku janë trajtuar të ardhurat nga puna sipas aktiviteteve ekonomike, sipas madhësisë së ndërmarrjes, sipas nivelit arsimor, sipas grup-moshës dhe sipas profesioneve.

Gjatë vitit 2019, ka vazhduar puna përgatitore për Censin e Popullsisë dhe Banesave, si edhe u realizua mbledhja në terren e të dhënave të Pilot Cens. Gjatë vitit 2020, INSTAT punoi mbi analizimin e të dhënave dhe proceseve të Pilot Cens, si dhe u përgatitën gjetjet lidhur me çështjet metodologjike, të teknologjisë së informacionit, hartografisë, logistikës dhe burimeve njerëzore. Bazuar në gjetjet e Pilotit, situatën e krijuar si pasojë e tërmetit të 26 Nëntorit 2019 dhe pandemisë globale COVID - 19, INSTAT po rishikon planin e aktiviteteve dhe Dokumentin e Strategjisë dhe Planifikimit të Cens.



Sa u përket “Statistikave ekonomike”, INSTAT ka vlerësuar përditësuar dhe transmetuar në EUROSTAT të dhëna mbi treguesit makroekonomikë dhe komponentët e tij, në përputhshmëri me konceptet dhe përkufizimet e Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010). Gjatë vitit 2020 në përmbushje të objektivave të PSZ-së 2017–2021, janë realizuar sipas moduleve objektivat si më poshtë:

- Llogaritë vjetore sipas sektorëve institucionalë – Vlerësimi dhe publikimi i llogarisë së prodhimit dhe gjenerimit të të ardhurave sipas sektorëve institucional 2017;

- Llogaritë kombëtare vjetore – Vlerësimi dhe publikimi i treguesve të PBB-së sipas metodës së prodhimit dhe metodës së shpenzimeve, 2018 me çmime korrente dhe çmimet e vitit të mëparshëm;

- Kryerja e llogaritjeve për kalimin nga treguesi i PBB në treguesin e të Ardhurave Kombëtare Bruto – AKB (GNI);

- Tabelat burime përdorime dhe tabelat *input-output* – Përpilimi dhe publikimi i tabelave Burime - Përdorime (IBP për vitin referencë 2017 me çmime korrente në tri nivele detajimi);

- Llogaritë rajonale – Vlerësimi dhe publikimi i treguesve të PBB-së sipas rajoneve statistikore nivel 2/3 2018;

- Llogaritë e Administratës Publike–Publikimi i “Listës së Institucioneve të sektorit publik 2019”.

INSTAT-i është pjesë e Programit të Transmetimit ESA 2010, duke transmetuar rregullisht në EUROSTAT, treguesit e Llogarive Kombëtare (Llogaritë Kombëtare Vjetore dhe Tremujore, Llogaritë Rajonale, Llogaritë jofinanciare sipas sektorëve Institucional, Tabelat Burime–Përdorime dhe IOT), në formatin SDMX. Banka e Shqipërisë transmeton Llogaritë Financiare sipas sektorëve Institucional. Përpjekje të vazhdueshme bëhen nga INSTAT për të rritur të dhënat dhe numrin e tabelave të transmetuara.

Tabelat e njofimit të Procedurës së Deficitit të Tejkalar (EDP) dërgohen rregullisht (dy herë në vit) në Eurostat. Dërgimi i fundit është kryer në Prill 2020, duke përdorur formatin zyrtar të kërkesave të EUROSTAT. Për plotësimin e tabelave EDP është i nevojshëm identifikimi i tërësisë së njërive institucionale që klasifikohen nën Qeverinë e Përgjithshme, në përputhje me standardet ESA2010. Listat e njërive të sektorit publik dhe atij financiar hartohen në përputhje me Faqe| 4104

ESA2010 dhe publikimi i tyre plotëson detyrimet e rrjedhura në kuadër të integritetit. Lista e dakortësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka e Shqipërisë dhe INSTAT përditësohet dhe publikohet rregullisht, çdo vit.

Shqipëria është e përfshirë dhe ka bërë progres në sistemin Procedurës së Imbalancës Makroekonomike (MIP). Ky sistem është një mekanizëm mbikëqyrjeje për monitorimin e politikave ekonomike dhe zbulimin e dëmeve të mundshme në funksionimin e duhur të ekonomisë së një shteti anëtar, të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar, apo dhe të Bashkimit Evropian në tërësi. Aktualisht, INSTAT dhe Banka e Shqipërisë, kanë arritur të sigurojnë informacionin e nevojshëm (plotësimi i tabelave, sipas serive kohore të dipsonueshme) për 14 treguesit kryesorë dhe 25 tregues ndihmës. Janë hartuar metadatat respektive për të gjithë treguesit kryesorë dhe dokumentimin për treguesit ndihmës.

Politika e Revizionimit të statistikave Makroekonomike, mbështetur në Politikën e Harmonizuar të Revizionimit (HERP), e cila është e detyrueshme për të gjithë vendet anëtare të Bashkimit Evropian është publikuar në faqen zyrtare të INSTAT. Kjo politikë u hartua në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Bankën e Shqipërisë. Metadatat strukturore të llogarive kombëtare janë të publikuara gjithashtu, në faqen zyrtare të EUROSTAT-it dhe INSTAT-it.

Llogaritë Kombëtare tremujore prodhojnë treguesin e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), në përputhshmëri me konceptet dhe përkufizimet e Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010), me metodën e prodhimit dhe atë të shpenzimeve, me çmime korrente dhe çmimet e vitit paraardhës, të përshtatura ose josezonalisht. Gjatë vitit 2020, në përmbushje të objektivave të PSZ-së 2017–2021 janë realizuar sipas moduleve objektivat si më poshtë:

- Tregues statistikorë mbi PBB tremujore, me metodën e prodhimit, me çmime korrente, me çmimet e vitit të mëparshëm dhe *chain link* sipas aktivitetit ekonomik, e përshtatur dhe e pa përshtatur sezonalisht (publikimi i fundit korespondon me tremujorin e 3-të 2020);

- Tregues kryesor statistikorë mbi PBB tremujore, me metodën e shërbimeve, me çmime korrente, me çmimet e vitit të mëparshëm dhe *chain*



link, e përshtatur dhe e papërshtatur sezonalisht (publikimi i fundit korrespondon me tremujorin e 3-të 2020);

Në përputhje me PSZ 2017- 2021, INSTAT-i përditëson regjistrin e bizneseve dhe njësive statistikore me burimet administrative dhe vrojtimet statistikore, duke ndjekur metodologjinë e përcaktuar në rregulloren e Këshillit EU (EEC) nr. 177/2008 datë 20 shkurt 2008 “Mbi ndërtimin e regjistrave të bizneseve për qëllime statistikore” dhe në manualin e rekomandimeve. Regjistri statistikor i bizneseve luan një rol qendror në prodhimin e statistikave ekonomike, si në aspektin e mënyrën e prodhimit të statistikave dhe për sa i përket përmbajtjes dhe cilësisë së tyre. Kështu regjistri statistikor i bizneseve bën të mundur sigurimin e koherencës ndërmjet rezultateve të ndryshme statistikore dhe zhvillimin e proceseve efikase të prodhimit statistikor.

Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve (RSN) mirëmbahet dhe përditësohet çdo vit që prej vitit 1998. RSN-ja shërben për qëllime statistikore dhe identifikon qartësisht njësitë në mënyrë që:

- të lejojë marrjen e informacionit për të nëpërmjet burimeve administrative;
- të lejojë përgatitjen e kampionëve, koordinimin e anketave dhe për grupimin e rezultateve të tyre;
- të lejojë analizën demografike të popullsisë së ndërmarrjeve dhe njësive lidhur me to.
- të informojë përdoruesit mbi statistikën zyrtare që prodhohen nga RSN-ja.

Regjistri Statistikor i Njësive Lokale, përditësohet çdo vit. Ky përditësim ka filluar në vitin 2010. Njësia lokale është një ndërmarrje apo pjesë e saj të ndodhura në zona të identifikuar gjeografikisht. Regjistri i njësive lokale shërben si mjet kryesor për prodhimin e statistikave rajonale.

Raporti i cilësisë për RSN është botuar në faqen zyrtare të INSTAT i hartuar në Metadata Referenciale në format *ESS Standard for Quality Reports Structure (ESQRS)*. Gjatë vitit 2020, INSTAT ka pilotuar procesin e përditësimit në kohë reale të regjistrit statistikor të ndërmarrjeve me burimet administrative e statistikore duke ndërtuar “Live Register”.

Në lidhje me statistikën e ndërmarrjeve, INSTAT kryen vrojtimin vjetor mbi Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve, nëpërmjet të cilit mbledh, përpunon dhe publikon statistikën vjetore

të ndërmarrjeve ekonomike jobujqësore. Metoda e grumbullimit është tradicionale, me pyetësor letër, me intervistë të drejtpërdrejtë me anketues. Aktiviteti përfshin të gjithë ndërmarrjet aktive në Shqipëri për të gjitha format ligjore. Popullsia është bazuar në ndërmarrjet të cilat sipas regjistrit statistikor të ndërmarrjeve, ishin aktive në dhjetor të vitit të referencës. Klasifikimi i ndërmarrjeve është bërë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev. 2, në seri kohore duke filluar nga viti 2010 e në vazhdim. Gjatë vitit 2020 u realizua prodhimi i rezultateve finale të Statistikave Strukturore të Ndërmarrjeve Ekonomike 2018 dhe rezultateve paraprake 2019. Gjithashtu, u realizua përpunimi dhe prodhimi i statistikave strukturore për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme 2018. Sipas PSZ 2017–2021, INSTAT ka kryer vlerësimin e statistikave strukturore në nivel rajonal për treguesit kryesorë për vitin 2018. Në Qershor 2020 u transmetuan në Eurostat për herë të parë disa nga treguesit kryesorë. Për të siguruar vazhdimësinë dhe përmirësimin e cilësisë të treguesve statistikorë të ndërmarrjeve, INSTAT-i shfrytëzoi edhe burimet administrative për editimin dhe imputimin me të dhëna të treguesve kryesorë.

INSTAT-i kryen vrojtimin PRODCOM që prej vitit 2018. Ky vërtim synon të mbledhë të dhëna mbi ecurinë e prodhimit dhe shitjes së produkteve industriale në ndërmarrje. Seria kohore 2018- 2020 është analizuar dhe rezultatet do të vazhdojnë të përdoren për përdoruesit e brendshëm të INSTAT. Kjo seri me të dhëna trevjeçare do të shërbejë për një analizë më të plotë të treguesve të prodhimit dhe shitjes së produkteve industriale.

Në lidhje me statistikën afatshkurtra të ndërmarrjeve, INSTAT-i kryen vrojtimin tremujor mbi Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve, nëpërmjet të cilit mbledh, përpunon dhe publikon statistikën afatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike jobujqësore. Popullata referuese është përcaktuar nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, për të gjitha format legale, ndërsa aktivitetet janë klasifikuar sipas Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike (NVE Rev.2). Të gjithë treguesit e prodhuar vijnë të publikohen të shprehur në indekse, në ndryshim vjetor dhe në ndryshim tremujor. Në fillim të vitit 2018, INSTAT transmetoi për herë të parë disa nga treguesit kryesorë afatshkurtër. Ky transmetim në Eurostat



vazhdon rregullisht edhe për vitet në vijim duke rritur numrin e treguesve të transmetuar nëpërmjet EDAMIS. Gjithashtu, për herë të parë gjatë vitit 2020 u përgatitën dhe transmetuan dhe u publikuan nga Eurostat raportet e cilësisë për pesë tregues, të cilët janë bërë publike edhe në faqen e INSTAT. Gjatë vitit 2020 burimet administrative u përdorën për analizën dhe prodhimin e treguesve afatshkurtër. Në rast të mungesës së burimit administrativ u përdor kontaktimi i ndërmarrjeve me telefon.

Gjatë vitit 2020 në përmbushje të objektivave të PSZ-së 2017–2021, janë realizuar:

- Indeksi i Tregtisë me Pakicë tremujor, publikimi i fundit korrespondon me muajin Dhjetor 2020;

- statistikat afatshkurtra, të mirat dhe shërbime, publikim tremujor i fundit korrespondon me muajin Dhjetor 2020;

Të dhënat mbi lejet e ndërtimit të miratuara janë të dhëna administrative. Informacioni statistikor i lejeve të ndërtimit grumbullohet nga zyrat rajonale të INSTAT-it në bashkëpunim me zyrat urbanistike të bashkive përkatëse. Të dhënat mbi lejet e ndërtimit të miratuara ofrojnë informacion për ndërtesat dhe punime inxhinierie në nivel vendi. Informacioni statistikor rreth lejeve të ndërtimit të miratuara është një tregues afatshkurtër i cili paraqet zhvillimin e sektorit të ndërtimit në periudhën pasardhëse. Të dhënat të cilat INSTAT-i grumbullon dhe publikon mbi lejet e ndërtimit të miratuara janë:

Numri total i lejeve të ndërtimit të miratuara (ndërtesa rezidente dhe jorezidente);

- Sipërfaqja totale në metra katrorë e lejeve të ndërtimit të miratuara (ndërtesa rezidente dhe jorezidente);

- Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa (ndërtesa rezidente dhe jorezidente) dhe punime inxhinierie;

- Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa sipas klientit (ndërtesa rezidente dhe jorezidente) dhe punime inxhinierie;

Gjatë vitit 2020, në përmbushje të objektivave të PSZ-së 2017–2021, janë realizuar publikime tremujore mbi lejet e ndërtimit; publikimi i fundit korrespondon me muajin Nëntor 2020.

INSTAT-i vlerëson dhe publikon statistikat e energjisë si Bilanci i Energjisë Elektrike dhe Bilanci i Përgjithshëm i Energjisë. Bilanci i Energjisë Faqe | 4106

Elektrike edhe gjatë vitit 2020 është publikuar me periodicitet tremujor dhe vjetor, bazuar në të dhënat e mbledhura nga burimet administrative. Bilanci i Përgjithshëm i Energjisë është publikim vjetor dhe është i përbërë nga dy pjesë kryesore si furnizimi dhe përdorimi i energjisë, ku bazë e këtyre të dhënave të mbledhura është burimi administrativ. Për vitin 2019 ky publikim është bërë në Shtator 2020. INSTAT transmeton në EUROSTAT pyetësorët me të dhëna vjetore (*Electricity & Heat, Natural Gas, Oil, Solid fossil fuels, Renewables & Wastes, Nuclear energy*) dhe pyetësorët me të dhëna mujore (MOS- Oil, MOS- Gas, Electricity).

INSTAT prodhon dhe publikon statistikat mbi Lëvizjen e Shtetasve të cilat paraqesin të dhëna të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj: sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë), pikave kufitare, qëllimit të udhëtimit të shtetasve të huaj, hyrjet e shtetasve të huaj sipas shteteve. Statistikat mbi Lëvizjet e Shtetasve publikohen afërsisht 21 ditë pas përfundimit të muajit referues (T+21), sipas datës së paracaktuar në kalendarin e publikimeve të INSTAT-it. Të dhënat mbi Lëvizjen e Shtetasve janë të dhëna administrative. Gjatë vitit 2020 në përmbushje të objektivave të PSZ-së 2017–2021, janë realizuar publikime mujore mbi lëvizjen e shtetasve; i fundit korrespondon me muajin dhjetor 2020.

Për sa i përket turizmit në ndërmarrje, informacioni mbledhet nëpërmjet “Anketës së strukturave akomoduese”. Kanë përfunduar fazat e grumbullimit, përpunimit, analizës dhe publikimit të të dhënave për periudhën kohore 2018–2019 dhe 6-mujori i parë 2020. Rezultatet kryesore u publikuan në Qershor dhe Gusht të vitit 2020. Në muajin Nëntor u publikuan të dhënat e tremujorit të tretë 2020. Treguesit e publikuar janë tregues mbi kapacitetin e njësive akomoduese, numrin e turistëve, netëqëndrimet, numrin e turistëve sipas shteteve, kapacitetin shfrytëzues. Seria kohore e të dhënave dhe raporti i cilësisë u transmetua në Eurostat. Grumbullimi, publikimi i të dhënave tremujore dhe transmetimi i tyre në Eurostat është procesi në vazhdim.

Që prej vitit 2015, INSTAT realizon vrojtimin vjetor mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Teknologjinë e Komunikimit (TIK) në ndërmarrje. Metodologjia e ndjekur është në përputhje me standardet evropiane. Gjatë vitit



2020, INSTAT përpunoi dhe publikoi të dhënat mbi “Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në ndërmarrje” për vitin referencë 2019 duke shtuar numrin e treguesve në krahasim me vitet e mëparshme. Gjatë tremujorit të parë të këtij viti, u mbledhën të dhënat për vitin 2020. Proceset në vazhdim janë: përpunimi i të dhënave të mbledhura, publikimi i rezultateve kryesore për vitin 2020, si dhe transmetimi i të dhënave në Eurostat.

Gjatë vitit 2018, INSTAT-i në bashkëpunim me projektin “Ngritja e kapaciteteve të inovacionit në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme” ka kryer vërtetimin mbi aktivitetin e Inovacionit pranë këtyre ndërmarrjeve. Rezultatet e këtij vërtetimi u publikuan në një botim të veçantë i cili u bë publik në faqen e *web-it* të INSTAT-it.

Në vitin 2019, INSTAT-i realizoi vërtetimin “Inovacioni pranë ndërmarrjeve” 2017- 2019, ku u mbledh informacion mbi shkallën e inovacionit në ndërmarrjet që zhvillojnë aktivitet në Shqipëri. Popullata e vërtetuar janë ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar në aktivitetet e përcaktuar në manualin e Oslos. Gjatë vitit 2020, INSTAT-i publikoi rezultatet e këtij vërtetimi për vitet 2017-2019. Në tremujorin e katërt të vitit 2020 INSTAT-i realizoi vërtetimin “Inovacioni pranë ndërmarrjeve 2018–2020”. Proceset në vazhdim janë: përpunimi i të dhënave të mbledhura dhe publikimi i rezultateve kryesore për vitin 2018–2020

Gjatë vitit 2020, INSTAT-i vazhdoi punën për rritjen e numrit të treguesve të Transportit. INSTAT-i ka trajnuar mbi Klasifikimin Standard të Mallrave për Statistikat e Transportit institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij klasifikimi. Klasifikimi Standard i Mallrave për Statistikat e Transportit i cili njihet shkurt si NST (2007) është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: rrugë, hekurudhë, rrugë ujore të brendshme dhe det. INSTAT-i përgatiti të dhënat e para me NST 2007 me frekuencë vjetore për transportin e mallrave në rrugë Detare dhe Hekurudhore. Gjithashtu, në bashkëpunim me projektin pilot për Statistikat e Transportit, INSTAT-i plotësoi dhe dërgoi në Eurostat serinë kohore (2016– 2019) të të dhënave të Transportit hekurudhor, rrugor dhe ajror. INSTAT-i publikoi për herë të parë në dhjetor 2020, “Statistikat mbi karakteristikat e mjeteve rrugore, 2019”. Lidhur me

statistikat e sigurisë në transport, INSTAT-i vazhdon të publikojë tregues mbi statistikat e Aksidenteve në rrugë dhe Aksidenteve hekurudhore.

Në kuadër të projektit pilot “Statistikat e Kërkim- Zhvillimit dhe statistikat mbi fondet e planifikuara në buxhetin e shtetit, GBARD”, INSTAT-i ka zhvilluar dy misione në periudhën kohore 2019–2020. Në këto misione është vlerësuar situata aktuale, problematikat e hasura për prodhimin e këtyre statistikave, institucionet në vend të cilat kanë rol në mbështetjen dhe sigurimin e të dhënave për aktivitetin e Kërkim- Zhvillimit eksperiencat e vendeve të rajonit në prodhimin e këtyre statistikave përgatitja e *sample frame* dhe përmirësimin e pyetësorëve dhe metodologjisë për kryerjen e vërtetimit. Gjatë vitit 2020, INSTAT-i vazhdoi punën për zbatimin dhe plotësimin e kërkesave në kuadër të këtij projekti për statistikat e Kërkim- Zhvillimit dhe fondet e e planifikuara në buxhetin e shtetit, njohur si statistikat GBARD.

Statistikat e Çmimeve të Konsumit maten nëpërmjet dy treguesve mujorë: “Indeksi i Çmimeve të Konsumit” dhe “Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHCK)”.

INSTAT-i vlerëson edhe indekse të tjera në periodicitet tremujor, si:

- indeksin e çmimeve të prodhimit (gjithsej; produkte eksporti; produkte vendi);
- indeksi i çmimeve të importit;
- indekset e kushtimit në ndërtim (për banesa).

Puna për vlerësimin e Indeksit të Standardit të Fuqisë Blerëse është në proces. Statistikat e kësaj kategorie do të prodhohen nga Eurostat me frekuencë vjetore duke përdorur të dhënat e vërtetimeve të ndryshme të çmimeve të konsumit, ndërtimit, makineri e pajisje, qirave, spitaleve dhe të dhënave të tjera shitesë të realizuara nga INSTAT-i për llogaritjen e këtyre treguesve.

Gjatë 2020, INSTAT-i po studion “Indeksin e Çmimeve të Banesave”. Po vlerësohet shtimi i burimeve të reja të informacionit për të siguruar një indeks sa më të besueshëm. INSTAT-i parashikon të prodhojë statistika me frekuencë tremujore duke shfrytëzuar të dhënat administrative të marra.

Gjatë vitit 2020 në përmbushje të objektivave të PSZ-së 2017 - 2021, janë realizuar sipas moduleve, objektivat si më poshtë:



- indeksi i çmimeve të konsumit mujor, publikimi i fundit korrespondon me muajin dhjetor 2020;

- indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit (IHÇK) mujor, publikimi i fundit korrespondon me muajin dhjetor 2020;

- indeksi i çmimeve të prodhimit tremujor, publikimi i fundit korrespondon me tremujorin e 3-të 2020;

- indeksi i çmimeve të importit tremujor, publikimi i fundit korrespondon me tremujorin e 3-të 2020;

- indeksat e kushtimit në ndërtim tremujor, publikimi i fundit korrespondon me tremujorin e 3-të 2020;

- indeksit të standardit të fuqisë blerëse tremujor, publikimi i fundit korrespondon me vlerën finale të 2019.

Gjatë 2020, INSTAT-i po vazhdon punën për vlerësimin e “Indeksi i çmimeve për shërbimet”.

- Gjatë vitit 2019–2020 në përmbushje të objektivave të PSZ-së 2017–2021, për “Statistikat e tregtisë së jashtme” janë realizuar sipas moduleve, objektivat si më poshtë:

- statistikatat e tregtisë së jashtme (eksporte/importe) të mallrave, botimi i fundit korrespondon me muajin dhjetor 2020;

- Treguesve statistikorë mbi (eksportet/importet) e mallrave për vitin 2019.

- Ndërmarrjet e huaja në Shqipëri 2017–2019

Në zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 17/2018, datë 5.2.2004, “Për statistikatat zyrtare”, “Programit Kombëtar të Statistikave Zyrtare 2017–2021”, Banka e Shqipërisë ka vijuar me prodhimin dhe publikimin e blloqeve statistikore të prezantuara nëpërmjet statistikave monetare e financiare dhe statistikave të sektorit të jashtëm. Banka e Shqipërisë është kujdesur që të gjithë treguesit e përgatitur prej saj të garantojnë plotësimin dhe respektimin e të gjitha parimeve të statistikave zyrtare, të tilla si integritetin, transparencën, cilësinë, koherencën, konfidencialitetin etj.

Lidhur me statistikatat monetare dhe llogaritë financiare, Banka e Shqipërisë, duke filluar nga nëntor 2019 është angazhuar në projektin e binjakëzimit me Bankën e Italisë dhe Bankën e Gjermanisë. Ky projekt synon harmonizimin e praktikës sonë për hartimin dhe shpërndarjen e

statistikave monetare dhe llogaritë financiare me standardet e bankave qendrore evropiane dhe rregulloret e ECB-së. Në fund të projektit pritet të realizohen:

- përmirësimi i prodhimit vjetor të FA–përmirësimi i metodave të vlerësimit të të dhënave që mungojnë për hartimin e transaksioneve sipas sektorëve/nën-sektorëve;

- identifikimi i burimeve dhe metodave për vlerësimin e Llogaritë financiare me bazë tremujore, stok, fluks dhe sipas sektorëve/nën-sektorëve;

- metodologjia e statistikave monetare në përputhje me rregulloren e ECB.

Banka e Shqipërisë ka nisur në nëntor 2019, programin IPA Shumëpërfutuese 2017 për statistikatat e Tregtisë Ndërkombëtare të Shërbimeve, ku fokus kryesor i projektit është përmirësimi i metodologjive statistikore kryesisht për shërbimet për përpunim, shërbimet e transportit të mallrave, matja e importit të FISIM-së, shërbimet qeveritare dhe mbulimi më i gjerë i të dhënave duke përfshirë transaksionet e llogaritë jashtë të rezidentëve.

Në kuadrin e investimeve të kryera, Banka e Shqipërisë ka përfunduar projektin njëvjeçar për automatizimin e prodhimit të bllokut të statistikave të sektorit të jashtëm. Aktualisht puna ka vijuar paralelisht në sistem dhe MS Office ekzistues për të garantuar vijueshmërinë e hartimit të statistikave të periudhave të ardhshme vetëm me sistem. Ky sistem përfshin hartimin mujor të statistikave të bilancit të pagesave, një nga pyetësorët e planifikuar për raportim në Eurostat për vitin 2021.

Për sa u përket aktiviteteve zbatuese për statistikatat monetare janë prodhuar dhe publikuar rregullisht treguesit monetarë mujorë dhe tremujorë, të tillë si: agregatat monetarë, depozitat, kreditë, normat e interesit të depozitave dhe kredive të reja, bilancet sektoriale dhe paraqitjet monetare të korporatave depozituese dhe institucioneve të tjera financiare. Në kuadër të harmonizimit të standardeve të raportimit me kërkesat e BE-së, Banka e Shqipërisë prej fundit të vitit 2017 filloi të zhvillojë një qasje të re lidhur me statistikatat e normave të interesit. Statistikatat e normave të interesit të Institucioneve Monetare Financiare (bankat e nivelit të dytë) hartohen bazuar në rregulloren, “Për raportimet në Bankën e Shqipërisë të statistikave të normave të interesit”



nr. 48/2017, e cila përaftron Rregulloren (EC) nr. 1072/2003, 24.9.2013 (ECB/2013/34), ndryshuar me rregulloren e Bankës Qendrore Evropiane (BQE) të datës 8.7.2014 (ECB/2014/30). Pas një periudhe konsolidimi të dhënash, në muajin Gusht 2020 në faqen zyrtare të BSH-së u publikuan për herë të parë statistikën e harmonizuar të normave të interesit të Institucioneve Monetare Financiare. Statistikat e harmonizuara të normave të interesit të institucioneve monetare financiare, sigurojnë informacion të vlefshëm për analizën e zhvillimeve monetare dhe mekanizmit të transmissimit monetar, si dhe për monitorimin e stabilitetit financiar.

Lidhur me hartimin e statistikave të llogarive financiare ka vijuar puna lidhur për konsolidimin e burimeve të informacionit dhe metodikës së vlerësimit në hartimin e llogarive financiare, për të gjithë sektorët ekonomikë, në përputhje me kërkesat e Bankës Qendrore Evropiane dhe Eurostatit. Në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional është forcuar bashkëpunimi për shkëmbimin e të dhënave me Qendrën Kombëtare të Biznesit, duke përmirësuar mbulimin e të dhënave për sektorin e korporatave jofinanciare. Banka e Shqipërisë publikon rregullisht si Llogaritë Financiare të Shqipërisë, në frekuencë vjetore së bashku me analizën e tyre. Në fund të vitit 2019, u raportuan me sukses në Eurostat tabelat - Bilancet për mjetet financiare dhe detyrimet (stoku ose gjendjet), të konsoliduara dhe të pakonsoliduara - për vitet 2013–2018. Energjitë janë përqendruar drejt arritjes së objektivit të transmetimit në Eurostat të tabelave të transaksioneve të mjeteve financiare dhe detyrimeve.

Në kuadër të grupit ndërinstitucional të punës për përmirësimin e cilësisë së treguesve të Procedurës së Deficitit të Tejkualuar (EDP), ka vijuar puna për harmonizimin e të dhënave të llogarive financiare me statistikën e financave të qeverisë. Gjithashtu, puna vijon për implementimin e rregullores 501/2004 EC për hartimin e llogarive financiare me bazë tremujore.

Lidhur me statistikën e sektorit të jashtëm, Banka e Shqipërisë ka transmetuar rregullisht në Eurostat pyetësorët e mëposhtëm, me bazë tremujore dhe vjetore:

- bilanci pagesave tremujore;
- pozicioni i investimeve ndërkombëtare;
- tregtia ndërkombëtare e shërbimeve;

- fluksi i investimeve direkte, sipas shteteve;
- të ardhurat nga i investimeve direkte, sipas shteteve;
- fluksi dhe të ardhurat nga investimet direkte, sipas shteteve dhe aktivitetit ekonomik;
- stoku i investimeve direkte, sipas shteteve;
- stoku i investimeve direkte, sipas shteteve dhe aktivitetëve;

Banka e Shqipërisë ka publikuar për herë të parë në dhjetor 2019 tregtinë ndërkombëtare të shërbimeve sipas shteteve, në kuadër të shtimit të produkteve statistikore.

Mbi statistikën e mjedisit, deri në vitin 2019 statistikën mbi “Mbetjet e ngurta urbane në Shqipëri” mbështeteshin në të dhëna të mbledhura në terren nëpërmjet anketës vjetore mbi mbetjet urbane pranë subjekteve që ushtronin veprimtarinë e mbledhjes dhe menaxhimit të tyre. Në vitin 2020, INSTAT për mbledhjen e të dhënave mbi mbetjet e ngurta urbane referuar vitit 2019, ka aplikuar për herë të parë metodën inovative nëpërmjet pyetësorëve elektronikë *online* pranë gjithë bashkive të vendit. Kjo metodë e re do të mundësojë prodhimin e disa indikatorëve të rinj të disagreguar në nivel qarku dhe në nivel bashkie. Gjatë vitit 2019, INSTAT-i ka vijuar me publikimet vjetore për llogaritë e flukseve të materialeve mjedisore (EW - MFA) dhe taksat e mjedisit dhe do të vazhdojë t'i prodhojë ato në baza vjetore. Në kuadër të projektit IPA shumëpërfutuese 2017, ka filluar punën për vlerësimin e situatës në lidhje me prodhimin e llogarive të emetimeve në ajër dhe llogarive të tjera mjedisore (EGSS, PEFA, EPEA).

Për prodhimin e statistikave të blegtorisë, kryhen vrojtime mujore (siç janë therja e bagëtive, të leshtave, të dhirtave dhe derrave në thertore, therja e shpendëve në thertore, grumbullimi dhe përpunimi i qumështit, prodhimi i vezëve). INSTAT-i, gjithashtu zhvillon edhe vrotimin vjetor mbi përpunimin e qumështit. Të dhënat janë të disponueshme dhe dërgohen në Eurostat për vlerësim, megjithatë ato ende nuk shpërndahen në shkallë vendi pasi informacioni nuk është ende i plotë për këto statistika për të cilat mungojnë të dhënat e therjeve jashtë thertoreve si dhe prodhimi i qumështit të lopës në fermë etj. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021, për anketat mujore në blegtori, INSTAT synon të përmirësojë metodologjinë e mbledhjes së të dhënave, duke kaluar nga metoda



tradicionale e intervistës me letër (PAPI) në metodën me *tablet* (CAPI).

Në lidhje me Statistikat e Peshkimit, në muajin korrik 2020, INSTAT-i në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (si burimi kryesor i informacionit statistikor), ka dërguar në Eurostat të dhëna të hollësishme në lidhje me Peshkimin dhe Akuakulturën. Ndërkohë, INSTAT-i po punon në përgatitjen e “Metadave lidhur me Statistikat e Peshkimit” të cilat do të transmetohen në Eurostat sapo të jenë gati.

Lista e fermave e Censit të Bujqësisë 2012 është përdorur si një bazë zgjedhje për Anketën Vjetore të Bujqësisë (AAS). Për shkak të mungesës së burimeve të tjera të të dhënave administrative, baza e zgjedhjes aktualisht përditësohet vetëm nga informacioni i ardhur nga vrojtimet vjetore në bujqësi. Baza e zgjedhjes përditësohet gjithashtu me listën e fermave të reja të hartuara çdo vit nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR).

Në Shqipëri Vrojtimi Vjetor i Bujqësisë (AAS) përfshin përdorimin e tokës, numrin e bagëtive dhe prodhimin e kafshëve, bilancet, kontributin e punës në bujqësi si dhe shpenzimet. Sa u përket të dhënave të këtij vrojtimi, në kuadër të programit IPA shumëpërfutuese 2015 u realizua seria kohore 2013- 2017 lidhur me statistikën e tokës dhe prodhimin bimor. Në vazhdimësi të punës së kryer, me mbështetjen e IPA shumëpërfutuese 2017, po realizohet edhe seria kohore 2013- 2018 sa u përket statistikave të numrit të krerëve dhe prodhimeve blegtorale.

Në lidhje me statistikën e çmimeve të produkteve bujqësore, kryhet një vërtetim i rëndësishëm mbi çmimet e prodhimit, indeksin e çmimeve të prodhimit publikohen çdo vit në nivel kombëtar. Të dhënat mbi çmimet mbledhen nga vërtetimet tremujore (INPUT1 dhe INPUT2). Shumica e të dhënave hyrëse (INPUT1) janë mbledhur që nga viti 2015, ndërsa të dhënat për çmimet e makinerive (INPUT2) janë mbledhur që nga viti 2018. Janë mbledhur të dhënat për çmimet e kafshëve të mbarështimit, si dhe të dhënat për çmimet e tokës dhe qiratë.

Në vitin 2022 do të fillojë prodhimi i indeksit të çmimeve të prodhimeve bujqësore me bazë vitin 2020 (2020=100). Gjithashtu, nëpërmjet asistencës teknike do të mundësohet prodhimi për herë të parë të indeksit të inputeve të prodhimeve

bujqësore. Në vijim, INSTAT-i do të fillojë dërgimin në EUROSTAT të të dhënave mbi çmimet e prodhimeve bujqësore.

Sektori i llogarive ekonomike në bujqësi harton dhe transmeton Llogaritë Ekonomike në Bujqësi (EAA) vetëm për përdorim të brendshëm.. Të dhënat e EAA janë përdorur kryesisht për përpilimin e Llogarive Kombëtare vjetore dhe tremujore, si dhe për përpilimin e llogarive rajonale për bujqësinë. Aktualisht, INSTAT-i nuk prodhon dhe nuk publikon të gjithë grupin e llogarive dhe treguesve të EAA për përdorim të jashtëm. Në kuadër të IPA shumëpërfutuese 2017, prodhimi i sistemit për llogaritjen e llogarive ekonomike në bujqësi planifikohet të përfundojë gjatë vitit 2023.

INSTAT ka planifikuar të kryejë Censin e Bujqësisë. Me qëllim përditësimin e listës së fermave bujqësore, si një bazë zgjedhje për Censin e ardhshëm të Bujqësisë, INSTAT-i ka përfshirë në Censin e Popullsisë dhe Banesave 2022, një rubrikë të veçantë me pyetje dedikuar Bujqësisë dhe Blegtorisë. Gjithashtu, sipas rekomandimeve të përcaktuara në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, brenda vitit 2020, INSTAT-i duhet të përfundojë dokumentet strategjike të Censit.

Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) për qëllime statistikore, shërben për përditësimin e vazhdueshëm të zonave të Censit. Gjatë vitit 2020, INSTAT-i ka kryer kontrollin e cilësisë dhe përditësimin e gjeodatabazës së ndërtesave dhe hyrjeve të tyre, të të dhënave të ardhura nga përditësimi në terren i informacionit gjeohapësinor të vitit 2019, në mbështetje të Censit të Popullsisë dhe Banesave. Procesi i përditësimit të gjeodatabazës po kryhet përmes një *software* *ArGis*, duke përdorur një model të dedikuar. Baza e të dhënave gjeohapësinore për qëllime statistikore, e përditësuar dhe e mirëmbajtur, do të shërbejë për mbështetjen e aktiviteteve statistikore (Cense, vërtetime, anketa etj.), inventarizimin e numrit të ndërtesave dhe karakteristikave të tyre.

18.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Arritjet kryesore gjatë vitit 2019–2020 janë:

- emërimi i drejtorit të përgjithshëm të INSTAT-it nëpërmjet vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 63/2020, “Për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Statistikave”;

- miratimi i ligjit nr. 140/2020, “Për censin e popullsisë dhe banesave”;



- plotësimin e rekomandimeve të Kuvendit sipas kërkesave të Rezolutës 2020, “Për veprimtarinë e Institutit të Statistikave”;

- plotësimi i pjesës më të madhe të vendeve vakante të stafit të INSTAT;

- publikimi i rezultateve të anketës “Inovacioni pranë ndërmarrjeve” periudha kohore 2017- 2019;

- përgatitja e raportit të gjetjeve të Pilotit të Censit të Popullsisë dhe Banesave;

- publikimi i rezultateve të anketës së Turizmit në Ndërmarrje “Strukturat Akomoduese”, seria kohore 2018–2019, 6-mujori i parë 2020 dhe tremujori i tretë 2020;

- INSTAT-i publikoi dhe transmetoi në Eurostat të dhënat tremujore të turizmit në ndërmarrje dhe raportin e cilësisë;

- INSTAT-i publikoi për herë të parë, “Statistikat mbi karakteristikat e mjeteve rrugore, 2019”.

- INSTAT-i ka transmetuar në Eurostat në Qershor të vitit 2020 të dhënat mbi treguesit kryesorë të Statistikave Strukturore të Ndërmarrjeve.

- INSTAT-i ka transmetuar në Eurostat në qershor të vitit 2020 të dhëna mbi treguesit demografikë dhe komponentët e saj, si: Popullsia, Lindjet, Vdekjet, Shtesa Natyrore, Migracioni Neto. Gjithashtu, në përputhje me rregulloret dhe definicionet e përdorura, INSTAT-i ka transmetuar metadata referenciale nëpërmjet platformës elektronike Metadata Handler, mbi këto të dhëna (Euro SDMX Metadata Strukturore, ESMS);

- INSTAT-i ka përpunuar analizuar dhe transmetuar për herë të parë në Eurostat gjatë muajve Maj-shtator të vitit 2020, të dhëna mbi vdekjet me periodicitet javor sipas karakteristikave kryesore demografike (NUTS 3, SEX dhe AGE). Këto të dhëna në seri kohore w1_2015–w27_2020 janë validuar dhe bërë publike në bazën e të dhënave të EUROSTAT-it në tetor 2020. INSTAT-i iu bashkua nismës nga EUROSTAT- i në mënyrë vullnetare për statistika sa më të detajuara dhe me periodicitet të lartë në kuadër të situatës të shkaktuar nga pandemia globale COVID-19;

- INSTAT-i në kuadër të përmirësimit dhe përmbushjes së treguesve mbi statistikën e migracionit në Shqipëri ka zhvilluar një studim të gjerë në 24 mijë familje në vitin 2019 me mbështetjen e IOM. Ky studim, i cili u publikua në

Shtator 2020, bën të mundur vlerësimin e Migracionit që prej vitit 2011 e në vazhdim, dhe prodhimin dhe përmirësimin e një sërë treguesve që lidhen me statistikën e Migracionit;

- në Janar të vitit 2020, INSTAT-i në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale lançuan për herë të parë raportin e Indeksit të Barazisë Gjinore. Treguesi i barazisë gjinore është një vlerë themelore e Bashkimit Evropian dhe është thelbësor për zhvillimin e politikave gjinore të një vendi. Si i tillë matja e progresit të barazisë gjinore është një pjesë integrale dhe efektive e politikë bërësve;

- Publikimi i Politikës së Revizionimit të treguesve makroekonomik, në përputhje të plotë me Politikën Evropiane e Harmonizuar e Revizionimit (HERP-eng);

- Përmbushja e të gjitha objektivave në kuadër të Projekteve Pilot IPA MB 2015 mbi Llogaritë Kombëtare;

- Vlerësimi dhe transmetimi për herë të parë, i tabelave Burime-Përdorime, 2017, me çmimet e vitit të mëparshëm, me kriterin e Konfidencialitetit sipas programit të Transmetimit ESA 2010;

Kryerja e anketës SILC+ në 15 bashki, korrik-tetor 2020 në bashkëpunim me UNWOMEN. Rezultatet priten të dalin brenda vitit 2020.

- Publikimi i Anketës së Strukturës së të Ardhurave nga Puna e planifikuar në nëntor 2020.

- Përditësimi i informacionit gjeohapësinor të ndërtesave dhe karakteristikave të tyre për të gjithë territorin e vendit;

- Dërgimi për herë të parë në EUROSTAT i setit të të dhënave të Statistikave të Peshkimit;

- Prodhimi për herë të parë të indikatorëve mbi produktet organike në bujqësi;

- Prodhimi i indikatorëve në nivel qarku për statistikën mbi mbetjet e ngurta urbane;

- Transmetimi i të dhënave të Transportit hekurudhor dhe rrugor për vitin 2019 në Eurostat nëpërmjet aplikacionit WEBCOQ.

18.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

INSTAT-i është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë dhe institucioni përgjegjës për koordinimin e funksionimit të Sistemit Kombëtar të Statistikave (SKS), i përbërë edhe nga dy agjenci statistikore si Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Banka e Shqipërisë. Institucionet e tjera publike si Ministria e Bujqësisë



dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Brendshme etj., dhe institucionet e tyre të varësisë, kontribuojnë në prodhimin e statistikave zyrtare si ofrues të informacionit statistikor dhe të dhënave administrative.

Banka e Shqipërisë, si agjenci statistikore është institucioni përgjegjës për prodhimin e statistikave monetare dhe financiare, dhe llogarive financiare, gjithashtu përgjegjës për prodhimin e statistikave të bilancit të pagesave dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si agjenci statistikore, është përgjegjëse për prodhimin e statistikave financiare të qeverisë. Gjithashtu së bashku me Bankën e Shqipërisë, ajo mbështet dhe furnizon me të dhëna INSTAT-in për hartimin e tabelave *input-output* në kuadër të EDP.

18.7 Prioritetet

Qëllimi kryesor i INSTAT-it është të përafrojë më tej legjislacionin e tij me *acquis* të BE-së në lidhje me standardet statistikore evropiane dhe të rrisë rolin e saj si koordinator i Sistemit Kombëtar të Statistikor.

Bazuar në rekomandimet e fundit të BE-së, për vitin 2020 prioritetet e identifikuara janë si më poshtë:

- Vazhdimi i përforcimeve të burimeve të INSTAT-it;

- Vazhdimi i përgatitjeve për Censin e Popullsisë dhe Banesave në përputhje me legjislacionin përkatës të BE-së dhe standardet e Kombeve të Bashkuara;

- Përgatitja e Programit të ri të Statistikave Zyrtare për periudhën 2022- 2026

- Përgatitja e planit të veprimit dhe buxhetit të detajuar vlerësuar për Censin e Bujqësisë;

- Të zbatojë Ligjin mbi Statistikat Zyrtare dhe të vazhdojë zgjerimin e qëllimit të statistikave zyrtare në përputhje me rregulloret e BE-së.

Prioritete të tjera bazuar në programin e Statistikave Zyrtare 2017- 2021, në Strategjinë e Zhvillimit të INSTAT-it, si dhe në rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Statistikës për vitin, janë si në vijim:

Kryerja e Anketës rreth “Strukturës së Kostos nga Puna” e planifikuar çdo katër vjet

- Përditësimi i kufijve të zonave të Censit;

- Mbështetje e aktiviteteve statistikore me informacion gjeohapësinor (cense, vrojtime, anketa etj.);

- Përshtatja e Strategjisë së Sistemit Kombëtar Statistikor me strukturën e strategjive kombëtare e sektoriale sipas sistemit IPSIS;

- Ndërtimi i sistemit IT të integruar, eksperimental, në funksion të statistikave GFS;

- Implementimi i vazhdueshëm i Sistemit Evropian i Llogarive ESA 2010;

- Rritja e lloshmërisë së tabelave të transmetuara në EUROSTAT, në kuadër të Programit të Transmetimit ESA 2010;

- INSTAT-i mirëmban regjistrin e ndërmarrjeve dhe regjistrin e njësive lokale përgjatë një procesi të vazhdueshëm. Prioriteti i INSTAT-it është zgjerimi i regjistrit të bizneseve me njësi statistikore si: grupet e ndërmarrjeve (siç përcaktohet në Rregulloren 177/2008).

- në kuadër të globalizimit, krijimi dhe përditësimi i regjistrit të grupeve të ndërmarrjeve është i një rëndësie të veçantë. Statistikat e bazuara në grupet e ndërmarrjeve janë shumë të rëndësishme, kryesisht për analizimin e ndikimit të ndërmarrjeve shumëkombëshe në ekonominë e vendit.

- Regjistri në kohë reale ose ndryshe *Live Register* u testua gjatë vitit 2020 dhe do të gjejë zbatim në vitin 2021. Roli kryesor i regjistrit në kohë reale është të japë një informacion mbi situatën aktuale të bizneseve, ashtu edhe të dokumentojë ndryshimet e ndodhura në kohë të njësive statistikore dhe karakteristikat e tyre. Zbatimi i *Live regjistër* do të shoqërohet me një strategji e mirëpërcaktuar të mirëmbajtjes.

- Njësitë statistikore në regjistrin e bizneseve do të përditësohen me informacionin më të fundit në dispozicion dhe do të shërbejë për metodologjinë e kampionimeve në vrojtimet statistikore.

- Burimet administrative të përdoren për analizën dhe prodhimin e treguesve afat-shkurtër.

- Nga metoda e grumbullimit tradicionale, me pyetësor letër, me intervistë të drejtpërdrejtë me anketues të përdoret sistemi CAPI si përmirësim i metodës së grumbullimit të informacionit për statistikën Afatshkurtra të Ndërmarrjeve.

- Transmetimi i të dhënave mbi vdekjet javore, kërkesë vullnetare nga Eurostat në kuadër të pandemisë globale;



- Kryerja dhe përpunimi i të dhënave të Anketës së Shëndetit (EHIS)

INSTAT-i planifikon publikimin e të dhënave të vrojtimit “Inovacioni pranë ndërmarrjeve, 2018-2020”;

- INSTAT-i planifikon publikimin e të dhënave të vrojtimit “Kërkimi dhe Zhvillimi 2018- 2020”.

- Analiza e të dhënave të Çmimeve të Shërbimeve dhe ndërtimi i një strategjie për implementimin e këtij treguesi, për të ndërtuar një Indeksi Çmimesh në Shërbime sipas standardeve të EU-së;

- Fokusimin në nevojat e të dhënave për përpilimin e moduleve të mbetura, INSTAT-i do të përqendrohet në zhvillimin e mëtejshëm të moduleve: Llogaritë rrjedhëse fizike të energjisë (*physical energy flow accounts*), produktet dhe shërbimet në sektorin e mjedisit (*environmental goods and services sector*), llogaritë e shpenzimeve për mbrojtjen e mjedisit (*environmental protection expenditure accounts*);

- Kryerja e suksesshme e Censit të Bujqësisë;

- Hartimi i statistikave të bilancit të pagesave me frekuencë mujore;

- Hartimi i llogarive financiare me baza tremujore (*stock* dhe fluks).

KAPITULLI 19

POLITIKAT SOCIALE DHE PUNËSIMI

19.1 Përmbajtja e kapitullit

Ky kapitull fokusohet në funksionimin e dialogut social, veçanërisht strukturat e përgjithshme ligjore mbi sindikatat dhe organizimet e punëdhënësve, e drejta për të organizuar/bashkuar sindikatat, kontratat kolektive dhe veprimi industrial, e drejta e grevës, mekanizmat trepalësh të konsultimit, duke përfshirë këshillin ekonomik dhe social, dialogun/kontratat, marrëveshjet dypalëshe dhe përfshirjen e partnerëve social në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit.²⁸

19.2 Struktura e kapitullit

Lista e nënkapitujve, si më poshtë:

- ligji i punës;
- shëndeti dhe siguria në punë;
- dialogu social;

- politikat e punësimit;

- fondi social evropian;

- përfshirja sociale dhe personat me aftësi të kufizuara;

- mbrojtja sociale;

- antidiskriminimi dhe shanset e barabarta.

19.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Detyrimi i përgjithshëm për të përafuar ligjin Shqiptar me atë të Bashkimit Evropian buron nga Neni 70 i MSA-së. E ndarë nga kjo dispozitë, Shqipëria nuk ka vetëm detyrimin për të sjellë teknikisht legjislacionin e saj kombëtar në linjë me atë të BE-së, por gjithashtu të sigurojë edhe zbatimin e tij. Sipas Nenit 77 të MSA-së, Shqipëria duhet të harmonizojë në mënyrë progresive legjislacionin e saj me atë të BE-së në fushat e kushteve të punës, sidomos në shëndetin dhe sigurinë në punë dhe mundësi të barabarta.

Detyrimet në fushën sociale dhe politikave të punësimit rrjedhin nga Neni 99 mbi “Zhvillimin dhe përmirësimin e Sistemit të Sigurisë Sociale”, Neni 48 “mbi Koordinimin e sistemeve të Mbrojtjes Sociale për Komunitetin e Qytetarëve Punëtorë në territorin Shqiptar dhe të shtetasve Shqiptarë të punësuarve në vendet e Bashkimit Evropian”.

Nenet 46, 47, 48, 77, 99 të MSA-së përcaktojnë bashkëpunimin ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, duke synuar në modernizimin dhe ristrukturimin e shërbimeve të punësimit dhe trajnimit profesional, zbatimit të programeve të punësimit aktiv dhe pasiv dhe mbështetjen e përafrimit gradual të legjislacionit Shqiptar dhe praktikave në fushën e tregut të punës dhe trajnimit profesional me rregullat dhe standardet e Unionit.

Rregullat e BE-së në fushën sociale përfshijnë standarde minimale për ligjin e punës, barazinë gjinore, shëndetin dhe sigurinë në punë dhe mos diskriminimin. Në bazë të Nenit 153 të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian (TFBE), Unioni mbështet dhe plotëson aktivitetet e Vendeve Anëtare në fushën e politikave sociale. Fondi Social Evropian është mjeti kryesor financiar përmes të cilit BE mbështet zbatimin e strategjisë së saj të punësimit dhe kontribuon në përpjekjet e përfshirjes sociale (rregullat e zbatimit janë të përfshira në kapitullin 22, i cili merret me të gjitha instrumentet strukturorë).

²⁸ Kapitulli 23 “Drejtesia dhe të Drejtat Themelore” mbulojnë lirinë e asamblesë dhe shoqërive nga një perspektive themelore e të drejtave.



Në fushën e aftësive të kufizuara, BE-ja është pjesë e Kuvendit për të Drejtat e Personave me Aftësi Ndryshe të Kombeve të Bashkuara dhe ka përshtatur një strategji që synon integrimin, përhapjen e çështjeve të aftësive të kufizuara me politikën e përshtatshme të Unionit dhe rritjen e përfshirjes dhe pjesëmarrjes e njerëzve me aftësi ndryshe, njëloj si të tjerët.

Marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura me punësimin, punën dhe çështjet sociale, siç është Kuvendi i ONP dhe Kuvendi i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me aftësi të kufizuara, duhet të merren në konsideratë.

19.4 Situata aktuale në Shqipëri

Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitje në fushën e politikave sociale dhe punësimit. Disa përparime janë bërë në rritjen e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe në përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të institucioneve dhe shërbimeve të tregut të punës.

Shqipëria ka vijuar ristrukturimin e sistemit të qeverisjes së punësimit, siç parashikohet në ligjin e ri për arsimin dhe formimin profesional (AFP). Reforma e shërbimeve sociale po përparon, duke synuar rritjen financiare dhe administrative, për të forcuar nivelin lokal.

Disa përparime u bënë në zbatimin e rekomandimeve të raportit të mëparshëm, veçanërisht në rritjen e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe në përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të institucioneve dhe shërbimeve të tregut të punës.

Shqipëria ka vazhduar ristrukturimin e sistemit të saj të qeverisjes së punësimit, në përputhje me ligjet për arsimin dhe aftësimin profesional dhe promovimin e punësimit.

Sa i përket legjislacionit të punës, Kodi i Punës i ndryshuar është duke u zbatuar. Me qëllim përmirësimin e monitorimit të zbatimit të legjislacionit të punës dhe mbledhjes së të dhënave të inspektimit nga ISHPSHSH është zhvilluar një platformë e quajtur “Matrica”. Ky shërbim është projektuar për vendosjen e standardeve në marrëdhëniet me biznesin dhe shërben si një mundësi testimi për çdo subjekt, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të punës, duke krijuar mundësinë e vetëkorrigimit. Gjithashtu “Matrica” shërben edhe për standardizimin e punës së inspektorëve të punës në çdo vendimarrje dhe kjo pasi:

- Rrit inteligjencën profesionale të inspektorëve të punës, siguron transparencë në vendimarrjen e tij dhe minimizon abuzimin me detyrën;

- Synon trajtim i barabartë, për mos respektimin e së njëjtës dispozite ligjore, në kushte të barabarta.

Nëpërmjet përpunimit të të dhënave të inspektimit të marra nga “Matrica” orientojmë inspektimin në bazë të nivelit të riskut të subjekteve.

Me qëllim monitorimin e punës së fëmijëve, është hartuar një udhëzues praktik për inspektorët e punës në identifikimin dhe kontrollimin e formave të punës së fëmijëve dhe reagimin e duhur. Ky udhëzim i veçantë do të forcojë rolin e inspektorëve të punës në identifikimin dhe referimin e punës së paligjshme të fëmijëve.

Me VKM-në nr. 479, datë 17.6.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 108, datë 15.2.2017” Për miratimin e rregullores për mbrojtjen e fëmijëve në punë”, e cila u miratua dhe hyri në fuqi me botimin në gazeta zyrtare e datës 22.6.2020, është shtuar detyrimi i inspektorëve të punës për të zbatuar këtë udhëzues praktik si shtojca II, e cila i bashkëlidhet kësaj VKM-je.

Lidhur me shëndetin dhe sigurinë në punë, dokumenti i politikës së sigurisë dhe shëndetit në punë 2016- 2020 dhe plani i tij i veprimit janë në zbatim. Gjatë viteve 2013–2017, Shqipëria miratoi ligje që përafrojnë 19 direktiva të BE-së të lidhura me Direktivën Kuadër për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë.

Gjatë vitit 2019, hyri në fuqi VKM-së nr. 596, datë 4.9.2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 639, datë 7.9.2016, “Për rregullat, procedurat dhe llojet e testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës që kryejnë punëmarrësit, si dhe mënyrën e funksionimit të shërbimit mjekësor në punë”.

Gjatë viteve 2018- 2019, Shqipëria u përqendrua në zbatimin efektiv të instrumenteve të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Aksidentet në punë hetohen nga ISHPSHSH-ja dhe ndahen sipas llojit të aktivitetit. Në këtë kontekst, për vitin 2019 rezulton së sipas degëve rajonale numri më i madh i inspektimeve për rast aksidenti në punë është kryer në degën rajonale Tiranë, Durrës, Dibër dhe Lezhë.

Sipas llojit të aktivitetit ekonomik numri më i madh i rasteve të hetimit të aksidenteve në punë, rezulton në sektorin e ndërtimit i cili zë 24,8% të



totalit të inspektimeve për aksident në punë, duke vijuar me “ndërmarrjet prodhuese” të cilat zënë 24.3% të totalit të inspektimeve për aksident në punë. Punëmarrësit e aksidentuar në sektorin e ndërtimit zënë 25.5% të punëmarrësve të aksidentuar në punë gjatë vitit 2019.

Situata e çështjeve të sigurisë dhe të shëndetit në punë ka marrë vëmendje të shtuar nga vetë subjektet. Si rezultat i pasojave të mos deklarimit të aksidenteve, parashikuar në ligjin përkatës, vërehet ndërgjegjësim i rritur për deklarim të aksidenteve në punë nga punëdhënësi. Janë krijuar lehtësira për marrjen e informacionit të shtuar dhe të kryerjes së këtij raportimi, nëpërmjet faqes zyrtare, duke mundësuar deklarim të aksidenteve në çdo ditë dhe orë të javës, përfshirë ditët e pushimit javor apo ditët e festave zyrtare.

Përveç aksidenteve të njoftuara nga vetë punëdhënësit ashtu siç ligji e parashikon, gjatë vitit 2019 ka pasur të regjistruara edhe aksidente nga burime të tjera e konkretisht nga organet e Prokurorisë, media, ankesa të vetë punëmarrësve të aksidentuar të ardhura drejtpërdrejtë pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës apo nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes.

Nuk janë regjistruar raste të fëmijëve të aksidentuar në punë, grave shtatzëna/gra me fëmijë në gjë apo persona me aftësi të kufizuara, grupe këto që gëzojnë mbrojtje të veçantë nga legjislacioni i punës:

- nga viti në vit konstatohet rritje e numrit të subjekteve që ndërmarrin masat për krijimin e kushteve të sigurta të punës, e konkretisht për periudhën janar–gusht 2020, vërehet rritje e:

- numrit të subjekteve që mbulohen me shërbim mjekësor (konstatohet në 41% të subjekteve të inspektuara);

- numrit të subjekteve që përdorin pajisje mbrojtëse individuale (87% të subjekteve të inspektuara);

- numri i subjekteve që përdorin pajisje mbrojtëse kolektive (80% të subjekteve të inspektuara);

- numrit të punëmarrësve që përdorin pajisjeve mbrojtëse kolektive dhe individuale (70% të punëmarrësve të konstatuar);

- shërbimit të ndihmës së parë (76% të subjekteve të inspektuara);

- shërbimit të mbrojtjes ndaj zjarrit (75% të subjekteve të inspektuara);

- këshillave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe përfaqësuesve në Këshillat e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, (në 41 % e subjekteve të inspektuara);

- ekziston Dokumenti i Vlerësimit të Rrezikut, (në 58% të subjekteve të inspektuara).

Prioritetet e ISHPSHSH-së në drejtim të krijimit të kushteve të sigurta të punës kanë orientuar edhe planifikimin e inspektimeve në subjektet që paraqesin rrezikshmëri për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëmarrësve, si dhe zhvillimin e takimeve ndërgjegjësuere me biznesin si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Vërehet një rritje e konsiderueshme e Këshillave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, dhe ekzistencës së dokumentit të vlerësimit të riskut, kjo si pasojë e kërkesës së vazhdueshme nga Inspektorati i Punës në këtë drejtim. ISHPSHSH inkurajon jo vetëm ngritjen e këtyre Këshillave por dhe efektivitetin e tyre. Gjithashtu, kërkon që dokumenti i vlerësimit të riskut të jetë konform legjislacionit në fuqi.

Në lidhje me dialogun social në nivel qendror, Këshilli Kombëtar i Punës (KKP) është riorganizuar në muajin prill 2018. Ky Këshill ka zhvilluar 3 mbledhje në total, 2 mbledhje në 2018 (prill dhe nëntor 2018) dhe 1 mbledhje në 2019 (prill). Në mënyrë që të përmbushë funksionet dhe detyrat e tij, është ngritur Sekretariati i Këshillit Kombëtar të Punës me 3 sekretarë me kohë të plotë brenda strukturës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Aktualisht, Këshilli Kombëtar të Punës ka zhvilluar *online* 2 mbledhje në vitin 2020 (12 qershor dhe 16 tetor), ku janë konsultuar çështje të rëndësishme lidhur me situatën e krijuar nga pandemia dhe masat e marra nga Qeveria në sektorin e shëndetësisë, arsimit, turizmit, paga minimale, ratifikimi i konventës 190 së ILO-së, “Për dhunën dhe ngacmimin”, si dhe raportim nga inspektorati për zbatimin e legjislacionit të punës në sektorin privat dhe publik.

Në lidhje me kriteret e matshme të përfaqësimit të partnerëve socialë në Këshillin Kombëtar të Punës, Grupi i Punës bazuar në propozimet e partnerëve socialë dhe ekspertizës së ILO, ka hartuar një projektvendim. Projektvendimi u miratua në parim nga Këshilli Kombëtar i Punës.

Kriteret e përfaqësueshmërisë u miratuan me VKM-në nr. 54, datë 29.1.2020, nga Këshilli i Ministrave, të cilat do të garantojnë legjitimitetin e



KKP-së, ndikimin politik dhe rritjen e besueshmërisë së mendimeve dhe rekomandimeve të këtij Këshilli.

Në kuadër të minimizimit dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të punës janë zhvilluar procedurat e ndërmjetësimit/pajtimit për zgjidhjen e disa mosmarrëveshjeve të lindura mes punëdhënësve dhe punëmarrësve në sektorin publik dhe privat, në zbatim të neneve 188- 192 të Kodit të Punës, sipas kërkesave dhe brenda afateve.

Janë zhvilluar fushata për rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me mekanizmin e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjeve të punës. Gjithashtu në bashkëpunim me Zyrën Ndërkombëtare të Punës janë organizuar trajnime me Rrjetin Shtetëror të Ndërmjetësimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kolektive të punës ndërmjet procedurave të ndërmjetësimit/pajtimit dhe standardet ndërkombëtare në këtë fushë.

Me kontributin e Zyrës Ndërkombëtare të Punës (ILO), në vitin 2019 u krijua një bazë të dhënash kombëtare për marrëveshjet kolektive dhe Sindikatat, si edhe sistemi i menaxhimit të çështjeve dhe çështjet e zgjidhura, i cili do të jetë i aksesueshëm nga aktorë të ndryshëm, si Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Inspektorati Shtetëror i Punës, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Partnerët Socialë. Ekzistenca e një informacioni të saktë dhe të besueshëm mbi marrëveshjet kolektive dhe mbulimin kolektiv të tyre, ndihmon autoritetet publike për të hartuar masa politikash që synojnë të nxisin dhe zbatojnë praktikat më të mira.

Për sa i përket situatës së kontratave kolektive, janë lidhur 12 kontrata kolektive në nivel qendror, ndërsa “kontratë kolektive” kombëtare për të gjitha degët nuk ka, pasi deri më sot nuk ekzistonte një organizim i tillë i punëdhënësve që të ketë autoritetin për të nënshkruar kontratën kolektive të nivelit kombëtar me sindikatat.

Në zbatim të nenit 167 të Kodit të Punës, punëdhënësit kanë depozituar në nivel dege 23 kontrata kolektive të punës, të cilat janë në fuqi kryesisht në sektorë të ndryshëm të ekonomisë si telekomunikacion, ndërtim, arsim, shërbime, elektroenergjetik, turizëm, bujqësi, shëndetësi, infrastrukturë, ndërtim, polici etj.

Sa u përket politikave të punësimit, Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (NESS) 2014–2020, dhe plani i saj i veprimit, janë rishikuar dhe kohëzgjatja e tyre është shtyrë deri në vitin 2022

(siç është miratuar me VKM-në në tetor 2019). Rishikimi i Strategjisë u bë pas Raportit të Vlerësimit Afatmesëm që përfshin periudhën 2014–2018. Raporti vlerësoi se të katër prioritetet strategjike janë akoma relevante. Qëllimi kryesor i Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2019–2022 dhe planit të saj të veprimit është të identifikojë dhe hartojë politikat e duhura për punësimin dhe formimin profesional të fuqisë punëtore, në mënyrë që të krijojë vende pune dhe mundësi cilësore për punësim dhe aftësi përgjatë gjithë ciklit të jetës. Plan i veprimit përqendrohet në rritjen e mundësive për punë të denjë përmes politikave efikase të tregut të punës, sigurimit të arsimit dhe aftësimit cilësor të të rinjve dhe të rriturve, nxitjen e përfshirjes dhe kohezionit social, dhe forcimin e sistemit të qeverisjes së tregut të punës dhe kualifikimeve. Strategjia rishikoi indikatorët deri në vitin 2022, sipas një baze të dhënash, në bashkëpunim të ngushtë me INSTAT-in. Secila masë do të zbatohet nga mbështetja e parashikuar në MTBP, si dhe nga projektet e donatorëve që janë duke u zbatuar.

Një prej objektivave të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, 2019–2022, është zgjerimi i mbulimit, përfshirjes dhe efektivitetit të shërbimeve të punësimit. Në kuadër të realizimit të këtij objekti, drejtoritë përgjegjëse në AKPA kanë parashikuar realizimin e aktiviteteve për periudhën në vijim.

Këshilli i Ministrave miratoi krijimin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) në Korrik 2019 (VKM 554/2019). Struktura e propozuar e Agjencisë së re është miratuar dhe në Drejtorinë e Përgjithshme është parashikuar rritje e stafit nga 36 në 90 persona. Plotësimi i stafit ka filluar pas miratimit të kësaj strukture. Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e COVID-19, procesi i plotësimit të stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të AKPA nisi gjatë muajit Qershor 2020. Edhe pse është parashikuar që plotësimi i stafit të shtrihet deri në vitin 2022, në fund të vitit 2020 parashikohet të plotësohet 54% e vendeve vakante në Drejtorinë e Përgjithshme. Në fund të muajit Shtator 2020 rezultoi, se për:

- 15 vende vakante ka përfunduar procesi i plotësimit të tyre;
- 4 vende vakante po zhvillohen konkurset;
- 5 vende vakante janë shpallur dhe janë në fazën e aplikimit nga kandidatët;



- 6 vende vakante janë në pritje për t'u shpallur nga DAP- i.

Pas miratimit të ligjit për nxitjen e punësimit nr. 15/2019 një pakete e rishikuar dhe programesh për nxitjen e punësimit të reja janë miratuar programesh për nxitjen e punësimit është miratuar. Programet përfshijnë mbështetje të ndryshme për punëkërkuessit e papunë, si:

- punësim i subvencionuar (ku janë përfshirë punëkërkuessit të papunë nga grupet e veçanta si të rinjtë, gratë me fëmijë në ngarkim, PAK-të, romët emigrantë të kthyer me probleme ekonomike, përfitues të ndihmës ekonomike dhe të pagesës së papunësisë të papunët afatgjatë, viktimat të dhunës etj.;

- trajnimit nëpërmjet punës;
- praktika profesionale;
- pune publike në komunitet;
- vetëpunësim;
- programet COVID-19.

40 zyra punësimi janë organizuar dhe operojnë me modelin e ri të shërbimeve të punësimit. Performanca e politikave të punësimit në tregun e punës është e lidhur ngushtë me punën e stafit, të sistemit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, si dhe me menaxhimin e mirë të buxhetit të tij vjetor. 329 punonjës të zyrës dhe stafit drejtues janë të trajnuar për programet e reja të Nxitjes së punësimit.

Reformimi i Kornizës Ligjore ka dhënë një kontribut domethënës në konsolidimin dhe reformimin e politikave të punësimit dhe aftësive në Shqipëri, të cilat janë detajuar në Planin e rishikuar të Veprimit 2019–2022, të ndërtuar në bazë të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2019–2022.

Karta e performancës si një mjet monitorimi i cilësisë së shërbimeve, përcakton arritjet vjetore të indikatorëve më të rëndësishëm që masin nivelin e shërbimit të Zyrës së Punës ndaj klientëve të saj: punëkërkuessit dhe punëdhënësit. Treguesit kryesorë të performancës si punësimet, përfshirja në programet aktive të tregut të punës, numri i VLP-ve të shpallura dhe rritja e numrit të punëdhënëseve klientë të Zyrës së Punës, detajohen edhe në tregues të tjerë që i referohen priorizimit të grupeve vulnerabël në zbatim të treguesve të strategjive përkatëse dhe indikatorë të tjerë strategjik.

Përcaktimi i objektivave bazohet në karakteristikat e regjistrit të punëkërkuessve dhe punëdhënëseve, ecures së treguesve të monitorueshëm të periudhave të mëparshme, objektivat në lidhje me secilin grup vulnerabël të përcaktuar në strategjitë e tyre dhe indikatorë të tjerë strategjikë kombëtar dhe ndërkombëtar.

Për herë të parë në vitin 2019 SHKP, nën mbështetjen e GIZ, nis të zbatojë në të gjitha Qendrat e Formimit Profesional paketën *Start Smart* për zhvillimin e aftësive të buta të punëkërkuessve të papunë, të cilat pritet të ndikojnë në zhvillimin e aftësive të punësueshmërisë.

Sa më sipër u bë planifikimi dhe shpërndarja e targetit për çdo ZP dhe QFP, duke u fokusuar në Pu. Pa-të e nivelit të parë dhe të dytë të punësueshmërisë, kryesisht të atyre që orientoreshin për të ndjekur një kurs formimi profesional.

Gjithashtu, për realizimin e objektivit u realizua trajnimi i stafit dhe u siguruan ambientet dhe pajisjet informatike.

Gjatë vitit 2019 dhe 2020 në kurset *Start Smart* morën pjesë 13,834 punëkërkuess të papunë në shkallë vendi.

U hartua dhe miratua në muajin maj 2019 manuali për sistemin e referimit dhe administrimit të kursit *Start Smart*, i cili përbëhet nga dy pjesë, përkatësisht:

- ZP (sistemi i referimit)
- QFP (sistemi i dokumentimit)

Ky manual standardizoi procesin dhe rregulloi marrëdhënien QFP- ZP. Me mbështetjen e GIZ u realizua një trajnim me qëllim administrimin e procesit nga QFP-të.

Marrëveshja midis AKPA-së dhe Shërbimit Social Shtetëror të nënshkruar për riintegrimin në tregun e punës të përfituesve aktualë dhe ish të ndihmës në para, dha si rezultat:

Viti 2018:

- Punësimin e 1,705 përfituesve të mëparshëm dhe 2,253 përfituesve;

- Pjesëmarrjen e 435 përfituesve të mëparshëm dhe 356 përfituesve në programe aktive të tregut të punës;

- Pjesëmarrjen e 327 përfituesve të mëparshëm dhe 394 përfituesve në kurse të formimit profesional.

**Viti 2019:**

- Punësimin e 1,168 përfituesve të mëparshëm dhe 1,875 përfituesve;
- Pjesëmarrjen e 403 përfituesve të mëparshëm dhe 311 përfituesve në programe aktive të tregut të punës;
- Pjesëmarrjen e 92 përfituesve të mëparshëm dhe 361 përfituesve në kurse të formimit profesional.

Viti 2020:

- Punësimin e 205 përfituesve të mëparshëm dhe 904 përfituesve;
- Pjesëmarrjen e 15 përfituesve të mëparshëm dhe 39 përfituesve në programe aktive të tregut të punës;
- Pjesëmarrjen e 14 përfituesve të mëparshëm dhe 54 përfituesve në kurse të formimit profesional.

Gjatë vitit 2019 SHKP-ja ka ndërmarre nismën për nënshkrimin e marrëveshjeve me Njësitë e Qeverisjes Vendore në kuadër të forcimit dhe bashkërendimit të politikave të punësimit në nivel rajonal dhe vendor.

Këto marrëveshje konsistojnë në ndërtimin e një marrëdhënieje dypalëshe me qëllim shërbimin e institucionalizuar dhe ndihmën ndaj punëkërkuesve për një jetë më të mirë dhe dinjitoze, si dhe në koordinimin e përpjekjeve institucionale në nivel vendor dhe rajonal nën objektivin kryesor të uljes së nivelit të papunësisë në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore dhe adresimin sa më efektiv të problematikave sociale me të cilat përballen individët.

Për sa më lart, gjatë vitit 2019 janë realizuar 4 marrëveshje bashkëpunimi; përkatësisht, a) me Bashkinë Maliq, b) Bashkinë Korçë, c) Bashkinë Fier dhe ç) Bashkinë Delvinë.

Në kuadër të **Fondit Social Evropian** nuk ka pasur zhvillime.

Në nënfushën mbi *Përfshirjen sociale dhe personat me aftësi të kufizuara*, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale koordinon dhe monitoron politikën për përfshirjen sociale për Personat me Aftësi të Kufizuara në përputhje me parimet e Konventës së OKB për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Raporti I për Shqipërinë i KDPK-së, i OKB-së, është marrë në konsideratë nga Komiteti i OKB për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në shtator 2019.

Faqe | 4118

Në këtë kontekst, do të diskutohet dhe mundësia e ratifikimit të Protokollit opsional Reforma e Modernizimit të Ndhmës Sociale, me Bankën Botërore dhe reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar synojnë zbatimin e vlerësimit biopsikosocial në të gjithë territorin. Reforma mbi Aftësinë e Kufizuar ishte planifikuar të shtrihej me faza fillimisht në rajonin e Tiranës në Dhjetor 2019 dhe në rajonet e Durrësit dhe Elbasanit brenda 2020–2021. Dokumenti i politikave për aftësinë e kufizuar dhe Plani i veprimit për zbatimin e tij u miratua në qershor 2019 me VKM. Ky dokument parashikon shtrirjen progresive kombëtare të vlerësimit biopsikosocial të aftësisë së kufizuar bazuar në modelin konceptual të Klasifikimit Ndërkombëtar të Funksionimit dhe Shëndetit nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH).

Ligj për shërbimet e kujdesit social nr. 121/2016 ka hapur rrugën për transformimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në institucionet rezidenciale duke synuar ofrimin e tipologjisë së shërbimit shtëpi-familje brenda institucionit; krijimin e Fondit Social, si dhe metodologjinë e shpërndarjes së fondeve të qeverisjes vendore, të miratuar tashmë në Këshillin e Ministrave (VKM 111/2018 dhe 156/2019). MSHMS-ja ka hartuar Planin Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020–2022, i cili përfshin gjithashtu masa për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Standardet për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në institucionet rezidenciale dhe të kujdesit ditor publik dhe jopublik, janë aprovuar për shërbime të reja, siç është krijimi i qendrave multifunksionale të komunitetit. Në zgjerimin e hartës së shërbimeve të kujdesit shoqëror, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Prill 2019 shpalli Thirrjen e parë për aplikime nga njësitë e qeverisjes vendore, në kuadër të Fondit Social me 14 njësi gvendore që u financuan për zbatimin e projekteve për krijimin e shërbimeve sociale duke filluar nga tetori 2019. Një sfidë shumë e rëndësishme mbetet aftësia e qeverisë vendore për të përfutur nga ky fond.

Qeveria e Shqipërisë ka kryer ndërhyrje për aksesueshmërinë në kohë për personat me aftësi të kufizuara në punësim dhe aftësim profesional. Strategjia e re për punësimin dhe aftësitë, miratuar me vendimin nr. 176, datë 26.2.2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 659, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për



miratimin e strategjisë kombëtare për punësimin dhe aftësitë 2019- 2022 dhe planin e veprimit për t për zbatimin e saj”. Vendime të tjera, posaçërisht për programet e nxitjes së punësimit” targetojnë PAK. Konkretisht, PAK të regjistruar në zyrat e punësimit janë 542 persona në 2019 dhe 539 në 2020 (gjysma e parë). Në programet e nxitjes kanë përparësi aftësitë e mësuara dhe aksesueshmëria.

Sipas parashikimeve të Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social” legjislacioni i strehimit “Social” për kategoritë në nevojë adreson edhe personat me aftësi të kufizuara. Për këtë ka programe të tilla si: skema e aplikimit të bonusit të qirasë, granti i menjëhershëm, projekte për përmirësimin dhe përshtatjen e kushteve të strehimit, si dhe investime në nivele të ulëta -strehim me kosto. Nga një total prej rreth 1280 familje, 245 familje përfituese kanë në përbërje një person me aftësi të kufizuara.

Rreth 536 familje u trajtuan gjithsej me subvencion të qirasë në tregun e lirë, nga të cilat rreth 201 familje përfituese kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara. Një numër i konsiderueshëm janë përfituesit e granteve të menjëhershme, të cilat lehtësojnë blerjen e banesave me kosto të ulët; nga familje, 25 familje kanë një person me aftësi të kufizuara. Lidhur me Ndhimën Juridike Falas, me urdhrin nr. 59 datë 25.3.2019, janë, Drejtoria e Ndhimës Ligjore Falas ka marrë masa që konsistojnë në: - hartimin dhe shpërndarjen e fletëpalosjeve të Drejtorisë së Ndhimës Juridike Falas; Konceptimi i një manuali shpjegues se si këto kategori të veçanta mund të përfitojnë nga ndihma juridike falas. Ligji, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” parashikon sigurimin e shërbimit të ndihmës juridike në qendrat rajonale të shërbimit të ndihmës juridike. Deri më tani këto qendra janë hapur në Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Lezhë dhe Vlorë.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ka mbështetur rrjetet profesionale të mësuesve ndihmës, trajnimit dhe zhvillimit profesional, dhe 555 mësues kanë marrë trajnim për gjithëpërfshirje në 2018–2019. Arsimi gjithëpërfshirës dhe cilësor i fëmijëve me aftësi të kufizuara vazhdon të jetë një përparësi e politikës në sistemin arsimor.

Gjithashtu, në vitin akademik 2019–2020, numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat jospesiale në arsimin publik u rrit me rreth 5%, krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 3858,

ndërsa numri i mësuesve ndihmës në shkollat publike u rrit me 13%, duke arritur në 1069.

Pjesëmarrja në shoqëri, në jetën politike dhe publike ka qenë një nga objektivat e rishikuar në PKV të ri për PAK. Pjesëmarrje në aktivitete kulturore dhe sportive, praktika të mira nga Ministria e Kulturës për promovim përmes projekteve mbështetëse në art- kulturë dhe trashëgimi kulturore si dhe nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në sport. Pjesëmarrja në jetën publike do të rritet më tej në mediat audiovizive dhe procesin zgjedhor në PKV për të përdorur praktikant më të mira sidomos përmes informacionit të arritshëm për të gjitha kategoritë.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me programin e OKB-së të mbështetur nga qeveria zvicerane “Askush të mos mbetet pas” (LNB) ka mbështetur ofrimin e shërbimeve sociale në internet për fëmijët me aftësi të kufizuara përmes një rrjeti në internet të profesionistëve të 8 qendrave të zhvillimit dhe komunitetit për fëmijët me aftësi të kufizuara, që veprojnë në bashkitë Pogradec, Lushnjë, Bulqizë, Dibër, Shijak, Ura Vajgurore, Përmet dhe Sarandë për t’i mundësuar ata me metoda dhe teknika për sigurimin e shërbimeve sociale të specializuara në internet për këta fëmijë gjatë epidemisë së COVID-19. Njoftimet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbi masat e qeverisë për virusin u shoqëruan me interpretim në gjuhën e shenjave.

Identifikimi i zonave të mbështetjes emergjente dhe reduktimi i ndikimit në grupet më të varfra dhe të tjera të prekshme vazhdon në bashkëpunim me të gjithë aktorët.

Në kuadër të **mbrojtjes sociale**, zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2015-2020 (SKMS), e shtyrë deri në vitin 2023 ka sjellë shndërrimin e skemës së ndihmës ekonomike (NE) në një skemë aktive që mundëson riintegrimin shoqëror; rishikimin e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar; ndërhyrjen dhe sigurimin e riintegrit të fëmijëve në familje dhe në komunitet, duke siguruar kujdes të veçantë për jetimet social dhe biologjik, dhe sigurimin e ofrimit të shërbimeve të integruara të mirëqenies sociale dhe komunitare. SKMS-ja shtjellon, gjithashtu, nevojën për të krijuar lidhje dhe integrim më të mirë midis politikave aktive të punësimit dhe përfshirjes sociale dhe politikave të mbrojtjes sociale. Veprimi do të kontribuojë në të tre



objektivat dhe do të ketë një fokus të veçantë në objektivin e tretë, që lidhet me decentralizimin lokal dhe zhvillimin e shërbimeve të integruara të kujdesit shoqëror dhe komunitar.

Sa i përket **Antidiskriminimit dhe Shanseve të Barabarta**, Raporti i Vlerësimit të Zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e saj të Veprimit 2016–2020, përfunduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në tetor 2020, tregoi se kjo strategji në tërësinë e saj është realizuar në masën 80% duke evidentuar arritje në drejtim të fuqizimit të gruas, avancimit drejt barazisë gjinore dhe zvogëlimit të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje. Pavarësisht sfidave dhe pengesave të ndeshura për shkak të situatës së shkaktuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe të pandemisë COVID-19, angazhimi i institucioneve përgjegjëse qendrore e vendore, koordinimi i veprimeve me aktorë të tjerë të rëndësishëm si organizatat e shoqërisë civile dhe mbështetja e ofruar nga partnerët tanë ndërkombëtarë, kanë rezultuar në përmbytjen e objektivave specifike të SKBGJ-së 2016–2020.

Fuqizimi ekonomik i grave dhe burrave ka qenë një nga qëllimet strategjike të SKBGJ 2016–2020 dhe në fokus të institucioneve përgjegjëse. Nëpërmjet zbatimit të masave konkrete është bërë e mundur të ketë rritje të pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në tregun e punës; zbatim me efektivitet të objektivave të Planit Kombëtar të Veprimit për Gratë Sipërmarrëse 2014–2020, si dhe përmirësim të ndjeshëm të shërbimeve dhe cilësisë së ofrimit të tyre nga ana e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, si dhe ka pasur përmirësime të ndjeshme në legjislacion në lidhje me punësimin dhe mjedisin e sigurt të punës për gratë, duke përcaktuar dhe kthyer barrën e provës në rastet e ngacmimit seksual.

Ka një rritje të konsiderueshme të pjesëmarrjes së grave në vendimmarrjen politike dhe publike si dhe strukturat që merren me çështjet e paqes dhe sigurisë. Përmirësimet ligjore në Kodin Zgjedhor gjatë vitit 2020 sollën një garanci më të madhe për respektimin e kuotës gjinore, aplikimi i së cilës në zgjedhjet e ardhshme do të sigurojë një përfaqësim më të madh të grave në Parlament. Në fund të janarit 2020 u lançua **Indeksi i Barazisë Gjinore për Shqipërinë**, i cili mat progresin e barazisë gjinore në 28 vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe dy vendet e Ballkanit Perëndimor. Ky indeks e Faqe | 4120

rendit Shqipërinë në vendin e 17 me **60.4 pikë** në 6 fusha të rëndësishme, ku në fushën e **vendimmarrjes dhe përfaqësimit politik të grave** renditemi me **60.9 pikë**, pra me **9 pikë mbi mesataren e vendeve të Bashkimit Evropian**.

Të dhënat e raportit të Indeksit Global të Hendekut Gjinor të Forumit Ekonomik Botëror të vitit 2020, tregojnë që **për vitin 2019 Shqipëria renditet në vendin e 20-të nga 153 vende, krahasuar me vendin e 34-t që ishte në vitin 2018**.

Referuar INSTAT-it, Botimit “Burrat dhe gratë në Shqipëri, 2020”²⁹, Hendeku gjinor në paga është 10.1%. Pra burrat kanë një pagë mesatare mujore bruto 10.1% më të lartë sesa gratë. Krahasuar me vitin 2018, në vitin 2019 vihet re një ulje e hendekut gjinor në paga me 0.6 pikë përqindje.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka vazhduar koordinimin dhe bashkëpunimin e saj me OJQ të specializuara për të zbatuar veprimet e parashikuara në Planin Kombëtar të Veprimit për LGBTI 2016–2020. Në këtë kuadër, vëmendje e veçantë i është kushtuar rritjes së kapaciteteve të profesionistëve, veçanërisht punonjësve të kujdesit shëndetësor për ofrimin e shërbimeve efektive dhe miqësore për personat LGBTI. Ndërgjegjësimi për çështjet LGBTI si pjesë e Planit të Veprimit, ka vazhduar të bëhet në bashkëpunim të ngushtë midis institucioneve dhe OJF-ve të fushës. Aktivitete në kuadër të Javës kundër Homofobisë u zhvilluan gjatë majit 2020 me gjithë vështirësitë për shkak të kufizimeve të COVID-19.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetje nga Këshilli i Evropës ka filluar procesin e vlerësimit të Planit të Veprimit për Personat LGBTI në Shqipëri, për vitet 2016–2020.

19.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Në fushën e **ligjit të punës**, për sa i përket zbatimit, janë ndërmarrë hapa pozitivë për promovimin e ndryshimeve të Kodit të Punës. Janë zhvilluar aktivitete trepalëshe (punëdhënës, punëmarrës dhe punonjësit e administratës së punës) me qëllim njohjen me risitë dhe ndryshimet e dispozitave të tij. Gjithashtu, është hartuar Komentari i Kodit të Punës i cili do t'i shërbejë Administratës së Punës, që ka në fushën e saj të përgjegjësisë zbatimin e legjislacionit të punës.

²⁹ <http://www.instat.gov.al/media/7376/burra-dhe-gra-2020.pdf>



Promovimi i komentarit të Kodit të Punës është bërë në disa qytete si Tiranë, Korçë, Vlorë dhe Shkodër.

Sa i përket **shëndetit dhe sigurisë në punë**, me synim përafrimin e legjislacionit shqiptar mbi sigurinë dhe shëndetin në punë me atë të *acquis* të BE-së, nga masat ligjore të parashikuara në PKIE 2019–2021 janë miratuar dy dhe e treta është në proces sipas afateve të paracaktuara.

Lidhur me **dialogun social**, me synim përmirësimin e sistemit të parandalimit dhe zgjidhjes miqësore të konflikteve në punë, është krijuar Rrjeti Shtetëror i Ndërmjetësimit si dhe janë ngritur Zyrat Shtetërore të Pajtimit (Zyra Kombëtare e Pajtimit dhe Zyra e Pajtimit në 12 qarqe) me qëllim funksionimin e tyre për zgjidhjen e konflikteve kolektive ndërmjet palëve, sipas parashikimeve ligjore për trajtimin në kohë të tyre.

Dakordësimi i kriterëve të përfaqësueshmërisë nga partnerët social dhe harmonizimi i nivelit të përfaqësueshmërisë në Këshillin Kombëtar të Punës me qëllim maksimizimin e impaktit të veprimtarisë së saj, u realizua me miratimin e VKM nr. 54, datë 29.1.2020 nga Këshilli i Ministrave.

Për nënfishën e **politikave të punësimit**, miratimi i ligjit Nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit” në Mars 2019, plotësoi kornizën ligjore që lidhet me politikat/programet e punësimit dhe zhvillimin e aftësive. Kjo ka krijuar hapësirë të bollshme për zhvillimet si më poshtë:

- diversifikimin e programeve të nxitjes së punësimit dhe shërbimeve të punësimit të miratuara gjatë vitit 2020, 4 VKM me 7 programe duke përfshirë dhe programe për nxitjen e punësimit të personave të dale të papunë si pasojë e COVID-19;

- ofruesit e punësimit dhe arsimit profesional dhe formimit janë tashmë nën menaxhimin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA);

Lidhur me **përfshirjen sociale dhe personat me aftësi të kufizuara**, MSHMS-ja ka monitoruar treguesit socialë për grupet e cënueshme me qasje në punësim, arsim profesional; mbrojtja sociale; arsimi; shërbime shëndetësore; banesa sociale; ndihma juridike.

Të dhënat për varfërinë dhe përfshirjen sociale kanë qenë gjithashtu evidente në anketat cilësore të Anketa për matjen e të ardhurave të përjashtimit social në Shqipëri për të vlerësuar intensitetin,

shkaqet dhe llojet e saj dhe për të krijuar politikëbërje me bazë të dhënash.

MSHMS po punon për zbatimin e rekomandimeve për përfshirje dhe aksesueshmëri dhe për përgatitjen e Planit Kombëtar për PAK 2021–2025, për personat me aftësi të kufizuara.

Në zbatim të ligjit MSHMS nr. 93/2014 dhe VKM-në nr. 1074, datë 23.12.2015, “Për masat për heqjen e pengesave mjedisore dhe të infrastrukturës në ofrimin e shërbimeve publike” për aksesueshmërinë fizike dhe në informacion ka ndjekur një qasje ndërinstitucionale për të planifikuar për aksesueshmërinë. U hartuan plane lokale për aksesueshmërinë, për të zbatuar objektivat në nivel lokal. Planet lokale në Pogradec dhe Lezhë janë modelet e para të planeve të aksesit në zbatimin e legjislacionit kombëtar. Këto plane veprimi u hartuan nën “Aksionin për aksesueshmërinë” dhe morën në konsideratë rekomandimet e konferencës së nivelit kombëtar mbi “Aksesueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen”, organizuar në maj 2019.

Përveç Strategjisë për Mbrojtjen Sociale dhe ligjin nr. 57/2019, datë 18.7.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, janë miratuar:

- Udhëzimi, nr. 659, datë 23.9.2019, “Për rregullat dhe procedurat për mbulimin e kostove të sigurimit të shërbimeve arsimore, shëndetësore ose rehabilituese, në përputhje me nevojat specifike, në një njësi të qeverisjes vendore, përveç asaj ku jeton fëmija me aftësi të kufizuara”.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 380, datë 5.6.2019, “Për miratimin e dokumentit politik” Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar në sistemin e mbrojtjes sociale dhe plani i veprimit 2019–2020 për zbatimin e tij “.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 411, datë 19.6.2019, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 708, datë 26.8.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivelin qendror dhe lokal”.

- Vendimi nr. 874, datë 24.12.2019, “Për mënyrën e ofrimit të ndihmës personale dhe kriteret për zgjedhjen e ndihmës personal”.

- Vendimi nr. 866, datë 24.12.2019, “Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale, 2020–2023, dhe planit të veprimit në zbatimin e saj”.



- Vendimi nr. 182, datë 26.2.2020, “Për përcaktimin e masës, kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe ndihmës personal”.

Lidhur me **përfshirjen sociale dhe personat me aftësi të kufizuara**, ligji nr. 15/2019, “Për Promovimin e Punësimit”, në dispozitat e tij ka parashikuar krijimin e një Fondi të Punësimit Social, i cili do të përdoret për programet që synojnë punësimin, vetëpunësimin, rehabilitimin e punës, trajnimin profesional, orientimin dhe këshillimin për punësim, shërbimet mbështetëse, rindërtimin dhe vendosjen e vendeve të punës për personat me aftësi të kufizuara. Interesi në rritje i personave me aftësi të kufizuara për t’u regjistruar në zyrat e punës si punëkërkuar të papunë u reflektua në një program të veçantë që punëson drejtpërdrejt këtë kategori.

Sa i përket strehimit për personat me aftësi të kufizuara, në vitin 2018 gjithsej 230 persona me aftësi të kufizuara përfituan. Për periudhën raportuese të vitit 2019, 248 persona me aftësi të kufizuara përfituan strehim social, qira banuese, strehim me kosto të ulët dhe fonde për përmirësimin e banesave, si dhe 16 PAK morën një fond të menjëhershëm. Duhet theksuar se të gjitha ndërtesat e reja të Entit Kombëtar të Banësive parashikohet të ndërtohen me të gjithë parametrat për të lehtësuar lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara.

Në lidhje me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën kulturore, në Strategjinë Kombëtare të Kulturës 2019–2025, ekzistojnë dispozita për personat me aftësi të kufizuara, të cilat garantojnë qasje në institucione ose shërbime kulturore.

Personat me aftësi të kufizuara janë pjesë e procesit të vendimmarrjes duke marrë pjesë në të gjitha proceset këshilluese në hartimin e politikave dhe legjislacionit, tryezat ndërministrorë dhe seancat dëgjimore në Parlament. Parlamenti gjithashtu ka dhënë interpretimin e gjuhës së shenjave për disa seanca për të mundësuar pjesëmarrjen në vendimmarrje.

Komisionerët e zgjedhjeve të nivelit të dytë dhe të tretë në zgjedhjet e fundit, me kurrikula të veçanta, u trajnuan për specifikat e votimit për PAK. Mbledhja e të dhënave është një përparësi për Qeverinë shqiptare, ku të gjithë palët e

interesuara, ministrinë, bashkitë dhe shoqëria civile duhet të angazhohen. INSTAT-i përdor modulet e aftësisë së kufizuar për të gjeneruar statistika mbi “aftësinë e kufizuar”. Modulet e pyetjeve të aftësisë së kufizuar janë përfshirë si pjesë e Regjistrimit të Popullsisë.

Sa i përket **mbrojtjes sociale**, Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale u rishikua dhe u zgjat deri në vitin 2023, duke ruajtur të njëjtat politika dhe synime. Me miratimin e ligjit nr. 57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, u shmangën procedurat burokratike gjatë procesit të vendimmarrjes duke hequr rolin e Këshillit Bashkiak, i cili nuk ka më autoritet për të miratuar listat e përfituesve të skemës së Ndihmës Ekonomike, pasi ato janë deklaruar të pranueshme në bazë të formulës dhe vendimi është marrë nga Shërbimi Social Shtetëror.

U miratuan procedura të reja kontrolli, duke krijuar një sistem monitorimi transparent dhe efikas përmes sigurimit të moduleve të reja në SMI që përbëhen nga profili i riskut, menaxhimi i rastit, menaxhimi më i mirë i pagesave direkt të familjeve dhe monitorimi i tyre përmes lidhjes me Thesarin, Bankat dhe Zyrat e Postës.

“Strategjia e daljes” dhe plani i saj i veprimit po zbatohet me qëllim promovimin e integritetit në jetën shoqërore të familjeve përmes programeve të nxitjes së punësimit, në mënyrë që kjo skemë të mos përdoret si një mekanizëm përfitimi që mund të çojë në papunësi të zgjatur të familjet përfituese të ndihmës ekonomike dhe ta shndërrojë atë në një skemë aktive.

Metodologjia e kontrollit të skemës së reformuar të vlerësimit të aftësisë së kufizuar është miratuar. Stafit i strukturave të kontrollit në drejtoritë qendrore dhe rajonale të Shërbimit Social Shtetëror janë trajnuar për përdorimin e metodologjisë së re të kontrollit, me qëllim shmangien e abuzimit në skemën e aftësisë së kufizuar. Pagesat dhe përfitimet e aftësisë së kufizuar, pagesa për asistentët personal dhe përfitimet në natyrë janë ristrukturuar dhe janë kombinuar me shërbimet sociale, të shëndetësisë, arsimit, formimit profesional, punësimit etj.

Janë fuqizuar dhe rritur përmes trajnimeve të vazhdueshme kapacitetet e stafit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të Shërbimit Social Shtetëror në nivel qendror dhe rajonal, dhe të strukturave shëndetësore që referojnë rastet dhe



stafin e institucioneve që ofrojnë shërbime në qarkun e Tiranës. Gjithashtu, është hartuar korniza e re ligjore për zbatimin e një vlerësimi të aftësisë së kufizuar biopsikosociale në mbarë vendin duke reflektuar kombinimin e përfitimeve të pagesave në para me shërbime të integruara. Skema e re e vlerësimit të aftësisë së kufizuar po aplikohet në qarkun Tiranë, duke mbuluar një të tretën e popullsisë së Shqipërisë.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka filluar të bëjë funksionale Fondin Social duke i akorduar 14 bashkive mbështetje financiare nga Fondi Social për vitin 2020, për krijimin e 14 shërbimeve të reja, me një fond 61,412,587 ALL, synohet që deri në fund të vitit 2022 të financohen 35 bashki.

Prioritet do kenë ato bashki, në të cilat nuk ofrohet asnjë shërbim shoqëror. Ndërsa për bashkitë në të cilat rezulton se mundësia e përdorimit të shërbimeve është tepër e kufizuar, për shkak të kapacitetit të pamjaftueshëm, duhet të shihet mundësia e harmonizimit dhe e plotësimit të nevojës në bashkitë më të afërta.

Aktualisht, rreth 40 bashki janë mbështetur nga UNICEF, UNDP dhe World Vision për të zhvilluar dhe hartuar planet sociale të kujdesit shoqëror të cilat janë bazat për ndërtimin dhe financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Stafi i shërbimeve sociale në 19 bashki janë trajnuar për përdorimin e MIS (Regjistri Elektronik) për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe trajnim, i cili vazhdon në vitin 2020 me mbështetjen e UNICEF

Në kuadër të procesit të deinstitutionalizimit, ka filluar ka filluar zbatimi Planit Kombëtar i Deinstitutionalizimit 2020–2020, miratuar me VKM-në nr. 706/2020.

Plani i veprimit ka ndërthur politika dhe programe specifike, për të reduktuar institutionalizimin e fëmijëve, duke transformuar shërbimet e ofruara në institucionet rezidenciale, në shërbime multidisiplinare me bazë komunitare, të cilat ofrojnë përkujdesje alternative dhe të specializuara, duke ofruar mundësi për jetesë më të mirë dhe të pavarur.

Zhvillimet ligjore për periudhën aktuale në fushën e sigurimeve shoqërore janë paraqitur si më poshtë vijon:

- **Vendim nr. 263, datë 30.3.2020, “Për indeksimin e pensioneve”** Ky projektvendim ka

për qëllim të mbajë në nivele optimale vlerën reale të pensioneve dhe përfitimeve të tjera sociale duke rikuperuar efektet e rritjes së indeksit të çmimit të konsumit.

- **Ligj nr. 65/2020, “Për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, ‘Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar.**

- **Vendimi nr. 448, datë 3.6.2020, “Për miratimin e listës së profesioneve dhe të punëve të personelit inxhiniero-teknik, që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës”,** në të cilën është përcaktuar lista e profesioneve dhe e punëve të personelit inxhiniero- teknik, që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës, të përcaktuara në shkronjën “ç”, të nenit 2, të ligjit nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”.

- **Vendimi nr. 720, datë 16.9.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar.**

Në nënfushën e **Antidiskriminimit dhe shanseve të barabarta**, kapacitetet e strukturave të barazisë gjinore janë fuqizuar. Është rritur roli i Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore nëpërmjet miratimit të shumë dokumenteve të rëndësishme dhe çështjeve të trajtuara gjatë mbledhjeve të organizuara lidhur me situatën e barazisë gjinore në vend.

Nëpunësit gjinorë janë caktuar në çdo ministri dhe bashki. Aktualisht në 11 ministri janë emëruar nëpunësit gjinorë, si dhe në Policinë e Shtetit e INSTAT-i kemi pikë kontakti. Në nivel vendor, në 59 bashki janë të emëruar nëpunësit gjinorë (nga 61 bashki në total), të cilët në shumicën e rasteve luajnë dhe rolin e koordinatorit vendor. Për koordinatorët vendorë kundër dhunës në familje, në Janar 2020 u hartuan përshtatjet e reja të tyre të punës të cilat u përshtatën edhe me ndryshimet e fundit të Ligjit 9669, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Janë ngritur kapacitetet e tyre për çështjet e buxhetimit gjinor; ndryshimeve që pësoi në korrik të vitit 2018 Ligji 9669/2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, njohjes së



Rezolutës të KS të Kombeve të Bashkuara 1325 “Gruaja, Paqja, Siguria”; trajnime për sistemin REVALB, trajnime lidhur me Procedurat Standarde të Veprimit dhe Protokollet e miratuara gjatë 2020 për trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare

Nëpërmjet zbatimit të VKM-së për “Integrimin Gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm”, iu është dhënë mundësia për planifikim dhe menaxhim të buxhetit mbi baza gjinore disa sektorëve dhe programeve buxhetore që janë kritike në ofrimin e mbështetjes ekonomike dhe fuqizimit të grave. Me asistencën e UN Women, aktualisht është bërë e mundur që numri i programeve buxhetore që përfshijnë plotësisht ose pjesërisht elementet e buxhetimit të përgjithshëm gjinor në programet buxhetore afatmesme të tyre të rritet gradualisht, duke shkuar në 39 të tilla të identifikuar në PBA 2020–2021.

Ngritja e kapaciteteve ka qenë gjithashtu në fokus të punës për dy vitet e fundit ku janë trajnuar nëpunësit gjinorë, përfaqësuesit e ekipit të menaxhimit të programeve, drejtuesit e sektorit të financës dhe buxhetit në ministri si dhe pushtetin vendor lidhur me procesin e përgatitjes së programit buxhetor 2019–2021 dhe përfshirjen në të të buxhetit të përgjithshëm gjinor. Në nivel qendror janë trajnuar rreth 70 persona dhe në pushtetin vendor rreth 90.

Ka disa arritje pozitive në fushën e legjislacionit, rritjes së kapaciteteve të profesionisteve për çështjet LGBTI dhe fushatave të përvitshme të ndërgjegjësimit, si dhe ka pasur përmirësime ligjore në disa ligje duke përfshirë edhe çështjet LGBTI.

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka miratuar korrik 2020 ‘Protokollin për Trajtimin e Fëmijëve me Zhvillim Atipik të Gjenitaleve’. Ishte hera e parë që ky lloj Protokoll miratohet dhe pritet të sigurojë mbrojtje për fëmijët ndërseksualë në Shqipëri, të cilët iu nënshtruan ndërhyrjeve mjekësore të panevojshme dhe të pakthyeshme, u përballën me mjekim të panevojshëm, mungesë të aksesit në informacion dhe paaftësi për marrjen e vendimeve pjesëmarrjen në vendimet që ndikojnë në trupin e tyre.

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, ka zhvilluar disa cikle trajnimesh për të mbështetur ndërtimin e kapaciteteve të punonjësve gjinorë në bashki, duke u përqendruar në konceptet drejt

orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Gjatë tri cikleve të trajnimit, u trajnuan rreth 45 persona;

- Ndërgjegjësimi i publikut përmes fushatave vjetore nën Ditën e Homofobisë synonte të bënte të papranueshëm diskriminimin dhe gjuhën e urrejtjes. Institucionet shtetërore, në bashkëpunim me OJQ-të, Institucionin e Avokatit të Popullit dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të mbështetur nga donatorët dhe ambasadat po kryejnë çdo vit aktivitete që kanë marrë vëmendjen e publikut, si dhe mbulimin në media. Në lidhje me fushatën e vitit 2020 duhet të themi se për shkak të situatës së katastrofës natyrore për shkak të pandemisë COVID-19, fushata u organizua *online*. Këtë vit marshimi i Krenarisë së Tiranës u zhvillua nën moton “Bëhu krenar! Ngrini flamurin! “Dhe lidhet me Festivalin e 11-të të Diversitetit LGBTI në Shqipëri, një ngjarje kombëtare e Ambasadës PINK Shqipëri. Flamuri LGBTI u vendos gjithashtu në mjediset e Ministrisë si një shenjë e bashkërendimit dhe përpjekjeve të bashkuara dhe më të mira për të mbrojtur të drejtat e personave LGBTI.

- “Strehëza” është qendra e parë rezidenciale në Shqipëri në kuadër të ofrimit të shërbimeve për komunitetin LGBTI. Qëllimi i saj është të ndihmojë këtë komunitet, duke ofruar integrim dhe strehim të sigurt. “Strehëza” ka filluar aktivitetet e saj që nga dhjetori i vitit 2014. Qendra “Strehëza” është një shërbim për të gjithë të rinjtë LGBTI, të cilët përballen me dhunë, diskriminim dhe nevojë për strehim, për shkak të orientimit të tyre seksual dhe identitetit gjinor. Kjo qendër ofron një gamë të plotë shërbimesh dhe funksionon sipas “Standardeve të Shërbimeve të Kujdesit Social” që janë të licencuar që nga viti 2016. “Strehëza” për herë të parë ka filluar të financohet nga Mekanizmi i Fondit Social të sapo hapur në maj 2019, përmes fondeve të buxhetit të shtetit.

19.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucioni përgjegjës për kapitullin 19 është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS).

Institucione të tjera kontribuuese për Kapitullin 19 janë: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH), Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), Agjencia



Kombëtare për Edukimin, trajnimin Profesional dhe Kualifikimet Ministria e Brendshme (AKETK), Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHMDF), Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH), Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), Ministria e Brendshme (MB); Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), Instituti i Statistikave (INSTAT), Zyra e Avokatit të Popullit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

Në ndihmë të koordinimit të punës së institucioneve përgjegjëse për kapitullin 19 në aspektin financiar dhe për të dhënat statistikore, ka angazhim të veçantë nga ministria përgjegjëse për fushën e financave (MFE) dhe Instituti i Statistikave (INSTAT).

Në ndihmë të koordinimit të punës midis institucioneve ndërkombëtare dhe institucioneve përgjegjëse për kapitullin 19 është ngritur Sekretariati i Integrimit Evropian nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEFA).

19.7 Prioritetet

Objektivat kryesorë të Shqipërisë për sa u përket politikave të punësimit dhe sociale përfshijnë:

- Zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit të reja dhe të rishikuara duke përfshirë programet e COVID-19;

- Miratimin e një programi të ri për garancinë rinore që të adresojë kryesisht NEET.

- Intensifikimin e përpjekjeve për zbatimin e strategjisë së mbrojtjes sociale, me fokus të veçantë grupet vulnerabël, forcimin e aftësive dhe burimeve të pushtetit vendor për të vlerësuar nevojat e kujdesit shoqëror në territorin e tyre;

- Intensifikimin e përpjekjeve për zbatimin e strategjisë së mbrojtjes sociale 2015–2020, me fokus të veçantë grupet vulnerabël, forcimin e aftësive dhe burimeve të pushtetit vendor për të vlerësuar nevojat e kujdesit shoqëror në territorin e tyre;

Qeveria e Shqipërisë është e vendosur të zhvillojë një politikë sociale dhe punësimi, që është në linjë me kërkesat e BE-së dhe praktikave më të mira, duke investuar në kapital njerëzor dhe kohezion social, si një ndër shtyllat kryesore të vizionit strategjik primar e të bërit një anëtar i Bashkimit Evropian.

Prioritetet në fushën e **mbrojtjes sociale** janë:

- Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale për 2020–2023 dhe Planit të saj të Veprimit;

- Zbatimi i “strategjisë së daljes” që mundëson riintegrimin shoqëror të përfituesve të NE.

- shtrirja graduale e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar;

- Zbatimi i Planit Kombëtar të deinstitutionalizmit 2020–2022 që synon zëvendësimin e qendrave rezidenciale me shërbimet të kujdesit social alternative komunitare;

- Vendosja e lidhjeve dhe integrimi më i mirë ndërmjet politikave aktive të punësimit dhe përfshirjes sociale dhe politikave të mbrojtjes sociale.

Sa i përket fushës së **barazisë gjinore**, në fokus është:

- Miratimi dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030.

- Fuqizimi i mëtejshëm së makinerisë së posaçme gjinore kombëtare dhe sigurimi i financimit të duhur.

Në lidhje me komunitetin e **LGBTI**, prioritetet janë:

- Miratimi dhe zbatimi i Planit LGBTI 2021–2027

- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut, profesionistëve të fushës,

Për çështjet e **Sigurimeve Shoqërore** prioritetet kryesore mbeten:

- Garantimi i mbulimit sa më të plotë të popullsisë së vendit me elemente të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, të mbajtura në nivele të pranueshme;

- Forcimi i qëndrueshmërisë financiare të skemës dhe zhvillimi i kapaciteteve të ISSH-së, implementimi gradual i projekteve të nisura për ngritjen e një sistemi kompleks e të automatizuar informacioni për plotësimin e funksioneve të sigurimeve shoqërore edhe për të tretët;

- Mbështetje e shqiptarëve që jetojnë dhe punojnë jashtë shtetit, përmes koordinimit të skemave të mbrojtjes sociale me vendet e BE-së edhe më tej duke i dhënë prioritet vendeve ku ka më shumë prezencë shqiptarësh.

Sa i përket **përfshirjes sociale dhe personave me aftësi të kufizuara**, prioritetet janë:

- Harmonizimi i të dhënave dhe treguesve për përfshirjen sociale



- Hartimi dhe zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit 2021–2025 për Personat me Aftësi të Kufizuara.

- Përmirësimin i bazës ligjore sipas parimeve të ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.

Në kuadër të planit të veprimit të rishikuar të **Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2019–2022** janë parashikuar, si prioritare:

- Nxitja e mundësive për punë të denjë, nëpërmjet politikave të frytshme të tregut të punës;

- Ofrimi i arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit;

- Nxitja e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial;

- Fuqizimi i qeverisjes së tregut të punës dhe i sistemeve të kualifikimeve.

Në lidhje me kërkesat e **shëndetit dhe sigurisë në punë**, objektivi kryesor mbetet zbatimi i politikave dhe ligjeve më të mira dhe më të dobishme për SSHP, të cilat mund të zbatohen në një mënyrë të dobishme duke zhvilluar një sistem më të dobishëm inspektimi dhe menaxhimi të SSHP.

Në fushën e legjislacionit të punës prioritetet do të jetë përmirësimi i zbatimit të tij në sektorin publik dhe atë privat.

Ne lidhje me zhvillimin e **dialogut social** ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve objekti kryesor mbetet promovimi i avantazheve të zgjidhjes paragjyqësore të konflikteve në punë; aftësimi i punëmarrësve dhe punëdhënësve për negociim dhe parandalim të mosmarrëveshjeve në punë; përmirësim i efektivitetit të shërbimit të ndërmjetësimit dhe pajtimit të mosmarrëveshjeve kolektive në punë.

Gjithashtu, rendisim prioritetet, si më poshtë:

- Ngritja e një sistemi monitorimi në mënyrë që Këshilli Kombëtar i Punës të vlerësojë shkallën në të cilën rekomandimet e saj janë marrë në konsideratë/zbatuar nga Këshilli i Ministrave.

- Përmirësimi i procedurave të ndërmjetësimit/pajtimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kolektive të punës, në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe të shpejtë.

- Rikonstituimi i Këshillit Kombëtar të Punës si institucioni më i lartë i dialogut social në nivel qendror ku përfaqësimi i organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve në këtë Këshill

do të përcaktohen sipas kriterëve të përcaktuara në VKM-së nr. 54, datë 29.1.2020.

- Ngritja e kapaciteteve të ndërmjetësve të Zyrave të Punësimit nëpërmjet trajnimeve për bazën e të dhënave në sistemin e menaxhimit të çështjeve, për marrëveshjet kolektive dhe Sindikatat.

KAPITULLI 20 NDËRMARRJET DHE POLITIKAT INDUSTRIALE

20.1 Përmbajtja e kapitullit

Politika industriale e BE-së kërkon të promovojë strategjitë industriale që rrisin konkurrencën duke përsheptuar përshtatjen ndaj ndryshimeve strukturore, duke inkurajuar një mjedis të favorshëm për krijimin dhe rritjen e biznesit në të gjithë BE-në, si dhe investimet e brendshme dhe të huaja. Ajo gjithashtu synon të përmirësojë mjedisin e përgjithshëm të biznesit në të cilin veprojnë Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM).

Ajo përfshin privatizimin dhe ristrukturimin (*shiko, gjithashtu, kapitullin 8 - Politika e konkurrencës*). Politika industriale e BE-së kryesisht përbëhet nga parimet e politikave dhe komunikimet e politikave industriale. Forumet e konsultimit të BE-së dhe programet e Komunitetit, si dhe komunikimet, rekomandimet dhe shkëmbimet e praktikave më të mira në lidhje me NVM-të synojnë të përmirësojnë formulimin dhe koordinimin e politikës së ndërmarrjeve në të gjithë tregun e brendshëm në bazë të një përkufizimi të përbashkët të NVM-ve. Zbatimi i politikës së ndërmarrjeve dhe asaj industriale kërkon kapacitete të përshtatshme administrative në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor.

20.2 Struktura e kapitullit

- Politika industriale—operacionet sektoriale;
- Privatizimi dhe ristrukturimi;
- Mjedis i biznesit;
- Politika e NVM-ve.

20.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Bashkëpunimi mes BE-së dhe Shqipërisë në lidhje me politikën e ndërmarrjeve dhe atyre industriale rregullohet në disa nene të Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit. Së pari, **neni 86** përcakton se bashkëpunimi do të synojë të kontribuojë në



potencialin për zhvillim dhe rritje të Shqipërisë. Masat do të hartohen për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social në Shqipëri. Këto masa do të marrin parasysh bashkëpunimin rajonal.

Neni 91 përcakton se palët (si BE-ja dhe Shqipëria) do të synojnë të sjellin një klimë të favorshme për investimet private të cilat janë vendimtare për zhvillimin e Shqipërisë.

Neni 92 përqendrohet në bashkëpunimin industrial që mbulon modernizimin dhe ristrukturimin e industrisë shqiptare, forcimin e sektorit privat, bashkëpunimin ndërmjet operatorëve ekonomikë etj. Bashkëpunimi industrial do të marrë parasysh edhe aspektet rajonale të politikave industriale. *Acquis* e BE-së do të përafrohet gjithashtu.

Neni 93 i dedikohet ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe synon të fokusojë bashkëpunimin BE-Shqipëri në zhvillimin dhe forcimin e NVM-ve duke marrë parasysh Aktin e Biznesit të Vogël etj.

Neni 94 trajton turizmin si një sektor të veçantë të industrisë. Neni 94 parashikon forcimin e rrjedhës së informacionit mbi turizmin dhe transferimin e njohurive. Duhet të përafrohet edhe *acquis* në lidhje me turizmin.

Së fundi, **neni 70** i Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit përcakton detyrimin e përgjithshëm të Shqipërisë për të përafëruar legjislacionin e saj me *acquis* e BE-së.

Në lidhje me kërkesat e BE-së, politikat në këtë Kapitull hyjnë nën grupin e III³⁰ të kompetencave të BE-së, d.m.th. nën fushat ku BE mund të mbështesë, koordinojë ose plotësojë aktivitetet e vendeve anëtare dhe ku BE nuk ka të drejtë të kalojë ligjërisht detyrues Aktet. Shtetet anëtare kanë ende kompetenca ekskluzive në këto politika, ndërsa BE mund të mbështesë përmirësimin e tyre. Dokumenti më i rëndësishëm për politikën industriale të BE-së është “Evropa 2020: Strategjia për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe

gjithëpërfshirëse”³¹, e cila paraqet dokumentin kuadër të zhvillimit industrial të BE-së.

Acquis në kapitullin 20 përfshin parimet dhe instrumentet e politikës që janë të pasqyruar kryesisht në komunikatat, rekomandimet dhe konkluzionet e Këshillit dhe që zbatohen më së shumti në nivel kombëtar. Në nivelin e Bashkimit Evropian, këto zbatohen përmes programeve të Bashkimit Evropian. Përveç parimeve dhe instrumenteve horizontale, politika e ndërmarrjeve dhe ajo industriale mund të përfshijnë edhe politika sektoriale. Në tërësi, politika e ndërmarrjeve dhe ajo industriale drejtohen fuqimisht nga Strategjia Evropa 2020.

Me vendosjen e parimeve të përgjithshme të politikës, BE kërkon të promovojë formulimin e politikave të ndërmarrjeve dhe strategjive industriale që rritin konkurrencën. Këto janë përshtatur, në përputhje me nenin 173 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, për të shpejtuar rregullimet strukturore, duke inkurajuar një mjedis të favorshëm për krijimin e biznesit, investimet e huaja vendëse dhe të brendshme, promovimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), dhe sipërmarrjen dhe inovacionin. Më konkretisht, politika e NVM-ve e BE-së karakterizohet nga rekomandime të politikave dhe mekanizma të përbashkët për rishikimin e politikave, të përbërë nga Akti i Biznesit të Vogël, si dhe një përkufizim i përbashkët i NVM-ve.

Instrumentet e politikës së ndërmarrjeve dhe asaj industriale janë zhvilluar në programin e BE-së për Konkurrueshmërinë e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME). Programi ofron mbështetje financiare për ndërmarrjet dhe politikëbërësit dhe është i përqendruar në veprimet që promovojnë qasjen në financa, hyrjen në tregje, sipërmarrjen, shërbimet e mbështetjes së biznesit siç është Rrjeti i Ndërmarrjeve Evropiane, zhvillimi i politikave më të mira në mbështetje të NVM-ve. Një instrument i rëndësishëm politik është Direktiva 2011/7/BE për luftimin e pagesave të vonuara në transaksionet tregtare. Programet e politikave hapësinore të BE-së janë gjithashtu pjesë e këtij kapitulli, pasi ato kontribuojnë në përmirësimin e konkurrueshmërisë së BE.

³⁰ Grupi i parë i politikave përfshin kompetencat ekskluzive të BE-së (ku aktet detyruese ligjore miratohen në nivelin e BE-së), ndërsa kompetencat e përbashkëta (si BE-ja, ashtu edhe shtetet anëtare mund të miratojnë akte ligjorisht të detyrueshme; vendet anëtare mund ta ushtrojnë këtë të drejtë vetëm kur BE nuk mund të veprojë ose ka zgjedhur të mos veprojë) bie nën grupin e dytë. Më shumë informacion mbi: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=URISERV:ai0020&from=EN>

³¹ Evropa 2020: Një strategji për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, /* COM/2010/2020.



Kur bëhet fjalë për politikën e inovacionit të BE-së në lidhje me Kapitullin 20, dokumenti më i rëndësishëm ka të bëjë me strategjinë e Evropës 2020 dhe me një nga nismat e saj kryesore “Bashkimi i Inovacionit” (*Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions “Europe 2020 Flagship Initiative - Innovation Union” COM(2010) 546 final, 6.10.2010 + SEC(2010) 1161*).

Për sa u përket kërkimit dhe inovacionit, referenca kryesore është kapitulli XIX i Traktatit (TFEU) me parashikimet mbi kërkimin, legjislacioni Horizon 2020 duke përfshirë dispozitat specifike për asociimin, kërkesat e Zonës Evropiane të Kërkimit, reformat kombëtare dhe Semestrin Evropian, politikën *Open Science* dhe *Open Access*, Programi i ardhshëm *Horizon Europe*, Integriteti i Kërkimit etj.

Gjithashtu ka edhe disa akte të tjera në këtë fushë, që lidhin kapitullin 20 me kapitujt e tjerë të negociatave të anëtarësimit si me kapitullin 1, “Lëvizja e lirë e mallrave” ose kapitullin 25 “Shkencë dhe kërkim”) apo çështje të tjera të rëndësishme që lidhen me konkurrencën e ekonomisë së BE-së, të tilla si klasterat.

Përmes politikave të ndërmarrjeve dhe sektorit industrial, BE nxit analizën e konkurrenshmërisë së sektorëve specifikë dhe fillimin e iniciativave specifike sektoriale, siç janë grupet e niveleve të larta, forumet e politikave, studime dhe panele ekspertësh, si dhe nisma e *networks*.

Formulimi dhe zbatimi i politikës së ndërmarrjes dhe asaj industriale kërkon aftësi të përshtatshme administrative në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor, duke përfshirë proceset efikase të konsultimit dhe mekanizmat e bashkëpunimit me palët kryesore të interesit, siç janë shoqatat e industrisë.

20.4 Situata aktuale në Shqipëri

Në fushën e ndërmarrjeve dhe politikave industriale, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur. Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 635, datë 1.10.2014, është miratuar Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014–2020. Strategjia është duke u zbatuar si dokumenti kryesor strategjik i qeverisë shqiptare që përcakton qasjen ndaj zhvillimit/ristrukturimit industrial dhe përmirësimit të konkurrencës. Zhvillimi industrial dhe përmirësimi i konkurrencës janë përparësitë

kryesore për qeverinë për të adresuar çështjet kryesore që prekin zhvillimin ekonomik të vendit. Në bashkëpunim me ministrinë e linjës dhe AIDA-n është monitoruar zbatimi i masave të Planit të Veprimit të Strategjisë për vitin 2019 dhe 6-mujorin e parë 2020. Nga monitorimi i strategjisë rezulton se janë:

- 19 masa të realizuara;
- 22 masa të realizuara pjesërisht;
- dhe 7 masa të përcaktuara;

Sa u përket instrumenteve të politikës industriale, Shqipëria merr pjesë në programin COSME të BE për NVM dhe Rrjeti Evropian i Ndërmarrjeve (EEN) përmes një konsorciumi të udhëhequr nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve. Në vijimësi, Shqipëria ka realizuar rekomandimet e OECD në “Aktin e Biznesit të Vogël”.

Në lidhje me të mësuarit e aftësive të sipërmarrjes, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) ka ndërmarrë Reformën e Kurrikulave 2015–2019 dhe ka zhvilluar programet e lëndëve shoqërore duke përfshirë në to kompetencat kyçe që duhet të fitojnë nxënësit në kuadrin e *Lifelong learning*, ku bëjnë pjesë edhe aftësitë e sipërmarrjes. Po kështu, janë miratuar udhëzime për ndjekjen ose mbarimin me kohët të shkurtuar të shkollës së mesme për ata të cilët nuk kanë mundur ta realizojnë atë.

Është forcuar korniza ligjore për procedurat e falimentimit. Ligji i ri për falimentimin, i miratuar në vitin 2017, përfshin shumë rregulla ligjore që nuk ishin trajtuar në legjislacionin e mëparshëm duke ofruar tani bazën ligjore për procedurat efikase të falimentimit. Duke lejuar riorganizimin e borxhit, korniza e re ligjore pritet të zgjidhë falimentimet në një kohë më të shpejtë dhe më lirë. Është hartuar edhe drafti përfundimtar i vendimit të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e marrëveshjeve jashtë - gjyqësore në rastet e falimentimit” dhe pritet të miratohet brenda dhjetorit 2020.

Në fushën e prokurimit publik, është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 850, datë 4.11.2020, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2020–2023 dhe planit të veprimit për zbatimin e saj”. Kjo Strategji ka për qëllim të garantojë një sistemi prokurimi eficient dhe efektiv në përputhje me parimet e transparencës, konkurrencës së lirë dhe të



ndershme, mos- diskriminimit dhe trajtimit të barabartë, duke promovuar dhe nxitur një sistem të qëndrueshëm që garanton vlerën për para. Për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian është në fazë miratimi projektligji i ri për prokurimin publik që transponon pjesërisht direktivat 2014/24, 2014/25, si edhe direktivat 89/665 dhe 92/13 të ndryshuara nga direktiva 2007/66. Projektligji është dërguar në Kuvend dhe pritet miratimi i tij brenda muajit dhjetor 2020.

Lidhur me reduktimin e informalitetit në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, plani i informalitetit në tregun e punës ka pasur në fokus edhe pagat e padeklaruara për profesione të ndryshme. Gjithashtu, është kryer edhe analiza e vlerësimit të riskut në sektorët e ndërtimit dhe tregtisë. Përpjekje maksimale janë duke u kryer për të ndryshuar sjelljen mospërmbushëse të tatimpaguesëve. Prej 1 janarit 2021, është parashikuar të hyjë në zbatim ligji i ri për faturën dhe monitorimin e qarkullimit (fiskalizimi), i cili formalizon marrëdhënien B2B dhe B2G, si dhe marrëdhëniet individ- biznes.

Lidhur me informacionin e disponueshëm mbi kreditimin, Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2020, finalizoi një punë disavejeçare të nisur për përpilimin e statistikave të reja mbi normat e interesit të kredisë së re dhe të portofolit të kredisë. BSH-ja ka punuar edhe me projektin, “Për përmirësimin e Regjistrimit të Kredive”. Me përfundimin e këtyre ndryshimeve në regjistrin e kredive pritet të ketë një infrastrukturë të përmirësuar teknike e cila do të ndikojë pozitivisht në drejtim të përpunimit të të dhënave, automatizimit të proceseve dhe reduktimit të rrezikut operacional duke ofruar një rritje cilësore të informacionit që regjistri përpunon aktualisht.

Lidhur me rritjen e mbulimit të Marrëveshjes Multilaterale të Akreditimit Evropian (EA MLA) për të lehtësuar aksesin e SME-ve në tregjet e eksportit dhe për të rritur konkurrencën e tyre, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) është bërë anëtare e EA MLA në fushën e certifikimit të personit në qershor 2020.

Në kuadër të përmirësimit të shërbimeve postare për të mbështetur më tej tregtinë elektronike, si dhe për përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të Bashkimit Evropian, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka parashikuar gjatë

tremujorit të dytë të vitit 2021 transpozimin e Rregullores 2018/644 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi shërbimet e dërgesave të pakove ndërkufitare. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka kryer studimin e fizibilitetit për zhvillimin e *broadbandit* rajonal në kuadër të projektit të WBIF ALB19-DII-01. Me VKM-në nr. 434 datë 3.6.2020 është miratuar Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës digjitale *broadband* që synon rritjen e penetrimit me lidhje *broadband* të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë drejt një shoqërie *gigabit*.

Banka e Shqipërisë që prej vitit 2018 ka intensifikuar përpjekjet për modernizimin e tregut të pagesave me vlerë të vogël me qëllim promovimin e përdorimit të pagesave elektronike dhe tregtinë elektronike si një kanal për përdorimin e tyre. Në këtë kuadër në vitin 2019 është punuar për hartimin e Ligjit nr. 55/2020, “Për shërbimet e pagesave” dhe hartimin e akteve nënligjore në zbatim të tij.

Në vitin 2018, u përcaktuan procedurat për vlerësimin e ndikimit rregullator (RIA) gjatë miratimit të ligjeve dhe akteve nënligjore. Gjatë vitit 2020 u realizua vlerësimi i ndikimit rregullator për të gjitha projektligjet e paraqitura për miratim, i cili merr parasysh edhe ndikimin e legjislacionit të ri në konkurrueshmërinë e biznesit.

Në lidhje me pagesat e vonuara, ligji nr. 48/2014, i datës 24.4.2014, “Për pagesa të vonuara”, është përafruar pjesërisht me direktivën 2011/7/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 16 shkurtit 2011 për luftën kundër pagesave të vonuara në transaksionet tregtare. Ligji hyri në fuqi më 4 qershor 2014. Ligji përcakton rregullat për luftimin e pagesave të vonuara në transaksionet tregtare midis ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve dhe autoriteteve publike. Aktualisht Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përgatitur dhe ka iniciuar procedurat e miratimit për një ndryshim në ligjin nr. 48/2014, “Për pagesa të vonuara në detyrimet kontraktuale dhe tregtare” me qëllim shkurtimin e afateve të shërbimit të kujdesit shëndetësor nga 1 vit në 60 ditë. Përafrimi i plotë i Direktivës mund të arrihet përmes ndryshimeve në Kodin Civil dhe Kodin e Procedurës Civile të Shqipërisë.

Bashkimi i QKR dhe QKL, mundësoi krijimin e QKB-së, si një qendër e vetme me një ndalesë për ofrimin e shërbimeve të regjistrimit dhe licencimit



të biznesit. Kjo ka sjellë një reduktim të mëtejshëm të barrierave administrative për bizneset që operojnë në Republikën e Shqipërisë. Krijimi dhe funksionimi i QKB u mirëprit nga subjektet, pasi tashmë procedurat dhe i gjithë informacioni i nevojshëm për të operuar në tregun shqiptar mund të gjendet lehtësisht në një qendër të vetme. Ngritja e QKB ka luajtur një rol kryesor në zvogëlimin e burokracisë së panevojshme dhe procedurave për NVM-të.

Digjitalizimi i shërbimeve qeveritare ka zvogëluar barrën administrative për NVM-të. Sistemi *e-Albania*, i menaxhuar nga Agjencia Kombëtare e Shqipërisë së Informacionit (AKSHI), lejon që bizneset të kenë më shumë se 300 shërbime përkatëse *online*. Veçanërisht, taksat mund të paraqiten dhe paguhet në internet, duke sjellë uljen e barrës rregullore për NVM-të.

Në kuadër të reformës së ndërmarrë nga Qeveria shqiptare për digjitalizimin e shërbimeve qeveritare, një pjesë e shërbimeve funksionale të Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrimin dhe licencimin/lejimin e biznesit ofrohen vetëm *online* nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania* dhe brenda vitit 2020, të gjitha shërbimet funksionale të Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrimin dhe licencimin/lejimin e biznesit do të ofrohen vetëm *online* nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*, dhe për aplikimet *online* tarifa e aplikimit është 0 ALL.

Zbatimi efektiv i parimeve të SBA varet nga ndërtimi i burimeve njerëzore dhe kapaciteteve institucionale të Shqipërisë. Duke shfrytëzuar sa më mirë memorien e akumuluar institucionale, personeli duhet të trajnohet vazhdimisht me qëllim të rritjes së kompetencës së tyre për të kuptuar nevojat e ndërmarrjeve dhe zhvillimin e masave të nevojshme.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ofron instrumente financimi për të stimuluar sipërmarrjen në inovacion, konkurrueshmëri, *startup*-et dhe artizanatin, për të mbështetur prodhimin e tarifave nën regjimin e përpunimit të brendshëm dhe konkurrencën.

Për vitin 2020, buxheti i planifikuar për skemat e granteve u administrua direkt nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në formë e skemave mbështetëse në shërbim të bizneseve të goditura nga COVID-19, sipas paketave të përgatitura nga qeveria që nga fillimi i pandemisë dhe në vazhdim. Faqe | 4130

Ndërkohë është punuar me asistencën e TAIEX për rishikimin e skemave ekzistuese.

Për sa u përket operacioneve sektoriale, në sektorin e turizmit, Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019–2023, miratuar nga Këshilli i Ministrave me VKM-në nr. 413, datë 19.6 2019, përcakton kornizën strategjike për zhvillimin e sektorit. Ligji nr. 93/2015, “Për turizmin” u miratua në korrik 2015, bazuar në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit. Ligji është në përputhje me angazhimet që rrjedhin nga neni 70 dhe neni 94 “Turizmi” i MSA-së. Ligji është përafëruar pjesërisht me Rregulloren (BE) nr. 692/2011 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 6 korrikut 2011, në lidhje me statistikën evropiane mbi turizmin dhe shfuqizimin e direktivës së Këshillit 95/57/KE dhe direktivës së Këshillit 90/314/KE 13 qershor 1990 për paketat e paketave të udhëtimeve, paketave të pushimeve dhe paketat me turne.

Në lidhje me sektorin e drurit, është ngritur dhe funksionon Klasteri i industrisë së drurit të Shqipërisë (WICA) si një organizatë joqeveritare jofitimprurëse.

Për sa u përket politikave sektoriale, një paketë stimulimi fiskal u miratua në vitin 2018 për hotelet me 4–5 vje. Incentiva fiskale janë miratuar edhe për industrinë e agropërpunimit.

Hartimi i një dokumenti të ri të Strategjisë së Zhvillimit të Industrisë do të bazohet në dokumentin e hartuar nga UNIDO dhe të miratuar nga Qeveria Shqiptare “Programi i vendit për Shqipërinë industriale gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme 2020–2024”, bazuar në strategjinë e re BIDS 2021–2027.

Lidhur me nën- kapitullin “Politikat industriale dhe operacionet sektoriale”, korniza ligjore për fushat e zhvillimit teknologjik dhe ekonomik, përbëhet nga ligji nr. 9789/2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të zhvillimit teknologjik dhe ekonomik”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij. Kuadri ligjor për zonat e zhvillimit teknologjik dhe ekonomik është i plotë. Ndryshimet e fundit të bëra në bazën nënligjore kanë krijuar mundësinë që si zhvillues i zonës të mund të jenë dhe njësitë e qeverisjes qendrore ose vendore. Pushteti vendor bazuar në projektet për zhvillim nëpërmjet thithjes së investimeve dhe rritjen e punësimit, në territorin që ka në administrim, mund të aplikojë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të



kërkojë shpalljen e një zone brenda territorit të saj, ku pushteti lokal do të marrë rolin e zhvilluesit.

Procesi i privatizimit mbetet përparësi, veçanërisht në sektorët strategjikë që synojnë tërheqjen e kapitalit të huaj dhe vendës që do të ndikonte pozitivisht në zhvillimin ekonomik. Sipas objektivave që lidhen me privatizimin e pasurive në pronësi të shtetit, ministri përgjegjës për ekonominë rishikon çdo vit planin për privatizimin e pasurive publike. Plani i veprimit për privatizimin e pasurive për periudhën 2016–2020”, ai është rishikuar për periudhën 2018–2020, me urdhrin nr. 88 të datës 21.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

20.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Në shkurt të vitit 2020 ka filluar puna për hartimin e Strategjisë së re të Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, e cila do të krijojë kushtet për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla e të mesme dhe tërheqjen e investimeve të huaja. Ministria e Financave dhe Ekonomisë po drejton punën për hartimin e Strategjisë së re të Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (2021–2027), e cila do të përqendrohet në tri shtylla kryesore:

- zhvillimi i sipërmarrjes dhe inovacioni;
- tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi;
- zhvillimi i kapitalit njerëzor.

Drafti i parë i kësaj Strategjie planifikohet të përfundojë në muajin dhjetor 2020. Përgjatë tri muajve në vijim do të zhvillohet procesi i konsultimeve me qëllim që në vitin 2021 Strategjia të miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Me miratimin e Planit të Veprimit për Reformën e Politikës së Investimeve si pjesë e përpjekjeve rajonale MAP-REA për investime, është bërë e mundur të synohet tërheqja e investimeve në sektorin e turizmit dhe zbatimi i një programi mbështetës për inovacionin.

Për monitorimin e BIDS-së në vijim janë zhvilluar takime me përfaqësues të institucioneve, me qëllim monitorimin e masave të Planit të Veprimit. Është në proces përafrimi i legjislacionit të pagesave të vonuara me Direktivën e BE-së.

Shqipëria po vazhdon të zbatojë masat për zgjerimin e bazës së tatimpaguesve me qëllim rritjen e transparencës dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për biznesin.

Në dhjetor 2019 u ratifikua “Ligji për krijimin e Korporatës Shqiptare të Investimeve”. Si një agjenci e krijuar rishtas e qeverisë për përgatitjen

dhe zbatimin e projekteve të investimeve dhe rigjallërimin e aseteve të zgjedhura të sektorit publik të papërdorura, fokusi i AIC gjatë vitit 2020 ka qenë në përgatitjen e akteve nënligjore të AIC (karta e AIC-së). Rregulloret u finalizuan në maj të vitit 2020. Struktura e AIC-së tashmë parashikon një organizatë të vogël, me katër departamente: operacionet, zhvillimi i biznesit, departamenti ligjor dhe financa/thesari. Paralelisht me organizimin e brendshëm të AIC-së, janë duke ndërmarrë hapa për identifikimin e projekteve që AIC-ja mund të marrë dhe shqyrtimin e ideve të mundshme të projektit. Projektet e AIC-së ndahen në katër kategori të gjera: prodhimi, logjistika, bujqësia dhe turizmi.

Në kuadër të masave për mbështetjen e bizneseve gjatë pandemisë COVID-19, Këshilli i Ministrave ka miratuar dy instrumente të Garancisë Sovrane për një shumë totale prej 26 miliardë lekësh.

Garancia Sovrane I në masën 11 miliardë lekë:

- Aplikohet nga bizneset në çdo bankë të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë;
- Garantohet 100% nga shteti shqiptar;
- Paguhet pagat e tre muajve të punonjësve të kompanive të prekura nga situata e COVID-19;
- Interesi subvencionohet nga Qeveria shqiptare;
- Periudhë pa shlyerje të principalit (*grace period*) prej 3 muajsh.

Garancia Sovrane II në masën 15 miliardë lekë:

- Aplikohet për bizneset në të gjithë sektorët e ekonomisë;
- Aplikohet për nevoja në kapital qarkullues dhe investime;
- Instrument që ndan riskun me bankat, duke mbuluar një përqindje të principalit të çdo huaje;
- Kushte preferenciale financimi, dhe afat shlyerje deri 5 vjet;
- Periudhë pa shlyerje të principalit (*grace period*) prej 6 muajsh.

Me vendimin nr. 856, datë 4.11.2020, “Për ndihmën financiare të disa prej kategorive kryesore të ndërmarrjeve, të cilat zbatojnë protokollet e sigurisë, në kuadër të parandalimit e të kontrollit të pandemisë COVID-19”, synohet dhënia e ndihmës financiare për ndërmarrjet e kategorizuara të vogla dhe të mesme në sektorin e prodhimit (në vijim “ndërmarrjet”), sipas nenit 4, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të



mesme”, të ndryshuar, sipas kodeve REV 2 NACE, në aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet vendimit. Ndihma financiare shtrihet për periudhën nëntor–dhjetor 2020 dhe u jepet ndërmarrjeve për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve, për të zbatuar protokollet, në kuadër të pandemisë. COVID-19, bazuar në numrin e të punësuarve, konkretisht 4 000 lekë për çdo punonjës për nëntor–dhjetor 2020.

Lidhur me ngritjen e Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik në Elbasan, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin e tij nr. 238, datë 20.3.2020, “Për miratimin e nënshkrimit të kontratës ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe zhvilluesit Italduri Elbasan llc për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e teknologjisë dhe ekonomisë. zona e zhvillimit në Elbasan”. Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe zhvilluesi i saj Italduri Elbasan sh.p.k. kanë nënshkruar kontratën. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka licencuar me licencë zhvilluesi në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, shoqërinë Italduri Elbasan sh.p.k.

Bashkia Tiranë në vijim të procedurave për shpalljen e TEDA Kashar, ka aplikuar pranë AIDA-s për përfitimin e statusit “Projekt me potencial strategjik”. Me vendimin nr. 1/4, datë 4.5.2020 të KIS-it, “Për miratimin e statusit “Projekt me potencial strategjik Zona Teknologjike e Zhvillimit Ekonomik (TEDA) Kashar, me subjekt propozuar Bashkia Tiranë”, është miratuar nga KIS statusi i investitorit strategjik për TEDA Kashar, e cila do t’i hapë rrugë zhvillimit të mëtejshëm të këtij projekti. Nga ana e Bashkisë Tiranë, po punohet për realizimin e projektit financiar të zhvillimit të zonës.

Vazhdon privatizimi i pasurive shtetërore, pjesërisht përmes bonove të privatizimit. Privatizimi i paketës së aksioneve strategjike (ndërmarrjet tregtare që operojnë në sektorë me rëndësi të veçantë për ekonominë) zbatohet në përputhje me Strategjinë e Privatizimit, të miratuar me ligjin nr. 8306, datë 14.3.1998, “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar. Në vitin 2020, janë privatizuar 9 asete që sollën 101,495,078.9 lekë në kesh dhe 233,149,915 lekë në bono të privatizimit, në total 334,644,993.9 lekë. Shitja e aseteve u realizua përmes procedurave të ankandit publik dhe ish-pronarët e tokave kishin përparësi për të blerë

asetet. Disa nga këto asete janë blerë nga pronarët e tokave, duke ushtruar të drejtën e tyre të parablerjes.

Sa u përket proceseve dhe rritjes së kapaciteteve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe grupit ndërinstitucional të punës (GNPIE), janë zhvilluar aktivitete për përgatitjen e tyre për takimin bilateral në kuadër të procesit *screening* me mbështetjen e projektit GIZ: Harmonizimi i legjislacionit ekonomik dhe tregtar me *acquis* të BE-së.

Është bërë përcaktimi i përgjegjësisë për përafrimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian dhe politikave të tij në sektorin e industrisë. Analiza e Mangësive Ligjore për kapitullin është përdorur nga anëtarët e GNPIE për të përgatitur pasqyrën e harmonizimit ligjor (*Legal Gap Assessment-LGA/Screening List*), duke identifikuar kështu çështjet kryesore të harmonizuara ose jo. Me mbështetjen e projektit vijues të GIZ-së. Mbështetje për negociatat e anëtarësimit në kapitujt ekonomikë të BE-së (SANECA), GNPIE për kapitullin 20 ka riparë, përmirësuar dhe plotësuar LGA-në me analizën e mangësive institucionale dhe administrative (*Institutional and Administrative Gap Assessment- IAGA*). Për këtë qëllim janë zhvilluar gjithsej 6 sesione *coaching* (në maj dhe shtator 2020) me mbi 100 pjesëmarrës, në të cilat anëtarët e GNPIE-së janë mbështetur praktikisht në plotësimin e dokumenteve LGA/IAGA, në vlerësimin e nivelit të harmonizimit dhe në planifikimin e masave për harmonizim të mëtejshëm. Gjithashtu, me mbështetjen e SANECA, në dhjetor 2020 është zhvilluar dhe një sesion trajnimi praktik për përgatitjen e prezantimeve për Takimin Bilateral për kapitullin 20, në cilin është paraqitur një shembull praktik prezantimi, përgatitur nga njëri prej institucioneve kyçe të kapitullit, për të ilustruar në praktikë nivelin e përafrimit sa u takon politikave të NVM-ve. Kësisoj, trajnimi praktik, shoqëruar me rekomandime për mënyrën e strukturimit dhe përgatitjes përmbajtësore të prezantimeve, synon t’i shërbejë mbajtjes dhe përgatitjes për simulimet e Takimit Dypalësh, që pritet të zhvillohen fill para zhvillimit të Takimit Dypalësh për këtë kapitull.

Programi Instrumenti i NVM-ve të Horizon 2020 synon mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) që kanë ide inovative për të sjellë në treg produkte, shërbime e modele të reja



biznesi. Në kuadër të punës për Instrumentin H2020 për SME, edhe gjatë vitit 2020 janë vijuar takimet me institucionet bashkëpunuese, për realizimin e organizimit të takimeve pranë bizneseve në vend ose ditëve informuese me to në bashkëpunim me institucionet partnere, lidhur me informimin e bizneseve mbi mundësitë për financim në programet e BE-së si programi Instrumenti SME. Shqipëria merr pjesë në Horizon 2020 si një vend i asociuar. Pjesëmarrja e saj në Horizon 2020 është përmirësuar ndjeshëm dhe ka tregues në rritje për vitin 2020. Bazuar në urdhrat për shpalljen për shprehje interesi dhe përzgjedhjen e përfaqësuesve në komitetet e programit Horizon 2020 dhe komitetet ERA (*European Research Area Committees*), u kryen procedurat e përzgjedhjes e pikave kombëtare të kontaktit (këtej e në vijim NCP) dhe përfaqësuesit në programet Era dhe Horizon 2020.

Në kuadër, të Programit Horizon 2002, AKKSHI (NASRI), ka organizuar 160 ditë informuese dhe trajnuese. Një pjesë e këtyre aktiviteteve janë organizuar në bashkëpunim me DG Research and Innovation të Komisionit Europian, Research Executive Agency, Agency for the Promotion of European Research (APRE) etj. Gjatë periudhës 2014–2020, aplikantët nga Shqipëria kanë paraqitur në Programin H2020 një numër total aplikimesh prej 475, nga të cilat janë vlerësuar deri tani 460 dhe janë shpallur fitues 45.

Performanca e Shqipërisë në Programin Horizon 2020 nga viti 2014 në vitin 2020, ka përmbushur objektivat e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor 2017–2022, rritje të aplikimeve dhe projekteve të fituara me më shumë se 10% në vit. Lidhur me këtë objektiv, përtej pjesëmarrjes më të lartë në Horizon 2020, në të ardhmen do të konsiderohet me prioritet edhe pjesëmarrja në programin Horizon Europe.

Në fillim të vitit 2020, Qendra Kombëtare e Biznesit nënshkroi marrëveshjen për pjesëmarrjen e regjistrimit tregtar shqiptar në portalin rajonal të regjistrave të biznesit të Evropës Juglindore. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) po mbështet Agjencisë Serbe të Regjistrimit të Biznesit (SRBA) dhe institucionet e saj homologe në Evropën Juglindore për të krijuar një platformë rajonale IT që do të lejojë lidhjen e institucioneve përgjegjëse për regjistrimin e biznesit në rajon dhe ofrimin e të dhënave dhe shërbimeve me vlerë të

shtuar për komunitetin e biznesit, për të lehtësuar regjistrimet e mundshme ndërkufitare të biznesit dhe transferimin e selive të shoqërive përmes një portal rajonal *online*.

Me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mjedisit të biznesit, është krijuar një grup pune, në të cilin QKB është një institucion kontribuues, për reformën e rregullimit në fushën e licencimit. Në kuadër të kësaj reforme, grupi i punës ka propozuar eliminimin e 22 licencave dhe përmirësimin e mëtejshëm të procesit të licencimit, me anë të riklasifikimit të licencave ose reduktimit të afatit të vendimmarrjes për 49 licencat e tjera. Aktualisht janë eliminuar 10 licenca.

Në kuadër të reformës së ndërmarrë nga qeveria shqiptare për digjitalizimin e shërbimeve qeveritare, një pjesë e shërbimeve funksionale të Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrimin dhe licencimin/lejimin e biznesit ofrohen vetëm *online* nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania* dhe brenda vitit 2020, të gjitha shërbimet funksionale të Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrimin dhe licencimin/lejimin e biznesit do të ofrohen vetëm *online* nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*, dhe për aplikimet *online* tarifa e aplikimit është 0 ALL.

20.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për kapitullin 20, sipas urdhrat të Kryeministrit nr. 94 të, “Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e GNIP për Integrimin Evropian” dhe janë si më poshtë:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) (institucioni koordinues);
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE);
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR);
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM);
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Kulturës;
- Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA);
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
- Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI);
- Agjencia e Prokurimit Publik (APP);
- Autoriteti i Konkurrencës (AK);



- Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB);
- sekretariati i Iniciativës së Transparencës për Industrinë Nxjerrëse (EITI);
- Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- Banka e Shqipërisë (BSH);
- Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimet Sociale;
- Autoriteti i Komunikimeve Postare dhe Elektronike;
- Instituti i Statistikave (INSTAT).

20.7 Prioritetet

Prioritetet kryesore në kapitullin 20 janë si më poshtë:

- Zbatimi efektiv i planit të veprimit Triple-Helix;
- Përpjekja e përafrimit të plotë të legjislacionit shqiptar me Direktivën e Pagesave të Vonuara;
- Përbalimi i sfidave kryesore në klimën e biznesit, konkretisht duke reduktuar barrën rregullatore në mënyrë më energjike dhe duke zgjeruar pjesëmarrjen në programet ekzistuese të financimit të biznesit;
- Përgatitja e Strategjinë e re të Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve për të përballuar sfidat e konkurrueshmërisë dhe rritjes ekonomike sikurse theksuar në rekomandimet e përbashkëta të majit 2019 të Programit të Reformave Ekonomike 2019–2021.

KAPITULLI 21 RRJETET TRANSEVROPIANE

21.1 Përmbajtja e kapitullit

Ky kapitull përfshin politikën e rrjeteve transevropiane në fushat e transportit, telekomunikacionit dhe infrastrukturës energjetike, përfshirë udhëzimet e Komunitetit për zhvillimin e rrjeteve transevropiane dhe masat mbështetëse për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët. Përcaktimi dhe zhvillimi i rrjeteve transevropiane, si dhe promovimi i ndërlidhjes së duhur dhe ndërveprimit të rrjeteve kombëtare synojnë të përfitojnë plotësisht nga tregu i brendshëm dhe të kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe krijimin e punësimit në vend dhe më gjerë.

21.2 Struktura e kapitullit

- Rrjetet transevropiane të transportit;
- Rrjetet transevropiane të energjisë.

21.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Bashkëpunimi midis BE-së dhe Shqipërisë në lidhje me rrjetet transevropiane, rregullohet nga disa nene të Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit. Lidhur me këtë, Marrëveshja e Stabilizim-asociimit në nenin 106 “Transporti” përcakton se palët, d.m.th. Shqipëria dhe Bashkimi Evropian do të përqendrohen në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e BE-së, duke synuar rristurimin dhe modernizimin e mënyrave të transportit të Shqipërisë, duke mbështetur zhvillimin e infrastrukturave multimodale dhe lidhjen me rrjetet kryesore transevropiane dhe arritjen e standardeve operative të krahasueshme me ato të Bashkimit Evropian.

Në sektorin energjetik, neni 107 përcakton se bashkëpunimi në energji do të bazohet në Traktatin rajonal të Komunitetit të Energjisë të nënshkruar me synim integrimin gradual të Shqipërisë në tregjet e energjisë të Evropës, i cili është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006, “Për ratifikimin e Traktatit të krijimit të Komunitetit të Energjisë”.

Neni 70 përcakton se Shqipëria do të përafrojë gradualisht legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së me qëllim përmirësimin e sistemit dhe shërbimeve të transportit dhe energjisë.

Në lidhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian, politikat në kapitullin 21 i përkasin grupit të dytë të kompetencave të Bashkimit Evropian, d.m.th. grupit të kompetencave të ndara mes Bashkimit Evropian dhe shteteve të tij anëtare. Sipas Nenit 4 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, si Bashkimi Evropian ashtu edhe shtetet anëtare mund të miratojnë akte ligjore në fushën e rrjeteve transevropiane. Shtetet anëtare e ushtrojnë kompetencën e tyre në rast se Bashkimi Evropian nuk e ushtron këtë kompetencë ose ka vendosur të mos e ushtrojë këtë kompetencë.

Politikat e Bashkimit Evropian në lidhje me rrjetet transevropiane të transportit (TEN- T) dhe energjisë (TEN- E) bazohen në tri shtylla kryesore: baza ligjore për TENs, Nenet 170–172 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, Rregullorja (BE) Nr. 1315/2013 për udhëzimet e Bashkimit për zhvillimin e rrjetit trans- evropian në transport dhe energji, dhe Rregullorja (BE) 1316/20132 për ngritjen e Instrumentit *Connecting*



Europe, duke amenduar Rregulloren (BE) 913/2010 dhe shfuqizuar Rregulloret (KE) 680/2007 dhe (KE) 67/2010. Ky kuadër ligjor përcakton objektivat e politikës së Bashkimit Evropian, të cilat përfshijnë rrjetet e transportit dhe energjisë dhe synojnë përshtatjen dhe zhvillimin e rrjeteve dhe sigurimin e ndërlidhshmërisë dhe ndërveprimit të tyre. Politikat e TEN-t dhe TEN- E i janë nënshtruar një rishikimi thelbësor. Instrumenti i ri i financimit për rrjetet transevropiane, Instrumenti *Connecting Europe* (CEF) dhe udhëzimet e rishikuara TEN-t dhe TEN- E hynë në fuqi në 1 janar 2014. Qëllimi i ngritjes dhe zhvillimit të rrjeteve transevropiane dhe nxitja e ndërlidhjes dhe ndërveprimit të duhur të rrjeteve kombëtare bëhet për të shfrytëzuar plotësisht avantazhin e tregut të brendshëm dhe për të kontribuar në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës në Bashkimin Evropian.

21.4 Situata aktuale në Shqipëri

Njëfarë niveli përgatitjeje është arritur tashmë në fushën e rrjeteve ndër evropiane. Shqipëria ka bërë disa përparime, si në rrjetet e transportit ashtu edhe në atë energjetik, duke përfshirë edhe vënien në funksionim të lidhjes së saj energjetike me Kosovën dhe zhvillimin e lidhjeve të saj të gazit me përfundimin e projektit të tubacionit trans- Adriatik (TAP).

Lidhur me rrjetet transevropiane të transportit, Strategjia e Sektorit të Transportit dhe Plani i saj i Veprimit 2016–2020, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 811, datë 16.11.2016, “Për miratimin e Strategjisë së Sektorit të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016–2020” është duke u zbatuar. Raporti i tretë i Monitorimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Transportit 2016 - 2020 dhe Planit të Veprimit u përgatit dhe u aprovua më 23 korrik 2020, si dhe u botua në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/3rd-Monitoring-Report-of-sectorial-Transport-strategy-and-Action-Plan-2016-2020-June-2020.pdf>.

Strategjia parashikon zhvillimin e rrjeteve bazë dhe gjithëpërfshirëse të transportit në përputhje me kërkesat e BE-së nën qasjen transevropiane. Strategjia e Sektorit të Transportit parashikon zhvillimin në Shqipëri të shtrirjes indikative të rrjetit TEN-t në Ballkanin Perëndimor sipas

Rregullores (BE) Nr. 1315/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 11 dhjetorit 2013 mbi udhëzimet e Bashkimit Evropian për zhvillimin e rrjetit trans- evropian të transportit dhe shfuqizimin e Vendimit Nr. 661/2010/BE të ndryshuar nga Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2016/758 e datës 4 shkurt 2016 për ndryshimin e Rregullores (BE) Nr. 1315/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me përshtatjen e Aneksit III me to.

Me ligjin nr. 8/2018, datë 26.2.2018, “Për ratifikimin e Traktatit që themelon Komunitetin e Transportit” u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë ky Traktat, që është një nga dokumentet më të rëndësishëm për të gjithë sektorët e transportit, dhe që do të jetë udhërrëfyesi për vitet në vijim. Zbatimi i Traktatit të Komunitetit të Transportit do të përmirësojë sektorin e transportit, jo vetëm në Shqipëri, por në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe do të përmirësojë në lidhjen e rrjetit shqiptar të transportit me rrjetin e transportit të BE-së. Traktati parashikon përafrimin e mëtejshëm të legjislacioneve kombëtare me *acquis* e BE-së, për të gjitha fushat e transportit.

Në zbatim të ligjit nr. 8/2018, datë 26.2.2018, “Për ratifikimin e Traktatit që themelon Komunitetin e Transportit” dhe, me qëllim përafrimin me *acquis* të BE-së, është miratuar urdhri i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 196, datë 9.7.2020, “Për zbatimin e Rregullores, “Për udhëzimet e Bashkimit Evropian për zhvillimin e rrjetit trans- evropian të transportit””.

Dokumenti kryesor i politikave në sektorin e energjisë është Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018–2030, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 31.7.2018. Kjo Strategji përcakton se vizioni i Shqipërisë është zhvillimi i burimeve kombëtare të energjisë që çon në një sistem rajonal të integruar dhe të diversifikuar të energjisë bazuar në parimet e tregut, i aftë për të përmbushur kërkesën për energji dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë, duke garantuar sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, sigurimin, mbrojtjen e mjedisit dhe veprimet klimatike, dhe rritjen e mirëqenies me kosto sociale minimal.

Për zhvillimin e infrastrukturës së gazit në Shqipëri, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 87, datë 14.2.2018, “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektori të gazit natyror në



Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”. Masterplani i Gazit përcakton linjat kryesore për zhvillimin e tregut dhe shërbimeve të gazit në Shqipëri bazuar në gazin natyror të furnizuar nga gazsjellësi Trans Adriatik (TAP), por edhe vendburime potenciale të gazit të zbuluara dhe konkretizuara në vend, apo edhe të gazsjellësve të tjerë si gazsjellësi Adriatiko-Jonian dhe gazsjellësi Shqipëri-Kosovë.

Shoqëria Trans-Adriatic Pipeline AG ka përfunduar ndërtimin e gazsjellësit TAP në territorin e Shqipërisë dhe së fundmi ka filluar procesin e transmetimit të gazit natyror.

21.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Për sa i përket fushës së rrjeteve të transportit, dokumenti kryesor i politikës në sektorin e transportit është Strategjia e Sektorit të Transportit dhe Plan i saj i Veprimit 2016–2020, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 811, datë 16.11.2016, “Për miratimin e Strategjisë së Sektorit të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016–2020”. Objektivi i përgjithshëm i Strategjisë Kombëtare të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016–2020 është i. të zhvillojë më tej sistemin kombëtar të transportit të Shqipërisë, dhe ii. përmirësojë ndjeshëm ndërlidhjen, ndërveprimin dhe integrimin e tij me sistemin dhe rajonin më të gjerë të transportit ndërkombëtar dhe evropian. Raporti i tretë i Monitorimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Transportit 2016–2020 dhe Planit të Veprimit u përgatit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe u aprovua me 23 korrik 2020. Ky raport është botuar në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/3rd-Monitoring-Report-of-sectorial-Transport-strategy-and-Action-Plan-2016-2020-June-2020.pdf>.

Zbatimi i Traktatit që themeloi Komunitetin e Transportit (ligji nr. 8/2018, datë 26.2.2018) do të rrisë edhe më tej integrimin e rrjetit shqiptar dhe rajonal të transportit në rrjetet evropiane të transportit. Sipas Traktatit, Neni 8(1) “Infrastruktura”, hartat e zgjatjes indikative të rrjeteve gjithëpërfshirëse dhe bazë TEN-t në Ballkanin Perëndimor janë pjesë përbërëse e Traktatit të detyrueshme për të gjithë palët në Traktat. Neni 3 i Traktatit përcakton se palët kontraktuese janë të detyruar të harmonizojnë legjislacionin e tyre me *acquis* e BE-së, në përputhje

me dispozitat e këtij neni dhe vendimet e Komitetit Drejtues Rajonal.

Në rrjetin kryesor rrugor, janë bërë disa përpertime në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së transportit rrugor. Ka përpertime në përgatitjen e projekteve të infrastrukturës rrugore, hekurudhore dhe portuale, veçanërisht përgjatë korridorit të VIII dhe korridorit Adriatiko-Jonian. Gjatë vitit 2020 janë realizuar disa projekte që synojnë të zvogëlojnë distancën kohore midis Tiranës dhe qyteteve të mëdha dhe/ose midis qyteteve të mëdha, si ndërtimi dhe hapja për trafik të *by pass*-ve të Fierit dhe Tepelenës. Investimet synojnë gjithashtu përmirësimin e sigurisë rrugore. Projektet janë të hartuara për të integruar rrjetin kombëtar në rrjetin rajonal dhe pan- Evropian TEN- T.

Rrjeti hekurudhor shqiptar është pothuajse i përfshirë në rrjetin rajonal të transportit. Gjatësia e përgjithshme e linjës kryesore është rreth 420 km, ka 200 kilometra linjë dhe degë hekurudhore dytësore. Sa u përket projekteve të ndërlidhjes, BERZH-i ka shpallur fituesin e procedurës për punime, mallra dhe shërbime për rehabilitimin e linjës hekurudhor Durrës- Tiranë dhe lidhjen me Aeroportin “Nënë Tereza” (TIA).

Në fushën e transportit detar, në zbatim të ligjit nr. 62/2019, për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin, “Për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor, me qasje programatike me shumë faza” pjesa e dytë ka filluar puna për ngritjen e një Sistemi Informacioni për Menaxhimin e Trafikut të Anijeve (VTMIS), për të monitoruar trafikun e anijeve, në kombinim me Shërbimin e Trafikut të Anijeve. Në zbatim të ligjit të mësipërm ngritja e sistemit parashikon dy faza: Faza e parë përgatitjen e një studimi të realizueshmërisë; dhe faza e dytë mbështetjen për zbatimin e VTMIS-së përgjatë gjithë vijës bregdetare të Shqipërisë.

Në zbatim të fazës së parë Banka Botërore në zbatim të Manualit Operacional të Projektit u përzgjedh ekspertin teknik i cili do të përgatisë Studimin e Fizibilitetit brenda tremujorit të parë të vitit 2021 dhe më pas do të vijojë faza e dytë për ngritjen e sistemit VTMIS.

Lidhur me infrastrukturën portuale, investime janë kryer në të gjitha portet shqiptare. Qëllimi



ishte rritja e kapaciteteve, shtimi i terminaleve/mjediseve të reja për anijet, pastrimi i baseneve të porteve etj.

Projekti IAP. Projekti WB15-REG- ENE-02 “Projektimi paraprak i tubacioneve të gazit Adriatik Jon - pjesët e Malit të Zi dhe Shqipërisë”, është në fazën përmbyllëse nga konsulenti SUEZ (IPF6 AT). Projekti filloi në shtator 2018 dhe do të zgjasë për 24 muaj. Gjatë vitit 2019, procesi i ridrejtimin për sektorin shqiptar përfundoi dhe u miratua nga institucionet shqiptare. Më 6 nëntor 2019, konsulenti paraqiti draftin e Projektimit Paraprak për Seksionin Shqiptar. Në shkurt të vitit 2020, konsulenti SUEZ IPF 6 paraqiti draftin përfundimtar të VNMS-së për seksionin shqiptar të IAP. Më 5 qershor 2020, konsulenti paraqiti Raportin Tremujor të Progresit 07, për periudhën 4 mars 2020 deri 4 qershor 2020 për projektin WB15- REG-ENE-01 “Projektimi Paraprak i Gazsjellësit Adriatik-Jon-seksionet e Malit të Zi dhe Shqipërisë”. Më datë 24.8.2020 konsulenti IPF6 paraqiti draft Projektin Implementimi i Planit për seksionin shqiptar të projektit IAP. Së fundmi konsulenti ka paraqitur draftin final për sa lidhet me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social.

Depozitat nëntokësore të gazit në zonën e Dumresë (UGS Dumreja). Komiteti Drejtues i WBIF në takimin e tij të 6 dhjetorit 2018, nën raundin e 20-të të WBIF, miratoi një grant prej 1 milion eurosh për përgatitjen e Studimit të Fizibilitetit dhe VNMS për këtë projekt. Termat e referencës për përgatitjen e Studimit të Fizibilitetit dhe VNMS-në për projektin WB20- ALB- ENE-01 “*Albania, Dumrea Underground Gas Natural Storage*” u përgatitën nga konsulenti dhe iu paraqitën WBIF dhe BERZH. WBIF dhe BERZH miratuan ToR-të më 24.10.2019. Takimi fillestar për Fizibilitetin dhe VNMS u mbajt përmes *Skype* në 8 prill 2020. Në qershor 2020 u aprovua nga palët Inception Raport. Aktualisht po trajtohen çështje që lidhen me:

1. Parashikimet dhe caktimet e kërkesës për gaz për opsionet për UGS;
2. Identifikimi dhe vlerësimi teknik i alternativave për UGS;
3. Koncepti dhe rishikimi i PPP-së Kornizën e PPP-së.

Konsulenti është në fazën e përgatitjes së Studimit të Fizibilitetit dhe VNMS.

Gazsjellësi Fier-Vlorë. Komiteti Drejtues i WBIF më 6 dhjetor 2018 miratoi një grant prej 1.1 milionë eurosh për përgatitjen e tubacionit të gazit “Fieri-Vlora: Disenjimi i Hollësishëm dhe Dokumentet e Tenderit”. Termat e referencës u miratuan në shtator 2019. Konsulenti Hill International - Projekti i Konsorciumit IPF 7 (WB20- ALB- ENE-04), dorëzoi në janar 2020 për komente dokumentin “Metodologjia për tubacionin e gazit Fieri - Vlorë: Dizajni i Hollësishëm dhe Dokumentet e Tenderit”. Më 7 janar 2020, u zhvillua një takim ku u diskutua në lidhje me “Metodologjinë e projektit për tubacionin e gazit Fieri-Vlorë”. Në mars 2020, “Metodologjia e zbatimit për Gazsjellësin Fieri - Vlorë: Projektimi i Hollësishëm dhe Dokumentet e Tenderit” u miratua zyrtarisht nga Komiteti Drejtues i projektit të lartpërmendur. Në 23 qershor 2020 u mbajt takimi i radhës ku konsulenti IPF 7 prezantoi objektivat, pasqyrën e statusit dhe detyrave të nënprojekteve mbi zbatimin e metodologjisë të nënprojekteve dhe planit kohor, rreziqet dhe masat zbutëse. Më datë 6.10.2020 konsulenti paraqiti rishikimin e statusit të projektit. Ndërkohë është aprovuar edhe gjurma e gazsjellësit.

Alkogap. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë po aplikon për një grant asistence teknike për përgatitjen e studimit të fizibilitetit, VNMS/VNM për Shqipërinë të Gazsjellësit Alkogap. Projekti synon të krijojë një rrugë të re furnizimi për gazin natyror nga Lindja e Mesme dhe rajoni Kaspik i transportuar nga Gazsjellësi Trans Adriatik, në verilindje të zonës së Ballkanit Perëndimor drejt Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë. Projekti Alkogap megjithatë do të planifikohet si një tubacion me dy drejtime, drejtimi i mundshëm i furnizimit, gjithashtu, mund të jetë në veri-jug, nga Unaza e Gazit e Komunitetit të Energjisë (ECGR), ose burime të tjera

21.6 Lista e ministrive dhe Institucioneve përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për kapitullin 21, sipas urdhrit të Kryeministrit nr. 94, “Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian” janë si më poshtë:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Autoriteti Rrugor Shqiptar;
- Instituti i Transportit;



- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- Drejtoria e Përgjithshme Detare;
- Portet detare sh.a.;
- Autoriteti Portual i Durrësit;
- Hekurudha Shqiptare sh.a.;
- Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor;
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;
- Enti Rregullator i Energjisë;
- Agjencia për Eficiencën së Energjisë;
- KESH sh.a.;
- OST sh.a.;
- OSHEE sh.a.;
- Albpetrol sh.a.;
- ALBGAS sh.a.;
- Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial;
- Ministria e Financës dhe Ekonomisë;
- INSTAT.

21.7 Prioritetet

- Do të vazhdohet zhvillimi i rrjeteve kryesore të transportit dhe energjisë në përputhje me:
 - i. strategjitë kombëtare për transportin dhe energjinë;
 - ii. prioritzimin e investimeve në infrastrukturë në kuadër të Listës Prioritare të Projekteve, dhe
 - iii. Agjendën e ndërlidhjes;
- Do të vazhdohet harmonizimi i kuadrit ligjor me *acquis* e BE-së dhe rregulloret përkatëse, përfshirë transpozimin e Rregullores (BE) 347/2013 mbi udhëzimet për infrastrukturën transevropiane të energjisë;
- Do të vazhdohet me zbatimin e masave të reformës së ndërlidhjes dhe do të forcohet kuadri institucional dhe kapacitetet administrative për zhvillimin dhe monitorimin e rrjeteve transevropiane.

KAPITULLI 22 POLITIKAT RAJONALE DHE KOORDINIMI I INSTRUMENTEVE STRUKTURORË

22.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis në këtë kapitull përbëhet kryesisht nga rregulloret kuadër dhe ato zbatuese, të cilat nuk kërkojnë përafrimin në legjislacionin kombëtar. Këto rregullore përcaktojnë rregullat për hartimin, miratimin dhe zbatimin e programeve të Fondeve Strukturore dhe Fondit të Kohëzimit duke pasqyruar organizimin territorial të secilit vend.

Këto programe janë negociuar dhe janë dakordësuar me Komisionin, por zbatimi është përgjegjësi e Shteteve Anëtare. Shtetet anëtare duhet të respektojnë në përgjithësi legjislacionin e Bashkimit Evropian, për shembull, në fushat e prokurimit publik, konkurrencës dhe mjedisit, kur përzgjedhin dhe zbatojnë projektet. Shtetet anëtare duhet të kenë kuadrin institucional dhe kapacitete zbatuese adekuate për të siguruar programimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë të përshtatshme dhe me kosto efektive nga këndvështrimi i menaxhimit dhe kontrollit financiar.

22.2 Struktura e kapitullit

Kapitulli 22 nuk është i ndarë në nënkapituj.

22.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Republika e Shqipërisë në Kapitullin 22 do të fokusohet në:

- Zbatimin e nenit 110 të Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit që përcakton se palët do të përpiqen të forcojnë bashkëpunimin në zhvillimin rajonal dhe lokal në mënyrë që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe të zvogëlojnë pabarazitë rajonale. Ndihma financiare e siguruar nga BE është e rregulluar me nenet 112–115 të Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit (MSA);
- Marrjen e masave për të reduktuar pabarazitë ekonomike, duke krijuar rajone konkurruese, me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, zhvillim social, mjedisor dhe rrjedhimisht ekonomik dhe social të vendit në përputhje me standardet e BE;
- Përgatitjet e strukturave institucionale shqiptare për të zbatuar pas hyrjes në Bashkimin Evropian, programet e Bashkimit Evropian të përmendura më lart.

Në lidhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian, politikat e kohëzimit ekonomik, social dhe territorial (politikat rajonale) janë pjesë e grupit të dytë të kompetencave të Bashkimit Evropian. Neni 4 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian përcakton se në këtë rast, Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare kanë të drejtë të miratojnë akte ligjore. Shtetet anëtare mund të ushtrojnë kompetencat e tyre në rast se Bashkimi Evropian nuk i ushtron kompetencat e tij ose ka vendosur që të mos i ushtrojë këto kompetenca.

Acquis në këtë kapitull përbëhet kryesisht nga rregulloret kuadër dhe ato zbatuese, të cilat nuk



kërkojnë përafrimin në legjislacionin kombëtar. Këto rregullore përcaktojnë rregullat për hartimin, miratimin dhe zbatimin e programeve të Fondeve Evropiane Strukturore dhe të Investimeve (ESIF) të cilat do të reflektohen në organizimin territorial të secilit vend. Këto programe janë negociuar dhe janë dakordësuar me Komisionin, por zbatimi është përgjegjësi e Shteteve Anëtare.

Kuadri ligjor duhet të jetë i miratuar për të lejuar programimin shumëvjeçar në nivel kombëtar dhe vendor dhe fleksibilitetin buxhetor, duke mundësuar kapacitetin bashkëfinancues në nivel kombëtar dhe vendor dhe duke siguruar kontrollin financiar të përshtatshëm dhe eficient dhe auditivin e ndërhyrjeve. Shtetet anëtare duhet të respektojnë legjislacionin e Bashkimit Evropian në përgjithësi, kur përzgjedhin dhe zbatojnë projektet në fushat që kanë lidhje me politikat rajonale dhe instrumentet strukturore të tilla si prokurimi publik, konkurrenca dhe mjedisi, jodiskriminimi dhe barazia mes burrave dhe grave.

Kuadri institucional përfshin përcaktimin dhe ngritjen e të gjitha strukturave në nivel kombëtar dhe vendor të kërkuara nga rregulloret ashtu edhe ngritjen e një sistemi zbatimi me përcaktime të qarta të detyrave dhe përgjegjësi për organet e përfshira. Kuadri institucional kërkon po ashtu, ngritjen e një mekanizmi eficient për koordinimin ndër institucional ashtu edhe përfshirjen dhe konsultimin në një partneritet të gjerë të organizatave për përgatitjen dhe zbatimin e programeve.

Duhet të sigurohen kapacitetet administrative të përshtatshme në të gjitha strukturat relevante. Kjo përfshin rekrutimin dhe trajnimin e stafit të kualifikuar dhe me eksperiencë dhe marrjen e masave për të mbajtur në punë këtë staf. Në këtë kontekst, Shtetet anëtare nevojitet që të miratojnë rregullimet e nevojshme organizative, të miratojnë procedurat dhe organigramat dhe të përgatisin dokumentet shoqëruese.

Procesi i programimit mbulon përgatitjen e Marrëveshjeve të Partneritetit (PA) dhe të një serie programesh operacionale (OP) duke përfshirë vlerësimet *ex-ante*. Shtetet anëtare duhet të organizojnë partneritete të gjera për përgatitjen e dokumenteve të programimit. Ato duhet të sigurojnë që është krijuar një listë e mjaftueshme projektesh që lejon zbatimin e plotë financiar të programeve. Shtetet anëtare duhet të realizojnë

edhe masa informative dhe publicitare specifike në lidhje me instrumentet strukturore.

Ngritja e një sistemi monitorimi dhe vlerësimi përfshin ngritjen e strukturave të monitorimit dhe vlerësimit në organet e ndryshme relevante ashtu edhe instalimin e një sistemi të menaxhimit të informacionit, tërësor dhe të kompjuterizuar (MIS) të aksesueshem dhe të përdorshëm nga të gjitha organet e interesuara.

Duhet të ngrihet një kuadër i veçantë për menaxhimin financiar dhe kontrollin duke përfshirë auditin. Ky përfshin përcaktimin dhe ngritjen e të gjitha strukturave të kërkuara nga rregulloret ashtu edhe ngritjen e një sistemi zbatimi me përcaktim të qartë të detyrave dhe përgjegjësi për organet e përfshira.

22.4 Situata aktuale në Shqipëri

Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e politikës rajonale dhe koordinimit të instrumenteve strukturore. Është arritur përparim i kufizuar, veçanërisht me nënshkrimin e Marrëveshjes Financiare për Programin Kombëtar IPA 2017 dhe IPA 2018.

Strategjia Kombëtare aktuale për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020 (SKZHI II) është aprovuar nga Qeveria e Shqipërisë me Vendim të Këshillit të Ministrave VKM Nr. 348, datë 11.5.2016. SKZHI-ja përbën dokumentin ombrellë që siguron priorizimin e politikave në nivel afatmesëm dhe afatgjatë dhe shërben si orientim dhe kuadër për të gjitha strategjitë sektoriale/ndërsektoriale. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2020 përfaqëson dokumentin themelor strategjik të vendit që kombinon dhe integron agjendën e integritimit në Bashkimin Evropian me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit, përfshirë edhe ndërlikohen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

SKZHI-ja ka siguruar orientim për disa cikle të Programit të Buxhetit Afatmesëm (PBA), si dhe shpërndarjen e shpenzimeve publike, duke siguruar që objektivat e politikave të përfshihen në përgatitjen e buxhetit nga të gjitha ministratë dhe agjencitë, sipas udhëzimeve të e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. SKZHI-ja siguron gjithashtu boshtin orientues për të gjitha programimet e fondeve të partnerëve për zhvillim, duke përfshirë financimin përmes IPAs, si instrument financimi i BE për Shqipërinë, apo edhe strategjitë për zhvillimin e vendit që kanë donatorët



shumëpalësh (si BB, UN etj.) apo dypalësh (si SIDA, SDC, Gjermania, Italia etj.).

Aktualisht, SKZHI II është në fazën finale të zbatimit dhe ka filluar procesi për hartimin e strategjisë së re kombëtar që do të shtrihet për periudhën 2021–2030 (SKZHI III). Në kontekstin e monitorimit të zbatimit të SKZHI 2020, është përgatitur në 2019 Raporti i Progresit të SKZHI II, i cili pasqyron progresin dhe rezultatet e arritura, si edhe sfidat, në zbatimin e reformave në kuadër të SKZHI II, gjatë periudhës 2015–2018.

SKZHI 2021–2030 do të sigurojë mbështetje veçanërisht për harmonizimin sa më të mirë me ciklin e Programimit Buxhetor Afatmesëm dhe me programimin e strategjisë së Bashkimit Evropian/Planin Kombëtar për integrimin evropian. Gjithashtu, SKZHI 2021–2030 do të përfshijë prioritet strategjike për politikën afatgjatë të lidhura me zhvillimin rajonal të vendit, në përputhje edhe me ligjin 102/2020, “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin: (neni 11/6).

Në lidhje me kuadrin e përgjithshëm të politikave dhe prioritetëve sektoriale, SKZHI 2021–2030 siguron:

- **Lidhjen me prioritetet afatmesme të Qeverisë Shqiptare**, ku prioritetet e parashikuara në programin e Qeverisë, si edhe sektorët prioritarë të Qeverisë, janë pjesë integrale e vizionit drejt të cilit duhet të zhvillohet vendi dhe politikën strategjike që përcaktohen në SKZHI, në funksion të vizionit.

- **Lidhjen e plotë midis agjendën e integritetit të vendit/MSA**, ku aktivitetet, masat dhe angazhimet në kuadër të MSA-së janë pjesë integrale e SKZHI-së dhe planifikimit buxhetor afatmesëm. Në këtë mënyrë përcaktohet deri në detaje kostoja e integritetit evropian dhe angazhimeve në këtë kuadër.

- **Harmonizimin më të mirë të PBA me SKZHI** përmes:

- hartimit të një kuadri makroekonomik për 2021–2030, që përfshin prioritetet e politikave për 2021–2030, financimin e huaj të parashikuar apo programuar, si edhe aspekte të tjera lidhur me financimin dhe të ardhurat.

- qëllimet e politikave të mirëpërcaktuara për 2021–2030, të cilat përfshijnë edhe objektivat në kuadër të integritetit evropian. Për këtë qëllim, udhëzimi për hartimin e Buxhetit përcakton detajet teknike të përfshirjes së politikave dhe zbërthimin e

objektivave në PBA e ardhshme në funksion të realizimit të qëllimeve 2021–2030.

Strategjia Kombëtare 2030 siguron gjithashtu boshtin orientues për të gjitha programimet e fondeve të partnerëve për zhvillim, duke përfshirë financimin përmes IPA-s, si instrument financimi i BE për Shqipërinë, apo edhe strategjitë për zhvillimin e vendit që kanë donatorët shumëpalësh (si BB, UN etj) apo dypalësh (si SIDA, SDC, Gjermania, Italia etj.). Duke qenë në sintoni me proceset planifikuese edhe me Bashkimin Evropian, që ne synojmë të anëtarësohemi, SKZHI përfshin një hark kohor 10-vjeçar, ku 7 vjet është edhe cikli planifikues i politikave të vetë BE-së, ndërkohë që deri më 2030-ën është edhe harku kohor i zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Koordinimi i procesit të programimit dhe monitorimit të asistencës IPA kryhet nga Kryenegociatori me cilësinë e Koordinatorit Kombëtar të IPA-s (KKIPA), sikurse përcaktuar në VKM-në nr. 422 datë 6.5.2020, “Mbi përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të Ekipit Negociator dhe Kryenegociatorit për negociatat e pranimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”. KKIPA dhe ZM KKIPA kanë të njëjtat detyra dhe përgjegjësi siç kërkohet në Marrëveshjen Kuadër të BE-së ndërmjet KE–Shqipëri. Drejtoria e Koordinimit të Programeve Kombëtare dhe Rajonale të IPA-s/është pjesë e strukturës organizative të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Për të siguruar ndarjen e detyrave dhe ndjekjen më të mirë të proceseve, ish Drejtoria e Fondeve të BE-së në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme është ndarë në dy drejtori të veçanta me Urdhrin e Kryeministrit nr. 138, datë 21.10.2019. Drejtoria për Koordinimin për Koordinimin e Programeve Kombëtare dhe Rajonale IPA dhe Drejtoria e Bashkëpunimit Territorial. Ndarja e drejtorisë së fondeve të BE-së në dy njësi të ndryshme garanton një ndarje domethënëse të instrumenteve dhe një përfaqësim institucional më të përqendruar dhe efektiv. Ndarja e re organizative parashikon një pozicion të ri drejtori, të plotësuar tashmë. Drejtoria për Koordinimin e Programeve Kombëtare dhe Rajonale IPA është e ndarë në 3 sektorë me gjithsej 12 punonjës. Drejtoria e Bashkëpunimit Territorial përbëhet nga dy sektorë me gjithsej 9 punonjës.



Zyrtari Kombëtar Autorizues (zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë) mban përgjegjësinë e përgjithshme për menaxhimin financiar të asistencës IPA në Shqipëri duke siguruar ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve sipas IPA I dhe IPA II. ZKA-ja mbështetet nga strukturat drejtuese, të cilat përbëhen nga Fondi Kombëtar dhe Drejtoria për Mbështetjen e ZKA/NAO. Të dyja këto janë struktura të veçanta brenda Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat përgjigjen te NAO/ZKA për funksionimin e sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit financiar të zbatimit indirekt të Programeve IPA-IPARD në Shqipëri.

Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës e Akredituar nga BE u krijua me Ligjin Nr. 90/2016, datë 15.9.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit për Programet e Asistencës të akredituar nga BE në Republikën e Shqipërisë”. Agjencia ka si objekt të veprimtarisë auditimin për sistemet e menaxhimit dhe kontrollit për veprimet, transaksionet dhe llogaritë vjetore të mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian.

Drejtoria e Koordinimit të Programeve Kombëtare dhe Rajonale të IPA-s ka finalizuar procedurat e brendshme për miratimin në parim të Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me Programin Vjetor Kombëtar për Shqipërinë për vitin 2018, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para- Anëtarësimit (IPA II). Paketa financiare është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 476, datë 10 korrik 2019, si dhe është nënshkruar nga KKIPA-ja po në të njëjtën ditë. Kosto totale për këtë Program është 94.1 milionë Euro.

Gjatë vitit 2019 dhe 2020 është finalizuar procesi i programimit për programet vjetore IPA 2019 dhe 2020. Bazuar në kalendarin programues për të dyja programet, paketat janë miratuar nga Komiteti IPA në Bruksel gjatë vitit 2020 (janë miratuar për së dyti në muajt shtator dhe nëntor 2020, për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19). Fushat kryesore për mbështetje nga këto dy programe janë: mbështetje për sektorin e ekonomisë për të përballuar pasojat e COVID-19 (IPA 2020) respektimi i së drejtës së pronës, mirëqeverisja, shteti i së drejtës, përfshirja sociale

me qëllim rritjen e punësimit (IPA 2019), ku rreth 50 milionë euro janë dedikuar lehtësimit të pasojave të COVID-19.

Gjatë vitit 2020, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka finalizuar procedurat e brendshme për modifikimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me Programin Vjetor Kombëtar për Shqipërinë për vitin 2017, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para- Anëtarësimit (IPA II). Ndryshimet në Marrëveshjen Financiare 2017 kryhen brenda dokumentit të veprimit “Instrumenti Lehtësues për Integrimin Evropian” në Programin Vjetor Kombëtar IPA 2017. Ky modifikim erdhi si rezultat i domosdoshmërisë për mbështetje për sektorin e shëndetësisë për t’i ardhur në ndihmë vendit tonë për të parandaluar përshkallëzimin e papritur të infeksioneve nga koronavirusi të shkaktuara nga pandemia globale COVID-19. Si pjesë e kësaj mbështetjeje është parashikuar një fond prej afro 4 milionë euro për pajisje dhe ndihmë shëndetësore të menjëhershme me qëllim që të mbështesë Shqipërinë në luftën kundër koronavirusit. Marrëveshja midis DBE dhe UNOPS për të vënë në lëvizje blerjen e pajisjeve mjekësore për spitalet shqiptare është nënshkruar në datën 2 prill 2020.

Për sa i përket programimit të IPA-s kombëtare, në kuadër të përgatitjeve për instrumentin e ri financiar IPA III Shërbimet e Komisionit Evropian i kanë kërkuar KKIPA–ve të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë të nisin përgatitjen për hartimin e dokumenteve strategjike dhe kuadrit legjislativ, në funksion të programimit dhe zbatimit të instrumentit të ri financiar IPA III, e cila do të mbulojë periudhën e viteve 2021–2027. Mbështetja financiare parashikohet që të ketë një buxhet prej 14,5 miliardë euro në total (indikative), për të gjithë vendet e rajonit, duke përfshirë edhe Turqinë.

Në kuadër të këtij procesi, në mungesë të një modeli të Përgjigjes Strategjike Kombëtare, Sektori i Programimit të IPA-s Kombëtare (ZM KKIPA) nën mbështetjen e stafit të asistencës teknike “Mbështetje për menaxhimi e fondeve IPA”, në bashkëpunim me Zyrën e KM (Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisjes), Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Tiranë, kanë diskutuar dhe



dakordësuar mbi përgatitjen e metodologjisë së Përgjigjes Strategjike të IPA III. Procesi i programimit të IPA III bazohet në një parim kryesor, përafrim me sistemin e ekzistues të planifikimit strategjik dhe programimit me strukturat dhe mekanizmat ekzistues të vendit. Kuadri sektorial i IPA III dhe strukturat e ndërlidhura, përcaktojnë si trupa konsultues institucionet lider të secilit prej 9 dokumenteve të Përgjigjes Strategjike Sektoriale dhe të IPMG-ve përkatëse. Mbështetja financiare nën IPA III është ideuar të jetë e ndarë në 5 dritare: i. Shteti i së drejtës, të drejtat themelore dhe demokracia; ii. Mirëqeverisja dhe përafrimi i *acquis*, komunikim strategjik dhe marrëdhëniet e mira me fqinjët; iii. Marrëveshja e gjelbër dhe konektiviteti i qëndrueshëm; iv. Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse; v. Bashkëpunimi territorial dhe ndërkufitar.

Institucionet shqiptare kanë finalizuar dhe përcjellë pranë ZM KKIPA një paketë prej 53 AF, të cilat janë dërguar pranë Delegacionit të BE-së në shtator 2020. AF-të fokusohen në nevojat imediate për mbështetje me fondet IPA, duke pasur parasysh llojin e ndërhyrjeve që plotësojnë kushtet, kryesisht ndërhyrje *soft*, me ndërhyrje *hard* për mbështetje të mëtejshme nga WBIF, nevojat për të përfshirë veprime që mund të lehtësojnë problemet e shkaktuara nga COVID-19 dhe gjithashtu nevojat për të paraqitur një portofol të balancuar sikurse sugjerohet nga DBE, me qëllim që të rritet shansi për Shqipërinë për të përfituar sa më shumë fonde IPA III.

Spektori i Programimit të Mbështetjes Kombëtare në bashkëpunim me Asistencën Teknike ka përgatitur draft modelin e SSR-së së rishikuar dhe e ka përcjellë për komente pranë Departamentit për Zhvillim dhe Mirëqeverisje në KM. Ndërkohë, ZM KKIPA po vijon punën për hartimin e Përgjigjes Strategjike Kombëtare, në funksion të përmbushjes së afatit të rishikuar të Komisionit, i cili mendohej të ishte mes nëntori i 2020, (informacione jozyrtare nga Komisioni Evropian).

Lista e Vetme e Projekteve Kombëtare (NSPP) 2020 u miratua më 30 korrik 2020 nga Këshilli Kombëtar i Investimeve (NIC)/Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS), që është organi vendimmarrës, i kryesuar nga Kryeministri. Ndërkohë është në proces përgatitja e

metodologjisë së NSPP-së për standardizimin, formatet dhe procedurat duke synuar përmirësimin e përgjithshëm të përgatitjes së listës së vetme sektoriale dhe të Listës së Vetme të Projekteve Kombëtare (NSPP) dhe cilësinë e paketave të dokumenteve të kësaj liste. Rritja e cilësisë së kësaj liste dhe prioritizimit dhe përgatitjes së projekteve i përgjigjet rëndësisë në rritje të Instrumentit të Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF). Sikurse specifikuar edhe në Strategjinë e BE-së të Zgjerimit të Ballkanit Perëndimor, të datës 6 shkurt 2018, Instrumenti i Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF) do të jetë gjithmonë e më tepër instrumenti kryesor për investimet në rajon. Në këtë kuadër, WBIF po zhvillohet dhe pëson ndryshime (WBIF 3.0) në mënyrë që të përshtatet edhe me perspektivën e re financiare 2021–2027, si dhe me IPA III.

Nëpërmjet hartimit dhe miratimit nga Këshilli Kombëtar i Investimeve (NIC)/Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS) më 15 korrik 2020 i Deklaratës së Politikave Prioritare 2021–2023 është siguruar lidhja e Listës së Vetme të Projekteve Kombëtare (NSPP) me Planin e Buxhetit Afatmesëm (PBA).

Monitorimi i asistencës IPA realizohet nga Drejtoria e Koordinimit të Programeve Kombëtare (zyra mbështetëse e KKIPA), e cila në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Evropian monitoron implementimin e projekteve/ programeve nën menaxhim direkt dhe indirekt, progresin drejt arritjes së objektivave dhe rezultateve të synuara, sigurimin e qëndrueshmërisë së investimeve IPA në Shqipëri etj.

Për kryerjen e funksionit të Monitorimit, strukturat përkatëse mbështeten në Marrëveshjen Kuadër dhe legjislacionin vendës për implementimin e fondeve të BE-së IPA I (2007–2013) dhe IPA II (2014–2020), marrëveshjet ndër institucionale të zbatimit dhe manualët e procedurave. Manualët e procedurave të Zyrës Mbështetëse të KKIPA për Monitorimin, Raportimin dhe Vlerësimin rishikohen/përditësohen çdo vit.

Gjatë vitit 2020, edhe në procesin e Monitorimit dhe Vlerësimit të fondeve IPA u vërejtën vonesa ose devijime për shkak të situatës së pandemisë, të tilla si vonesa në kontraktimin e Vlerësuesve për Vlerësimin Interim, anulimin e takimeve të Komiteteve Sektoriale të Monitorimit dhe mbajtjen



e tyre nëpërmjet procedurës së shkruar, ulja e ritmit të aktivitetëve për forcimin e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e fondeve IPA dhe konsolidimin institucional, marrja e masave për zëvendësimin me metodën *online* të zhvillimit të trajnimeve e takimeve konsultative në gjysmën e dytë të vitit etj.

Megjithatë, Shqipëria synon të forcojë më tej kapacitetet e saj lidhur me menaxhimin e IPA-s si pjesë e përgatitjeve për anëtarësimin në BE. Kjo është në përputhje me rekomandimin e Raportit të KE-së të vitit 2020 për Shqipërinë që bëri thirrje për forcimin e kapaciteteve administrative, veçanërisht të Njësisë Qendrore të Financimeve dhe Kontraktimeve (CFCU) të Ministrisë së Financave, Zyrës për Mbështetje të Zyrtarëve Kombëtar të Autorizuar dhe Autoritetit të Auditimit dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Në kuadër të **Bashkëpunimit Territorial**, Shqipëria merr pjesë në 8 Programe Ndërkufitare dhe Transnacionale nën perspektivën IPA II 2014–2020, koordinimi dhe zbatimi i të cilave kryhet nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe konkretisht Struktura Operuese në Drejtorinë e Bashkëpunimit Territorial. Në këtë aspekt janë ngritur dhe funksionojnë të gjitha strukturat e përfshira në zbatimin e Programeve të Bashkëpunimit Territorial, si: zyrat e Kontrollit të Nivelit të Parë (FLC), Sekretariatet e Përbashkëta, Antenat, Pikat e Informimit etj. Drejtuesi i Strukturës Operuese është caktuar me urdhrin e Ministrit në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme/KKIPA nr. 432, datë 16.9.2018.

Gjithashtu, MEPJ ka ndjekur procesin e nënshkrimit të marrëveshjeve përkatëse të financimit (alokimet përkatëse vjetore) për programet e Bashkëpunimit Ndërkufitar, konkretisht: Programi IPA CBC Mali i Zi-Shqipëri, Programi IPA CBC Maqedoni e Veriut-Shqipëri dhe Programi IPA CBC Shqipëri-Kosovë.

Gjatë vitit 2020 janë shpallur disa thirrje për projekt propozime ku vihet re një numër i lartë i aplikantëve nga Shqipëria, çka tregon një rritje të interesit nga ana e tyre për të përfutur nga fondet e BE-së. Sfidat kryesore në zbatimin e projekteve të bashkëpunimit ndërkufitar nga ana e institucioneve dhe organizatave shqiptare mbetet rimbursimi i kostove të TVSH dhe sigurimi i kuotës së bashkëfinancimit (15% e vlerës së projektit).

Gjithashtu, një problematikë tjetër lidhet edhe me rregullat dhe procedurat e tejzgjatura dhe burokratike që ndiqen nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për hapjen e llogarive bankare të projekteve dhe transferimin e fondeve midis partnerëve, të cilat mbajnë pezull zbatimin e aktivitetëve të projekteve.

Gjatë kësaj periudhe, ka nisur procesi për përgatitjen e hartimin e programeve të reja të bashkëpunimit territorial për Perspektivën e III të Instrumentit të Para- Anëtarësimit IPA. Strukturat Operuese në bashkëpunim të ngushtë me strukturat homologe, të vendeve fqinje, po koordinojnë procedurat për hartimin e programeve të reja IPA III.

Gjithashtu, Shqipëria ka intensifikuar pjesëmarrjen e saj në Strategjinë e BE për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR), duke kontribuar në zbatimin e saj, sidomos në kuadër të identifikimit të masave dhe projekt-ideve me karakter rajonal.

22.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Në kuadër të priorizimit të politikave afatmesme, si një fazë parapërgatitore për SKZHI 2030, është përgatitur dhe miratuar Dokumenti i Politikave Prioritare 2021- 2023, i cili siguron edhe buxhetimin e prioriteteve dhe përcaktimin e tavanëve të PBA-së në terma afatmesëm. Dokumenti i Politikave Prioritare hartohet bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave lidhur me miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike edhe VKM nr. 185, datë 29.3.2019, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”. Dokumenti i Politikave Prioritare (DPP) përgatitet nga Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje, në Kryeministri, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me qëllim ndikimin në procesin e shpërndarjes së burimeve midis sektorëve. Për vitin 2020, DPP është diskutuar nga Komiteti i Planifikimit Strategjik, kryesuar nga Kryeministri, në fazën e diskutimit të prioriteteve strategjike të buxhetit në shkurt dhe në korrik dhe është miratuar në mbledhjen e KPS në korrik 2020.

Analiza e Dokumentit mbi Politikat Prioritare bazohet në analizën e kryer mbi:

- prioritete e përcaktuara në SKZHI 2020, si edhe dokumentet e kuadrit strategjik të vendit për sektorët/politikat, të miratuara me VKM:



- prioritetet e përcaktuara nga ministritë e linjës dhe Kryeministrit, të bazuara në Programin e Qeverisë së miratuar;

- si edhe projektet prioritare strategjike të ministrive të linjës, pjesë e Paketës Kombëtare e Projekteve Strategjike (PKPS), miratuar në Komitetin e Planifikimit Strategjik.

Dokumenti i Politikave Prioritare (DPP) diskutohet dhe miratohet në Komitetin e Planifikimit Strategjik dhe përbën një fazë të ndërmjetme përpara përcaktimit të taveve buxhetore për Planifikimin Buxhetor Afatmesëm, si edhe për përgatitjen e draftit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021- 2030. Procesi i hartimit të draftit SKZHI do të vijojë me miratimin e metodologjisë e hartuar për përgatitjen e SKZHI 2021–2030, si edhe në zbatimin e metodologjisë. Procesi për përgatitjen e SKZHI 2021–2030 bazohet në parimin e funksionimit të plotë të gjithë mekanizmave dhe proceseve aktuale të lidhura me Sistemin e Planifikimit të Integruar. Përgatitja e draftit të konsoliduar për SKZHI 2021–2030 është parashikuar të kryhet brenda vitit 2021.

Ligji për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin u miratua në Korrik 2020 (ligji nr. 102/2020). Ky ligj përcakton parimet bazë, objektivat, përgjegjësitë, rregullat e zhvillimit rajonal dhe kohezionit, si dhe kuadrin institucional e strategjik të këtij zhvillimi në Republikën e Shqipërisë. Sipas këtij ligji, zhvillimi rajonal zbatohet në përputhje me parimin e partneritetit, subsidiaritetit, qëndrueshmërisë, planifikimit, programimit, transparencës, përqendrimit dhe koordinimit. Ligji për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin synon:

a) të përcaktojë instrumentet e posaçme dhe kuadrin institucional e financiar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin në Republikën e Shqipërisë;

b) të përcaktojë kuadrin strategjik dhe institucional të hartimit të politikave afatgjata zhvillimore rajonale në zbatim të politikave kombëtare, duke siguruar nxitjen e zhvillimit të balancuar ekonomik, shoqëror e kulturor rajonal;

c) të sigurojë që autoritetet politikëbërëse të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre planifikuese për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të rajoneve;

d) të sigurojë harmonizimin e strategjive sektoriale në një politikë të përbashkët zhvillimore

rajonale, duke e mbështetur atë edhe me buxhetin përkatës.

Gjatë vitit 2020 janë finalizuar programet Vjetore IPA 2019 dhe 2020. Bazuar në kalendarin programues për të dyja programet, paketat janë miratuar nga Komiteti IPA në Bruksel, ndërkohë që IPA 2019 pritet të nënshkruhet brenda muajit dhjetor, ndërsa IPA 2020 parashikohet të nënshkruhet brenda 6-mujorit të parë të vitit 2021.

Si rezultat i situatës së shkaktuar nga pandemia globale COVID-19, ZM KKIPA është duke koordinuar një proces të dytë, i cili lidhet me rialokimin e 46 milionë euro të tjera, të cilat do të mund të përfitohen nga fondet e IPA kombëtare për vitet 2019 dhe 2020 si më poshtë:

Nga fondet IPA 2019, do të fuqizohet ndërhyrja për Programin “BE për Përfshirjen Sociale”, nëpërmjet atashimit të fondeve të Programit “BE për Ekonominë Qarkulluese”, me qëllim forcimin e kuadrit social të programit për mbështetjen sociale. Shuma prej 20.65 milionë EUR do t’i bashkëlidhet shumës prej 50 milionë eurosh kontribut i BE-së për aktivitete në mbështetje të punësimit dhe përfshirjes sociale.

Nga fondet IPA 2020, e cila do të ndahet në dy pjesë për shkak të fondeve shtesë që ka përfituar Shqipëria si Shpërblimi i Performancës (*Performance Reward*), mënyra e rialokimeve të fondeve do të kryhet si më poshtë vijon:

Dokumenti i Veprimit “BE për të drejtat e Pronësisë - IPA 2020, do të reduktohet në shifrën prej 5.7 milionë eurosh, nga 15.7 milionë euro që ishte programuar fillimisht. Gjithashtu, nga dokumenti i veprimit “BE për shtetin e së drejtës”, shuma prej 10 milionë euro e dedikuar për Euralius dhe Pameca, do të reduktohet në 5 milionë euro. Këto 2 reduktime së bashku me 11 milionë euro nga paketa e Shpërblimit të Performancës do të shkojnë për financimin e një Programi të paprogramuar më parë (Mbështetje Buxhetore Sektoriale) dedikuar sektorit privat dhe rimëkëmbjes së ekonomisë, me një shumë totale prej 26 milionë eurosh në total.

Për sa i përket IPA 2020 Shpërblimi i Performancës, për Shqipërinë është alokuar një shumë prej 28 milionë eurosh, e cila, pas situatës së pandemisë, do të programohet, për i. 11 milionë euro për Programin e ri të Mbështetjes Buxhetore orientuar në biznesin privat dhe rimëkëmbjen e ekonomisë; ii. 8.5 milionë euro vijueshmëria për



vettingun, iii. 9.5 milionë euro për instrumentin lehtësues për integrimin evropian (pjesë e të cilave do të shkojë për të mbështetur aktivitetet e IPA 2017, të cilat u rialokuan për nevojat emergjente në sistemin mjekësor) në përballimin e krizës që shkaktoi COVID-19.

Referuar përgatitjes për instrumentin e ri financiar IPA III (2021–2027), gjatë periudhës 5–14 Shkurt 2020, ZM KKIPA ka organizuar 9 *workshope* sektoriale, të cilat synonin të ndihmonin institucionet lider dhe aktorët e tjerë kontribuues, në njohjen dhe hartimin e Përgjigjes Strategjike Sektoriale (SSR). Në *workshop*-et e organizuara nga ZM KKIPA morën pjesë rreth 230 nëpunës civil, të cilët dhanë kontributin në hartimin e pjesës së parë të SSR-ve. Gjatë muajve mars–prill 2020, ZM KKIPA ka marrë draftin e parë të dokumenteve Strategjike Sektoriale nga ministritë përfituese dhe ka përcjellë komentet përkatëse me qëllim përmirësimin e cilësisë së tyre.

Nga Shërbimet e Komisionit Evropian, në fund të muajit prill 2020, të gjithë KKIPA-të e rajonit janë informuar zyrtarisht lidhur me kalendarin e programimit për IPA 2021, 2022, si dhe me rëndësinë e hartimit dhe dërgimit të fishave të veprimit brenda muajit qershor 2020 pranë Komisionit Evropian. Në këtë kuadër, në datat 11–23 maj 2020, janë organizuar disa takime virtuale midis Sektorit të Programimit të IPA Kombëtare dhe institucionet lider për fushat potenciale që do të marrin mbështetje nga fondet IPA III. Në vijim të procesit programues, KKIPA i ka përcjellë DBE-së, në shtator 2020, një listë me 53 fisha veprimi që institucionet potenciale përfituese kanë përgatitur duke pasur parasysh parimin e maturimit dhe prioritizimit.

Bazuar në VKM-në nr. 185, datë 29.3.2018, “Për procedurat e administrimit të investimeve publike” dhe VKM nr. 52, datë 6.2.2019, “Për miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2019”, Komiteti i Planifikimit Strategjik/Këshilli Kombëtar i Investimeve miratoi në 15 Korrik 2020, Deklaratën e Politikave Prioritare (DPP) 2021–2023, e cila përfshin projektet strategjike, pjesë e Listës së Vetme të Projekteve Kombëtare (NSPP), që do të jene pjesë e Buxhetit të vitit 2020 dhe Planin Buxhetor Afatmesëm 2021–2023 (PBA). Deklarata e Politikave Prioritare (DPP) 2021–2023, do të

rishikohet çdo vit në të njëjtën linjë me procedurën e hartimit të PBA-së.

SRC-ja për Luftën kundër Korrupsionit - Kërkesa për disbursim për transhin e radhës në shumën 2,700,000 nga 3 milionë Euro të parashikuara iu dorëzua DBE-së në Qershor 2020 për përmbushjen e 4 nga 5 indikatorët e kërkuar për disbursimin, si dhe plotësimin e pjesshëm të njërit prej indikatorëve.

SRC-ja për Drejtësinë - Kërkesa për disbursimin e transhit të dytë fiks dhe transhit të parë variabël iu dërgua DBE-së në tetor 2020 për shumën 3 milionë Euro (shuma fikse) dhe 4,583,331 Euro nga 5 milionë të mundshme, për përmbushjen e 5 indikatorëve nga 7, dhe përmbushjen e pjesshme të dy indikatorëve.

SRC-ja për Transport me fokus Rrugët - Kërkesa për disbursimin e transhit të dytë variabël iu paraqit DBE-së në Korrik 2020 në shumën 3,750,000 Euro nga 5 milionë Euro të parashikuara, për përmbushjen e 6 indikatorëve. Vetëm dy nga indikatorët nuk janë përmbushur sipas vetëvlerësimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Kontrata për Reformën në Administratën Publike - Kërkesa për disbursimin e transhit të tretë variabël iu dërgua DBE-së në tetor 2020, për shumën 5,6 milionë Euro. Marrëveshja financiare u amendua gjatë vitit 2020 e cila rezultoi në rialokimin e tri indikatorëve dhe shtyrjen e vlerësimit për dy të tjerë gjatë vitit 2021. Kështu kërkesa i referohet vetëm 5 indikatorëve të plotësuar me vlerë 1,120,000 Euro secili.

Kontrata për reformën Sektoriale të Përfshirjes Sociale, nënshkruar në Shtator 2020 me një shumë të përgjithshme 50,65 milionë Euro. Kërkesa për disbursimin e transhit të parë fiks të kësaj kontrate iu dërgua DBE-së në tetor 2020 për shumën 15,650,000 Euro.

Shtatë Komitete të Monitorimit Sektorial, të ngritura për herë të parë në vitin 2019, janë tashmë plotësisht funksionale, me takime të organizuara sipas sektorëve përkatës, dy herë në vit.

Për herë të parë në 2019, filluan përgatitjet për kryerjen e një Vlerësimi të zbatimit të projekteve gjatë fazës së implementimit të tyre (*Interim Evaluation*). Ushtrimi i Vlerësimit parashikohet të fillojë gjatë vitit 2020, menjëherë pas kontraktimit të Vlerësuesve të jashtëm që do të zgjidhen për të kryer këtë proces.



Deri në tetor 2020, në kuadër të projektit të asistencës teknike “Mbështetje për Menaxhimin e IPAs”, 73 nëpunës civile ndoqën trajnimet mbi Monitorimin dhe Raportimin e asistencës IPA.

Në lidhje me **bashkëpunimin territorial**, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka mbyllur me sukses procesin e nënshkrimit të marrëveshjeve përkatëse të financimit (alokimet përkatëse vjetore) për të gjitha programet IPA të Bashkëpunimit Ndërkufitar.

Gjatë vitit 2020 janë shpallur disa thirrje për projekt propozime ku ka vijuar numri në rritje i aplikantëve shqiptarë, çka tregon një rritje e interesit nga ana e tyre për të përfituar nga fondet e BE-së. Sfidat kryesore në zbatimin e projekteve të bashkëpunimit ndërkufitar nga ana e institucioneve dhe organizatave shqiptare mbetet rimbursimi i kostove të TVSH dhe sigurimi i kuotës së bashkëfinancimit (15% e vlerës së projektit). Nisur nga këto problematika, janë zhvilluar një sërë takimesh me Drejtorinë e Analizës dhe Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me qëllim gjetjen e një mekanizmi për të lehtësuar implementimin e këtyre projekteve. Në Mars 2020 u dakordësua ngritja e një fondi të dedikuar dhe të menaxhuar nga MFE, si një mekanizëm që do të siguroj mbështetje nëpërmjet financimit afatshkurtër për realizimin e aktiviteteve dhe përmbushjen e detyrimeve nga autoritetet publike kombëtare, rajonale ose vendore përfituese të projekteve të financuara në kuadër të Programeve të Bashkëpunimit Territorial. Me hyrjen në fuqi të këtij mekanizmi, mendohet që problematika e bashkëfinancimit do të zgjidhet.

Në kuadër të procesit për përgatitjen e programeve të reja të Bashkëpunimit Territorial për Perspektivën e III-të të Instrumentit të Para-Aderimit IPA, Drejtoria e Bashkëpunimit Territorial të MEPJ, në rolin e strukturës operuese dhe koordinuese të këtij procesi, ka finalizuar ngritjen e Task-Forcës (TF) në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar respektivisht për programet IPA bilaterale dhe ato transnacionale, si një ndër hapat kryesorë të programimit për periudhën 2021 në VKM nr. 2027.

Këto task-forca, në rastin e programeve bilaterale IPA BNK, përbëhen nga përfaqësues të nivelit të lartë të Ministrive të linjës, AMSHC-së dhe Këshillave të Qarqeve të zonave aktuale të secilit program bilateral ku vendi ynë merr pjesë. Faqe | 4146

Gjithashtu është ngritur Task-Forca e programeve transnacionale dhe atij trilateral, të përbëra nga anëtarët e secilit vend partner të këtyre programeve dhe nga pala shqiptare, nga zyrtarët e programit specifik si dhe përgjegjësi i sektorit të programimit, të Drejtorisë së Bashkëpunimit Territorial të MEPJ, të cilët koordinojnë këto programe në nivelin kombëtar. Në këtë kontekst, janë organizuar një sërë takimesh me grupet e TF me qëllimin kryesor, ndër të tjera, atë të identifikimit të prioritetëve më relevante për vendin tonë si dhe përcaktimin e shtrirjes së re gjeografike. Brenda vitit 2020, programet e reja bilaterale 2021- 2027 do të draftohen dhe dërgohen për miratim pranë Komisionit Evropian.

Procesi i programimit merr një rëndësi të veçantë për programimin e IPA BNK Shqipëri – Kosovë, ku Shqipëria është vendi lider (programi i vetëm ku vendi ynë ka rolin e liderit). Drafti i parë i programit po përgatitet në bashkëpunim me Delegacionin e BE-së në Tiranë, si dhe dy strukturat operuese të këtij programi IPA BNK, si dhe me asistencën e ekspertëve të kontraktuar nga Komisioni Evropian.

22.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Zyra e Kryeministrit;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- INSTAT;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Agjencia e Auditimit për Programet e Ndihmës së Akredituar në BE;
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

22.7 Prioritetet

Prioritetet në Kapitullin 22 janë në përputhje me rekomandimet e shërbimeve të Komisionit Evropian siç janë paraqitur në Raportin e Komisionit Evropian të vitit 2019 për Shqipërinë. Këto prioritetet janë:

-të forcojë aftësitë dhe kapacitetet administrative, veçanërisht Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve (CFCU) e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Zyra Mbështetëse e Zyrtarit Kombëtar Autorizues, Autoriteti i Auditimit, si dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;

-të përshpejtojë përgatitjen e dokumentacionit të projekteve për të shmangur vonesat në përdorimin



e fondeve të BE-së dhe vështirësitë në përmbushjen e afateve kontraktuese, siç vërehet në programet për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016;

-të rrisë aftësinë e programimit në përputhje me qasjen sektoriale dhe politikat sektoriale, dhe të përmirësojë hartimin dhe maturimin e Listës së Vetme të Projekteve Kombëtare (NSPP);

-të forcohen aftësitë përthithëse të institucioneve dhe organizatave shqiptare nga programet e ndryshme të BE-së.

KAPITULLI 23 GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE

23.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli 23 është një kapitull thelbësor në procesin e stabilizim-asociimit dhe mbart një rëndësi të veçantë gjatë negociatave për anëtarësim, Ky kapitull mbulon tri fusha të rëndësishme, sistemin gjyqësor, politikat kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore.

Më konkretisht, Politikat e BE-së në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore, të cilat synojnë të ruajnë dhe zhvillojnë më tej Bashkimin Evropian si një fushë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Krijimi i një gjyqësori të pavarur dhe efikas ka një rëndësi të madhe. Paanshmëria, integriteti dhe standardi i lartë i gjyqimit nga ana e gjykatave janë thelbësore për ruajtjen e sundimit të ligjit. Kjo kërkon një angazhim të fortë për ndikimet e jashtme mbi gjyqësorin dhe për t'i përkushtuar burime të mjaftueshme financiare dhe trajnime. Me rëndësi të veçantë janë dhe krijimi i garancive ligjore për procedurat e një gjykimi të drejtë. Po kështu, Shtetet Anëtare duhet të luftojnë korrupsionin në mënyrë efektive, pasi kjo paraqet një kërcënim për stabilitetin e institucioneve demokratike dhe sundimin e ligjit. Një kuadër i fortë ligjor dhe institucione të besueshme janë të nevojshme për të mbështetur një politikë koherente për parandalimin e korrupsionit. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë respektin për të drejtat themelore dhe të drejtat e qytetarëve të BE-së, siç garantohet nga *acquis* dhe nga Karta e të Drejtave Themelore.³²

Këto parime janë përkthyer në një kuadër ligjor të Bashkimit Evropian që përcakton të drejtat dhe detyrimet e Shteteve Anëtare të tij dhe gjithashtu të atyre vendeve candidate që synojnë të jenë shtete anëtare të BE-së. Prandaj është e domosdoshme për secilin vend kandidat që synon të bëhet një shtet anëtar i BE-së për të njohur dhe përafruar *acquis* e BE-së që mbulon kapitullin 23. Më konkretisht neni 2 i Traktatit për Bashkimin Evropian (TBE) parashikon që Bashkimi themelohet nga parimet e dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Neni 3 (2) i TBE dhe neni 67 (1) i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) kanë krijuar zonën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.

Përveç kësaj, Shtetet Anëtare duhet të luftojnë korrupsionin në mënyrë efektive pasi paraqet një kërcënim për stabilitetin e institucioneve demokratike dhe për sundimin e ligjit. Neni 83 (1) i TFBE përcakton kompetencën e BE-së për të hartuar rregulla minimale në lidhje me përcaktimin e veprave penale dhe sanksioneve në fushën e korrupsionit. Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave themelore është i domosdoshëm. Sipas nenit 6 të TBE-së dhe jurisprudencës së Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJDBE), BE respekton të drejtat themelore, të garantuara në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian siç rezulton nga traditat kushtetuese të përbashkëta për Shtetet Anëtare, si parime të përgjithshme të së drejtës së BE-së. Kështu, ato janë të detyrueshme për institucionet e Bashkimit në ushtrimin e kompetencave të tyre dhe për Shtetet Anëtare kur zbatojnë të drejtën e BE-së (neni 51 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian).

23.2 Struktura e kapitullit

Tri shtyllat kryesore për reformat në këtë kapitull janë:

1. Sistemi gjyqësor;
2. Lufta kundër korrupsionit;
3. Përmirësimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore.

Të tria këto shtylla janë të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të ndërsjellë me njëra-tjetrën.

23.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Përafrimi i parimeve dhe *acquis* të BE-së për kapitullin 23 përbëjnë një detyrim që rrjedh nga

³² https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/conditions-membership/chapters-of-the-acquis_en



Marrëveshja e Stabilizim-asociimit BE-Shqipëri. Në veçanti, nenet 1, 2, 13, 70 dhe 78 të MSA-së janë të një rëndësie të madhe për këtë kapitull. Sipas nenit 78 të MSA-së, një rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet forcimit të sundimit të ligjit dhe forcimit të institucioneve në të gjitha nivelet në fushën e administratës në përgjithësi, si dhe të zbatimit të ligjit dhe administrimit të drejtësisë. Përveç kësaj, neni 78 i MSA-së përcakton se bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian duhet të synojë forcimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe përmirësimin e efektivitetit të tij, përmirësimin e funksionimit të organeve të policisë dhe të zbatimit të ligjit duke siguruar trajnime të përshtatshme si dhe duke luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Gjithashtu, përafrimi me *acquis* dhe standardet e BE-së për kapitullin 23 është një nga kërkesat që vendi kandidat në BE duhet të zbatojë gjatë procesit të negociatave për aderim në BE.

Lidhur me përafrimin e legjislacionit të BE në legjislacionin e brendshëm, duhet theksuar se *acquis* i transpozueshëm ndahet në *hard acquis* (*acquis* që buron nga aktet me efekt detyrues siç janë traktatet, direktivat, rregulloret etj. të BE-së) dhe *soft acquis* (*acquis* që buron nga, standardet, parimet e rekomandimet e institucioneve të BE-së apo organizatave të tjera ndërkombëtare relevante). Analiza paraprake ka vlerësuar totalin e *hard acquis*, i cili përbëhet nga 61 akte, ndërsa *soft acquis* përbëhet nga 65 akte³³.

23.4 Situata aktuale në Shqipëri

Reforma në Drejtësi

Reforma e sistemit të drejtësisë në Shqipëri është reforma më gjithëpërfshirëse e kryer në vend në 30 vitet e fundit. Qeveria shqiptare e konsideron reformën në drejtësi ndër prioritetet e saj më të larta dhe si një çështje me rëndësi të madhe për integrimin e vendit në BE. Arsyeja themelore e ndërmarrjes së reformës ishte adresimi i çështjeve të ndryshme shqetësuese në lidhje me mosfunksionimin e gjyqësorit në Shqipëri, të tilla si:

- Korrupsioni endemik;

- Mungesa e pavarësisë së institucioneve gjyqësore, Prokurorisë, si dhe organeve drejtuese gjyqësore;

- Mungesa e integritetit, profesionalizmit dhe llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve;

- Mungesa e efikasitetit dhe transparencës në funksionimin e sistemit.

Vizioni kryesor i reformës ishte rikthimi i besimit të gjyqësori, përmes një procesi të thelluar ndryshimesh kushtetuese, ligjore dhe institucionale. Pikërisht për këtë qëllim, në korrik të 2016, Kushtetuta u ndryshua për të adresuar secilën prej çështjeve të lartpërmendura që pengojnë procesin e dhënies së drejtësisë dhe sigurimin e mbrojtjes së duhur të të drejtave themelore të qytetarëve. Dispozitat kushtetuese u krijuan si të tilla për të shmangur çdo ndikim politik në sistemin e emërimit për gjyqtarët dhe prokurorët, për të parandaluar bllokimet institucionale në procedurat e emërimit të gjyqtarëve të gjykatave më të larta të vendit, si dhe për të siguruar integritetin, llogaridhënien dhe efikasitetin në dhënien e drejtësisë.

Bazuar në amendamentet kushtetuese të miratuara në kuadrin e reformës në drejtësi në vitin 2016, është kryer një punë intensive legislative, duke përfshirë:

- Miratimin e 7 ligjeve themelore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjyqësorit, Prokurorisë dhe institucioneve të qeverisjes së drejtësisë;

- Ndryshimet e miratuara në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, ligjin për gjykatat administrative;

- Miratimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit;

- 30 ligje të tjera janë miratuar ose janë në proces miratimi si dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë dhe Planit i Veprimit

Nëpërmjet Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2017–2020 dhe Planit të saj të Veprimit³⁴, miratuar me VKM-në nr. 773, datë 2.11.2016, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2017- 2020 dhe Planit të saj të Veprimit”, qeveria shqiptare po ndjek zbatimin e reformës të përgjithshme të sistemit gjyqësor shqiptar.

³³ Pas një analize të përgjithshme të nivelit të harmonizimit për Kapitullin 23, ku janë hartuar 39 draft ToCs me 2374 faqe, duke përfshirë krahasimin me rreth 60 akte ligjore dhe nënligjore kombëtare rezultoi se 66% e akteve janë pjesërisht të harmonizuara, 25% nuk janë harmonizuara dhe 9% është vlerësuar si jorelevantë për harmonizim në këtë moment.



Në kuadër të thellimit të angazhimit të zbatimit të Reformës në Drejtësi dhe reflektimin e saj në zbatimin e Planit të Veprimit, Ministria e Drejtësisë ka rishikuar Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, për periudhën 2019–2021. Për këtë qëllim, u hartua Pasaporta e Indikatorëve, në funksion të objektivave të strategjisë. Në qershor 2019, Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 409, datë 19.6.2019 ka miratuar Planin e Veprimit 2019–2021 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë. Plani i Veprimit 2019–2021 përbëhet nga: 8 objektiva strategjike, 11 indikatorë nga Pasaporta e Indikatorëve, 7 indikatorë transhe të Bashkimit Evropian, dhe 65 masa. Raporti i monitorimit³⁴ të PV 2019–2021, që mbulon progresin gjatë periudhës 1 janar–30 qershor 2020, tregon se në këtë periudhë, nga 65 masa të parashikuara në Planin e Veprimit 2019–2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë janë realizuar 18 prej tyre, pra 28 % e totalit të masave të parashikuara, 41 prej tyre janë në proces zbatimi, pra 63% e totalit, dhe 6 masa janë të parealizuar, pra 9% e totalit.

Me qëllim avancimin e objektivave të Reformës në Drejtësi për 5 vitet e ardhme, Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me të gjithë institucionet e reja të drejtësisë dhe asistuar nga ekspertët e Projektit EURALIUS V ka nisur procesin e hartimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025 bazuar në një vizion të qartë për rritjen e efektivitetit të sistemit gjyqësor të reformuar, si dhe përmirësimin e shërbimeve në përputhje me standardet evropiane.

Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut

Në prill të 2019, Kuvendi i Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 47, datë 18.4.2019, Dokumentin Strategjik për Edukimin Ligjor të Publikut, 2019–2023, i cili është një nga “produktet” e paketës së Reformës në Drejtësi, që synon rritjen e ndërgjegjësimit qytetar mbi rëndësinë e zbatimit të ligjit. Instrumenti me të cilin do të jetë e mundur të zbatohet strategjia në vend, është Plani i Veprimit të kësaj Strategjie. Plani i Veprimit për vitet 2021–2023, është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 878, datë 11.11.2020, me qëllim që të

garantojë zbatueshmërinë e këtyre nismave dhe të garantojë ndihmë juridike dhe edukim për publikun e gjerë. Ky Plan është i organizuar në 28 masa konkrete, për të cilat sigurohen 80 aktivitete dhe iniciativa specifike. Ministria e Drejtësisë, ministritë e linjës, institucionet e pavarura, dhe organizatat e tjera janë të ngarkuara me zbatimin e këtij Plan Veprimi dhe përcaktohen si institucione përgjegjëse për zbatimin e tij.

Funksionimi i Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë

Gjykata Kushtetuese që prej 17 dhjetorit 2020 përbëhet nga 5 anëtarë. Lidhur me vakancën e fundit të plotësuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në 14 Dhjetor ka përmbyllur procesin e miratimit të vendimit për pikëzimin dhe renditjen e kandidatit të kualifikuar për pozicionin vakant të shpallur dhe ri-shpallur nga Kuvendi. Në të njëjtën ditë, KED i ka përcjellë këto akte Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në 17 Dhjetor 2020, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë emëroi z. Altin Binaj si anëtar të Gjykatës Kushtetuese.

Lidhur me plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm, sipas parashikimeve ligjore, për ta bërë Gjykatën e Lartë plotësisht funksionale, megjithëse procesi në vetvete ndërlidhet me dinamikën e procesit të vettingut dhe numrin e aplikimeve të paraqitura. Paketa nën- ligjore e hartuar dhe miratuar nga KLGJ i hapi rrugën fillimit të dy proceseve paralele që lidhen me rekrutimin e juristëve të shquar dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve brenda sistemit. KLGJ hapi thirrjen për aplikime nga juristë të shquar si dhe nga vetë sistemi gjyqësor. Në korrik dhe shtator 2019, KLGJ hapi thirrjen për 4 vende të lira për Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të shquar. Këshilli zhvilloi procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për kandidatët e paraqitur dhe në përfundim me datë 5.3.2020, KLGJ i dorëzoi Presidentit të Republikës listën e kandidatëve të propozuar për emërim në Gjykatën e Lartë. Presidenti i Republikës bëri dekretimin e 3 prej tyre, ndërsa për kandidatin e katërt nga radhët e juristëve të shquar është në përfundim procesi i vlerësimit. 3 anëtarët e Gjykatës së Lartë kanë shqyrtuar tashmë 1759 çështje gjyqësore (rekurse).

Paralelisht me procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës së Lartë nga radhët e juristëve të shquar, KLGJ-ja ka shpallur 11 vende

³⁴ <http://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/09/Raporti-i-Monitorimit-janar-qershor-2020-n%C3%AB-zbatim-t%C3%AB-Strategjis%C3%AB-Nd%C3%ABrsektoriale-t%C3%ABDrejt%C3%ABsis%C3%AB29.09.2020.pdf>



të lira nga brenda sistemit gjyqësor (3 në fushën e së drejtës civile, 4 në atë administrative dhe 4 në atë penale) aplikimi për të cilat ka përfunduar në muajin gusht 2020. Aktualisht, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës po verifikon përmbushjen e kriterëve ligjore për kandidaturat e paraqitura. Për ata kandidatë që nuk i janë nënshtruar ende procesit të verifikimit, sipas kërkesës ligjore, KLGJ ka kërkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit që të kryejë me përparësi vlerësimin e pasurisë.

Funksionimi i Gjykatave të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar procesi i emërimeve në gjykatat e tjera të sistemit gjyqësor

Për sa i përket funksionimit të Gjykatave të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, gjatë vitit 2020, KLGJ ka caktuar në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar 5 gjyqtarë dhe në mënyrë të përkohshme 1 gjyqtar, ndërsa në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar janë caktuar në mënyrë të përhershme 4 gjyqtarë, si dhe në mënyrë të përkohshme 6 gjyqtarë. Gjatë këtij procesi janë transferuar edhe 9 gjyqtarë në gjykata të ndryshme (kryesisht për shkak të pezullimit të tyre sipas vendimit të shkarkimit të KPK-së).

Më datë 26 shkurt të vitit 2020 KLGJ hapi thirrjen për plotësimin e vakancave në këto gjykata, afatet e të cilave u pezulluan për shkak të pandemisë globale COVID-19. Situata aktuale e këtyre gjykatave, si rrjedhojë e procesit të *Vettingut*, është si më poshtë:

- Në Gjykatën e Posaçme të Apelit janë vetëm 5 gjyqtarë të emëruar në mënyrë të përhershme nga 11 të parashikuar me ligj. Ndërkohë, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, funksionon me 9 gjyqtarë nga 16 të parashikuar me ligj. Nga këta, 4 gjyqtarë janë të emëruar përkohësisht dhe 5 gjyqtarë janë caktuar në mënyrë të përhershme³⁵. Për shkak të numrit të kufizuar të

aplikimeve, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen plenare të datës 10.9.2020, vendosi rihapjen (për herë të tretë) të procedurës së ngritjes në detyrë në GJKKO, gjithsej për 4 pozicione të lira si dhe rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, gjithsej për 2 pozicione të lira.

Në lidhje me zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 70, datë 7.2.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, përcaktoi rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën për renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për ngritje në detyrë.

Sa i përket procesit të emërimit dhe caktimit në detyrë të magistratëve gjyqtarë dhe prokurorë, KLGJ po vijon ndjekjen e këtij procesi për magistratët gjyqtarë që kanë përfunduar studimet në vitin 2020. Gjithashtu ky proces po ndiqet dhe nga KLP dhe pritet që të përfundojë brenda muajit dhjetor 2020.

Në kuadër të procesit të rekrutimit të magistratëve të rinj, Shkolla e Magistraturës zhvilloi në datat 26.6.2020 dhe 29.6.2020 provimin për kandidatët magistratë dhe këshilltarë/ndihmës ligjorë. Në bazë të rezultateve u shpallën fitues 70 kandidatë magistratë, prej të cilëve 40 në profilin gjyqtar dhe 30 në profilin prokuror, sikurse edhe 14 të tjerë në profilin këshilltarë dhe ndihmës ligjorë. Pas rezultateve, 3 persona (për profilin prokuror) dhanë dorëheqjen dhe rrjedhimisht, për vitin akademik 2020–2021 do të ndjekin Programin e Formimit Fillestar 67 kandidatë. Këta persona do të marrin statusin e kandidatit për magistratë dhe këshilltarë/ndihmës ligjorë pas kryerjes së kontrollit dhe verifikimeve sipas ligjit nga ana e KLGJ-së dhe KLP-së.

Rritja e llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve

Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organ përgjegjës për miratimin e rregullave dhe Kodit të Etikës dhe për monitorimin e tyre, konsideron me prioritet përgatitjen e draftit të parë të standardeve të etikës gjyqësore dhe të rregullave të sjelljes të gjyqtarëve, sipas Ligjit Nr. 115/2016. Me datë 11.10.2019, KLGJ-ja ka caktuar një gjyqtar si këshilltar për etikën.

³⁵ Për të plotësuar pozicionet e lira në këto gjykata të posaçme, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka publikuar thirrjet për 5 vende të lira për secilën nga gjykatat. Në fund të afatit të aplikimit u paraqitën një numër i vogël aplikimesh, përkatësisht: 3 kandidatë kanë aplikuar për 5 pozicione në gjykatën e posaçme të apelit dhe 1 kandidat ka aplikuar për 5 pozicione në gjykatën e posaçme të shkallës së parë. Këshilli ka vendosur fillimin e procedurave të verifikimit të

kritereve ligjore për këta kandidatë me vendimet nr. 152 dhe 153, datë 6.5.2020, nr. 190 dhe 191, datë 4.6.2020.



Në përputhje me objektivin nr. 3 të Planit Strategjik të KLGJ “Sigurimi i mirëfunksionimit të gjykatave, përmes miratimit të rregullave të unifikuara të administrimit të gjykatave”, KLGJ-ja, ka miratuar me datë 14.9.2020 rregulloren për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Kjo rregullore, përcakton rregulla më të detajuara për zhvillimin e procedurave disiplinore të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shqyrtimin e çështjeve që lidhen me procedura disiplinore të zhvilluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj gjyqtarëve të të gjithë niveleve, në funksion të vendosjes së standardeve që garantojnë një sistem gjyqësor sa më profesional dhe etik.

Një tjetër element i rëndësishëm për karrierën e gjyqtarëve është edhe plotësimi i kuadrit nënligjor për krijimin e skemës së vlerësimit etiko-profesional të gjyqtarëve. Në këtë kuadër janë hartuar edhe aktet nënligjore për realizimin e këtij procesi me synim:

- përmirësimin e vazhdueshëm të aspektit etik dhe profesional të gjyqtarëve;
- vendosjen e standardeve të qëndrueshme për cilësinë dhe sasinë e veprimtarisë së gjyqtarëve;
- zhvillimin e karrierës së gjyqtarit bazuar në meritat profesionale, duke identifikuar gjyqtarët që kanë aftësi të veçanta profesionale;
- identifikimin e nevojave për trajnim profesional të gjyqtarëve me qëllim planifikimin efektiv të procesit të trajnimit vazhdues.

Në kuadër të implementimit të plotë të ligjeve të reformës në drejtësi, garantimin e efikasitetit, etikës dhe transparencës, përveç caktimit të një gjyqtari për etikën janë publikuar në faqen zyrtare kriteret dhe metodologjia e emërimit dhe promovimit të gjyqtarëve.

Në kuadër të rritjes së llogaridhënies së gjyqtarëve, tashmë funksionon Inspektori i Lartë i Drejtësisë, institucion i cili ka në kompetencë hetimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha shkallëve. Inspektori i Lartë i Drejtësisë që prej muajit shkurt 2020 ka miratuar 6 vendime për fillimin e hetimit disiplinor. Nga këto hetime disiplinore të kryera janë dërguar 2 kërkesa për procedim disiplinor për një magjistrat gjyqtar dhe një magjistrat prokuror pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Cilësia e drejtësisë dhe eficienta

Lidhur me rritjen e efikasitetit në sistemin gjyqësor, në vijim dhe reflektim të amendimeve në

ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ku u rregulluan kryesisht çështje që kanë të bëjnë me shtesën në pagë për vjetërsi pune, pritët të rritet numri i aplikimeve për gjyqtarë në gjykatat e posaçme.

KLGJ-ja ka realizuar një studim mbi problematikat e sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykata, sipas kategorive të prioriteteve, për t’u mbajtur parasysh për përmirësimin e sistemit. KLGJ, gjithashtu, është duke kryer një studim për zhvillimin e projektit të sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve. Është parashikuar nevoja për resurse financiare, në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë (Misioni EURALIUS V) por kostoja përfundimtare do të përlogaritet në përfundim të miratimit të projektit dhe opsioneve të përzgjedhura. Sistemi i ri pritët të jetë një sistem i unifikuar me mundësinë e bashkëveprimit me sistemet aktuale në përdorim nga institucionet e tjera (Prokuroria, QKB etj.), në përputhje me praktikën dhe me standardet me të mira ndërkombëtare.

Gjithashtu, Grupi Ndërinstitucional i Punës, i përbërë nga përfaqësues nga gjykatat e vendit, KLGJ, Ministria e Drejtësisë dhe partnerë ndërkombëtarë si Këshilli i Evropës, EURALIUS dhe Projekti “Drejtësi për të gjithë” - USAID), bazuar në metodologji dhe standarde ndërkombëtare, pas një analize paraprake, ka përfunduar draftin e hartës së re gjyqësore. Në vijim, dhe pas konsultimeve me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe aktorë të tjerë, draft propozimi do t’i përcillet Këshillit të Ministrave në formën e një projektvendimi. Nisma është planifikuar në katërmujorin e tretë të vitit 2020.

Aktualisht, KLGJ, në bashkëpunim me partnerët e Projektit “Drejtësi për të gjithë” (USAID), ka përfunduar hartimin e Projekt- planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor, nëpërmjet të cilit synohet përcaktimi i bazave për përmirësimin e marrëdhënieve të gjyqësorit me median dhe publikun, të kuptuarit prej publikut të mjeteve dhe mënyrës së komunikimit me gjykatat, të veprimtarisë dhe shërbimeve që ofrohen nga gjykatat, të mënyrës së marrjes së vendimeve dhe kufizimet në punën e gjyqtarëve. KLGJ, me vendimin nr. 280 datë 10.12.2019, ka caktuar 8 gjyqtarët për mediat, në çdo juridiksion apeli.



KL GjJ-ja, në bashkëpunim me Projektin “Drejtësi për të gjithë” (USAID)”, është duke punuar për krijimin e një portali elektronik të unifikuar të sistemit gjyqësor ku KL GjJ dhe të gjitha gjykatat do të kenë faqen e tyre të dedikuar. Ky portal do të mundësojë një transparencë më të mirë të veprimtarisë gjyqësore të gjykatave.

Lidhur me ngarkesën në gjykata, një masë e marrë nga Këshilli për rifunksionimin e Gjykatës së Lartë është miratimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mes KL GjJ dhe Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Aktualisht, 12 operatorë janë angazhuar në uljen e numrit të çështjeve të pazgjidhura dhe po punojnë për të krijuar një inventar të detajuar të pothuajse 35,000 çështjeve të mbetura në këtë gjykatë.

Në lidhje me reduktimin e numrit të çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë, Këshilli në datë 19.12.2019, ka miratuar edhe ngritjen e një komisioni të përkohshëm për hartimin e një plani veprimesh lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar dhe vënë në funksionim një numër aktesh rregullatorë që synojnë përmirësimin e efikasitetit dhe të pavarësisë së gjykatave si skema e delegimit, transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve, caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të veçanta në gjykata të tjera, zgjedhja e zëvendëskryetarëve të gjykatave etj. Kjo edhe në përgjigje ndaj problemeve të evidentuara në lidhje me mungesën e gjyqtarëve, numrin e çështjeve të mbartura dhe procedimeve të zakonshme të gjykatave në nevojë.

Gjithashtu, Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. 160, datë 8.7.2020 ka miratuar Rregulloren për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit. Në kuadër të mirëfunksionimit dhe përmirësimit të punës së prokurorisë, KLP-ja ka organizuar dhe zhvilluar takime të njëpasnjëshme me drejtues të Prokurorisë pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore. Për periudhën janar–korrik 2020, për çështje që lidhen me veprimtarinë e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, KLP-ja ka marrë një sërë vendimesh lidhur me komandimin e përkohshëm të prokurorëve, emërimit të prokurorëve etj.

Lufta kundër korrupsionit

Funksionimi i SPAK-së

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka filluar të ushtrojë funksionet e saj prej datës 19 dhjetor 2019, njëkohësisht me Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Kompetenca e Prokurorisë së Posaçme dhe GJKKO-ja përfshijnë:

- Veprat penale të korrupsionit;
- Veprat penale të kryera në kuadrin e një grupi të strukturuar kriminal, organizatës kriminale, organizatës terroriste dhe bandave të armatosura;
- Akuza penale (pavarësisht nga lloji i veprës penale) kundër disa zyrtarëve të lartë publik, të përcaktuara me ligj.

Prokuroria e Posaçme ushtron funksionet e saj me 13 prokurorë të emëruar në Prokurorinë e Posaçme nga 15 në total. Procesi i përzgjedhjes së 2 (dy) prokurorëve të tjerë është duke vijuar, procedurë e cila varet nga përfundimi i procesit të vetingut për këta kandidatë.

Byroja Kombëtare e Hetimit është në fazën e konstituimit të plotë nëpërmjet finalizimit të plotësimit të strukturës së saj me 60 hetues. Ky proces pritet të përfundojë brenda muajve të parë të 2021.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministria e Drejtësisë, si Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit monitoron periodikisht zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015–2023 dhe Planit të Veprimit 2020–2023 të miratuar me vendimin nr. 516, datë 1.7.2020 të Këshillit të Ministrave, nëpërmjet një strukture monitorimi, planifikimi dhe koordinimi, konkretisht Komiteti Koordinues për Monitorimin e Strategjisë, të kryesuar nga Ministri i Drejtësisë dhe në përbërje të të cilit janë 10 Zëvendësministra.

Në përshtatje me nevojat në rritje të luftës kundër korrupsionit, Ministria e Drejtësisë ka rishikuar Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2020–2023, nëpërmjet një procesi transparent konsultimi, gjatë të cilit janë zhvilluar 24 tryeza pune për diskutimin e masave të Planit të Veprimit, si dhe është kryer procesi i kostimit. Plani i Veprimit është hartuar në përputhje me metodologjinë e hartimit të



dokumenteve sektoriale dhe ndërsektoriale të agjendës së mirëqeverisjes. Ky Plan Veprimi u miratua me vendimin nr. 516, datë 1.7.2020.

Në raportin e monitorimit të zbatimit të masave të parashikuara në Planin e Veprimit për Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën janar–shtator 2020, rezulton për të gjitha aktivitetet e parashikuara për të tri qasjet parandaluese, ndërgjegjësuere, dhe ndëshkuese (60 masa dhe 105 aktivitete në zbatim për këtë periudhë monitorimi nga 68 masa e 124 aktivitete të parashikuara për zbatim për vitin 2020), janë realizuar plotësisht 20 masa, pjesërisht 25 masa dhe nuk janë realizuar 15 masa. Aktivitete të realizuara plotësisht janë 33, pjesërisht 34 dhe të porealizuara 38. Përmes realizimit të masave dhe aktiviteteve janë arritur vlerat e synuara për këtë periudhë monitorimi për vitin 2020 për 2 tregues performance. Gjithashtu, është arritur pjesërisht vlera e synuar vjetore për 6 tregues, ndërsa për 29 tregues vlera e synuar është e pamatshme për këtë periudhë raportimi për shkak të mungesës së të dhënave për përlogaritjen e tyre (pasi indikatorët janë të matshëm mbi baza vjetore).

Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë, me asistencën e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, ka kryer edhe procesin e vlerësimit të jashtëm afatmesëm të “Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015–2020 (SNKK)”, duke mundësuar një qasje kritike ndaj zbatimit të këtij dokumenti strategjik që prej miratimit të tij si dhe dhënien e rekomandimeve për strukturën dhe përmbajtjen e një dokumenti strategjik në këtë fushë në të ardhmen.

Pranë Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, është krijuar Rrjeti i Koordinatorëve kundër Korrupsionit. Rrjeti i Koordinatorëve Antikorrupsion do të operojë në 17 agjenci të ndryshme shtetërore që ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për qytetarët. Rrjeti i Koordinatorëve Antikorrupsion (Koordinatori) do të ndjekë rast pas rasti çdo sinjalizim për korrupsion dhe përmes tij do të krijohet një mekanizëm kombëtar i referimit të korrupsionit të të gjitha niveleve.

Në zbatim të politikave parandaluese të korrupsionit dhe forcimin e integritetit, Ministri i Drejtësisë me urdhrin nr. 333, datë 7.10.2020 dhe urdhrin nr. 334, datë 7.10.2020, miratoi përkatësisht Planin e Integritetit për Ministrinë e Drejtësisë dhe Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për institucionet e qeverisjes

qendrore. Në këtë mënyrë, Ministria e Drejtësisë bëhet i pari institucion në nivel qendror që ka një plan integriteti tashmë të miratuar. Gjithashtu, modeli i këtij plani pritet që të realizohet edhe në ministrinë e tjera.

Në kuadër të veprimtarive ndërgjegjësuere, Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë në Shqipëri, me mbështetjen e Delegacionit të Bashkimit Evropian dhe Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Shqipëri, organizuan në datat 3–11 shkurt 2020 dhe në datat 1- 9 Dhjetor 2020 “Java e Integritetit” me qëllim amplifikimin e përpjekjeve të përbashkëta për të luftuar korrupsionin dhe promovuar integritetin, përtej kufijve institucionalë. Java e Integritetit është konceptuar si një fushatë ndërgjegjësuere kombëtare ku veprimi kolektiv parashikohet si një mekanizëm për të tërhequr vëmendjen mbi rëndësinë e integritetit dhe për të promovuar sjelljen etike jo vetëm në biznes, por edhe në organet qeveritare, botën akademike dhe OJQ-të.

Veprimtaria e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)

Veprimtaria e ILDKPKI-së bazuar në kuadrin ligjor ekzistues ka zhvilluar veprimtarinë e tij përqendruar në tri drejtime kryesore:

- Kontributi në procesin e rivlerësimit kalimtar i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

ILDKPKI-ja, konkretisht, gjatë vitit 2019, ka përfunduar dhe dorëzuar pranë këtyre organeve, dokumentacionin e plotë, së bashku me raportet e hollësishme dhe të arsyetuara për pjesën e mbetur të gjyqtarëve të gjykatave të apelit dhe prokurorëve pranë prokurorive të apelit, gjyqtarët e gjykatave të Shkallës së Parë dhe prokurorëve të prokurorive pranë gjykatave të shkallëve të para, Gjykatës të Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, si dhe gjykatave administrative të shkallëve të para, në total 220 subjekte të rivlerësimit. Ndërkohë që për periudhën janar–13 tetor 2020, ILDKPKI-ja ka përfunduar dhe dorëzuar pranë këtyre organeve, dokumentacionin e plotë, së bashku me raportet e hollësishme dhe të arsyetuara për 61 subjekte të procesit të rivlerësimit.

Ky numër, së bashku me subjektet në listën prioritare, të dërguar pranë këtyre institucioneve përgjatë periudhës nëntor–dhjetor 2017, shkon në total në 759 subjekte të procesit të rivlerësimit.



- Deklarimi dhe kontrolli i pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë dhe sistemi elektronik i deklarimit të interesave privatë.

ILDKPKI-ja, gjatë vitit 2019 si dhe gjatë periudhës vijuese janar–tetor 2020, ka vazhduar procesin e koordinimit dhe mbështetjes me burimet e nevojshme institucionale, me qëllim finalizimin e angazhimeve të marra në kuadër të projekteve asistuese në drejtim të ngritjes së sistemit elektronik të deklarimit të interesave privatë.

Sistemi elektronik, në përmbushje të rekomandimit të lënë nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në Rezolutën e 2019 për ILDKPKI pritet që të jetë tërësisht funksional gjatë 2021. Në vijim të proceseve të nevojshme për të bërë sistemin tërësisht funksional, ILDKPKI kërkoi dhe morri mbështetjen e nevojshme financiare nga buxheti i shtetit për të garantuar mirëmbajtjen e sistemit, si një kërkesë e nevojshme, parashikuar nga VKM nr. 710/2013.

ILDKPKI-ja, ka trajtuar të gjitha kërkesat e individëve apo mediave, lidhur me publikimin e deklaratave të interesave privatë të subjekteve deklarues, brenda afatit 10 ditor, pavarësisht fluksit të kërkesave dhe procesit të përpunimit manual për redaktimin e të dhënave personale, duke rritur kështu transparencën institucionale. Në këtë kuadër, për t'u theksuar mbetet fakti se nuk janë paraqitur kontestime apo ankesa nga palët e interesuara.

Volumi gjithmonë e më shumë në rritje, tregohet në mënyrë të qartë edhe nga të dhënat e publikimit të deklaratave të interesave privatë, ku ILDKPKI gjatë periudhës 2014–2019 ka publikuar rreth 52 198 deklarata me kërkesë, ndër të cilat vetëm për vitin 2019, janë publikuar rreth 10 937 deklarata me kërkesë, ndërsa për periudhën janar–shtator 2020 janë publikuar rreth 4 521 deklarata.

- Zbatimi i ligjit Nr. 60, datë 2.6.2016, “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka vijuar zbatimin e kompetencave të dhëna me anë të ligjit nr. 60, datë 2.6.2016, “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”.

ILDKPKI-ja, gjatë periudhës 2017–2019, në ushtrim të kompetencave ligjore, si mekanizëm i jashtëm raportimi për sinjalizimin dhe kërkesat për

mbrojtje nga hakmarrja, ka regjistruar dhe trajtuar në total 38 raste sinjalizimi dhe 5 raste kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja.

Për vitin 2019, ILDKPKI, si mekanizëm i jashtëm raportimi për sinjalizimin dhe kërkesat për mbrojtje nga hakmarrja, ka regjistruar dhe trajtuar në total 14 raste sinjalizimi dhe 1 kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja, ndërsa për periudhën janar–13 tetor 2020 ka regjistruar 8 raste sinjalizimi të jashtëm dhe 1 kërkesë për mbrojtje.

ILDKPKI-ja ka marrë masa për të regjistruar të gjitha rastet e sinjalizuara në Regjistrin e Sinjalizimeve të Jashtme, si dhe për të zhvilluar hetimin administrativ në respektim të afateve ligjore në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 60/2016 dhe K.Pr.A. ILDKPKI-ja për rastet e tjera të sinjalizuara, pas hetimit administrativ ka vënë në dijeni organin kompetent sipas problematikës së ngritur nga sinjalizuesit.

- Vlerësimi Kalimtar dhe Periodik i Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme

Zbatimi i Ligjit Nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të policisë së shtetit, gardës së Republikës dhe shërbimit për çështjet e brendshme dhe ankesave në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, po procedohet nga ana e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit (KJV) me vlerësimin e subjekteve të niveleve të larta drejtuese dhe vlerësimit të subjekteve të SHÇBA. Pas përfundimit të këtij procesi menjëherë, subjektet e vlerësuara të SHÇBA do të bëjnë vlerësimin e kategorive të mesme dhe të ulëta të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, është organi i pavarur i ngritur në zbatim të Ligjit Nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, i përbërë nga 15 komisionerë të ndarë në 5 trupa vlerësimi, i cili kryen vlerësimin kalimtar të punonjësve me funksione dhe grada të larta drejtuese në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës si dhe në zbatim të ndryshimeve ligjore të vitit 2019 (Ligj 20/2019) veton edhe të gjithë punonjësit e SHÇBA pavarësisht gradës dhe funksionit të tyre.



KJV-ja ka shortuar deri më tani 92 punonjës dhe po përfundon vendimmarrjen për 45 punonjës të parë të shortuar me grada dhe funksione të larta në Polici, SHÇBA dhe Gardën e Republikës, si dhe po shorton 45 punonjës të SHÇBA në mënyrë që të nisë vlerësimin e tyre me qëllim zbatimin e ndryshimeve ligjore me ligjin nr. 74/2020 që i jep mundësi procesit të vlerësimit të kryhet paralelisht edhe nga SHÇBA për kategoritë e mesme dhe të ulëta.

Deri më tani janë vlerësuar me vendimmarrje të trupave të vlerësimit 29 punonjës nga të cilët:

- 4 punonjës të policisë janë dorëhequr gjatë procesit kryesisht pas dërgimit të relacionit të vlerësimit dhe është ndërprerë procesi i vlerësimit me vendimmarrje nga trupa e vlerësimit me pasojë të njëjtë përjashtimin nga policia;

- 4 zyrtarë janë përjashtuar me vendimmarrje të rezultuar nga procesi i vlerësimit (nga të cilët tre punonjës të SHÇBA-së dhe punonjës së Gardës së Republikës).

Vlerësimi i punonjësve të policisë së shtetit, gardës dhe SHÇBA është në funksion të luftës kundër korrupsionit, pasi do të sigurojë qëndrueshmërinë e institucioneve me persona me figurë të pastër, me integritet dhe profesionistë në fushat e tyre respektive.

Raportimet ndërkombëtare

Në fokus të punës së Ministrisë së Drejtësisë për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ka qenë edhe adresimi i rekomandimeve të mekanizmave monitorues të Konventave të Këshillit të Evropës GRECO, Moneyval, si dhe rekomandimeve të FATF.

Në seancën e datës 25.9.2020, në kuadër të raundit të katërt të vlerësimit për parandalimin e korrupsionit të gjyqtareve, prokurorëve dhe anëtarëve të parlamentit, GRECO miratoi – Shtojcën e Raportit të Dytë të Vlerësimit për Shqipërinë ku u cilësua se Shqipëria ka përmbushur 9 nga 10 rekomandimet e adresuara nga GRECO për këtë raund vlerësimi³⁶. Ky vlerësim përbën një arritje të konsiderueshme të Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit në gjyqësor/prokurori si dhe për anëtarët e parlamentit. Referuar rregullave procedurale të GRECO, Shqipëria nuk do të

monitorohet më për këtë Raund pasi konsiderohet si i përmbyllur me sukses.

Në kuadër të raundit të pestë të vlerësimit të GRECO-s, me titull “Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në qeverinë qendrore (funksionet e larta ekzekutive) dhe agjencive të zbatimit të ligjit, është miratuar raporti i Vlerësimit për Shqipërinë në seancën plenare në datat 26- 30 tetor 2020. Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse do të ndjekë zbatimin e rekomandimeve të vendosura nga GRECO me qëllim përmbushjen e plotë të tyre. Raportimi mbi përputhshmërinë e rekomandimeve të GRECO-s për këtë raund vlerësimi është data 30 Prill 2022.

Në përmbushje të rekomandimeve të Moneyval dhe Bashkimit Evropian është miratuar Ligji Nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” si dhe është hartuar Projektligji, “Për regjistrin qendror të llogarive bankare”, i cili është në fazën e konsultimit publik. Miratimi i këtij projektligji është në përmbushje të detyrimit të BE dhe përafrimit të kuadrit ligjor Shqiptar me *acquis* të BE/Direktivën 849/2015 (ndryshuar me 843/2018).

Në kuadër të zbatimit të Planit të ICRG/FATF, nga institucionet pjesë e Grupit Ndërinstitucional të punës janë realizuar objektiva si më poshtë:

- Janë përgatitur 6 analiza risku për pastrim parash konkretisht risku që paraqesin personat juridik dhe risku i produkteve bankare, për avokatët, ekspertët kontabël, pasuritë e paluajtshme dhe ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme).

- Është hartuar projektligji, “Për ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme” që do të mundësojë formalizmin e këtij sektori nëpërmjet licencimit të tyre, si dhe kontrollit dhe parandalimit të lidhjeve kriminale, në këtë sektor. Projektligji është në fazë shqyrtimi në Kuvend;

- Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në funksion të kontrollit dhe parandalimit të elementeve kriminale të aplikantëve për titullin “Avokat” dhe licencimin e tyre, si dhe rinovimin e licencës për ushtrimin e profesionit të “Avokatit” ka hartuar ndryshimet ligjore në Statutin e “Dhomës të Avokatëve të Shqipërisë” dhe i ka paraqitur ndryshimet për miratim në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Tiranë;

- Në shtator 2020 ka hyrë në fuqi Ligji 112/2020, “Për regjistrin e pronareve përfitues”;

³⁶ <https://rm.coe.int/raundi- i- katert- i- vleresimit- parandalimi- i- korrupsionit- ne- lidhje- me- d/16809fd88d>



- Është hartuar projektligji, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, i cili është miratuar në mbledhjen e qeverisë në datë 9.9.2020. Projektligji tashmë është përcjellë në Kuvend për të vijuar me ndjekjen e procedurave të mëtejshme;

- Është rritur numri i pasurive të sekuestruara dhe po shkon drejt rritjes edhe numri i pasurive të konfiskuara. Në këtë rritje ka ndikuar dhe struktura e ngritur në kuadër të Aktit normativ Nr. 1/2020, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të kundër Terrorizmit, Krimin të Organizuar, Krimeve të Rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike” “Operacioni Forca e Ligjit”;

- DPPP-JA ka përfunduar rishikimin e udhëzuesit për sanksionet ndërkombëtare, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit duke e shpërndarë këtë informacion te 1200 subjekte raportuese, si dhe gjatë muajit shtator - tetor, ka zhvilluar një seri trajnimesh me subjektet e ligjit (Shoqëri ndërtimi, Zyra këmbimi valutor, Shoqëri Sigurimi, Noter, subjekte financiare, agjenci udhëtimi) duke trajtuar në mënyrë të veçantë zbatimin nga subjektet e ligjit të sanksioneve ndërkombëtare.

Të drejtat e njeriut

Ashtu siç përmendet edhe në raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë në vitin 2020, Shqipëria ka avancuar kornizën e politikave dhe ka ndërmarrë hapa për të forcuar kapacitetet institucionale për të adresuar pengesat e ndryshme me të cilat përballen fëmijët shqiptarë në aksesin në drejtësi, garantimin e të drejtave procedurale sipas skemës së re për ndihmën juridike falas dhe ofrimin e shërbimeve pa pagesë. Gjithashtu Shqipëria ka punuar intensivisht për garantimin e standardeve evropiane në sistemin penitenciar mbi trajtimin e problematikës së mbipopullimit dhe rritjen e sigurisë në burgje.

Sistemi i burgjeve

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në përmbushje të misionit të saj për të garantuar sigurinë, të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe paraburgosurve, ka pasur fokus kryesor rritjen e sigurisë në burgje dhe zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore, nëpërmjet intensifikimit të kontrolleve, përmirësimit të procedurave dhe akteve ligjore e nënligjore, bashkëpunimit ndër-institucional dhe eliminimin e diskriminimit pozitiv ndaj personave të dënuar me rrezikshmëri të lartë dhe anëtarë të grupeve të strukturuar kriminale.

Gjithashtu, ka pasur një vëmendje të shtuar në respektimin e të drejtave të njeriut, me qëllim shmangien e rasteve të dhunës, keqtrajtimit e diskriminimit, informim i vazhdueshëm i të dënuarve dhe paraburgosurve lidhur me mirëfunksionimin dhe menaxhimin sa më mirë të kohës së vuajtjes së dënimit.

Zhvillime pozitive ka pasur në drejtim të rritjes së masave për përmirësimin shëndetësor në burgje, nëpërmjet:

- Bashkëpunimit me Institucionet e Shëndetit Publik;

- Rekrutimin e stafit shëndetësor dhe përpjekjet për përmirësimin e pagave;

- Kontrollin e përgjithshëm shëndetësor (*Check-up*).

Gjithashtu, janë miratuar një sërë aktesh lidhur me procedurat e sigurisë si procedura e kontrollit, procedura të shoqërimit dhe transportit, procedura të përdorimit të forcës, procedura të pajisjeve të dhomave, procedura të vlerësimit të riskut për arratisje, udhëzues për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, procedura të vlerësimit të sjelljeve etj.

Zhvillim i rëndësishëm ka qenë reforma legislative në sistemin e burgjeve dhe zbatimi i parashikimeve të Ligjit Nr. 108/2018 për krijimin e regjimit të posaçëm të burgjeve, i cili u vendos në funksion të plotë në janar të 2020. Në këtë kuadër, u hartua dhe miratua rregullorja e regjimit të posaçëm. U kryen investime në IEVP Peqin dhe “Jordan Misja” për vendosjen dhe sigurinë e personave subjekt i Ligjit Nr. 108/2018. Aktualisht ndodhen 7 të burgosur në regjimin e posaçëm.

Lidhur me luftën kundër korrupsionit në sistemin e burgjeve, gjatë vitit 2019- 2020 janë rishikuar apo nxjerrë akte dhe procedura të punës, për të krijuar mekanizma antikorrupsion dhe transparencë lidhur me procedurat e rekrutimit, vlerësimit e sjelljes së të dënuarve që kanë bërë kërkesë për lirim me kusht, përmirësimin e përfaqësimit të ndjekjes së proceseve gjyqësore, transferimin e të burgosurve dhe për kujdesin shëndetësor.

Është rritur në mënyrë të konsiderueshme shkëmbimi i informacionit me Shërbimin Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve (SHKBB), si dhe është ngritur rrjeti i sinjalizuesve (në referencë të Ligjit Nr. 60/2016 për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve), si dhe është kryer trajnimi i tyre.



Gjatë vitit 2020, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka ndërmarrë disa iniciativa të rëndësishme që kanë pasur si qëllim goditjen e korrupsionit dhe forcimin e ligjshmërisë në menaxhimin e sistemit penitenciar. Janë ushtruar inspekte thuajse në të gjithë IEVP lidhur me procedurat e punësimit të dënuarve. Në vijim të inspekteve janë marrë masa duke filluar edhe procedime penale. Gjatë vitit 2020 janë kallëzuar penalisht për korrupsion drejtuesi i IEVP “Jordan Misja” dhe një zyrtar tjetër i këtij institucioni. Disa kallëzime penale janë kryer edhe ndaj stafit të IEVP Rrogozhinë dhe Fushë- Krujë, për shpërdorim detyre.

Gjithashtu, për periudhën janar–shtator 2020 janë aplikuar 42 pezullime administrative, për efekt të fillimit të procedimit penal, si të dyshuar për kryerjen e veprave penale “shpërdorim detyre” dhe “korrupsion pasiv dhe aktiv i personave që kryejnë një funksion publik”. Deri në muajin janar–shtator 2020 janë dhënë 508 masa disiplinore për stafin, prej të cilave 42 largime nga detyra. Sipas kategorisë janë larguar 37 punonjës me uniformë, 4 punonjës civil dhe 1 drejtues.

Lidhur me uljen e mbipopullimit në burgje, sipas të dhënave më të fundit sistemi i burgjeve është në nivel nënpopullimi - 21%. Kjo ka ardhur si rezultat i ngritjes së institucioneve të reja, aplikimit të dënimeve alternative, si dhe të zbatimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Janë realizuar trajnime për stafin e burgjeve dhe paraburgimeve lidhur me raportimin e dhunës dhe torturës dhe kryerjen e hetimeve të thelluara. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka zhvilluar disa seanca trajnime lidhur me Protokollin e Stambollit në bashkëpunim me partnerë dhe organizata joqeveritare që operojnë në fushën e të drejtave të njeriut. Në raportet e organizmave përkatës në këtë fushë është evidentuar progresi i kryer në sistemin e burgjeve në drejtim të zbatimit të kërkesave ligjore për të drejtat e trajtimin e të burgosurve, nga të cilët veçojmë konkluzionet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës në raportin e monitorimit (i vitit 2019 për vitin 2018) dhe si asnjëherë më parë ka vlerësuar bashkëpunimin e gjetur me administratën e burgjeve në të gjitha institucionet e vizituara.

Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve ka marrë të gjitha masat e nevojshme për adresimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me

përmirësimin e kushteve dhe trajtimin e të burgosurve.

Lidhur me forcimin e sigurisë në burgje, janë marrë masa për forcimin e sigurisë dhe parandalimin e kryerjes së aktivitetit kriminal. Më konkretisht:

- Zbatimi i regjimit të posaçëm për anëtarët e grupeve të strukturuar kriminale;

- Zbatimi për herë të parë i nenit 55 mbi regjimin e veçantë, ku janë vendosur mbi 110 të dënuar që kanë thyer rëndë sigurinë dhe rendin;

- Reduktimi në zero raste i takimeve favorizuese të të dënuarve, veçanërisht të personave me rrezikshmëri;

- Reduktimi i sendeve të ndaluara nëpërmjet kontroleve dhe masave parandaluese dhe ndëshkimore. Veçanërisht futja e sendeve të ndaluara ishte kthyer në një fenomen;

- Gjithashtu, është përmirësuar sistemi i mbikëqyrjes dhe kontrollit, janë instaluar sisteme të reja të vëzhgimit me kamera në regjimin e posaçëm, si dhe sistemi PIN i kufizimit të telefonatave. Eliminimi i diskriminimit pozitiv ndaj personave “të fortë”, me rrezikshmëri të lartë dhe anëtarë të grupeve të strukturuar kriminale ka qenë një objektiv kryesor i punës. Gjatë kësaj periudhe është bërë një ndryshim real dhe i matshëm sa lidhet me zbatueshmërinë e rregullave të brendshme dhe akteve rregullatore.

Mbrojtja e të Dhënave Personale

Kuadri ligjor shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale përbëhet nga Ligji Nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore të tij, i përafëruar në mënyrë të plotë me Direktivën 95/46/EC të Bashkimit Evropian. Ligji ende nuk është i përafëruar me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Bashkimit Evropian 2016/679 (GDPR) dhe Direktivën 2016/680, i cili aktualisht është një nga prioritetet e Qeverisë Shqiptare si një nga detyrimet e parashikuara dhe në Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020.

Në këtë kontekst, për vetë rëndësinë që mbart Reforma e BE-së për mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”), ka iniciuar punën për hartimin e ndryshimeve ligjore. Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit është përfutuese e projektit të



binjakëzimit, financuar nga programi i BE-së IPA 2017, sipas aktivitetit “Ndërtimi i institucioneve për harmonizimin me *acquis* të BE për të përmbushur kriteret ekonomike lidhur me mbrojtjen e të dhënave”, i cili ka si qëllim të asistojë Zyrën e Komisionerit në përafrimin e legjislacionit kombëtar në fuqi, me *acquis* të BE në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale si dhe të mbështesë në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative të institucioneve shqiptare për të zbatuar këto *acquis*. Zbatimi i projektit ka filluar me datë 1 Tetor 2020, dhe do të zgjasë 12 muaj.

Në vitin 2020, Kuvendi i Shqipërisë miratoi rezolutën, “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale për vitin 2019”, i cili përmban gjetjet dhe rekomandimet për vitin 2019. Zyra e Komisionerit është angazhuar në bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ka luajtur rol proaktiv në kuadër të implementimit të akteve kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të dhënave siç është hartimi i projektligjit për ratifikimin e protokollit që ndryshon Konventën, “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale” të Këshillit të Evropës. Nga ana tjetër, Zyra e Komisionerit ka realizuar me sukses aktivitetin më të rëndësishëm botëror në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, Konferencën e 41-të Kombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, nënvizuar edhe në Progres Raportin e Bashkimit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020.

Liria e Shprehjes

Ligji nr. 91/2019, datë 18.12.2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar synon të rregullojë veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Publikimeve Elektronike, në mënyrë që të garantojë të drejtën e informacionit, lirinë e shprehjes, mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtat themelore të njeriut, respektimin dhe garantimin e jetës private, moslejimin e transmetimeve që nxisin intolerancën, gjuhën e urrejtjes dhe dhunën në shoqëri.

Presidenti i Republikës, kërkoi rishqyrtimin e ligjit të miratuar me dekretin nr. 11413, datë 11.1.2020, “Për kthimin e ligjit nr. 91/2019, “Për

disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në fazën e rishikimit në Parlament, ligji ishte subjekt i një procesi të gjatë të konsultimit publik. Ligji është konsultuar vazhdimisht me ekspertët ndërkombëtarë të OSBE-së, Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë dhe me përfaqësues të BE-së dhe është rishikuar disa herë në dritën e komenteve dhe sugjerimeve të tyre. Rekomandimet e OSBE-së, përfaqësuesve të BE-së, si dhe rekomandimet e Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, u pasqyruan në ligjin e miratuar.

Në vijim të Opinionit të Komisionit të Venecias, autoritetet shqiptare janë angazhuar në rishikimin e Ligjit dhe adresimin e të gjitha rekomandimeve të dhëna në Opinion. Mbështetur në rekomandimet e Komisionit të Venecias për përmirësimet që duhen bërë në ligjin nr. 91/2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, në korrik të vitit 2020 është ngritur grupi i punës për rishikimin e këtij ligji, i cili ka vazhduar punën me qëllim reflektimin e rekomandimeve të Komisionit të Venecias.

Të Drejtat e Pronës

Të drejtat e pronës përfaqësojnë një nga elementet e rëndësishme si pjesë e kornizës së të drejtave themelore. Është e nevojshme të vazhdohen përpjekjet për të konsoliduar të drejtat e pronës dhe për të çuar më tej rishikimin e akteve të pronës, për të bërë përparimin e nevojshëm në digjitalizimin dhe hartëzimin e pronës si dhe për të zbatuar skemën e kompensimit.

Qeveria Shqiptare po përparon në zbatimin e një “Reforme të Integruar të Menaxhimit të Tokës (ILRM)”, për të përmirësuar të drejtat e pronës dhe administrimin e tokës dhe për të zvogëluar kufizimet aktuale për të krijuar një treg të fortë të tokës. Reforma e tokës është identifikuar si një përparësi e lartë për zhvillimin e vendit dhe ky vizion shprehet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (NSDI) 2015–2020, korniza kryesore strategjike e vendit. Forcimi i produktivitetit dhe qëndrueshmërisë së përdorimit të tokës për të promovuar zhvillimin është përparësia kryesore e qeverisë. Reforma e Menaxhimit të Integruar të Tokës (ILMR) do të lejojë Qeverinë të përshpejtojë zhvillimin e Shqipërisë duke sjellë përfitime të konsiderueshme



ekonomike, sociale dhe mjedisore si dhe të sigurojë shërbime më transparente të lidhura me tokën për publikun.

Struktura e qeverisjes për reformën është ngritur nga:

- Komiteti Ndërmintor;
- Grupi i Punës;
- sekretariati Teknik.

Është përgatitur drafti i Drejtimit të Reformës dhe Plani i saj i veprimit (drafti) i saj për periudhën 2018–2022. Janë krijuar dy grupe pune për të përfunduar inventarin dhe regjistrimin e tokës në pronësi të shtetit. Inventari shtetëror i tokës pritej të përfundonte dhe regjistrohej gjatë vitit 2019. Të dhënat dhe shërbimet e regjistrimit kombëtar të pronave janë pengesat kryesore për reformën në sektorët me prioritet që lidhen me tokën. Reformat prioritare në bujqësi, turizëm, administrimin e tokës shtetërore dhe tregun e tokës kërkojnë investime të konsiderueshme në cilësinë, besueshmërinë dhe efikasitetin e regjistrimit të tokës/informacionit dhe shërbimeve kadastrale. Kërkohej investim kyç për të krijuar dhe siguruar mirëfunksionimin e Agjencisë së re Shtetërore të Kadastrës, për të azhurnuar infrastrukturën ekzistuese të Teknologjisë Informacionit dhe Komunikimit, për të zbatuar plotësimin e të dhënave.

Është e nevojshme që të sigurohet një sistem qendror i ri i cili harmonizon të gjitha aplikacionet e përdorura aktualisht për t'i mundësuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrave të kryejë në mënyrë efektive detyrat e saj. Cilësia e të dhënave ndikohet gjithashtu nga bazat e të dhënave dhe sistemet e shpërndara të lidhura me pronën. Shpërndarja dhe integrimi i këtyre të dhënave është thelbësore për të pasur një Sistem Qendror Shqiptar të Informacionit të Tokës (ACLIS) si një sistem funksionues i përgjithshëm.

Në vijim janë duke u ndjekur disa projekte të rëndësishme që kanë të bëjnë me pronën dhe çështjet e menaxhimit të tokës të tilla si me Bankën Botërore, Bashkimin Evropian dhe OSCE, GIZ, Sida- Qeveria Suedeze, Autoriteti Norvegjez i Hartëzimit.

Kompensimi i pronave

Në datën 7 maj 2020, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), i njoftoi Qeverisë Vendimin në lidhje me aplikimin nr. 29026/06 “Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë. Referuar përmbajtjes së vendimit, Gjykata ka vlerësuar se

skema e re e përdorur nga Ligji Nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, dhe aktet ligjore të dala në zbatim të tij, konsiderohen të pranueshme referuar parimeve të aplikuara nga Neni 1 i Protokollit 1 të Konventës.

Përpos vlerësimit në tërësi të skemës së re të kompensimit, në funksion të një barazie në kompensim, Gjykata ka kërkuar që të bëhen disa ndërhyrje. Gjykata ka vlerësuar se në vijim Qeveria duhet të marrë disa masa në kuadër të një shpërblimi të drejtë të ish-pronarëve. Me qëllim të një kompensimi të drejtë, dhe për të parandaluar një barrë të tepërt mbi ish-pronarët në përgjithësi dhe mbi kërkuesit në veçanti, mjeti juridik mund të konsiderohet efektiv nëse shumat totale të kompensimit pavarësisht formës së kompensimit arrijnë të paktën 10% të vlerës që kërkuesit do të kishin përfituar nëse vlerësimi financiar do të ishte kryer duke përdorur si referencë zërin kadastral aktual të pronës së shpronësuar.

Duke pasur parasysh procesin e kompensimit i cili po ecën ngadalë, Gjykata ka kërkuar të respektohet indeksimi. Nga momenti i daljes së vendimit e deri në ekzekutimin e tij, ATP duhet të bëjë kompensimin mbi bazën e normës së inflacionit.

Në këtë kuadër është ngritur me urdhër të Kryeministrit nr. 88/2020, grupi i punës për marrjen e masave të përgjithshme për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së. Ky proces është drejt finalizimit dhe janë duke u përgatitur propozimet sipas rekomandimeve përkatëse të vendimit *Beshiri kundër Shqipërisë*.

Në vijim Agjencia e Trajtimit të Pronave ka punuar për realizimin e objektivave të përcaktuar në ligj, si dhe ka ndërmarrë disa reforma për zbatimin e ligjit. Objektivat e ATP-së në zbatim të ligjit:

- Vlerësimi financiar i vendimeve që kanë njohur të drejtën për kompensim. Nga hyrja në fuqi e ligjit 133/2015 deri në publikimin e fundit në Buletin e njoftimeve zyrtare nr. 24, datë 20.7.2020, ATP-ja ka vlerësuar gjithsej 26 091 vendime përfundimtare për kompensim të viteve 1993–2013, me një faturë financiare prej 101,031,385,711 lekësh;

- Kompensimi financiar dhe fizik i vendimeve përfundimtare. Nga hyrja në fuqi e ligjit të ri, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka ekzekutuar; 729



vendime, nga këto 657 për kompensim financiar me një vlerë prej 7,015,949,163.22 lekësh (vlera e kompensimit financiar plus vlera e llogaritur për kompensim financiar të kërkesave të veçanta) dhe 72 vendime me mbyllje procedimi. Janë shpërndarë fond fizik 667.6 ha tokë. Është realizuar trajtimi i kërkesave për përfitimin e shpërblimit për pronat e zëna nga ndërtimet informale (ALUIZNI). Gjithashtu, janë ekzekutuar gjithsej 6250 kërkesa që nga viti 2015 dhe është shpërndarë vlera financiare prej 7,609,995,622 lekësh;

- Trajtimi i kërkesave të reja të depozituara për njohje pronësie. Nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 133/2015, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka pasur një afat trevjeçar për trajtimin e kërkesave për njohje pronësie dhe ka regjistruar në total 16 462 kërkesa për njohje pronësie. Gjatë periudhës nga miratimi i ligjit deri në përfundim të afatit ligjor (2016–2019), Agjencia e Trajtimit të Pronave ka arritur të trajtojë 9512 kërkesa për njohje pronësie, ka përfunduar procesin e njohjes së pronësisë me datë 23 shkurt 2019 dhe për 6950 kërkesat e patrajtuara;

- Përparimi i nevojshëm në digjitalizimin dhe hartëzimin e pronave. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka bërë përparim në procesin e digjitalizimit dhe hartëzimit të pronave me krijimin e sistemit elektronik të digjitalizuar Web-Gis. Krijimi i një “harte” unike “vendimesh” në lidhje me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave mundësoi inventarizimin dhe skanimin e situatës së krijuar ndër vite për të gjitha dosjet që janë trajtuar me vendime nga ish-KKKP-ja, ZRKKP-ja apo AKKP-ja., si dhe mundëson transparencë të institucionit ndaj subjekteve të ligjit dhe përmirësim të eficiencës së punës në ATP.

Të drejtat e fëmijëve

Në kuadër të reformës në drejtësi është miratuar ligji nr. 37/2017, datë 30.3.2017 “Kodi i drejtësisë penale për të mitur”, dhe ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve për trajtimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Ligji nr. 37/2017, datë 30.3.2017 “Kodi i drejtësisë penale për të mitur”, i cili përmban norma të posaçme ligjore lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një

të mitur në konflikt me ligjin, një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale, si dhe rregulla për të rinjtë nga grup-mosha 18 deri në 21 vjeç. Ky ligj përbën një risi dhe zhvillon standardet e legjislacionit shqiptar në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në tërësi dhe të të miturve në konflikt me ligjin në veçanti. Kodi është një ligj i veçantë për shkak të përmbajtjes së tij pasi përmbledh të gjitha dispozitat që referojnë të miturin në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, ligjin, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, si dhe ligje të tjera referuese të sistemit të drejtësisë penale për të mitur. Ky Kod siguron përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivën 2011/93/BE datë 13.12.2011, përveç përpunjes me standardet ndërkombëtare dhe rajonale. Në zbatim të plotë të këtij Kodi janë parashikuar një seri masash në Planin e Veprimtë Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur, i cili vazhdon të zbatohet.

Krijimi i institucioneve të reja në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, si kusht për plotësimin e infrastrukturës së nevojshme për të vënë në zbatim aktet nënligjore, masat alternative të dënimit si dhe riintegrimin e të miturve në shoqëri, është një nga hallkat më të rëndësishme për t’u realizuar. Për këtë qëllim, Ministria e Drejtësisë është angazhuar në ngritjen e institucioneve të reja.

Aktualisht është përmbyllur procesi i hartimit dhe miratimit të 13 akteve për drejtësinë penale për të mitur të cilat mundësojnë zbatimin e legjislacionit të reformuar, si dhe po punohet në mënyrë intensive për ngritjen e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, institucion i cili do të hartojë programe parandaluese dhe do të mbikëqyrë për një periudhë 6-mujore të miturit pas përfundimit të dënimit. Ministria e Drejtësisë ka përfunduar dokumentacionin i cili normon funksionimin e brendshëm të këtij institucioni si dhe ka vijuar procedurat e rekrutimit të stafit të tij.

Gjithashtu, në fokus është edhe ngritja e Institucionit të Kufizimit të Lirisë. Lidhur me funksionimin e këtij institucioni Ministria e Drejtësisë ka përfunduar procedurat që lidhen me pjesën arkitekturore të projektit dhe vendit ku do të ngrihet ky institucion. Është ngritur grupi i punës i cili ka hartuar termat e referencës për zhvillimin dhe projekt disenjimit të institutit.



Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur ka reformuar trajtimin e të miturve përpara institucioneve të drejtësisë penale duke mundësuar masat alternative që synojnë shmangien e të miturit nga procedimi penal ose zbatimi i masave të drejtësisë restauruese si mundësi e parë nga organi kompetent. Me qëllim zbatimin në praktik të kësaj mase alternative MD ka lidhur 33 marrëveshje bashkëpunimi deri në tetor 2020 si dhe ka vijuar me ngritjen e 15 qendrave të reja të trajtimit të të miturve në njësitë e qeverisjes vendore gjatë vitit 2020.

Në lidhje me vendosjen e të miturve në institucionet penitenciare, vihet re një reduktim i numrit të të miturve të paraburgosur. Në shtator të vitit 2020, rezulton se ka pasur vetëm 20 të mitur të paraburgosur dhe asnjë të dënuar në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur në Kavajë.

Mbrojtja e Pakicave Kombëtare

Detyrimet për zbatimin e Ligjit 96/2017, “Për pakicat kombëtare” dhe nxjerrjen e akteve nënligjore vijnë në vazhden e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare”, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8496, datë 3.6.1999. Miratimi i akteve nënligjore, që lidhen me zbatimin e këtij ligji, veçanërisht, për sa i takon mbledhjes së të dhënave, arsimimit, përdorimit të gjuhës në marrëdhëniet me autoritetet administrative, duhet të bazohet detyrimisht në kriteret objektive dhe jo vetëm në kriterin subjektiv (parimi i vetidentifikimit). Nga 12 aktet nënligjore, përcaktuar në kuadër të Ligjit për “Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në RSH”, 7 akte janë miratuar, ndërkohë që janë në proces finalizimi edhe 5 të tjerë.

Aktet që priten ende të finalizohen parashikojnë ndër të tjera përbërjen, funksionet dhe procedurën e Komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e pakicës kombëtare, përdorimin e gjuhës në marrëdhënie me organet e qeverisjes vendore, arsimimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare, masat për nxitjen dhe promovimin e identitetit të tyre etj.

Të drejtat procedurale

Ndihma juridike e garantuar nga shteti është një nga format më thelbësore të aksesit në drejtësi që çdo shtet duhet ta garantojë në mënyrë eficiente dhe efektive. Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën

juridike të garantuar nga shteti” është një ndër ligjet e miratuara në kuadër të reformës në drejtësi përmes të cilit u reformua i gjithë sistemi i ndihmës juridike duke ofruar një frymë të re, në sinkron me kërkesat dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Në zbatim të ligjit janë miratuar të gjitha aktet nënligjore të cilat synojnë të rregullojnë kuadrin ligjor të detajuar për çdo fushë specifike të ndihmës juridike. 13 akte nënligjore në fushën e ndihmës juridike kanë sjellë një serë risish dhe procedurash të reja. Shërbimi i ndihmës juridike të garantuar nga shteti, me ndryshimet e reja, është ndarë në 3 forma duke synuar zgjerimin e llojit të shërbimeve ligjore falas, konkretisht:

- Ndihmë juridike parësore (duke përcaktuar qartë ofruesit e këtij shërbimi me synimin për të rrjetëzuar dhe shtrirë këtë shërbim në të gjithë territorin);

- Ndihmë juridike dytësore (ofruar nga avokatët e miratuar nga DHASH);

- Përfjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas (DNJF) po funksionon me kapacitet pothuajse të plotë. Struktura është e plotësuar me rekrutimin e plotë të stafit ekzekutiv dhe gjithashtu është emëruar Drejtori i Përgjithshëm. Mbeten vende vakante 3 drejtorët e drejtorive, respektivisht Drejtoria e Politikave, e Mbikëqyrjes, dhe e Financës.

Aktualisht, qytetarët përfitojnë shërbime të ndihmës juridike parësore në 5 qytete dhe konkretisht në qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë dhe në Lushnjë. Ndërkohë pritet hapja e qendrave të reja të shërbimit të ndihmës juridike parësore, konkretisht në Gjirokastrë (në bashkëpunim me UNDP); Pogradec (në bashkëpunim me UNDP); dhe 3 qendra të tjera në bashkëpunim me UNDP (qytetet/qarku është duke u identifikuar dhe vlerësuar), duke e çuar numrin total të qendrave të administruara në 10 qendra.

Me ndryshimet e reja të ligjit, organizatat jofitimprurëse parashikohen si një ndër ofruesit e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti. Për herë të parë parashikohet një procedurë tërësisht e re, procedurë e cila ka për qëllim të autorizojë dhe financojë Organizata Jofitimprurëse për të ofruar ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti në rrethin ku këto organizata operojnë. Më datë 10.9.2020, u zhvillua ceremonia e



shpërndarjes së autorizimeve nga ana e Ministrisë të Drejtësisë të 12 organizatave jofitimprurëse.

Gjithashtu, DNJF ka lidhur marrëveshje me 6 institucione të arsimit të lartë për të ofruar ndihmë juridike parësore (konkretisht Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës; Kolegji Universitar “Uisdom”; universiteti “Aleksandër Mojsiu” Durrës; universiteti “Ismail Qemali” Vlorë; Universiteti Evropian i Tiranës dhe Kolegji Universitar “Bedër”.

23.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Reforma në Drejtësi

Reforma që po zbatohet në sistemin e drejtësisë ka si qëllim harmonizimin e sistemit gjyqësor shqiptar me standardet e BE-së në lidhje me pavarësinë, paanshmërinë, llogaridhënien, cilësinë e drejtësisë dhe efikasitetin e këtij sistemi. Në këtë kuadër arritjet kryesore për paraqiten si më poshtë:

- Institucionet e reja të reformës në drejtësi, përkatësisht, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (ILD), Gjykata Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, janë tërësisht funksionale;

- Përparim i veçantë është konstatuar në drejtim të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve;

- Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) ka nisur procesin e rivlerësimit për 635 subjekte të zgjedhur nëpërmjet shortit dhe u janë nënshtruar procedurave të rivlerësimit kalimtar, nga 801 gjithsej (referuar listës zyrtare të subjekteve të administruar nga Komisioni në këtë proces), duke përfunduar me vendimmarrje për 320 prej tyre, nga të cilat, 115 vendime për shkarkimin nga detyra;

- Kolegji i Posaçëm të Apeli vijon të ushtrojë funksionin e tij në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pas paraqitjes së ankimit nga subjektet e rivlerësimit apo Komisioneri Publik ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në total, që nga fillimi i procesit të *Vetting*-ut janë marrë gjithsej 84 vendime;

- Emërimi i tre anëtarëve të rinj në Gjykatën e Lartë dhe katër anëtarëve në Gjykatën Kushtetuese;

- Emërimi i drejtuesit të BKH-së dhe nisjes së procesit për emërimin e 60 hetuesëve;

- Emërimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

- Lidhur me ecurinë e punës së Gjykatës Kushtetuese, vlen të theksohet se për vitin 2020 janë marrë afërsisht 180 vendime nga Kolegjet e GJK;

- Procesi i vënies në funksion të Gjykatave të Posaçme për Gjykimin e Veprave Penale të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, i konsideruar si një ndër prioritetet kryesore të KLGJ-së, ka përfunduar. Gjatë vitit 2020, KLGJ ka caktuar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar 5 gjyqtarë në mënyrë të përhershme dhe 1 gjyqtar në mënyrë të përkohshme, ndërsa në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar janë caktuar në mënyrë të përhershme 4 gjyqtarë, si dhe në mënyrë të përkohshme 6 gjyqtarë. Gjatë këtij procesi janë transferuar edhe 9 gjyqtarë në gjykata të ndryshme (kryesisht për shkak të pezullimit të tyre sipas vendimit të shkarkimit të KPK-së);

- KLGJ miratoi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, me vendimin nr. 70, datë 7 shkurt 2020;

- KLP ka miratuar Rregulloren për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorëve;

- KLP ka marrë një sërë vendimesh lidhur me komandimin e përkohshëm të prokurorëve (77 vendime), emërimin e prokurorëve etj.;

- Për periudhën janar- 13 tetor 2020, ILDKPKI-ja ka përfunduar dhe dorëzuar pranë këtyre organeve dokumentacionin e plotë, së bashku me raportet e hollësishme dhe të arsyetuara për 61 subjekte të procesit të rivlerësimit;

- Përveç kryerjes së procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të kuadrit ligjor përkatës, ILDKPKI-ja ka administruar deklaratat e pasurisë së subjektit kandidat për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë dhe ka ushtruar kontrollin e pasurive, ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre dhe përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë të subjektit kandidat dhe personave të lidhur me të;

- Ngritja e një sistemi tërësisht funksional nga Ministria e Drejtësisë për garantimin e ndihmës juridike falas, si asaj parësore, ashtu edhe dytësore;



- Adresimi nga Ministria e Drejtësisë dhe Qeveria Shqiptare e problematikave të lidhura me shtimin e kapaciteteve njerëzore dhe financiare të organeve të *vetting*-ut si dhe Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Lufta kundër korrupsionit

Lufta kundër korrupsionit vazhdon të jetë ndër fokuset kryesore të Qeverisë Shqiptare, së cilit i është kushtuar një vëmendje e shtuar në aspektin ligjor dhe strategjik me qëllim zbatimin në mënyrë rigorozë dhe efektive të ligjit, si dhe adresimin me sukses të rekomandimeve të organizmave ndërkombëtarë për të pasur rezultate të prekshme.

Një ndër arritjet kryesore të Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit është zbatimi i reformës në drejtësi dhe ngritja e institucioneve të posaçme për luftën kundër korrupsionit. Përveç ndikimit që procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve ka në luftën kundër korrupsionit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, një arritje për t'u vlerësuar është ngritja e Prokurorisë së Posaçme (SPAK) dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH). Ngritja e këtyre institucioneve ka filluar të japë edhe rezultatet e para, ku SPAK ka regjistruar disa raste suksesi si vijon:

- Nisja e hetimeve nga SPAK për ish-Prokurorin e Përgjithshëm A.L.L. dhe gjithashtu regjistrimi i procedimit penal Nr. 137/20120 kundër 10 subjekteve me funksionin e ish-gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese, për veprën penale të “Refuzimit të deklarimit, mosdeklarimit, fshehjes ose deklarimit të rremë të pasurisë, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose të ndonjë personi tjetër që ka një detyrim ligjor për të deklaruar”, parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal. Gjithashtu, në datën 28.4.2020 është regjistruar kallëzimi penal nr. 91, i paraqitur nga shtetasi F.D., kundër 20 shtetasve me funksion ish-gjyqtarë dhe ish-prokurorë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, Apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, si dhe Prokurorive të ndryshme, për veprat penale të parashikuara nga nenet 143, 143/a/6, 180, 181, 248 dhe 257/a të Kodit Penal. Objekt kallëzimi janë deklarimet e kryera nga këto subjekte para Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe vendimet e shkarkimit të tyre nga KPK-ja;

- Në lidhje me veprat penale në fushën e zgjedhjeve, SPAK-u ka filluar një procedim penal kundër 20 komisionerëve të komisioneve të

zgjedhjeve, të cilët janë akuzuar për “votim me shumë se një herë ose pa u identifikuar”, ose kanë lejuar qëllimisht persona të ndryshëm të votojnë në emër të votuesve që ishin jashtë vendit në zgjedhjet e qershorit 2017;

- SPAK-u ka filluar procedime penale kundër 23 ish-magjistratëve, duke përfshirë 9 çështje në lidhje me gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese. Hetimet e pasurisë në lidhje me këto raste janë ende në proces. Sipas të dhënave të SPAK-ut, ka pasur së paku 22 raste të referuara ndaj kësaj strukture për fillimin e procedimit penal në 2020 në lidhje me zyrtarë të lartë;

- Miratimi i Planit të Veprimit 2020–2023 për zbatimin e Strategjisë Ndërsektorale kundër Korrupsionit, i cili përbën një dokument modern që synon të luftojë korrupsionin përmes tri qasjeve parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuere, duke parashikuar masa konkrete për realizimin e objektivave bazuar në këto qasje;

- Miratimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Institucionet e Qeverisë Qendrore dhe Planin e Integritetit për Ministrinë e Drejtësisë 2020–2023, si dhe forcimin e kapaciteteve monitoruese të Ministrisë së Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, bazuar në kuadrin metodologjik të miratuar nga Ministria e Drejtësisë;

Në zbatim të Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit, Ministria e Drejtësisë në cilësinë e - Koordinatorit Kombëtar ka ndërmarrë veprimtari ndërgjegjësuere në drejtim të luftës kundër korrupsionit, përfshirë dhe organizimin e Javës së Parë të Integritetit në shkurt 2020 dhe Javës së Dytë të Integritetit në dhjetor 2020;

- Ngritja dhe funksionimi i Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion;

-në drejtim të luftës kundër korrupsionit “të vogël”, Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë masa konkrete në drejtim të ofrimit të shërbimeve *online*. Aktualisht ofrohen 759 shërbime *online*, duke përfshirë dhe shërbimet në sektorët më të ndjeshëm. Në total ka mbi 1.2 milionë përdorues të platformës *e-Albania*, të cilët mund të përdorin shërbimet elektronike, duke reduktuar nevojën e pranisë fizike në sportele. Ka pasur deri tani mbi 4.3 milionë përdorime të shërbimeve elektronike të portalit nga qytetarë, biznese, si dhe punonjës të administratës publike;



- Me ligjin 19/2020 janë miratuar ndryshimet në ligjin nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të konfiskuara”;

- Përmbyllja e raundit IV të vlerësimit të GRECO-s për Shqipërinë me objekt “Parandalimi i korrupsionit në lidhje me anëtarët e Parlamentit, gjyqtarët dhe prokurorët” nga ku 10 rekomandime, 9 janë realizuar në mënyrë të kënaqshme;

- Miratimi i ligji nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”;

- Miratimi i ligjit nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”;

- Rritja e ndjeshme e numrit të pasurive të sekuestruara si dhe rritja e numrit të pasurive të konfiskuara. Në këtë rritje ka ndikuar edhe struktura e ngritur në kuadër të Aktit normativ Nr. 1/2020 “Operacioni Forca e Ligjit”;

- Miratimi i Ligjit 112/2020, “Për regjistrin e pronareve përfitues”;

- në proces miratimi në Kuvend janë projektligji, “Për ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme” dhe projektligji, “Për organizatat jofitimprurëse”.

Të drejtat themelore

Shqipëria ka ratifikuar të gjitha Konventat mbi të drejtat e njeriut në kuadrin e OKB-së, si dhe një sërë Konventash të Këshillit të Evropës. Traktatet dhe konventat ndërkombëtare, bashkë me rekomandimet e organeve monitoruese luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e të drejtave të njeriut. Institucionet kombëtare zbatojnë Kushtetutën dhe kuadrin ligjor për të garantuar mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave themelore, si ato politike, ekonomike dhe sociale.

Ndër arritjet kryesore përmendim:

- Miratimi i Ligjit Nr. 80/2020 “Për policinë e burgjeve” dhe Ligjit Nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” ka sjellë disa risi dhe përmirësime në garantimin e të drejtave dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve;

- Gjatë vitit 2020 janë kryer edhe investime në lidhje me rikonstruksionin e plotë të ambienteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, duke krijuar ambiente të bollshme dhe të përshtatshme pune. Brenda këtij investimi janë rikonstruktuar ambientet e Qendrës së Trajnimit me kapacitet rreth 100 persona, si dhe janë pajisur me të gjitha mjetet didaktike;

- Një arritje mjaft e rëndësishme është edhe vendosja e të gjithë të miturve të dënuar dhe të paraburgosur në një institucion të vetëm në të gjithë territorin e RSH-Së (në IEVP Kavajë);

- Lidhur me uljen e mbipopullimit në burgje, sipas të dhënave më të fundit sistemi i burgjeve është në nivel nënpopullimi (- 21%). Kjo ka ardhur si rezultat i ngritjes së institucioneve të reja, aplikimit të dënimeve alternative, si dhe të zbatimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur;

- në zbatim të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” dhe Ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, ka rritje të numrit të hetimeve administrative në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në sektorë të rëndësishëm për kategorinë dhe sasinë e të dhënave personale që përpunojnë apo që kanë ndikim në privatësinë e individit;

- është monitoruar zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga Komisioneri për kontrollues publikë dhe privatë, duke e rritur në 60.34% numrin e rekomandimeve të zbatuara. Zyra e Komisionerit është angazhuar në bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ka luajtur rol proaktiv në kuadër të implementimit të akteve kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të dhënave, sikurse është hartimi i projektligjit për ratifikimin e protokollit që ndryshon Konventën, “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale” të Këshillit të Evropës;

- Zyra e Komisionerit ka realizuar me sukses aktivitetin më të rëndësishëm botëror në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, Konferencën e 41-të Kombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, nënvizuar edhe në Raportin e Bashkimit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020;

- Miratimi i ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”;

- Miratimi i ligjit nr. 78/2020, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës”;

- Funksionimi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe miratimi i të gjitha akteve nënligjore në zbatim të ligjit Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;

- Miratimi i akteve nënligjore, në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit;

- Pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, janë hartuar dhe miratuar 7 nga 12 akte nënligjore;



-në datën 7 maj 2020, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), i njoftoi Qeverisë vendimin në lidhje me aplikimin nr. 29026/06 “Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë”. Referuar përmbajtjes së vendimit, Gjykata ka vlerësuar se skema e re e përdorur nga ligji nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” dhe aktet ligjore të dala në zbatim të tij, konsiderohen të pranueshme referuar parimeve të aplikuara nga neni 1 i protokollit 1 të Konventës.

23.6 Lista e ministrive dhe e institucioneve përgjegjëse:

1. Kuvendi;
2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
3. Ministria e Brendshme;
4. Ministria e Kulturës;
5. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
6. Ministria e Mbrojtjes;
7. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
8. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
9. Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
10. Gjykata e Lartë;
11. Gjykata Kushtetuese;
12. Kontrolli i Lartë i Shtetit;
13. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
14. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
15. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit;
16. Kolegji i Posaçëm i Apelit;
17. Institucioni i Komisionerëve Publikë;
18. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
19. Këshilli i Lartë Gjyqësor;
20. Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
21. Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
22. SPAK;
23. Shkolla e Magjistraturës;
24. Prokuroria e Përgjithshme;
25. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;
26. Departamenti i Administratës Publike;
27. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASP);
28. Agjencia Shtetërore e Kadastrës;
29. Agjencia e Trajtimit të Pronave;
30. Avokati i Popullit;
31. Avokatura e Shtetit;
32. Instituti i Statistikave;

33. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare;

34. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave;

35. Autoriteti i Mediave Audiovizive;

36. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit;

37. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës;

38. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;

39. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;

40. Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;

41. Komiteti i Pakicave Kombëtare.

23.7 Prioritetet

Bazuar edhe në rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020 prioritetet për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” prioritetet janë:

Reforma në drejtësi

- Sigurimi i funksionimit të plotë të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë;

- Miratimi i masave efektive për të plotësuar me përparësi vendet vakante të gjyqësorit dhe Prokurorisë dhe të vijohet me progresin në rekrutimin e magistratëve të rinj;

- Miratimi nga KLGJ-JA i draftpropozimit për hartën e re gjyqësore dhe nisja e procesit të diskutimit me aktorët kryesorë;

- Vazhdimi i përpjekjeve për të forcuar përdorimin efektiv të një sistemi të përmirësuar të menaxhimit të çështjeve, me kapacitet të shëndoshë statistikor bazuar në metodologjinë CEPEJ, e cila siguron rastësinë në alokimin e çështjeve;

- Avancimi më tej me procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve;

- Vijimi i bashkëpunimit të ngushtë me KPK dhe ONM dhe zhvillimi i pjesës së mbetur të shorteve për të gjithë gjyqtarët subjekt të rivlerësimit kalimtar;

- Përfundimi i procesit të vlerësimit për rreth 60 gjyqtarë, duke përfshirë ata të cilët janë kandidatë në një procedurë ngritjeje në detyrë, qoftë në Gjykatën e Lartë ose në gjykatat e apelit;

- Miratimi i Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë 2021–2025 brenda marsit 2020;

- Transformimi gradual i Shkollës së Magjistraturës në një qendër burimore dhe pikë



takimi për të drejtën e Bashkimit Evropian dhe të Drejtën Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

- Ofrimi i trajnimeve të specializuara për magjistratët, këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë, avokatët e shtetit dhe kancelarët në gjykata dhe prokurori;

- Ndërtimi i godinës së re të Shkollës së Magjistraturës;

- Përcaktimi i metodologjisë së zhvillimit të veprimtarisë së ILD-së, lidhur me përgjegjësitë disiplinore të magjistratëve;

- Përmirësimi i teknologjisë në drejtim të sistemit të menaxhimit të çështjeve dhe sistemeve elektronike në shërbim të qytetarëve nga organet e sistemit të drejtësisë.

Lufta kundër korrupsionit

- Arritja e një progresi të mëtjshëm drejt krijimit të një *track record*-i solid të çështjeve të korrupsionit, konfiskimit dhe rikuperimit të pasurive kriminale që rezultojnë nga veprat penale të lidhura me korrupsionin si dhe rritja e mëtjshme e përdorimit të financave hetimore;

- Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH), si dhe gjykatat kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar (GJKKO) të jenë operacionale dhe të adresojnë në mënyrë efektive korrupsionin e nivelit të lartë, të sigurojnë burime dhe bashkëpunim midis këtyre strukturave të reja me strukturat e tjera të prokurorisë dhe gjyqësorit;

- Monitorimi i planit të veprimit 2020–2023 për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit;

- Përmirësimi i aksesit në regjistrat elektronikë kombëtarë për agjencitë e zbatimit të ligjit;

- Funksionimi me kapacitet të plotë i Rrjetit Antikorrupsion si mekanizëm referimi të rasteve korruptive në agjencitë e specifikuar si të ndjeshme ndaj riskut për korrupsion;

- Plotësimi i vendeve vakante të Drejtorisë Antikorrupsion me qëllim funksionimin e strukturës me kapacitete të plota;

- Miratimi i draft- Raportit Vjetor të Vlerësimit në kuadër të rishikimit të kornizës së kuadrit strategjik në fushën antikorrupsion;

- Ngritja e sistemit elektronik të deklarimit të interesave privatë pritët që të jetë tërësisht funksional gjatë 2021.

Të drejtat e njeriut

- Ngritja e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve dhe ngritja e Institucionit të Kufizimit të Lirisë, si dhe Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale;

- Miratimi i Planit tranzitor të masave nga MSHMS-ja dhe MD-ja, në kuadër të përmirësimit të kushteve dhe trajtimit të personave me masë mjekësore mjekim i detyruar;

- Forcimi i mëtjshëm të mekanizmave institucionale për mbrojtjen e fëmijëve, mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, promovimin e të drejtave për personat me aftësi ndryshe, garantimin e barazisë gjinore dhe sigurimi i shërbimeve minimale sociale dhe shëndetësore, sidomos në nivel lokal;

- Ngritja e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në qytetet e planifikuara duke synuar shtrirjen e shërbimit të ndihmës juridike parësore në të gjithë territorin e vendit;

- Miratimi i 5 akteve nënligjore të mbetura për sigurimin e zbatimit të plotë të legjislacionit lidhur me ligjin kuadër nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”;

- Konsolidimi i mëtjshëm dhe forcimi i të drejtave pronësore, veçanërisht duke finalizuar regjistrimin e parë, avancimin në rishikimin e vendimeve për të drejtat e pronës, zbatimin e skemës së kompensimit, dhe vijimin për të bërë përparimin e duhur në digjitalizimin dhe hartëzimin e pronës;

- Përafrimi i legjislacionit kombëtar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të BE-së 679/2016, dhe direktivën 680/2016, nëpërmjet zbatimit me sukses të projektit të binjakëzimit;

- Ngritja e kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit në kuadër të harmonizimit të ligjit me *acquis* të BE-së dhe rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe kontrolluesve publikë dhe privatë mbi risitë e ligjit të ri të harmonizuar.

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, për kapitullin 23 të *acquis* “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian është një detyrim i cili buron prej Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit. Në këtë kuadër, Shqipëria vazhdon përpjekjet për të përafruar në mënyrë graduale legjislacionin e



brendshëm me atë të Bashkimit Evropian me qëllim përmbushjen e detyrimeve dhe shtrimin e rrugës drejt BE. Ministria e Drejtësisë në cilësinë e institucionit lider për kapitullin 23 ka parashikuar si prioritet për vitin 2021 për t'u përafruar me legjislacionin e BE-së masat ligjore të analizuara si më poshtë vijon:

- Përafrimi i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Bashkimit Evropian 2016/679 (GDPR) dhe direktivën 2016/680 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 27 prill 2016, “Për mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente për qëllime të parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjes së veprave penale ose të ekzekutimit të vendimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave” që shfuqizon vendimin kuadër të Këshillit 2008/977/bd.

Kuadri ligjor shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale përbëhet nga Ligji Nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të tij, përafruar në mënyrë të plotë me Direktivën 95/46/EC të Bashkimit Evropian.

Me hyrjen në fuqi të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Bashkimit Evropian 2016/679 (GDPR) në maj të vitit 2018, lindi nevoja e përafrimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale me këtë akt dhe me Direktivën 2016/680 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 27 prill 2016, “Për mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente për qëllime të parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjes së veprave penale ose të ekzekutimit të vendimeve penale, dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave” që shfuqizon vendimin kuadër të Këshillit 2008/977/çbd.

Edhe pse GDPR është Rregullore, kompleksiteti i saj kërkon që të ndërmerren hapat e nevojshëm për ndryshimet legjislative në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria e saj me kuadrin ligjor në fuqi. Qëllimi i GDPR-së është që të mbrojë privatesinë dhe shkeljet e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale në një kohë kur përpunimi i të dhënave në kuadër të zhvillimeve teknologjike është shumëfishuar nga koha në të cilën është themeluar Direktiva e vitit 1995.

Megjithëse parimet kryesore të mbrojtjes së të dhënave janë akoma në përputhje me direktivat e mëparshme, shumë ndryshime janë propozuar për politikën rregullatore. Disa nga risitë që sjell kjo Rregullore mbi mbrojtjen e të dhënave personale janë:

Zgjerimi i shtrirjes territoriale të efekteve të saj ligjore

Ndoshta ndryshimi më i madh në peizazhin rregullator të mbrojtjes së të dhënave vjen me juridiksionin e zgjeruar të efekteve të GDPR-së. Më parë, aplikimi territorial i direktivës ishte i paqartë. GDPR e bën zbatueshmërinë e saj shumë të qartë. GDPR-ja do të jetë e zbatueshme për përpunimin e të dhënave personale nga kontrolluesit dhe përpunuesit që ndodhen në vendet e BE-së, pavarësisht nëse përpunimi kryhet apo jo në këto vende.

Forcimi i kriterëve për dhënien e pëlqimit

Ka një qasje të re lidhur me konceptin e “pëlqimit” sipas GDPR-së. Në rregulloren e re trajtohen konkretisht aspektet praktike të pëlqimit dhe aspekte të tjera që lidhen me pëlqimin e të miturve ose pëlqimin me mjete elektronike.

Të drejtat e reja - E drejta për t'u harruar - “Right to be forgotten”

Kjo do të thotë që subjekti i të dhënave ka të drejtën t'i kërkojë kontrolluesit të bëjë fshirjen e të dhënave personale në lidhje me të, pa vonesë, dhe kontrolluesi ka detyrimin të fshijë të dhënat personale, bazuar në shkaqet e parashikuara në Rregulloren e BE-së.

E drejta e transferueshmërisë së të dhënave - Data Portability

Subjekti i të dhënave ka të drejtën të marrë të dhëna personale që ai ose ajo i ka dhënë kontrolluesit, në një format të strukturuar, të përdorur gjerësisht dhe të lexueshëm automatikisht dhe t'i transferojë ato të dhëna te një kontrollues tjetër pa pengesë.

Forcimi i llogaridhënies

GDPR-ja sjell një forcim të llogaridhënies në raport me përpunuesit e të dhënave. Kontrolluesit janë të detyruar të tregojnë më shumë vëmendje në respektimin e parimeve të mbrojtjes së të dhënave dhe të drejtave në çdo fazë të përpunimit të të dhënave duke krijuar një kulturë të monitorimit, rishikimit dhe vlerësimit të procedurave të përpunimit të të dhënave apo dhe përmes rritjes së sanksioneve ndaj moszbatuesve të ligjit për mbrojtjen e të dhënave.



Rritja e transparencës

Parimi i transparencës kërkon që çdo informacion që i drejtohet publikut ose subjektit të të dhënave të jetë konciz, i aksesueshëm lehtësisht dhe i lehtë për t'u kuptuar dhe të përdoret gjuhë e lehtë dhe e qartë, e përveç kësaj, sipas rastit, edhe vizualizim.

Mbrojtja e të dhënave të fëmijëve

Fëmijët meritojnë mbrojtje specifike në lidhje me të dhënat e tyre personale, pasi ata mund të jenë më pak të ndërgjegjshëm për rreziqet, pasojat dhe garancitë përkatëse dhe të drejtat e tyre në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.

Forcimi i pavarësisë së Autoritetit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

GDPR garanton pavarësinë e plotë të Autoriteteve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke sugjeruar rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe financiare.

Krijimi i rrjetit të Oficerëve të Mbrojtjes së të Dhënave (DPO)

GDPR sjell si risi detyrimin për caktimin e Oficerëve të Mbrojtjes së të Dhënave të cilët duhet të caktohen me qëllimin për të vlerësuar nëse një organizatë kryen një përpunim të gjerë të të dhënave personale.

Certifikimi i kontrolluesve-përpunuesve të mbrojtjes së të dhënave

Në zbatim të nenit 43 të rregullores 2016/679, kërkohet certifikimi i kontrolluesve të mbrojtjes së të dhënave sipas kërkesës së tyre. Në këtë kuptim, autoriteti mbikëqyrës duhet të ketë krijuar kushtet e nevojshme ligjore për:

- hartimin dhe miratimin e aktit ligjor ose nënligjor, "Për certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre";
- akreditimin e organit certifikues;
- certifikimin e kontrolluesve.

Sa më sipër, qëllimi i parashikimit të këtij akti në PKIE është harmonizimi i të gjithë kuadrit ligjor ekzistues për mbrojtjen e të dhënave personale me praktikatat më të mira të BE-së në mënyrë që të garantohet kjo e drejtë. Sikurse vërehet, risitë që sjell rregullorja e GDPR janë të shumta. Edhe pse Shqipëria nuk është pjesë e BE-së, si një vend që aspirojnë integrimin, duhet të ndjekë trendin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me *acquis*.

Gjithashtu, përafrimi i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren e Faqe | 4168

Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Bashkimit Evropian 2016/679 (GDPR) dhe Direktivën 2016/680 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 27 prill 2016, "Për mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente për qëllime të parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjes së veprave penale ose të ekzekutimit të vendimeve penale, dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave", që shfuqizon vendimin kuadër të Këshillit 2008/977/çbd është aktualisht një nga prioritetet e Qeverisë Shqiptare si një nga detyrimet e parashikuara edhe në Raportin e Bashkimit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020.

Në këtë kontekst, për vetë rëndësinë që mbart Reforma e BE-së për mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit"), ka iniciuar punën për hartimin e ndryshimeve ligjore. Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit është përfutuese e projektit të binjakëzimit, financuar nga programi i BE-së IPA 2017, sipas aktivitetit "Ndërtimi i institucioneve për harmonizimin me *acquis* të BE për të përmbushur kriteret ekonomike lidhur me mbrojtjen e të dhënave", i cili ka si qëllim të asistojë Zyrën e Komisionerit në përafrimin e legjislacionit kombëtar në fuqi me *acquis* të BE-së në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe të mbështesë në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative të institucioneve shqiptare për ta zbatuar këtë *acquis*. Zbatimi i projektit ka filluar me datë 1 Tetor 2020 dhe do të zgjasë 12 muaj.

Aktualisht zbatimi i projektit ka filluar me implementimin e Komponentit 1 të tij që është: "Harmonizimi i legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale me GDPR dhe Direktivën e Policisë" dhe do të vijojë me dy komponentët e tjerë të cilët janë: "Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e kuadrit të ri ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe Komponenti 3 "Ndërgjegjësim i kontrolluesve dhe përpunuesve me qëllim që të sigurohet zbatimi i kuadrit të ri ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale".

Përafrimi i legjislacionit penal me direktivat e BE-së, si pjesë e kapitujve 23, dhe kapitujve të tjerë të *acquis*

Nga hyrja në fuqi e Kodit Penal deri aktualisht, kanë kaluar 25 vite. Për shkak të dinamizmit



nëpërmjet të cilit karakterizohen marrëdhënie shoqërore, gjatë kësaj periudhe kohore janë ndërmarrë një sërë nismash për ndryshimin e tij, të cilat kanë prekur si pjesën e përgjithshme, ashtu edhe pjesën e posaçme të Kodit. Kjo shpreshtësi ndryshimesh përbën shkak për prishjen e balancës dhe rrjedhës logjike që duhet të ekzistojë ndërmjet dispozitave të këtij Kodi.

Hartimi i Kodit të ri Penal lindi pikërisht si pasojë e shpreshtësisë së ndryshimeve dhe shtesave të pasqyruara në përmbajtje të Kodit Penal, mungesës së efektivitetit të ndryshimeve që janë bërë ndër vite si rrjedhojë e ndryshimit të sanksioneve për veprat penale, riformulimit të dispozitave, dhe si nevojë e harmonizimit të dispozitave mes tyre, përputhshmërisë së Kodit Penal me aktet ndërkombëtare në fuqi, si dhe përafrimit të tij me të drejtën e Bashkimit Evropian, duke qenë se anëtarësimi në BE është një nga aspiratat kryesore të Shqipërisë në këto vite. Aktualisht në fokus të së drejtës penale, për shkak edhe të zhvillimeve globale, është pastrimi i parave, lufta kundër terrorizmit, mbrojtja e të drejtave financiare, mbrojtja e ambientit, ndalimi i trafikimit të narkotikëve, ndalimi i tregtimit dhe qarkullimit të ndaluar të armëve të ftohta apo armëve të fuqishme. Në këtë kuadër, do të mbahen parasysh aktet e Bashkimit Evropian për t'u parashikuar në Kodin Penal me qëllim përafrimin e tyre, në zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit.

Me anë të këtij Plani Kombëtar të Integritetit Evropian, synohet përafrimi i Kodit të ri Penal me Direktivat e BE-se, të cilat janë pjesë e kapitujve 23, 24, 19 dhe 17 të *acquis*, si më poshtë:

- Direktiva 2017/1371³⁷ “Në luftën kundër mashtrimit ndaj interesave financiarë të Bashkimit Evropian”;

- Direktiva 2017/541³⁸ e Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Në luftën kundër terrorizmit”;

- Direktiva 2015/849³⁹ ndryshuar nga direktiva 2018/843 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, “Në parandalimin e përdorimit të sistemeve financiare me qëllim pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit”;

- Direktiva 89/654⁴⁰ e Këshillit të BE-së “Mbi vendosjen e masave minimum të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës”;

- Direktiva 89/391⁴¹ e Këshillit të BE-së “Mbi nxitjen e përmirësimit të sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve në ambientet e punës”;

- Direktiva 2011/93/EU⁴² “Në luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve”;

- Direktiva 2014/62/EU⁴³ e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, “Për mbrojtjen nga ligji penal të Euros dhe monedhave të tjera kundër falsifikimit”;

- Direktiva 2014/42/EU⁴⁴ “Mbi sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve/të ardhurave të krimeve të kryera në Bashkimin Evropian”;

- Direktiva 2011/36⁴⁵ “Mbi parandalimin dhe luftën e trafikut të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tyre”;

- Direktiva “Vendimi Kuadër i Këshillit 2004/757/JHA i 25 tetorit 2004 që përcakton dispozitat minimale mbi elementet përbërëse të veprave penale dhe ndëshkimeve në fushën e trafikimit të paligjshëm të drogës”.

Është i nevojshëm përafrimi i Kodit Penal me direktivën 2017/1371, “Në luftën kundër mashtrimit ndaj interesave financiarë të Bashkimit Evropian”, duke parashikuar inkriminimin e cenimit të interesave financiarë të Bashkimit Evropian nëpërmjet mashtrimit, si dhe duke shtuar llojet e dënimeve për personat juridikë.

Gjithashtu, duhet të garantohen standardet e vendosura nga Bashkimi Evropian nëpërmjet Direktivës 2017/541 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Në luftën kundër terrorizmit”, duke njehsuar terminologjinë e përdorur, si dhe duke zgjeruar anën objektive të veprave penale terroriste edhe për sa u përket sulmeve ndaj integritetit fizik të personit, shkatërrimit të një platforme fikse të vendosur në shelfin kontinental, një vendi publik ose privat që mund të rrezikojë jetën e njeriut ose të rezultojë në humbje të mëdha ekonomike, ndërhyrjes së paligjshme në sistemet apo të dhënat, vjedhjes së rëndë me qëllim të kryerjes së veprave penale terroriste, zhvatjes me qëllim kryerjen e

³⁷ Direktivë e përfshirë në kapitullin 23.

³⁸ Direktivë e përfshirë në kapitullin 24.

³⁹ Direktivë e përfshirë në kapitullin 23.

⁴⁰ Direktivë e përfshirë në kapitullin 19.

⁴¹ Direktivë e përfshirë në kapitullin 19.

⁴² Direktivë e përfshirë në kapitullin 24.

⁴³ Direktivë e përfshirë në kapitullin 17.

⁴⁴ Direktivë e përfshirë në kapitullin 23.

⁴⁵ Direktivë e përfshirë në kapitullin 24.



veprave penale terroriste, hartimit ose përdorimit të dokumenteve të rreme administrative me qëllim kryerjen e veprave penale terroriste. Gjithashtu është i nevojshëm shtimi i veprave penale të udhëtimit me qëllime terroriste dhe lehtësimi apo organizimi i udhëtimit me qëllim kryerjen e veprave terroriste.

Është i nevojshëm përafrimi i Kodit Penal me Direktivën 2015/849 ndryshuar nga Direktiva 2018/843 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, “Në parandalimin e përdorimit të sistemeve financiare me qëllim pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit”, duke i dhënë një përkufizim të unifikuar veprimtarisë së “pastrimit të parave” për të qenë në përputhje me parashikimin e Direktivës dhe standardeve evropiane.

Kodi Penal ka një qasje të re mbi mbrojtjen në punë. Për pasojë, ka lindur nevoja për ta parë në këndvështrim të Direktivës 89/654 të Këshillit të BE-së “Mbi vendosjen e masave minimum të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës”, si dhe Direktivës 89/391 të Këshillit të BE-së “Mbi nxitjen e përmirësimit të sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve në ambientet e punës”.

Veprat penale në fushën seksuale kanë marrë një vëmendje të veçantë vitet e fundit, ndaj në Kodin e ri Penal është i nevojshëm përafrimi i plotë me direktivën 2011/93/EU “Në luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve”. Direktiva parashikon kriminalizimin e figurës së tërheqjes/angazhimit dhe ekspozimit të fëmijëve ndaj akteve seksuale pa pasur nevojën e asistimit në veprimtarinë seksuale, përfshirjen në veprimtari seksuale etj. Masat e dënimit synohen të përcaktohen në përputhje me parashikimet e direktivës. Direktiva kërkon inkriminimin lidhur me shtrëngimin, detyrimin ose kërcënimin e një fëmije në aktivitete seksuale me një palë të tretë. Direktiva kërkon inkriminimin e blerjes së materialeve pornografike të fëmijëve etj.

Duke i paraprirë integritet të Shqipërisë në Bashkimin Evropian ka lindur nevoja për të parashikuar në ligjin e brendshëm penal rregulla juridike mbi mbrojtjen e monedhës Euro dhe monedhave të tjera, sipas parashikimeve apo standardeve të vendosura nga direktiva 2014/62/EU e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, “Për mbrojtjen nga ligji penal të euros dhe

monedhave të tjera kundër falsifikimit”. Direktiva kërkon që shtetet të marrin masat e nevojshme për të siguruar që sjelljet në vijim të dënohen si veprë penale, kur kryhen me dashje:

- importimi, eksportimi, transportimi, mbajtja e monedhës së falsifikuar kur subjekti ka dijeni se është e falsifikuar;

- instrumente, artikuj, programe kompjuterike dhe të dhëna, dhe çdo mjet tjetër i përshtatur posaçërisht për falsifikimin ose ndryshimin e monedhës;

- karakteristikat e sigurisë, të tilla si hologramet ose përbërës të tjerë të monedhës që shërbejnë për të mbrojtur nga falsifikimi etj.

Është i nevojshëm përafrimi i direktivës 2014/42/EU “Mbi sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve/të ardhurave të krimeve të kryera në Bashkimin Evropian”, me qëllim krijimin e një kuadri të plotë ligjor i cili gjen aplikim në rastet e kryerjes së veprave penale në BE të cilat gjenerojnë të ardhura. Përkufizimi i termave dhe dënimet kërkojnë unifikim, ndaj është e rëndësishme që kjo Direktivë të përfshihet në Kodin e ri Penal.

Pavarësisht rëndësisë që i është dhënë në Shqipëri luftës ndaj trafikut të qenieve njerëzore, është e domosdoshme përfshirja në ligjin e brendshëm të parashikimeve të Direktivës 2011/36 “Mbi parandalimin dhe luftën e trafikut të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tyre”, pasi kjo direktivë vendos një standard minimal rregullash që lidhen me përcaktimin e veprave penale dhe sanksioneve në fushën e trafikut të qenieve njerëzore. Ajo paraqet gjithashtu dispozita duke marrë parasysh perspektivën gjinore për të forcuar parandalimin e këtij krimi dhe mbrojtjen e viktimave të tij. Nëse kjo veprë është kryer nga zyrtarë publikë, kjo gjë do të konsiderohet si rrethanë rëndëse. Dënimi në këtë rast duhet të jetë efektiv, dekurajues dhe proporcional. Për këto vepra penale, duhet të merren masat që personat juridikë të mos i shpëtojnë përgjegjësisë. Po ashtu, Direktiva përcakton detyrimet e shtetit për ndihmë ndaj viktimave të trafikut, mbrojtjen e fëmijëve viktimë të krimit të trafikut të qenieve njerëzore dhe kompensimin e tyre.

Gjithashtu në kuadër të integritet të Shqipërisë në Bashkimin Evropian ka lindur nevoja për të parashikuar në ligjin e brendshëm penal rregulla juridike mbi dënimet ku vepra përfshin sasi të mëdha droge si dhe vepra përfshin droga më të



dëmshme për shëndetin ose ka shkaktuar dëme të konsiderueshme në shëndetin e një numri personash. Sipas parashikimeve apo standardeve të vendosura nga Direktiva 2004/757/EU, datë 25 tetor 2004, “Për vendosjen e rregullave minimum mbi elementet përbërëse të veprave penale dhe sanksioneve në fushën e trafikimit të drogës”. Direktiva kërkon që shtetet të marrin masat e nevojshme për të siguruar që dënimet e parashikuara nga shtetet anëtare duhet të jenë efikase, proporcionale dhe shtrënguese dhe të përfshijnë edhe dënime me privim të lirisë. Për të përcaktuar nivelin e dënimeve, duhet të merren në konsideratë elemente faktike, si p.sh. sasitë dhe llojet e drogave të trafikuar dhe fakti nëse vepra është kryer në kuadër të një organizate kriminale.

KAPITULLI 24 DREJTËSIA, LIRIA, SIGURIA

24.1 Përmbajtja e kapitullit

Politikat e BE-së kanë për qëllim të zhvillojnë më tej Bashkimin si një fushë lirie, sigurie dhe drejtësie. Për çështje të tilla si kontrolli kufitar, vizat, migrimi i jashtëm, azili, bashkëpunimi policor, lufta kundër krimit të organizuar dhe kundër terrorizmit, bashkëpunimi në fushën e drogës, bashkëpunimi doganor dhe bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale dhe civile. Shtetet Anëtare duhet të jenë të pajisura në mënyrën e duhur për të zbatuar në mënyrë të përshtatshme kuadrin në rritje të rregullave të përbashkëta. Mbi të gjitha, kjo kërkon një kapacitet administrativ të fuqishëm dhe të integruar brenda agjencive të zbatimit të ligjit dhe organeve të tjera relevante, të cilat duhet të arrijnë standardet e nevojshme. Një polici profesionale e organizuar mirë, e besueshme dhe efikase është me rëndësi të madhe. Pjesa më e detajuar e politikave të BE-së për drejtësinë, lirinë dhe sigurinë është *acquis* e Schengen-it. Gjithsesi, për Shtetet e reja Anëtare, pjesë thelbësore të *acquis* të Schengen-it, janë implementuar, duke ndjekur një vendim më vete të Këshillit, të marrë pas hyrjes së tij në fuqi.

Pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, Fusha e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë rregullohet në Titullin V të Traktatit për Funksimimin e Bashkimit Evropian (nenet 67–89). Për më tepër, Karta e të Drejtave Themelore është bërë e detyrueshme dhe Bashkimi Evropian - sipas nenit 6

TEU - është në rrugën drejt anëtarësimit në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Protokollin 36 i Traktateve Themelore rregullon statusin e legjislacionit përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, i cili ishte miratuar nën kuadrin e Shtyllës së Tretë së mëparshme të Bashkimit Evropian. Fusha e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë përfshin legjislacionin dytësor në fushat kryesore: Migracioni, Vizat dhe Azili; Bashkëpunimi Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale; dhe Bashkëpunimi Gjyqësor në Çështjet Civile. Dy fushat e para dominohen nga direktivat dhe vendimet kornizë, ndërkohë që këto të fundit përmbajnë direktiva të zbatueshme drejtpërdrejt. Legjislacioni primar dhe sekondar plotësohet nga një vëllim i madh i jurisprudencës së Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian.

Acquis për këtë kapitull përbëhet nga një vëllim prej 392 aktesh. *Acquis* i transpozueshëm ndahet në “*hard acquis*” (*acquis* që buron nga aktet me efekt detyrues siç janë traktatet, direktivat, rregulloret etj. të BE-së) dhe “*soft acquis*” (*acquis* që buron nga standardet, parimet e rekomandimet e institucioneve të BE-së apo organizatave të tjera ndërkombëtare relevante).

24.2 Struktura e kapitullit

1. Lufta kundër krimit të organizuar
2. Lufta kundër terrorizmit
3. Migrimi i rregullt dhe i parregullt
4. Azili
5. Politika e vizave
6. Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe penale
7. Bashkëpunimi Doganor (shih kapitullin 29)

24.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Sipas nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë të drejtën e saj kombëtare me *acquis* të BE-së. Bashkëpunimi në fushën e menaxhimit të kufijve ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së është parashikuar në nenin 80 të MSA-së. Në vazhdim, bashkëpunimi në fushën e migracionit midis Shqipërisë dhe BE-së është parashikuar në nenet 4, 80 dhe 81 të MSA-së, ndërsa bashkëpunimi në fushën e politikës së vizave dhe azilit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian parashikohet në nenin 80 të MSA-së.



Neni 80 përcakton që puna duhet përqendruar në zbatimin e legjislacionit të brendshëm për të përmbushur standardet e Konventës së Gjenevës të vitit 1951 dhe Protokollit të Nju-Jorkut të vitit 1967, për të siguruar respektimin e parimit të moskthimit të individit në vendin që përbën një kërcënim për jetën e tij, si dhe të drejta të tjera të azilkërkuesve dhe refugjatëve.

Zhvillimet në fushën e bashkëpunimit policor dhe luftën kundër krimit të organizuar midis Republikës së Shqipërisë dhe BE-së është parashikuar në nenet 4, 82, 84 dhe 85 të MSA. Nenet 4 dhe 85 të MSA-së parashikojnë bashkëpunimin midis Shqipërisë dhe BE-së në luftën kundër trafikimit të paligjshëm. Më tej, nenet 4 dhe 82 të MSA-së parashikojnë bashkëpunim në luftën kundër pastrimit të parave. Gjithashtu, në nenet 5, 82 dhe 84 SAA, parashikohet bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe BE-së në luftën kundër terrorizmit. Nenet 83 dhe 85 të MSA-së parashikojnë bashkëpunim në luftën kundër drogës. Detyrimet në fushën e doganave parashikohen në nenet 14, 15, 34, 43 dhe 97. Së fundi, bashkëpunimi në çështjet penale është përcaktuar në nenin 85 të MSA-së.

24.4 Situata aktuale në Shqipëri

Në vijim të takimit shpjegues për kapitullin 24 në nëntor 2018 në Bruksel, Ministria e Brendshme me qëllim përshtatjen e legjislacionit në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, migracionit të paligjshëm, terrorizmit, me standardet dhe praktikatat më të mira evropiane, Ministria e Brendshme në bashkëpunim edhe me institucionet e tjera përgjegjëse, inicioi dhe vijoi punën për procesin *screening* në kuadër të këtij kapitulli.

Këto aktivitete u mbështetën nga projekti i financuar nga IPA “Mbështetje këshilluese e nivelit të lartë për Ministrinë e Evropës dhe Punëve të Jashtme dhe ministrinë e linjës të zgjedhura në funksion të përgatitjes së negociatave të pranimit në Shqipëri” dhe “Mbështetje për procesin *pre-screening* për negociatat e pranimit në BE të Shqipërisë”, financuar nga Ministria Gjermane e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Zhvillimit’.

Puna e Grupit Ndërinstitucional të Punës u përcaktua me urdhrin nr. 666 datë 18.12.2018 “Mbi organizimin e punës për analizën *screening*” të ministrit të Brendshëm, dhe urdhrin e ri të ministrit të Brendshëm nr. 145, datë 31.1.2019, me objekt “Mbi disa ndryshime në urdhrin nr. 666 datë

18.12.2018 mbi organizimin e punës për analizën *screening*”. Mes të tjerash, këto urdhra identifikuan anëtarët e grupeve të punës me detyrën për të përgatitur tabelat e përputhshmërisë.

Përfundimi i tabelave të përafrimit u asistua nga ekspertë Këshillues të Nivelit të Lartë, ekspertë të GIZ dhe SEESAC. Gjithashtu, dy vizita studimore u organizuan nga PAMECA dhe ekspertë të Nivelit të Lartë në Kroaci me anëtarët e grupit të punës për kapitullin 24 të përfshirë në këtë proces.

Disa trajnime u zhvilluan me të gjithë anëtarët e ekipit shqyrtues për përgatitjen e tabelave të përputhshmërisë dhe plotësimin e tabelës së kapaciteteve institucionale të organizuar nga ekspertë të Projektit të Mbështetjes së Nivelit të Lartë për negociatat e pranimit dhe GIZ.

Gjithashtu, me ndihmën e Projektit GIZ, u organizua një takim simulues, ku ekspertët dhanë udhëzime për zhvillimin e takimit bilateral Shqipëri-BE.

Lidhur me *Acquis*, SEESAC ka asistuar në hartimin e ligjit për armët, disa vizita studimore trajnimi në Prishtinë etj.

Në fillim të vitit 2020, Ministria e Brendshme, ka përfunduar punën për realizimin e procesit *screening*. Aktualisht, Ministria e Brendshme është në fazën që ka përfunduar përmirësimin e tabelave përfundimtare të analizës ligjore dhe tabelave të kapaciteteve institucionale sipas fushave që mbulon Kapitulli 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”.

Lufta kundër krimit të organizuar/ drogës/ terrorizmit

Shqipëria po zbaton një sërë masash në luftën kundër krimit të organizuar. Operacionet policore për shkatërrimin e grupeve kriminale janë intensifikuar. Gjatë vitit 2019 janë goditur 28 grupe kriminale të trafikut dhe shpërndarjes së drogës. Gjatë periudhës Janar-shtator 2020 janë goditur 32 grupe kriminale të trafikut dhe shpërndarjes së drogës.

Në vitet e fundit, Shqipëria ka treguar vazhdimisht një angazhim të fortë për të luftuar prodhimin dhe trafikimin e kanabisit. Shqipëria lejon monitorimin ajror nga një Shtet Anëtar i BE-së (monitorime ajrore nga *Guardia di Finanza* Italiane, bashkëfinancuar nga BE-ja). Shqipëria ka nënshkruar një marrëveshje me EMCDDA. Bashkëpunimi ndërkombëtar i policisë, veçanërisht me Shtetet Anëtare të BE-së, gjithashtu është intensifikuar, duke çuar në një numër operacionesh të suksesshme të zbatimit të ligjit në shkallë të gjerë.



Operacioni “Forca e ligjit” ka çuar në rritje të bashkëpunimit mes policisë dhe prokurorisë, i cili gjithashtu duhet të zgjerohet në agjenci dhe organe të tjera relevante. Është bërë progres në lidhje me përafrimin e legjislacionit përkatës me standardet evropiane dhe praktikat më të mira, si dhe konfiskimet e aseteve kriminale. Gjatë vitit 2019 janë sekuestruar në total rreth 95. 122. 511 euro pasuri, llogari bankare, *cash* që janë vënë nga veprimtaria kriminale e personave e grupeve kriminale. Gjatë periudhës janar–shtator 2020 janë sekuestruar në total rreth 17 493 985 euro pasuri që janë vënë nga veprimtaria kriminale e personave e grupeve kriminale dhe konfiskuar 150 000 euro pasuri.

Në fushën e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore po zbatohet Plani i Veprimit për periudhën 2018–2020, si dhe po zbatohen Procedurat Standarde për Mbrojtjen e Viktimave të Mundshme të Trafikimit. Në zbatim të Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave, në prill 2020, u hartua raporti i monitorimit.

Lufta kundër terrorizmit është konsideruar si një prioritet për agjencitë ligjzbatuese dhe kuadrin ligjor si dhe janë ngritur strukturat për të parandaluar dhe luftuar çdo kërcënimin ndaj sigurisë, nga aktet terroriste.

Është nënshkruar në 5 tetor 2018 Plani i Përbashkët i Veprimit në luftën kundër terrorizmit. Një protokoll bashkëpunimi është firmosur me Maqedoninë e Veriut në Shkurt 2019 në këtë fushë. Janë bërë përparime në përmirësimin e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e luftës kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm me pajisje logjistike që ndihmojnë hetimet kundër terrorizmit që i shërbejnë njësisë operationale në Drejtorinë e Antiterrorit. Ndërkohë, është krijuar edhe Njësia për Hetimin e Financimit të Terrorizmit, në Drejtorinë e Antiterrorit. Bashkëpunimi rajonal dhe shkëmbimi i informacioneve të ndjeshme me partnerët ndërkombëtarë është i kënaqshëm. Është intensifikuar bashkëpunimi me Europol përmes rritjes së shkëmbimit të informacionit.

Gjatë periudhës janar–tetor 2020, është intensifikuar shkëmbimi i informacionit me Europol dhe Qendrën Evropiane të Antiterrorizmit për përfshirjen në aktivitete terroriste, ku si rezultat i Projektit *Vennling* - nismës

Europol për të identifikuar personat e arrestuar në konflikt të armatosur në Siri dhe Irak,. Gjithashtu, janë intensifikuar kontaktet me Europol SIENA, ku përgjigjet janë verifikuar, trajtuar dhe kthyer në të gjitha rastet e kërkuara.

Bashkëpunimi në shkëmbimin e informacionit me shërbimet kundër terrorizmit në vendet e rajonit është intensifikuar siç janë Italia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia, dhe shërbimet e specializuara në BE, vendet anëtare dhe agjencitë e BE për shtetas shqiptarë dhe të huaj të përfshirë në aktivitetet terroriste. Drejtoria e Antiterrorit është pjesë e pikave qendrore të “Hydra”, “Dolphin” dhe “Travellers” të Europol.

Strukturat e Drejtorisë së Antiterrorit kanë marrë vlerësime pozitive nga partnerët tanë strategjikë për punën, përkushtimin, profesionalizimin dhe rezultatet e arritura në parandalimin, ndjekjen dhe goditjen e individëve/grupeve me aktivitet kriminal me sfond terrorist.

Lidhur me kthimin e shtetasve shqiptarë pjesëtarë në luftime në Siri/Irak dhe familjarëve të tyre (gra e fëmijë), që në shumicën e rasteve janë çuar në zonat e luftës përmes dhunës apo mashtrimit, prandaj që në vitin 2018, me inicim të Policisë së Shtetit (Drejtorisë Antiterrorit) është miratuar “Plani i veprimit ndërinstitucional për pritjen dhe trajtimin e shtetasve shqiptarë gjatë kthimit nga vendet në konflikt Siri/Irak”, miratuar me urdhër të Kryeministrit nr. 169, datë 1.11.2018. Janë planifikuar detyra konkrete për disa ministri dhe institucione vartëse të cilat kanë detyrime në lidhje me kthimin dhe pritjen e luftëtarëve të huaj terroristë dhe të afërmeve të tyre nga zonat e konfliktit në Siri/Irak.

Shqipëria ka një **kuadër ligjor** gjithëpërfshirës për parandalimin dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe është mjaft e avancuar në përafrimin me legjislacionin kryesor të BE-së për luftën kundër terrorizmit. Ajo është palë në të gjitha konventat kundër terrorizmit të Këshillit të Evropës, përfshirë ato që mbulojnë sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe financimin e terrorizmit. Në vitin 2019, ajo forcoi kuadrin e saj ligjor me ndryshimet legjislative në zbatim të rezolutave e sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Kundërshtimi i Radikalizmit dhe Lufta Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm



Qeveria Shqiptare ka hartuar Strategjinë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, i cili është një dokument strategjik, gjithëpërfshirës në funksion të hartimit të politikave të mirëfillta për adresimin e shkaqeve multidimensionale që çojnë në ekstremizëm dhe radikalizëm, por edhe zhvillimin e qasjes parandaluese me anë të fuqizimit të rolit të komunitetit dhe profesionistëve të vijës së parë në nivel qendror dhe lokal (përfshirë Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike në rreth 61 Bashki të vendit). Aktualisht, Qendra CVE parashikon brenda 2020 të nisë procesin e hartimit të Strategjisë së re për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, një dokument ky që vjen si domosdoshmëri për t'u përshtatur me realitetin e sotëm dhe me zhvillimet e fundit në vendin tonë.

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga “Plani i Përbashkët i Veprimit për Antiterrorizmin (CT/CVE) për Ballkanin Perëndimor”, është kryer edhe raportimi i parë në Qershor të 2020, duke përfshirë kontributin e të gjithë institucioneve të përfshira në këtë proces.

Në maj 2019 është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Qendrës CVE dhe Komuniteteve Fetare (Mysliman, Ortodoks, Katolik, Bektashi dhe Protestant).

Qendra CVE ka koordinuar, mbështetur si dhe ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme që kanë të bëjnë me kundërshtimin e çdo forme të financimit të terrorizmit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga FATF bazuar në raportin e fundit të Moneyval për Shqipërinë, si dhe aktivitete të tjera në lidhje me këtë çështje. Këto trajnime, të organizuara nga OSBE, UNODC, Këshilli i Evropës dhe ICITAP (ToT), janë bashkë-koordinuar me stafin e Qendrës CVE dhe atë të pikave të kontaktit nga ministrinë e linjës.

Qendra CVE ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme, në koordinim dhe me mbështetjen e *EU DG Home* dhe Delegacionit të BE-së në Tiranë, në mënyrë që të krijojë një përdorim proaktiv të mjeteve të Europol dhe Qendrës së tij Evropiane kundër terrorizmit me synim zhvillimin e një strategjie më efikase komunikimi (veçanërisht në internet). Qendra CVE nisi një bashkëpunim më të ngushtë me përfaqësuesit e Rrjetit Evropian të Komunikimeve Strategjike (ESCN).

Është hartuar plani sektorial i riintegritimit të Ministrisë së Drejtësisë, qëllimi i të cilit është edhe

zhvillimi i kapaciteteve deradikalizuese dhe riintegruese në Sistemin e Burgjeve dhe Shërbimin e Provës, dhe duke përfshirë një komponent të rëndësishëm të respektimit të të drejtave të njeriut sikurse është ndihma ligjore e garantuar nga shteti dhe për këtë grup individësh.

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të sistemit të burgjeve dhe shërbimit të provës, është hartuar një raport vlerësimi, i cili shqyrton nevojat dhe kapacitetet e tyre për P/CVERLT⁴⁶ (OSBE, në bashkëpunim me UNICRI), si dhe një Modul Trajnimi bazë për P/CVERLT, për trajnimin e personelit të sistemit të burgjeve. Gjithashtu, është miratuar zyrtarisht një udhëzues administrativ për “Identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të ekstremizmit të dhunshëm në Sistemin e Burgjeve”. Janë rritur e fuqizuar kapacitetet e rreth 660 punonjësve të nivelit bazë dhe të mesëm të sektorëve të ndryshëm, në 24 institucione të sistemit të burgjeve në gjithë vendin, si dhe të 100 punonjësve të Shërbimit të Provës nga 22 zyra vendore për çështjet e P/CVE.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka aktualisht nga një Protokoll të nënshkruar me Komunitetin Mysliman Shqiptar për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve. Qendra CVE, në bashkëpunim të ngushtë me KNFSH po bashkëpunon në forcimin e bashkëpunimit më së shumti në nivel vendor.

Një tjetër arritje në këtë drejtim ka qenë pajisja e shkollave me një plan veprimi për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në rang republike. Gjithashtu, me anë të marrëveshjes dypalëshe ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, u krijua struktura e Oficerëve të Sigurisë në Shkollë (OSSH), një risi e sistemit arsimor shqiptar në kontekstin e garantimit të një shkolle të sigurt dhe miqësore.

Që nga viti 2019 (VKM nr. 148, datë 5 nëntor 2019), ka nisur procesi për re-integrimin e luftëtarëve të huaj dhe familjarëve të tyre. Në këtë qasje, procesi i parë riintegruer që konkretisht po realizohet që nga maji 2020, ka në trajtim 9 njësi familjare, ku në total në këtë skemë kemi të përfshirë 50 shtetas, të ndarë në burra, gra/vajza dhe fëmijë po marrin trajtimin socio-shëndetësor së bashku me skemë për mbështetje financiare si nga

⁴⁶ Preventing/countering violent extremist radicalization leading to terrorism (VERLT).



strukturat në nivel lokal por dhe nga partnerë ndërkombëtarë.

Në kuadër të fuqizimit dhe qëndrueshmërisë në nivel lokal, që prej vitit 2018, në 6 bashkitë e vendit (Bulqizë, Cërrik, Dibër, Kamzë, Librazhd dhe Pogradec) janë zhvilluar aktivitete që kontribuojnë në parandalimin e përjashtimit social, ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit, marginalizimit, rekrutimit dhe konfliktit, leadershipit dhe advokimit. Janë ngritur 6 borde rinore me pjesëmarrje aktive të rreth 150 të rinjve përmes aktiviteteve të përmuajshme.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u hartuan dhe shpërndanë pyetësorët e parë mbi vlerësimin e kapaciteteve institucionale në qasje të parandalimit dhe rehabilitimit/riintegritimit të ekstremizmit të dhunshëm gjatë vitit 2019. Mbi këto baza po hartohen në vijim trajnime/ sesione informuese/module/udhëzues ku më konkretisht mund të përmendim hartimin e dy udhëzuesve për profesionistë psikosocial: “Udhëzues për profesionistë të terrenit: Rehabilitimi dhe riintegrimi i të kthyerve nga zonat e konfliktit” si dhe “Adresimi i çrregullimeve posttraumatike manual terapie”.

Migracioni i rregullt/i parregullt

Në shkurt 2020 është miratuar ligji nr. 13/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2013, “Për të huajt”, i ndryshuar, i cili ka sjelle i cili sjell ndryshime dhe shtesa në dy çështje kryesore, konkretisht, në politikën e vizave, për krijimin e mekanizmave të nevojshëm për lëshimin e vizave elektronike *online* dhe politikën e punësimit të të huajve, në përmirësimin e disa dispozitave të lidhura me lejet e punës.

Është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 222, datë 12.3.2020, “Për miratimin e Profilin të Zgjeruar Kombëtar të Migracionit për vitet 2015–2018.

Është ratifikuar marrëveshja me BE dhe Frontex me ligjin nr. 6/2019, datë 7.2.2019, duke filluar nga data 22 Maj 2019 për një periudhë të pacaktuar dhe në terren po vazhdon zhvillimi i Operacionit “*Joint Operation Flexible Operation Activities, Western Balkan 2019*”, në zbatim të Marrëveshjes statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë.

Është nënshkruar protokollin i zbatimit me Spanjën. Qeveria ka miratuar një strategji gjithëpërfshirëse kombëtare ndërsektoriale për migracionin. Është miratuar një strategji e re mbi diasporën 2018- 2024. Shqipëria ka përditësuar një plan kontigjence për një fluks të mundshëm masiv të emigrantëve dhe azilkërkuesve, i cili pritet të miratohet së shpejti.

Plani i parashikuar synon të garantojë respektimin e të drejtave të njeriut të migrantëve dhe azilkërkuesve në Shqipëri, përmes përmirësimit të kapaciteteve për identifikimin, përpunimin dhe dhënien e shërbimeve për migrantët dhe azilkërkuesit në shkallë të gjerë. Krijimin e një mjedisi ku migrantët të ndjehen të sigurt. Ai gjithashtu ka për qëllim të parashikojë përmbyshjen e kërkesave të migrantëve për zhvendosje, evakuim, komunikim, strehim në situatë emergjente, ndihmë ushqimore, kujdes shëndetësor dhe mbështetje psikosociale;

Shqipëria ka një qendër pritjeje për emigrantët e parregullt në Karrec me një kapacitet prej 150 shtretërish.

Në përputhje me mangësitë e hasura gjatë procesit *screening*, si dhe në përputhje me rekomandimet e KE, institucionet përgjegjëse shqiptare janë duke punuar për të përmirësuar më tej legjislacionin për të huajt. Gjatë periudhës korrik- tetor 2020 është punuar për përmirësimin e mëtejshëm të dispozitave të ligjit për të huajt.

Analiza, vlerësimi dhe hartimi i projektligjit, “Për të huajt” (LpH), do të kryhet duke marrë në konsideratë këto dimensione:

- pajtueshmërinë e dispozitave të LpH me të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë dhe instrumentet ndërkombëtarë të ratifikuar;

- në mënyrë të veçantë do të tregohet kujdes për t’u siguruar që dispozitat e LpH të jenë në përputhje me parimin e interesit më të mirë të fëmijës, parimin e së drejtës për jetë familjare, parimin e moskthimit, parimin e procedurave të drejta dhe transparente;

- pajtueshmërinë e dispozitave të LpH me *acquis* komunitare në lidhje me menaxhimin e migrimit të rregullt dhe luftën kundër migrimit të parregullt;

- pajtueshmërinë e LpH me objektivat e shtetit shqiptar për të lehtësuar hyrjen dhe qëndrimin e investitorëve dhe turistëve dhe për të luftuar migrimin e parregullt.



Është forcuar kontrolli i shtetasve shqiptarë që kalojnë kufirin shtetëror, me qëllim plotësimin e kushteve për udhëtim drejt vendeve të BE-së/Schengen, sipas Urdhrit të Ministrit të Brendshëm Nr. 641, datë 20.12.2019, “Për forcimin kontrollit të shtetasve shqiptarë që kalojnë kufirin shtetëror”. Sipas këtij Urdhri, të gjithë shtetasit shqiptar të kategorisë “Inad”, që gjatë dy vjetëve të fundit, nga data e paraqitjes në Pikat e Kalimit Kufitar, për shkak të masës së ndalimit të hyrjes në zonën “Schengen”, me arsyetimin, “Për informacione në SIS”, “Refuzim azili”, dhe “Rrezik për sigurinë publike” dhe të gjithë shtetasit shqiptarë të kategorisë “Deportiv”, gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e paraqitjes në Pikat e Kalimit Kufitar, për shkak të çdo lloj arsye, të cilët janë të regjistruar në sistemin TIMS si të tillë, nuk lejohen të kalojnë kufirin shtetëror deri në paraqitjen e një dokumenti shkresor, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar, që provon se nuk kanë ndalim hyrje, urdhër largimi ose dëbimi në vendet e Bashkimit Evropian dhe zonën Schengen.

Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 640, datë 20.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave të veçanta të kalimit të shtetasve shqiptarë të mitur në kufi”. Sipas këtij udhëzimi kryhet kontroll i detajuar për minorenët që udhëtojnë jashtë vendit - deklaratat noteriale të të miturve në kufi.

Politika e vizave

Shqipëria ka një sistem të E-vizave, i cili përdoret për të regjistruar të gjithë shtetasit e huaj që aplikojnë për vizë kur hyjnë në Shqipëri. Sistemi është funksional në kuadër të sistemit TIMS.

Shqipëria vazhdoi të forcojë bashkëpunimin e saj operacional me Shtetet Anëtare përmes shkëmbimit të informacionit mbi ndalimet në hyrje për zonën Schengen dhe fushatat informuese mbi të drejtat dhe detyrimet e udhëtimit pa viza. Në veçanti, bashkëpunimi me Francën është intensifikuar, kryesisht në shkëmbimin e informacionit për qëllime të kthimit dhe ripranimit të shtetasve shqiptarë me qëndrim të parregullt në vend dhe organizimit të fluturimeve të përbashkëta për kthimin e shtetasve shqiptarë. Operacionet për kthimin vullnetar të shtetasve shqiptarë nga Franca kanë filluar. Numri i kërkesave të pabazuara në mënyrë të dukshme për azil në Shtetet Anëtare dhe vendet e Schengenit edhe pse është ulur, mbetet përsëri i lartë, dhe Shqipëria duhet të marrë masa për të adresuar këtë fenomen. Për të adresuar

fenomenin e të miturve të pashoqëruar, janë marrë masa të mëtejshme si përfundimi i Urdhrit të Ministrit të Brendshëm, “Për kontrollin e të miturve të pashoqëruar në kufi”. Për më tepër, po zbatohet edhe Letër Porosia me Nr. 3210, datë 26.7.2017 e Drejtorit të Departamentit të Kufirit dhe Migracionit, “Për kontrollin e akteve noteriale në kufi”.

Shqipëria ka një sistem *online* SHKO ku pranohen të gjitha aplikimet *online* për pajisje me viza. Pas pranimit në SHKO, aplikimet procedohen në sistemin *e-Viza*, i cili përdoret për të regjistruar të gjithë shtetasit e huaj që aplikojnë për vizë kur hyjnë në Shqipëri. Sistemi është funksional në kuadër të sistemit TIMS. Në përgjithësi, standardet për liberalizimin e vizave vazhdojnë të përmbushen.

Janë realizuar ndryshimet në ligjin për të huajt në kuadrin e e-viza, konkretisht miratimi I Ligjit nr. 23/2020, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar.

Evidentohen arritje për sa i përket sistemit të informatizimit dhe digjitalizimit të të gjitha hallkave të sistemit të aplikimit, me synim lehtësimin e qytetarëve, kontrollimin dhe modernizimin e sistemit për rritjen e transparencës dhe shmangien e abuzimeve. Me miratimin e ndryshimeve në bazën ligjore, po punohet me synim zhvillimin e *softverit* të aksesueshëm njëkohësisht nga të gjitha strukturat që nga aplikimi *online* e deri në marrjen e përgjigjes për vizën (*e-Viza*).

Kufijtë Shengen dhe kufijtë e jashtëm

Ligji për Kontrollin e Kufirit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij janë në përputhje me *acquis*. Sidoqoftë, kuadri ligjor për menaxhimin e kufijve të jashtëm të Shqipërisë ende nuk është në përputhje të plotë me standardet e BE-së. Zbatimi i strategjisë së integruar të menaxhimit të kufijve dhe planit të veprimit vazhdoi normalisht dhe është gjerësisht në përputhje me standardet evropiane. Ka filluar puna për hartimin e strategjisë së re të menaxhimit të integruar të kufirit e cila pritet të miratohet brenda vitit 2020.

Kanë përfunduar rikonstrukcioni i dy pikave të kalimit kufitar Hani i Hotit dhe Morina. Shqipëria ka firmosur protokollin me Malin e Zi për vendosjen e pikave të përbashkëta të kontrollit. Qendra trilaterale në Plavë është bërë funksionale. Shqipëria ka përmbyllur një marrëveshje me Kosovën për pikën e përbashkët në Morinë. Janë



zbatuar masat parandaluese kundër korrupsionit në pikat e kalimit kufitar, përmes instalimit të kamerave. Bashkëpunimi ndërmjet agjencive është përmirësuar. Bashkëpunimi operacional me vendet fqinje vazhdon të jetë i mirë megjithatë përpjekje kërkohen për të vazhduar bashkëpunimin dypalësh.

Azili

Ligji për Azilin është pjesërisht në përputhje me *acquis* e B.E-së. Vendi ka institucionet dhe procedurat e nevojshme për të trajtuar kërkesat për azil.

Të gjitha vendimet e dhëna nga Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët mund të ankimohen në rrugë administrative në Komisionin Kombëtar për Refugjatët dhe Azilin, i cili është themeluar në vitin 2017 dhe është ribërë funksional gjatë vitit 2019.

Në këtë drejtim, gjatë vitit 2020 janë ankimuar 4 vendime të kësaj drejtorie, nga të cilat një është ende në proces shqyrtimi, ndërsa për 3 prej tyre ky Komision ka lënë në fuqi vendimin e Drejtorisë së Azilit.

Sa i përket procedurës së azilit, kërkesat e azilit regjistrohen nga Policia Kufitare dhe Migracionit duke plotësuar formularët *pre-screening* të cilët më pas i referohen Drejtorisë së Azilit dhe Shtetësisë për të vazhduar me procedurat për përcaktimin e statusit.

Që prej muajit Prill 2019 funksionon *database* e Azilit e cila shërben si një qendër integrale të dhënash midis Drejtorisë së Azilit dhe Shtetësisë, Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit dhe Qendrës Kombëtare të Pritjes së Azilkërkuesve, duke shkëmbyer informacionin në kohë reale mes këtyre institucioneve dhe duke mundësuar kryerjen e procedurave si dhe nxjerrjen e statistikave në kohë reale mes këtyre institucioneve dhe duke mundësuar kryerjen e procedurave si dhe nxjerrjen e statistikave në kohë reale.

Për shkak të situatës së pandemisë COVID-19, Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë, me qëllim parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive (përhapjes së COVID-19) nxori vendimin nr. 12, datë 3.4.2020, “Për kufizimin e lirisë së lëvizjes për azilkërkuesit e akomoduar në Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkues”, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të azilkërkuesve dhe kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-2019. Gjatë kësaj periudhe edhe me ndihmën e delegacionit të BE-së në Tiranë, u sigurua nga ana procedurale kryerja e

intervistave *online*. Tashmë ka filluar intervistimi *face to face*, duke respektuar garancitë procedurale.

Në bashkëpunim me zyrën EASO, është duke u finalizuar ROAD- MAP i azilit për Shqipërinë.

24.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Përafrimi me *acquis* është duke përparuar në të gjitha fushat e mbuluara nga Kapitulli 24. Në kuadër të hapjes së negociatave për Shqipërinë, detyrimi kryesor i Qeverisë shqiptare është procesi parapërgatitor *screening*, i cili konsiston në një analizë të legjislacionit shqiptar në raport me *acquis* e BE-së dhe evidentimin e mangësive ligjore. Në kuadër të këtij procesi, Ministria e Brendshme, si lider për Kapitullin 24 “Drejtësia, Liria, Siguria” vijon procesin e shqyrtimit të legjislacionit. Arritjet kryesore në kuadër të përafrimit të legjislacionit për vitin 2020 paraqiten si më poshtë:

Lufta kundër krimit të organizuar

Kuadri ligjor shqiptar është pjesërisht i përafruar me Vendimin Kuadër të Këshillit 2008/841/DÇB të datës 24 tetor 2008 mbi luftën kundër krimit të organizuar, i cili është pjesërisht i transpozuar në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Për Kodin Penal”, të ndryshuar, Ligji Nr. 9754, datë 14.6.2007, “Përgjegjësia penale e personave juridikë”. Boshllëqet aktuale të identifikuar përfshijnë nenin 28 të Kodit Penal – i cili nuk përcakton se krimi i organizuar përfshin vepra penale që parashikojnë dënimin deri në 4 vjet burgim.

Kuadri ligjor shqiptar është plotësisht në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, Palermo Dhjetor 2000 (ratifikuar në vitin 2002). Marrëveshja për bashkëpunim strategjik dhe operativ midis Europolit dhe Republikës së Shqipërisë (ratifikuar në vitin 2014 dhe përditësuar në vitin 2018 me ligjin nr. 60, datë 20.9.2018, lejon shkëmbimin e të dhënave personale ndërmjet palëve. Shkëmbimi i informacionit bëhet nga Aplikacioni i Rrjetit të Sigurt të Shkëmbimit të Informacionit (SIENA). Shqipëria ka një oficer ndërlidhës të emëruar në Europol dhe një Njësi Kombëtare në ambientet e Policisë së Shtetit të Shqipërisë. Në mënyrë të veçantë, në korrik 2018, Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Forcimit të Ligjit (Europol) mbi vendosjen e Oficerit Ndërlidhës të Europolit u nënshkrua dhe ratifikua me ligjin nr. 77, datë 1.11.2018, ka mundësuar vendosjen e një oficeri



ndërlidhës të Europolit në ambientet e Policisë së Shtetit të Shqipërisë që nga qershori 2019.

Plani i veprimit për vitet 2019–2020, për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit 2013– 2020 miratuar me VKM-në nr. 616, datë 18.9.2019.

Bazuar në vendimin e Këshillit 2001/887/DÇB e 6 dhjetorit 2001, është miratuar me VKM-në nr. 637, datë 2.10.2019 ligji për Ratifikimin e Konventës së Gjenevës të vitit 1929 Për Shtypjen e Falsifikimit të Monedhës” si dhe ligji nr. 77, datë 11.11.2019, “Për ratifikimin e konventës ndërkombëtare për luftën kundër falsifikimit të monedhës”. Ky ligj ka hyrë në fuqi 18.12.2019.

Është miratuar ligji nr. 33/2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

Ligji Nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar me ligj nr. 32 datë 17.6.2019.

Është miratuar urdhri i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 240, datë 28.2.2019, “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 328, datë 30.3.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për miratimin e strukturës dhe organikës së strukturave të veçanta në Policinë e Shtetit, të ndryshuar, i cili krijon Sektorin e Forcës së Posaçme Operacionale për Mbështetjen Hetimore/Kërkimin.

Është miratuar urdhri i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 708, datë 3.6.2019, “Për Krijimin e Njësies *Fast Albania*”.

Është miratuar dhe po zbatohet plan-veprimi i DPPSH-së nr. 257, datë 1.2.2019, “Për parandalimin dhe luftimin e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike, për vitin 2019”.

Gjithashtu, për vitin 2020 është miratuar dhe po zbatohet Plan-veprimi i DPPSH nr. 139, datë 27.1.2020, “Për parandalimin dhe luftimin e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike, për vitin 2020”.

Është miratuar ligji nr. 93, datë 29.9.2019, për Policinë Gjyqësore.

Lidhur me Rezolutën e Këshillit të datës 30 nëntor 2009 mbi shkëmbimin e rezultateve të analizës së ADN-së, Shqipëria aktualisht është duke shkëmbyer të dhëna të ADN-së dhe gjurmëve të gishtërinjve nëpërmjet Europolit dhe Interpolit.

Faqe | 4178

Me urdhrin e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 496, datë 24.4.2019, është krijuar Njësia për armët e Zjarrit në Policinë e Shtetit.

Me qëllim ndërhyrjen emergjente dhe me karakter të përkohshëm në kushtet e nevojës së forcimit dhe ashpërsimit të luftës kundër krimit të organizuar, më datë 31.1.2020, u miratua Akti Normativ nr. 1, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”.

Në zbatim të aktit normativ, me urdhër të ministrit të Brendshëm nr. 105, datë 25.3.2020 u krijua Struktura e Posaçme Operacioni Forca e Ligjit, në përbërje të së cilës janë:

- Njësia “E” për hetimin e krimit ekonomik;
- Njësia “C” kundër krimit kibernetik;
- Njësia “T” e Menaxhimit të Informacionit, në

Drejtorinë e Forcës së Posaçme

Në kuadër të këtij akti normativ, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara kalon në varësi të Ministrit të Brendshëm. Për këtë qëllim, janë bërë ndryshime në ligjin nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara”, të ndryshuar, si dhe janë drejt finalizimit aktet nënligjore në zbatim të tij.

Bashkëpunimi në Fushën e Drogave

Pritet të miratohet Dokumenti Strategjik kundër Drogës.

Është miratuar dhe po zbatohet plan-veprimi i DPPSH-së nr. 139, datë 27.1.2020, “Për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike, për vitin 2020”.

Lufta kundër terrorizmit

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është nënshkruar:

- Memorandum bashkëpunimi nr. 1079, datë 15.7.2020, “Për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare dhe sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale në funksion të përmbushjes së rekomandimeve të KSA-së e FAFT-së dhe Planit të Veprimit” ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (DPPPP, DPT e DPD) dhe Ministrisë së Brendshme (DPPSH dhe AAPSK).



Bazuar në marrëveshjen e posaçme të bashkëpunimit nënshkruar nga dy **institucionet** (Policisë së Shtetit dhe DPPP) është marrë aksesi në sistemin e të dhënave të DPPP-së dhe është vendosur një zyrë e posaçme për aksesimin e drejtpërdrejtë të të dhënave dhe kalimi i shkresave nëpërmjet platformës së përbashkët.

Me urdhri nr. 148, 5.11.2019, të aprovuar nga Kryeministri është miratuar plani i veprimit ndërinstitucional shtesë për Pritjen dhe Trajtimin e Shtetasve Shqiptarë që kthehen nga Zona e Konfliktëve në Siri dhe Irak.

Në tetor 2019, është nënshkruar një marrëveshje me BE-në mbi zbatimin e Planit të Përbashkët të Veprimit 2019–2020 në luftën kundër terrorizmit për Ballkanin Perëndimor. Raporti i parë mbi zbatimin e marrëveshjes (aranzhimit), tregoi fushat ku është bërë progres, veçanërisht në bashkëpunimin me Europol në këtë fushë.

Në zbatim të rekomandimeve të Moneyval për luftën kundër financimit të terrorizmit, me urdhër nr. 159, datë 7.2.2019 të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, është krijuar Njësia për Hetimin e Financimit të Terrorizmit dhe janë përzgjedhur dhe emëruar Shefi i Njesisë dhe një Specialist i hetimit.

Migracioni i rregullt dhe i parregullt

Është ratifikuar marrëveshja me BE dhe Frontex me ligjin nr. 6, datë 7.2.2019.

Është miratuar ligji nr. 13/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2013, “Për të huajt”, i ndryshuar;

Është miratuar, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 222, datë 12.3.2020, “Për miratimin e profilit të zgjeruar kombëtar të migracionit për vitet 2015–2018”.

Me VKM-në nr. 400, datë 19.6.2019 është miratuar Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plan i saj Veprimit 2019–2022 në përputhje me *acquis* të BE-së, e cila përcakton qeverisjen e migracionit si një çështje thelbësore dhe si një detyrim i shprehur në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2016–2020. Vizioni i Strategjisë Kombëtare për Migracionin, është që deri në vitin 2022, të ofrohet përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj sfidave dhe mundësive të migracionit global në kontekstin e Shqipërisë.

Është miratuar VKM nr. 620, datë 18.9.2019, “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe

procedurës për pajisjen, ripërtëritjen, refuzimin, anulimin e lejes së punës për punëmarrësit e tipit “A/PS, e cila është në përputhje me direktivën 2014/36/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 26 shkurtit 2014 për kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim të punësimit si punëtorë sezonalë.

Rregullorja për përpunimin e të dhënave të pasagjereve, në zbatim të ndryshimeve dhe shtesave në ligjin 71/2016, “Për kontrollin kufitar”, pritet të miratohet së shpejti.

Është miratuar urdhri nr. 641, datë 20.12.2019, i ministrit të Brendshëm, “Për forcimin kontrollit të shtetasve shqiptar që kalojnë kufirin shtetëror”.

Është miratuar udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 640, datë 20.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave të veçanta të kalimit të shtetasve shqiptarë të mitur në kufi”.

Azili

Komisionet Parlamentare dhe pritet miratimi i tij nen për nen, brenda vitit 2020.

Politika e Vizave

Ndryshim dhe shtesë në VKM-në nr. 513, “Mbi përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me VKM-në nr. 90, datë 27.2.2019, për disa shtesa në VKM-në nr. 513, datë 13.6.2013 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në RSH”, të ndryshuar.

Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe penale

Marrëveshja midis Shqipërisë dhe Eurojust ka hyrë në fuqi në tetor 2019. Me urdhrin nr. 140, datë 3.9.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm është “Miratuar Rregullorja për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shkëmbimin e Informacionit me Eurojust”. Hartimi i kësaj rregulloreje u realizua në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e Eurojust-it, të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

24.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse:

- Ministria e Brendshme
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (DPD, DPT, DPPP, AAPSK)



- Ministria e Mbrojtjes
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Prokuroria e Përgjithshme;
- Banka e Shqipërisë
- shërbimi Informativ Shtetëror
- Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të

Dhunshëm

- INSTAT
- Autoriteti i Mediave Audiovizive

24.7 Prioritetet

Bazuar në rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020 dhe rekomandimet e Komitetit të Stabilizim-asociimit dhe Nënkomitetit “Drejtesia, Liria, Siguria” prioritetet kryesore në kuadër të kapitullit 24 “Drejtesia, liria, siguria” janë:

- të zhvillojë më tej përdorimin sistematik të hetimeve paralele financiare kur kemi të bëjmë me krim të organizuar, trafik të paligjshëm, terrorizëm dhe pastrim parash;

- Zbatimi i rekomandimeve të raportit nga Komiteti i ekspertëve të Këshillit të Evropës për vlerësimin e masave kundër pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit (Moneyval) për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit;

- Bashkëpunimi midis prokurorisë dhe policisë duhet të forcohet më tej, veçanërisht në lidhje me procedurat për marrjen e informacionit dhe shkëmbimin e informacionit penal dhe përdorimin e teknikave speciale të hetimit;

- Intensifikimi i përpjekjeve për krijimin e një rekord solid të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në luftën kundër krimit të organizuar, forcimi i hetimeve efektive dhe ndjekjeve penale të grupeve të organizuara kriminale, dhe siguri i dënimeve përfundimtare për kriminelët;

- Harmonizimi i legjislacionit në lidhje me konfiskimin e palëve të treta, konfiskimin e zgjatur dhe sigurimin e ngrirjes paraprake të pasurive;

- Përpjekjet për të vazhduar në parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Shqipëria është e ftuar të adresojë çështjen e të kthyerve dhe të hartojë programe për deradikalizimin dhe riintegrimin për të kthyerit;

- Forcimi i kapaciteteve në fushën e krimit kibernetik, përfshirë bashkëpunimin ndër-institucional dhe trajnimin specifik;

- Harmonizimi i legjislacionit shqiptar për armët me legjislacionin e BE-së;

Vazhdoni përpjekjet në luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të drogës, përmes përdorimit të teknikave speciale të hetimit, hetimeve proaktive dhe konfiskimit të pasurive, të ndjekura nga ndjekje penale efektive dhe gjykime të drejta;

- Hapat e mëtejshëm të masave për të adresuar në mënyrë efektive problemin e kërkesave të pabazuara të azilit në BE përmes adresimit të 'faktorëve të shtytjes' prapa tij, përmirësimit të kontrolleve kufitare dhe organizimit të fushatave informuese mbi të drejtat dhe detyrimet e udhëtimit pa viza, duke vazhduar bashkëpunimin përkatës dhe dialogu me vendet anëtare të BE-së më të prekura;

- Marrja e masave të mëtejshme për identifikimin dhe mbrojtjen e të miturve të pashoqëruar, të tilla si Urdhri i Ministrit të Brendshëm, “Për kontrollin e të miturve të pashoqëruar në kufi” dhe Urdhri i Ministrit të Brendshëm, “Për forcimin e kontrollit kufitar të shtetasve shqiptarë që udhëtojnë jashtë” të cilat janë hartuar dhe pritet të miratohet;

- Harmonizimi i legjislacionit me listat pozitive dhe negative të BE-së në lidhje me politikën e vizave;

- Forcimi i strukturave institucionale, veçanërisht autoritetet qendrore që merren me bashkëpunimin gjyqësor, si dhe gjyqtarët, prokurorët dhe organet gjyqësore që merren me çështjet ndërkombëtare dhe siguri i trajnimit dhe mbështetjes së duhur;

- Vazhdimi i zbatimit të shpejtë të planit të veprimit të rënë dakord me Task-Forcën e Veprimit Financiar për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit;

- Krijimi i një Zyre për Rikuperimin e Aseteve përgjegjëse për identifikimin dhe gjurmimin e pasurive kriminale, siç parashikohet në legjislacionin e miratuar së fundmi dhe në përputhje me legjislacionin e BE-së;

- Përmirësimi i kapacitetit të tij për të menaxhuar pasuritë e ngrira ose të konfiskuara në mënyrë që ato të mos humbin vlerën ekonomike të mjeteve;

- Rritja e përpjekjeve për identifikimin e hershëm të viktimave dhe viktimave të mundshme; intensifikimi i bashkëpunimit ndërkufitar me vendet fqinje dhe bashkëpunimi ndërkombëtar;



dhe të kontribuojë në riintegrimin e suksesshëm të viktimave;

- Kushtimi i vëmendjes së veçantë fëmijëve të pashoqëruar dhe fëmijëve viktimë të trafikimit dhe sigurimi i tyre i mbrojtjes së duhur;

- Forcimi i mëtejshëm në luftën kundër krimit të organizuar, përfshirë përmes bashkëpunimit me Shtetet Anëtare të BE-së, si dhe Europol;

- Miratimi i një strategjie dhe plani të ri veprimi për drogën për të plotësuar boshllëkun legjislativ për pararendësit e drogës dhe për të intensifikuar luftën kundër trafikimit të drogës;

- Miratimi i një strategjie të krimit kibernetik dhe krijimi i një përgjigje më efektive të zbatimit të ligjit që përqendrohet në zbulimin, gjurmueshmërinë dhe ndjekjen penale të kriminelëve në internet dhe adresimin e fenomenit në rritje të pedopornografisë në internet;

- Vazhdimi i hetimit të lidhjeve midis krimit të organizuar dhe terrorizmit;

- Përpjekjet e vazhdueshme në lidhje me riintegrimin dhe risocializimin e të kthyerve;

- Përmirësimi i kapaciteteve profesionale të të gjitha strukturave që do të angazhohen në riatdhesimin e shtetasve shqiptarë të vendosur në zonat e konfliktit, Siri dhe Irak;

- Përmirësimi i mëtejshëm i masave për të adresuar në mënyrë efektive çështjen e kërkesave të pabazuara për azil, duke përfshirë adresimin e arsyeve themelore të tij, përmirësimin e kontrolleve kufitare dhe organizimin e fushatave të mëtejshme informuese mbi të drejtat dhe detyrimet e udhëtimit pa viza. Bashkëpunimi dhe dialogu përkatës me vendet anëtare të BE-së më të prekura duhet të vazhdojnë;

- Vazhdimi i adresimit të fenomenit të të miturve të pashoqëruar;

- Miratimi i një plani emergjence për një numër të konsiderueshëm të mundshëm të mbërritjeve të migrantëve dhe azilkërkuesve, me një buxhet dhe modalitete të qarta për shkaktimin e tij;

- Miratimi i ndryshimeve në Informacionin e Avancuar të Pasagjerëve dhe Regjistrimin e Emrit të Pasagjerëve (PNR);

- Vazhdimi i forcimit të kapaciteteve njerëzore dhe logjistike të Policisë Kufitare dhe Migracionit;

- Rritja e ndërgjegjësimit për të parandaluar aplikime të pabazuara të shtetasve shqiptarë në vendet e BE-së;

- Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit në fushën e sigurisë kufitare me legjislacionin e Komunitetit, garantitë procedurale dhe garantimin e të drejtave të migrantëve, si dhe përdorimi i terminologjisë kryesore ndërkombëtare në fushën e migracionit;

- Forcimi i analizës së rrezikut dhe zbatimi i modelit FRONTEX CIRAM;

- Forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit midis Policisë Kufitare dhe Doganave;

- Investimi i më shumë burimeve për modernizimin e infrastrukturës kufitare dhe përmirësimin e mbikëqyrjes së kufijve 'jeshile' (tokë) dhe 'blu';

- sigurimi i harmonizimit të plotë me politikën e vizave të BE-së;

- Rritja e kapacitetit të Drejtorisë së Azilit dhe Shtetësisë;

- Përafrimi i legjislacionit me legjislacionin e BE-së për të promovuar shkëmbimin e praktikave më të mira në bashkëpunimin gjyqësor.

KAPITULLI 25

SHKENCA DHE KËRKIMI SHKENCOR

25.1 Përmbajtja e kapitullit

Politika e kërkimit shkencor të Bashkimit Evropian (BE), synon krijimin e bazës shkencore dhe teknologjike të vendeve të unionit me synim fuqizimin e Zonës Evropiane të Kërkimit (ERA) dhe sigurimin e zbatimit të programeve kuadër për kërkimin shkencor (Horizon 2020 dhe Horizon Evrope pas vitit 2020). Të gjithë Shtetet Anëtare mund të përfitojnë nga programet kërkimore të BE-së, veçanërisht kur ka përsosmëri shkencore dhe investime të qëndrueshme në kërkime. Në të njëjtën linjë, BE-ja ofron mbështetje të rëndësishme për kërkimin shkencor dhe inovacionin në Shqipëri si dhe lehtëson zbatimin e programeve të kërkimit aty ku Shqipëria është e lejuar të aplikojë.

25.2 Struktura e kapitullit

Kapitulli shkenca dhe kërkimi shkencor nuk është i ndarë në nënkapituj. Në zbatim të metodologjisë së përcaktuar, kapitulli 25 përmban:

- financimin e programit buxhetor për kërkimin shkencor në kuadrin e arsimit të lartë;

- performanca e Shqipërisë në programet kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit shkencor (veçanërisht në programin kuadër H2020)



- Strategjia e Specializimit Inteligjent, ecuria gjatë 2020-ës;

- politika e shkencës së hapur (*Open Science*).

25.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Detyrimi i Shqipërisë për të ndërmarrë iniciativa politike, ligjore, institucionale dhe financiare në kapitullin 25, në mbështetje të konsolidimit të sistemit të kërimit, rrjedh nga Neni 109 i Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit (MSA), i cili përcakton shtyllat e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në fushën e kërimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik (Titulli VIII - Politikat e Bashkëpunimit/Bashkëpunimi për Kërkimin dhe Zhvillimin Teknologjik).

Listë përmbajtësore e *acquis* sipas takimit shpjegues për kapitullin 25

1. Traktati (TFEU). Përmbledhje e parimeve, objektivave, modaliteteve dhe instrumenteve në Kërkimin dhe Inovacionin;

2. Zona Evropiane e Kërimit;

3. Reformat Kombëtare dhe Semestri Evropian;

4. Politikat *open science/open data*;

5. Politikat e inovacionit;

6. Bashkëpunimi ndërkombëtar;

7. Barazia Gjinore;

8. Nismat e partneriteteve, neni 185 dhe neni 187 etj.;

9. Infrastruktura e kërimit;

10. Etika dhe Integriteti i Kërimit etj.;

11. Programi kuadër (Horizon 2020 dhe Horizon Europe) dhe performanca;

12. Kërkimi mbi hekurin dhe qymyrin;

13. Euroatomi.

25.4 Situata aktuale në Shqipëri

Sipas “Raportit të Progresit të Bashkimit Evropian për Shqipërinë” të vitit 2020 rekomandimet kryesore që janë renditur prej BE-së në kapitullin 25 “Shkenca dhe kërkimi Shkencor” janë:

-në vitin e ardhshëm vendi duhet të:

- Rrisë investimet në kërkimin shkencor në përputhje me angazhimet e veta dhe përparësitë e ERA-s;

- Përparojë në zhvillimin e Strategjisë së Specializimit Inteligjent;

-të sigurojë pjesëmarrje më të lartë në Horizon 2020.

Në këtë kuadër sfidat që mbeten në situatën aktuale janë rritja e investimeve për kërkim

shkencor dhe inovacion në Shqipëri si dhe mbledhja në mënyrën e duhur të statistikave përkatëse që lidhen me këtë fushë. Nga ana tjetër një tjetër sfidë në këtë kuadër e cila del edhe nga raporti i fundit i monitorimit të “Strategjisë për Kërkim Shkencor dhe Inovacion” është krijimi i kuadrit ligjor dhe institucional sipas parashikimeve në këtë strategji. Në këtë aspekt nevojitet edhe miratimi i ligjit të ri për kërkim shkencor (ose i ndryshimeve të ligjit aktual) që do ta sillnin ligjin e vjetër në përputhje me ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu duhen konkretizuar përpjekjet për “Strategjinë e Specializimit Inteligjent” për të mundësuar ecjen në një vijë me vendet e rajonit.

Gjatë periudhës 2019- 2020 është bërë progres, veçanërisht me përfundimin e fazës së hartëzimit të Strategjisë së Specializimit Inteligjent e cila filloi në 2017 nën udhëheqjen e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në bashkëpunim me Komisionin Evropian. Gjithashtu me mbështetjen e projektit “EU for Innovation” në vitin 2020 është përfunduar faza e analizës cilësore.

Gjatë periudhës raportuese ka vazhduar monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të strategjisë kombëtare për kërkimin shkencor, teknologjinë dhe novacionin 2017- 2022. Rekomandimet kryesore përfshinin kryerjen e një rishikimi të burimeve të planifikuara në draftin e planit buxhetor afatmesëm 2021- 2023 për rritjen e fondeve për kërkimin shkencor në vazhdimësi, deri në 2% të PBB-së deri në vitin 2023. Gjithashtu ka një progres të kufizuar në zbatimin e planit të veprimit 2017- 2021 për të mbështetur zhvillimin e politikave inovative, i cili synon promovimin e lidhjeve më të mira midis akademisë, industrisë dhe qeverisë.

Ligji, “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, u miratua në Shtator 2019. Ai rregullon funksionimin e Akademisë së Shkencave, të Akademisë së Rinisë dhe synon rritjen e integritetit të sistemit të kërimit shkencor.

Për sa u përket programeve kuadër të BE-së, Shqipëria merr pjesë në Horizon 2020 si një vend i asociuar. Pjesëmarrja e saj në Horizon 2020 është përmirësuar ndjeshëm dhe tregon një zhvillim të mirë për vitin 2020. Lidhur me këtë objektiv, përtej pjesëmarrjes më të lartë në Horizon 2020, në të



ardhmen nevojitet të shihet me prioritet edhe pjesëmarrja në programin Horizon Europe.

Financimi i programit buxhetor, “Për arsimin e lartë”

Duke pasur parasysh rekomandimin e vazhdueshëm për të rritur fondin kombëtar për *Research and Innovation (R&I)*, me gjithë vështirësitë e krijuara në buxhetin e shtetit për shkak të kufizimeve të shkaktuara nga tërmeti i vitit 2019, buxheti i dedikuar për R&I për 2020 ka pasur një rritje, në krahasim me vitin 2019.

Për financimin e veprimtarisë në IAL-të publike për periudhën 2021–2023, janë planifikuar fonde me burim financimi buxhetin e shtetit në shumën nga 11,476 miliardë lekë deri 12,962 miliardë lekë në vit. Për vitin 2021, buxheti i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor (pa përfshirë fondet jashtë buxhetore) është planifikuar në një vlerë totale prej 11 miliardë e 476 milionë lekë. Në raport me treguesit kryesorë makroekonomikë, ky fond zë:

- 26,49% të fondeve totale të MASR-së;
- 0,68% ndaj PBB-së;
- 1,95% ndaj shpenzimeve publike.

Nëse këtij fondi i shtohen edhe fonde të tjera nga buxheti për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor (Akademia e Mbrojtjes, Akademia e Policisë, Shkolla e Magjistraturës, Akademia e Shkencave, si dhe të ardhurat e veta të IAL-ve publike) treguesit e fondeve për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor paraqiten sa me poshtë:

- 0,95% ndaj PBB-së;
- 2,73% ndaj shpenzimeve publike.

Buxheti 2021 i MASR-së për programin buxhetor “Arsimi i lartë” ka shënuar një rritje prej 7,6% ose 767 milionë lekë më shumë se buxheti i rishikuar 2020, rritje e cila është orientuar kryesisht në shpenzimet kapitale të cilat janë rritur me 84% krahasuar me vitin 2020.

Gjithashtu edhe buxheti i vitit 2021 i MASR-së për programin buxhetor “Kërkimi Shkencor” ka një rritje me 25,9% ose 140 milionë lekë më shumë krahasuar me vitin 2020, nga të cilat 100 milionë lekë janë destinuar për projekte infrastrukturore (kapitale) të kërkimit shkencor dhe 40 milionë lekë rritje e cila destinohet kryesisht për projektet kërkimore shkencore të IAL-ve dhe të programeve kombëtare të zhvillimit.

Fondet grant për financimin e IAL-ve

Granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë përfshin;

a) fondin për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike;

b) fondin e projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë.

Aktivitetet kryesore që mbulohen nga buxheti 2021- 2023 për “Arsimin e Lartë” dhe “Kërkimin Shkencor” janë:

- Fondet e miratuara në formë “granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë”, për vitin 2021–2023 janë parashikuar nga 10 miliardë e 796 milionë lekë në vitin 2021 dhe arrijnë në 12 miliardë e 230 milionë lekë në vitin 2023, me një rritje mesatare vjetore që shkon në 7.6% në vitin 2021 dhe në 6.8% në vitin 2023. Ky grand ndahet me vendim të organeve kolegjiale të IAL-ve publike (Bordet e Administrimit).

- Granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese për periudhën 2021–2023 është planifikuar 660 milionë lekë në vitin 2021 dhe arrin në 710 milionë lekë në vitin 2023. Granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese, përfshin fondet për kërkimin shkencor. Ky grant është i hapur, për konkurrim/aplikim për të gjitha institucionet e arsimit të lartë të akredituara që zhvillojnë kërkim shkencor.

Shpërndarja e fondeve të kësaj kategorie të miratuara në formën e “Granti i punës kërkimore-shkencore”, realizohet nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), mbi bazën e projekteve që institucionet paraqesin dhe duke mbajtur në konsideratë treguesit kryesorë për projektet kërkimore-shkencore dhe veprimtarinë krijuese të IAL-ve, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 607, datë 31.8.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit (AKKSHI), si dhe kreun IV, të Vendimit nr. 75, datë 12.2.2018, “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”.

Për vitin 2021, nga granti i punës kërkimore shkencore janë planifikuar të mbështeten aktivitetet sa më poshtë:

- Nxitja e punës kërkimore në IAL publike nëpërmjet financimit të drejtpërdrejtë të 3,500 kërkuesve, ku prioritet kanë femrat në përputhje me parimet e barazisë gjinore, si dhe mbështetje financiare për kërkim fundamental në IAL publike



me 60 milionë lek (shpërndahen me vendim BA të AKKSHI-t).

- Zgjerimi i bashkëpunimit të Universiteteve me biznesin privat në Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit nëpërmjet organizimit të seminareve dhe takimeve informuese në IAL-të mbi Programet Kombëtare dhe Ndërkombëtare, rritja me 10- 15% më shumë ndaj viti paraardhës 46 milionë lek (shpërndahen me vendim Bordi të AKKSHI-t).

- Pjesëmarrje në Horizon Europe, (pagesë kuote anëtarësimi)

- Rritja e aplikimeve me 15–20% më shumë në programin Horizon Europe, me 50 milionë lekë (pagesë kuote anëtarësimi).

- Fonde për pjesëmarrjen në marrëveshjen kuadër të Programeve të BE-së për Kërkim dhe Inovacion, pjesëmarrje e që premtan arritje të mëdha në kërkimin shkencor dhe synon sigurimin e konkureshmërisë së Evropës në nivel global, janë parashikuar shuma prej 20–25 milionë lekësh në vit, ku 50% e shumës vjetore paguhet me fonde grand nga transfertat e buxhetit si dhe 50% nga rimbursimi i shpenzimeve për këtë marrëveshje.

- Fonde grand për pjesëmarrje me të drejta të plotë të Republikës së Shqipërisë në programin Erasmus+, programi i BE-së për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin, propozuar nga Komisioni Evropian, që synon të nxisë modernizimin e sistemeve arsimore 10- 15 milionë lekë në vit.

- Fonde, “Për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e shkëmbimit akademik *Fulbright*”, zbatim të ligji nr. 93/2019, datë 18.12.2019, “Për ratifikimin e Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për programin e shkëmbimit akademik *Fulbright*, në shumën 18–20 milionë lekë në vit.

- Financimi i studentëve ekselencë, që fitojnë në 15 Universitetet e renditur në *Times Higher Education* me 200 milionë lekë (miratohen me vendim të Komisionit të Ekselencës)

- Rritja e mobilitetit të stafit dhe studentëve me 20% në vit, që financohen nga projekte të huaja/donator me rreth 100 milionë lek, sipas projekteve fituese me donatorët;

- Promovimi, menaxhimi i projekteve kërkimore shkencore nëpërmjet Veprimtarisë

funksionale të Agjencisë së Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit - 25 milionë lekë.

- Projekte të reja për Kërkimin Shkencor për infrastrukture laboratorike + akademike dhe shkencore-300 milionë lek për rreth 15–20 projekte kërkimore-shkencore;

Të dhënat statistikore

Për sa i përket përmirësimit të të dhënave statistikore të kërkim- zhvillimit dhe inovacionit, këto janë të përfshira me detaje në kapitullin 18 “Statistikat”.

Gjatë tremujorit të katërt 2019, rezultatet e të cilit dolën në Nëntor 2020, INSTAT realizoi vrojtimin “Inovacioni pranë ndërmarrjeve” i cili mbledhi informacion mbi disa tregues që shprehin shkallën e inovacionit në ndërmarrjet që kanë aktivitet në Shqipëri. Në këtë rast popullata e vërtetuar janë ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar në aktivitetet e përcaktuar në manualin e Oslos.

Gjithashtu AKKSHI dhe INSTAT në qershor të 2020, nënshkruan një memorandum bashkëpunimin, i cili parashikon futjen në programin statistikor zyrtar të një serie indikatorësh për fushën e kërkim & zhvillimit. Në zbatim të kësaj marrëveshje është ngritur një grup pune me përfaqësues të dy institucioneve të cilët po punojnë për përcaktimin e indikatorëve, metodologjisë së matjes, burimeve të marrjes së informacionit si dhe periodicitetin e mbledhjes së të dhënave, bazuar kryesisht në manualin *frascati* dhe atë të Oslos.

- *Performanca e Shqipërisë në programet kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit shkencor (veçanërisht në programin kuadër H2020)*

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr. 132/2014, “Për Ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi pjesëmarrjen në Programin Kuadër Horizon 2020 - Programi për kërkim dhe inovacion”, datë 2.10.2014, dhe të ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe VKM nr. 607, datë 31.8.2016, “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit” (AKKSHI) dhe bazuar në urdhrin nr. 606, datë 27.9.2018, “Për shpalljen për shprehje interesi dhe përzgjedhjen e përfaqësuesve në komitetet e programit Horizon 2020 dhe komitetet



ERA (*European Research Area Committees*)” dhe në urdhrin nr. 605, datë 27.9.2018, “Për shpalljen për shprehje interesi dhe përzgjedhjen e pikave kombëtare të kontaktit në zbatim të “Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi Pjesëmarrjen në Programin Kuadër Horizon 2020 - Programi për Kërkim dhe Inovacion” u hap thirrja për përzgjedhjen e pikave kombëtare të kontaktit (këtej e në vijim “NCP”) dhe përfaqësuesit në Programet Era dhe Horizon 2020.

Si rezultat i sa më lart janë caktuar pozicionet e:

- 36 NCP (PIKA Kombëtare Kontakti) për 22 fusha të Horizon 2020;
- 15 NCP Programme Committees, për 14 - Programe;
- 9 NCP ERA Committees, për 6 - komitete ERA.

Funksioni kryesor i pikave Kombëtare të Kontaktit është informimi i kërkuesve shqiptarë mbi thirrjet e BE-së për aplikim në fushat e tyre specifike. Pjesëmarrja në këto Programe ka si parakusht partneritete me përfaqësi nga disa vende anëtare dhe joanëtare, kërkesë kjo e cila nxit bashkëpunimin dhe rrjedhimisht kontaktin dhe lëvizjen ndërmjet kërkuesve shqiptarë dhe partnerëve të tyre.

Përmes marrëveshjeve bilaterale për bashkëpunim Shkencor dhe Teknologjik AKKSHI-t ka krijuar hapësira për lehtësimin e lëvizjes së kërkuesve të huaj. AKKSHI-t aktualisht po monitoron zbatimin e Marrëveshjeve me Republikat e Italisë, Austrisë, Kosovës. Gjithashtu, ka marrë nismën për 2 (dy) marrëveshje të reja në fushën e kërkimit shkencor me Republikën e Serbisë dhe të Maltës, të cilat synojnë lehtësimin e lëvizjes së kërkuesve të këtyre vendeve drejt Shqipërisë dhe krijimin e rrjeteve të bashkëpunimit mes kërkuesve shqiptarë dhe homologëve të tyre.

Marrëveshjet bilaterale synojnë hapjen e horizonteve të reja për kërkuesit në kërkim të partneriteteve të reja dypalëshe të cilat më vonë mund të përkthehen në bashkëpunime shumëpalëshe. Janë instrument i provuar i suksesshëm për lëvizjen e kërkuesve dhe krijimin e grupeve kërkimore aplikuese në programet kuadër të BE-së.

Aktualisht ekzistojnë marrëveshje ndërkombëtare të bashkëpunimit dypalësh, të ndara si më poshtë:

- tridhjetë e dy marrëveshje me vendet e BE-së;
- pesë marrëveshje me vendet e Ballkanit Perëndimor;
- gjashtë marrëveshje me shtete në Amerikë, Azi, Afrikë.

AKKSHI, si një institucion ekzekutiv përmes Udhëzimit nr. 13 datë 12.7.2012, “Për procedurën e dorëzimit, rishikimit, miratimit dhe raportimit të projekteve të financuara nga programet e bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik”, aktualisht po implementon marrëveshjet bilaterale si më poshtë vijon:

Marrëveshja Bilaterale Shqipëri-Itali 2020–2022

AKKSHI, në zbatim të Marrëveshjes për Bashkëpunim Shkencor ndërmjet MASR dhe Qendrës Kombëtare të Kërkimit (CNR), nënshkruar më 19.5.2017, ripërtëriti Protokollin e Bashkëpunimit dhe hapi Thirrjen e dytë për projekt propozime ndërmjet studiuesve shqiptarë dhe italianë që përfaqësojnë institucionet shkencore brenda CNR Thirrja qëndroi e hapur prej datës 20.4.2020- 16.6.2020. Rezultat i kësaj thirrje ishin 24 (njëzet e katër) aplikime, nga të cilat 1 (një) është skualifikuar për mungesë dokumentacioni prej CNR-së. Projekt- propozimet janë në fazë vlerësimi prej ekspertëve vlerësues të të dyja palëve, AKKSHI dhe CNR.

Fushat përkatëse të projekteve fituese janë:

- 10% Uji dhe energjia;
- 80% Biodiversitet dhe mjedis;
- 10% Sisteme dhe Teknologji Informacioni.

Ndërsa sipas institucioneve, projektet fituese janë: 70% IAL publike; 10% institucione kërkimore publike dhe 20% IAL private

Marrëveshja Shqipëri-Kosovë

Sektori i Marrëveshjeve Bilaterale, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 265, datë 21.4.2010, për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim në fushën e arsimit dhe shkencës, me bashkëpunimin rajonal si platforma rajonale për bashkëpunim të ngushtë në fushën e arsimit dhe trajnimit, “ERI SEE”, AKKSHI, hapi thirrjen e parë të bashkëpunimit tekniko-shkencor Shqipëri-Kosovë në Maj të vitit 2019, e cila u mbyll në Tetor 2019. Rezultat i kësaj thirrjeje pranë AKKSHI janë 19 (nëntëmbëdhjetë) projekt propozime të aplikuara, nga të cilat 10 (dhjetë) janë shpallur fituese. Projektet fituese janë në pritje të vendimit



të Bordit të Administrimit të AKKSHI-t për të filluar financimin.

Të shprehura në përqindje projektet fituese sipas fushave të kërkimit, ndahen në:

- 30% Shkencat Sociale dhe Albanologjike;
- 10% Biodiversitet dhe Mjedis;
- 30% Agrikulturë, Ushqim dhe Bioteknologji;
- 20% Sistemet dhe Teknologji Informacioni;
- 10% Uji dhe Energjia

Ndërsa sipas institucioneve, kemi një shpërndarje të aplikimeve: 90% institucione publike dhe 10% institucione private.

AKKSHI ka financuar 6 Projekte Kombëtare të Kërkim Zhvillimit (PKKZH), me një shumë totale prej rreth 400,000 E (50.221.003 lekë), në 6 fusha kërkimore me përparësi kombëtare, si:

- bujqësia, (Veterinari, Zooteknika), Siguria e Ushqimit dhe Bioteknologjia;
- sistemet dhe teknologjitë e informacionit;
- shkencat Sociale dhe Albanologjike;
- biodiversiteti dhe mjedisi;
- shëndeti;
- uji dhe energjia.

Projektet e financuara në kuadër të PKKZH-së kanë ardhur nga IAL-ja publike, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Tiranë.

Në kuadër të Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH), AKKSHI ka financuar 15 projekte. Financimi i PIKSH u realizua në zbatim të vendimit nr. 12, datë 8.8.2019, të Bordit të Administrimit të AKKSHI-t, për “Miratimin e financimit të projekteve fituese të infrastrukturës së kërkimit shkencor në kuadër të paktit për universitetin”. Vlera e financimit nga buxheti i shtetit për këto projekte është: 164,114,255 lekë.

Projekti me vlerën më të lartë të financimit sipas fushave vërehet në Shkencat Natyrore, me 53 563 794 lekë.

Programi - COST

Shqipëria është një nga anëtarët e 38-të të COST që nga prilli i vitit 2018, pasi plotësoi kushtin e pjesëmarrjes në të paktën 5% të veprimeve COST.

Aktualisht numri i pjesëmarrësve nga Shqipëria është 225 delegatë që kanë aktivitet në 190 aksione COST. Deri në vitin 2018, numri i pjesëmarrësve në veprimet COST arriti deri në 29 - pjesëmarrës. Në dy vitet e fundit, Shqipëria numëron 225 pjesëmarrës në Veprimet COST.

Faqe | 4186

Pritjet tona janë që të rrisim më tej pjesëmarrjen në Veprimet COST. Deri në fund të 2022 të jemi pjesëmarrës në 90% të të gjithë Veprimeve COST. Kjo do të sjellë një rritje të rezultateve të programin kuadër Horizon Europe (HE)

Të dhëna:

- viti 2010: 10 anëtarë të Komitetit Menaxhues (MC);

- viti 2018: 29 anëtarë të Komitetit Menaxhues (KM);

- viti 2019: 151 anëtarë të Komitetit të Menaxhimit (KM);

- viti 2020: 225 anëtarë të Komitetit të Menaxhimit (KM).

Aktualisht janë emëruar 225 studiues si të Deleguar të Komitetit të Menaxhimit (KK) nga Shqipëria, krahasuar me vitin 2010, ku kishte vetëm 10 - Delegatë të MC-së nga Shqipëria dhe vetëdija për këtë program nuk ishte e lartë.

Bazuar në shprehjen e interesit nga komuniteti i studiuesve, deri në vitin 2022, ne synojmë të rrisim numrin e pjesëmarrjes në Veprimet COST në 350 delegatë të MC-së (studiues).

Që nga prilli i vitit 2018, kur Shqipëria u bë një anëtare e plotë e veprimeve COST, AKKSHI ka organizuar më shumë se 25 ditë informuese, në mënyrë që të promovojë programin. Në këto ditë informimi morën pjesë afërsisht 500 persona nga 25 IAL (institucionet e arsimit të lartë), si privatë ashtu edhe publik.

Për më tepër, AKKSHI shërben si një mjet për shpërndarjen e informacionit dhe sigurimin e mbështetjes dhe ndihmës ditore për palët e interesuara, në Veprimet COST.

NASRI është koordinatori i procesit promovimin dhe mbështetjen e COST.

Programi - CEEPUS

Shqipëria është anëtare e programit CEEPUS që nga viti 2006. Që nga viti 2018 AKKSHI është Zyra Kombëtare CEEPUS në Shqipëri, duke luajtur një rol kryesor në promovimin e Programit CEEPUS në bashkëpunim me IAL-të, si private ashtu edhe publike. Shpërndarja e informacionit mbi programin CEEPUS, ka krijuar një terren pjellor për më shumë aplikime dhe ka rritur numrin e IAL-ve dhe fakulteteve specifike për t'u përfshirë në këtë program. Gjatë vitit të kaluar dy IAL janë bashkuar me programin CEEPUS, Universitetin e Biznesit në Tiranë dhe Universitetin Shqiptar.



Numri i studentëve dhe profesorëve që largohen nga Shqipëria drejt vendeve të tjera të CEEPUS është afërsisht 80. Ky numër ka mbetur i pandryshuar gjatë viteve të fundit.

Shumica e studentëve dhe studiuesve shqiptarë kanë shprehur interes të madh për të realizuar lëvizshmëri në Universitetet Austriake sesa në vendet e tjera të CEEPUS. Aktualisht, tendencat dalëse të vlerësuara në përqindje të shqiptarëve janë:

- Austri (30%);
- Poloni (20%);
- Rumani (13%);
- 12 vendet e mbetura (37%).

Gjatë vitit 2019–2020 numri i lëvizjes në hyrje është rritur me 5%. Qëllimi ynë kryesor në të ardhmen është të rrisim numrin e studentëve dhe profesorëve në hyrje me 10% në vitin 2022 pasi ai mbetet akoma i ulët. Hapi i parë është krijimi i të gjitha lehtësirave të nevojshme për ta bërë Shqipërinë tërheqëse për një student dhe/ose profesor të huaj. Hapi i dytë do të ishte nxitja e zyrave homologe për të promovuar lëvizshmërinë në Shqipëri nën kornizën e CEEPUS-it.

Marie Skłodowska-Curie (MSCA)

Gjatë vitit 2014–2020 janë përfitues 26 studiues në MSCA. Buxheti i BE-së dhënë për organizatat shqiptare është 96.000 Euro; Pjesëmarrja për gjini është 61% femra dhe 39% meshkuj; Shkalla e suksesit të pjesëmarrësve shqiptarë është 13.64%, krahasuar me 11.16% të vendeve të asociuara; Fushat e kërkimit shkencor ku regjistrohen përfituesit e mësipërm janë: ekonomia, letërsia angleze, mjedisi, shkencat shoqërore.

EURAXESS

AKKSHI është Bridge-head organization (BHO) e Rrjetit EURAXESS në Shqipëri. Ekzistojnë katër shtylla kryesore të EURAXESS: puna, shërbimet, të drejtat dhe Euraxess Links.

Objektivat parësorë të këtij rrjeti janë: Vendosja e Rrjetit Shqiptar të Shërbimit EURAXESS, që ka për qëllim dhënien e një informacioni gjithëpërfshirës dhe ndihmë të personalizuar për studiuesit e mobilitetit që vijnë në Shqipëri dhe nga Shqipëria. Sigurimi i një aksesit në një gamë të plotë të informacionit dhe shërbimeve mbështetëse për studiuesit evropianë dhe joevropianë që dëshirojnë të zhvillojnë karrierën e tyre në vend. Ky proces është një mbështetje në integrimin drejt Zonës së Kërkimit Shqiptar në Zonën e Kërkimit Evropian.

AKKSHI ka një Zyrë Ndihme për të gjithë ata studiues që kontaktojnë dhe pyesin për çështje të lidhura me Euraxess. Gjithashtu ka ndërtuar webfaqen e Euraxess Albania, duke siguruar informacione mbi stafin akademik të huaj që vijnë për të studiuar dhe punuar në Shqipëri, për vizat, lejet e qëndrimit, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shkollat, kopshtet etj. <https://www.euraxess.al/>.

Euraxess është promovuar nga viti 2014–2020, në 140 entitete publike dhe private, IAL dhe qendra kërkimore. Aktualisht në Shqipëri ka 22 institucione (IAL-të dhe institucionet kërkimore) që kanë mbështetur parimet e C&C (Karta dhe Kodi). Dy institucione shqiptare kanë marrë logon HR Excellence in Research.

Dhënia e Logos “HR Excellence in Research” i jep njohje publike institucioneve kërkimore që kanë bërë përparim në përafrimin e politikave të burimeve njerëzore, me parimet e përcaktuara në “Kartën dhe Kodin”.

Institucionet që kanë marrë të drejtën për të përdorur logo do të nxjerrin në pah angazhimin e tyre, për të zbatuar procedura të rregullta dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të studiuesve. Marrja e titullit të përsosmërisë së burimeve njerëzore në kërkime (ose HRS4R), rrit mundësinë që institucioni të përfshihet në projekte të ndryshme kërkimore evropiane. Karta Evropiane për Studiues dhe Kodi i Sjelljes për rekrutimin e studiuesve të nisur në vitin 2005, synojnë t’u japin studiuesve individual të njëjtat të drejta dhe detyrime kudo që ata mund të punojnë në të gjithë Bashkimin Evropian. Ata adresojnë studiuesit, si dhe punëdhënësit dhe financuesit në sektorin publik dhe privat. Ato janë elemente kryesore në politikën e Bashkimit Evropian për ta bërë hulumtimin një karrierë tërheqëse.

Horizon 2020

Në kuadër të Programit Horizon 2002 Drejtoria e Programeve Ndërkombëtare; Sektori i Marrëdhënieve Multilaterale, pjesë e AKKSHI (NASRI), ka organizuar 160 ditë informuese dhe trajnuese, në IAL-të publike dhe private. Një fokus të veçantë kanë pasur Thirrjet Tematike Horizon 2020 në ardhje, Rrjetet NCP, CORDIS dhe gjetja e partnerëve.

Një pjesë e këtyre aktiviteteve janë organizuar në bashkëpunim me DG Research and Innovation të Komisionit European, Research Executive Agency,



Agency for the Promotion of European Research (APRE), Projekti i Asistencës Teknike për Programet EU që implementohen në Shqipëri, TAIEX, Instituti Italian i Kulturës dhe Ambasada Italiane, NCP Academy.

Gjatë periudhës 2014–2020, aplikantët nga Shqipëria kanë paraqitur në Programin H2020 një numër total aplikimesh prej 475, nga të cilat janë vlerësuar deri tani 460 dhe janë shpallur fitues 45 me vlerë totale prej 4.4 milionë eurosh.

Duhet theksuar se në Programin Horizon 2020, rezultatet janë dy herë më të larta se e njëjta periudhe e programit paraardhës (FP7). Pritshmëria jonë është që deri në fund të programit H2020, kërkuesit shqiptarë të përfitojnë një financim në vlerën e 5 milionë eurove ose 2.5 herë më shumë se FP7. Performanca e Shqipërisë në Programin Horizon 2020 nga viti 2014 në vitin 2020, ka përmbyshur objektivat e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor 2017–2022, rritje të aplikimeve dhe projekteve të fituara me më shumë se 10% në vit.

AKKSHI do të vazhdojë fushatën trajnuese mbi aplikimin në thirrjet Horizon 2020 dhe Horizon Europe. Do të vazhdojë fushata e takimeve tematike me grupet e kërkuesve shkencorë dhe stafet akademike, trajnimet me webinarë dhe asistencë të personalizuar me kërkuesit shkencor. Paralel janë dërguar në Databazën e Kërkuesve Shkencorë 3900 kontakte, thirrjet e H2020, MSCA, kërkesat për partneritet, trajnime *online*, konferenca etj.

Në programin kuadër pasardhës Horizon Europe (HE) pritshmëritë janë që të trefishojmë rezultatet në krahasim me Horizon 2020.

Të mbështesë Politikën e Shkencës së Hapur (Open Science) dhe të marrë informacion (open access) mbi rezultatet e botimeve shkencore që financohen nga fondet publike

Mbështetur në nenin 13 të Ligjit Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë”, dhe pikës 4/d të VKM-së nr. 607, datë 31.8.2016, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)”, AKKSHI ka iniciuar krijimin e një data baze me të dhëna lidhur me periodikët shkencorë në gjuhën shqipe, të botuar nga institucionet e kërkim–zhvillimit në vend para dhe pas vitit 1990, përfshirë periodikët që e kanë

ndërprerë botimin pas viteve ’90, si dhe ata që vijnë të botohen ende. Nga informacioni i mbledhur, rezulton se nga 57 (pesëdhjetë e shtatë) institucione të kontaktuara, kanë deklaruar që kanë botime shkencore 37 (tridhjetë e shtatë) prej tyre, ndërkohë që 20 (njëzetë) të tjerët nuk kanë botime shkencore. Databaza përmban të dhëna për botimet shkencore bazuar mbi tregues të tillë si: fushat sipas Manualit Frascati, viti i parë i botimit, periodiciteti, lloji i botimit, aksesueshmëria në web, pajisja me ISBN/ISSN, vijueshmëria, botime me bord editorial ose jo. Databaza do të përditësohet dhe plotësohet vazhdimisht me të dhëna të reja.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), bazuar në ligjin nr. 119/2014 datë 18.9.2014, “Për të drejtën e informimit”, si dhe ligjin nr. 146/2014, datë 30.10.2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ka zhvilluar portalin opendata.gov.al, i cili nëpërmjet tri moduleve kryesore të tij, shërben si një dritare informuese për ecurinë e projektit OGP për Shqipërinë, si një vend konsultimi mes qytetarëve dhe institucioneve vendimmarrëse në Shqipëri, si edhe si një pikë unike e publikimit të të dhënave të hapura qeveritare. Portali Open Data është një realitet në Shqipëri i cili ofron të dhëna të hapura, cilësore, të standardizuara, të besueshme dhe të ripërdorshme të publikuara mbi legjislacionin dhe projektaktet ligjore, buxhetin dhe shpenzimet e qeverisë, statistikën, regjistrimin e biznesit, performancat e sistemit të edukimit dhe atij shëndetësor etj. (afërsisht 100 *dataset*-e). Qëllimi i portalit Open Data është qeverisje më efiçente dhe efektive, rritje ekonomike dhe inovacion, transparencë dhe përgjegjshmëri, promovimi i ripërdorimit të informacionit publik duke respektuar të drejtën e pronësisë intelektuale dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Zhvillimi i Strategjisë së Specializimit të Zgjuar

Si pjesë e Politikës së Kohezionit të Komisionit Evropian, Strategjia e Specializimit Inteligent (S3) është një qasje inovative që synon të nxisë rritjen ekonomike dhe vendet e punës, duke mundur që çdo rajon i një vendi të identifikojë dhe të zhvillojë përparësitë e veta konkurruese. Përmes partneritetit dhe qasjes nga poshtë- lart, strategjia e specializimit inteligjent i bën bashkë autoritetet lokale, akademinë, biznesin dhe shoqërinë civile, për të bashkëpunuar në zbatimin e strategjive afatgjata të rritjes.



Koncepti dhe struktura e S3 kërkon një analizë të thelluar të situatës aktuale në aspektin e kërkimit, inovacionit (përfshirë infrastrukturën ekzistuese), strukturat industriale, aftësive dhe kapitalit njerëzor (akademik), buxheteve publike dhe private për kërkim dhe inovacion, kuadrin ligjor dhe atij institucional që përcaktojnë ekosistemin e inovacionit.

Gjatë vitit 2020 është realizuar analiza e mësipërme e vendosur në kontekstin e vendit, si dhe janë shqyrtuar boshllëqet, pengesat dhe potencialet për të ardhmen e zhvillimit ekonomik përfshirë potencialet që kërkohen për një bashkëpunim në fushën e inovacionit me vende dhe rajone të tjera.

Me mbështetjen e projektit EU for Innovation (GIZ), pas një procesi konkurrues, është përzgjedhur një ekip ekspertësh nga Fraunhofer Institute në Gjermani, për të vazhduar me formulimin e strategjisë S3 për Shqipërinë. Në fund të vitit 2019 ekipi ka përgatitur një hartëzim të plotë të potencialeve ekonomike dhe shkencore në nivele nënkombëtare dhe bashkërendohen ngushtë me organizatat partnere kombëtare. Kjo fazë do të pasohet nga faza e Analizës Cilësore dhe EDP gjatë vitit 2020. S3 është parashikuar të përfundojë deri në vitin 2021.

25.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Ndër arritjet kryesore përgjatë periudhës së raportimit janë:

- ecuria me përgatitjen e Strategjisë së Specializimit Inteligjent, konkretisht “hartëzimi dhe analiza e situatës”;

- në vitin 2019 ligji nr. 53/2019, “Për akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”.

- rritja, ndonëse modeste e buxhetit për kërkimin shkencor dhe inovacionin;

- përmirësimi i infrastrukturës së kërkimit shkencor si rezultat i masave në kuadër të “Paktit për Universitetin”. MASR në bashkëpunim me universitetet publike kanë identifikuar problematikat infrastrukturore të cilat do të pasqyrohen në marrëveshjet e bashkëpunimit si dhe është ngritur platforma e Bibliotekës Digjitale Universitare - ulibrary.rash.al në të cilën kanë akses studentët dhe stafet e IAL-ve publike. Ndryshuar me VKM-në Nr. 99, datë 5.2.2020 Për disa ndryshime në vendimin nr. 777, datë 26.12.2018, të këshillit të ministrave, “Për kontrollin

antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore;

- nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit me INSTAT për prodhimin e statistikave të fushës së kërkimit shkencor dhe inovacionit;

- progres është bërë në kuadër të hartimit të kuadrit rregullator të vlerësimit të cilësisë së kërkimit shkencor me miratimin e VKM-së nr. 165, datë 21.3.2018 e cila shpjegon metodologjinë e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore shkencore të njërive bazë të institucioneve të arsimit të lartë, duke përcaktuar kriteret e vlerësimit. Gjithsesi që kjo procedurë të vihet në zbatim, duhet plotësuar me dy masa të parashikuara në VKM: përcaktimi i sistemit të pikëzimit algoritmik dhe ngritja e Sistemit Shqiptar të Informacionit të Kërkimit Shkencor (ACRIS) i cili është në proces për t'u ngritur dhe do të shërbejë si bazë kombëtare të dhënash.

25.6 Lista e ministrave dhe e institucioneve përgjegjëse

Ministritë dhe institucionet kryesore përgjegjëse për kërkimin shkencor në Shqipëri janë:

- Ministria e Arsimit e Sportit dhe Rinisë;
- Këshilli për Arsimin e Lartë dhe Shkencën;
- Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor e Inovacionit;

- Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë;

- Instituti i Statistikave–INSTAT;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

- Institucionet që merren me zbatimin e kërkimit shkencor në Shqipëri kategorizohen në institucionet e arsimit të lartë publik dhe jopublik, institute, qendra dhe agjenci, në varësi të institucioneve të linjës, qendrave kombëtare kërkimore dhe sipërmarrjet private që veprojnë në fushën e kërkimit, zhvillimit dhe inovacionit.

- Institucionet publike dhe jopublike të arsimit të lartë janë institucione mësimore-kërkimore, që sipas ligjit 80/2015 kanë si mision arsimin e lartë, kërkimin shkencor, zhvillimin dhe transferimin e njohurive dhe të teknologjisë.

- QKK-të janë institucione kërkimore-mësimore që kanë si mision kërkimin shkencor, formimin e thelluar universitar në ciklin e dytë dhe



të tretë të studimeve, zhvillimin dhe transferimin e njohurive dhe të teknologjisë. Deri tani është ngritur Qendra e Studimeve Albanologjike (QSA) mbi bazën e riorganizimit të instituteve albanologjike të Akademisë së Shkencave;

- Institutet publike/qendrat/agjencitë publike të kërkimit shkencor, zhvillimit dhe transferimit të teknologjisë në vartësi të ministrive, kanë për mision kryerjen e studimeve dhe projekteve zhvillimore, si dhe transferimin e njohurive dhe teknologjive në praktikën e prodhimit të produkteve dhe të ofrimit të shërbimeve. Në varësi të ministrive të linjës ekzistojnë institutet/qendrat/agjencitë si më poshtë vijojnë:

- qendra/institute pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

- 1 agjenci pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;

- 2 qendra/agjenci dhe 2 institute pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

- 2 qendra/institute pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

- 3 institute pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

- 1 institut pranë Ministrisë së Drejtësisë;

- 1 institut pranë Ministrisë së Brendshme;

- 1 qendër pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

Qendrat/agjencitë/institutet dhe sipërmarrjet e tjera private që veprojnë në kërkim, zhvillim dhe transferim të teknologjisë dhe njohurive. Nuk ka të dhëna apo studime për të mundësuar vlerësimin e vëllimit të aktivitetit të inovacionit (shpenzimet për inovacionin etj.), ose produktet në sektorin e ndërmarrjeve (p.sh. shitjet nga produktet dhe shërbimet e reja etj.).

25.7 Prioritetet

Rekomandimet e fundit të raportit të progresit 2020 për Shqipërinë janë:

- të rrisë investimet në kërkim shkencor, në përputhje me angazhimet e veta dhe përparësitë e zonës kërkimore evropiane;

- të përparojë në zhvillimin e Strategjisë së Specializimit Inteligent;

- të sigurojë pjesëmarrje më të lartë në Horizon 2020.

Nisur nga këto rekomandime përparësitë kryesore të Shqipërisë në këtë fushë janë:

Reformimi dhe përmirësimi i sistemit ligjor dhe institucional të kërkimit shkencor. Hartimi i Ligjit për shkencën dhe kërkimin shkencor si dhe

përmirësimi i statusit të AKKSHI-së. Në këtë kuadër edhe hartimi i metodologjisë kombëtare të investimit të fondeve për kërkimin dhe shkencën; Hartimi i udhërrëfyesit të infrastrukturës kërkimore shkencore me qëllimin adresimin e kësaj çështjeje në nivel kombëtar.

Rritja e financimit në nivel kombëtar për shkencën dhe zhvillimin, gjë që është parashikuar edhe në buxhetin afatmesëm të MASR-së. Shqipëria duhet të rrisë buxhetin për shkencë dhe kërkime (më shumë se 0.2% e PBB-së të tanishme).

Nxitja e bashkëpunimit të trefishtë qeveri-akademi-biznes (*Triple Helix*), si dhe përballimin e zgjidhjen e sfidave social- ekonomike të vendit përmes një kërkimi shkencor sa më cilësor.

Qeveria shqiptare ka prioritet forcimin e kapaciteteve njerëzore e infrastrukturore të kërkimit shkencor për të rritur pjesëmarrjen dhe nivelin e suksesit në Programet kuadër të BE-së për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin.

Thellimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e shkencës e kërkimit shkencor, qoftë në nivel rajonal e ndërkombëtar.

Përfshirja dhe zbatimi i parimeve të Zonës Evropiane të Kërkimit Shkencor-ERA në hartimin kuadrit strategjik e ligjor për zhvillimin e shkencës në Shqipëri do të pasohet nga ndjekja e aktiviteteve që afrojnë Shqipërinë me Unionin e Inovacionit. Gjithashtu, prioritet mbetet edhe hartimi i një metodologjie të qartë për financimin e kërkimit dhe shkencor si dhe të udhërrëfyesit kombëtar për infrastrukturën kërkimore-shkencore.

Të miratojë Strategjinë për Specializimin Inteligent. Në kushtet e ndikimit të pandemisë të rishikojë afatet e vendosura në *road map*.

Gjithashtu bazuar edhe në rekomandimet që theksohen në progres raportin e vitit 2020 mbetet një prioritet edhe marrja e masave në proporcion edhe me zhvillimet në nivel të Bashkimit Evropian sa i përket rritjes së pjesëmarrjes në programin kuadër Horizon 2020 dhe sigurimit të pjesëmarrjes në programin e ardhshëm kuadër për kërkimin shkencor Horizon Europe.

KAPITULLI 26

ARSIMI DHE KULTURA

26.1 Përmbajtja e kapitullit

BE-ja mbështet bashkëpunimin në arsim dhe kulturë përmes financimit të programeve dhe



koordinimit të politikës së Shteteve Anëtare përmes metodës së hapur të koordinimit. Shtetet Anëtare gjithashtu duhet të parandalojnë diskriminimin dhe të garantojnë arsimim cilësor të fëmijëve të punëtorëve migrantë, përfshirë ata me prejardhje të disavantazhuar.

26.2 Struktura e kapitullit

- Arsimi;
- Kultura.

26.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Detyrimi për të përafuar legjislacionin shqiptar në arsim me *acquis* të BE-së buron nga neni 70 MSA për përafrimin e legjislacionit dhe neni 100 lidhur me përafrimin e legjislacionit në arsim dhe trajnim. Në fushën e kulturës neni 101 i MSA-së thekson se ‘palët zotohen të ndërmarrin bashkëpunim kulturor. Ky bashkëpunim do të shërbejë gjithashtu edhe për rritjen e mirëkuptimit të përbashkët dhe të respektit reciprok ndërmjet individëve, komunitetit dhe njerëzve. Palët gjithashtu zotohen të bashkëpunojnë për promovimin e diversitetit kulturor, veçanërisht në kuadër të Konventës së UNESCO-s për mbrojtjen dhe promovimin e diversitetit të shprehjeve kulturore.’

Qëllimi i politikave të BE-së për kulturën është për të inkurajuar bashkëpunimin në mbështetje dhe për plotësimin e veprimeve që lidhen me rritjen e dijes dhe përhapjen e kulturës, ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, shkëmbimet kulturore dhe krijimet letrare dhe artistike duke përfshirë dhe sektorin audiovizual.

BE gjithashtu fokusohet dhe inkurajon pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet komunitare të BE-së në fushën e arsimit dhe kulturës.

26.4 Situata aktuale në Shqipëri

Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e arsimit dhe kulturës. Një përparim është arritur në këtë fushë, veçanërisht duke përmirësuar aplikimin në internet për njohjen e diplomave, kornizën kurrikulare për arsimin parashkollor dhe standardet e zhvillimit dhe mësimin për fëmijët nga 3 deri në 6 vjeç, si dhe monitorimin e kornizës për vlerësimin e arsimit parashkollor.

Nën drejtimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka filluar procesi i hartimit të Strategjisë Kombëtare të Arsimit për periudhën 2021–2026. Për këtë është ngritur me urdhër Nr. 555, datë

22.11.2019, Grupi i Koordinimit për organizimin e ndjekjen e veprimtarive lidhur me të dhe në ndihmë të të cilit janë krijuar grupe pune, në përbërje të të cilëve janë specialistë të mirënjohur të fushës së edukimit, përfaqësues të ministrive të linjës, të institucioneve të arsimit të lartë, sindikatave, si dhe përfaqësues të organizatave partnere. Në të njëjtën kohë, Grupi i Koordinimit ndihmohet nga grupe teknike për aspekte të caktuara, si dhe bashkëpunon me institucione të tjera ndërkombëtare si UNICEF, me qëllim bashkërendimin e punës dhe veprimtarive në kuadër të përgatitjes së Strategjisë. Hartimi i Strategjisë ndjek etapat e përcaktuara në *roadmap*-in e miratuar. Strategjia e re synon të japë përgjigje kërkesave që shtron procesi i integritetit evropian të vendit dhe zhvillimet bashkëkohore në fushën e arsimit.

Nga Ministria e Kulturës është hartuar “Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019–2025” dhe miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 24.12.2019, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën, 2019–2025”, dhe Plani i saj i Veprimit. Ky është dokumenti i parë i këtij lloji, me anë të të cilit synohet konceptimi i një udhërrëfytyrës për zhvillimin e sektorit të kulturës dhe trashëgimisë kulturore me qëllim të krijimit të kushteve të favorshme për zhvillim individual, social dhe shtetëror.

Ligji për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë po plotësohet me aktet nënligjore, shumica e akteve është miratuar dhe po përfundon miratimi dhe hartimi i akteve të mbetura.

Qeveria së fundmi ka racionalizuar institucionet e AFP-së, duke krijuar Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe duke ristrukturuar më tej Agjencinë Kombëtare të AFP-së dhe Kualifikimeve. Në sistemin e AFP-së, tashmë është zhvilluar një cikël koherent politikash të proceseve të brendshme për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e kualifikimeve profesionale, i cili mbështet relevancën e kualifikimeve në tregun e punës.

Me miratimin më 23.7.2018 të ligjit nr. 48/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, sigurohet një qasje e re e përgjegjësisë të institucioneve përgjegjëse për sistemin arsimor parauniversitar. Me riorganizimin e institucioneve të sistemit



arsimor parauniversitar është krijuar Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar. Këto struktura do të sigurojnë cilësinë e shërbimit në institucionet e arsimit parauniversitar. Ligji përcakton për herë të parë konceptin e “Vlerësimit të arritjeve në arsimin fillor”. Një tjetër risi është krijimi i bazës ligjore për Këshillin Kombëtar të Prindërve si një strukturë e prindërve në nivel kombëtar. Gjithashtu ligji siguron përmirësimin e kritereve dhe standardeve profesionale të leadershipit të institucioneve shkollore.

Sigurimi i cilësisë bazuar në standarde të krabasueshme me ato të vendeve të BE-së

- Dy institucione të reja, ASCAP dhe DPAP, duhet të krijojnë bashkëpunim të ngushtë në monitorimin e sektorit të arsimit parauniversitar dhe sigurimin e cilësisë së shërbimeve arsimore.

- Shqipëria do të prezantojë një përmbledhje të plotë vjetore të sektorit (JASR) si një mjet për monitorimin e sistemit arsimor parauniversitar.

- Përcaktimi i një sërë indikatorësh kombëtar të arsimit bazuar në standardet e UNESCO-s dhe Eurostatit, duke përfshirë edhe treguesit në Programin e Statistikave Zyrtare (POZ).

Me vendimin nr. 98, datë 27.2.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) u krijua ASCAP. Misioni i ASCAP-it është të garantojë performancën e sistemit të arsimit parauniversitar dhe cilësinë e arsimit parauniversitar publik e privat, në përputhje me qasjen e kurrikulës, të bazuar në zhvillimin e kompetencave.

DPAP-ja u krijua sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 27.2.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar” dhe urdhrit nr. 68, datë 5.4.2019, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së drejtorisë së përgjithshme të arsimit parauniversitar dhe drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar.

DPAP-ja e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror, nëpërmjet Drejtorisë Qendrore; në nivel rajonal, nëpërmjet drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar, si dhe nga njësitë e ofrimit direkt të shërbimeve, të cilat përfshijnë zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore të sistemit parauniversitar

publik. DPAP-ja ka lidhje funksionale bashkëpunimi me institucionet e tjera të sistemit arsimor parauniversitar në varësi të ministrit.

Misioni i DPAP-së është ofrimi dhe sigurimi i shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë në përputhje me politikat, strategjitë kombëtare dhe kurrikulën e arsimit parauniversitar, me qëllim zhvillimin dhe edukimin e plotë e të gjithanshëm të nxënësit, në mënyrë që të përballojë sfidat e së ardhmes.

Njësitë Arsimore Vendore (drejtoritë arsimore rajonale/zyrat arsimore, DAR/ZA) janë riorganizuar në Drejtori Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyra Vendore Arsimore (ZVA). Këto njësi arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar janë në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP).

Në zbatim të udhëzimit nr. 13, datë 22.5.2019, “Për procedurat e pranimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar, procedurat e pranimit dhe emërimit në një vend të lirë pune rriten në mënyrë të ndjeshme transparencën në konkurrim, duke iu nënshtruar vlerave më të larta të profesionalizmit, meritës dhe interesit më të lartë të nxënësve.

Kandidatët për mësues aplikojnë në dy faza, aplikim me dosje dhe me testim të informatizuar. Për vitin 2020 aplikuan 7789 mësues të të gjitha profileve. Nga këta 5078 aplikuan për t’iu nënshtruar testimit të informatizuar dhe 2314 mbartën pikët e vlerësimit të dosjeve dhe testimit ndër vite.

Klasat e profilizuara në sport

Në vitin shkollor 2018- 2019 filluan veprimtarinë mësimore klasat e profilizuara në sport, të organizuara në klasat VI, VII, VIII dhe IX në sportet: volejboll, futboll dhe basketboll, me programe të posaçme mësimore të hartuara nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA), aktualisht Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP).

Me hapjen e klasave të profilizuara në sport, synohet që, nëpërmjet kurrikulave të specializuara në disiplinat sportive përkatëse, të krijohen mundësi konkrete për nxënësit që spikasin për prirje dhe talent në sporte të ndryshme, sikurse janë



sportet me traditë të pasur në vendin tonë. Veprimtaria e tyre mbështetet edhe nga Federatat sportive respektive, jo vetëm në mbështetjen e procesit mësimor/stërvitor, por edhe në organizimin e garave/kampionateve.

Gjatë vitit shkollor 2019–2020 u krijuan dhe vijojnë të funksionojnë gjithsej:

- 223 klasa sportive në 121 shkolla, të cilat kanë angazhuar

- 5.616 nxënës = rreth 10 % të numri të përgjithshëm të nxënësve në këto shkolla.

Procedurat për hapjen, organizimin dhe funksionimin e klasave të profilizuara në sport janë përfshirë në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) nr. 18, datë 20.8.2019, “Për vitin shkollor 2019–2020 në sistemin arsimor parauniversitar”.

Ligji, “Për sportet” 79/2017, në nenin 6 të të cilit, është parashikuar ngarkesa e detyruar mësimore referuar lëndës “Edukim Fizik, Sporte dhe Shëndet”. Në këtë nen të Ligjit, “Për sportin” jepet një përkufizim më i gjerë i lëndës së edukimit fizik, duke parashikuar ngarkesën mësimore të saj në arsimin parauniversitar 3 orë mësimore në javë, në klasat 1- 12. Kjo ngarkesë mësimore për lëndën e “Edukim Fizik, Sporte dhe Shëndet” nga 2 orë në javë në 3 orë në javë erdhi si rezultat i implementimit të kurrikulës së re, mbështetur në kompetenca, në arsimin parauniversitar e cila u shoqërua me një shtesë të numrit të mësuesve të edukimit fizik në të gjithë sistemin, rreth 7000 mësues të rinj në sistem. Përfshirja e ngarkesës mësimore të kësaj lënde në ligjin për sportin, vjen si një domosdoshmëri për t'i dhënë kësaj lënde, pozita më të konsoliduara kundrejt tendencave negative të shfaqura gjatë viteve të fundit, për uljen e ngarkesës, deri në heqjen e plotë të saj, nga programet mësimore të arsimit parauniversitar. Kontributi i kësaj lënde është jo vetëm në formimin e përgjithshëm të nxënësve, por është gjithashtu kontribut në ofrimin e mundësive për një shëndet më të mirë të popullatës, si një nga prioritetet kryesore të politikave të shtetit për sigurimin e shëndetit publik.

Zhvillimi profesional i mësuesve të diasporës

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë e Shqipërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH) së Kosovës në kushtet e krijuara nga pandemia COVID-19 kanë

shtyrë në një moment të dytë organizimin e seminarit XVI mbarëkombëtar, “Për mësimin plotësues të gjuhës shqipe në diasporë”, i cili ka në fokusin e tij shkëmbimin e përvojave në fushën e mësimdhënies:

- dhënien e modeleve praktike të orëve mësimore;

- promovimin e librave për mësues të diasporës dhe doracakë për mësuesit e diasporës;

- veprimtari kulturore.

Mësuesit e diasporës, sipas kriterëve të përcaktuara me vendimin nr. 104/2019 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë”, aplikuan në tetor 2019, për herë të parë për t'u bërë pjesë e regjistrit shtetëror të mësuesve të diasporës. Aplikimi bëhet pranë ASCAP. U kualifikuan 12 mësues që plotësonin këto kriterë dhe emrat e tyre iu dërguan ministrit të Shtetit për Diasporën. Qendra e Botimeve për Diasporën po përgatit regjistrin, të cilin çdo vit, pas aplikimeve do ta përditësojë dhe ruajë ASCAP.

Në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Diasporës, MASR-ja ka dhënë leje dyjavore në vitin shkollor 2019–2020, për disa mësues të gjuhës shqipe nga Tirana të mbështesin mësuesit e gjuhës shqipe në Ukrainë për mësimin e gjuhës shqipe.

Plani i Veprimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në kuadër të “Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm”.

Përgjatë muajve dhjetor 2018–janar 2019, u realizuan 13 sesione informuese me pjesëmarrjen e 822 drejtorëve/psikologëve të shkollave të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore përgjegjëse për arsimin parauniversitar. Në këto sesione të pranishmit u orientuan drejt hartimit të planeve individuale të shkollave të tyre, duke u bazuar te paketa e hartuar nga grupi i përhershëm i punës.

MASR-ja në bashkëpunim me Qendrën e Koordinimit të Ekstremizmit të Dhunshëm pranë Kryeministrisë gjatë vitit shkollor 2019–2020 ka trajtuar me përparësi përmes projekteve me organizata partnere trajnimin e mësuesve, drejtuesve, psikologëve dhe oficerëve të sigurisë për parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm në shkolla; ka përgatitur broshura informuese për mësuesit, prindërit dhe nxënësit për



parandalimin e ekstremizmit; ka përgatitur module trajnuese mbi këtë tematikë, si dhe janë zhvilluar trajnime për riintegrimin e fëmijëve të radikalizuar ose në rrezik radikalizimi të kthyer nga zonat e konfliktit.

Gjithashtu, është konsoliduar rrjeti i koordinatorëve në shkolla për parandalimin e ekstremizmit në sistemin arsimor parauniversitar.

Pakicat kombëtare

Në vitin shkollor 2019–2020 rreth 600 nxënës të pakicës kombëtare greke dhe rreth 100 nxënës të pakicës kombëtare maqedonase ndoqën arsimin nga klasa e 1–9, të cilët janë pajisur me tekste shkollore falas.

Për vitin shkollor 2020–2021, bazuar në VKM-në nr. 227, datë 17.4.2019, “Për përgatitjen, shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve publike parauniversitare ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare”, u përgatitën, shtypën, botuan dhe u shpërndanë tekstet shkollore të arsimit bazë në gjuhën amtare për nxënësit e pakicave kombëtare.

Nxënësit e pakicave kombëtare, për vitin shkollor 2020–2021, u pajisën me të gjitha tekstet shkollore falas.

Në sistemin arsimor parauniversitar është parashikuar që institucionet arsimore për arsimin bazë ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, si çdo vit edhe këtë vit shkollor do të planifikojnë veprimtari të veçanta, me qëllim ruajtjen e promovimin e trashëgimisë kulturore dhe artistike të pakicave kombëtare.

Në qershor të vitit 2020, për të mbështetur institucionet arsimore parauniversitare ku mësojnë nxënës të pakicës kombëtare greke është krijuar zyra vendore arsimore Finiq–Dropull që drejtohet nga një përfaqësues i kësaj pakice kombëtare.

Të drejtat e fëmijëve, mbrojtja nga dhuna në institucionet arsimore

Në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, MASR-ja në vitin shkollor 2019–2020 ka orientuar çdo institucion arsimor të realizojë informimin në mënyrë verbale dhe vizuale të nxënësve, mësuesve dhe prindërve se ku duhet të drejtohen në rast të shkeljes së të drejtave të fëmijëve duke i përfshirë në rregulloren e institucioneve parauniversitare.

Gjithashtu është ndjekur realizimi i agjendës kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve 2017–2020.

MASR-ja është aktualisht pjesë e grupit të punës për hartimin e Agjendës Kombëtare për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve për periudhën 2021–2024. Në çdo vit shkollor në të gjitha institucionet arsimore janë përdorur një sërë mënyrash dhe instrumentesh për të identifikuar rastet e dhunës si vëzhgime të herëpashershme të nxënësve dhe mësuesve, realizimi i pyetësorëve për dhunën si një mjet shumë i mirë dhe efikas për të analizuar situatën lidhur me format apo rastet e dhunës që nxënësit pësojnë apo perceptojnë direkt apo indirekt, anketa, takime bashkëpunuese me mësues dhe Qeverinë e Nxënësve për identifikimin e personave dhunues dhe të dhunuar, marrjen e masave për trajtimin e tyre.

Në çdo institucion arsimor funksionojnë Komisionet e Etikës, të cilët trajtojnë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të fëmijëve, apo rastet e dhunës së çdo lloji në institucionet arsimore, dhe sipas rastit bashkëpunojnë me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Policinë e Shtetit.

Nga viti 2015 vazhdon nisma “Stop dhunës në shkollë” dhe kemi një raport të rasteve të dhunës në çdo institucion arsimor. Kjo nismë mbështetet edhe nga organizata partnere që operojnë në fushën e mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve.

Oficerët e sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar

MASR-ja dhe Ministria e Brendshme po zbatojnë prej 3 vitesh projektin “Shkolla të sigurt - Oficerët e Sigurisë në shkolla”, i cili ka një vëmendje të posaçme në rritjen e sigurisë si brenda ashtu edhe në perimetrimin e institucioneve arsimore, nëpërmjet patrullimit të shpeshtë të policisë si dhe një sërë masash të tjera siç është dhe prezantimi i projektit pilot për oficerin e sigurisë në shkolla.

Bazuar në VKM-në nr. 600, datë 9.10.2018, qeveria shqiptare vendosi që në 150 institucione arsimore të arsimit të mesëm të vendosej oficeri i sigurisë.

Gjatë viteve shkollore 2018–2019, 2019–2020 MASR-ja është duke zbatuar aktualisht me vendimin nr. 600, datë 9.10.2018 i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë” dhe udhëzimi nr. 13, datë 22.5.2019, i



MASR-së, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar për 150 oficerë sigurie në shkolla. Oficerët e sigurisë trajnohen nga Akademia e Sigurisë dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të arsimit Parauniversitar. Deri tani nga shërbimi i oficerëve të sigurisë kanë përfutur 62 589 nxënës.

Mbështetja për nxënësit e komunitetit rom/egjiptian për të parandaluar braktisjen e shkollës

Disa nga masat për sigurimin e përfshirjes arsimore të popullatës rome dhe egjiptiane janë vendimet e Këshillit të Ministrave për tekstet shkollë dhe transportin falas; udhëzime të Ministrisë për regjistrimin me përparësi në kopshte të fëmijëve romë dhe për ofrimin e arsimit bazë dhe gjimnazit me kohë të pjesshme; Vendimi nr. 666, datë 10.10.2019 i Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit para- universitar në institucionet arsimore publike”; VKM-ja nr. 40, datë 23.1.2019, që përjashton studentët romë dhe egjiptianë nga tarifa e shkollimit në ciklin e parë të studimeve (*Bachelor*), VKM-ja nr. 780, datë 26.12.2018, e cila përcakton që studentët romë dhe egjiptianë të paguajnë vetëm 50% të tarifës së shkollimit në ciklin e dytë të studimeve (Master); nënshkrimi i marrëveshjeve ndërministrorë për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor, si dhe për fëmijët në situatë rruge etj.

Një ndër sfidat më madhore është angazhimi i MASR-së për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Komunitetit Rom dhe Egjiptian, 2016–2020. Në këtë plan, fusha e politikës “Arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor” ka si qëllim strategjik ofrimin e arsimit cilësor dhe përfshirës për romët dhe egjiptianët për të promovuar dialogun ndërkulturor.

Kategoritë e nxënësve që ndjekin institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe që do të përfitojnë mbështetje buxhetore për kompensimin në masën 100% të çmimit të teksteve shkollë janë miratuar me vendimin nr. 486, datë 17.6.2020 të Këshillit të Ministrave, “Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollë të sistemit të arsimit parauniversitar”, në pikën 6 përcaktohen kategoritë

që do të përfitojnë mbështetje buxhetore për kompensimin në masën 100% të çmimit të teksteve, ndër to pakicat kombëtare, pakicat rome dhe egjiptiane, ata të cilët kanë statusin e të verbrit etj.

Për vitin shkollor 2020–2021 kanë përfutur mbështetje financiare 230,291 nxënës në institucionet arsimore publike: të klasës së parë, të cilëve u jepen tekstet shkollë të reja; nxënësit nga klasa e dytë deri në klasën e shtatë, të cilëve u jepen tekstet shkollë në përdorim falas; nxënësit e arsimit parauniversitar nga shtresa sociale në nevojë dhe nxënësit e pakicave kombëtare në arsimin bazë, me një fond të miratuar prej 864 milionë lekë.

Udhëzimi nr. 17, datë 9.5.2018, “Për procedurat e ndjekjes së arsimit të detyruar nga nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë dhe për arsimimin me kohë të pjesshme në arsimin bazë” lehtëson procedurat e regjistrimit/rikthimit në shkollë të fëmijëve që, për rrethana të përcaktuara në udhëzim, nuk e kanë ndjekur arsimin bazë për të paktën dy vite shkollë, e kanë braktisur shkollën etj. Nga lehtësirat që krijohen me këtë udhëzim, përfitues janë dhe fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit romë dhe egjiptianë. Është hartuar, për herë të parë, programi mësimor i gjuhës rome për arsimin bazë (klasat VI–IX), i cili u miratua me urdhrin e MASR-së nr. 754, datë 9.11.2018, “Për miratimin e programit të gjuhës rome, shkalla III–IV, klasat VI–IX”.

Vazhdon zhvillimi i mësimin të gjuhës rome në shkollën 9-vjeçare “Hamit Mullisi” Elbasan, në kuadrin e nismës “Shkolla si qendër komunitare”. Sipas të dhënave nga ZVA-ja Elbasan, në vitin shkollor 2018–2019 u regjistruan dhe ndoqën gjuhën rome 30 fëmijë.

Për të siguruar rritje të aksesit të fëmijëve në arsimin parashkollor MASR gjatë periudhës së raportimit ka ndërmarrë:

- Regjistrimi i romëve dhe egjiptianëve në arsimin parauniversitar (parashkollor, arsim bazë dhe arsim i mesëm i lartë) ka ardhur në rritje nga vitit në vit. Baza ligjore e nënligjore ekzistuese përmban të gjitha lehtësirat e mundshme për arsimimin e romëve dhe egjiptianëve, përfshirë regjistrimin, bursat (në të gjitha nivelet), tekstet shkollë falas, pranimet në universitet e përjashtimin nga tarifat. Megjithatë, vijimi i arsimit të mesëm të lartë nga romët dhe egjiptianët që mbarojnë arsimin bazë, mbetet ende i ulët. Të rinjtë



e të rejtat romë dhe egjiptiane pranohen në universitete edhe përmes kuotave të veçanta, të cilat planifikohen nga vetë universitetet. Procedurat e aplikimit bëhen drejtpërdrejt në universitet. Në disa universitete, kuotat e veçanta mbeten të paplotësuara për shkak të mungesës së aplikimit nga romët dhe egjiptianët.

Personat me aftësi të kufizuara

Në vitin akademik 2019–2020 në sistemin arsimor parauniversitar ndoqën mësimin në institucione arsimore jospesiale publike dhe private duke filluar nga arsimi parashkollor, 4566 nxënës me aftësi të kufizuara (AK) ose 13% më shumë se një vit më parë. Raporti i nxënësve me AK që ndjekin arsimin gjithëpërfshirës ndaj arsimit special është përmirësuar nga 75% që ishte në vitin 2014 në rreth 90% në vitin 2019–2020.

Në vitin shkollor (2019–2020) u punësuan në sistemin e arsimit parauniversitar publik dhe privat rreth 1236 mësues ndihmës (1069 në publik), kundrejt 1020 mësuesve ndihmës të një viti më parë, ose 21% më shumë krahasuar me një vit më parë. Raporti fëmijë me AK/mësues ndihmës këtë vit është 3.7.

Profilu i mësuesit të arsimit special është përcaktuar si një profesion i rregulluar dhe po punohet për t'i punësuar me përparësi mësuesit e licencuar në këtë profil si mësues ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara. Me miratimin e udhëzimit të ri nr. 26, datë 25.11.2019, “Për mësuesin ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, është rikonceptuar puna e mësuesit ndihmës në shkollë dhe roli i tij në klasë dhe jashtë saj në mbështetje të zhvillimit konjitiv, socioemocional dhe arsimimit të fëmijëve me AK.

Gjuha e Shenjave Shqiptare dhe bashkëpunimi me ANAD

Për personat që nuk dëgjojnë është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 4481, datë 25.4.2018 ndërmjet “Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Shoqatës Kombëtare Shqiptare të Personave që nuk dëgjojnë” për bashkëpunim në fushën e arsimit dhe ofrimin e shërbimeve të interpretimit në gjuhën e shenjave për personat që nuk dëgjojnë.

Progres është bërë dhe në përmirësimin e të nxënësve të gjuhës së shenjave shqiptare dhe bashkëpunimin me Shoqatën Kombëtare Shqiptare

të Njerëzve që nuk dëgjojnë në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me qëllim rritjen e cilësisë së arsimit të nxënësve që nuk dëgjojnë deri në nivelin e arsimit të mesëm.

Bazuar në këtë marrëveshje dhe në planin e veprimit 2019–2022 po ndërmerren këta hapa të rëndësishëm:

- U hartua dhe miratua plani i ri mësimor dhe filloi puna për hartimin e kurrikulës të re për arsimin bazë.

- Po planifikohet shtrirja e arsimit nga arsimi bazë në arsim të mesëm me drejtim profesional.

- Po studihet transformimi i Institutit në të parën Qendër Burimore në Shqipëri për Edukimin e nxënësve që nuk dëgjojnë.

- Po intensifikohet përgatitja e moduleve për trajnimin e mësuesve ndihmës në gjuhën e shenjave shqipe për nxënësit që nuk dëgjojnë në shkollat e zakonshme.

Kurrikula

Gjatë vitit shkollor 2020–2021 zbatohet kurrikula me kompetenca në të gjitha klasat 1–12 të sistemit të arsimit parauniversitar. Ndërkohë gjatë periudhës qershor 2019 u aplikuan testet kombëtare me kurrikulën me kompetenca në përfundim të klasës së 9-të të arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë.

Në përfundim të pilotimit dhe të zbatimit në sistemin e kurrikulës së bazuar në kompetenca, ASCAP realizuan vlerësimin e jashtëm të kësaj kurrikule. Ky proces u mbështet nga UNICEF. Gjithashtu, në këtë kuadër ASCAP është duke zhvilluar vlerësimin e brendshëm të kurrikulës me kompetenca. Është hartuar analiza e vlerësimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët dhe në proces është hartimi i analizës së zbatimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të lartë.

Pandemia COVID-19 konsiderohet një sfidë e madhe globale, e cila ka ndikuar në çdo aspekt dhe sektor të shoqërisë, përfshirë edhe arsimin.

Dy format kryesore mësimore të arsimit në distancë u përdoren gjatë kësaj periudhe në vendin tonë:

- Mësime të xhiruara dhe të transmetuara në Radiotelevizionin Shqiptar (RTSH). Këto mësime u ndoqën nga 78.9% e nxënësve, 79.9% e prindërve dhe 96.4% e mësuesve. Nxënësit që nuk arrinin të shohin transmetimet, ndoqën videot në kanalën e *Youtube* të MASR-së apo edhe te platforma akademiale.



- Komunikimi mes nxënësve dhe mësuesve përmes rrjeteve sociale apo përmes platformave të ndryshme që mundësuan krijimin e klasave virtuale (*google classroom, google hangout, edmodo, zoom* etj.). Një numër shumë i konsiderueshëm i nxënësve, prindërve dhe mësuesve u angazhuan në mësimet *online*: 96.8% e nxënësve, 95.3% e prindërve dhe 98.7% e mësuesve

Gjatë situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 për t'u ardhur në ndihmë mësuesve, nxënësve dhe prindërve, ASCAP ka hartuar dhe publikuar disa urdhra dhe udhëzime si më poshtë:

- Udhëzues për mësimin në kushtet e shtëpisë, për shkak të situatës së krijuar nga përhapja e virusit COVID-19, datë 9.3.2020.

- Udhëzues për realizimin e programit lëndor dhe vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në kushtet e shtëpisë (ASCAP).

- Udhëzues për vlerësimin e nxënësve dhe mbylljen e vitit shkollor 2019–2020 (të gjitha ciklet).

- Urdhër për organizimin e mësimin dhe vlerësimit për mbylljen e vitit shkollor për klasën e 12.

- 20 programet e maturës shtetërore janë rishikuar duke reduktuar të gjitha tematikat dhe njohuritë të cilat janë zhvilluar pas datës 9 mars 2020.

- ASCAP-ja ka punuar për sigurimin e cilësisë së rreth 500 videove të publikuara në Radiotelevizionin Shqiptar–Shkolla.

- ASCAP-ja ka hartuar planifikimin e temave mësimore të njësuara për të gjitha lëndët dhe klasat 1- 12.

- Janë hartuar standardet profesionale të mësuesit dhe janë miratuar në MASR më urdhër nr. 246 datë 24.7.2020.

- Janë hartuar fondet e kualifikimit të mësuesve (gjithsej 41 fonde për secilën lëndë dhe profil).

Lidhur me fillimin e vitit shkollor 2020–2021, MASR dhe ASCAP:

- Hartuan dhe zbatuan programin e mësimin plotësues në gjuhë shqipe dhe matematikë për klasat 1–5 me nxënësit që paraqitën vështirësi gjatë mësimin të zhvilluar në kushtet e shtëpisë (*online*), si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.

- Kanë realizuar sondazhin me mësues, nxënës, prindër për fillimin e vitit shkollor.

- Kanë hartuar udhëzuesin për fillimin e vitit shkollor 2020–2021 ku janë përfshirë edhe skenarët e mundshëm për zhvillimin e procesit të mësimdhënies–nxënies në kushtet e krijuara nga pandemia COVID-19.

Çdo ditë, nga data 14 shtator, në kanalin RTSH shkolla transmetohen sipas një orari lëndor për klasat 1–12, të gjitha lëndët e kurrikulës bazë (18 lëndë).

Po përdoret platforma Akademi.al, e cila siguron për nxënësit dhe mësuesit përdorim falas në platformën *online* për mësimdhënien, e cila bazohet në kurrikulën e arsimit parauniversitar.

Nga fillimi i pandemisë në muajin mars MASR ka shpërndarë në dy faza rreth: 500 tableta të dhuruara nga UNICEF-i, 500 tableta të dhuruara nga ECOLOG dhe rreth 5000 *smartphone* dhe 10000 tableta të dhuruara nga *Vodafone Albania* për nxënësit të cilët nuk kishin akses në mësimdhënien *online*, ku bëjnë pjesë nxënës të klasave kolektive, nxënës, banesat e të cilëve janë prekur nga tërmeti, si edhe kategori të tjera në nevojë që nuk kishin akses gjatë muajve të parë të pandemisë në mësimdhënien *online*.

Është miratuar lista me 1,000 mësues me kontratë e ndarë për secilën ZVA, të cilët do të jenë në dispozicion për mbulimin e nevojave për zëvendësimin e mësuesve që mungojnë për arsye shëndetësore.

Janë krijuar klasat sipas përcaktimit të distancimit fizik, me jo më pak se 1.5 m distancë dhe është sistemuar mjedisi i jashtëm për të mundësuar distancën e duhur. Në shkollat me numër të madh nxënësish zhvillimi i mësimin me turne dhe nënturne krijon mundësinë e respektimit të distancimit fizik në shkolla. Nga organet e pushtetit vendor është kryer dezinfektimi i të gjitha shkollave në fillim të vitit mësimor si edhe në vazhdimësi zbatohet protokoli i nxjerrë nga MSHMS-ja.

Me mbështetjen edhe të partnerëve tanë zhvillimorë UNICEF, World Vision, *Confindustria Save the Children* etj. janë furnizuar institucionet arsimore me maska mbrojtëse (230 mijë maska) për nxënësit dhe mësuesit dhe me dezinfektantë.

Në arsimin parashkollor janë hartuar dokumentet e mëposhtme:

- standardet e zhvillimit dhe të të nxënës të fëmijëve të moshës 3–6 vjeç (2017);



- korniza kurrikulare e arsimit parashkollor (2017);
- programet e moshës 3–4 vjeç (2017); programet e moshës 4–5 vjeç (2018); programet e moshës 5–6 vjeç (2019);
- standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit të arsimit parashkollor (2018);
- korniza e vlerësimit të fëmijëve në arsimin parashkollor (2019).

Për vitin shkollor 2020–2021 janë hartuar 27 programe orientuese, për provimet të arsimit bazë dhe të maturës shtetërore dhe vlerësimit të arritjeve të nxënësve të klasës së pestë.

Zhvillimi profesional

Në kuadër të zhvillimit profesional të mësuesve ka vijuar trajnimi i mësuesve për zhvillimin e tyre profesional, duke përfshirë edhe nevojat e mësuesve në kuadër të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe ka vijuar edhe funksionimi i rrjeteve profesionale të mësuesve, sipas profileve përkatëse apo sipas roleve të mësuesve në shkollë.

- Trajnimet e ofruara nga ASCAP deri në tetor 2020 janë si më poshtë:

Tema	Gjithsej
2020	
Shkollat e shekullit 21 (me <i>British Council</i>) Trajnimi i drejtorëve, cikli 3	246
Shkollat e shekullit 21 (me <i>British Council</i>) Trajnimi i mësuesve, cikli 3	857
Trajnimi i specialistëve të DRAP/ZVAP-ve për udhëzimin e kualifikimit	120
Nxitja e sjelljeve pozitive për parandalimin e dhunës në shkollë	64
Ngritja e kapaciteteve të oficerëve të sigurisë në shkollë	100
Ngritja e kapaciteteve të specialistëve të ZVAP-ve dhe bashkive për njohjen me reformën kurrikulare në arsimin parashkollor me kompetencat dhe përgjegjësitë e ZVA-ve dhe të bashkive, me problematikat e deritanishme që janë ndeshur nga të dyja institucionet.	65
Trajnimi me drejtuesit e rrjeteve profesionale të arsimit parashkollor për rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, prezantimi i Kornizës së vlerësimit në arsimin parashkollor; Diskutimi i ecures së takimeve të rrjetit të mësuesve të arsimit parashkollor.	154
Metodat e mësimdhënies dhe nxënies me në qendër nxënësin për mësuesit e gjuhës së huaj	27
Drejtuesit e rrjeteve profesionale për shkencat e natyrës	110
Drejtuesit e rrjeteve profesionale për temat mësimore të unifikuara	1200
Specialistët e ZVA-ve për udhëzuesin e fillim vitit shkollor 2020–2021	67
Trajnime të mësuesve për përdorimin e platformave <i>online</i> TeachPitch	5508
Drejtuesit e rrjetit dhe mësues të klasave kolektive për fillimin e vitit shkollor 2020 - 2021	60
Anëtarë të rrjeteve profesionale për hartimin e planeve të periudhës bazuar në temat mësimore të hartuara nga ASCAP	20000
Shkollat e shekullit 21 (me <i>British Council</i>) Trajnimi i drejtorëve cikli 4	112
Shkollat e shekullit 21 (me <i>British Council</i>) Trajnimi i mësuesve cikli 4	474
TOTAL	29164



Lufta kundër dukurive të tilla, si episode të dhunës apo përdorimi i drogave në shkolla janë prioritet i Ministrisë së Arsimit Rinisë dhe Sporteve dhe të Ministrisë së Brendshme. Ministria e Brendshme ka filluar tashmë të zbatojë konceptim “Shkolla të sigurta”, ku ka një vëmendje të posaçme në rritjen e sigurisë si brenda ashtu edhe jashtë shkollës. Duke synuar rritjen e sigurisë nëpërmjet ndërveprimit dhe parandalimit, Ministria Arsimit, Sportit dhe Rinisë në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme ndërmjet marrëveshjes së firmosur midis palëve, kërkon të krijojë një qasje të re nëpërmjet projektit “Shkolla të sigurta - Oficerët e sigurisë në shkolla”. Aktualisht janë trajnuar nga ASCAP 100 oficerë të sigurisë në shkolla, 64 mësues për nxitjen e sjelljeve pozitive për parandalimin e dhunës në shkollë.

Hartimi i pyetjeve me kompetenca për t'i paraprirë vlerësimit formues të nxënësit ka qenë në fokus edhe për këtë vit. 168 drejtues rrjetesh profesionale janë trajnuar në këtë fushë për zbatimin e udhëzuesit të hartimit të pyetjeve bazuar në kompetenca.

Prioritet i MASR-së dhe ASCAP për vitin shkollor 2019- 2020 është trajnimi i mësuesve të shkencave të natyrës (Biologji, Kimi, Fizikë). Aktualisht janë trajnuar rreth 110 drejtues të këtyre rrjeteve profesionale të cilët kanë përcjellë trajnimin me 3300 mësues po të këtyre lëndëve. Trajnimi konsiston në zbërthimin e programeve lëndore me kompetenca në tekstet e përshtatura të shtëpive prestigjioze *Oxford*, *Pearson* dhe *Cambridge*) si dhe në përgatitjen e nxënësve me pyetje të formatit të provimit ndërkombëtar PISA. Trajnimet vijnë edhe gjatë vitit shkollor 2020–2021.

Prioritet i rëndësishëm gjatë vitit 2019–2020, si dhe në vitin shkollor 2020–2021 ka qenë mbështetja e arsimit gjithëpërfshirës përmes ngritjes së kapaciteteve të mësuesve ndihmës që tashmë janë pjesë e qenësishme e sistemit tonë arsimor. Puna për këtë target-grup filloi me krijimin e rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës. Janë ngritur 42 rrjete profesionale të cilat përfshijnë rreth 1200 mësues ndihmës në të gjithë vendin për vitin 2020–2021.

Në kuadër të bashkëpunimeve, ASCAP në bashkëpunim me *British Council* kanë trajnuar deri tani 1689 drejtues dhe mësues të shkollave për përdorimin e Micro: Bit në procesin e mësimdhënie-nxënies si dhe për zhvillimin e

aftësive bazë të mendimit kritik dhe zgjidhjes problemore.

Pjesëmarrje e MASR (ASCAP) në Erasmus+, 3 universitete të huaja dhe 8 universitete shqiptare në realizimin e projektit “*Developing teacher competences for a comprehensive vet system in Albania - TEAVET (Erasmus+)*”. Ligji për IAL-të mundëson funksionimin efektiv të qendrave të ekselencës për trajnimin e mësuesve. MASR/ASCAP është përfshirë në orientimin e universiteteve për hartimin e moduleve të trajnimit (16 module trajnimi) në fushat: Të nxënës digjital, strategjitë e mësimdhënie/nxënies, qytetaria aktive, gjithëpërfshirja në arsim, kultura e të nxënës, mediat e lexim-shkrimit etj., si dhe në zhvillimin e trajnimeve të 1990 mësuesve në këto fusha. Aktualisht vijon trajnimi i mësuesve pa pagesë me modulet e akredituara nga projekti TEAVET.

IAL-të kanë përgatitur kriteret për vitin akademik 2020–2021, të cilat janë shpërndarë nëpër shkollat e mesme gjatë periudhës prill–maj 2019.

Shumëgjuhësia

Për mbrojtjen dhe formësimin e shumëgjuhësisë në sistemin arsimor shqiptar dhe standardizimin e kurrikulës e trajnimit të mësuesve, vijon bashkëpunimi bilateral me vendet anëtare të BE.

PISA

Shqipëria mori pjesë në PISA 2018 në format kompjuterik. Procesi është realizuar sipas standardeve PISA. Rezultatet e PISA 2018 u publikuan nga OECD në dhjetor 2019. Ecuria e Shqipërisë përgjatë dy cikleve të fundit të PISA mund të përkufizohet pozitivisht. Në fushën e leximit (që në PISA 2018 ishte edhe fusha kryesore), nxënësit shqiptarë kanë arritur konstante. Për sa u përket pikëve mesatare. Megjithatë, duhet theksuar se vështirësia e fushës së leximit në ciklin e fundit, ishte më e lartë se në ciklin e 2015–ës. Në matematikë (fusha në të cilën nxënësit shqiptarë kanë arritur më të larta), ka një rritje me 24 pikë nga cikli i 2015–ës. Ky progres e ka renditur Shqipërinë në vendin e 3-të me rritjen me të madhe në fushën e matematikës midis vendeve pjesëmarrëse në PISA, përgjatë një cikli. Në fushën e shkencës ka një ulje prej 10 pikësh nga cikli i mëparshëm. Duhet të theksojmë se kjo fushë është e lidhur drejtpërdrejt me fushën e leximit (fusha me arritje më të dobëta të nxënësve shqiptarë). Duke qenë se fusha e leximit ka qenë me e vështirë në



ciklin e fundit, mund të jetë një ndër faktorët që ka penalizuar nxënësit edhe në shkencë.

Faktorët që duhen konsideruar:

1. Në PISA 2018, Shqipëria e zhvilloi testimin në versionin kompjuterik, ku nxënësit u janë përgjigjur si pyetjeve të njohurive por edhe pyetësorëve, direkt nga kompjuteri. Sipas optikës sonë, ky është një faktor i cili mund të ketë ndikuar në performancën e nxënësve tanë.

2. Një faktor tjetër që mund të ketë ndikuar në arritjet e nxënësve, është edhe implementimi i kurrikulës së re të bazuar në kompetenca, e cila është reflektuar në programet mësimore, si edhe në librat shkollore.

Vendi ynë ka marrë pjesë në PISA në katër raunde, në 2000, 2009, 2012 dhe 2015. Shqipëria do të marrë pjesë në ciklin tjetër në PISA 2021.

Shqipëria ka marrë pjesë, gjithashtu, në trendet në Studimin Ndërkombëtar të Matematikës dhe Shkencës (TIMSS) 2019. Vendi ynë do të marrë pjesë në Progresin në Studimin Ndërkombëtar të Letërsisë së Leximit (PIRLS) 2021.

Reforma e teksteve shkollore

Sa i përket implementimit të reformës së teksteve shkollore gjatë periudhës mars–maj 2019, MASR-ja ndërmori procesin e përzgjedhjes së teksteve të reja për klasën V sipas kurrikulës së re.

Në shtator 2019 nxënësit e klasës V filluan mësimin me tekstet e reja.

Me realizimin e këtij procesi, u përmbyll pajisja e nxënësve të klasës I–XII me tekste sipas kurrikulës së re me bazë kompetencat.

Në vazhdim të dhënies në përdorim/falas të teksteve shkollore në vitin shkollor 2020–2021, në skemë u përfshinë edhe nxënësit e klasës VI dhe VII.

Nxënësit e klasës II–VII i përdorin tekstet përgjatë vitit shkollor dhe duhet t'i rikthejnë në përfundim të vitit shkollor, kurse nxënësit e klasës I marrin tekste 100% të reja çdo vit.

Për nxënësit nga klasa e I–XII, që u përkasin 16 kategorive të tilla si fëmijë që vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie, fëmijë që gëzojnë statusin e jetimit, statusin e të verbrit, fëmijë të pakicave kombëtare, fëmijë Rom dhe Egjiptian, fëmijë të familjeve emigrante, fëmijë me aftësi të kufizuara, fëmijë që vijnë nga familje ku kryefamiljari është pensionist, fëmijë viktime të trafikimit, fëmijë viktime të mundshme të trafikimit, fëmijë në institucionet e

paraburgimit/vuajtjes së dënimit, fëmijë të policëve të rënë në detyrë, fëmijë të shtruar në shërbimin onkologjik të Qendrës Spitalore “Nënë Tereza”, Tiranë, fëmija i tretë në familje, fëmijë ku njëri nga prindërit është me AK, tekstet shkollore ju jepen falas në masën 100%.

Për vitin shkollor 2020–2021 janë rreth 250 000 nxënës nga klasa e 1–7, përfshirë edhe 16 kategoritë e veçanta nga klasa 1–12, që kanë përfutur tekstet shkollore falas.

Buxheti i shtetit ka akorduar mbi 600 milionë lekë për tekstet falas.

Programi kombëtar i praktikave të punës

- Programi Kombëtar i Praktikave të Punës në administratën publike, synon të përfshijë pjesëmarrësit në një eksperiencë pune të integruar e në ndërveprim me profesionistë karriere në administratën publike, me qëllim përfitimin e një përvojë kualifikuese që ndikon në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale dhe njohjen e administratës publike.

- Aplikantët, janë të rinj nga mosha 21 deri në 26 vjeç, të diplomuar në programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës zgjat 3 muaj. Përfshirja në këtë program është pa pagesë. Periudha e praktikës së zhvilluar njihet si përvojë pune gjatë procedurave të rekrutimit në institucionet e administratës publike.

- Ky program, realizohet nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, e cila mbështetet nga institucionet e administratës shtetërore dhe institucione të tjera publike e jopublike, që ofrojnë gatishmëri për pranimin e aplikantëve. Në vitin 2020 ka pasur 2405 aplikantë, nga të cilët janë shpallur 662 aplikantë fitues në administratën qendrore dhe vendore.

Ndërhyrje në kuadrin e Paktit për Universitetin

Në lidhje me *bursat dhe reduktimi/përylashtimi nga tarifat* ndryshimet ligjore në fund të vitit 2018 unifikonin bursat në vetëm një vlerë të plotë, duke hequr opsionin e bursave të përgjysmuara. Po ashtu, ka shumë më tepër mundësi për të përfutur bursën. Për pasojë, megjithëse numri i studentëve ka një rënie të lehtë nga viti 2017–2018 në vitin 2019–2020, numri i përfutësve të bursës është rritur nga 6 264 studentë në 11,142 studentë. Në të njëjtën kohë, efekti financiar është gati trefishuar, nga 338,524,645 lekë në 929,501,038 lekë.

Po ashtu, është pesëfishuar numri i studentëve që përfitojnë reduktim apo heqje të tarifës së



studimit. Numri i përfituesve ishte 8 336 studentë në vitin akademik 2017- 2018 dhe arriti në 41,708 studentë në vitin 2019–2020. Po ashtu, efekti financiar i heqjes dhe reduktimit të tarifave u rrit nga 245,945,759 lekë në 831,382,194 lekë.

Biblioteka digjitale është një tjetër shërbim që ofrohet për arsimin e lartë. Janë zhvilluar disa takime në universitete për promovimin e mëtejshëm në bibliotekës digjitale, për të synuar shtimin e llogarive të përdoruesve. Po ashtu, është vendosur një përshtatje më e mirë e bashkësisë së materialeve që ofron biblioteka digjitale duke synuar shtimin e materialeve në fushën juridike.

Numri i llogarive MyEBSCOhost është dyfishuar gjatë vitit 2020. Në të njëjtën kohë, në bibliotekën digjitale janë realizuar rreth 90 mijë sesione kërkimi dhe rreth 100 mijë tekste dhe artikuj të ndryshëm.

Janë realizuar dhe planifikohen të realizohen shumë *ndërhyrje në infrastrukturë*. Kanë përfunduar punimet infrastrukturë të tri rezidencave studentore, Shkodër–Konvikti i Vajzave, Godina nr. 2, Vlorë–Konvikti i Vajzave dhe Korçë–Godina nr. 1, të financuara nga buxheti i shtetit në shumë prej 295 milionë lekë. Ka mbaruar mobilimi i të tria rezidencave studentore me vlerë pajisje elektro shtëpiake me vlerë totale 11.366.640 lekë dhe pajisje akomoduese mobilim me vlerë 106.809.540 lekë. Kanë përfunduar punimet rezidencat studentore, Elbasan–Konvikti i Vajzave dhe Gjirokastrë–Konvikti i Djemve, të financuara nga donatorë me vlerë 175 milionë lekë.

MASR-ja, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës dhe me Universitetin e Tiranës kanë përgatitur detyrën e projektimit të Kampusit të Universitetit të Tiranës. Në shtator është ngritur një task-forcë e cila po përgatit studimin e fizibilitetit dhe projektin teknik, mbështetur nga grantet e Western Balkan Investment Fund (WBIF).

Korniza Shqiptare e Kualifikimeve (KSHK)

Korniza Shqiptare e Kualifikimeve (KSHK), vlerësohet si thelbësore për reformën e kualifikimeve dhe cilësinë e sistemit të arsimit dhe aftësisë, në përgjithësi.

Task-forca ka ekzaminuar dhe veçuar ndryshimet e nevojshme të kornizës ligjore për AL në mënyrë që të përmbushë kriteret e referencës në mënyrë që korniza jonë e kualifikimeve t'i referohet Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (EQF) dhe asaj të QF-EHEA.

Mbi njohjen automatike të diplomave

Shqipëria u bë pjesë e rrjetit AdReN, një rrjet ku Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Italia dhe Maqedonia e Veriut janë qendrat përgjegjëse për procedurat e njohjes së diplomave (qendrat ENIC/NARIC). Ky rrjet synon të krijojë një zonë të njohjes automatike në rajonin e Adriatikut dhe të rrisë mobilitetin e stafit akademik. Në periudhën në vijim do të punohet, në bashkëpunim me vendet e tjera palë e rrjetit për të vijuar me njohjen automatike të kualifikimeve akademike.

Shqipëria ka negociuar një marrëveshje me Italinë për njohjen e kualifikimeve akademike dhe bashkëpunimin në kuadër të Procesit të Bolonjës. Palët bien dakord të promovojnë në nivelin më të lartë, të njohin gradat e lëshuara në të dyja vendet me qëllim vijimin e studimeve të mëtejshme, mbështetjen për Shqipërinë për të arritur angazhimet kryesore të procesit të Bolonjës dhe të EHEA, duke përfshirë veprimtaritë e përbashkëta të mobilitetit në të gjitha nivelet dhe zbatimin dhe lëshimin i diplomave të dyfishta (*double degrees*), diplomave të përbashkëta (*joint degrees*), doktoratave të përbashkëta në bashkë-udhëheqje (*co-tutoring*).

Në mbledhjen e kryeministrave të WB6 në Poznan në korrik 2019 u miratua një deklaratë e përbashkët për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor në kuadër të planit shumëvjeçar për zonën ekonomike rajonale, që synon të kontribuojnë në mënyrë aktive në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë dhe Zonën Evropiane të Arsimit në mënyrë që të konsolidojnë përpjekjet për t'u përafruar plotësisht me parimet e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë të përshkruara në Komunikimet e procesit të Bolonjës dhe Konventës për Njohjen e Kualifikimeve në lidhje me Arsimin e Lartë në Rajonin Evropian (Konventa e Lisbonës për Njohjen), si dhe Rekomandimi i Këshillit për promovimin e njohjes automatike të ndërsjellë të arsimit të lartë dhe kualifikimeve të arsimit të mesëm të lartë dhe të rezultateve të periudhave të mësimi jashtë vendit.

Në lidhje me Procesin e Bolonjës

Si pjesë e EHEA dhe Procesit të Bolonjës nga 2003, Shqipëria është shumë e angazhuar të përmbushë të gjitha angazhimet e Procesit të Bolonjës duke qenë shumë aktive në BFUG dhe të kontribuojë në këtë proces përmes pjesëmarrjes në grupe të ndryshme pune/këshilluese të BFUG dhe



së fundmi të marrë pjesë në tri grupe tematikë të BFUG.

Në fokus të kërkesës për mbështetjen Shqipërisë në BFUG në vitet e ardhshme duhet të jenë treguesit e mëposhtëm:

- implementimi i rezultateve të të nxënës në kurrikula;
- shpërndarja e ECTS sipas rezultateve të të nxënës;
- nxitja dhe inkurajimi i vlerësimit të studentëve në bazë të rezultateve të të nxënës;
- përshtatja e masave për mbështetjen e studentëve që të sigurojnë përfaqësimin e grupeve të nënpërfaqësuar;
- anketimi i të diplomuarve;
- llogaritja dhe monitorimi i atyre që nuk përfundojnë studimet e larta.

Përtej këtyre treguesve, vitet e fundit janë ndërmarrë disa angazhime të mëparshme që pasohen nga disa aktivitete të mundshme për t'u realizuar si më poshtë:

- hartimi i kuadrit ligjor kombëtar për të lehtësuar rihartimin e kurrikulave në bazë të rezultateve të të nxënës;
- vetëreferencimi me QF-EHEA dhe referencimi me EQF;
- hartimi i manualit dhe kornizës ligjore kombëtare në mënyrë që të zbatohet plotësisht udhëzuesi i përdoruesit për ECTS, duke përfshirë njohjen e ECTS për qëllime transferimi dhe procedurat e apelimit;
- zbatim i plotë i LRC (Hartimi i dispozitave ligjore për refugjatët, kuptim më i mirë dhe specifikim i dispozitave ligjore mbi dallimet thelbësore dhe procedurat e ankimimeve);
- njohje automatike (njohje automatike brenda rrjetit ADREN);
- hartimi i kornizës ligjore në mënyrë që të lejojë zbatimin e plotë të ESG;
- rishikimi i Kodit të Cilësisë për të pasqyruar standardet e ESG;
- ristrukturimi i Sistemit (QA) Sigurimit të Cilësisë për të siguruar pavarësinë gjithashtu dhe nga palët e interesuara dhe për të garantuar zbatimin e ESG;
- gjetja e mekanizmit për të garantuar përfshirjen më të gjerë të palëve të interesuara në QA të brendshme dhe të jashtme;

Shqipëria ka aplikuar në thirrjet për mobilitet në kuadër të aktiviteteve të financuara nga Erasmus +

në gusht 2019 për të shkëmbyer eksperiencë midis institucioneve në vendet e tjera të EHEA, dhe gjithashtu ka aplikuar të jetë vendi pritës në maj të vitit 2020 (afatet do të riskedulohen në 2021 për shkak të emergjencës COVID-19) për projektet e mobilitetit në lidhje me Sigurimin e Cilësisë dhe Sigurimin e Cilësisë së Programit të Përbashkët Ndërkombëtar.

Shqipëria po merr pjesë në 2 projekte të miratuara në vitin 2019:

- Nxitja e zbatimit të procesit të Bolonjës duke u përqendruar në njohjen e kualifikimeve dhe LRC në vendet që janë pjesë e TPG B mbi Njohjet, të financuar nga Erasmus + “Mjetet e Arsimit të Lartë - Nisma për të mbështetur zbatimin e reformave EHEA/Mbështetje për procesin e Bolonjës”;

- Zhvillimi i një Qasje Gjithëpërfshirëse Evropiane për Sigurimin e Cilësisë së Rrjeteve Universitare (Evropiane) - EUniQ, të financuar ERASMUS + KA3 - Mbështetje për projektin e Reformës në Politikëbërje.

Shqipëria është partner në 2 projekte nën Erasmus + “Mbështetje për zbatimin e reformave Evropiane të Zonës së Arsimit të Lartë (EHEA)”:

- Bologna Hub PS me drejtues të projektit *Deutscher Akademischer Austauschdienst EV*.

- SEQA- ESG me drejtues të projektit Shoqata Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA).

Në vitin 2019–2020 ASCAL mori pjesë në aktivitetet trajnuese dhe të plotësimit të databazës, për njohjen reciproke të diplomave në vendet e Ballkanit perëndimor, në kuadër të Projektit të *Regional Cooperation Council (RCC)*.

Mbështetur në ligjin e arsimit të lartë 80/2015, dhe VKM 783, “Për vlerësimin e performancës në mësimdhënie të personelit akademik të IAL”, në vitin 2019 ASCAL organizoi për herë të parë Sondazhin Kombëtar të Studentëve, në 40 Institucione të AL në vend. Qëllimi ishte përfshirja e studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të infrastrukturës në universitetin ku studionin.

Në kuadër të projektit RCC, në gjysmën e dytë të vitit 2020, ASCAL mori pjesë në aktivitetet trajnuese dhe hartoi raportin dhe dosjen e vetëvlerësimit (DVV), përkatësisht “ESG Self-Evaluation Guidance for QA agencies in preparation of an external evaluation of quality assurance systems against



European standards and guidelines for quality assurance in the western balkan”, në kuadër të përgatitjes për anëtarësim në EQAR dhe më tej në ENQA. ASCAL synon anëtarësimin e plotë në EQAR (Q4 2022) dhe ENQA (Q4 2023).

Një drejtim i rëndësishëm i punës është plotësimi i kushteve për anëtarësimin e ASCAL-it në ENQA dhe regjistrimi i saj në EQAR. Hartimi dhe plotësimi i bazës ligjore për zbatimin e plotë së ESG (Standardeve Evropiane për sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë), kryesisht e lidhur me pjesëmarrjen e studentëve dhe të përfaqësuesve të tregut të punës në ekipet e vlerësimit të jashtëm.

Buxheti

Fondet buxhetore të miratuara për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë në programin buxhetor afatmesëm për periudhën 2021–2023.

Totali i fondeve/tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2021–2023, të miratuara për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, miratuar me vendimin nr. 577, datë 22.7.2020 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2021–2023”, për vitin 2021 janë 43 miliardë e 852 milionë lekë, krahasuar me fondet e rishikuara të vitit 2020 kanë një rritje prej 5.5%, në vitin 2022 janë 44 miliardë e 431 milionë lekë dhe në vitin 2023 arrijnë në 45 miliardë e 512 milionë lekë. Fondet e parashikuara për periudhën 2021–2023, kanë një rritje mesatare vjetore që shkon nga 5.5%, në 2.4% ndaj vitit paraardhës. Fondet e miratuara për vitin 2023, krahasuar me vitin 2020 sipas VKM-së nr. 527, datë 22.7.2020, kanë një rritje prej 9%.

Fondet e miratuara në tavanet përfundimtare për MASR-në, *pa përfshirë të ardhurat dytësore si dhe fondet e ministrive të linjës për arsimin si dhe fondet e njësive të vetëqeverisjes vendore për arsimin*, ndaj totalit të shpenzimeve buxhetore për periudhën 2021–2023, parashikohet të arrijnë në 7.6% në vitin 2021, në 7.8% në vitin 2022, dhe në 7.6% në vitin 2023.

Fondet publike për arsimin, pa përfshirë të ardhurat dytësore si dhe fondet e ministrive të linjës për arsimin si dhe fondet e njësive të vetëqeverisjes vendore për arsimin, ndaj produktit të brendshëm bruto nga 2.4% në vitin 2019, në vitin 2021 arrijnë në 2.5%, në vitin 2022 në masën 2.4, si dhe në vitin 2023 arrijnë në masën 2.3%.

Fondet për “Sektorin e Arsimit”, parashikuar për periudhën afatmesme 2021–2023, ku janë pjesë e fondeve të arsimit, të ardhurat dytësore të IAL publike si dhe të ardhurat e tjera nga të tretë, përfshirë fondet e parashikuara nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Financës dhe Ekonomisë “Fonde për arsimin”, fondet e parashikuara të njësive të vetëqeverisjes vendore, “Për shërbimet dhe funksionet në arsimin parauniversitar”, si dhe fondet nga projekte të veçantë të donatorëve (*pa përfshirë shpenzimet familjare dhe shpenzimet për arsimin nga institucione private), në vitin 2023 parashikohet të arrijnë në 63.3 miliardë lekë, krahasuar me shpenzimet publike fondet për arsimin parashikohet të arrijnë në 10.61% dhe ndaj produktit të brendshëm bruto në 3.21%.

Rinia

Ideja e hartimit të Dokumentit Strategjik për Rininë 2022–2026 vjen si një domosdoshmëri jo vetëm me miratimin e ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, por edhe për faktin se në dhjetor të këtij viti përfundon “Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015–2020”. Dokumenti Strategjik për Rininë 2022–2026 do të jetë dokumenti ku do të bazohen politikat për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve. Ky dokument do të synoj hartimin e politikave rinore kombëtare integruese, për adresimin e problemeve të ndryshme me të cilat përballen sot, të rinjtë e që lidhen me sfida si, përfshirja e tyre në proceset vendimmarrëse, punësimi, edukimin, përfshirja sociale etj. Dokumenti Strategjik për Rininë 2022–2026 do të jetë në përputhje me Strategjinë Evropiane për Rininë 2019–2027.

Arsimi dhe formimi profesional

Në fushën e politikave të AFP, janë zhvilluar politika të konsiderueshme të zhvillimit të aftësive dhe plotësime në kuadrin ligjor për ligjin e AFP dhe KSHK.

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (NESS) 2014–2020, dhe plani i saj i veprimit, janë rishikuar dhe kohëzgjatja e tyre është shtyrë deri në vitin 2022 (siç është miratuar me VKM-në në tetor 2019). Rishikimi i Strategjisë u bë pas Raportit të Vlerësimit Afatmesëm që përfshin periudhën 2014–2018. Raporti vlerësoi se të katër prioritetet strategjike janë akoma relevante. Qëllimi kryesor i Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2019–2022 dhe planit të saj të veprimit është të



identifikojë dhe hartojë politikat e duhura për punësimin, arsimin dhe formimin profesional, në mënyrë që të krijojë vende pune dhe mundësi cilësore për punësim dhe aftësi përgjatë gjithë ciklit të jetës. Plani i veprimit në fushën e AFP ka si prioritet sigurimin e cilësisë së arsimit dhe formimit, duke siguruar parimet thelbësore të gjithëpërfshirjes dhe lidhjen/me tregun e punës, pa neglizhuar shkallën e pjesëmarrjes në arsimin dhe formimin profesional për të kapërcyer hendekun që ekziston krahasuar me vendet e Bashkimit Evropian.

Aktualisht, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive si dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), po plotësohen me burime njerëzore dhe po punohet për rritjen e kapaciteteve të tyre.

Në sistemin e AFP-së, tashmë është zhvilluar një cikël koherent politikash të proceseve të brendshme për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e kualifikimeve profesionale, i cili mbështet relevancën e kualifikimeve në tregun e punës. Në këtë kontekst, standardet e profesioneve, standardet e kualifikimit dhe skeletkurrikulat tashmë po zhvillohen në përputhje me një metodologji bashkëkohore, e cila merr në konsideratë parimet dhe kriteret e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe dokumentet e lartpërmendura bazohen në kontributin aktiv të sektorit privat. Rishikimi dhe përditësimi i Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve është një proces dinamik që lidhet ngushtë edhe me adresimin e nevojave të tregut të tregut të punës dhe nevojave të shoqërisë në tërësi.

Pandemia COVID-19, imponoi ndryshime në zhvillimin dhe implementimin e politikave të reja në fushën e AFP-së. Në të gjithë ofruesit e AFP-së, u implementua zhvillimi i mësimin në kushtet e shtëpisë (*online*). Për t'i ardhur në ndihmë zhvillimit të procesit të mësimin *online* u hartua dhe miratua udhëzuesi për mësimin dhe vlerësimin në kushtet e shtëpisë⁴⁷ si dhe Udhëzues për zhvillimin e testit *online* të provimit përfundimtar të teorisë profesionale të nivelit⁴⁸.

⁴⁷ <http://www.akafp.gov.al/wp-content/uploads/2014/09/Udhezues-Mesimi-e-vleresimi-online-ne-AP-.pdf>.

⁴⁸ <http://www.akafp.gov.al/wp-content/uploads/2014/09/Udhezues-praktik-per-hartimin-e-testit-online-final1.pdf>

Bazuar në udhëzuesin, ofruesit e arsimit profesional, organizuan *online* procesin mësimor si dhe vlerësimin e nxënësve, në kushtet e shtëpisë. Mësimi në kushtet e shtëpisë (*online*) u zhvillua nëpërmjet platformave të ndryshme, grupe në *WhatsApp*, *e-mail*, *messenger*, *facebook*, *skype*, *zoom*, *virtual classroom*, *google classroom*, *webinar* etj. Gjithashtu për lëndët e përgjithshme, si matematikë gjuhë, biologji, kimi, u ndoqën *live* në RTSH.

Pjesëmarrja në mësimin *online* u monitorua vazhdimisht dhe 87.6% e nxënësve morën pjesë në mësimin nëpërmjet platformave *online* social media etj.

Gjithashtu, u monitorua ecuria e zbatimit të mësimin *online* nëpërmjet pyetësorëve të hartuar nga AKAFPK. Raporti pasqyron ecurinë e zbatimit të mësimin në kushtet e shtëpisë dhe një panoramë të realizimit të këtij procesi, si dhe vështirësitë që u hasën e rekomandime për përmirësime në të ardhmen⁴⁹.

Për vitin akademik 2020- 2021, regjistrimet në arsimin e mesëm profesional publik janë 17,000 nxënës. Në vitin aktual akademik ka një rritje të numrit të nxënësve nga zonat rurale dhe grupet e marginalizuara. Më konkretisht, pjesëmarrja e romëve dhe egjiptianëve (R/E) u rrit me 11.6% duke arritur në 603 studentë (krahasuar me 568 në vitin e kaluar), ndërsa pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara u rrit nga 128 në 143 nxënës. Nxënësit nga zonat rurale zënë 45.4% të totalit të nxënësve në arsim profesional.

Trajnimi fillestar dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve/instruktorëve ka vazhduar dhe gjatë 2020 dhe pse kjo ishte e vështirë në kushtet e COVID-19. Konkretisht janë trajnuar 35 mësues/instruktorë me programin Bazat e didaktikës në AFP dhe 40 mësues dhe instruktorë me programe të tjera trajnimi për zhvillimin e vazhdueshëm profesional. Gjithashtu, janë organizuar Webinare në trajnimin e mësuesve/instruktorëve për aspekte të mësimin dhe vlerësimin *online* të nxënësve në kushtet e COVID-19. Aktualisht, po rishikohet programi bazat e didaktikës duke integruar në mënyrë më të qenësishme kompetencën digjitale në mësimdhënie.

⁴⁹ <http://www.akafp.gov.al/wp-content/uploads/2014/09/RAPORTI1.pdf>



Një hap shtesë drejt sigurimit të cilësisë është procesi i vetëvlerësimit i cili tashmë është një proces që kryhet çdo vit në të gjithë ofruesit e AFP-së. Zbatimi i procesit të vetëvlerësimit nga ofruesit publikë të AFP-së kërkon përdorimin e një metodologjie të qartë, të besueshme dhe shkencore, e cila siguron informacion dhe të dhëna që pasqyrojnë pikat e forta, pikat e dobëta dhe mundësitë në kualifikimet profesionale të ofruara nga ofruesit e AFP-së, por thekson nevojën për përmirësime në të ardhmen. Elementet e metodologjisë së vetëvlerësimit në AFP përfshijnë 5 dimensionet e cilësisë së veprimtarisë së ofruesve të AFP-së. Procesi i vetëvlerësimit i koordinuar dhe monitoruar nga AKAFPK-ja, u shërben të gjithë ofruesve publikë të AFP-së për të vlerësuar gjendjen dhe performancën e institucionit, funksionimin e organizmave dhe mënyrat e veprimit (*modus operandi*) brenda institucioneve të tyre, në lidhje me dimensionet e cilësisë, kryesisht në mësimdhënie, të nxënies dhe kualifikimit të nxënësve. Sa më objektivisht të kryhet procesi, aq më mirë përvetësohen mësimet e nxjerra nga ky proces, arrijtet e identifikuar, si edhe çështjet problematike për ofruesit e AFP-së. Në të vërtetë, të gjitha institucionet pjesëmarrëse kanë identifikuar përmes këtij procesi aspektet e tyre pozitive, si dhe fushat që kanë nevojë për përmirësim. Ky është një rezultat i rëndësishëm dhe shumë i dobishëm për ofruesit e AFP-së. Gjithashtu po punohet për përcaktimin e një modeli akreditimi për ofruesit e AFP.

Në përshtatje me nevojat e tregut të punës për punonjës të kualifikuar, në vitin 2020 janë hartuar 18 përshtatje/standarde të kualifikimit profesional hartuar 2 skeletkurrikula të reja dhe rishikuar 19 skeletkurrikula në përputhje me nivelet 2–4 të KSHK-së.

Rregullorja për praktikantët profesionale të nxënësve në biznes është miratuar në shtator 2020 dhe po implementohet në nivel kombëtar. Është rritur interesi i bizneseve për të bashkëpunuar me shkollat profesionale dhe për pasojë për të pranuar nxënës në vendin e punës.

Procesi i ngritjes së komitetit të parë sektorial është një nga zhvillimet e reja në AFP në Shqipëri. Pas miratimit të VKM-së, “Për mënyrën e funksionimit si dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteteve sektoriale dhe mënyrën e shpërbërimit të tyre” është hartuar një *roadmap* për

ngritjen dhe funksionimin e komitetit sektorial dhe po vijon procesi për zhvillimin e metodologjisë për përzgjedhjen dhe përcaktimin/përkufizimin e sektorit, si dhe metodologjia për zhvillimin e analizës së nevojave sektoriale për aftësi. Në fund të vitit 2020 do të hartohet dhe validohet metodologjia për përzgjedhjen dhe përcaktimin/përkufizimin e sektorit, si dhe do të finalizohet përcaktimi i sektorit të parë për të cilin do ngrihet komiteti sektorial.

Digjitalizimi është bërë një element i rëndësishëm i tregut të punës dhe ofruesit e AFP-së po përshtaten që të të përdorin avantazhet e tij për të ofruar mënyra të reja të të mësuarit/mësimdhënies moderne. Në bashkëpunim me donatorët, (BE, GIZ- Gjermani, SDC- Zvicër, ADA - Austri, Kooperacioni Italian etj.) po punohet si në drejtim të pajisjes me infrastrukturën e nevojshme dhe logjistikën por dhe në rritjen e kapacitetit të burimeve njerëzore në shfrytëzimin e avantazheve të digjitalizimit në zhvillimin e procesit mësimor. Nevojat në këtë fushë janë të konsiderueshme dhe situata e COVID-19 vuri në dukje se duhet investuar me përparësi në këtë drejtim si në aspektin e pajisjes me infrastrukturë e logjistikë ashtu dhe në trajnimin e vazhduar të mësuesve.

Përmes buxhetit të shtetit, investime të konsiderueshme në infrastrukturë janë bërë në shkollat profesionale, në aspektin e ndërtesave të reja. Përmes buxhetit të shtetit, janë bërë investime të konsiderueshme në infrastrukturë në ofruesit e AFP-së, si në aspektin e ndërtesave të reja, modern dhe laboratorëve të praktikave profesionale. Tashmë, pothuajse të gjitha shkollat kanë pajisje të përshtatshme për zhvillimin e të nxënies praktik e teorik. Ndërkohë, po vijon puna për optimizimin e rrjetit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional për t'u pozicionuar në treg si një ofertë arsimore cilësore në përgjigje të nevojave të tregut të punës dhe të shoqërisë në tërësi.

Ka vijuar ofrimi i kurseve të formimit profesional dhe trajnime të kryera, nëpërmjet Drejtorive Rajonale të Formimit Profesional Publik. Për periudhën vitin 2019, nëpërmjet qendrave publike të formimit profesional janë ofruar kurse formimi sipas kërkesave të tregut të punës. Në këto kurse janë regjistruar gjatë kësaj periudhe 32,247 persona, kryesisht të papunë nga zyrat e punësimit. Nga këto 13,411 janë femra. Të



certifikuarit gjatë kësaj periudha kanë qenë 24,777 persona, prej të cilëve 10,542 femra. Për 8-mujorin e viti 2020 janë regjistruar rreth 7,000 persona, prej të cilëve 2,900 femra, ndërsa janë certifikuar rreth 2400 persona dhe rreth 1000 janë femra.

Kultura

Prioriteti kryesor në fushën e artit dhe kulturës mbetet intensifikimi i përpjekjeve për zbatimin dhe realizimin e objektivave të parashikuara në “Strategjinë Kombëtare të Kulturës 2019 - 2025”, e cila është miratuar me VKM-në nr. 903, datë 24.12.2019, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për kulturën, 2019–2025” dhe plani i saj i veprimit.

Në këtë dokument strategjik, janë marr në konsideratë dhe eksperiencat më të mira të mëparshme në këtë fushë me qëllim:

- zbatimin e platformës së edukimit përmes artit dhe kulturës në institucionet e artit dhe kulturës, trashëgimisë kulturore dhe në sistemin para universitar;

- fuqizimin e partneritetit publik-privat (PPP) të institucioneve të trashëgimisë kulturore sipas modelit të paraparë në aktet ligjore për trashëgiminë kulturore;

- ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe profesionale në nivel qendror, vendor dhe të pavarur;

- përmirësimin e legjislacionit për mbështetjen e zhvillimit të industrisë kreative si forcë e pashfrytëzuar sa dhe si duhet deri më tani;

- rritjen e buxhetit dhe mbështetjes financiare për artin dhe kulturën;

- forcimi i bashkëveprimit të Ministrisë së Kulturës me komunitetin artistik.

Përparësitë strategjike të Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019–2025, në përputhje dhe me programin e qeverisë shqiptare, si dhe me planifikimin buxhetor afatmesëm janë:

- përmirësimi dhe zgjerimi i tregut kulturor nëpërmjet një legjislacioni në dobi të krijuesve, krijimtarisë artistike e kulturore dhe trashëgimisë kulturore, si dhe hartimi i paketës së re të skemës së mbështetjes së projekteve të Ministrisë të Kulturës;

- ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale – pasuri kombëtare e popullit shqiptar në breza;

- mbështetja e krijimtarisë dhe aktivitetit krijues të artistëve shqiptarë përmes rritjes së aktiviteteve kulturore dhe përfshirjes së artistëve;

- promovimi dhe përfaqësimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore shqiptare, materiale dhe shpirtërore në evenimentet e rëndësishme ndërkombëtare;

- zbatimi me sukses i Platformës kombëtare “Edukimi përmes artit” nga të gjitha institucionet e Artit dhe Trashëgimisë dhe në sistemin para universitar.

- forcimi i partneritetit publik dhe privat për realizimin e projekteve rijetëzuese në qendrat e trashëgimisë kulturore kombëtare;

- mbështetja e krijimtarisë dhe aktivitetit krijues të artistëve shqiptarë përmes rritjes së aktiviteteve kulturore dhe përfshirjes së artistëve, kryesisht të rinj nga Universiteti i Arteve, Tiranë (UART), në zbatim edhe të paktit për universitetin/studentët.

Në lidhje me paktin për universitetin/studentin deri më tani janë nënshkruar 8 marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Universitetit të Arteve me institucione të ndryshme që operojnë në fushën e artit, kulturës dhe/apo të trashëgimisë kulturore.

Ndërkohë në fushën e trashëgimisë kulturore mbetet prioritet dhe gjatë vitit 2021 hartimi dhe miratimi i akteve të tjera nënligjore në zbatim të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

26.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Arsimi

Gjatë vitit 2020 vazhdoi puna në grupe për hartimin e SKA (Strategjisë Kombëtare të Arsimit) për periudhën 2021–2026.

Në fushën e arsimit të lartë, gjatë vitit 2020 ka vijuar puna për zbatimin e ligjit 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” në bazë të të cilit janë miratuar aktet nënligjore si më poshtë vijon:

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 57, datë 29.1.2020, “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë”.

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 5.2.2020, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 777, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, ‘Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore’”.

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 156, datë 19.2.2020, “Për dhënien e statusit të veçantë



Akademisë së Forcave të Armatosura, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, si dhe organizimin e funksionimit të saj”.

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 160, datë 19.2.2020, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)”.

- Vendim nr. 436, datë 3.6.2020, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020–2021 dhe 2021–2022 e në vijim”.

- Udhëzim i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 1, datë 14.1.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisë kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”.

- Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 6, datë 4.3.2020, “Për përcaktimin e rregullave për afatet e aplikimit, të zbatimit të kriterëve dhe procedurave, për përcaktimin e masës dhe mënyrës së financimit, si dhe numrin e anëtarëve dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë komisioni për dhënien e bursave të parashikuara nga Fondi i Ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit civilë”.

- Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 17, datë 23.6.2020, “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar”.

- Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 23, datë 28.9.2020, “Për një shtesë në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisë kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”.

- Udhëzim i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 11, datë 2.4.2020, “Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së suplementit të diplomës”.

- Udhëzim i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 10, datë 30.3.2020, “Për përcaktimin e elementeve përbërëse, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”.

- VKM nr. 251, datë 27.3.2020, “Për një ndryshim në vendimin nr. 269, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, të ndryshuar.

- VKM nr. 331, datë 22.4.2020, “Për një shtesë në vendimin nr. 649, datë 14.9.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e listës së specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara”, të ndryshuar.

Akte nënligjore të miratuara në vitin 2020 për arsimin parauniversitar

- Udhëzim nr. 12, datë 18.5.2020, “Për mosorganizimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor, viti shkollor 2019–2020, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e COVID-19”.

- Udhëzim nr. 13, datë 18.5.2020, “Për vlerësimin me notë të nxënësve që nuk do t’u nënshtrohen provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2019–2020, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19”.

- Udhëzim nr. 24, datë 8.10.2020, “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 13, datë 22.5.2019, “Për procedurat e pranimit të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar.

- Udhëzim nr. 21, datë 13.8.2020, “Për përcaktimin e procedurave për administrimin e teksteve shkollore në përdorimin falas në arsimin parauniversitar”.

- Udhëzim i përbashkët nr. 18, datë 1.7.2020, “Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar”.



- Udhëzim nr. 19, datë 2.7.2020, “Për organizimin dhe zhvillimin e sesionit të dytë të provimeve të maturës shtetërore 2020 dhe maturës shtetërore profesionale 2020”.

- Udhëzim nr. 20, datë 8.7.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 13, datë 22.5.2019, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lire pune në institucionet publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar.

- Udhëzim nr. 14, datë 18.5.2020, “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 28 datë 12.12.2019, “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve kombëtare të maturës shtetërore 2020”.

- Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psikosocial”.

- Urdhër nr. 115, datë 18.5.2020, “Për trajtimin e kërkesave të personave për pajisjet me programet mësimore lëndore të zbatuara në institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë, në Republikën e Shqipërisë para vitit shkollor 2008–2009”.

- Urdhër nr. 114, datë 18.5.2020, “Për miratimin e rregullores së posaçme për zhvillimin e maturës shtetërore 2020 në Republikën e Shqipërisë, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e COVID-19”.

- Urdhër nr. 103, datë 27.4.2020, “Për marrjen e masave për mbylljen e vitit shkollor 2019–2020 nga institucionet e arsimit parauniversitar, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e COVID-19”.

- Urdhër nr. 106, datë 30.4.2020, “Për porositjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të klasave 1 dhe 6–12 të sistemit arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2020–2021”.

- Urdhër nr. 91, datë 9.3.2020, “Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jopublike”.

- Udhëzimi i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 8 datë 26.3.2020, “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesit”.

- Urdhri nr. 246 datë 24.7.2020, “Për miratimin e Standardeve profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesit në sistemin arsimor parauniversitar”.

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka vijuar punën për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

Konkretisht janë miratuar aktet si më poshtë:

- Miratuar udhëzimi nr. 11, datë 3.3.2020, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”.

- Miratuar udhëzimi nr. 18 datë 8.5.2020, “Për organizimin e mësimit, vlerësimin e nxënësve, provimet përfundimtare dhe mbylljen e vitit shkollor 2019–2020 në shkollat profesionale publike dhe jo publike, në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia COVID-19”.

Aktet e tjera ende të pa miratuara, janë draftuar, diskutuar me grupet e interesit dhe janë në pritje të miratimit (janë ose në sistemin e miratimit të akteve në Këshillin e Ministrave ose për t'u firmosur nga titullari i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë).

Në vit arsimor 2019–2020 u regjistruan rreth 4.900 nxënës në vitet e para, në të gjitha shkollat e mesme profesionale dhe totali i nxënësve që ndjekin këto shkolla është rreth 18.500 nxënës, ose rreth 20% e totalit të nxënësve që ndjekin shkollat e mesme.

Vijon puna në bashkëpunim me donatorët (BE, GIZ-Gjermani, SDC-Zvicër, ADA-Austri, Kooperacioni Italian etj.) për mbështetjen e shkollave më të mira profesionale.

Me fonde të buxhetit të shtetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka vijuar punën për rikonstruksionin e disa shkollave profesionale, bazave prodhuese të shkollave, blerjen e pajisjeve si për kabinetet profesionale ashtu edhe për kabinete të lëndëve të përgjithshme. Po ashtu është menduar edhe për blerjen e mobilie, duke synuar përmirësimin e kushteve të akomodimit të nxënësve në shkolla por edhe duke rritur cilësinë e shërbimit të ofruar. Këtij qëllimi i shërben edhe kualifikimi i burimeve njerëzore të shkollave profesionale, si të stafëve drejtuese ashtu edhe mësimeve. Ky proces është duke u mbështetur edhe nga donatorët ku evidentojmë bashkëpunimin me GIZ.

Ka vijuar ofrimi i kurseve të formimit profesional nëpërmjet Drejtorive Rajonale të Formimit Profesional Publik. Sqarojmë se për periudhën Janar-shtator 2019, nëpërmjet qendrave publike të formimit profesional janë ofruar kurse



formimi sipas kërkesave të tregut të punës. Në këto kurse janë regjistruar gjatë kësaj periudhe 19,589 persona, kryesisht të papunë nga zyrat e punësimit. Nga këto 8,480 janë femra. Të certifikuarit gjatë kësaj periudha kanë qenë 13,570 persona, prej të cilëve 6,023 femra.

Kultura

Në vizionin e Qeverisë dhe prioritetëve institucionale të Ministrisë së Kulturës, kultura nuk është vetëm një plotësim shpirtëror por një domosdoshmëri e përditshme e të rinjve dhe audiencave të gjera. Investimet kulturore do të kenë prioritet në rikualifikim dhe ri konceptim të Institucioneve Qendrore të Artit dhe Kulturës, synon të ndikojnë drejtpërsëdrejti në rritjen e cilësisë së jetës dhe në edukimin e grup-moshave të ndryshme.

Programi Kombëtar “Edukimi përmes artit” do të reflektojë konsolidimin e platformave të qëndrueshme në institucionet e artit dhe politikat kulturore duke vënë theksin në rëndësinë dhe rolin e edukimit përmes kulturës në kohezionin social, i provuar tashmë në vende të tjera. Edukimi masiv me art e kulturë do të synojë ndërhyrjen në kurrikulat e shkollës nga njëra anë dhe duke përfshirë në çdo institucion arti linjën pedagogjike dhe edukative nga ana tjetër.

Duke konsideruar artin dhe trashëgiminë kulturore si një faktor të rëndësishëm për një zhvillim të qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit, Ministria e Kulturës gjatë vitit 2020 ka intensifikuar investimet në infrastrukturë për rehabilitimin, ruajtjen dhe promovimin e artit e trashëgimisë kulturore. Ministria e Kulturës nëpërmjet koordinimit të disa sektorëve strategjikë të qeverisjes qendrore dhe partnerëve, gjatë vitit aktual ka siguruar fonde dhe planifikuar projekte dhe investime konkrete në të gjitha rajonet e Shqipërisë.

Veçojmë këtu bashkëpunimin tepër të frytshëm me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri, Fondacionin Shqiptaro- Amerikan për Zhvillim, Bankën Botërore, UNESCO, TIKa (Agjencia Turke e Bashkëpunimit dhe Koordinimit), CHwB.

Falë këtij bashkëpunimi gjatë 2020, janë zbatuar dhe po vijojnë ndërhyrje restauruese, konservuese në disa objekte të rëndësishme të trashëgimisë kulturore kombëtare, ndër të cilat përmendim:

- Në kuadër të pjesëmarrjes në programet IPA, Ministria e Kulturës dhe 6 institucione të trashëgimisë kulturore të varësisë po zbatojnë 9 projekte: “3D-IMP-ACT”, “Milestone II”, “Polyphonia”, IPA “Approdi”, IPA “Monet MK”, IPA “Monet MKF Marubi”, IPA “SMART- CULTOUR”, IPA “3C”, “IPA Phygital”, IPA “Hamleti”;

- Projekti me Rajonin e Pulias për rikualifikimin e hapësirës së Parkut të Kinostudios “Parku Artit”;

- Projekti “Inventarizimi me bazë komunitare i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale” me financim të UNESCO po zbatohet;

- Zbatimi i projekteve të restaurimit të Xhamisë Mbret, Berat, Xhamia e Beqarëve, Berat, Teqeja e Helvetive, Berat, Xhamia Ethem Beut Tiranë dhe Xhamia e Pazarit Gjirokastrë me investitor TIKa.

Viti 2020 ka rezervuar gjithashtu angazhime dhe/apo nisma të rëndësishme, ku vlejnë për t’u përmendur:

Në fushën e artit dhe të kulturës:

- Përfaqësime Kinematografike në Festivalin e Kanës, Berlinit etj.;

- Përfaqësime në Festivale dhe Pannaire të Librit;

- Kalendar i Përbashkët Kulturor Shqipëri-Kosovë;

- Kalendar kulturor i vijës bregdetare në shërbim të turizmit kulturor;

- Programi kombëtar “Edukimi përmes artit, kulturës në institucionet qendrore dhe rajonale;

- Projekti “Parku i artit”;

- Fushata kombëtare e leximit me shtrirje gjatë gjithë vitit;

- Tetori i librit;

- Krijimtaria letrare për fëmijë;

- Festivali letrar i të rinjve;

- Fondi i përkthimit nga shqip në gjuhë të huaj dhe anasjelltas;

- Konkurse mbarëkombëtare të krijimtarisë së re.

Prioritet kanë pasur dhe do të kenë projektet me thirrje ku tashmë është krijuar një traditë e mirë gjatë këtyre viteve të fundit. Në kuadër të thirrjes për projekt- propozime në Art, Kulturë dhe Trashëgimi Kulturore për vitin 2020, Ministria e Kulturës ka mbështetur 27 projekt propozime në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

Gjithashtu, me fonde të Ministrisë së Kulturës janë mbështetur 62 projekte të tjera në fushat e lartpërmendura.



Në fushën e trashëgimisë kulturore:

- Programi Kombëtar “Edukimi përmes artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore”;

- Ditët Evropiane të Trashëgimisë 24–29 shtator 2020;

- Njësia e Digitalizimit të pasurive kulturore në proces përfundimi në kuadër të Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Kulturës me AADF;

- Përgatitja e Dosjes për regjistrim në listën Botërore të Trashëgimisë jomateriale të UNESCO të katër dukurive: Xhubleta, Eposi i Kreshnikëve, Kërcimi i Tropojës dhe Transhumanca;

- Ekspozita të organizuara brenda dhe jashtë vendit ndër të cilat përmendim:

- “Një skedar apo ndoshta dy: mënyrat e fotografimit”, 11 janar–16 mars 2020, të artistit Armin Linke në bashkëpunim me Universitetin POLIS, Tiranë.

- “100 vjet parlamentarizëm shqiptar”, me fotografi dhe dokumente të të gjithë periudhës historike, me ngjarjet dhe dekretet më të rëndësishme, të marra nga Parlamenti Shqiptar përgjatë këtij 100-vjeçari, organizuar nga Historik Kombëtar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

- “Rrugëtim - Ismail Qemali ndër vite”, në përkujtim të 101-vjetorit të vdekjes së Ismail Qemalit, realizuar nga Agjencia Telegrafike Shqiptare me Muzeun Historik Kombëtar dhe në bashkëpunim me Muzeun Kombëtar të Pavarësisë Vlorë.

- “World Press Photo”, 6–26 shkurt 2020, organizuar nga Muzeu Historik Kombëtar dhe Ministria e Kulturës dhe Ambasada e Holandës në Tiranë.

- “Shqipëria dhe shpëtimi i hebrenjve nga nazistët”, ku MHK ishte pjesë e grupit të punës dhe ekspozoi objekte, pjesë të fondit të tij muzeor 3–17 shkurt 2020, Muzeu Historik Kombëtar, Kryeministra, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Kulturës.

- “Tungjatjeta, emri im është Tirana”, Varnë, Bullgari, dhe “Tungjatjeta, emri im është Tbilisi”, 7 shkurt–30 mars 2020, Muzeu Historik Kombëtar, Ambasada Shqiptare në Sofje, Ambasada e Gjeorgjisë në Republikën e Bullgarisë, dhe Departamenti i Historisë në Muzeun Rajonal të Varnas.

- Ekspozitë me objekte personale, të personave që kanë vuajtur nga regjimi komunist, si edhe me

piktura të artistit Lekë Tasi, 26–29 shkurt 2020, Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Instituti i Ish të Përndjekurve Politikë.

- “Krimet serbe dhe gjenocidi në Kosovë” 12 shkurt 2020, organizuar nga Muzeu Historik Kombëtar, Ambasada e Kosovës në Tiranë, Këshilli Koordinues i Shoqatës së të Zhdukurve të Kosovës.

Konferencë Shkencore Ndërkombëtare “Emigracioni politik shqiptar 1944– 1990”, 19 shkurt 2020, organizuar nga Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit 1944 - 1991 në bashkëpunim me Akademinë e Studimeve Albanologjike, Muzeun Historik Kombëtar, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Institutin e Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Institutin e Ish të Përndjekurve Politikë dhe Institutin e Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë.

Pas mbylljes së institucioneve të trashëgimisë kulturore (muzeve kombëtarë dhe parqeve arkeologjike), si pasojë e pandemisë COVID-19, institucionet dhe destinacionet e kulturës dhe trashëgimisë kulturore u promovuan gjerësisht *online* nëpërmjet tureve virtuale dhe formave të tjera digjitale. Ministria e Kulturës dhe Institucionet e trashëgimisë kulturore ndërmorën një seri nismash dhe aktiviteteve *online* ndër të cilat përmendim:

- “Hapni dritaret, lini muzikën” dhe një seri takimesh digjitale me institucionet vartëse të Ministrisë me temat “Muzikë nga shtëpia”, Muzikë nga dritarja”, “Lexo në shtëpi”, “Opera në shtëpi”, “Opera me pizhame”; Muzeu Historik Kombëtar - “Vizatimi i historisë nga shtëpia”, Arkivi Kombëtar i Filmit ndau filma të arkivuar për grupe të ndryshme moshe, Biblioteka Kombëtare promovoi bibliotekën e saj digjitale, Qendra Kombëtare e Librit hapi thirrjen me temën “Libri i karantinës”, Muzeu Kombëtar Gjethi - Programe edukative virtuale si “Lexo dhe ti” “Shqipëria dhe Korona”, “Edhe rrëfimi yt është pjesë e historisë”, Zbulojmë sekretet e “Shtëpisë me gjethe” ekspozitë virtuale “Qëndresa” dhe “Libra të ndaluar në komunizëm” etj.

Në fund të muajit maj, muzetë kombëtarë, Galeria Kombëtare e Arteve, parqet kombëtare arkeologjike dhe destinacione e tjera të trashëgimisë, në varësi të Ministrisë së Kulturës,



rinisën aktivitetet e tyre duke respektuar protokollet antikovid dhe udhëzimet e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në kushtet e situatës COVID-19, Ministria e Kulturës ka ndërmarrë disa masa zbutëse, që synojnë promovimin e turizmit kulturor, njëra prej të cilave është hyrja falas në muzetë dhe parqet arkeologjike çdo të diel. Vizitat kryhen gjithmonë në përputhje me protokollet e mbrojtjes nga përhapja e COVID-19.

Gjatë vitit 2020, një rëndësi e veçantë kanë qenë investimet publike, ku për t'u theksuar janë:

- Përfundimi i rikonstruksionit të Teatrit të Operës dhe Baletit;

- Përfundimi i hartimit të dy projekteve madhore të Ministrisë së Kulturës “Rehabilitimi dhe riformulimi i linjës muzeore të Muzeut Historik Kombëtar dhe Galerisë Kombëtare të Arteve”;

- Vijimi i zbatimit të ndërhyrjeve restauruese dhe të mirëmbajtjes në disa objekte të rëndësishme të trashëgimisë kulturore, ndër të cilat rendisim:

- Muzealizim i Muzeut “Mësonjëtorja e pare shqipe”;

- Restaurim i kishës së “Shën e Premtes në fshatin Valsh”, Faza II, Gjinar, Elbasan;

- Restaurim i kishës së “Shën Ilias Stegopull”;

- Restaurim i pjesshëm i tavanit me dekoracione murale në ish-muzeun popullor, Kulla e Inglizit, Shkodër;

- Restaurimi i çatisë së banesës së Sali Shijakut, Tiranë (faza e emergjencës);

- Vijimi i zbatimit dhe përfundimi i projekteve për ndriçimin e jashtëm të katër kalave monument kulture, kati I: kalatë e Shkodrës, Beratit, Krujës dhe Gjirokastrës.

Gjithashtu, gjatë 2020-ës:

- janë përfunduar projektet për ndriçimin e jashtëm në 15 kala, monumente kulture kategoria I, ndërsa është realizuar ndriçimi i jashtëm për 4 kala;

- është realizuar projekti për ndërhyrje përfunduese dhe restauruese në grupin e objekteve pasuri kulturore dhe muze sa më poshtë:

Ura e Kurcajt në perroin e Zerzës, Kalaja e Bashtovës, Kalaja e Prezës (Kulla e Sahatit dhe Kulla verilindore); Kalaja e Lezhës, Kalaja e Krujës (Kulla e Sahatit dhe muret e fortifikimit), Rrënojat e Kishës së Shën Mërisë, Mamurras, Kisha e Manastirit të Rubikut, Mirditë; Ish-Arqipeshkëvia e Durrësit në Delbnisht, Kurbin, Lezhë, Teqja e

Dollmës në Kalanë e Krujës, Godina e Vettingut (ish-Lidhja e Shkrimtarëve), Tiranë), Akademia e Shkencave, Tiranë, Godina e Ish të përndjekurve politikë, Tiranë, Teatri i Kukullave, Tiranë, Godina e Ish Kinostudios, Ministria e Kulturës, Tiranë, Hamami në oborrin e Shkollës “16 Shtatori”; Muzeu Arkeologjik; Banesa e “A Moisiu” Muzeu Etnografik; Kalaja e Durrësit (kulla C dhe muret e fortifikimit); Amfiteatri, Durrës; Kalaja e Ishmit dhe banesa pranë mureve të kalasë; Porto-Romano; Kalaja e Rodonit dhe Kisha e Shna Ndout në Kepin e Rodonit, Muzeu Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, Krujë; Muzeu Kombëtar i Përgjimeve sekrete “Shtëpia me gjethe”, Tiranë; Muzeu Etnografik, Krujë.

Investimet e parashikuara për vitin 2021 do të fokusohen kryesisht në rehabilitimin e monumenteve të kulturës, të cilat janë në faza emergjente dhe të planifikuara si në plane pune dhe parashikimet financiare nga buxheti i shtetit apo dhe donacionet. Gjatë vitit 2021 parashikohen në vijim:

- vazhdimi dhe përfundimi i restaurimit të Xhamisë Mbret, Teqesë Helvetike në Berat, Xhamisë së Et ‘hem Beut në Tiranë;

- Implementimi i Projektit *Smart Heritage* pjesë e programit “Adrion” me fokus promovimin, valorizimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në zonën e Adriatiko-Jonian e, përfutues Muzeu Arkeologjik, Durrës.

- Projekti i Digjitalizimit “Të fuqizojmë muzetë nëpërmjet teknologjisë, për një qasje më të gjerë për të gjithë”, bashkëpunim me fondin Shqiptaro – Amerikan për Zhvillim AADF

- Tri programe kulturore: “Gjurmët Fishtiane”, “Rrugët e Kujtesës” (Projekti për kthimin e burgut të Spaçit në një qendër muzeore, Ngrija e Muzeut të Hebrenjve, Rikonceptimi dhe Muzealizimi i Muzeut Kombëtar të Arsimit, Korçë), “Rrugët e Besimit”.

- Gjithashtu, në kuadër të ndërkombëtarizmit të vlerave të trashëgimisë kulturore gjatë 2021 Shqipëria do të marrë pjesë në edicionin e 17-të të Ekspozitës Ndërkombëtare të Arkitekturës, Bienale e Venecias, Itali. Ky aktivitet ndërkombëtar ishte planifikuar për vitin 2020 por për arsye të Pandemisë COVID-19 është shtyrë për vitin 2021.

Në zbatim të ligjit 27/2018, gjatë vitit 2020 janë miratuar dhe ka filluar puna për zbatimin e tyre aktet nënligjore sa më poshtë vijojnë:



- vendim i KM-së nr. 792, datë 7.10.2020, “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale”;

- vendim i KM-së nr. 793, datë 7.10.2020, “Për përcaktimin e kushteve të posaçme e të kriterëve të licencimit, dokumenteve shoqëruese dhe procedurave për shqyrtimin ose revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore”;

- vendim i KM-së nr. 737, datë 19.9.2020, “Për përcaktimin e rregullave për administrimin e Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale”;

- vendim i KM-së nr. 169, datë 26.2.2020, “Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme”;

- vendim i KM-së nr. 771, datë 30.9.2020, “Për deklarimin pasuri kulturore të Qendrës historike” të qytetit të Shkodrës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”;

- vendim i KM-së nr. 729, datë 16.9.2020, “Për deklarimin pasuri kulturore “Qendër historike” të fshatit Kaninë, zonës mbrojtëse të saj, dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”;

- vendim i KM-së nr. 583, datë 22.7.2020, “Për miratimin e planit të menaxhimit të integruar të Parkut Kombëtar të Butrintit”;

- vendim i KM-së nr. 399, datë 13.5.2020, “Për përcaktimin e kufijve të parkut arkeologjik Durrës”;

- vendim i KM-së nr. 560, datë 15.7.2020, “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore”, i ndryshuar;

- vendim i KM-së nr. 60, datë 29.1.2020, “Për deklarimin pasuri kulturore “Ansambël historik urban”, zonës mbrojtëse të tij, dhe zonës arkeologjike “B”, të fshatit Voskopojë dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”;

- udhëzim i ministrit të Kulturës nr. 285, datë 27.8.2020, “Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licencë, për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore”, i ndryshuar;

- urdhër i ministrit të Kulturës nr. 223, datë 3.7.2020, “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të saj”.

Gjithashtu me Vendimin e KM nr. 24, datë 16.1.2019 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit” është krijuar Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit.

Për sa u përket marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e kulturës, Ministria e Kulturës përgjatë vitit 2020 ka nënshkruar 4 Marrëveshje dhe aktualisht janë në proces 17 marrëveshje tjera.

Marrëveshje të nënshkruara gjatë vitit 2020:

1. Kalendar i përbashkët Kulturor Vjetor Shqipëri–Kosovë, për vitin 2020.

2. Marrëveshje për Bashkëprodhimin e Filmit ndërmjet Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Kulturës të Republikës së Shqipërisë.

3. Memorandum Bashkëpunimi midis Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës për bashkëpunimin në fushën e librit dhe veprimtarisë botuese.

4. Marrëveshje midis Ministrisë së Kulturës dhe Bashkimit Evropian për rivitalizimin e trashëgimisë kulturore në Shqipëri”.

Aktualisht janë në proces marrëveshjet e mëposhtme:

1. Protokoll Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë në Kulturës në Republikës në Shqipërisë dhe Drejtorisë në Përgjithshme në Vakëfeve në Republikës në Turqisë për zbatimin e projektit “Restaurimi i Xhamisë së Plumbit”, Shkodër, Shqipëri.

2. Marrëveshje Kulturore ndërmjet Qeverisë së Republikës Islamike të Iranit dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

3. Program Bashkëpunimi në fushën e Kulturës midis Ministrisë së Kulturës së Republikës së



Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës dhe Sportit të Republikës së Greqisë për vitet 2019- 2023;

4. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës për themelimin e Qendrës Kulturore të Kinës në Shqipëri (është firmosur në 2018 por nuk ka hyre ende ligjërisht në fuqi).

5. Marrëveshje për bashkëpunim kulturor midis Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës së Republikës së Çeke.

6. Marrëveshje për bashkëpunim kulturor midis Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit të Republikës së Italisë.

7. Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Muzeut Historik Kombëtar të Republikës së Shqipërisë dhe Muzeut Kombëtar të Qytetërimit të Republikës Arabe të Egjiptit për bashkëpunime dypalëshe në fushën e muzeve (marrëveshja është ende duke u negociuar nëse do të firmoset nga muze apo nga Ministria e Kulturës).

8. Marrëveshje midis muzeut “Marubi” dhe Institutit Historik të Malit të Zi.

9. Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Burimeve Njerëzore të Republikës së Hungarisë mbi bashkëpunimin kulturor”.

10. Kalendari i përbashkët kulturor vjetor midis MK së Republikës së Shqipërisë dhe MK, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës, për vitin 2020.

11. “Program ekzekutiv për bashkëpunimin kulturor midis Ministrisë së Kulturës dhe Informacionit së Mbretërisë së Arabisë Saudite dhe Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë për vitin 2017–2020”;

12. “Marrëveshje për Bashkëpunim kulturor midis Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës dhe Sportit të Mbretërisë së Spanjës”;

13. “Marrëveshje midis Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Kulturës, Sportit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Japonisë mbi Bashkëpunim në fushën e kulturës”;

14. “Marrëveshje Kulturore midis Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës së Republikës Sllovene”;

15. “Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi krijimin, funksionimin dhe aktivitetet e Qendrave Kulturore”;

16. Marrëveshje Kulturore me Italinë;

17. Marrëveshje Kulturore me Kubën.

Në kuadër të anëtarësimit dhe pjesëmarrjes në Programin Komunitar “Evropa Krijuese”, është shpallur Thirrja për vendet e Ballkanit Perëndimor, me nr. 39/2019, e quajtur “Forcimi i bashkëpunimit kulturor dhe konkurrencës së industrive kulturore dhe krijuese në Ballkanin Perëndimor”.

Për vitin 2020, në këtë thirrje, ka pasur 300 aplikues, nga të cilat rreth 30 aplikime nga institucionet dhe OJF-të që veprojnë në fushën e artit dhe kulturës nga Shqipëria.

Nga 13 projekte fituese, 7 prej tyre janë nga Shqipëria: OJF dhe institucione publike kulturore, si vijon:

- “Shoqata Poeteka” (2 herë fituese);

- “Tulla”;

- “Qendra Marrëdhënie”;

- “Vox Baroque”;

- “Qendra Harabel”;

- “Muzeu Historik Kombëtar”.

Gjatë periudhës raportuese Ministria e Kulturës ka organizuar dy sesione informuese rreth Programit dhe Thirrjes 39/2019, për Nënprogramet e Kulturës dhe atë të Medies.

26.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR);

- Ministria e Kulturës;

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;

- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP);

- Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA);

- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL);

- Agjencia Kombëtare për Arsimin, Formimin Profesional dhe Kualifikimet (AKAFPK);

- INSTAT.

26.7 Prioritetet

- të zbatojë strategjinë e arsimit parauniversitar dhe reformën e arsimit të lartë, me fokus në sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor në të



gjitha nivelet si në zonat urbane ashtu edhe ato rurale;

- të finalizojë legjislacionin dytësor për zbatimin e ligjit të AFP-së;

- të zbatojë Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2019–2022 dhe planit të saj të veprimit e cila ka fokus, ofrimin e arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit;

- të vijojë puna për zbatimin e Plan Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019–2025;

- të vijojë puna për plotësimin e legjislacionit dytësor në zbatim të ligjit 27/2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”.

KAPITULLI 27 MJEDISI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

27.1 Përmbajtja e kapitullit

Politikat e BE-së për mjedisin synojnë që të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të mbrojnë mjedisin për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Këto politika bazohen në veprimet parandaluese, parimin “ndotësi paguan”, si dhe luftën kundër dëmtimit të mjedisit në burim, ndarjen e përgjegjësisë dhe integrimin e mbrojtjes së mjedisit në politikat e tjera të Bashkimit Evropian. Legjislacioni mjedisor i BE-së përfshin mbi 200 akte ligjore që mbulojnë legjislacionin horizontal, cilësinë e ujit dhe atë të ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e riskut, kimikatet dhe organizmat e modifikuar gjenetikisht (OMGJ), zhurmat dhe pyjet. Sigurimi i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së kërkon investime të rëndësishme. Për aplikimin dhe zbatimin e *acquis* është e domosdoshme një administratë e fortë dhe e mirëpajisur në nivel qendror dhe lokal.

27.2 Struktura e kapitullit

- legjislacioni horizontal;
- cilësia e ajrit;
- ndryshimet klimaterike;
- menaxhimi i mbetjeve;
- menaxhimi i ujërave;
- mbrojtja e natyrës;
- kontrolli nga ndotja industriale
- kimikatet;
- mbrojtja nga zhurmat;

- mbrojtja civile.

27.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Sipas nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë legjislacionin e saj kombëtar me atë të BE-së.

Detyrimi për përaftrimin e legjislacionit shqiptar në fushën e mjedisit me atë të BE-së buron nga neni 108 i MSA-së, në të cilin citohet si më poshtë:

- Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit të mjedisit, me qëllim të promovimit të qëndrueshmërisë së mjedisit;

- Bashkëpunimi është përqendruar kryesisht në fushat prioritare që lidhen me *acquis* të Komunitetit në fushën e mjedisit.

Në lidhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian, politikat e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike janë pjesë e grupit të dytë të kompetencave të Bashkimit Evropian. Neni 4 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian përcakton se në këtë rast, Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare kanë të drejtë të miratojnë akte ligjore. Shtetet anëtare mund të ushtrojnë kompetencat e tyre në rast se Bashkimi Evropian nuk i shtron kompetencat e tij ose ka vendosur që të mos i ushtrojë këto kompetenca.

Politikat e Bashkimit Evropian për mjedisin dhe ndryshimet klimatike synojnë të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm, kalimin drejt një ekonomie me përdorim eficient të resurseve, emetime të ulëta dhe të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit për brezat ekzistuese dhe të ata të ardhshëm. Parimet kryesore të *acquis* të përfshira në këtë kapitull janë: veprimi parandalues, parimi se ndotësi paguan, lufta kundër dëmtimit të mjedisit në burim, përgjegjësia e përbashkët dhe integrimi konsideratave mjedisore, klimatike dhe mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore në politikat e tjera të Bashkimit Evropian. *Acquis* e Bashkimit Evropian në këtë kapitull përmban mbi 200 akte ligjore që rregullojnë legjislacionin horizontal, cilësinë e ujit dhe ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, kontrollin e ndotjeve industriale dhe menaxhimin e riskut, kimikatet, zhurmat, mbrojtjen civile dhe ndryshimet klimatike.

Respektimi i *acquis* të përfshirë në këtë kapitull kërkon investime të konsiderueshme dhe bashkëpunim të strukturuar ndërmjet të gjithë



grupeve të interesit, duke përfshirë autoritetet vendore, industrinë dhe shoqërinë civile. Për më tepër, për aplikimin dhe zbatimin e *acquis* është e domosdoshme një administratë e fortë dhe e mirëpajisur në nivel qendror dhe lokal.

27.4 Situata aktuale në Shqipëri

Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitje në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike.

Kushtetuta e Shqipërisë e konsideron zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen mjedisit si një nga objektivat kryesorë të shtetit. Ligji i vitit 2011 për mbrojtjen e mjedisit siguron bazat për akte ligjore specifike që normojnë komponentët e ndryshëm të mbrojtjes së mjedisit. Ligje specifike ekzistojnë për të normuar procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe vlerësimit strategjik mjedisor, cilësinë e ujit dhe atë të ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e riskut, kimikatet, pyjet etj.

Në kuadër të përafrimit të mëtejshëm të politikave dhe legjislacionit me *acquis*-legjislacionin evropian, është shënuar progres në fusha të tilla si: menaxhimi i mbetjeve dhe ujit, krimi mjedisor dhe mbrojtja civile. Përpjekje të mëtejshme janë ende të nevojshme për forcimin dhe zbatimin e legjislacionit, veçanërisht në fushën e menaxhimit të mbetjeve, cilësisë së ujit dhe ajrit, si dhe ndryshimet klimatike.

Legjislacioni horizontal

Në lidhje me **çështjet horizontale**, Shqipëria duhet të shtojë përpjekjet për të arritur një harmonizim dhe zbatim të plotë në shumicën e fushave, veçanërisht sa i përket zbatimit të Direktivave të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimit Strategjik Mjedisor, në sektorët e energjisë dhe minierave.

Pjesëmarrja dhe konsultimi me publikun në vendimmarrje, duhet të përmirësohet, veçanërisht në nivelin lokal.

Në korrik 2019, Shqipëria miratoi ligjin që ndryshon Kodin Penal, duke transpozuar plotësisht Direktivën për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal. Sidoqoftë, zbatimi mbetet një sfida.

Është përparuar lidhur me zbatimin e mëtejshëm të direktivës INSPIRE. Nevojitet progres i mëtejshëm për të arritur një harmonizim të plotë me direktivën e përgjegjësisë mjedisore.

Në periudhën janar dhe tetor 2019, (ish) Inspektorati Shtetëror i Mjedisit ka kryer mbi 3,300 inspektime mjedisore. Pas tërmetit në nëntor 2019

dhe gjatë pandemisë COVID-19 në pranverën e vitit 2020, inspektimet janë pezulluar. Inspektorati kaloi në ristrukturim dhe shpërndarje të kompetencave, ku me vendim të Këshillit të Ministrave të korrikut 2019, Agjencia Kombëtare e Mjedisit mori përgjegjësi për inspektimin dhe kontrollin në mjedis dhe sektorin e ujit, Ministrisë së Brendshme iu dha gjithashtu kompetenca në këtë fushë në fillim të vitit 2020.

Buxheti i Shtetit për mjedisin dhe ndryshimin e klimës u zvogëlua më shumë në 2019. Ai duhet të rritet për të përmbushur të gjitha kërkesat e direktivave të transpozuar të BE-së.

Menaxhimi i mbetjeve

Kuadri ligjor është i përafërt me 53.5%. Strategjia e re kombëtare 2020- 2035 për menaxhimin e integruar të mbetjeve u miratua më 27 maj 2020. Ajo synon të përfshijë parimet e ekonomisë qarkulluese në sistemin kombëtar të menaxhimit të mbetjeve. Në zbatim të VKM nr. 428, datë 8.6.2016, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore, për hartën digjitale të deponive të mbetjeve urbane”, po hartohet një hartë GIS, e cila pritet të miratohet, e krijuar me informacione që pasqyrojnë situatën aktuale të mbetjeve urbane deponitë, si dhe zhvillime të tjera në terren. Fushatat e ndërgjegjësimit janë kryer për të zvogëluar deri në pikën e mos përdorimit të qeseve të holla plastike dhe përdorimit të qeseve të rrobave. Janë marrë masa për zvogëlimin e qeseve plastike, plastike, përmes vendosjes së kriterëve të miratuara me vendimin nr. 232, datë 26.4.2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 177, datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”.

Pas një analize të detajuar të mangësive, sfidave ose progresit në fushën e menaxhimit të mbetjeve, në fund të Shtatorit 2020, u përgatit një plan veprimi në fushën e menaxhimit të mbetjeve me mbështetjen e projektit SANE 27. Plan i është përgatitur për të gjitha direktivat dhe rregulloret e BE-së për nënkapitullin e mbeturinave. Përmbytja e tij ofron një përshkrim të hollësishëm të situatës aktuale, transpozimin dhe zbatimin e detyrave që do të kryhen në periudhën afatshkurtër (2021–2023) dhe afatmesme (2024–2027) si dhe një vlerësim të burimeve financiare dhe njerëzore për të kryer detyrat. Ky plan përcakton rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të përfshira si dhe afatet për zbatimin e direktivave të përgatitura.



Bazuar në identifikimin e deponive në të gjithë vendin, rehabilitimi/mbyllja e tyre ka filluar. Rehabilitimi i deponive ka filluar për deponitë në bashkitë e Beratit, Ura Vajgurore dhe Kuçova, me mbështetjen e projektit zviceran SECO, ndërsa mbyllja e deponisë në Porto-Romano dhe kthimi i saj në një ekopark financohet nga buxheti i shtetit. Një seri trajnimesh janë kryer për të zbatuar plotësisht VKM 319/2018 në lidhje me llogaritjen e kostove dhe tarifave të kërkuara për menaxhimin e mbetjeve në një Njësi të Qeverisjes Vendore. Fillimisht trajnimet u zhvilluan me praninë e përfaqësuesve të komunave dhe më pas për shkak të fillimit të situatës pandemike, trajnimet u zhvilluan në internet përmes platformave të ndryshme: *skype*, *webex*, *zoom*.

Përgatitja e një drafti për të vendosur sistemin e Përgjegjësisë të Prodhuesit të Zgjatur ka filluar me mbështetjen e programit Suedezi SIDA. Duke pasur parasysh përgatitjet e Shqipërisë për negociata me BE, është thelbësore jo vetëm për të transpozuar direktivat/rregulloret e BE, por edhe për të zhvilluar praktikën më të mira për zbatimin e sistemit të Përgjegjësisë të Prodhuesit të Zgjatur. Gjatë këtij viti, u përgatit një draft për të ndaluar prodhimin, importimin, përdorimin e çdo lloji qese plastike në vend.

Drafti u miratua nga Këshilli i Ministrave me VKM-në nr. 227, datë 12.3.2020, “Për propozimin e projektligjit”. Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve, i ndryshuar”.

Pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, kërkohen diskutime në komisionet parlamentare dhe më pas paraqiten në parlament për miratim.

Objektivat specifikë të Dokumentit të Politikave Strategjike synojnë të japin zgjidhje praktike, për:

1. Adresimin e problematikave në sistemin e deritanishëm të menaxhimit,

2. Zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi; dhe

3. Përgatitjet e nevojshme për të përmbushur detyrimet nga ndryshimet në direktivat e BE-së, përfshirë edhe objektivat ambiciozë të Paketës së Ekonomisë Qarkulluese.

Arritja e këtyre objektivave, përmirëson cilësinë e mjedisit dhe shëndetin e qytetarëve, duke i dhënë impuls shtesë zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, si dhe hapjen e rrugës drejt integritimit evropian.

Menaxhimi i ujërave

Niveli i përafrimit të legjislacionit të BE-së me atë kombëtar për fushën e menaxhimit të ujërave, mbetet i pandryshuar dhe i pjesshëm, në lidhje me disa direktiva të rëndësishme. Një paketë ligjore është në përgatitje nën mbështetjen e BE dhe ADA nëpërmjet projektit EUSIWM, e cila do të çojë në një nivel më lartë nivelin e përgjithshëm të transpozimit.

E ngritur në vitin 2018 nën varësinë e Zyrës së Kryeministrit, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) ka bërë progres në rekrutimin e stafit e saj gjatë vitit 2019, por ka nevojë për forcimin e kapaciteteve të saj administrative për menaxhimin e baseneve të lumenjve dhe zbatimin e *acquis* të BE-së për ujin, në këtë aspekt kjo agjenci po mbështet nga EU, ADA dhe SIDA.

Shqipëria duhet të procedojë me përfundimin dhe miratimin e planeve të mbetura të menaxhimit të baseneve lumore, duke përfshirë konsultimet ndërkuftare. Rrjeti i monitorimit dhe raportimit të cilësisë së ujit dhe sistemi i licencimit duhet të përmirësohen më tej dhe të harmonizohen me kërkesat e *acquis*. Rrjeti i monitorimit të ujit shtrihet në lumenj, liqene, zona bregdetare dhe laguna. Agjencia Kombëtare e Mjedisit duhet të forcohet urgjentisht në këtë drejtim. Nën-sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve ka nevojë për përmirësime. Megjithatë, nevojiten përpjekje më të mëdha për të forcuar kapacitetin, performancën dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve komunale. Për të konsoliduar progresin, duhet të miratohet projektligji për furnizimin me ujë dhe kanalizimet dhe strategjia kombëtare 2020–2030 për furnizimin me ujë dhe kanalizimet. Agjencia Kombëtare e Ujësllës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve duhet të rrisë kapacitetet e saj, veçanërisht në sektorët e ujërave të ndotura dhe mbetjeve.

Implantet e trajtimit të ujërave të ndotura plotësojnë vetëm rreth 15% të popullsisë, ata ende përballen me shqetësime kryesore si mungesa e licencimit dhe tarifimit për trajtimin e ujërave të ndotura, funksionimi dhe mirëmbajtja e pamjaftueshme dhe ndikimit mjedisor të kufizuar për shkak të rrjeteve dhe lidhjeve në zhvillim e sipër. Ka një nevojë urgjente për të siguruar harmonizimin e plotë me Direktivën e Trajtimit të Ujërave të Zeza Urbane, shtrirjen e rrjeteve të kanalizimeve, licencimin dhe aplikimin e tarifave



për të gjitha impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura dhe ndërtimin e atyre të reja, veçanërisht në zonat urbane dhe bregdetare dhe ato të vizituara nga turistët.

Në shkurt 2020, Këshilli Kombëtar i Ujit miratoi planet e menaxhimit të basenit lumor Drini- Buna dhe Seman.

Në prill 2020, ministrat dhe përfaqësuesit e nivelit të lartë të pesë vendeve kufitare të Basenit të Drinit, nënshkruan Programin e Veprimit Strategjik (SAP) për Basenin e Lumit Drin në Evropën Juglindore.

Në qershor 2020, PMBU Seman u miratua me VKM-në nr. 453, datë 10.6.2020, “Për miratimin e planit të menaxhimit të basenit ujqor Seman”. Gjithashtu në mbledhjen e këshillit të ministrave të datës 4.11.2020 është miratuar edhe vendimi i këshillit të ministrave, “Për miratimin e planit të menaxhimit të basenit ujqor Drin-Bunë”.

Disa përparime janë bërë përmes kontratave të performancës të nënshkuara me shërbimet komunale, rregullimin e lidhjeve të paligjshme, skemat e rishikuara të subvencioneve dhe miratimin e një skeme të certifikimit të stafit.

Cilësia e ajrit

Plani kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit i miratuar në qershor 2019 përqendrohet në masat mbi transportin, eficiencën e energjisë, zhvillimin urban, sektorin e bujqësisë si dhe parashikon masa lidhur me përmirësimin e sistemit të monitorimit dhe bërjen e tij plotësisht dhe vazhdimisht funksional. Zbatimi i masave të planifikuara në PKMCA, duhet të shoqërohet me mbështetje financiare dhe forcimin e kapaciteteve teknike.

Aktualisht, për shkak të mungesës së fondeve, pajisjet e monitorimit të ajrit kanë hasur sfida për shkak të nevojës për kalibrim dhe mirëmbajtje. Pjesëmarrja në trajnime lidhur me përgatitjen dhe dhe raportimin e inventarëve kombëtare të shkarkimeve, siç kërkohet nga Konventa e UNECE, mbi Ndotjen e Ajrit në Distançë të Largët Ndërkufitare, ka rritur disi kapacitetet administrative në vend. Përmbyshja e detyrimeve ndaj CLRTAP, kërkon mbështetje teknike afatgjatë. Përafrimi i direktivës 2016/2284 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 14 dhjetor 2016 mbi pakësimin e shkarkimeve kombëtare të disa ndotësve atmosferikë, që amendon direktivën 2003/35/KE dhe që

shfuqizon direktivën 2001/81/EC, CELEX:32016L2284, ka avancuar me miratimin e në shkurt 2020, të VKM-së nr. 162, datë 19.2.2020, “Për rregullat për përgatitjen, miratimin, rivlerësimin dhe zbatimin e programeve kombëtare për uljen e emetimeve në ajër”.

Ndryshimet klimatike

Referuar fushës së *ndryshimeve klimatike*, Shqipëria ka arritur njëfarë niveli të përgatitjes, por përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* mbetet ende i kufizuar. Në korrik 2019, u miratua Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike për periudhën 2019–2030, me objektiva për vitin 2050. Strategjia fokusohet tek energjia, transporti, bujqësia, përdorimin e tokës dhe pyjeve, me qëllim për të arritur objektivin prej 32% të energjisë së rinovueshme.

Një çështje tepër serioze dhe shqetësuese mbetet mungesa e strukturave specifike administrative si dhe ekspertëve aktual të cilët duhet të merren me trajtimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike. Sa i përket raportimit të saj në Konventën Kuadër të KB për Ndryshimet Klimatike, Shqipëria po përgatit komunikimin e saj të katërt kombëtar dhe raportin e dytë të përditësuar bienal.

Mbrojtja e natyrës

Përafrimi me legjislacionin e Bashkimit Evropian, kryesisht referuar Direktivave për Habitatet dhe Zogjtë, është në nivel të avancuar. Ligji për zonat e mbrojtura u ndryshua në 2018 për të vënë theksin më të madh në planifikimin dhe zhvillimin e tyre.

Janë përgatitur dhe janë në proces miratimi dy draftvendime të KM-së; draftvendimin e KM-së “Për të ardhurat e gjeneruara nga tarifat, masat dhe kriteret e përdorimit të tyre, si dhe draftvendimin e KM-së “Për masën e fondit të veçantë për zonat e mbrojtura mjedisore, për burimet e krijimit dhe rregullat e përdorimit të tij”.

Me urdhër të Këshillit të Ministrave nr. 26, datë 3.2.2020, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura”, ka një rritje të stafit të punonjësve, që nënkupton dhe rritje të buxhetit, lidhur me fondin e pagave.

Është firmosur marrëveshja e grantit midis qeverisë Suedeze dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për fillimin e projektit



“Ngritja e rrjetit Natura 2000”, i cili gjatë zbatimit të tij do të sigurojë transpozimin e plotë të direktivës së habitateve dhe shpendëve. Njëkohësisht do të zhvillohet legjislacioni i nevojshëm primar dhe sekondar për përputhshmërinë e plotë me këto direktiva. Gjithashtu do të fuqizohen kapacitetet institucionale, lidhur me monitorimin dhe zbatimin, si dhe do të përgatitet një plan institucional zhvillimi, duke marrë në konsideratë një plan gradual për rritjen e kompetencave dhe numrit të stafit si dhe planifikimin e buxhetit dhe shpenzimeve.

Shqipëria duhet të **sigurojë zbatimin e ligjeve për sa i përket prerjes së pyjeve**, ndjekjes penalisht të shkelësve dhe zjarrvënësve. Raportet për krimin mjedisor janë rritur në gjashtë muajt e fundit, veçanërisht në shpyllëzimet, prerjet, zjarrvëniet, gjuetinë dhe shitjen e botës së egër dhe specieve të mbrojtura, nxjerrjen e zhavorrit nga shtretërit e lumenjve, hedhjen e mbetjeve në lumenj. Ende nuk ka informacion mjedisor nga inspektimet dhe monitorimet e HEC-eve aktuale.

Kontrolli nga ndotja industriale

Lidhur me Kontrollin nga Ndotja Industriale Përafrimi me legjislacionin e BE-së është ende në një fazë të hershme.

Kimikate

Referuar fushës së **kimikateve**, janë ndërmarrë disa hapa pozitivë në kuadër të harmonizimit me Rregulloren e BE-së për regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve (REACH) dhe me instrumente të tjerë. Në shkurt të vitit 2020 Shqipëria ratifikoi Konventën Minamata për Merkurin.

Sidoqoftë, legjislacioni zbatues mbetet për t'u miratuar dhe strukturat e duhura administrative duhet të forcojnë kapacitetet teknike në këtë fushë.

Mbrojtja nga zhurmat

Shqipëria duhet të forcojë kapacitetin e saj administrativ për përgatitjen e hartave strategjike dhe planet e veprimit për zhurmat.

Mbrojtja civile

Ligji i ri i Mbrojtjes Civile i miratuar në Korrik 2019 parashikon që Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile të shndërrohet në Agjenci Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC).

Përveç tërmeteve, përmbytjet janë një rrezik i madh, por Shqipëria ka bërë pak përparim në përafrimin me Direktivën e Përmbytjeve dhe

akoma duhet të rregullojë shërbimet e paralajmërimit të hershëm dhe hidrometrik-meteorologjik.

Kapaciteti administrativ, infrastruktura dhe sistemet për paralajmërimin e hershëm, parandalimin, gatishmërinë dhe reagimin janë të papërshtatshme.

Tërmetet e vitit 2019 theksuan urgjencën e ndërtimit të sistemeve efikase të mbrojtjes civile dhe Zvogëlimit të Rrezikut nga Katastrofat (*Disaster Risk Reduction DRR*) dhe integrimin e DDR-së në sektorët kryesorë. Pandemia COVID-19 theksoi nevojën për të forcuar kuadrin ligjor dhe kapacitetet institucionale si dhe burimet njerëzore dhe financiare të autoriteteve të mbrojtjes civile gjithashtu në lidhje me urgjencat shëndetësore. Shqipëria inkurajohet të përshpejtojë përgatitjet për të qenë pjesë e Mekanizmit të Mbrojtjes Civile Evropiane (UCPM).

Duhet të ndërtohen kapacitete institucionale dhe të krijohen shërbime të sigurta Transevropiane për telematikën ndërmjet administratave (STESTA), e cila është një parakusht për lidhjen me Sistemin e Përbashkët të Komunikimit të Emergjencës dhe Informacionit (CECIS). AKMC duhet të sigurohet me kapacitet të plotë për këtë qëllim.

Në funksion të premtimeve që rezultuan nga Konferenca e Donatorëve pas tërmetit të organizuar nga Komisioni në Bruksel në 17 shkurt 2020, Shqipëria duhet gjithashtu të vendoset urgjentisht një plan financimi dhe veprimi në zbatim të masave të Mbrojtjes Civile dhe të strategjisë të rikuperimit të pas-tërmetit DRR, e cilat përfshijnë gjithashtu veprime kryesore strukturuese kombëtare.

27.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Legjislacioni horizontal

Për sa i përket legjislacionit horizontal, Shqipëria ka përafruar pjesërisht Direktivën për krijimin e një infrastrukture për informacionin hapësinor (INSPIRE).

Miratuar ligji nr. 52/2020, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar

Miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 380 datë 13.5.2020, “Për propozimin e projektligjit, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar”. Në pritje për t'u miratuar ligji.



Është miratuar urdhri i Kryeministrit nr. 113, datë 30.8.19, “Për formatin e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të platformës së partneritetit për integrimin evropian”, i cili vjen si kërkesë e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 749, datë 19.12.19, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse, për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.

Ky urdhër synon të adresojë disa çështje të rëndësishme të procesit aktual të integritimit evropian, si dhe atij të pritshëm me nisjen e bisedave për anëtarësim.

Konkretisht, sipas kreut III.2 pika 4 të urdhrit përcaktohet se për të qenë anëtar në tryezat e diskutimit, duhet fillimisht të ftohen të marrin pjesë lirisht përfaqësuesit e organizatave të shoqërive civile, të pushtetit vendor, të komunitetit të biznesit, të shoqatave të punëmarrësve, të medias dhe të grupeve të interesit. Në zbatim të urdhrit të Kryeministrit, MTM-ja ka ndjekur hapat e kërkuar me qëllim finalizimin e tryezës për kapitullin 27.

Menaxhimi i mbetjeve

Kuadri ligjor është përafruar 53.5.%. Strategjia e re kombëtare 2020–2035 për menaxhimin e integruar të mbetjeve është miratuar më 27 maj 2020. Ajo synon përfshirjen e primeve të ekonomisë qarkulluese në sistemin kombëtar të menaxhimit të mbetjeve.

Në zbatim të VKM-së nr. 428, datë 8.6.2016, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore, për hartën digjitale të venddepozitimeve të mbetjeve urbane”, po hartohet një hartë GIS, e cila pritët të miratohet, krijuar me informacione që reflektojnë situatën aktuale të venddepozitimeve të mbetjeve urbane, si dhe zhvillime të tjera në terren.

Janë zhvilluar fushata ndërgjegjësimi për reduktimin deri në mospërdorimin e qeseve të holla plastike dhe përdorimin e çantave prej cope. Janë ndërmarrë masa për reduktimin e plastikës, qeseve plastike, nëpërmjet vendosjes së kritereve të miratuara me vendim nr. 232, datë 26.4.2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 177, datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”.

Pas një analizimi të imtësishëm të mangësive, sfidave apo dhe progresit në fushën e menaxhimit të mbetjeve, në fund të muajit shtator 2020, u përgatit me mbështetjen e projektit SANE 27, një

plan veprimi në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Plani është përgatitur për të gjithë direktivat dhe rregulloret e BE-së për nënkapitullin e mbetjeve. Në përmbajtje të saj jepet një përshkrim i detajuar i situatës aktuale, transpozimi dhe zbatimi i detyrave për t'u kryer në periudhën afatshkurtër (2021–2023) dhe afatmesme (2024–2027), si dhe një vlerësim i burimeve financiare dhe njerëzore për të kryer detyrat. Në këtë plan janë përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të përfshira, si dhe afatet për zbatimin e direktivave të përgatitura.

Nisur nga identifikimi i venddepozitimeve në të gjithë vendin, ka filluar dhe rehabilitimi/mbyllja e tyre. Rehabilitimi i venddepozitimeve ka filluar për venddepozitim në bashkinë Berat, Urë Vajgurore dhe Kuçovë, më mbështetjen e projektit zviceran SECO, ndërsa mbyllja e venddepozitimit të Porto-Romanos dhe kthimi i tij në një ekopark është i financuar me buxhet të shtetit. Një varg trajnimesh është kryer për të vënë në zbatim të plotë VKM nr. 319/2018 lidhur me përlogaritjen e kostos dhe tarifës që nevojiten për menaxhimin e mbetjeve në një Njësi të Qeverisjes Vendore. Fillimisht trajnimet u kryen me prezencë të përfaqësuesve të bashkive e më pas, për shkak të fillimit të situatës së pandemisë, trajnimet janë zhvilluar *online* përmes platofrmave të ndryshme: skype, webex, zoom.

Përgatitja e një drafti për të ngritur sistemin e Përgjegjësisë të Zgjeruara të Prodhuesve ka filluar me mbështetjen e programit suedez SIDA. Nisur nga përgatitjet e Shqipërisë për negociatat me BE-në është thelbësore jo vetëm transpozimi i direktivave/rregulloreve të BE-së, por edhe zhvillimi i praktikave më të mira për zbatimin e sistemit të Përgjegjësisë të Zgjeruara të Prodhuesve.

Gjatë këtij viti, u përgatit dhe drafti për ndalimin e prodhimit, importimit, përdorimit të çdo lloji qeseje plastike në vend. Drafti u miratua në Këshill të Ministrave me VKM-në nr. 227, datë 12.3.2020, “Për propozimin e projektligjit, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 Për menaxhimin e integruar të mbetjeve, të ndryshuar”. Pas miratimit në Këshill të Ministrave, nevojiten diskutimet në komisione parlamentare e më pas dërgimi në parlament për miratim.

Menaxhimi i ujit

Në fushën e *menaxhimit të ujërave*, strategjia sektoriale për furnizimin me ujë dhe kanalizimeve



2020–2030 është në proces hartimi. Kjo do të integrojë një mekanizëm të qartë dhe operacional për qëndrueshmërinë financiare të sektorit.

Është miratuar udhëzimi i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 2, datë 2.4.2019, “Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat e shpërndarjes dhe përdorimit të subvencioneve shtetërore për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujit dhe kanalizimeve”, të ndryshuar nga udhëzimi i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 6, datë 14.10.2019, “Për një shtesë dhe ndryshim në udhëzimin nr. 2, datë 2.4.2019, “Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat e shpërndarjes dhe përdorimit të subvencioneve shtetërore për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujit dhe kanalizimeve”.

Në shkurt 2020, Këshilli Kombëtar i Ujit miratoi planet e menaxhimit të basenit lumor Drini- Buna dhe Seman dhe filloi procedurën për miratimin e tyre nga Këshilli i Ministrave. Shqipëria duhet të procedojë me përfundimin dhe miratimin e planeve të mbetura të menaxhimit të baseneve lumore, duke përfshirë konsultimet ndërkuftare. Rrjeti i monitorimit dhe raportimit të cilësisë së ujit dhe sistemi i licencimit duhet të përmirësohen më tej dhe të harmonizohen me kërkesat e *acquis*.

Cilësia e ajrit

Strategjia Kombëtare e Cilësisë së Ajrit e miratuar në shtator 2014, u pasua me miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 412, datë 19.6.2019, “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”. Plani Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit përfshin masa afatshkurtra të dedikuara për fushat e transportit, eficiencën e energjisë, zhvillimin urban etj., dhe masa afatmesme të përqendruara në sektorin e bujqësisë.

Përmirësimi i cilësisë së ajrit përbën një nga prioritetet mjedisore të Programit të Qeverisë 2017–2021. Në këtë këndvështrim, miratimi i planit kombëtar për cilësinë e ajrit në datë 19.6.2019, Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 412/2019, përmbushi një nga prioritetet e MTM-së në këtë fushë, për vitin 2019, në përputhje me kuadrin e përgjithshëm ligjor të BE-së, për fushën e Cilësisë së Ajrit, të përafruar në legjislacionin kombëtar. Plani Kombëtar ka si qëllim të zbatojë Strategjinë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit të Mjedisit dhe dispozitat e ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”.

Faqe | 4220

Është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 162, datë 19.2.2020, “Për rregullat për përgatitjen, miratimin, rivlerësimin dhe zbatimin e programeve kombëtare për uljen e emetimeve në ajër”, e cila ka transpozuar pjesërisht direktivën e BE-së nr. 2016/2284 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 14 dhjetor 2016 mbi pakësimin e shkarkimeve kombëtare të disa ndotësve atmosferikë, që amendon direktivën 2003/35/KE dhe që shfuqizon direktivën 2001/81/EC, botuar në Fletoren Zyrtare L 344/1, 17.12.2016; CELEX:32016L2284. Për të siguruar zbatimin e VKM-së 162/2020, është e nevojshme ngritja e kapaciteteve teknike të institucioneve përgjegjëse, si dhe përgatitja e miratimi i akteve nënligjore të parashikuara në të.

Në zbatim të VKM-së nr. 147, datë 21.3.2007, “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel”, si dhe të VKM-së nr. 429, datë 26.6.2019, “Për cilësinë e disa lëndëve të djegëshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor), është miratuar udhëzimi i përbashkët i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, nr. 6529/2, datë 6.10.2020, “Për mbledhjen, ruajtjen, marrjen e mostrave dhe raportimin e të dhënave për cilësinë e benzinës, diezelit, gazit të lëngët të naftës (gln), lëndëve djegëse të lëngëta të mesme-rënda, lëndëve djegëse të lëngëta të rënda, lëndëve djegëse të lëngëta detare dhe furnizuesit e këtyre lëndëve djegëse të lëngëta”, i cili transpozon pjesërisht vendimin zbatues të Komisionit (EU) 2015/253 të datës 16 shkurt 2015 mbi përcaktimin e rregullave për marrjen e mostrës dhe raportimit në kuadër të direktivës së Këshillit 1999/32/EC lidhur me përmbajtjen e squfurit në lëndët djegëse detare dhe vendimin e Komisionit 2002/159/KE, 18 Shkurt 2002, për një format të përbashkët për dorëzimin e përmbledhjeve të dhënave kombëtare mbi cilësinë e lëndëve djegëse.

Ndryshimet klimatike

Qeveria shqiptare ka shprehur një vullnet dhe angazhim të qartë politik për të përmbushur kërkesat dhe detyrimet e ngulitura në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe protokollet dhe dokumentet e tjera të ndërlidhura duke ndërmarrë hapat e mëposhtëm.

Shqipëria ka ndërmarrë hapa shumë të rëndësishëm drejt dokumenteve të politikave dhe



planeve të veprimit për ndryshimet klimatike, duke përfshirë veçanërisht sektorët e energjisë dhe transportit, por edhe bujqësinë, pyjet, menaxhimin e mbetjeve etj.

Është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 466, datë 3.7.2019, “Për miratimin e dokumentit strategjik dhe planeve kombëtare për zbutjen e gazrave serë dhe për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike”, duke përfaqësuar një strategji të përgjithshme ndërsektoriale me objektiva politike dhe veprime konkrete lidhur me:

- uljen e emetimeve të GES;
- fleksibilitetin ndaj ndryshimeve klimatike.

Me miratimin e këtij akti ligjor, Qeveria e Shqipërisë u bë vendi i parë në Ballkanin Perëndimor me një Strategji të miratuar lidhur me Ndryshimet Klimatike dhe Planet e Veprimit për Zbutjen dhe Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike.

U miratua vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 17.7.2019, “Për propozimin e projektligjit”, “Për ndryshimet klimatike”. Më 17 shtator 2019 Komisioni Parlamentar i Integritimit Evropian dhe Komisioni i Sigurisë Kombëtare, pasi shqyrtuan draftin ligji në parim, nen për nen dhe në tërësinë e tij, e miratoi atë me shumicë votash dhe vendosi ta kalojë atë në seancë plenare për miratim. Miratimi i projektligjit është shtyrë për shkak të tërmetit në nëntor 2019 dhe pandemisë COVID-19 në pranverën e vitit 2020.

Në përputhje me përpjekjet e BE-së për ndryshimet klimatike dhe detyrimet tona përkatëse në procesin e pranimit në BE, një legjislacion kuadër për “Ndryshimet Klimatike” do të miratohet brenda vitit 2020, i cili merr në konsideratë gjithashtu edhe sistemin MRV mbi ndryshimet klimatike (monitorimi, raportimi dhe verifikimi).

Nga ana tjetër, vendi së fundmi miratoi Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2018–2030 (korrik 2018) si dokumenti kryesor i politikës së energjisë që përfshin ndryshimet klimatike. Kuadri i ri strategjik bazohet në dy shtylla kryesore: i. zhvillimi i reformave për të nxitur liberalizimin e tregut dhe integrimin rajonal, dhe ii. investime të mëdha në zhvillimin e qëndrueshëm të nxitur nga pjesëmarrja në iniciativën e Komunitetit të Energjisë dhe në veçanti në nivelin ndërkombëtar nga marrëveshja e Parisit për ndryshimet klimatike. Për më tepër, Strategjia parashikon përgatitjen e

Planit Kombëtar të Integruar të Energjisë dhe Klimës, si një angazhim i Republikës së Shqipërisë në Takimin Ministror të Komunitetit të Energjisë, puna përgatitore e së cilës ka filluar të sigurojë objektivat kombëtarë përtej vitit 2020 dhe në përputhje me Agjendën e BE-së e vitit 2030:

Shqipëria ka filluar punën e nevojshme përgatitore për politikën, aspektet analitike dhe teknike të planeve.

Parlamenti shqiptar miratoi ligjin nr. 116/2020, për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Amendamentin e Dohas të Protokollit të Kiotos të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike. Shqipëria renditet së bashku me vendet që kanë ratifikuar amendamentin e Doha që përcakton periudhën e dytë të angazhimit të Protokollit të Kiotos 2013–2020, ka marrë numrin e duhur të ratifikimeve për të hyrë në fuqi... Amendamenti synon zvogëlimin e emetimeve të gazeve serrë (GHG) me 18% krahasuar me nivelet e vitit 1990 për vendet pjesëmarrëse.

Hyryra në fuqi e Amendamentit të Dohas është një pjesë e vlefshme e veprimit të klimës globale para vitit 2020. Ai gjithashtu përfaqëson një sinjal të vlefshëm të një angazhimi të unifikuar, shumëpalësh për të ndërmarrë veprime për ndryshimet klimatike.

Shqipëria ka ratifikuar Amendamentin e Kigalit të Protokollit të Montrealit dhe synon të zvogëlojë përdorimin e hidrofluorokarbureve (HFCs), gazeve të fuqishme serre të përdorura kryesisht në ftohje, kondicionim të ajrit dhe pajisjet e pompave të nxehtësisë, të cilat janë mijëra herë më të dëmshme për klimën sesa CO₂. Amendamenti i Kigalit, i cili hyri në fuqi në janar 2019, ndryshon Protokollin e Montrealit për Substancat që hollojnë Shtresën e Ozonit për të përfshirë substanca - përfshirë hidrofluorokarburet (HFC) - të cilat nuk dëmtojnë shtresën e ozonit, por dihet se kanë potencial të lartë të ngrohjes globale. Ratifikimi i Kigalit nga Republika e Shqipërisë tregon se vendi është i angazhuar në mënyrë proaktive për të adresuar problemet në të ardhmen duke parandaluar një rritje të përdorimit të HFC-së dhe duke promovuar përdorimin e alternativave miqësore me klimën.

Mbrojtja e natyrës

Janë përgatitur dhe janë në proces miratimi dy draftvendime të KM-së, konkretisht:



- draftvendimi i KM-së, “Për të ardhurat e gjeneruara nga tarifat, masat dhe kriteret e përdorimit të tyre; si dhe

- draftvendimi i KM-së, “Për masën e fondit të veçantë për zonat e mbrojtura mjedisore, për burimet e krijimit dhe rregullat e përdorimit të tij”.

Me urdhër të Këshillit të Ministrave nr. 26, datë 3.2.2020, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura”, ka një rritje të stafit të punonjësve, që nënkupton dhe rritje të buxhetit, lidhur me fondin e pagave.

Është firmosur marrëveshja e grantit midis qeverisë suedeze dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për fillimin e projektit “Ngritja e rrjetit Natura 2000”, i cili gjatë zbatimit të tij do të sigurojë transpozimin e plotë të Direktivës së Habitave dhe Shpendëve. Njëkohësisht do të zhvillohet legjislacioni i nevojshëm primar dhe sekondar për përputhshmërinë e plotë me këto direktiva. Gjithashtu do të fuqizohen kapacitetet institucionale, lidhur me monitorimin dhe zbatimin, si dhe do të përgatitet një plan institucional zhvillimi, duke marrë në konsideratë një plan gradual për rritjen e kompetencave dhe numrit të stafit si dhe planifikimin e buxhetit dhe shpenzimeve.

Raportet për krimin mjedisor janë rritur në gjashtë muajt e fundit, veçanërisht në shpyllëzimet, prerjet, zjarrvëniet, gjuetinë dhe shitjen e botës së egër dhe specieve të mbrojtura, nxjerrjen e zhavorrit nga shtretërit e lumenjve, hedhjen e mbetjeve në lumenj.

Shqipëria duhet të sigurojë zbatimin e ligjeve në lidhje me shpyllëzimet, ndjekjen penale të shkelësve dhe zjarrvënësve. Raportet e krimit mjedisor janë rritur në gjashtë muajt e fundit, veçanërisht në shpyllëzimet, prerjet, zjarrvëniet, gjuetinë dhe shitjen e botës së egër dhe specieve të mbrojtura, nxjerrjen e zhavorrit nga shtretërit e lumenjve, hedhjen e mbeturinave në lumenj. Ende nuk ka asnjë informacion mjedisor nga inspektimet dhe monitorimet e HEC-eve aktuale.

Kontrolli nga ndotja industriale

Në fushën e *kontrollit të ndotjes industriale*, transpozimi i Direktivës së Emetimeve Industriale mendohet të jetë rreth 70%, nëpërmjet miratimit të disa akteve ligjore.

Kimikatet

Për sa u përket *kimikateve*, janë ndërmarrë disa hapa pozitivë lidhur me transpozimin në legjislacionin kombëtar të Rregullores REACH NR.1907/2006, i cili ka avancuar më tej me miratimin e:

1. Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 319, datë 15.5.2019, “Për prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e disa kimikateve dhe artikujve të caktuar të rrezikshëm”;

2. Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 9, datë 9.1.2019, “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”;

Në vijim të miratimit nga Parlamenti Shqiptar të ligjit nr. 7/2020, “Për ratifikimin e Konventës së Minamatës, “Për merkurin”, prej datës 26 maj 2020, Shqipëria listohet përkrah shteteve që kanë ratifikuar Konventën e Minamatës për Merkurin, duke kontribuar kështu në mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga efektet negative të merkurit. Është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 442, datë 26.6.2019, “Për miratimin e rregullave të ndalimit të eksportit të merkurit metalik, komponimeve dhe përzierjeve të caktuara të merkurit, ruajtjes së sigurt të merkurit metalik dhe të kriterëve specifike të ruajtjes së merkurit metalik të konsideruar si mbetje”, i cili ka transpozuar pjesërisht Rregulloren (EU) 2017/852 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 17 maj 2017 mbi merkurin, që shfuqizon Rregulloren (EC) nr. 1102/2008, CELEX: 32017R0852. VKM 442/2019, ka hyrë në fuqi prej datës 1 janar 2020, dhe synon zbatimin e Konventës së Minamatës për Merkurin.

Është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 161, datë 19.2.2020, “Për miratimin e rregullave të nevojshme për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti”, i cili ka transpozuar pjesërisht direktivën e Këshillit 87/217/EEC datë 19 mars 1987, Për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti e amenduar.

Me miratimin e urdhrat të Kryeministrit nr. 23, datë 3.2.2020, “Mbi miratimin e strukturës dhe organizimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, është **ngritur Zyra e Kimikateve**, si detyrim që rrjedh nga ligji 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, dhe si një element kyç i cili do të sigurojë zbatimin



e legjislacionit në këtë fushë. Krijimi i Zyrës së Kimikateve, me një strukturë të parashikuar prej 4 personash (1 përgjegjës sektori+3 specialistë) ka rritur numrin e kapaciteteve administrative dedikuar menaxhimit të kimikateve. Prej Korrikut 2020 e deri në nëntor 2020, Zyra e Kimikateve është plotësuar me 3 persona.

Mbrojtja nga zhurmat

Autoritetet përkatëse janë duke identifikuar zonat në vend, për të hartuar një hartë digjitale të zhurrmave.

Mbrojtja civile

Më 18.7.2019, Parlamenti shqiptar miratoi ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, i cili shndërron Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Ky ligj është përafuar pjesërisht me disa direktiva të Bashkimit Evropian. Nëpërmjet këtij ligji është krijuar Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

Ligji i ri krijon kushtet për anëtarësimin e Shqipërisë në të ardhmen në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Unionit. Aktualisht, po punohet për hartimin dhe miratimin e akteve të reja nënligjore në zbatim të ligjit.

Struktura dhe organika e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile është miratuar nga Kryeministri me urdhrin nr. 27, datë 3.2.2020.

Agjencia është në procese të ndryshme bashkëpunuese me partnerët dhe strukturat homologe, si dhe është në procedura zbatuese të projekteve të ndryshme të financuara nga organizata ndërkombëtare, të cilat po ndihmojnë në funksionimin e agjencisë, ngritjen e kapaciteteve, infrastrukturave dhe sistemeve, si dhe për anëtarësimin në të ardhmen në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile Evropiane (UCPM).

Me mbështetjen e UNDP pritet të fillojë puna sa më shpejt për hartimin e Strategjisë Kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe Planit Kombëtar për emergjencat civile.

27.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Në zbatim të urdhrin të Kryeministrit nr. 94, datë 20.5.2019, “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian”, institucioni lider për Kapitullin 27 “Mjedisi dhe ndryshimet klimatike”, është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Ministrinë e linjës dhe agjencitë e pavarura, pjesë e këtij kapitulli janë si më poshtë:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE);
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE);
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS);
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR);
- Ministria e Mbrojtjes (MM);
- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT);
- Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU);
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM);
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM);
- Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT);
- Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB);
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN);
- Instituti i Shëndetit Publik (ISHP);
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU);
- Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASHIGJ);
- Instituti i Statistikave (INSTAT);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD);
- Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV);
- Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI);
- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT).

27.7 Prioritetet

Legjislacionit horizontal

Për sa i përket mjedisit, në fushën e *legjislacionit horizontal*, disa nga prioritetet kryesore kanë të bëjnë me:

- zbatimin e legjislacionit kombëtar që ka transpozuar direktivën 2001/42/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 27 qershor 2001 “Mbi vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private në mjedis” dhe direktivën e VNM-së (2011/92/BE) “Mbi vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private në mjedis”, amenduar me direktivën 2014/52/BE, si dhe transpozimi i plotë i direktivës 2014/52/BE;
- forcimin e zbatimit të legjislacionit mjedisor.

Nevojitet një pjesëmarrje më efektive e publikut për konsultime në procesin e vendimmarrjes, veçanërisht në nivelin lokal. Progres i mtejshëm është i nevojshëm për të arritur plotësisht



përafrimin dhe zbatimin e direktivave për përgjegjësinë mjedisore, krimin mjedisor dhe inspektimin mjedisor.

Shqipëria duhet të miratojë Strategjinë Kombëtare për Ujësjellës-Kanalizimet 2019–2030 dhe aktet përkatëse të saj, planet e menaxhimit të baseneve ujore dhe të sigurojë kapacitetet dhe burimet e duhura administrative për agjencitë përgjegjëse.

Zhvillimi i kornizës institucionale me theks të veçantë në procesin e pjesëmarrjes së publikut, veçanërisht në sektorët e hidrocentraleve, ndërtimeve dhe minierave.

Nevojitet sigurimi i një buxheti të përshtatshëm, forcimi i kapaciteteve të monitorimit dhe raportimit të agjencisë së mjedisit.

Cilësia e ajrit

Prioritet në fushën e cilësisë së ajrit për vitin 2021 dhe në vijim është forcimi bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse me qëllim zbatimin e planit kombëtar të cilësisë së ajrit, përmirësimi i rrjetit të monitorimit, sigurimi i burimeve për funksionimin e monitorimit të vazhdueshëm, rritja e kapaciteteve teknike në MTM dhe AKM lidhur me detyrimet që rrjedhin nga Konventa e CLRTAP, zbatimin e VKM 162/2020; sigurimi i aksesit të publikut në internet në të dhënat e cilësisë së ajrit dhe të përgatitjes plane të cilësisë së ajrit për aglomeratat kryesore.

Menaxhimi i mbetjeve

Mbyllja e venddepozitimeve të shumta jashtë standardeve, mbetet një sfidë. Ndarja në burim e rrymave të mbetjeve dhe instrumenteve ekonomike për të promovuar riciklimin dhe ripërdorimin dhe për të parandaluar gjenerimin e mbetjeve mbeten të kufizuara.

Mbrojtja e natyrës

Në fushën e *mbrojtjes së natyrës*, do të punohet për të garantuar:

- Identifikimin, studimin dhe plotësimin e formave standarde të propozimit për çdo zonë potenciale Natura 2000 për Shqipërinë;
- Menaxhimin e integruar të zonave të mbrojtura;
- Masat për zbatimin e moratoriumit të gjuetisë dhe pyjeve;
- Forcimin e kapaciteteve të të gjithë strukturave që mbulojnë fushën e mbrojtjes së natyrës në nivel qendror dhe lokal.

Në fushën e *pyjeve*, prioritetet e MTM-së kanë të bëjnë me:

- Përafrimin e plotë të legjislacionit kombëtar me atë të BE-së në këtë fushë, si dhe hartimin e akteve nënligjore që dalin nga ligji për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave në Republikën e Shqipërisë;
- Regjistrimin e fondit pyjor dhe kullësor kombëtar në sistemin kadastral të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet krijimit të Inventarit Kombëtar të Pyjeve, si dhe;
- Pyllëzimin e sipërfaqeve të degraduara nëpërmjet riciklimit në destinacion të të ardhurave nga fondi pyjor dhe detyrimeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor.

Në këtë kuadër, dokumenti politik i miratuar për mbrojtjen e pyjeve në Republikën e Shqipërisë, parashikon themelimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, e cila do të ketë si mision qeverisjen e mirë të pyjeve, ruajtjen dhe zhvillimin e tyre, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve pyjore shumëfunksionale si burime natyrore me rëndësi kombëtare, që të realizohet:

- sigurimi i performancës në sektorin e pyjeve;
- vlerësimi i gjendjes së pyjeve;
- të organizojë punën për inventarizim dhe hulumtime në fushën e pyjeve;
- organizimi i punës dhe hartimi i dokumenteve për menaxhimin e pyjeve;
- organizimi i punës për monitorimin dhe kontrollin e pyjeve.

Kimikateve

Në fushën e *kimikateve*, prioritetet e MTM-së për vitin 2021 e në vijim, kanë të bëjnë me:

- suportin për zbatimin e projektit “Mbështetje për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për Përmirësimin e Menaxhimit të Kimikateve” dhe planin vjetor të punës të projektit;
- mbështetjen teknike të Zyrës së Kimikateve, me qëllim mirëfunksionimin e saj dhe sigurimin e zbatimit të legjislacionit të kimikateve;
- bashkëpunimin ndërinstitucional, me qëllim përmbushjen e detyrimeve nga legjislacioni në fuqi në fushën e kimikateve dhe marrëveshjet ndërkombëtare në këtë fushë.

Kontrolli nga ndotja industriale

Për sa i përket fushës së *Kontrollit nga ndotja industriale* një nga prioritetet kryesore është përafrimi i plotë i legjislacionit kombëtar me direktivën 2010/75/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 24 nëntor 2010, për emetimet



industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes), si dhe me direktivën 2012/18/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 4 korrik 2012, “Për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që përfshijnë substanca të rrezikshme”, ndryshimi dhe më pas shfuqizimi i direktivës së Këshillit 96/82/EC.

Mbrojtja nga zhurmat

Për sa u përket *politikave për zhurmën në mjedis*, një nga prioritetet kryesore të MTM-së për vitin 2020 në këtë fushë është një hartë e zhurrmave, vlerësimi i situatës lidhur me zbatimin e kërkesave ligjore për menaxhimin e zhurrmave në mjedis dhe forcimi i zbatimit të legjislacionit në këtë fushë; përmbushja e detyrimit ligjor nga njësitë e qeverisjes vendore për hartimin e planeve lokale të veprimit për zhurmat, në zbatim të udhëzimit të ministrit të MTM, nr. 1. datë 19.2.2018; forcimi i zbatimit të vendimeve të task-forcës së ngritur për ndotjen akustike në qendrat urbane dhe zonat turistike bregdetare.

Ndryshimet klimatike

Për sa u përket ndryshimeve klimatike, Shqipëria ka treguar angazhim të vazhdueshëm për të zvogëluar emetimet e gazeve me efekt serrë nga sektorët ekonomikë, por edhe për të rritur rezervuarët e GES-së përmes politikave ambicioze të mbjelljes së pyjeve.

Pas Marrëveshjes së Parisit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit synon të rishikojë Kontributin e saj të Përcaktuar Kombëtar deri në fund të vitit 2020 si pjesë e angazhimeve të saj nën agjendën kombëtare të klimës dhe zbatimin e objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Dokumenti i rishikuar i NDC:

- do të mbulojë gaze të tjerë përveç CO₂ (d.m.th. CH₄, N₂O, gazet F), që nuk janë përfshirë në NDC-në e parë, por janë të mbuluara në komunikimin e Tretë Kombëtar, edhe pse kanë pasiguri të mëdha;

- do të mbulojë të gjithë sektorët e shkarkimeve: Energjinë; Proceset industriale; Bujqësia, LULUCF dhe mbetjet. INDC mbulonte vetëm proceset energjetike dhe industriale;

- do të konsiderojë përmirësimet më të fundit metodologjike të ekipit lokal të ngarkuar me inventarin kombëtar, Komunikimin e tretë Kombëtar dhe Komunikimin e ardhshëm të katërt Kombëtar. Në veçanti, do të diskutohen çështjet e

pasigurisë të ngritura gjatë procesit të komunikimit të Tretë Kombëtar;

- do të shqyrtojë mënyrat e mundshme për rritjen e ambicies së vendit për klimën, në përputhje me kornizën e marrëveshjes së Parisit dhe nevojën e një ngritjeje kolektive të premtimeve lidhur me klimën për të arritur qëllimin e kufizimit të ngrohjes globale në + 2° C dhe madje + 1,5° C;

- do të përfshijë masat e adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike dhe qëllimin për të integruar adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike në strategjitë dhe zhvillimet sektoriale përkatëse;

- do të pasqyrojë specifikat e Shqipërisë: përdorimi i burimeve të rinovueshme për prodhimin e energjisë elektrike (95% nga burimet hidro, që do të thotë emisione të ulëta për energjinë, por një ndjeshmëri e lartë ndaj ndryshimeve klimatike), kërkesa për dru zjarri, nevoja për krijimin e një regjistri për mbetjet që gjenerohen nga aktivitetet industriale dhe joshhtëpiake, mungesa e sistemit të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, mungesa e kadastrës për një monitorim të saktë kombëtar të ndryshimeve të përdorimit të tokës, përqendrimi i popullsisë, infrastruktura dhe aktivitetet turistike përgjatë bregdetit.

Përmes dokumentit të rishikuar, Republika e Shqipërisë synon të forcojë NDC-në, të rrisë ambiciet për emisione të ulëta, si dhe zbatimin e shpejtë të NDC-së.

Si një Palë jo e aneksit I të UNFCCC (që nga viti 1995), deri më tani Shqipëria ka përgatitur tri komunikime kombëtare (përkatësisht më 2002, 2009 dhe 2016) dhe aktualisht po përgatit komunikimin e katërt kombëtar dhe përditësimin e parë dyvjeçar, që do të dorëzohet brenda 2021.

Ratifikimi i Amandamentit të Kigalit, të Protokollit të Montrealit, i hap rrugën Shqipërisë për të vendosur bazën e saj për HFC-të, për të ngrirë sasinë e saj të konsumit dhe për të vendosur një plan për fazën e uljes së HFC-ve. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit po harton projekt- ligjin, “Për gazet e fluorinuara” që do të transpozojë pjesërisht Rregulloren (BE) nr. 517/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 16 Prillit 2014 mbi gazet me efekt serrë dhe shfuqizon Rregulloren (KE) Nr. 842/2006.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit po punojnë



ngushtë dhe bashkëpunojnë për hartimin e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (NECP).

Përgatitja e NECP-ve do t'i mundësojë vendit të planifikojë në një mënyrë të integruar, objektivat që ka në fushën e klimës me objektivat energjetikë, synimet, politikat dhe masat dhe përafrimin e politikave energjetike shqiptare me ato të BE-së. NECP, pas finalizimit do të zvogëlojnë barrën administrative, do të sigurojnë koherencë më të madhe dhe do të sigurojnë parashikueshmëri afatgjatë për investime.

Puna përgatitore për aspektet analitike dhe teknike të planeve tashmë ka filluar dhe NECP pritet të miratohet brenda vitit 2021.

Sa u përket *organizmave të modifikuar gjenetikisht*, si një fushë ndërtematike, në kuadër të zbatimit të Protokollit të Kartagjenës për Biosigurinë të Konventës së Biodiversitetit (CBD) kërkohet kontributi i të gjithë aktorëve kryesorë të përcaktuar dhe bashkërendimin e punës ndërmjet tyre.

Mbrojtja civile

Për sa i përket mbrojtjes civile prioritetet për vitin 2021 e në vazhdim janë:

- hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e ligjit të ri për mbrojtjen civile;
- konsolidimi i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me plotësimin dhe funksionimin e plotë me kapacitetet njerëzore, logjistike dhe infrastrukturore;

- zbatimi i detyrimeve të ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile" për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Reduktimin e Riskut ndaj Fatkeqësive, strategjive vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë; vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë në të tria nivelet, në nivel qendror, qarku dhe vendor; Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, planit të emergjencave civile në nivel qarku dhe në nivel vendor;

- bashkëpunimi ndërinstitucional në nivel kombëtar për implementimin e politikave të zvogëlimin të riskut nga fatkeqësitë dhe të mbrojtjes civile, referuar ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", dhe akteve të tjera nënligjore.

- përmirësimi i kapaciteteve, infrastrukturës dhe sistemeve për paralajmërimin e hershëm, parandalimin, gatishmërinë dhe përgjigjen ndaj fatkeqësive.

- anëtarësimi në mekanizmin e mbrojtjes civile evropiane.

KAPITULLI 28 MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE SHËNDETIT

28.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli 28 për pjesën e mbrojtjes së konsumatorit, mbulon mbrojtjen e interesit publik për çështje të sigurisë së produkteve dhe interesave ekonomikë të konsumatorëve, për aspekte të lidhura me politikën, legjislacionin dhe zbatimin e tij etj.

Pjesa e shëndetit, përfshin standardet për kontrollin e duhanit, gjakut, indeve, qelizave dhe organeve si dhe barnave për përdorim njerëzor dhe veterinar. Gjithashtu, këtu përfshihen shëndeti mendor, parandalimi i abuzimit me drogën, pabarazia shëndetësore, ushqyerja, reduktimi i dëmeve të lidhura me alkoolin, shfaqja e kancerit, mjedise të shëndetshme duke përfshirë parandalimin e lëndimeve, promovimin e sigurisë, plakjen aktive dhe të shëndetshme si dhe veprimin evropian në fushën e sëmundjeve të rralla.

28.2 Struktura e kapitullit

Kapitulli 28 është i ndarë në dy nënkapituj:

- Mbrojtja e konsumatorit;
- Mbrojtja e shëndetit

28.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Angazhimet në fushën e mbrojtjes së konsumatorit janë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga nenet 70 dhe 76 të Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit, si dhe të dispozitave përkatëse të *acquis* të BE-së.

Detyrimi për të përafruar ligjin shqiptar me atë të Bashkimit Evropian buron nga neni 70 i MSA-së dhe Kriteret e Kopenhagës.

Marrëveshja e Stabilizim-asociimit përmban gjithashtu një dispozitë të përshtatur që merret me mbrojtjen e konsumatorit. Neni 76 i MSA-së kërkon që Shqipëria të sigurojë një politikë të mbrojtjes aktive të konsumatorit; të harmonizojë legjislacionin dhe të sigurojë mbrojtje efikase ligjore të konsumatorëve.

Acquis për mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit përfshin masat rregullatore, rekomandimet për Shtetet Anëtare, koordinimin dhe mbështetjen e aktiviteteve të Shteteve Anëtare duke përfshirë mbështetjen financiare. Shtetet Anëtare duhet të transpozojnë *acquis* në legjislacionin kombëtar dhe të krijojnë struktura të



përshtatshme administrative të cilat lejojnë mbikëqyrje efektive të tregut dhe zbatimin e *acquis*. Duhet të sigurohen gjithashtu mekanizma të përshtatshëm gjyqësorë edhe jashtë gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, si dhe informimin dhe edukimin e konsumatorit dhe një rol për organizatat e konsumatorit.

Acquis për mbrojtjen e konsumatorit përbëhet nga legjislacioni për sigurinë e produkteve dhe Sistemin e Alarmit të Bashkimit Evropian (RAPEX), imitimet e rrezikshme, përgjegjësinë për produktet me defekte, bashkëpunimin ndërkufitar të zbatimit, dëmshpërblimin e konsumatorit, shitjen e mallrave të konsumit dhe garancitë përkatëse, kushtet e padrejta të kontratave, treguesit e çmimeve, të drejtat e konsumatorit, kredia konsumatore, praktikat e padrejta tregtare etj.

Për sa i përket shëndetit publik, *acquis* përbëhet nga masat që lidhen me kontrollin e duhanit, kërcënimet serioze për shëndetin ndërkufitar, duke përfshirë sëmundjet ngjitëse, gjakun, indet, qelizat dhe organet, të drejtat e pacientëve në kujdesin shëndetësor ndërkufitar, produktet medicinale dhe kozmetikë, pajisjet medicinale etj.

Për sa i takon **gjakut** *acquis* përbëhet nga masat që lidhen me forcimin e kapaciteteve për implementimin e legjislacionit EU përcaktimin dhe forcimin e kapaciteteve të autoriteteve kompetente pavarura për autorizimin, licencimin, akreditimin, inspektimin, vigjilencën dhe raportimin.

28.4 Situata aktuale në Shqipëri

Nuk ka pasur përparim në rekomandimet e vitit të kaluar (2019), megjithëse pati një progres në forcimin e efektivitetit të Komisionit për Mbrojtjen e Konsumatorit (KMK). Aktualisht, Strategjia për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2015–2020 është në fazën përfundimtare të zbatimit të saj. Kjo strategji përcakton kornizën e masave horizontale dhe sektoriale në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit, duke synuar krijimin e një mjedisi ligjor dhe institucional që garanton konsumatorin shëndetin dhe sigurinë, mbron interesat e tyre ekonomike, përmes edukimit të tyre për çështjet e mbrojtjes së konsumatorit. Masat konsistojnë në akte ligjore dhe forcim institucional, si dhe në rritjen e ndërgjegjësimit të konsumatorëve. Gjatë periudhës së zbatimit të strategjisë janë hartuar dy raporte monitorimi, përfshirë këtu edhe raportin në kuadër të monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit

dhe Integritet, i hartuar me kontributin e institucioneve pjesëmarrëse. Një raport i plotë monitorimi mbi zbatimin e strategjisë, që do të përfshijë vlerësimin e të gjithë aktiviteteve, të parashikuara në planin e veprimit, do të kryhet në përfundim të zbatimit të saj.

Sa u përket çështjeve që nuk lidhen me sigurinë, ligji horizontal 9902/2008, “Për mbrojtjen e konsumatorit”, i ndryshuar, është i përafëruar gjerësisht me direktivat kryesore në këtë fushë, siç janë Direktiva mbi kushtet e padrejta të kontratave, direktiva e shitjes së mallrave dhe garancive, Direktiva e mbi publicitetet çorientues dhe krahasues, direktiva e praktikave të padrejta tregtare, direktiva e kredisë së konsumatorit etj. Ndryshimi më i fundit i këtij ligji të miratuar në tetor 2018 (Ligji 71/2018), ka rritur më tej shkallën e përafrimit duke e harmonizuar pjesërisht me Direktivën 2011/83 për të drejtat e konsumatorit dhe direktivën 2013/11 mbi zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve (ADR). Parimet themelore të disa çështjeve të tjera të lidhura me konsumatorin janë të rregulluara me ligjin 9902/2008, dhe më tej janë përpunuar me legjislacionin sekondar, siç janë kontratat në largësi të shërbimeve financiare, paketat e udhëtimit etj.

Sa u përket shërbimeve financiare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 27, datë 4.4.2018, miratoi disa ndryshime në Rregulloren nr. 48, datë 1.7.2015, “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”. Ndryshimet hyrën në fuqi më datë 1 qershor 2018. Këto ndryshime synojnë një harmonizim më të lartë me kërkesat e Direktivës së Bashkimit Evropian 2014/17/BE, “Për marrëveshjet e kredisë për konsumatorët në lidhje me pasuritë e paluajtshme rezidenciale, që rregullojnë marrëveshjet e kredisë konsumatore dhe të kredisë hipotekore për individët me qëllim rritjen e kërkesave të mbrojtjes së konsumatorit”.

Sa i përket Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Bordi i AMF-së ka miratuar një strategji për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit 2017–2020, nëpërmjet së cilës synohet përafrimi sa më i plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Strategjia, “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje” 2017–2020, u përmbyll me realizimin e objektivave të qarta, por edhe me vetëdijen, që në bashkëpunim me të gjithë aktorët e tjerë të rëndësishëm të tregut dhe institucionet



financiare e arsimore ta kalojmë edukimin financiar në një nivel tjetër dhe me synimin për të hartuar dhe nisur zbatimin e një strategjie të dytë edukimi për Institucionin, duke marrë nga eksperiencat më të mira në mbarë botën sipas sugjerimeve të OECD-së.

Hyrja në fuqi e ligjit 52/2014, “Për sigurimin dhe risigurimin” ka mundësuar të gjithë kuadrin ligjor të nevojshëm për të mbështetur zbatimin e metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus rrezikun në tregun e sigurimeve si edhe janë rregulluar parimet themelore të disa çështjeve të tjera të lidhura me konsumatorin.

Gjatë vitit 2020, AMF-ja ka mundësuar sistemin e të dhënave të historikut të dëmeve për pronarin dhe drejtuesit e mjeteve. Gjithashtu konsumatori/investitori mund të kontrollojë në çdo kohë, nëpërmjet një kodi unik të gjeneruar nga sistemi i integruar me shoqëritë e sigurimit, statusin e trajtimit të dosjes së tij të dëmshpërblimit.

Në lidhje me zbatimin e çështjeve që nuk lidhen me sigurinë, Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorit (KMK) është organi kryesor përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve. Kapaciteti i KMK-së forcohet vazhdimisht përmes trajnimeve mbi legjislacionin e BE-së dhe praktikat e zbatimit. Aktivitetet e KMK-së drejtohen kryesisht në mbrojtjen e interesave të përgjithshëm të konsumatorëve, por njëkohësisht u jepet zgjidhje dhe ankesave individuale të konsumatorit. Komisioni është organ vendimmarrës dhe ka marre vendime në lidhje me kushtet standarde të kontratës në sektorin e shërbimeve, siç janë energjia elektrike, uji, interneti, telekomunikacioni, universitetet. Masat e dhëna nga KMK-ja kanë synuar gjetjen dhe eliminimin e kushteve të padrejta në këto kontrata. Transparenca dhe përgjegjësia e këtij organi sigurohet duke publikuar vendimet e saj dhe raportet vjetore në faqen e internetit të KMK-së. Kjo faqe interneti, që funksionon që nga viti 2015, ka rritur gjithashtu mundësinë e përdorimit të informacionit nga konsumatorët pasi përmban të gjithë legjislacionin, informacionin dhe materialet për ndërgjegjësimin e tyre, si dhe informacionin mbi aktivitetet e KMK-së. Konsumatorët mund të paraqesin ankesat e tyre edhe përmes kësaj faqe interneti.

Për sa u përket çështjeve të lidhura me sigurinë, legjislacioni shqiptar (ligji nr. 10480/2011 për Faqe| 4228

“Sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”) është përafruar gjerësisht me direktivën e Përgjithshme të Sigurisë së Produkteve 2001/95/EC. Kodi Civil shqiptar, edhe pse pjesërisht, rregullon disa aspekte të parashikuara nga direktiva 85/374/EEE mbi përgjegjësinë për produktet me defekt. Sa i përket zbatimit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT), i krijuar në vitin 2016, është institucioni përgjegjës për të siguruar që produkti i vendosur në treg është i sigurt për konsumatorët. Në çështjet që lidhen me sigurinë e produkteve, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, krijuar me VKM-në nr. 36/2016, përgjatë periudhës 2019-2020 ka vijuar të plotësoj organikën e saj dhe ka aktualisht 61 punonjës nga 80 punonjës që duhet të ketë në total në bazë të organigramës të miratuar më 1.6.2020 e cila ka pësuar një rritje nga 69 pozicione në 80 pozicione në total, 50 prej të cilëve janë inspektorë. Aktualisht, procesi i plotësimit të vendeve vakante të mbetura po vijon nëpërmjet procedurave të konkurrencës të organizuara nga Departamenti i Administratës Publike dhe pritet shumë shpejt që stafi të rritet edhe më tej. Legjislacioni kombëtar përputhet pjesërisht me *acquis* të BE-së.

Sa i përket shëndetit publik, duhet të bëhet një përparim i rëndësishëm për të zbatuar kuadrin e politikave dhe për të siguruar mbulim të kujdesit shëndetësor për të gjithë në Shqipëri. Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2016–2020 u miratua në maj 2017 dhe synon të arrijë një mbulim universal të kujdesit shëndetësor. Raportimi i të dhënave shëndetësore nga ofruesit e shërbimeve shëndetësore publike dhe private është krijuar tashmë dhe cilësia dhe mbulimi i këtyre të dhënave është përmirësuar.

Bazuar në direktivat dhe standardet e OBSH dhe synimit të përafrimit ligjor me direktivat e BE Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me INSTAT që është lider në këtë proces ka hartuar VKM nr. 135, datë 20.3.2019, “Për miratimin e Nomenklaturës së klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve, ICD-10”. Kjo VKM konsiston në implementimin e ICD-10 klasifikimit ndërkombëtar i sëmundjeve në të gjitha institucionet shëndetësore të sistemit publik dhe jopublik në shërbimin parësor dhe spitalor, Ministria e Drejtësisë-spitali i Burgjeve dhe Mjekësia Ligjore, Instituti i Sigurimeve Shoqërore



për CEMP, Ministria e Mbrojtjes – Spitali i Traumës që ka varësi të dyfishtë institucionale. Kjo nomenklature ka për qëllim zëvendësimin e ICD-IX në ICD-10, e cila ka të bëjë me kodifikimin e detajuar të diagnozave në kartelat e pacientit sipas standardeve ndërkombëtare të OBSH dhe BE.

Sa i përket **gjakut**, indeksi i dhurimit është 11,8 dhurime për 1000 banorë (të dhënat e vitit 2019) dhe 25% e tyre janë dhurime vullnetare. Gjaku i dhuruar në nivel kombëtar testohet për agjentë infektivë në një qendër të vetme në Tiranë, ndërkohë që akoma nuk është centralizuar testimi imunohematologjik dhe përpunimi i gjakut në qendrat rajonale. Legjislacioni është harmonizuar në pjesën më të madhe të tij me direktivën 2002/98/EC dhe direktivat zbatuese të saj edhe pse akoma ka nevojë për ndërhyrje specifike për një harmonizim të plotë me legjislacionin EU.

Sa u përket sëmundjeve të rralla, strategjia kombëtare e shëndetësisë është duke u zhvilluar në bashkëpunim me Bankën Botërore. Në fushën e kërcënimeve serioze ndërkufitare për shëndetin, duke përfshirë sëmundjet ngjitëse, ekziston baza ligjore për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse dhe është hartuar për të qenë në përputhje me *acquis*. Ekziston një sistem kombëtar alarmi dhe mbikëqyrjeje për sëmundjet ngjitëse. Shkalla kombëtare e mbulimit të imunizimit është 97%. Për kontrollin e duhanit është duke u zbatuar ligji për mbrojtjen e shëndetit publik kundër produkteve të duhanit, i cili është hartuar për t'u harmonizuar me *acquis*. Për parandalimin e abuzimit me drogën dhe reduktimin e dëmeve, janë zhvilluar disa aktivitete parandaluese, kryesisht të iniciuara nga Departamenti i Promovimit të Shëndetit dhe Instituti i Shëndetit Publik.

Vitet e fundit minoriteti Rom dhe Egjiptian është njohur dhe promovuar nga shteti Shqiptar dhe institucionet publike. Me qëllim minimizimin e pabarazive në fushën e shëndetësisë është miratuar Plan i Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016–2020, më 23 dhjetor të vitit 2015.

Detyrimi i prodhuesve dhe/ose importuesve të produkteve të duhanit për të informuar Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për hyrjen në treg të produkteve të reja të duhanit synon të mbajë të informuar organet përkatëse për dinamikën e hyrjes së produkteve të reja në treg, karakteristikat e

tyre dhe për efektet negative që ata kanë në popullatë. Pasja e këtij informacioni pritet të mundësojë monitorim më të mirë të zbatimit të ligjit dhe të përshtatjes së tij në të ardhmen bazuar në produktet e reja që hyjnë në vend.

Ndalimi i shitjes së paketave me numër të reduktuar cigaresh pas vitit 2021 apo me alterim të shijeve, pritet të reduktojë blerjen e këtyre produkteve nga konsumatorë që nuk e përballojnë dot çmimin e një pakete të plotë apo nga konsumatorë për të cilët shija karakteristike e duhanit është një element i pakënaqshëm i duhanpirjes dhe në mungesë të shijeve alternative do zgjidhnin të mos konsumonin produktin konvencional.

Ndalimi i promocionit të indirekt nëpërmjet ngjyrave të logos së produkteve të duhanit dhe vendosjen e tyre në raftet të dukshme bëhet në kuadër të forcimit të kontrollit për moslejimin e promocionit dhe marketimit të produkteve të duhanit si një faktor që stimulon përdorimin e tij në popullatë.

Ndalimi i përdorimit të cigares elektronike dhe duhanit me ngrohje në ambiente të mbyllura duke aplikuar për të, të njëjtat rregulla si për format konvencionale të duhanpirjes synon mbrojtjen nga ekspozimi i pavullnetshëm ndaj produkteve të duhanit.

Forcimi i masave ndëshkuese në rast moszbatimi të ligjit ka për synim të forcojë implementimin e ligjit dhe shtimin e mbrojtjes për qytetarët që ekspozohen në mënyrë të pavullnetshëm ndaj tymit të duhanit, qoftë nga produkte konvencionale qoftë nga produkte inovative.

Në kuadër të përafrimit të legjislacionit evropian mbi të drejtat e pacientëve në kujdesin shëndetësor ndërkufitar dhe në zbatim të politikave dhe strategjive të qeverisë shqiptare, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor operon përmes zbatimit të Marrëveshjeve Ndërkombëtare bilaterale (kryesisht me vende anëtare të Bashkimit Evropian) të ratifikuara si më poshtë vijnë:

- ligji nr. 9066, datë 15.5.2003, “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë për mbrojtjen shoqërore”, në fuqi;

- ligji nr. 35/2014, datë 3.4.2014, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së



Shqipërisë dhe Mbretërisë së Belgjikës për mbrojtjen shoqërore”, në fuqi;

- ligji nr. 42/2015, datë 16.4.2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut për mbrojtjen shoqërore”;

- ligji nr. 123/2015, datë 12.11.2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë për mbrojtjen shoqërore”;

- ligji nr. 151/2015, datë 21.12.2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Hungarisë për mbrojtjen shoqërore”;

- ligji nr. 23/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Mbrojtjen Shoqërore dhe të Protokollit përfundimtar të saj”;

- ligji nr. 34/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke për Mbrojtjen Shoqërore”;

- ligji nr. 42/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Rumanisë për Mbrojtjen Shoqërore”.

Në bazë të Marrëveshjeve të lartpërmendura Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor është institucioni përgjegjës për ndjekjen e procedurave administrative lidhur me lëshimin e formularëve të sigurimeve shëndetësore. Në Marrëveshje parashikohen rastet kur një person i siguruar, që ka fituar të drejtën e përfitimit në natyrë sipas legjislacionit të një prej shteteve kontraktuese fiton të drejtën e përfitimeve në natyrë në territorin e shtetit tjetër kontraktues. Në këtë rast përfitimet në natyrë jepen në emër të agjencisë kompetente (FSDKSH) nga agjencia e vendit të qëndrimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, e cila është përgjegjëse për rimbursimin e përfitimeve në natyrë sipas legjislacionit në fuqi.

Në kuadër të rekomandimeve, theksohet se ka përfunduar raundi i parë i negociatave mbi marrëveshjen bilaterale në fushën e mbrojtjes sociale me Republikën e Bullgarisë.

Programi Kombëtar i Kujdesit Shëndetësor siguron kujdes shëndetësor në vendbanime, kryesisht për grupet e marginalizuara rome dhe egjiptiane. Në kuadër të iniciativave të ndërmarra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Faqe| 4230

janë ofruar shërbime të dedikuara falas për gratë rome dhe egjiptiane për pap test, vizita falas dhe të gjitha shërbimet që u nevojiten. Qëllimi i kësaj iniciative është rritja e aksesit ndaj shërbimeve për gratë e marginalizuara që synojnë parandalimin e sëmundjeve nëpërmjet kontrolleve të hershme. Janë zhvilluar aktivitete/trajnime në fushën e ndërgjegjësimit për HIV në komunitetin Rom dhe Egjiptian. Aktivitetet/trajnimet kanë pasur qëllim që duke përfshirë edhe anëtare nga komuniteti Rom dhe Egjiptianë të rrisin informacionin mbi infeksionin HIV dhe në këtë grup popullate. Roli i këtyre aktiviteteve është i rëndësishëm për të lehtësuar komunikimin me familjarët gjatë vizitave në shtëpi.

Në lidhje me pajisjet mjekësore, është rishikuar Ligji 89/2014, “Për pajisjet mjekësore” në zbatim të rregullores evropiane për pajisjet mjekësore. Rishikimi i ligjit është bërë në vijim të procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë evropian dhe ka si qëllim rritjen e sigurisë gjatë përdorimit të pajisjeve mjekësore pas vendosjes së tyre në treg dhe rritjen e aksesit për pacientet.

28.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Sa u përket përgatitjeve për takimin bilateral në kuadër të fazës *screening*, gjatë vitit 2020 GNPIE ka vijuar punën për përmbushjen e Planit të Hapave Kyç. Si rezultat, është finalizuar Analiza e Mangësive Ligjore (*Screening List*) dhe Analiza e Mangësive Institucionale dhe Administrative. Ndonëse pjesa që i takon nënkaptullit të shëndetit publik, ka ende nevojë për plotësime të mëtejshme, këto dokumente janë një bazë e mire punë për përgatitjen e prezantimit për takimin dypalësh. Për finalizimin e tyre janë realizuar rreth 11 takime tematike sipas nënndarjeve të kapitullit dhe nënkaptullit të shëndetit publik.

Në fushën e Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve”(ZAM) ndërmjet konsumatorëve dhe tregtarëve, ka avancuar procesi i përgatitjes së draftvendimi i KM-së, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të strukturës përgjegjëse për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve konsumatore, të tjera nga ato që lidhen me shërbimet me interes publik, si dhe përcaktimin e kriterëve shtesë që duhet të përmbushin strukturat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve”. Aktualisht, pas përgatitjes së paketës (projektvendimi i KM-së, tabela e përputhshmërisë – shqip dhe anglisht, relacioni



shpjegues) është dërguar për konsultim në ministrinë e linjës dhe entet rregullatorë. Pritet që sipas planifikimit në PKIE 2020–2022, ky projektvendim të miratohet deri në fund të vitit 2020, duke e plotësuar kështu në një masë të konsiderueshme nivelin e përafrimit me Direktivën përkatëse 2013/11/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 maj 2013, “Për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve”

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve gjatë vitit 2020, ka vijuar funksionimin në drejtim të zbatimit të legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve nëpërmjet zhvillimit të katër mbledhjeve, duke marrë në shqyrtim 30 çështje, 10 prej të cilave të lidhura me mbrojtjen e interesit të përgjithshëm publik të konsumatorëve. Gjithashtu janë shqyrtuar ankesat e konsumatorëve, të paraqitura nga konsumatorë individuale, shoqata e konsumatorëve dhe pushteti lokal, të cilat kanë gjetur zgjidhje me ndërmjetësim apo me vendime nga KMK-ja, ISHMT-ja apo i kanë kaluar për kompetencë institucioneve të tjera sipas fushës së përgjegjësisë.

ISHMT-ja përgjatë periudhës tetor 2019–tetor 2020 ka realizuar rreth 120 inspektime në treg, nga të cilat 12 kanë rezultuar me masa paralajmëruese për dhënien e informacionit të plotë në etiketim e produkteve në gjuhën shqipe në përputhje me ligjin nr. 9902/2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, por edhe për sigurinë e përgjithshme për kategorinë veshje të fëmijëve. Përmes Projektit “Asistencë EuropeAid/137616/IH/SER/AL”, ISHMT-ja ka zhvilluar një program, ku informacioni i grumbulluar nga inspektimet e realizuara dhe produktet e kontrolluara do të shtohen nga inspektorët për të mundësuar ruajtjen e të dhënave të nevojshme për të kryer vlerësimin e rrezikut në përputhje me udhëzimet e Rapex.

ISHMT-ja ka punuar për fuqizimin e mëtejshëm të kapaciteteve njerëzore, nëpërmjet trajnimeve të ndryshme, edhe virtualisht përgjatë pandemisë COVID-19 nga organizatorët. Trajnimet konsistojnë në njohjen e legjislacionit të BE, implementimin e tij, si dhe praktikave më të mira mbi mbikëqyrjen e tregut. Vlen të përmendet trajnimi praktik dhe teorik i inspektorëve të sektorit përgjegjës për kontrollin e sigurisë së lodrave të vendosura në parqe publike dhe private në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë e

Përgjithshme dhe standardet referues. Trajnimet synojnë të aftësojnë inspektorët të kryejnë inspektime profesionale. Përveç inspektimit si përgjegjësi kryesore, aktiviteti i ISHMT-së është përqendruar gjithashtu në aktivitete informimi dhe ndërgjegjësim që synojnë konsumatorët dhe operatorët ekonomik, në fusha siç janë: siguria e ashensorëve të rinj dhe në përdorim, siguria e produkteve elektrike/mekanike, artikujt për kujdesin ndaj fëmijëve, lodrat, detergjentet etj. Në këtë kontekst, për periudhën Tetor 2019- Tetor 2020, janë organizuar rreth 13 takime me pjesëmarrjen e konsumatorëve dhe operatorëve ekonomik, në bashkëpunim edhe me organizata jofitimprurëse që kanë në objekt të tyre mbrojtjen e konsumatorëve. Gjithashtu, për të njëjtën periudhë janë publikuar dy materiale informuese mbi etiketimin dhe dhënien e informacionit për artikuj lodra dhe kimikatet të cilat janë bërë të disponueshëm ndaj konsumatorëve dhe operatorëve ekonomik në *website*-n zyrtar.

Si çdo vit, më datë 1 Qershor, ISHMT organizoi aktivitetin nëpërmjet një takimi virtual për ndërgjegjësimin dhe informimin e konsumatorëve, kryesisht prindërve për përzgjedhjen e produkteve të përshtatshme dhe të sigurta për fëmijët e tyre si dhe mënyrat e adresimit të ankesave konsumatore që lidhen me këtë kategori pranë ISHMT-së.

Prej vitit 2018 ISHMT disponon *website*-n e saj zyrtar, ku përveç materialeve informuese që janë të publikuar si për konsumatorët edhe për bizneset, ka një seksion të posaçëm ku qytetarët mund të drejtojnë ankesat e tyre. Prej Tetor 2019- Tetor 2020 janë zgjidhur 6 ankesa konsumatore nëpërmjet inspektimeve ku objekti i ankesës lidhet me mosrespektimin e kushteve të garancisë kontraktuale/ligjore për mallrat e konsumit të qëndrueshëm të cilat janë zgjidhur në favor të konsumatorit duke marrë dëmshpërblimin e munguar sipas të drejtave që garantohen nëpërmjet ligjit të mbrojtjes konsumatore. Gjithashtu, në faqen zyrtare të ISHMT-së është shtuar një panel i dedikuar, produktet e rrezikshme që janë konstatuar në tregun shqiptar njoftohen dhe përditësohen përmes një formati të ngjashëm me njoftimin në portalin e Rapex me të gjitha të dhënat përkatëse (emri, fotoja e produktit/numri i artikullit/arsyeja e moskonformitetit/lloji i rrezikut etj.).



Sa i përket Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, deri në muajin shtator 2020 janë trajtuar mbi 150 ankesa nga Drejtoria e Mbrojtjes Konsumatore, të cilat krahasuar me një vit më parë përbëjnë rreth 60% më tepër ankesa të trajtuara. Metodika e trajtimit të ankesave rregullohet nga Rregullorja 35, “Për trajtimin e ankesave të konsumatorëve”.

Me ndryshimet strukturore të vitit 2020, Drejtoria e Mbrojtjes Konsumatore u forcua në kapacitete duke u kthyer në Departament.

Në fushën e shëndetit publik, *Baby Check Pay* është një politikë sociale që është ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare gjatë vitit 2018. Me VKM-në nr. 740, datë 12.12.2018, “Për përcaktimin e ndihmës së menjëhershme financiare për nënat me foshnja të porsalindura dhe procedurën për dhënien e tij”, e cila hyri më 1 janar 2019, aplikohet bonusi për nënat me foshnja të porsalindura, i cili varion nga 40.000 mijë lekë për fëmijën e parë, 80.000 lekë për fëmijën e dytë dhe 120.000 mijë lekë për fëmijën e tretë dhe në vijim. Këtë bonus e përfitojnë edhe nënat që i lindin fëmijët e tyre jashtë vendit me kushtin që fëmija të regjistrohet sipas afateve ligjore. Masa e ndihmës së menjëhershme financiare jepet në formën e një çeku në emër të nënës, pranë maternitetit ku ajo ka lindur fëmijën.

Me dekretin 47 (30/01/2019), Qeveria ka aprovuar një ligj për caktimin e kontrollit kombëtar të kancerit të qafës së mitrës në vend. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i kanë kushtuar një buxhet asaj dhe Instituti i Shëndetit Publik kanë përgatitur bazat laboratorike për ekzaminim me bazë HPV. ISHP-ja ka përgatitur gjithashtu kornizën teknike të Programit Kombëtar. Grupi i synuar në popullatë janë gratë 40–50 vjeç, të cilët do të kontrollohen për HPV me rrezik të lartë gjatë 5 viteve. Ndërsa që prej nëntorit 2019, programi është plotësisht funksional dhe më shumë se 12000 gra janë ekzaminuar dhe u janë ofruar shërbime përcjellëse kur të jetë e nevojshme.

Në zbatim të synimeve kyçe të Strategjisë Kombëtare Shëndetësore 2016–2020 dhe Planit të Veprimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor 2013–2022, atë të deinstitutionalizimit dhe decentralizimit të shërbimeve të shëndetit mendor, dhe parashikimeve të paketës ligjore në zbatim të ligjit nr. 44/2012, “Për shëndetin mendor”, i ndryshuar, ndërhyrjet e fundit në fushën e shëndetit mendor synojnë fuqizimin e rrjetit të shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor.

Në këtë kuadër, me anë të VKM nr. 558, datë 15.7.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 325, datë 23.6.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për Krijimin e Qendrës Kombëtare, ‘Për mirëritjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e fëmijëve’, si njësi buxhetore, e veçantë”, të ndryshuar është riorganizuar kjo qendër (tashmë e quajtur Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët) duke zgjeruar grup-moshën përfituese të shërbimeve të saj, nga 0–6 vjeç në 0–18 vjeç, me qëllim maksimizimin dhe fuqizimin e shfrytëzimit të burimeve infrastrukture dhe njerëzore ekzistuese, të specializuara në shëndet mendor për fëmijët dhe adoleshentët.

Në fushën e gjakut arritja më e rëndësishme ka qenë ndërtimi dhe konsolidimi i një kornize rregulluese e ligjore të harmonizuar në pjesën më të madhe të saj me direktivat EU. Po kështu centralizimi i testimit për agentë infektivë dhe shtimi i metodës NAT në testimin rutinë të çdo njësie gjaku të dhuruar në vend, kanë qenë ndërhyrje të cilat kanë përmirësuar ndjeshëm sigurinë e gjakut lidhur me infeksionet e transmetueshme përmes transfuzionit të gjakut.

Bazuar në direktivat dhe standardet e OBSH-së dhe synimit të përafrimit ligjor me direktivat e BE-së Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me INSTAT, që është lider në këtë proces, ka hartuar VKM-në nr. 135, datë 20.3.2019, “Për miratimin e nomenklaturës së klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve, ICD-10. Kjo VKM konsiston në implementimin e ICD-10 klasifikimin ndërkombëtar i sëmundjeve në të gjitha institucionet shëndetësore të sistemit publik dhe jopublik, në shërbimin parësor dhe spitalor, Ministria e Drejtësisë-spitali i Burgjeve dhe Mjekësia Ligjore, Instituti i Sigurimeve Shoqërore për CEMP, Ministria e Mbrojtjes – Spitali i Traumës që ka varësi të dyfishtë institucional. Kjo nomenklaturë ka për qëllim zëvendësimin e ICD-IX në ICD-10, e cila ka të bëjë me kodifikimin e detajuar të diagnozave në kartelat e pacientit sipas standardeve ndërkombëtare të OBSH dhe BE.

28.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Kuadri institucional që merret me mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit në Shqipëri përbëhet nga institucionet e mëposhtme:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE);



- Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorit (KMK);
- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT);
- Banka e Shqipërisë (BA);
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS);
- Instituti i Shëndetit Publik;
- Spitalet universitare për diagnostikimin, trajtimin, trajnimin e specialistëve;
- Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut;
- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor;
- Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

28.7 Prioritetet

Prioritete në këtë kapitull për periudhën 2021–2023 janë:

Forcim i kapaciteteve administrative të strukturës përgjegjëse të mbrojtjes së konsumatorëve, Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve, si dhe institucioneve të tjera përkatëse;

- Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit me *acquis* në përputhje me analizën e mangësive ligjore për kapitullin 28 dhe, veçanërisht, në fushën e kredisë konsumatore dhe tregtimit në distancë të shërbimeve financiare;

- Funksionimi i Inspektoratit të Mbikëqyrjes së Tregut, me kapacitet të plotë punonjësish;

- Zbatimi i kuadrit të politikave për shëndetin publik dhe të sigurohet qëndrueshmëria e ndërhyrjeve;

- Përmirësimi i aksesit në shëndetësi dhe shërbime për njerëzit në nevojë, duke përfshirë: minoritetet romë dhe egjiptiane; personat me aftësi të kufizuara; dhe popullsinë në zonat rurale ose të thella;

- Me rëndësi të veçantë është përmirësimi i aksesit për gratë dhe vajzat që u përkasin grupeve të mësipërme, të cilat shpesh u nënshtrohen formave të shumta të diskriminimit;

- Përpjekje të mëtejshme për përafrimin e plotë me legjislacionin e BE-së për çështjet e produkteve të duhanit, substancat me origjinë njerëzore dhe barnat për përdorim njerëzor dhe veterinar;

- Vlerësimi dhe priorizimi i ndikimit shëndetësor të politikave të mbrojtjes sociale, sigurisë në punë, mjedisit, planifikimit dhe rregullimit territorial, duke përfshirë transportin

dhe komunikimet, politikat fiskale për të rritur barrën e taksave mbi duhanin, pijet alkoolike, lëndëve djegëse shumë ndotëse, lojërat e fatit dhe lehtësimin të politikave fiskale për produktet me interes të veçantë për shëndetin publik;

- Krijimi/konsolidimi i mekanizmit të koordinimit ndërsektorial për probleme madhorë të shëndetit publik, si droga dhe abuzimi me alkoolin, duhan- pirja, siguria rrugore, siguria ushqimore dhe ushqyerja, shpërthimi i sëmundjeve infektive, rezistenca antibiotike, përgatitja dhe reagimi ndaj pandemive, menaxhimi strategjik i kimikateve, faktorët mjedisorë, ndryshimet klimatike, migrimi, shëndeti dhe përfshirja sociale;

- Përmirësimi i programeve të mbikëqyrjes dhe reagimit ndaj sëmundjeve infektive, përmes përmirësimit të legjislacionit, forcimit të kapaciteteve dhe rrjeteve të informimit, si dhe forcimit të laboratorëve mikrobiologjikë të shëndetit publik;

- Ngritja e një sistemi mbikëqyrjeje për rezistencën antibiotike dhe të një programi kontrolli dhe monitorimi mbi konsumin dhe politikat e antibiotikëve, përmes përmirësimit të legjislacionit, forcimit të kapaciteteve dhe rrjeteve të informimit, si dhe forcimit të laboratorëve mikrobiologjikë të shëndetit publik;

- Përmirësimi i përgatitjes dhe reagimit ndaj pandemive dhe i politikave të kontrollit të sëmundjeve (HIV/AIDS, sifilizi, hepatiti viral, programi i imunizimit etj.), përmes rritjes së kapaciteteve dhe përmirësimit të strategjive kombëtare; përmirësimit të akteve nënligjore, forcimit të kapaciteteve dhe digjitalizimit, si dhe forcimit të laboratorëve mikrobiologjikë të shëndetit publik; ngritjen e një sistemi mbikëqyrjeje për rezistencën antibiotike.

- Rritja e numrit të dhuruesve vullnetarë përmes riorganizimit tërësor të promocionit të dhurimit vullnetar të gjakut në vend, forcimit të kapaciteteve promovuese brenda QKTGJ dhe digjitalizimit të të dhënave të dhuruesve/dhurimeve të gjakut në nivel kombëtar.

- Përmirësimi i cilësisë së gjakut përmes rritjes së kapaciteteve testuese/përpunuese/ruajtëse, harmonizimit të plotë të standardeve dhe legjislacionit me Direktivat Evropiane dhe disenjimit/forcimit të kapaciteteve të autoriteteve kompetente për inspektim dhe hemovigilancë. Implementimi i një sistemi të integruar të



hemovigilancës përmes ngritjes së një rrjeti raportimi dhe vlerësimi të reaksioneve dhe eventeve të padëshiruara.

- Një plan veprimi/program mbi zhvillimin e shërbimeve të shëndetit mendor në Shqipëri është planifikuar të hartohet brenda vitit 2023, bazuar në objektivat relevantë strategjikë të dokumentit të ri të Strategjisë Kombëtare Shëndetësore 2020–2030. Objektivat do të reflektojnë vizionin e dokumenteve ndërkombëtare në shëndet mendor si Planit të veprimit për Shëndetin Mendor të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe dokumentet relevantë të *EU Acquis* në këtë fushë.

- Gjithashtu, një zgjatje e Dokumentit Strategjik mbi “Parandalimin dhe reduktimin e dëmeve të lidhura me alkoolin në Shqipëri, 2017–2021” dhe planit të tij të veprimit do të rishikohet në 2022, duke pasqyruar objektivat strategjikë përkatës të lidhura me alkoolin të parashikuara si në Strategjinë e Re Kombëtare të Shëndetësisë 2030, si dhe të dokumenteve përkatëse ndërkombëtare, si të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe *Acquis* përkatëse të BE-së.

- Një Plan kombëtar për kontrollin e drogave dhe një plani pesëvjeçar i veprimit për zbatimin e tij është planifikuar të miratohet brenda vitit 2022, duke pasqyruar objektivat strategjikë përkatës, në lidhje me drogat të Strategjisë së Re Kombëtare të Shëndetit 2030. Objektivat do të pasqyrojnë vizionin e dokumente ndërkombëtare, si të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, të Qendrës Evropiane të Monitorimit të Drogave dhe Varësisë nga Drogat dhe *Acquis* përkatëse të BE-së.

Çështje të tjera horizontale

- Rritja e angazhimit dhe përfshirjes së shoqërisë civile në procesin e negociatave të anëtarësimit, përmes ngritjes së Tryezës për Kapitullin 28, në kuadër të Platformës së Partneriteti për Integrimin Evropian.

- Rritja e kapaciteteve të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian, lidhur me përfundimin e fazës *screening* dhe me tej me procesin e bisedimeve të anëtarësimit për Kapitullin 28.

KAPITULLI 29 BASHKIMI DOGANOR

29.1 Përmbajtja e kapitullit

Legjislacioni i BE-së në fushën e Bashkimit Doganor është direkt i detyrueshëm për Shtetet Anëtare, duke siguruar funksionimin e bashkimit doganor si dhe mbrojtjen efektive dhe kontrollin e kufijve të jashtëm. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë ekzistencën e kapaciteteve të nevojshme zbatuese, duke përfshirë lidhjet me sistemet relevante të kompjuterizuara të BE-së. Shërbimet doganore gjithashtu duhet të sigurojnë kapacitete adekuate për zbatimin e rregullave të veçanta të përcaktuara në fushat përkatëse të *acquis*, siç janë tregtia e jashtme, dispozitat për shëndetin dhe sigurinë.

29.2 Struktura e kapitullit

N/A

29.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Angazhimet në fushën e doganave janë marrë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-asociimit, nenet 13, 14, 15, 34, 43, 86 dhe 97. Nenet 13, 14, 15, 34, 43 dhe 86 parashikojnë në veçanti forcimin e bashkëpunimit me vendet e rajonit që kanë nënshkruar MSA, ndërsa neni 41 dhe protokollin 4 përcaktojnë rregullat e origjinës për implementimin e dispozitave të kësaj Marrëveshje.

Marrëveshja e Stabilizim-asociimit, në veçanti neni 97 i referohet doganave. Ky nen parashikon, detyrimin për të përafuar legjislacionin doganor shqiptar me atë të BE-së, bashkëpunimin mes Palëve duke pasur parasysh *acquis* në fushën e doganave dhe bashkëpunimin për asistencë të ndërsjellë administrative në çështje doganore.

Acquis në fushën e Bashkimit Doganor përfshin Kodin Doganor të BE-së dhe dispozitat e tij zbatuese, Nomenklaturën e Kombinuar, tarifën e përbashkët doganore dhe dispozitat për klasifikimin e tarifave, lehtësimin e detyrimeve doganore, pezullimet doganore dhe kuotat e caktuara tarifore, si dhe dispozita të tjera të tilla si ato mbi kontrollin doganor të të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe ndihmën e ndërsjellë administrative në çështjet doganore dhe transit.

Implementimi i *acquis* të Bashkimit Doganor kërkon ekzistencën efektive të autoriteteve doganore, në secilin Shtet Anëtar për të siguruar



zbatimin korrekt, uniform të rregullave doganore dhe kur është e përshtatshme, të dispozitave të tjera të zbatueshme për mallrat që i nënshtrohen mbikëqyrjes doganore.

29.4 Situata aktuale në Shqipëri

Shqipëria ka përafruar gjerësisht *acquis* e BE në fushën doganore. Rregullat e vlerësimit, analizës së riskut, tarifës, pronësisë intelektuale, procedurave përfshirë ato *online*, borxhit dhe sistemit të garancive janë të harmonizuara me rregullat e BE-së. Nomenklatura e Mallrave miratohet e përditësuar çdo vit për të qenë në linjë me Nomenklaturën e Kombinuar të BE-së.

Nga Banka Botërore është bërë një investim për Shqipërinë mbi “Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor”, nga i cili dogana do të përfitojë një shumë prej 10,9 milionë USD për zhvillimin dhe zbatimin e projektit të Sportelit të Vetëm (*Single Window*); Platformën NCTS (*New Computerised Transit System*); dhe implementimin e Pikës së Përbashkët të Kalimit të Kufirit (me Maqedoninë e Veriut) në Qafëthanë. Kjo kredi është nënshkruar nga Qeveria Shqiptare me 19.6.2019 dhe ratifikuar nga Parlamenti në shtator 2019.

Zbatimi ka filluar në janar 2020. Në shkurt 2020 është ngritur njësi PIU për zbatimin e projektit pranë MFE. Kjo njësi së bashku me CFCU në MFE, po ndjekin procedurat e implementimit dhe kontraktive në kuadër të këtij Projekti.

Është përzgjedhur kompania fituese e cila do të kryejë analizën e sistemit aktual të tranzitit dhe do të hartojë termat e referencës për komponentët e tjerë të parashikuar në projekt për implementimin e NCTS-së.

Shqipëria zbaton Konventën Rajonale Pan-Euro-Mesdhetare mbi rregullat preferenciale të origjinës.

Administrata doganore mbështetet në Strategjinë e Biznesit të Administratës Doganore 2018- 2021 të miratuar nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, që përcakton misionin dhe objektivat strategjike, si dhe përmirësimin e sistemeve dhe platformave të TI. Gjithashtu është miratuar plani i veprimit për zbatimin e kësaj strategjie.

Vendimi nr. 3/2015 i Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes CEFTA që parashikon zbatimin e kumulimit të plotë të origjinës dhe heqjen e ndalimit për kthimin ose përjashtimin nga pagesa e detyrimeve doganore (*Duty Drawback*) në tregtinë

ndërmjet vendeve të Marrëveshjes CEFTA ka filluar zbatimin nga data 1 korrik 2019. Vendimi 2/2017 i Komitetit të Përbashkët të Konventës Pan-Euro-Mesdhetare për rregullat preferenciale të origjinës, datë 16 maj 2017 ka përfshirë Vendimin 3/2015 të CEFTA-s në Shtojcën II-të të Konventës Rajonale Pan-Euro-Mesdhetare për rregullat preferenciale të origjinës duke futur mundësinë e tërheqjes nga detyrimet doganore dhe kumulimin e plotë në tregtinë që mbulohet nga CEFTA.

Komiteti i Përbashkët i MTL-së ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Turqisë nëpërmjet vendimit 1/2019 ka rënë dakord të zëvendësojë protokollin II “Protokoll për përkufizimin e konceptit të “Produkteve të origjinës” dhe metodave të bashkëpunimit administrativ” me konventën PEM. Në lidhje me këtë vendim po kryhen procedurat e brendshme në dy vendet përkatëse. Në Shqipëri, nëpërmjet VKM nr. 591, datë 4.9.2019 është rënë dakord në parim për ndryshimin e këtij protokoll.

Përmes udhëzimit të ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 3, datë 23.1.2018, “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore” është miratuar Baza Kombëtare e të Dhënave të Vlerësimit si një instrument i njohur dhe i rekomanduar nga Organizata Botërore e Doganave. Kjo bazë të dhënash përdoret gjatë procesit të vlerësimit doganor të mallrave kur vlera e deklaruar nuk pranohet dhe përcaktimi i saj bëhet duke zbatuar vlerat optimale të deklaruara dhe të pranura për mallrat identike dhe të ngjashme.

Gjatë periudhës Janar-shtator 2020 zhdoganimi duke përdorur të dhënat e disponueshme (çmimet minimale të referencës, metoda 6 ka qenë rreth 7–8% të totalit të artikujve për këtë periudhë. Përdorimi i të dhënave të disponueshme (vlera minimale të referencës) u nënshtrohen kryesisht mallrave me vlerë tregu dhe ato me origjinë jashtë BE-së.

Sistemi i Menaxhimit të Riskut i automatizuar kontribuon në ekuilibrin ndërmjet lehtësimit të tregtisë dhe kontrollit doganor. Gjatë periudhës 1 janar 2020–30 shtator 2020, 7.1% e numrit të përgjithshëm të deklaratave doganore import-eksport është inspektuar fizikisht (kanali i kuq); 69.1% kontroll dokumentacioni (kanali i verdhë), 10.3% kontroll pas zhdoganimit (kanali blu) dhe



pjesa tjetër (13.4%) nuk kishin kontroll (kanali i gjelbër).

Gjatë periudhës 1 tetor 2020–6 dhjetor 2020, 7% e numrit të përgjithshëm të deklaratave doganore import/eksport është inspektuar fizikisht (kanali i kuq); 68.5% kontroll dokumentacioni (kanali i verdhë), 10% kontroll pas zhdoganimit (kanali blu) dhe pjesa tjetër (14.5%) nuk kishin kontroll (kanali i gjelbër).

Sistemi i kontrollit doganor të vendit për prekursorët e drogës, produktet kimike të rrezikshme dhe “substancat e kontrolluara” është i harmonizuar me Konventën e OKB-së kundër

trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotropë të vitit 1988. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në kontekstin e mbrojtjes kombëtare dhe misionit të sigurisë dhe në kontekstin e përmirësimit të kontrolleve doganore mbi importin, eksportin dhe tranzitin e lëndëve narkotike dhe prekursorëve psikotropikë të narkotikëve, zbaton profilet e riskut në sistemin ASYCUDA World prej vitit 2012.

Lidhur me vazhdimin e luftës kundër trafikëve të paligjshme, kontrabandës, korrupsionit dhe importeve të produkteve të falsifikuara, situata deri me tetor 2020 është:

<i>Cigare të kapura në BCP:</i>	<i>1 janar–20 tetor 2020</i>
Nr. i rasteve	Sasia e kapur
4	2,658,000 paketa cigaresh (20 copë/paketë) ose 5,316 koli

<i>Narkotike të kapur në BCP:</i>		<i>1 janar–20 tetor 2020</i>
Nr. i rasteve	Lloji i narkotikës	Sasia e kapur
1	Cocaine	1.03 kg
1	Heroine	38 kg
10	CannabisSativa	777 kg
1	Cannabis Sativa (seeds)	11,000 cope
Total, 10 raste		

<i>Armë të kapur në BCP:</i>		<i>1 janar–20 tetor 2020</i>
Nr. i rasteve	Lloji	Sasia e kapur
1	(handgun model TT)	1 pcs
<i>Klandestinë të kapur në BCP:</i>		
Persona të kapur		
36 persona		

Ndërsa rastet e kapjeve të vlerave monetare në pikat doganore kufitare për periudhën 1 janar–9 dhjetor 2020, janë në vlera shumë të konsiderueshme dhe konkretisht paraqiten në tabelën më poshtë:

<i>Para Cash e kapur në pikat e kontrollit doganor BCP's:</i>	<i>1 janar 2020–9 dhjetor 2020 – 45 raste mosdeklarimi (kapje cash)</i>
Monedha	Sasia e kapur
EUR	1,480,965
CHF	113,517
GBP	380,990
ALL	551,000



Gjatë periudhës tetor–9 dhjetor 2020 nga Drejtoria e Antikontrabandës, janë ushtruar kontrole, 677 nga të cilat 46 kanë qenë të plota. Kontrollat janë ushtruar në bashkëpunim edhe me strukturat në DPD, si dhe me organet e tjera ligjzbatuese. Gjatë kontroleve të ushtruara, janë konstatuar/zbuluar 7 raste me shkelje doganore, ku 6 janë me penalitet, në vlerën totale 4,769,451 Lekë.

Ndërkohë vlera e deklarimit *cash* në kufi është rregulluar me ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar dhe është në linjë me Rregulloren (BE) 2018/1672 e Parlamentin Evropian dhe e Këshillit të 23 tetor 2018 për kontrollin e parave *cash* në hyrje ose dalje nga Unioni, që shfuqizon Rregulloren (BE) nr. 1889/2005 në vlerën 10,000 euro.

Sistemet e TI-së janë plotësisht të ndërlidhura me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor, ndërsa kushtet për akses të drejtpërdrejtë janë krijuar për policinë dhe prokurorinë, si dhe Autoritetin Kombëtar të Ushqimit.

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave referuar VKM-në nr. 921, datë 29.12.2014, “Për personelin e administratës doganore”, të ndryshuar, ka të përcaktuar organikën e Administratës Doganore. Organika e Drejtorisë së Përgjithshme është 1102 punonjës të shpërndarë në nivel qendror (Drejtorja e Përgjithshme e Doganave) dhe nivel vendor (17 degë doganore). Nga këta 1102 punonjës, 810 punonjës gëzojnë statusin e nëpunësit civil, ndërsa për 292 punonjës marrëdhëniet rregullohen ndërmjet Kodit të Punës. Me hyrjen në fuqi të strukturës së re në prill 2019, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në zbatim të VKM nr. 2, datë 8.1.2018, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar, u vijua me organizimin e brendshëm referuar strukturës dhe organikës analitike sipas përcaktimeve të këtij të fundit. Aktualisht janë të punësuar 1003 punonjës (724 nëpunës civilë dhe 279 me Kod Pune) dhe janë 99 vende vakante (86 nëpunës civil dhe 13 me Kod Pune).

Përgjatë vitit 2020 nga data 1 JANAR deri në 19 tetor janë punësuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave gjithsej 63 punonjës, nga këta 31 janë nëpunës civilë, sipas procedurave të parashikuara në ligjin për shërbimin civil dhe 31, sipas Kodit të Punës dhe 1 me vendim të Këshillit

të Ministrave. Janë larguar 51 punonjës nga administrata doganore (me ristrukturim, në zbatim të vendimit të Gjykatës, me Komision Disiplinor, pension pleqërie, me kërkesë, transferuar në detyrë tjetër pezullim për një afat deri 2 vjet me kërkesë, për shkak të ligjit).

Për periudhën 1 tetor deri në 7 dhjetor janë punësuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave gjithsej 48 punonjës, nga këta 43 janë nëpunës civilë sipas procedurave të parashikuara në ligjin për Shërbimin Civil dhe 4, sipas Kodit të Punës dhe 1 me vendim të Këshillit të Ministrave. Janë larguar 9 punonjës nga administrata doganore (me ristrukturim, në zbatim të vendimit të Gjykatës, me Komision Disiplinor, pension pleqërie, me kërkesë, transferuar në detyrë tjetër pezullim për një afat deri 2 vjet me kërkesë, për shkak të ligjit).

Gjatë vitit 2020 nga data 1 janar deri në 19 tetor në Komisionin Disiplinor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave janë regjistruar 64 çështje disiplinore. Këto janë shqyrtuar dhe janë zbardhur me vendime përfundimtare. Në vijimësi deri në 7 dhjetor në Komisionin Disiplinor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nuk janë regjistruar çështje disiplinore dhe nuk janë zhvilluar seancat për arsye të situatës së pandemisë.

Procedura e vlerësimeve të punës për 6-mujorin e parë 2020 është kryer, duke përfshirë shpërndarjen dhe grumbullimin e formularëve, hedhjen e vlerësimit në bazën e të dhënave dhe përgatitjen statistikore të rezultateve për 616 nëpunës civilë.

Në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthim në punë është kryer procedura në zbatim të urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015 të ministrit të Shtetit dhe janë marrë në punë 5 nëpunës.

Në zbatim të urdhrit të ministrit të Ekonomisë dhe Financave nr. 155/1, datë 19.6.2019, “Për funksionet e personelit doganor që duhet të pajisen me certifikatë sigurie”, DMBNJ-ja ka evidentuar gjithsej 303 pozicione. Nga këto 215 punonjës janë pajisur me certifikatë sigurie dhe 88 punonjës janë në proces certifikimi.

Sa i përket certifikimit elektronik të dokumentacionit dhe nënshkrimit elektronik të deklaratës nga ana e operatorëve ekonomikë/agjentëve doganorë, si dhe nga ana e punonjësve doganorë zbatohet vula elektronike.



Aktualisht operojnë 9 operatorë ekonomik me zhdoganim lokal elektronik. Deklaratat e thjeshtësuara aplikohen për sektorin e anijeve, dërgesave postare, blerjet në internet, eksportin e mineraleve. Udhëzimi nr. 6, datë 27.3.2019, mbi zbatimin e procedurave të miratimit dhe përdorimit të deklarimit të thjeshtëzuar është miratuar.

Aktualisht, kanë aplikuar për Statusin e Operatorit Ekonomik të Autorizuar 11 operatorë dhe 4 nga të cilët janë në proces autorizimi. Gjithashtu, është miratuar urdher nr. 19532/1 datë 19.10.2020 udhëzuesi, “Për Operatorët Ekonomikë të Autorizuar” i cili ka natyrë shpjeguese. Qëllimi i këtij Udhëzuesi është të garantojë një ide të përbashkët për autoritetet doganore dhe operatorët ekonomikë, si edhe të jetë një instrument për lehtësimin e zbatimit të rregullt dhe të harmonizuar të dispozitave ligjore të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar dhe mbulon të gjitha instrumentet dhe procedurat e përdorura gjatë aplikimit për përfitimit e statusit “Operator Ekonomik i Autorizuar” si dhe procedurën e menaxhimit.

Është miratuar udhëzimi i OEA bazuar në versionin 6 të Manualit të BE.

Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale (DASP) për periudhën 1 janar – 30 shtator 2020, ka trajtuar 71 raste, denoncime/ankesa, të mbërritura nëpërmjet numrit jeshil, adresës antikorrupsion.dpd@dogana.gov.al, si dhe raste të deleguara nga drejtori i përgjithshëm. Për të gjitha rastet e trajtuara, në përfundim të verifikimeve të rasteve specifike u propozuan 22 masa disiplinore dhe 2 raste ku gjatë hetimit administrativ lindi dyshimi i arsyeshëm se kishte elemente të figurës së veprës penale, materialet iu deleguan për kompetencë Drejtorisë së Hetimit.

Nga 23 propozime për masa disiplinore:

- 15 propozime për komision disiplinor;
- 4 propozime për “vërejtje”;
- 2 kaluar eprorit direkt për vlerësim;
- 1 ndërprerje kontrate.

Për periudhën 1 tetor–7 dhjetor 2020, Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale trajtoi 30 raste.

Sistemi LIMS (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Laboratorit) është zbatuar dhe funksionon. Me vendim të Trupit Akreditues, laborator doganor shqiptar është akredituar për 5 tregues analitikë më 25.10.2018. Me plotësimin e kushteve teknike (kalibrim, mirëmbajtje e

aparaturave) Laboratori Doganor do të ndjekë procedurat e nevojshme për zgjerimin e fushës së akreditimit me tregues të tjerë analitikë. Kapacitetet teknike dhe profesionale në lidhje me metodat analitike dhe sigurinë në laborator janë përmirësuar përmes trajnimeve nga Organizata Botërore e Doganave. Në mënyrë të vazhdueshme, Laboratori Doganor paraqet nevojat për trajnime nga OBD.

Në datat 6–9 korrik 2020 është realizuar në Laboratorit Doganor vizita vlerësuese për zgjerimin e fushës së akreditimit, nga eksperte të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit.

Laboratorit Doganor i është akorduar Certifikata e Akreditimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit edhe për 33 treguesit e rinj analitikë, në datë 26.10.2020.

Gjithashtu, njohuritë mbi procedurat e marrjes së mostrës SAMANCTA (Manuali i Marrjes së Mostrave për Doganat dhe Autoritetet Tatimore) janë përmirësuar përmes trajnimeve nga DG TAXUD dhe *Scivan Group*.

Administrata Doganore Shqiptare, si institucion i zbatimit të ligjit, ka pezulluar lëshimin e mallrave të mëposhtëm të dyshuar për shkelje të së drejtës së pronësisë intelektuale, gjatë 3 viteve të fundit:

- Gjatë vitit 2019 u pezullua lirimi i 9043 mallrave, të dyshuar për shkelje të një të drejte të pronësisë intelektuale 6651 artikuj të ndryshëm, u pezulluan sipas procedurës *ex-officio*.

- Gjatë vitit 2020 janë pezulluar 23440 copë mallra cenuese me procedurën *ex-officio* dhe bazuar në një aplikim. Gjithashtu në bazë të konfirmimit/eve nga mbajtësit e së drejtës janë shkatërruar 4140 copë mallra cenuese.

Drejtoria për Mbrojtjen e së Drejtës së Pronësisë Intelektuale ka aftësi administrative për kryerjen e detyrave në lidhje me të drejtat e pronësisë intelektuale bazuar në përvojën e më shumë se 10 viteve të stafit të saj në këtë fushë, koordinimin ndër-institucional (organizimin e operacioneve të përbashkëta me strukturat brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe institucionet e tjera), trajnime si lektorë dhe si përfitues në fushën e pronësisë intelektuale.

Gjatë vitit 2020, për të përditësuar informacionin mbi legjislacionin mbi Pronësisë Industriale, u ndoq metoda “Trajnim në punë”, dhe numri i stafit doganor të trajnuar në total është 36 persona në nivelin lokal.



Në janar të vitit 2021 fillon projekti IPA *“Support to the Albanian Customs Administration in relation to the implementation of the EU Customs Code and increase of operational capacities in the area of counterfeit goods”*, i cili synon miratimin e akteve të nivelit të tretë sipas atyre të BE si dhe krijimin e një sistemi të dhënash doganore mbi kapjet, procedurat dhe shkatërrimet e mallrave cenuese si dhe implementimin e procedurës *online* për aplikimet që do të bëhen nga mbajtësit e së drejtës.

29.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Është miratuar, ligji nr. 62/2019, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin, “Për Lehtësimin e Tregtisë dhe të Transportit në Ballkanin Perëndimor, me qasje programatike me shumë faza” që parashikon “Zhvillimin dhe zbatimin e projektit të Sportelit të Vetëm (*Single Window*), Platformën NCTS (*New Computerised Transit System*) dhe implementimin e Pikës së Përbashkët të Kalimit të Kufirit (me Maqedoninë e Veriut) në Qafëthanë.

Tashmë ka filluar zyrtarisht zbatimi i Projektit në lidhje me NCTS, që parashikon hartimin e kërkesave/specifikimeve teknike për zhvillimin dhe zbatimin e NCTS. Kjo detyrë përfshin përgatitjen e akteve të reja ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me NCTS si dhe përgatitjen e kërkesave teknike dhe funksionale dhe specifikimet e rrjedhës së punës dhe çdo kërkesë tjetër të nevojshme për fazën 5 të NCTS-së.

Në kuadër të rritjes së kontrollit të lëvizjes së parasë *cash* në pikat e kalimit kufitar, me Ligjin Nr. 33, datë 17.6.2019 janë bërë ndryshime në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, ku si risi është vendosja e sanksioneve (gjobë) nga autoriteti doganor në rastet e mos deklarimit apo deklarimeve të rremë të parasë *cash* në kufi. Është në proces përgatitja e me asistencën e ekspertit të kontraktuar nga GIZ, e projektvendimit të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për vendosjen e sanksioneve administrative nga organet doganore në zbatim të nenit 17/1 të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, të ndryshuar”.

Më 1 janar 2021, ka hyrë në fuqi VKM nr. 1087, datë 24.12.2020, “Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2021”. Përmes miratimit të VKM nr. 626, datë

18.9.2019, “Për disa shtesa në VKM-në nr. 651, datë 10.11.2017 Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014 Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, trajtohen, standardizohen dhe sqarohen çështje që kanë të bëjnë me zonat e lira dhe veprimtarinë apo regjimin doganor të zonës së lirë. Gjatë vitit 2019–2020, përmes VKM nr. 617, datë 18.9.2019, VKM nr. 618, datë 18.9.2019, VKM nr. 493, datë 11.7.2019, VKM nr. 218, datë 12.3.2020, VKM nr. 384, datë 13.5.2020, VKM nr. 385 datë 13.5.2020 janë miratuar 6 (gjashtë) Zona të Lira në Porto-Romano dhe përmes VKM nr. 384 datë 13.5.2020 është miratuar një zonë e lirë në Portin e Vlorës.

Sistemi doganor “paperless” për procedurat e import-eksportit zbatohet që prej datës 16.5.2019. Aplikimet për regjime doganore (magazinimi doganor, regjimi i përpunimit aktiv, regjimi i përpunimit pasiv dhe regjimi i lejimit të përkohshëm) mund të kryhen përmes shërbimit *e-Albania*.

Në vitin 2020 nga data 1 janar deri në 19 tetor janë zhvilluar trajnime nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Organizata të ndryshme, si: EXBS, WCO, GIZ, OBD, UK Border Force, Kryeministria, MFE, QTATD, ASPA etj., një pjesë e të cilave janë në vijimësi. Si rezultat janë zhvilluar 32 trajnime dhe janë trajnuar 296 punonjës të Administratës Doganore.

Dogana shqiptare po bashkëpunon me GIZ-in për zbatimin e projektit rajonal pilot të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar.

Në kuadër të Programit IPA 2017 është miratuar Projekti i Binjakëzimit “Mbështetje për Administratën Doganore Shqiptare në lidhje me implementimin e Kodit Doganor të BE-së dhe përgatitjen për ndërveprim me sistemin e IT të BE për mallrat e falsifikuara”. Ky Projekt synon të ndihmojë ADSH-në në përafrimin e akteve të treta dhe udhëzimeve me *acquis* të BE-së dhe praktikat më të mira si dhe të ndihmojë në përgatitjen për ndërveprim me sistemin IT të BE-së për mallrat e falsifikuara. Më datë 24.11.2020, u nënshkrua kontrata dhe filloi zyrtarisht zbatimi i Projektit.

29.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për këtë kapitull janë:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- Ministria e Mbrotjtjes;



- Ministria Kulturës;
- Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);
- Instituti i Statistikave.

29.7 Prioritetet

Prioritetet në këtë fushë janë:

- Përmirësimi i procedurave doganore në mënyrë që të rritet mbledhja e efikase e detyrimeve është një nga prioritetet kryesore në këtë fushë.
- Avancimit me regjistrimin e operatorëve ekonomik të autorizuar, ndjekjes së luftës kundër kontrabandës, dhe trafikeve të paligjshme importeve të produkteve të falsifikuara dhe korrupsionit.
- Ndjekja dhe zbatimi korrekt i ligjit nr. 62/2019, për zhvillimin dhe zbatimin e projektit të Sportelit të Vetëm (*Single Windows*), Platformës NCTS (*New Computerised Transit System*), si dhe implementimi i Pikës së Përbashkët të Kalimit të Kufirit (me Maqedoninë e Veriut) në Qafëthanë.
- Implementimi i korsive të gjelbra me vendet kufitare të BE-së
- Përmirësimi dhe shtimi i numrit të aplikimeve *online* për Autorizime të cilat miratohen nga Administrata Doganore nëpërmjet portalit *e-Albania*.
- Përmirësimi dhe zhvillim i sistemit informatik doganor për deklarimin para mbërritjes së mallrave.
- Miratimi dhe publikimi zyrtar i Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.
- Miratimi i dispozitave zbatuese të ligjit nr. 33, datë 17.6.2019 në lidhje me procedurat për vendosjen e sanksioneve (gjobë) nga autoriteti doganor në rastet e mosdeklarimit apo deklarimeve të rremë të parasë *cash* në kufi.
- Luftë kundër shkeljeve ndaj pronësisë intelektuale në doganë, sistemit të menaxhimit të riskut sipas modeleve të harmonizuara të menaxhimit të riskut të BE-së, si dhe bashkëpunimit aktiv me partnerët kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.
- Ndërmarrja e aktiviteteve për të përmirësuar imazhin publik dhe reputacionin e doganave. Aktivitetet dhe veprimet në fushën e luftës kundër korrupsionit do të forcohen dhe zbatohen.

- Ndërlidhja me sistemet dhe standardet e TI të BE-së, përmirësimi i sistemeve dhe platformave të TI.

- Zhvillimi i një cikli trajnimesh në degët doganore si dhe *online* me qëllim rritjen e kapaciteteve administrative në bashkëpunim edhe me QTATD për sa u përket çështjeve të pronësisë intelektuale.

- Organizimi i fushatave sensibilizuese për rritjen e ndërgjegjësimin të bizneseve dhe rritjen e njohurive legjislative, si dhe për mënyrën e mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale nga Administrata Doganore Shqiptare.

- Ndjekja dhe zbatimi korrekt i Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje për Administratën Doganore Shqiptare në lidhje me implementimin e Kodit Doganor të BE-së dhe përgatitjen për ndërveprim me sistemin e IT të BE për mallrat e falsifikuara” (që i përket Programit IPA 2017).

- Zbatimi i Strategjisë së Biznesit 2018–2021.

KAPITULLI 30 MARRËDHËNIET ME JASHTË

30.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis në këtë fushë përbëhet kryesisht nga legjislacioni direkt detyrues i BE-së i cili nuk kërkon transpozim në ligjin kombëtar. Ky legjislacion i BE-së rezulton nga angazhimet tregtare shumëpalëshe dhe bilaterale të BE-së, si dhe nga një numër masash autonome preferenciale tregtare. Në fushën e ndihmës humanitare dhe politikës së zhvillimit, Shtetet Anëtare duhet të zbatojnë legjislacionin e BE-së dhe angazhimet ndërkombëtare dhe të sigurojnë aftësinë për të marrë pjesë në politikën e zhvillimit dhe humanitare të BE-së. Vendet aplikuese u kërkohet të harmonizojnë në mënyrë progresive politikën e saj ndaj vendeve të treta dhe pozicionet brenda organizatave ndërkombëtare në lidhje me politikën dhe pozicionet e miratuara nga Bashkimi dhe Shtetet Anëtare të tij.

30.2 Struktura e kapitullit

- Politika e përbashkët tregtare;
- Politikën për zhvillim dhe ndihma humanitare.

30.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Detyrimi për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian buron nga neni 70-të i MSA-së, dispozitë nga e cila Shqipëria ka jo vetëm



detyrimin për të sjellë legjislacionin e saj kombëtar në përputhje me legjislacionin e BE-së, por edhe të sigurohet që ajo të zbatohet. Marrëveshja Stabilizim-asociimit (MSA) përfshin një titull kryesor mbi tregtinë e lirë mes Shqipërisë dhe BE-së. Ajo përfshin dispozita në disa fusha që kërkojnë se palët duhet të veprojnë në përputhje me rregullat e OBT-së ose të detyrimeve ndërkombëtare. Detyrimet e Shqipërisë sipas përcaktimeve të MSA-së për politikën tregtare në mënyrë të përmblodhur janë nenet relevante të MSA-së për këtë kapitull, si: 7, 16, 19, 20, 21, 25, 26, 27, 28, 29, 33, 34, 40, 59, 60, 70, 71, 72, 73, 74, 97.

Legjislacioni në fushën e politikës së përbashkët tregtare përbëhet kryesisht nga zbatimi i drejtpërdrejtë i legjislacionit të BE-së, i cili nuk kërkon transpozim në legjislacionin kombëtar.

Acquis në këtë fushë është produkt kryesisht i angazhimeve tregtare shumëpalëshe dhe dypalëshe të Bashkimit Evropian si dhe i një sërë masash autonome tregtare. Në fushën e kredive të eksportit dhe mallrave me përdorim të dyfishtë, disa elemente të *acquis* kërkojnë përgatitje më të hershme për të pasur një administratë plotësisht të aftë që nga dita e anëtarësimit. Vendeve kandidate u kërkohej të harmonizojnë në mënyrë graduale politikën tregtare ndaj vendeve të treta dhe organizatave ndërkombëtare, me politikën dhe qëndrimet e miratuara nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet Anëtare të tij, në mënyrë që të jenë në gjendje të zbatojnë politikën e përbashkët tregtare të BE-së në datë e anëtarësimit. Në fushën humanitare dhe të zhvillimit tregtar, Shtetet Anëtare duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe me angazhimet ndërkombëtare të BE-së si dhe të sigurojnë kapacitetet për të marrë pjesë në zhvillimet dhe politikën humanitare të Bashkimit Evropian.

30.4 Situata aktuale në Shqipëri

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur për anëtarësim në këtë kapitull. Ky vlerësim është i njëjtë me atë të vitit 2019. Niveli i përparimit të arritur gjatë periudhës raportuese është i njëjtë me atë të vitit 2019. Pati njëfarë përparimi me kryesimin e suksesshëm të CEFTA nga Shqipëria, miratimin e Protokollit 6 të CEFTA-s për liberalizimin e tregtisë së shërbimeve, me njohjen reciproke të Operatorëve Ekonomike të Autorizuar (OEA) dhe me ratifikimin e Protokollit 5 të CEFTA-s.

Ajo është anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë nga shtatori i vitit 2000 dhe politika e saj tregtare ndjek parimet dhe rregullat e kësaj organizate. Shqipëria ka përafruar legjislacionin e saj të brendshëm me atë të BE-së në fushën e importit të mallrave, ndihmës shtetërore, prokurimit publik, aviacionit civil, subvencioneve etj., në përputhje me angazhimet e saj në këtë organizatë.

Vendi kryesoi suksesshëm CFFTA (Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë me Vendet e Evropës Qendrore) duke arritur progres me miratimin e Protokollit Shtesë të CEFTA (AP) 6 mbi liberalizimin e tregtisë së shërbimeve, me njohjen reciproke të Operatorëve Ekonomike të Autorizuar Kombëtarë (AEO) dhe me ratifikimin e CEFTA AP 5.

Në lidhje me Politikën e Përbashkët Tregtare (PPT), Shqipëria koordinon pozicionet dhe i harmonizon politikën e saj me ato të BE-së, duke përfshirë dhe Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT).

Sekretariati teknik i Komiteti Kombëtar për Koordinimin dhe Lehtësimin e Politikave Tregtare (KKKLPT) është rikompozuar me përfaqësues të Sektorit për Çështjet e Tregtisë në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, i cili po koordinon punën për mbledhjen e radhës. Për më tepër, është përgatitur një raport monitorimi mbi Lehtësimin e Tregtisë. Website i KKKLPT-së është funksional (<http://tregtia.gov.al/index.php/sq-al/>).

Në vijim të mbledhjes së dhjetor 2019, në muajin korrik 2020 u miratua urdhri i Kryeministrit nr. 104, datë 7.8.2020, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të koordinimit të politikës tregtare dhe lehtësimin të tregtisë”. Aktualisht është duke u rikompozuar përbërja e këtij komiteti dhe monitorimi i masave të parashikuara në Planin Kombëtar për Koordinimin e Politikave Tregtare dhe Lehtësimin e Tregtisë 2017- 2020.

Shqipëria po zbaton marrëveshjen e tregtisë së lirë me Bashkimin Evropian (pjesë e MSA-së) midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, vendeve të Evropës Lindore (CEFTA 2006), vendeve të EFTA-s dhe Turqisë. Shqipëria, si zyra e kryesuese për vitin 2019, ka marrë pjesë dhe ka kontribuar në mënyrë konstruktive në të gjitha takimet dhe aktivitetet e CEFTA-s.



Protokolli shtesë AP 6, “Për tregtinë në shërbime” u miratua në muajin prill të viti 2020 me ligjin nr. 46/2020, “Për ratifikimin e protokollit shtesë 6 të marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në marrëveshjen e tregtisë së lirë të Evropës Qendrore”.

Me miratimin e ligjit nr. 82/2020 u ratifikua ndryshimi Protokollit II-të të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë” të ratifikuar me Ligjin Nr. 9733 datë 14.5.2007, në lidhje me përkufizimin e konceptit “produkte origjinuese” dhe “metoda e bashkëpunimit administrativ”. Aktualisht, MFE-ja është në konsultim me Unionin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë si dhe Ministrisë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për hartimin e listës së produkteve bujqësore për të cilat do të negociohen koncesione të mëtejshme me palën turke.

Gjatë muajve korrik–tetor 2020, Shqipëria ka qenë pjesë aktive e konsultimeve për hartimin e Planit shumëvjeçar të krijimit të një Zone Ekonomike Rajonale MAP REA 2. Me miratimin e tij, Shqipëria do të krijojë instrumentet e duhura për zbatimin dhe monitorimin e realizimit të këtij plani.

Gjatë vitit 2020, Shqipëria ka vijuar me plotësimin e detyrimeve të saj për të bërë notifikimet në Organizatën Botërore të Tregtisë.

Në fushën e kontrollit të eksportit për artikujt me përdorim të dyfishtë, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE), në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes është struktura përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit për mallrat me përdorim të dyfishtë.

Korniza ligjore përbëhet nga ligj nr. 46/2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, që përafron pjesërisht Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 428/2009 datë 5 maj 2009, “Mbi vendosjen e një regjimi komunitar për kontrollin e eksportit, transferimit, ndërmjetësimit dhe transitit të mallrave me përdorim të dyfishtë”.

Legjislacioni që ka të bëjë me Rregulloren (BE) 2019/125 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16.1.2019, “Për tregtinë e disa mallrave që mund të përdoren për dënimin me vdekje, torturën apo trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore apo trajtime ose dënime poshtëruese” i ndryshuar është në proces hartimi dhe synohet të përafrohet plotësisht nga projektligji, “Për tregtimin e

produkteve që mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore ose degraduese” dhe projektvendimi, “Për miratimin e listës së mallrave të cilat mund të përdoren për dënim kapital, torturë ose trajtim ose ndëshkim tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues”. Projektligji gjatë vitit 2021 do të konsultohet edhe me shërbimet e Komisionit Evropian.

Në lidhje me marrëveshjet dypalëshe të bashkëpunimit ekonomik dhe teknik, Shqipëria ka nënshkruar 45 marrëveshje/memorandume bashkëpunimi ekonomik dhe teknik, me vende të ndryshme si Arabia Saudite, Argjentina, Austria, Belgjika, Çeki, Greqia, Hungaria, Izraeli, Japonia, Katari, Kina, Kroacia, Koreja e Jugut, Kuvajti, Libia, Rumania, Rusia, Serbia, Sllovenia, Sllovakia, Suedia; Turqia, Ukraina, Uruguai, SHBA dhe Zvicra.

45 marrëveshje dypalëshe të investimeve BITS, nga të cilat 23 janë nënshkruar me Shtetet Anëtare të BE-së.

Po vijohet me rakordimin dhe me procedurat për lidhjen e marrëveshjeve si më poshtë:

- Marrëveshja e partneritetit, bashkëpunimit dhe tregtisë me Mbretërinë e Bashkuar-në proces të konsultimeve të brendshme të Grupit Negociator;

- Vijimi i procedurave ligjore për lidhjen e projekt marrëveshjes për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve me Arabinë Saudite-dërguar komentet e palës shqiptare, palës saudite nëpërmjet kanaleve diplomatike, dhe pritet qëndrimi i palës saudite.

Në fushën e politikës së zhvillimit dhe të ndihmës humanitare, Shqipëria nuk ka ende një kuadër politik ose ligjor, si dhe asnjë institucion apo njësi specifike për menaxhimin e ndihmës për zhvillim apo ndihmave humanitare. Ai siguron ndihmë humanitare vetëm në baza *ad hoc* si përgjigje ndaj fatkeqësive natyrore të rënda ose situatave të jashtëzakonshme humanitare. Kjo ndihmë jepet drejtpërdrejtë në mbështetjen përkatëse të buxhetit të shtetit. Ligji i vitit 2001 për organizatat jofitimprurëse njeh aktivitetet e mundshme të organizatave të tilla në fushën e ndihmave humanitareve dhe i lejon ata të kryejnë veprimtari zhvillimi dhe ndihme humanitare në Shqipëri dhe diku tjetër.

30.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Shqipëria tashmë po zbaton marrëveshjen e tregtisë së lirë me Bashkimin Evropian (pjesë e



MSA-së) midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, vendeve të Evropës Lindore (CEFTA 2006), vendeve të EFTA-s dhe Turqisë. Shqipëria, në kuadër të Kryesimit të Marrëveshjes CEFTA për vitin 2019, ka kontribuar në mënyrë konstruktive duke miratuar në parim dy dokumente të rëndësishme:

i. vendimin për njohjen e përbashkët për statusin AEO; si dhe

ii. protokollin shtesë 6 mbi tregtinë në shërbime. Këto dokumente do të hynë në fuqi pasi të miratohen në Komitetin e Përbashkët Ministerial.

Negociatat mbi liberalizimin e tregtisë në shërbime janë përfunduar. Në mbledhjen e Komitetit të Përbashkët Ministror të CEFTA-s më datë 18 dhjetor 2019, u miratua Protokollin Shtesë 6 “Tregtia në Shërbime”.

Në lidhje me Protokollin Shtesë 7, mbledhja rajonale e grupit negociator u zhvillua në Mars të vitit 2019. Mbledhja e radhës së grupit negociator u zhvillua në datë 29 tetor 2020. Gjithashtu, gjatë Komitetit të përbashkët ministror, i cili përmbylli dhe Kryesimin e Shqipërisë në CEFTA u miratuan dhe Vendimet e mëposhtme:

- vendimi mbi njohjen reciproke të statusit AEO;

- strategjia e Menaxhimit të Riskut në dogana.

Në lidhje me zbatimin e angazhimeve për AEO, janë zhvilluar fushata sensibilizimi me përfaqësuesit e biznesit dhe dhomat e tregtisë në lidhje me kërkesat për autorizime për OEA. Si rezultat i kësaj fushate kemi 9 kërkesa për autorizim për OEA, të cilat janë në proces të shqyrtimit dhe kompletimit të dokumentacionit. Me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Doganave është ngritur grupi i punës për të marrë në shqyrtim aplikimet e Operatorëve Ekonomik për OEA-të me qëllim verifikimin e përmbushjes së kushteve dhe kritereve të parashikuara nga kuadri ligjor e nën ligjor në fuqi. Është bërë plan kontrolli për 4 kompani nga data 28.9.2020 deri me 18.10.2020.

Në fushën e kontrollit të eksportit për artikujt me përdorim të dyfishtë, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE), në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes është struktura përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit për mallrat me përdorim të dyfishtë. Aktualisht janë miratuar:

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 91 datë 26.2.2019, “Për miratimin e listës së përditësuar të

mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare” që përaftron plotësisht Aneksin 1 të Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2017/2268 të datës 26.9.2017, e cila ndryshon Rregulloren e Këshillit të (KE) nr. 428/2009 dhe krijon regjimin e komunitetit për kontrollon e eksporteve, transferimin, ndërmjetësimin dhe transitin e mallrave me përdorim të dyfishtë”;

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 31 datë 22.1.2020, “Për organizimin, funksionimin dhe statusin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, përcaktimin e procedurës për shkëmbimin e informacionit dhe marrjes së mendimit nga institucionet e tjera të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara, si përcaktimin e procedurave lidhur me lëshimin e garancive dhe kryerjen e kontrollit shtetëror”.

Ky vendim ka miratuar:

- Statusin, organizimin, përbërjen dhe funksionimin të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve;

- Afatet, mënyrën dhe të procedurën për shkëmbimin e informacionit dhe të marrjes së mendimit nga institucionet e tjera të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara;

- Procedurat për lëshimin e garancive dhe kryerjen e kontrollit shtetëror.

Shqipëria së fundi, ka miratuar dhe nënshkruar disa Marrëveshje dhe Memorandume, Bashkëpunimi ekonomik e teknik specifikisht:

- Protokollin e Komisionit të Përbashkët Ekonomik me Turqinë, nënshkruar në Ankara në datën 24 janar 2020;

- Protokollin e Komisionit të Përbashkët Ekonomik me Çekinë, nënshkruar në Pragë në datën 20 shkurt 2020;

- Memorandumin e Bashkëpunimit Ekonomik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, “Për projektet dhe blerjet në Shqipëri”, nënshkruar në datën 3 tetor 2020 në Tiranë.

Për arsye të pandemisë globale:

- zhvillimi i Komisionit të Përbashkët Ekonomik me Hungarinë, parashikuar për t'u zhvilluar në datat 11- 12 Mars në Budapest është shtyrë për një periudhë të dytë;



- zhvillimi i Komisionit të Përbashkët Ekonomik me Austrinë, parashikuar për t'u zhvilluar në datat 8–10 qershor 2020, në Tiranë është shtyrë për t'u zhvilluar gjatë muajt shkurt 2021; si dhe

- zhvillimi i Komisionit të Përbashkët Ekonomik me Ukrainën, ku pritet të nënshkruhet rregullorja e përbashkët me palën ukrainase, është shtyrë për një afat të pacaktuar.

Në kuadër të zbatimit të agjendës rajonale të reformës së investimeve (RIRA), në bashkëpunim me IFC/WB është hartuar me ekspertët e BB, edhe një model i BIT për Shqipërinë, që është ende në fazën e diskutimeve të brendshme, për të vijuar me miratimin final.

Miratimi në vitin 2015 i Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm siguron një kornizë të unifikuar politike të nevojshme për të mundur të bëjmë zgjedhjet e duhura; për të kapërcyer krizat; dhe për të krijuar një botë të qëndrueshme. Me një parim të qartë se të gjithë qytetarët (duke mos lënë askënd pas) duhet të përfshihen në zhvillimin e qëndrueshëm nëpërmjet arritjes së 17 Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ/SDG) dhe 169 synimet e tyre themelore, duke marrë parasysh faktin që Shqipëria është përpara hapjes së negociatave me BE-në, OZHQ/SDG-të duhet të konsiderohen gjithashtu nën perspektivën e Integritimit në BE.

Në mënyrë që të sinkronizohet vizioni 2030 me zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim (SKZHI) dhe të sigurohet sinergji të dyja proceseve, kërkohen përpjekje të mëtejshme për të integruar OZHQ/SDG në SKZHI (III), si dhe strategjitë e sektorëve përkatës, politikat dhe planet kombëtare. Një proces planifikimi për hartimin e SKZHI III, i filluar tashmë, synon të përgatisë vizionin afatmesëm për kornizën e planifikimit strategjik të Shqipërisë duke përfshirë kornizën OZHQ/SDG-ve në proces. Planifikohet që Vizioni 2030 të projektohet dhe prezantohet së bashku me SKZHI III.

30.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (si përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e politikave tregtare në Shqipëri);

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; dhe çdo ministri apo institucion që ndikon në tregti;

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

- Ministria për Evropën dhe Punëve të Jashtme;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Brendshme;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri;

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
- Banka e Shqipërisë;
- Autoriteti i Konkurrencës;
- Agjencia e Prokurimit Publik;
- Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave Tregtare.

30.7 Prioritetet

Në rekomandimet e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020, Shqipëria në veçanti duhet të:

- Të forcojë kapacitetin e përgjithshëm administrativ të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që merret me tregtinë me BE, OBT dhe CEFTA;

Në lidhje me këtë rekomandim, në drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, janë plotësuar vendet vakante të sektori për Çështjet e Tregtisë, i cili mbulon marrëdhëniet me OBT, zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-asociimit me BE-pjesën e tregtisë së lirë, marrëveshjet Rajonale dhe dypalëshe të Tregtisë së lirë, CEFTA, EFTA, Turqinë etj. Aktualisht, sektori është plotësuar me përgjegjësin e sektorit dhe një specialist. Rekrutimi i specialistit të dytë është në proces nga Departamenti i Administratës Publike:

- të vazhdojë zbatimin e planit kombëtar të veprimit për koordinimin dhe lehtësimin e politikës tregtare;

- të miratojë legjislacionin përkatës në fushën e kontrollit të eksportit të mallrave me përdorim të dyfishtë;

- të zbatojë veprimet sipas planit shumëvjeçar të veprimit për zhvillimin e një zone ekonomike rajonale, në veçanti për zbatimin e CEFTA AP 5 për Lehtësimin e Tregtisë dhe AP 6 për liberalizimin e tregtisë së shërbimeve dhe, përkatësisht, për AEOs;

- të negociojë dhe të përfundojë CEFTA AP 7 për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;

- të miratojë standarde rajonale për Marrëveshjet Ndërkombëtare të Investimeve dhe të ndjekë zbatimin e planit individual të veprimit të reformës për investimet (IRAP).



Sa u përket politikave të përbashkëta tregtare:

- Shqipëria ka vazhduar të koordinojë pozicionet e saj dhe t'i përafrojë plotësisht politikat e saj me ato të BE-së, përfshirë edhe ato në kuadër të OBT-së;

- Shqipëria ka vazhduar të bëjë notifikimet e kërkuara sipas neneve 1.4, 10.6.2 dhe 12.2.2 të Marrëveshjes së OBT-së për Lehtësimin e Shkëmbimeve Tregtare.

Në fushën e mallrave me përdorim të dyfishtë:

- Harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit për kontrollin e eksporteve, transferimit, ndërmjetësimit dhe transitit të artikuljeve me përdorim të dyfishtë dhe në Listën Ushtarake të Përbashkët të Bashkimit Evropian (rregullorja e BE 2017/2268) u ndoq nga vendimi i marrë nga Qeveria në muajin shkurt. Shqipëria ka miratuar tashmë listën kombëtare të kontrollit të mallrave me përdorim të dyfishtë në përputhje me aktet normative të BE-së;

- Përditësimi i listës së mallrave me përdorim të dyfishtë e cila pritet të miratohet nga Bashkimi Evropian brenda vitit 2020 dhe transpozimi i saj nga Shqipëria brenda vitit 2021.

- Transpozimi i legjislacionit me aktet normative të BE-së Për sa i përket tregtisë së mallrave të caktuara, të cilat mund të përdoren për dënim kapital, torturë ose ndëshkim dhe trajtim tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues.

Në lidhje me marrëveshjet dypalëshe me vende të treta:

- Negociatat për ndryshimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë me Turqinë vazhdojnë, duke u fokusuar në përfshirjen e specifikimeve që lidhen me tregtinë në shërbime dhe investime;

Zbatimi i një plan veprimi shumëvjeçar për zhvillimin e një Zone Ekonomike Rajonale në Ballkanin Perëndimor; pas rakordimit nga të gjitha vendet WB6 do të vijohet me ndjekjen e procedurave ligjore të mëtejshme për adaptimin zyrtar të standardeve rajonale të pranuar nga WB6, për negociimin e IIA-ve., bazuar te RIRA

Në fushën e zhvillimit të bashkëpunimit dhe ndihmës humanitare:

- Prioritet është miratimi i një dokumenti të politikës për të trajtuar çështjet e krijimit të strukturës strategjike, ligjore dhe institucionale në mënyrë që të jenë në përputhje me kërkesat e BE-së.

KAPITULLI 31

POLITIKA E JASHTME, E SIGURISË DHE E MBROJTJES

31.1 Përmbajtja e kapitullit

Vendet anëtare duhet të jenë në gjendje të zhvillojnë dialogun politik në përputhje me politikën e jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes së BE-së, të linjëzohen me deklaratat e BE-së, të marrin pjesë në veprimtarinë e BE-së dhe të aplikojnë sanksionet dhe masat kufizuese të dakordësuara. Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (CFSP) dhe Politika Evropiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes (ESDP) bazohen në akte juridike, përfshirë marrëveshje ndërkombëtare detyruese dhe në dokumente politike. *Acquis* përbëhet nga deklaratat, veprime dhe marrëveshje politike.

31.2 Struktura e kapitullit

1. Dialogu politik
2. Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare
3. Kontrolli i armëve
4. Zbatimi i masave kufizuese dhe sanksioneve ekonomike
5. Lufta kundër terrorizmit
6. Politika evropiane e sigurisë dhe mbrojtjes

31.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Marrëveshja e Stabilizim-asociimit që në preambul të saj thekson dëshirën e përbashkët për të zhvilluar më tej një dialog politik të rregullt për çështje dypalëshe dhe ndërkombëtare me interes të ndërsjellë, përfshirë aspektet rajonale, duke pasur parasysh Politikën e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët të Bashkimit Evropian.

Neni 8 “Dialogu Politik” përcakton se dialogu politik ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian zhvillohet më tej brenda kontekstit të MSA-së dhe do të zhvillohet në drejtim të konsolidimit të marrëdhënieve ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë dhe do të kontribuojë në vendosjen e lidhjeve të ngushta të solidaritetit dhe formave të reja të bashkëpunimit.

Pika 3 e nenit 8 në pjesën “Dialogu Politik” përcakton se Shqipëria dhe BE bien dakord të bashkëpunojnë dhe kontribuojnë kundër përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe të mjeteve për shpërndarjen e tyre, nëpërmjet respektimit të plotë dhe zbatimit në nivel kombëtar të detyrimeve të tyre ekzistuese, detyrime këto që rrjedhin nga traktate dhe marrëveshje ndërkombëtare për



çarmatimin dhe mospërhapjen, si dhe detyrime të tjera ndërkombëtare.

Për sa u përket *Armëve të shkatërrimit në masë*, strategjia e BE-së thekson rëndësinë e të vepruarit me qëllim zgjidhjen, parandalimin, frenimin, ndalimin dhe eliminimin e programeve të shtimit dhe shumimit të armëve të shkatërrimit në masë dhe raketave. BE është e angazhuar në sistemin e traktatit shumëpalësh, i cili siguron bazën ligjore dhe normative për të gjitha përpjekjet për mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë. Politika e BE-së synon të ndjekë zbatimin dhe universalizimin e normave ekzistuese të çarmatimit dhe mospërhapjes të armëve. Për këtë qëllim, Shqipëria do të vijojë punën dhe do iu bashkohet përpjekjeve të BE-së për universalizimin e NPT (Traktati i Mos-përhapjes), marrëveshjeve të Mbrojtjes të IAEA (Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike) dhe protokolleve shtesë të tyre, CWC (Konventa e Armëve Kimike), BTWC (Konventa e Armeve Biologjike dhe Toksike), HCOC (Kodi i Sjelljes së Hagës (kundër Përhapjes së Raketave Balistike)) si dhe hyrjen e hershme në fuqi të CTBT (Traktati Gjithëpërfshirës i Procesit të Ndalimit të Provës Bërthamore).

Politika e BE-së synon të punojë drejt përcaktimit të ndalimit të armëve biologjike dhe kimike si rregulla universale të së drejtës ndërkombëtare. Politika e BE-së synon të arrijë një marrëveshje ndërkombëtare për ndalimin e prodhimit të materialit të zbrëthyesëm për armë bërthamore ose pajisje të tjera shpërthyes bërthamore. BE do të ndihmojë vendet e treta në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas konventave dhe regjimeve multilaterale.

Neni 12 “Bashkëpunimi Rajonal” përcakton se në përputhje me angazhimet e saj për paqen dhe stabilitetin ndërkombëtar e rajonal, si dhe për zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, Shqipëria duhet të promovojë bashkëpunimin rajonal në mënyrë aktive.

Detyrimi për përafrimin e legjislacionit shqiptar në fushën e informacionit të klasifikuar me atë të Bashkimit Evropian rrjedh nga neni 70 i MSA-së.

31.4 Situata aktuale në Shqipëri

Dialogu politik

Dialogu politik ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë për çështjet e politikës së jashtme e të sigurisë ka vijuar.

Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare

Faqe | 4246

Shqipëria ka vijuar të angazhohet në mënyrë aktive në proceset rajonale dhe ndërkombëtare për shkëmbimin e informacionit dhe praktikat e mira në fushën e armëve të vogla dhe të lehta.

Hapi i radhës për Shqipërinë do të ishte që të fillojë sigurimin e përputhshmërisë me Marrëveshjen e Uasenarit, si pjesë integrale e rekomandimeve të Komisionit Evropian për Shqipërinë, në lidhje me Kapitullin 31. Instrumenti “*Wassenaar Arrangement*” është një marrëveshje globale shumëpalëshe e ngritur me qëllim për të kontribuar në sigurinë dhe stabilitetin rajonal dhe ndërkombëtar përmes nxitjes së transparencës dhe përgjegjësisë në transferimin e armëve konvencionale, si edhe mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë, duke parandaluar akumulimet e rrezikshme destabilizuese. Kjo marrëveshje synon gjithashtu të parandalojë zotërimin dhe përdorimin e këtyre armëve nga grupet terroriste.

Për nga vetë natyra specifike e këtij instrumenti, është e pamundur të përcaktohen saktë afatet mbi masat që do merren për arritjen e këtij objekti. Ndërkohë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Mbrojtjes kanë filluar tashmë procesin e koordinimit dhe konsultimit për përmbushjen e kriterëve për aderim dhe realizimin e procedurave përkatëse, të cilat përfshijnë aspektin teknik që do të ndiqet nga Ministria e mbrojtjes, ashtu edhe atë politik që do të realizohet nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Shqipëria vijoi pjesëmarrjen aktive në organizatat ndërkombëtare. Ka mbajtur prani të qenësishme në një sërë misionesh të NATO-s, përfshirë disa misione me rëndësi strategjike për BE-në (p.sh. Grupi Detar i NATO-s në detin Egje).

Shqipëria ka marrë kryesinë e Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë në vitin 2020 dhe është një vend kandidat për anëtar jo të përhershëm në Këshillin e Sigurimit të OKB në 2022 –2023. Duke kryesuar OSBE-në këtë vit, Shqipëria po inkurajon zbatimin e plotë të të gjitha parimeve dhe angazhimeve të OSBE-së, për të rritur transparencën ushtarake, për të zvogëluar rreziqet dhe për të rindërtuar besimin në shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së.

Dialogu për të drejtat e njeriut

Shqipëria ka ratifikuar shumicën e instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të



njeriut dhe qëndron e angazhuar për të kontribuar në mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Shqipëria vazhdon të ndjekë në përgjithësi linjën e BE-së në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Këmbimet e rregullta me Delegacionin e BE-së brenda Këshillit për të Drejtat e Njeriut kanë rezultuar shumë efektive për veprimet e koordinuara për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Shqipëria vazhdon angazhimin e saj në mbështetje të multilateralizmit.

Shqipëria paraqiti në maj të vitit 2019 një raport gjithëpërfshirës kombëtar mbi zbatimin e

Deklaratës të Pekinit dhe Platformës së Veprimit (1995). Viti 2020 është një vit thelbësor për realizimin e përsheptuar të barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave.

Një plan ndërinstitucional i veprimit (2018–2020) për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të KB u miratua në shtator 2018, ndërsa në janar 2020 u prezantua raporti i parë i vlerësimit për zbatimin e Planit të Veprimit.

Gjatë vitit 2020, Shqipëria ka harmonizuar pozicionin e saj me deklaratat e BE-së në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut në të gjitha vendet e treta përkatëse.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në organizata rajonale

Organizata rajonale	Data e pranimit
Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP)	1996
Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC)	27 shkurt 2008
Iniciativa e Evropës Qendrore (CEI)	1996
Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ/BSEC)	25 qershor 1992
Nisma Adriatiko-Jonian e (AII)	20 maj 2000
Nisma Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI)	2003
RACVIAC (Qendra Rajonale e Verifikimit të Armë- Kontrollit)	20 shtator 2000
SHBA - Karta e Adriatikut (A-5)	2 maj 2003
Fondi i Ballkanit Perëndimor (selia në Tiranë)	13 nëntor 2015
Task-Forca Mjekësore e Ballkanit (BMTF)	Nëntor 2011
Iniciativa Rajonale Detare “ADRION”	20 maj 2000
Ministeriali i Mbrojtjes i Evropës Juglindore (SEDM)	1996

Pjesëmarrja e Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare

Organizata ndërkombëtare	Data e pranimit
UN - Kombet e Bashkuara	14 dhjetor 1955
OSBE	20 qershor 1991
Këshilli i Evropës	13 korrik 1995
IAEA - Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike	29 korrik 1957
CTBTO - Organizata për Parandalimin Gjithëpërfshirës të Testeve Nukleare	1996
IOF - Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë	1999
UNAOC - Aleanca e Qyteteve të Kombeve të Bashkuara	2005
UNESCO - Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara	1958
IACA - Akademia Ndërkombëtare për Antikorrupsionin	21 shtator 2011
Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior NATO	4 prill 2009

Bashkëpunimi rajonal dypalësh dhe shumëpalësh



Prioriteti kryesor i politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë në rajon është promovimi dhe kontributi në stabilitetin politik, paqen, sigurinë dhe zhvillimin ekonomik përmes bashkëpunimit si në nivelin dypalësh dhe në atë shumëpalësh. Një rajon i sigurt dhe politikisht i qëndrueshëm që zhvillon lidhje të duhura ekonomike brenda tij, dhe me pjesën tjetër të botës, u shërben interesave kombëtarë të Shqipërisë, por është, gjithashtu, në interes të të gjitha vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor dhe të fqinjëve tanë.

Duke qenë një pjesëmarrëse aktive e Procesit të Berlinit, Republika e Shqipërisë është e angazhuar që qytetarët e Ballkanit Perëndimor të gëzojnë katër liritë themelore të BE-së (lëvizja e lirë e mallrave, kapitalit, shërbimeve dhe personave). Për këtë qëllim, Qeveria Shqiptare ka promovuar iniciativën e bashkëpunimit të zgjeruar rajonal që aktualisht ka tre pjesëmarrës (Republika e Shqipërisë, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Republika e Serbisë), por që mbetet e hapur për pjesëmarrjen e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor (Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Republika e Kosovës). Një fakt inkurajues është që Qeveria e Republikës së Kosovës ka deklaruar vullnetin e saj për t'iu bashkuar kësaj nisme. Pritet që Samiti në Sofje në nëntor të marrë vendime të rëndësishme në këtë drejtim.

Në prill të vitit 2019 Shqipëria priti Samitin Brdo-Brijuni, ndërsa në gjashtë muajt e parë të 2021 do të kryesojë organizatën e Bashkimit Ekonomik të Detit të Zi. Shqipëria pret dy mekanizma rajonalë të bashkëpunimit: Fondi i Ballkanit Perëndimor dhe Zyra Rajonale e Bashkëpunimit Rinor.

Republika e Shqipërisë nuk ka mosmarrëveshje kufitare, apo ndonjë çështje tjetër kritike dypalëshe të pazgjidhura me vendet e saj fqinje.

Kontrolli i armëve

Shqipëria miratoi në shkurt 2019 një strategji të re kombëtare për armët e vogla dhe të lehta për periudhën 2019- 2024. Gjithashtu, miratoi planin e saj të veprimit për 2019- 2021. Shqipëria nënshkroi “Udhërrëfyesin rajonal për zgjidhje të qëndrueshme për mbajtjen e paligjshme, keqpërdorimin dhe trafikimin e armëve të vogla dhe të lehta dhe municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor deri në vitin 2024”, në Samitin e Londrës në shkurt të 2018.

Shqipëria ka bërë përmirësime të mëtejshme në sigurinë e ambienteve të magazinimit për armatimet dhe municionet. Përforcimi i sigurisë së depos qendrore të armatimit të Policisë së Shtetit në Mullet përfundoi në shtator. Gjithashtu, ka përfunduar përforcimi i sigurisë i dy sallave të shërbimit të provës në drejtoritë e policisë në Tiranë dhe Durrës. Pastrimi i pikave të nxehta të kontaminuara me armatura të pashpërthyer është duke u zhvilluar.

Në këtë drejtim, Komisioni Kombëtar për Armët e Vogla dhe Armët e Lehta mori pjesë në Takimin e 3-të Rajonal të Koordinimit të Udhërrëfyesit më 3 korrik 2020. Këto takime mbahen si pjesë e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Bashkimit Evropian 2018/1788/CFSP në mbështetje të zbatimit të Udhërrëfyesi Rajonal për luftimin e trafikut të paligjshëm të armëve në Ballkanin Perëndimor.

Zbatimi i masave kufizuese dhe i sanksioneve ekonomike

Në tetor 2019 u miratua një ligj mbi masat kufizuese ndërkombëtare, i cili siguron një bazë të re ligjore për zbatimin e sanksioneve të BE, OKB-ja dhe sanksioneve të tjera ndërkombëtare. Në qershor të vitit 2020, u miratua një vendim i Këshillit të Ministrave për zbatimin e dispozitave të Ligjit Nr. 72.2019, “Për masat kufizuese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Lufta Kundër Terrorizmit

Qendra e Koordinimit për Luftimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (Qendra CVE) që nga fillimi i punës institucionale në vitin 2018 funksionon në përputhje me “Strategjinë Kombëtare për Luftimin e Ekstremizmit të Dhunshëm”. Drejtimi i Qendrës CVE në Shqipëri është drejtuar kryesisht drejt promovimit dhe avancimit të fokusit të rolit arsimor në forcimin e paqes dhe sigurisë kombëtare në parandalimin, mos- angazhimin dhe rehabilitimin/rriintegrimin e qytetarëve shqiptarë në luftimin e fenomeneve të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që çon në terrorizëm (VERLT). Shqipëria, pavarësisht se është një vend i vogël është njohur globalisht si shembulli më i mirë i harmonisë fetare. Sidoqoftë, ende nuk ka qenë immune ndaj këtyre fenomeneve që paraqesin një rrezik të madh për kohezionin dhe vlerat e shoqërisë shqiptare dhe rajonit të Ballkanit Perëndimor.



Një studim i rreziqeve hibride filloi me dorëzimin e kontributit të saj në studimin e rrezikut hibrid të BE-së në gusht 2019 si pjesë e një procesi që synon identifikimin e dobësive ndaj kërcënimeve hibride dhe mobilizimin e instrumenteve të mundshëm të BE për të ndërtuar kapacitete dhe forcuar qëndrueshmërinë.

Politika Evropiane e Sigurisë dhe e Mbrojtjes

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë kanë struktura të përshtatshme për të marrë pjesë në politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, si dhe në politikën e përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes. Në fushën e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë (CFSP), Shqipëria mbështet Strategjinë Globale për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian. Shqipëria i është bashkuar të gjitha vendimeve të Këshillit dhe deklaratave të Përfaqësuesit të Lartë në emër të BE-së, kur i është kërkuar (100% përputhje).

31.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Dialogu politik

Dialogu politik midis BE dhe Shqipërisë për çështjet e politikës së jashtme dhe të sigurisë vazhdoi, duke përfshirë angazhimin aktiv të Shqipërisë në dialogun rajonal të BE me Ballkanin Perëndimor në nivelin e drejtorëve politikë.

Shqipëria u bashkua me iniciativën e Bashkëpunimit të Përmirësuar në kuadër të Procesit të Stabilizim-asociimit (ECSAP), i cili do të sigurojë mbështetje politike për procesin e bashkëpunimit rajonal në kuadrin e PSA, duke u fokusuar në fushën e sundimit të ligjit, qeverisjes ekonomike dhe konektivitetit.

Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare

Ministria e Mbrojtjes është e angazhuar në iniciativën rajonale Ministeriale për Mbrojtjen e Evropës Juglindore (SEDM), i cili përfshin Iniciativën e Forcës Shumëkombëshe për Paqeruajtje në Evropën Juglindore (MPFSEE) dhe Brigadën e Evropës Juglindore (SEEBRIG) si dhe një sërë projektesh të tjera. Në këtë kuadër, gjatë periudhës 2019–2021 Ministria e Mbrojtjes ka drejtimitin e kësaj iniciative duke ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e rolit dhe vizibilitetit të vendit tonë në rajon.

Brenda kornizës së NATO-s, Forcat e Armatosura Shqiptare dhe personeli civil i Ministrisë së Mbrojtjes kanë marrë pjesë në disa misione dhe operacione. Konkretisht në Forcën

Ndërkombëtare të Ndhmës së Sigurisë (ISAF)/Misionin e Mbështetjes së Vendosur (RSM) në Afganistan, në praninë e përparuar të NATO-s (eFP) në Letoni, në aktivitetet e NATO-s në Detin Egje, operacionet e IFOR dhe SFOR të drejtuara nga NATO në Bosnjë dhe Hercegovina, dhe në operacionin e udhëhequr nga NATO, KFOR në Kosovë dhe në Ekipin Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALI) në Kosovë.

Brenda kornizës së OKB, Forcat e Armatosura Shqiptare kanë marrë pjesë në misionin “UNMISS”, në Sudanin e Jugut, Afrikë, Misionin Vëzhgues në Gjeorgji (UNOMIG) dhe Misionin në Republikën e Afrikës Qendrore dhe Çad (MINURCAT).

Kontrolli i armëve

Mospërhapja e Armëve të Dëmtimit në Masë (C-WMD)

Shqipëria nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 33, datë 22.1.2020, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Shkatërrimeve Masive (DMD) dhe Planit të saj të Veprimit” miratoi Strategjinë Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Shkatërrimeve Masive, duke përmbushur detyrimet e Republikës së Shqipërisë dhe institucioneve shtetërore të saj, në zbatim të përgjegjësisë që burojnë nga Rezoluta 1540 e KS të OKB-së për ndalimin e përhapjes së Armëve të Dëmtimit në Masë (ADM-së) në nivel rajonal dhe global.

Shqipëria bashkë-sponsorizoi vendimin “Adresimi i posedimit dhe përdorimit të armëve kimike nga Republika Arabe Siriane” i miratuar nga Këshilli Ekzekutiv i OPCW në 9 korrik 2020 mbi masat e marra kundër Sirisë në rast të shkeljes së Konventës së Armëve Kimike.

Si një anëtare e NATO-s dhe kandidate për BE, Shqipëria do të vazhdojë të inkurajojë, mbështesë dhe forcojë më tej politikën e saj të kontrollit të armëve, çarmatimit dhe mospërhapjen e armëve, si elemente kryesore të sigurisë euroatlantike si edhe globale. Shqipëria vazhdon të mbështesë përpjekjet për dialog brenda Këshillit NATO-Rusi, për zvogëlimin e rrezikut të Rusisë dhe rritjen e transparencës së saj. Mirëpritet çdo përgjigje nga Rusia për përmbushjen e detyrimeve të Traktatit të Qiejve të Hapur, i cili do të bënte të mundur që Shtetet e Bashkuara të mos tërhiqeshin nga ky Traktat.

*Mbi armët e vogla dhe të lehta*

Programi i Punës i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nr. 584, “Për zbatimin e Objektivave të Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municionit dhe Eksplozivëve 2019–2024 dhe Planit të Veprimit 2019–2021” është miratuar në 24 janar 2020. Bazuar në VKM-në nr. 50, me urdhër të ministrit të Brendshëm nr. 399, datë 10.5.2019, u ngrit një Grup Pune për ndryshimin e ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, nën drejtimin e Zëvendësministrit të Brendshëm.

Në zbatim të ligjit për Armët, Policia e Shtetit ka ndërmarrë verifikimin dhe regjistrimin në regjistrin kombëtar të të gjitha armëve në pronësi të qytetarëve të cilat janë dorëzuar para hyrjes në fuqi të ligjit 74/2014, “Për Armët”. Regjistrimi i armëve të gjuetisë është një proces i vazhdueshëm. Nga 31 Marsi deri më 15 qershor 2020, u regjistruan 57.26% e shumës totale të 103.062 armëve në pronësi të personave fizikë dhe juridikë në Republikën e Shqipërisë.

Përmirësimi i sigurisë së armatimeve dhe objekteve për ruajtjen e municioneve.

Në zbatim edhe të rekomandimeve të dhëna në Progres Raporte, si pjesë e politikës së saj, Ministria e Mbrojtjes ka vijuar proceset e përmirësimit infrastrukturor dhe sigurisë së objekteve ku mbahen armatime dhe municione ushtarake.

A. Po realizohet rikonstruksion i përgjithshëm në 3 depo (nëntokësore), punime të cilat po realizohen në saj të bashkëpunimit dhe mbështetjes financiare me donator Komandën Amerikane në Evropë (EUCOM).

B. Bashkëpunimi më mbështetje financiare me UNDP/SEESAC:

- Përfundoi me sukses projekti për rritjen e masave të sigurisë fizike në 1 grup depo municioni.
- Përfundoi Projekti për mbështetjen dhe kompletim me armaturave metalike për ruajtjen dhe sigurinë e armëve të vogla dhe të lehta (AVL), në administrimin dhe përdorim të strukturave të komandës së forcave tokësore.

Materialet me përdorim të dyfishtë

Në përputhje me rekomandimet e dhëna nga Komisioni Evropian, Ministria e Mbrojtjes ka bërë një vlerësim paraprak të pjesëmarrjes së Shqipërisë në Rregullimet e Uassennar-it. Në përfundim të këtij procesi vlerësimi, Ministria e Mbrojtjes ka konsideruar pozitivisht mundësinë e anëtarësimit në Republikën e Shqipërisë në Rregullimet e Faqe| 4250

Uassennar-it dhe ka nisur praktikë zyrtare për bashkëpunim të përbashkët për këtë proces me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Zbatimi i masave kufizuese dhe sanksioneve ekonomike

Ligji nr. 72, datë 17.10.2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” është miratuar nga Parlamenti Shqiptar më 17.10.2019. Dispozitat e këtij ligji parashikojnë detyrimin ligjor për implementimin e Rezolutës së OKB-së lidhur me parandalimin, ndërprerjen dhe shkatërrimin e përdorimit të armeve të shkatërrimit në mase dhe financimin e tyre. Ai, gjithashtu, parashikon edhe implementimin e masave shtrënguese të vendosura nga BE-ja apo organizata të tjera ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

Ky ligj nuk përfshin masa kufizuese në lidhje me financimin e terrorizmit, të cilat tashmë janë adresuar nga ligji për Masat kundër Financimit të Terrorizmit.

Lufta kundër terrorizmit

Për sa i përket luftës kundër terrorizmit, vendi ynë është anëtar i koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit dhe vazhdon të mbështesë aleatët dhe partnerët në zonë, duke e konsideruar bashkëpunimin ndërkombëtar në luftën kundër terrorizmit si një përparësi për agjencitë e zbatimit të ligjit. Ekzistojnë kuadri ligjor dhe strukturat e duhura për të parandaluar dhe luftuar çdo kërcënim të sigurisë nga aktet terroriste. Shqipëria është një vend që nuk ka përjetuar akte terroriste dhe viktima, por është përballur me fenomenin e luftëtarëve të huaj terroristë, qytetarë që shkojnë në zonat e konfliktit në Siri/Irak, madje edhe me familjet e tyre, gratë dhe fëmijët, duke u përballur me tmerrin e luftës atje.

Për sa i përket komunikimit midis BE dhe vendeve të treta në fushën e antiterrorizmit, Shqipëria, kur ftohet, përputhet me të gjitha Vendimet dhe Deklaratat e Këshillit të BE. Në këtë kuadër, ne jemi plotësisht dakord me politikën e jashtme të BE-së në luftën kundër terrorizmit, duke pasur parasysh veçanërisht promovimin e dialogut ndërkulturor, qeverisjen e mirë dhe për të trajtuar shkaqet themelore të radikalizimit.

Kapacitetet administrative të strukturave kushtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (PBB) janë shtuar dhe strukturat e reja kushtuar parandalimit të financimit



të terrorizmit në Policinë e Shtetit dhe Bankën e Shqipërisë janë ngritur.

Dokumenti i ri i Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar (Qershor 2019) është miratuar, i cili pasqyron më mirë rreziqet e financimit të terrorizmit në Shqipëri.

Për informacion të mëtejshëm, ju lutem referojuni kapitullit 24, “Drejtesia, liria dhe siguria”.

Politika evropiane e sigurisë dhe mbrojtjes

Angazhimi i Shqipërisë në Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe të Mbrojtjes (CSDP) është në përputhje me orientimet për angazhim aktiv ndërkombëtar në fushën e sigurisë dhe synon vijimin e kontributit për konsolidimin e sigurisë, stabilitetit dhe paqes si në rajon, ashtu edhe në arenën globale.

Shqipëria merr pjesë në misionet ushtarake të menaxhimit të krizave nën Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP). Shqipëria merr pjesë në misionin ushtarak EUFOR ALTHEA në Bosnje-Hercegovinë, si dhe morri pjesë në misionin trajnues EUTM MALI në Mali deri në gjysmën e parë të vitit 2020.

Gjithashtu, në përputhje me prioritetet e Strategjisë Globale të Bashkimit Evropian, në kuadër të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes, Shqipëria do të përfaqësohet me Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Grup Batalionet BE, përkatësisht në Grup Batalionin e 6-mujorit të dytë të vitit 2024 (EUBG 2024-2).

Si pjesë e Nismës së Kartës së Adriatikut në Afganistan, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë vazhduan të kontribuojnë në përfaqësimin e përbashkët të vendeve A-5 në RSM, me dy personel ushtarak që shërbejnë në Qendrën e Situatës së Ndërgjegjësimit dhe Rimëkëmbjes (SAROC) në Komanda e Ndihmës Taktike dhe Këshillimit në Mazar-i-Sharif.

Në përputhje me rekomandimet e dhëna nga Komisioni Evropian, Ministria e Mbrojtjes ka bërë një vlerësim paraprak të pjesëmarrjes së Shqipërisë në Agjencinë Evropiane të Mbrojtjes (EDA). Në përfundim të këtij procesi vlerësimi, Ministria e Mbrojtjes ka shqyrtuar pozitivisht mundësinë e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në EDA dhe ka filluar një praktikë zyrtare për bashkëpunim të përbashkët për këtë proces me Ministrinë e Evropës dhe Punëve të Jashtme.

31.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Ministria e Brendshme;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar;
- SHISH;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- Ministria e Drejtësisë;
- Agjencia Kombëtare Bërthamore;
- Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.

31.7 Prioritetet

Shtetet anëtare duhet të jenë të afta të zhvillojnë dialog politik në kuadrin e politikës së jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes, të jenë në linjë me deklaratat e BE-së, të marrin pjesë në veprimtarinë e BE-së dhe të zbatojnë sanksionet dhe masat shtrënguese të dakordësuara në nivel të Bashkimit Evropian.

Prioritetet në Kapitullin 31 janë si më poshtë:

Në vitin e ardhshëm, vendi duhet të:

- Vënia në funksion e plotë e armëve të zjarrit në Policinë e Shtetit Shqiptar, vazhdimi i zbatimit të strategjisë kombëtare për armët e vogla dhe ato të lehta dhe përmirësimi i mëtejshëm i sigurisë së ambienteve të magazinimit të armatimeve dhe municioneve;

- Shqipëria duhet të vazhdojë të zbatojë strategjinë e sapo miratuar të armëve të lehta dhe të lehta;

- Shqipëria duhet të ndajë me Europol të gjithë informacionin përkatës në lidhje me kthimin e Luftëtarëve të Huaj Terroristë në vendet e tyre të origjinës në mënyrë që të lejojë BE-në të rrisë sigurinë e kufijve të saj;

- Shqipëria duhet të ndjekë penalisht Luftëtarët e Huaj Terroristë ose të marrë masa për rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre kur është e mundur;

- Shqipëria duhet të vazhdojë të trajtojë çështjen e rreziqeve që vijnë nga radikalizimi në burgje;

- Hapi tjetër do të ishte që Shqipëria të fillojë të respektojë Marrëveshjen e Uassenaar;

- Përditësimi i listës së mallrave ushtarake që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare, do të transpozohet legjislacionin e *acquis*.



KAPITULLI 32 KONTROLLI FINANCIAR

32.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli ka të bëjë me miratimin e standardeve, metodave dhe parimeve ndërkombëtare të kontrollit të brendshëm financiar në të gjithë sektorin publik, si dhe kontrollin e shpenzimeve të fondeve të BE-së.

Objektivat kryesorë të kapitullit janë: stabiliteti financiar i Shteteve Anëtare, parandalimi i keqpërdorimit të mjeteve financiare, kontributi në një shpenzim më efikas, të suksesshëm dhe të përgjegjshëm, i cili ofron një mekanizëm të rëndësishëm për të luftuar korrupsionin.

Sistemet e brendshme të kontrollit financiar kontribuojnë në një disiplinë të përmirësuar dhe sigurojnë transparencë në përdorimin e fondeve publike dhe atyre të BE-së, si dhe mbrojtjen e interesave financiarë të BE-së.

32.2 Struktura e kapitullit

1. Kontrolli i brendshëm financiar publik
2. Auditimi i jashtëm
3. Mbrojtja e interesave financiarë të BE-së
4. Mbrojtja e euros nga falsifikimi

32.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Detyrimi i përafrimit të legjislacionit shqiptar në fushën e kontrollit financiar me atë të Bashkimit Evropian rrjedh nga nenet 70, 85 dhe 90 të MSA-së.

Në fushën e mbrojtjes së monedhës euro në zonën e euros dhe më gjerë, ligjet e BE-së kanë qëllim të sigurojnë koordinim të duhur të masave të ndërmarra kundra falsifikimit nga autoritetet kombëtare dhe dënimeve adekuate të falsifikatoreve sipas ligjit penal kombëtar.

Legjislacioni i BE-së përmban dispozita themelore për mbledhjen dhe analizën e të dhënave teknike dhe statistikore lidhur me kartëmonedhat dhe monedhat metalike të falsifikuara dhe për bashkëpunimin mes autoriteteve kombëtare në vendet anëtare të BE-së, Komisionit Evropian, Bankës Qendrore Evropiane, vendeve të treta dhe organizatave ndërkombëtare.

Përcaktimet kryesore:

- Analiza dhe identifikimi—autoritetet në vendet e BE-së, duhet të dërgojnë për identifikim dhe analizë teknike kartëmonedhat dhe monedhat

metalike të falsifikuara në qendrat e tyre kombëtare të Analizës (rregullore 1338/2001 & 1339/2001);

- tërheqja nga qarkullimi—bankat dhe institucionet e kreditit duhet t'i tërheqin nga qarkullimi të gjitha kartëmonedhat dhe monedhat metalike euro të dyshuara të falsifikuara, dhe t'i dorëzojnë ato tek autoritetet kombëtare kompetente (rregullore 1338/2001 & 1339/2001);

- Kontrolli i vërtetësisë — bankat dhe institucionet e kreditit duhet të kontrollojnë vërtetësinë e të gjitha kartëmonedhave dhe monedhave metalike euro që do hidhen në qarkullim (Vendim BQE/2010/14 dhe Rregullore e (KE) nr. 1210/2010)

Dënimet e Kodit Penal

Më 22 maj 2014, ka hyrë në fuqi, direktiva e re 2014/62/BE. Kjo Direktivë ka për qëllim të forcojë mbrojtjen e euros nga falsifikimi me masa ligjore në kodin penal. Direktiva zëvendëson vendimin kuadër 2000/383/JHA, si dhe plotëson e ndihmon në zbatimin e Konventës së Gjenezës të vitit 1929 për ndalimin e falsifikimit. Masat e reja përfshijnë ashpërsimin e sanksioneve për shkelësit e ligjit dhe përmirësimin e mjeteve të hetimit ndërkufitar.

32.4 Situata aktuale në Shqipëri

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në këtë fushë. Njëfarë përparimi është bërë veçanërisht me ratifikimin e konventës ndërkombëtare për ndalimin e monedhave të falsifikuara dhe miratimin e një metodologjie të rishikuar për monitorimin e performancës së kontrollit të brendshëm.

Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik

Kuadri strategjik për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik (KBFP-në) është pjesërisht funksional. Masat e KBFP-së aktualisht përfshihen vetëm në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike (MFP) 2019–2022. Disa kushte lehtësuese për zbatimin e KBFP-së trajtohen në strategjinë e reformës së administratës publike dhe planin e saj të veprimit.

Përgjegjshmëria menaxheriale është përfshirë në legjislacionin aktual të fushës por zbatimi në praktikë i këtij koncepti mbetet problematik për shkak se elemente të caktuara si strukturat e papërshtatshme organizative apo mospërcaktimi i qartë i objektivave të njësisë publike ngadalësojnë procesin e implementimit. Vendimarrja në institucione është e centralizuar dhe një numër shumë i vogël vendimesh delegohen



në praktikë. Llogaridhënia vertikale është shumë e dobët ndërmjet politikëbërjes dhe njërive zbatuese të politikave. Marrëveshjet e qeverisjes që sigurojnë plane strategjike me objektiva të përcaktuara, tregues të performancës dhe linja të qarta monitorimi dhe raportimi midis ministrive dhe agjencive në varësi të tyre ende mungojnë. Përsëritja dhe rritja e detyrimeve të prapambetura është një tregues për shpërndarjen jo tërësisht efektive të kontrollit të përgjegjësisë dhe angazhimeve të ndërmarra.

Legjislacioni për **kontrollin e brendshëm** është kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare. Deklaratat e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm nënshkruhen sistematikisht nga menaxhimi i lartë, por në mungesë të një kuadri të përcaktuar delegimi, kjo mbetet më shumë një ushtrim formal. Në prill 2019, u miratua një metodologji e re që duhet të përmirësojë efektivitetin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të monitoruar performancën e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësive publike. Për sa i përket funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm vërehen ende problematika në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe njësitë e varësisë. Në të gjitha nivelet, menaxhimi i riskut është akoma në një fazë të hershme dhe duhet të përfshihet më mirë në menaxhimin e proceseve financiare dhe operationale. Funksioni i inspektimit të buxhetit është i centralizuar brenda Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila kryen aktivitete ex - post sipas kërkesës. Numri i kërkesave të paraqitura nga njësitë e auditimit të brendshëm është relativisht i ulët.

Legjislacioni për **praktikën e auditimit të brendshëm** është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në vitin 2019, numri i auditorëve të certifikuar në sektorin publik u rrit.

Njësia qendrore e harmonizimit (NJQH) ofron udhëzime metodologjike dhe monitoron performancën e kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm në sektorin publik në bazë të monitorimeve dhe raporteve të vetëvlerësimit nga institucionet. Raporti vjetor i KBFP-së i paraqitet Këshillit të Ministrave dhe diskutohet në Parlament.

Auditimi i jashtëm

Në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOKLSH), **kuadri kushtetues dhe**

ligjor i Shqipërisë parashikon pavarësinë e Institucionit Shtetëror të Auditimit (KLSH). Miratimi i ndryshimeve ligjore të propozuara, të cilat forcojnë fushën e mandatit të auditimit për të mbuluar të gjitha entitetet publike është ende pezull.

Në përputhje me planin strategjik të zhvillimit 2018–'22, KLSH-ja po zbaton aktivitete për të përmirësuar **kapacitetet institucionale**. Legjislacioni aktual duhet të forcohet për të siguruar vazhdimësi pas përfundimit të mandatit të kryesuesit të KLSH-së. Në vitet e fundit, KLSH-ja ka marrë masa për të përmirësuar zhvillimin profesional të stafit auditues. KLSH-ja ka zbatuar strategjinë e komunikimit 2017–2019 dhe ka rritur ndërgjegjësimin te bota akademike dhe shoqëria civile për rëndësinë e auditimit të jashtëm.

Cilësia e punës së auditimit. Objektivat e auditimit të KLSH-së kanë filluar të zhvendosen nga auditet e pajtueshmërisë dhe rregullsisë drejt auditëve që mund të ndihmojnë në parandalimin e dëmit ekonomik dhe shkeljes së rregullave. Auditimet financiare ende nuk rezultojnë në opinione profesionale dhe të kualifikuara të auditimit, edhe pse KLSH lëshoi për herë të parë në 2018 një opinion mbi ekzekutimin e buxhetit të shtetit 2017. KLSH ndjek një qasje të auditimit të jashtëm të bazuar në risk. Numri i auditimeve të performancës është rritur duke llogaritur afërsisht 10% të të gjitha auditimeve të kryera në vitet e fundit.

Ndikimi i punës së auditimit është i kufizuar. Raportet e auditimit përgatiten periodikisht çdo tre muaj dhe publikohen rregullisht në faqen e internetit të KLSH-së. Memorandumi i Mirëkuptimit i vitit 2017 ndërmjet KLSH-së dhe Ministrisë së Financave për monitorimin e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit u pasua me krijimin e një sekretariati teknik me përfaqësuesit e të dyja palëve. Ky sekretariat nuk është bërë ende plotësisht funksional. Platforma elektronike për ndjekjen e rekomandimeve të auditimit u bë funksionale në fund të vitit 2019.

Mbrojtja e interesave financiarë të BE-së

Shqipëria ka siguruar një nivel të caktuar të përafrimit të *acquis* në luftën kundër mashtrimit ndaj interesave financiarë të BE-së. Shërbimi kombëtar i koordinimit kundër mashtrimit (AFCOS) është një njësi brenda Drejtorisë së Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave



dhe Ekonomisë. Rrjeti AFCOS, që përfshin autoritete të tjera përkatëse, është ngritur dhe organizohen takime të rregullta. Manuali për menaxhimin e parregullsive me fondet e BE-së është miratuar. Shqipëria bashkëpunon me Komisionin Evropian gjatë hetimeve dhe raporton në Komision për parregullsitë dhe rastet e dyshuara të mashtrimit. Shqipëria raportoi tri raste përmes Sistemit *Online* të Menaxhimit të Parregullsive në 2019. Deri më tani, vetëm katër raste janë raportuar përmes sistemit që nga viti 2006.

Mbrojtja e euros nga falsifikimi

Në nëntor 2019, Shqipëria ratifikoi Konventën Ndërkombëtare të vitit 1929 për Shtypjen e Monedhës së Falsifikimit. Shqipëria është pjesërisht e përafruar me *acquis* në lidhje me përcaktimin e kartëmonedhave dhe monedhave të falsifikuara, si dhe procedurat për mbledhjen, ruajtjen dhe tërheqjen e tyre nga qarkullimi. Aktualisht kryhen dhe janë të konsoliduara procedurat detyruese për kontrollin e autenticitetit, tërheqjen nga qarkullimi, dhe mbledhjen e kartëmonedhave e metal monedhave të dyshuara të falsifikuara nga qarkullimi. Identifikimi, analiza teknike, klasifikimi dhe ruajtja e kartëmonedhave dhe metal monedhave të falsifikuara kryhet nga Qendra Kombëtare e Analizës në Bankën e Shqipërisë. Bashkëpunimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar është i qëndrueshëm dhe në vazhdim. Banka e Shqipërisë ka finalizuar marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare (DG ECFIN) pranë Komisionit Evropian për mbrojtjen e monedhave metalike euro. Një marrëveshje me Bankën Qendrore Evropiane është duke u finalizuar gjithashtu, për mbrojtjen e kartëmonedhave euro nga falsifikimi. Shqipëria merr pjesë në aktivitetet në kuadër të programit Pericles 2020.

32.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik

Kuadri strategjik për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik (KBFP-në) është pjesërisht funksional.

Arritjet kryesore paraqiten si më poshtë:

- Në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit është miratuar udhëzimi nr. 4, datë 29.1.2020, “Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, me fokus kryesor Faqe| 4254

përcaktimin e qartë të afateve, rregullave, procedurave që duhet të ndiqen në procesin e delegimit të detyrave brenda njësive së qeverisjes së përgjithshme.

- Me urdhrin e ministrit përgjegjës për financat Nr. 305, datë 18.12.2020 është miratuar Dokumenti i Politikave për Zhvillimin e mëtejshëm të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik 2021–2022.

- Është miratuar me urdhrin e ministrit përgjegjës për financat Nr. 311, datë 23.12.2020 Metodologjia për Vlerësimin e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike.

- Është bërë vlerësimi i gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2019 (Raporti vjetor i KBFP-së).

- Janë organizuar 8 takime ndërgjegjëse me menaxherë të njësive të qeverisjes vendore mbi zbatimin me rigorozitet të kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin në bashkëpunim me Projektin e Financave Lokale (113 pjesëmarrës).

- Janë realizuar disa aktiviteteve në kuadër të ofrimit të asistencës teknike në institucionet e përzgjedhura pilot.

- Është kryer monitorimi në vend në 5 njësi publike (diktuar nga situata e shkaktuar nga COVID-19).

- Janë zhvilluar 8 seanca 1-ditore trajnimi mbi rritjen e kapaciteteve të punonjësve të administratës publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditimit të brendshëm (149 pjesëmarrës).

- Është bërë rishikimi dhe përmirësimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm.

- Është kryer vlerësimi i jashtëm i cilësisë së 15 njësive të auditimit të brendshëm (3 ministri linje; 7 bashki; 3 institucione qendrore dhe dy shoqëri aksionare) dhe deri në fund të 9-mujorit 2020 janë realizuar 10 vlerësime të jashtme.

- Janë organizuar 13 seanca trajnimi me qëllim rritjen e kapaciteteve të auditimit të brendshëm në sektorin publik (338 pjesëmarrës).

- Janë përzgjedhur 41 kandidatë të certifikuar si “Auditues të brendshëm në sektorin publik”.

- Është përmirësuar kuadri metodologjik për t’iu ofruar audituesve udhëzime specifike për zhvillimin e veprimtarisë audituese në përputhje të plotë me



kërkesat e standardeve të pranuar dhe praktikat e mira profesionale për auditimin e brendshëm.

Auditimi i jashtëm

Zhvillimi profesional i audituesve dhe stafit është mbështetur në Programin Vjetor të Trajnimit për vitin 2019 duke synuar që ndërtimi i kapaciteteve të mbështetet në metodologji të reja e të përditësuara dhe në aplikimin e qasjeve moderne të auditimit. Stafi auditues gjatë vitit 2019 arritur një nivel pjesëmarrje prej rreth 25 dite trajnimi për çdo auditues (duke ruajtur objektivin që çdo auditues gjatë 7 viteve të fundit të trajnohet mesatarisht 25 ditë trajnim në vit). për periudhën Janar Shtator 2020 për çdo auditues/specialist janë kryer 17 dite trajnimi.

Në funksion të përafrimit të metodologjisë audituese në një linjë me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, KLSH-ja është përqendruar në rishikimin/hartimin e manualeve të auditimit, si dhe të dokumenteve të tjera që rregullojnë veprimtarinë audituese. Sa më sipër janë hartuar dhe miratuar dokumentet si më poshtë vijon:

- Rregullorja e Procedurave të Auditimit, e rishikuar, miratuar me vendimin e kryetarit të KLSH nr. 63, datë 22.6.2020.

- Manuali i Auditimit Financiar, i rishikuar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH Nr. 66, datë 22.6.2020.

- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, i rishikuar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 66, datë 30.6.2020.

- Manuali i Auditimit të Performancës i rishikuar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 78, datë 23.6.2020.

- Manuali i Ndjekjes së Zbatimit të Rekomandimeve dhe të Regjistrat Institutional të zbatimit të rekomandimeve, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 23.6.2020.

- Udhërrëfyesi mbi mënyrën e referimit të veprave penale në prokurori miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 60, datë 31.5.2020

Gjatë vitit 2019, KLSH-ja ka dërguar në Parlament Raportin Vjetor të Performancës për vitin 2018, Raportin e Auditimit për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2018, së bashku me Raportin Gjithëpërfshirës të Ndjekjes së Zbatimit të Rekomandimeve me qëllim rritjen e impaktit të punës audituese.

Në prill të vitit 2020 është dërguar në Parlament Raporti Vjetor të Performancës për vitin 2019.

KLSH-ja ka dërguar në Kuvendin e Shqipërisë dhe në komisionet respektive (në funksion të tematikës së trajtuar) 135 vendime/raporte auditimi të cilat i përkasin veprimtarisë audituese të vitit 2019. Për vitin 2020 (deri në korrik) KLSH ka dërguar në Kuvend (Komisionin e Ekonomisë dhe Financave) 34 Auditime të evaduar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020.

Për të siguruar veprimtarinë e auditimit në përputhje të plotë me standardet ISSAI, KLSH ka rritur gradualisht numrin e auditimeve të performancës nga 9.6 % në vitin 2017, në 10.5 % në vitin 2018, dhe për vitin 2019 auditimet e performancës përfaqësuan 11.4 % të totalit të auditimeve.

Mbrojtja e interesave financiarë të BE-së

DIFP/AFCOS ka bashkëpunuar rregullisht me Autoritet Kombëtarë të Rrjetit AFCOS, në varësi të objektit të parregullsisë/çështjes, apo informacionit të kërkuar nga OLAF; AFCOS ka mundësuar për OLAF-in kontaktin me Përfaqësuesit e Autoriteteve Kombëtarë të përfshira në këtë rrjet, në funksion të bashkëpunimit operacional për rastet e hetimit të kryera nga OLAF, si dhe ka asistuar në dhënien e informacionit të kërkuar nga OLAF. Ka asistuar Zyrtarin Kombëtar Autorizues, për rastet e parregullsisë të konstatuara. Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik/AFCOS ka kryer inspektime për rastet e kërkuara nga Zyrtari Kombëtar Autorizues, në cilësinë e Autoriteti Përgjegjës.

Mbrojtja e euros nga falsifikimi

Banka e Shqipërisë me kuadrin rregullator aktual garanton procedura detyruese për kontrollin e vërtetësisë, tërheqjen menjëherë të kartëmonedhave dhe monedhave metalike të dyshuara të falsifikuara të zbuluara në qarkullim. Në Qendrën e Analizës, struktura përgjegjëse me kapacitetet përkatëse pranë Bankës së Shqipërisë, bëhet dërgimi i kartëmonedhave dhe monedhave metalike të dyshuara të falsifikuara, me qëllim identifikimin, analizën teknike dhe klasifikimin e kartëmonedhave dhe monedhave metalike të falsifikuara. Në Nëntor 2019 Parlamenti ratifikoi Marrëveshjen e Gjenezës të vitit 1929 për ndalimin e monedhave të falsifikuara. Banka e Shqipërisë ka finalizuar marrëveshje bashkëpunimi me DG/ECFIN pranë Komisionit Evropian në



fushën e mbrojtjes së metal monedhave euro. Shqipëria merr pjesë në aktivitet e organizuara në kuadër të programin Pericles, madje Banka e Shqipërisë ka mbështetur dhe kontribuar në aktivitetet e organizuara në Tiranë në fushën e mbrojtjes të monedhës euro kundër falsifikimit.

32.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë (institucioni lider)
2. Kontrolli i Lartë i Shtetit
3. Banka e Shqipërisë
4. Ministria e Brendshme
5. Ministria e Brendshme/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
6. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
7. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
8. Ministria e Drejtësisë
9. Agjencia e Auditimit të Projekteve të Asistencës së Akredituar nga BE
10. Agjencia për Zhvillim Bujqësor
11. Instituti i Statistikave (INSTAT)

32.7 Prioritetet

Shqipëria duhet të marrë masa për zbatimin e dokumentit gjithëpërfshirës të politikave të KBFP-së, të miratuar së fundmi, me fokus të veçantë në përcaktimin dhe zbatimin e përgjegjësisë menaxheriale dhe kuadrin e monitorimit, nëpërmjet koordinimit të KBFP-në me reformën e administratës publike dhe reformën e menaxhimit të financave publike.

Shqipëria duhet të përmirësojë zbatimin e raportit vjetor të KBFP-së ndërmjet njërive buxhetore.

Shqipëria duhet të rrisë kontrollin parlamentar të organeve të audituara në zbatimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm, përmes dëgjimeve më të shpeshta parlamentare dhe krijimit të një kornize parlamentare monitorimi për të vlerësuar rregullisht aktivitetin e qeverisë.

Kontrolli i brendshëm financiar publik

Funksionaliteti i grupit të integruar të menaxhimit të politikave për qeverisjen e mirë për të përmirësuar koordinimin, monitorimin dhe raportimin e reformave të KBFP-së duhet të forcohet më tej.

Ligji për administratën shtetërore, ligji për nëpunësit civilë dhe ligjet përkatëse për planifikimin e politikave dhe ligji i sistemit buxhetor duhet të

vlerësohen dhe nëse është e nevojshme të ndryshohen për të siguruar një bazë të qëndrueshme për zbatimin e përgjegjësisë menaxheriale. (Shih reformën e administratës publike).

Funksioni i auditimit të brendshëm ende nuk lëshon opinione të auditimit mbi efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në të gjitha njësitë buxhetore. Procedurat e kontrollit të cilësisë së auditimit të brendshëm duhet të kryhen në përputhje me standardet dhe duhet të jenë funksionale. Monitorimi i zbatimit në mënyrë efektive dhe në kohë i rekomandimeve të auditimit të brendshëm duhet të përmirësohet.

Kapaciteti i Njërive Qendrore të Harmonizimit duhet të forcohet më tej.

Auditimi i jashtëm

Legjislacioni aktual duhet të forcohet për të siguruar vazhdimësinë pas përfundimit të mandatit të kryetarit të KLSH-së.

Monitorimi i zbatimit në mënyrë efektive dhe në kohë të rekomandimeve të auditimit duhet të përmirësohet.

Cilësia e punës së auditimit duhet të përmirësohet më tej, pasi aktivitetet e auditimit nuk janë ende në përputhje të plotë me standardet INTOSAI, posaçërisht në lidhje me procedurat e kontrollit të cilësisë.

Me synim implementimin e rekomandimit të Progres Raportit të Komisionit Evropian “Të rritet kontrolli parlamentar ndaj institucioneve të audituara për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm, përmes dëgjësive më të shpeshta parlamentare dhe krijimit të një kornize monitoruese parlamentare për të vlerësuar rregullisht veprimet qeverisë për implementimin e rekomandimeve”, KLSH do të vijojë:

- T’i ridërgojë Kuvendit të Shqipërisë propozimin për ngritjen e një nen komisioni parlamentar, pjesë e Komisionit për Ekonominë dhe Financat për shqyrtimin e raporteve të KLSH-së dhe zhvillimin në mënyrë periodike të dëgjësive parlamentare për vlerësimin e veprimeve korrigjuese të ndërmarra nga institucionet e audituara për implementimin e rekomandimeve të KLSH-së.

- T’i ridërgojë Kuvendit të Shqipërisë propozimin për nënshkrimin e një memorandumit mirëkuptimi midis dy institucioneve dhe hartimin e një plani konkret pune për rritjen e kontrollit



parlamentar për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Për zbatimin e rekomandimit për “*Amendimin e kuadrit ligjor të KLSH-së*”, i cili siguron ndër të tjera vazhdimësinë e aktivitetit institucional edhe pas mbarimit të mandatit kushtetues të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, KLSH do t’ia përcjellë Kuvendit propozimin për amendime në ligjin nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH” për këtë çështje.

Përmirësimi i cilësisë së punës audituese përbën një nga objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së dhe për këtë institucioni do të fokusohet tek:

- Hartimi dhe zhvillimi i një plani specifik trajnimesh i cili ka në fokus zbatimin e kërkesave të Standardit ISSAI 40 “Kontrolli dhe Sigurimi i Cilësisë” dhe zbatimi i Udhëzuesit për Menaxhimin e Cilësisë së Auditimit në kontekstin e implementimit të Rregullores së rishikuar të Procedurave të Auditimit dhe manualeve të rishikuara të auditimeve financiare, të përputhshmërisë dhe performancës, si dhe manualit të ri për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve (dokumente të miratuara në qershor 2020).

- Rritja e impaktit të punës audituese do të realizohet nëpërmjet:

- Përcjelljes në Kuvendin e Shqipërisë të raporteve periodike dhe raportit të konsoliduar mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

- Dërgimit periodik të (ekzekutivi) ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin të Raportit të zbatimit të rekomandimeve në funksion të informimit dhe monitorimit nga ana e qeverisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së nga institucionet e qeverisjes qendrore.

- Dërgimit të komisionet respektive parlamentare të raporteve të auditimit, të auditimit të performancës dhe raporteve me rëndësi dhe ndjeshmëri të lartë publike.

- Zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për krijimin dhe funksionimin e Sekretariatit për Bashkëpunim ndërmjet dy institucioneve, i cili një ndër objektivat ka të cilësuar krijimin e mekanizmave efektive për të siguruar rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit.

- Kryerjes së auditimeve tematike të veçanta për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve me qëllim

evidentimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve dhe hartimin e raportit të konsoliduar të zbatimit të rekomandimeve.

Mbrojtja e interesave financiarë të BE-së

Shqipëria duhet të përafrojë plotësisht direktivën e BE-së kundër mashtrimit ndaj interesave financiarë të BE-së, në drejtim të ligjit penal. Megjithatë bashkëpunimi për hetimet është përmirësuar, Shqipëria ka nevojë të zhvillojë një histori solide mbi hetimet dhe raportimin e parregullsive.

Miratimi i Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit (2022), e cila synon mbrojtjen e interesave financiarë të BE-së është përfshirë në Strategjinë e Mbikëqyrjes së Financave Publike 2019- 2022 (komponenti 6.1, masa 6.1.1 e PFM); Draftimi i kësaj strategjie ishte parashikuar të niste në 3-mujorin e dytë 2020, por për shkak të pandemisë COVID-19, është shtyrë për 3-mujorin e parë të vitit 2021.

Për hartimin e kësaj strategjie DIFP/AFCOS do të vijojë me koordinimin e mundësimit të asistencës teknike nga OLAF, nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm që ka me këtë strukturë. Strategjia është parashikuar të miratohet me Urdhër të Ministrit përgjegjës për Financat brenda 3-mujorit të katërt të vitit 2022.

Në lidhje me rritjen e kapaciteteve/burimeve njerëzore në Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik/AFCOS, është planifikuar ndërmarrja e hapave respektive administrative dhe ligjore për përfshirjen e Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) në rrjetin AFCOS- AL.

Mbrojtja e euros nga falsifikimi

Prioritetet në këtë fushë janë,

- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Bankën Qendrore Evropiane “Mbi Kartëmonedhat”.

- Miratimi i Rregullores “Mbi medaljet dhe xhetonat të ngjashme me monedhën metalike euro”.

- Miratimi i Rregullores “Mbi kriteret e riprodhimit të kartëmonedhave dhe metal monedhave”.



KAPITULLI 33 DISPOZITAT FINANCIARE DHE BUXHETORE

33.1 Përmbajtja e kapitullit

Ky kapitull mbulon rregullat që disiplinojnë fondet e buxhetit të BE-së ('burimet vetjake'). Këto burime konsistojnë kryesisht në: i. kontribute të bazuara në të ardhurat kombëtare bruto të secilit Shtet Anëtar; ii. detyrimet doganore; dhe iii. një burim bazuar në tatimin mbi vlerën e shtuar. Shtetet Anëtare duhet të kenë kapacitetet e duhura administrative për të koordinuar në mënyrë adekuate dhe për të garantuar llogaritjen e saktë, mbledhjen, pagesën dhe kontrollin e burimeve vetjake.

33.2 Struktura e kapitullit

Burimet vetjake tradicionale

33.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Neni 70 i MSA-së kërkon përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* e BE-së, ku gjithashtu përfshihet dhe legjislacioni i BE-së për këtë kapitull.

Sa i përket *acquis*, ky kapitull përfshin rregulloret në lidhje me burimet financiare të nevojshme për financimin e buxhetit të BE-së (burimet vetjake). Këto burime përbëhen nga të ashtuquajturat burimet tradicionale vetjake. *Acquis* në këtë fushë është direkt detyrues dhe nuk kërkon transpozim në ligjin kombëtar.

33.4 Situata aktuale në Shqipëri

Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitje në këtë fushë. Njëfarë përparimi është bërë në politikën bazë që ndikojnë në funksionimin e sistemit të financimit të BE-së, përmes progresit në zbatimin e ligjit organik të buxhetit 2016, të rregullit fiskal dhe vazhdimin e reformës së menaxhimit të financave publike. Vijon përafrimi me *acquis* e BE-së në fushat bazë të politikës.

33.5 Përmbledhje e arritjeve kryesore

Shqipëria ka shënuar progres në fushat themelore të politikës që ndikojnë indirekt në sistemin e burimeve vetjake (kapitujt: 16 taksat, 18 statistikat, 29 bashkimi doganor dhe 32 kontrolli financiar).

Shqipëria ka ngritur struktura për mbledhjen e detyrimeve doganore në pikën e importit dhe ka një sistem kombëtar të TVSH-së. Shqipëria ka filluar punën për hartimin e një Strategjie

Afatmesme të të Ardhurave e cila do të përmbledhë reformën në fushën e taksave.

Llogaritë Kombëtare janë në linjë me Sistemin Evropian (ESA2010). INSTAT-i publikon rregullisht treguesin e Produktit të Brendshëm Bruto dhe të të Ardhurave Kombëtare Bruto mbështetur në metodologjinë e rekomanduar në ESA 2010. INSTAT, nën asistencën e vazhdueshme të Bashkimit Evropian, nëpërmjet projekteve IPA shumëpërfutuese, ka zhvilluar një punë intensive në fushën e Llogarive Kombëtare për përmirësimin dhe zgjerimin e indikatorëve makroekonomikë sipas ESA 2010.

INSTAT-i ka të publikuar në faqen zyrtare, inventarin e Burimeve dhe Metodave të përdorura në Llogaritë Kombëtare, duke përdorur strukturën e një inventari burimesh të rekomanduar nga EUROSTAT. Ky inventar është përditësuar me të gjitha aktivitetet e realizuara në kuadër të projekteve pilot IPA shumëpërfutuese.

Duke filluar nga shtatori 2014, INSTAT-i është pjesë e Programit të Transmetimit ESA 2010, duke transmetuar rregullisht në EUROSTAT treguesit e Llogarive Kombëtare (llogaritë kombëtare vjetore dhe tremujore, llogaritë rajonale, llogaritë jofinanciare sipas sektorëve institucional, tabelat burime-përdorime dhe IOT) në formatin SDMX.

INSTAT-i zbaton nomenklaturat e nevojshme në përputhje me Nomenklaturat e BE-së dhe të përditësuara në mënyrë periodike sipas EUROSTAT-it.

Gjatë vitit 2019, INSTAT-i, përveç tabelave të reja të dërguara, u fokusua gjithashtu edhe në përmirësimin e cilësisë dhe variablave, duke përfshirë indikatorët e lidhur zinxhir (*Chain link*) dhe duke zgjeruar serinë e të dhënave prej vitit 1995, si pjesë e Programit të Transmetimit ESA 2010.

INSTAT-i transmeton në mënyrë të rregullt, në Prill dhe në Tetor të çdo viti, tabelat e procedurës së deficitit të tejkalluar.

33.6 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (lider i kapitullit);
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- INSTAT.



33.7 Prioritetet

- Shqipëria duhet të vijojë me përafrimin e të dhënave të Llogarive Kombëtare me ESA 2010 (Sistemi Evropian i Llogarive) dhe përmirësimin e përmbledhjeve të transmetimit të të dhënave në Eurostat.

- Shqipëria duhet të harmonizojë legjislacionin e saj me dispozitat e BE-së për TVSH-në dhe detyrimet doganore.

Shqipëria duhet të përmirësojë më tej pajtueshmërinë me ESA 2010 dhe të fillojë hartimin e Inventarit të GNI-së, bazuar në përshkrimin ekzistues të burimeve dhe metodave të përdorura për përpilimin e Llogarive Kombëtare. Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të siguruar që janë marrë masa efektive për të zyrtarizuar ekonominë gri, për të përmirësuar shterimin e llogarive kombëtare dhe llogaritjet e GDP/GNI dhe për të luftuar evazionin fiskal dhe mashtrimet me detyrimet doganore. (Burimet vetjake tradicionale)

Në fokus është dhe zhvillimi i mëtejshëm i burimeve të brendshme, burimeve të cilat bazohen në tatimin mbi vlerën e shtuar si dhe i burimeve që lidhen me të ardhurat e brendshme bruto.

Do të vijojë puna për implementimin e mëtejshëm të Sistemit Evropian të Llogarive ESA 2010. Një informacion më i zgjeruar rreth zhvillimeve në fushën e statistikave dhe sidomos në fushën e Llogarive Kombëtare dhe qasjes ndaj standardeve ESA 2010, mund ta gjeni në kapitullin 18 “Statistikat”.

Në lidhje me infrastrukturën administrative, Shqipëria do të punojë për ngritjen e institucioneve përkatëse, organit koordinues dhe rregullave të zbatimit në mënyrë që të jetë në gjendje që të llogarisë, parashikojë, grumbullojë, paguajë, kontrollojë dhe raportojë pranë BE-së, në mënyrë korrekte, burimet vetjake në përputhje me *acquis*.



ANEKSI 1

MASAT LIGJORE TË PLANIFIKUARA PËR PERIUDHËN 2021–2023

Kapitulli	Nënkapitulli	Acquis e BE-së	Legjislacioni shqiptar	Lloji i aktit të përafuar	Dokument strategjik Po/Jo	Institucioni propozues	Niveli i synuar i përafërimit	Viti i përafërimit	Tremujori i planifikuar për miratim	Përkthimi
1	LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE									
1	Parimet e përgjithshme dhe fusha paharmonizuar	Nenet 34–36 të Traktatit për funksionimin e BE-së.	Projektvendimi “Për miratimin e Udhërefësyt Kombëtar të Lëvizjes së Lirë të Mallrave”.	VKM	Po	MFE	N/A	2022	IV	–
1	Parimet e përgjithshme dhe fusha paharmonizuar	Nenet 34–36 të Traktatit për funksionimin e BE-së.	Projektvendimi “Për miratimin e Planit të Veprimit për përputhshmërinë me nenet 34 – 36 të Traktatit për funksionimin e Bashkimit Evropian”.	VKM	Po	MFE	N/A	2022	IV	–
1	Qasja e re	Rregullorja (BE) 2016/425, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 9 mars 2016 mbi pajisjet mbrojtëse personale, që shfuqizon direktivën e Këshillit 89/686/EEC (PPE).	Projektvendim “Për miratimin e rregullit teknik ‘Për pajisjet mbrojtëse personale’”.	VKM	Jo	MFE	I pjesshëm	2021	IV	–
1	Qasja e re	Direktiva 2014/29/BE, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 26 shkurtit 2014, mbi harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare, në lidhje me bërjen të disponueshme në treg të enëve të theksa nën presion (SPVD).	Projektvendimi “Për miratimin e rregullit teknik ‘Për enët e theksa nën presion’ dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”.	VKM	Jo	MFE/MIE	I pjesshëm	2022	IV	Jo
1	Qasja e re	Rregullorja (BE) 2016/426, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 9 marsit 2016, mbi pajisjet e gazit, që shfuqizon direktivën 2009/142/EC.	Projektvendimi “Për miratimin e rregullit teknik ‘Për pajisjet e gazit dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara’”.	VKM	Jo	MFE/MIE	I pjesshëm	2023	IV	–
1	Qasja e vjetër	Rregullorja EU 2018/858, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 30 majit 2018, mbi miratimin dhe mbikëqyrjen e tregut të mjeteve me motor dhe rimorkiove, sistemeve, komponentëve dhe pjesëve teknike të veçanta të atyre që amendon rregulloret (EC) nr. 595/2009 dhe shfuqizon direktivën 2007/46/EC.	Projektudhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Për miratimin e tipit të mjeteve motorike dhe rimorkiove të tyre, të sistemeve, pjesëve përbërëse dhe pjesëve të veçanta teknike të destinuara për këto mjete”.	Udhëzim	Jo	MIE	I plotë	2023	IV	Jo
1	Qasja e vjetër	Direktiva 76/211/EEC, e 20 janarit 1976, e amenduar nga direktivat 78/891/EEC, e 28 shtatorit 1978, dhe 2007/45/EC.	Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Rregullore për parapaketimet”.	VKM	Jo	DPM	I pjesshëm	2021	I	Jo
1	Qasja e vjetër	Direktiva 75/107/EEC, e 19 dhjetorit 1974, “Shishet si enë matëse”.	Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Rregullore për shishet si enë matëse”.	VKM	Jo	DPM	I pjesshëm	2021	I	Jo
1	Qasja e re	32014 L0058, direktiva zbatuese e Komisionit 2014/58/BE, e 16 prillit 2014, që krijon, në përputhje me direktivën 2007/23/EC, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, një sistem për gjurmueshmërinë e artikulave piroteknikë.	Projektvendim “Për ngritjen e sistemit të gjurmimit të artikulave piroteknikë”.	VKM	Jo	MM	I pjesshëm	2021	IV	Po
1	Çështjet horizontale	Rregullorja nr. 1025/2012 BE, “Mbi standardizimin evropian”.	Projektvendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 382/2018, ‘Për veprimtarinë e standardizimit’”.	VKM		MFE/Dr. Përgjithshme e Standardizimit	I Plotë	2021	IV	Jo
1	Çështjet horizontale	Rregullorja (KE) nr. 273/2004, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të 11 shkurtit 2004, mbi prekurzorët e drogave.	Ligj nr. 8874, datë 29.3.2002, “Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotropë”.	Ligj	Jo	MSHMS	I pjesshëm	2023	IV	-
1	Çështjet Horizontale	Direktiva e Këshillit nr. 89/105/KEE, e 21 dhjetorit 1988, në lidhje me transparencën e masave që rregullojnë çmimet e barnave për përdorim njerëzor dhe përshirjen e tyre në fushën e sistemeve kombëtare të sigurimeve shëndetësore.	Vendim nr. 645, datë 1.10.2014, “Për ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të çmimit të barnave”, i ndryshuar.	VKM	Jo	MSHMS	I pjesshëm	2023	IV	-
1	Qasja e re	Rregullorja (BE) nr. 305/2011, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 9 mars 2011, mbi përcaktimin e kushteve të harmonizuara për tregtimin e produkteve të ndërrimit dhe shfuqizimin e direktivës së Këshillit 89/106/EEC.	Projektligji “Për produktet e ndërrimit”.	Ligj	Jo	MIE	I plotë	2023	IV	Jo
1	Përqasja e re dhe globale	Directive 2014/60/EU of the European Parliament and of the Council of 15 May 2014 on the return of cultural objects unlawfully removed from the territory of a Member State.	Projektvendim “Për kushtet e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, procedurat për shpërndarjen ose revokimin e licencës, tarifën e aplikimit dhe të kuotizimit vjetor për ushtrimin e veprimtarisë tregtare të pasurive kulturore”, në zbatim të pikës 3, të nenet 116, të ligjit nr. 27/2018.	VKM	Jo	MK/IKRTK	I pjesshëm	2023	IV	Jo



1	Përqasja e re dhe globale	Directive 2014/60/EU of the European Parliament and of the Council of 15 May 2014 on the return of cultural objects unlawfully removed from the territory of a Member State.	Projektvendim “Për procedurat e krijimit dhe administrimit të bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura”, në zbatim të pikës 1, të nenit 130, të ligjit nr. 27/2018.	VKM	Jo	MK/IKRTK	I pjesshëm	2023	IV	Jo
1	Përqasja e re dhe globale	Directive 2014/60/EU of the European Parliament and of the Council of 15 May 2014 on the return of cultural objects unlawfully removed from the territory of a Member State.	Projektudhëzimi për krijimin dhe për funksionimin e “Regjistrit të tregimit të pasurive kulturore”, në zbatim të pikës 7, të nenit 116, të ligjit nr. 27/2018.	Udhëzim	Jo	MK/IKRTK	I pjesshëm	2023	IV	Jo
1	Përqasja e re dhe globale	Directive 2014/60/EU of the European Parliament and of the Council of 15 May 2014 on the return of cultural objects unlawfully removed from the territory of a Member State.	Projektudhëzimi i përbashkët “Për vlerat mbi të cilat është i detyrueshëm një përshkrim më i detajuar i pasurive kulturore, objekte të veprimave tregtare”, në zbatim të pikës 8, të nenit 116, të ligjit nr. 27/2018.	Udhëzim	Jo	MK/IKRTK	I pjesshëm	2023	IV	Jo
1	Përqasja e re dhe globale	Directive 2014/60/EU of the European Parliament and of the Council of 15 May 2014 on the return of cultural objects unlawfully removed from the territory of a Member State.	Projektudhëzimi “Për procedurat e përditësimit të bazës së të dhënave dhe administrimit të pasurive kulturore të vjedhura”, në zbatim të pikës 6, të nenit 130, të ligjit nr. 27/2018.	Udhëzim	Jo	MK/IKRTK	I pjesshëm	2023	IV	Jo
2	LËVIZJA E LIRË E PUNËTORËVE									
2	Liria e lëvizjes së punëtorëve	Regulation (EC) No 883/2004 of the European Parliament and of the Council of 29 April 2004 on the coordination of social security systems.	Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicrane”.	Ligj	Jo	MFE	I pjesshëm	2021	IV	Jo
2	Liria e lëvizjes së punëtorëve	Regulation (EC) No 883/2004 of the European Parliament and of the Council of 29 April 2004 on the coordination of social security systems.	Projektvendim “Për miratimin në parim të marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bullgarisë”.	VKM	Jo	MFE	I pjesshëm	2021	IV	Jo
2	Liria e lëvizjes së punëtorëve	Regulation (EC) No 883/2004 of the European Parliament and of the Council of 29 April 2004 on the coordination of social security systems.	Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bullgarisë”.	Ligj	Jo	MFE	I pjesshëm	2021	IV	Jo
2	Liria e lëvizjes së punëtorëve	Regulation (EC) No 883/2004 of the European Parliament and of the Council of 29 April 2004 on the coordination of social security systems.	Projektvendim “Për miratimin në parim të marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës”.	VKM	Jo	MFE	I pjesshëm	2021	IV	Jo
3	E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME									
3	3.3 Shërbimet postare	Rregullorja (BE) 2018/644, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 18 prill 2018, mbi shërbimet e shpërndarjes së parcelave ndërkufitare.	Projektvendim i Këshillit të Ministrave mbi shërbimet e dërgesave ndërkufitare të pakove postare.	VKM	Jo	MFE	I pjesshëm	2021	II	Jo
3	3.2 Njohja e ndërsjellë e kualifikimeve profesionale	Direktive 2005/36/EC, e PE-së dhe e Këshillit, “Mbi njohjen e kualifikimeve profesionale”, e ndryshuar.	Projektligj nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.	Ligj	Jo	MK	I pjesshëm	2022	I	Po
3	3.2 Njohja e ndërsjellë e kualifikimeve profesionale	Direktive 2005/36/EC e PE dhe e Këshillit “Mbi njohjen e kualifikimeve profesionale”, e ndryshuar.	Projektvendimi “Për licencimin në fushën e restaurimit dhe trashëgimisë kulturore”.	VKM	Jo	MK	I pjesshëm	2022	I	Po
4	LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT									
4	Sistemet e pagesave	Direktiva 2009/110/EC mbi ushtrimin, ndjekjen dhe mbikëqyrjen prudenciale të veprimtarisë së institucioneve të parasë elektronike, që ndryshon direktivat 2005/60/EC dhe 2006/48/EC dhe shfuqizon direktivën 2000/46/EC.	Rishikimi i rregullores nr. 1, datë 17.1.2013, “Për licencimin dhe ushtrimin e aktivitetit nga subjektet financiare jobanka”.	Rregullore	Jo	BSH	I plotë	2022	II	Jo
4	Sistemet e pagesave	Direktiva 2009/110/EC mbi ushtrimin, ndjekjen dhe mbikëqyrjen prudenciale të veprimtarisë së institucioneve të parasë elektronike, që ndryshon direktivat 2005/60/EC dhe 2006/48/EC, dhe shfuqizon direktivën 2000/46/EC.	Rishikimi i rregullores nr. 2, datë 17.1.2013, “Për administrimin e rrezeve në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka”.	Rregullore	Jo	BSH	I plotë	2022	II	Po
4	Sistemet e pagesave	Direktiva 2009/110/EC, mbi ushtrimin, ndjekjen dhe mbikëqyrjen prudenciale të veprimtarisë së institucioneve të parasë elektronike, që ndryshon direktivat 2005/60/EC dhe 2006/48/EC, dhe shfuqizon direktivën 2000/46/EC.	Rishikimi i rregullores nr. 11, datë 6.2.2008, “Për instrumentet e pagesave elektronike”.	Rregullore	Jo	BSH	I plotë	2022	II	Po



4	Lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit	Direktiva (BE) 2015/849, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 20 maj 2015, “Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar, për qëllime të pastrimit të parave ose të financimit të terrorizmit”, duke ndryshuar rregulloren (BE) nr. 648/2012, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe duke shfuqizuar direktivën 2005/60/KE, të Parlamentit Evropian dhe të drektivës së Këshillit dhe Komisionit 2006/70/KE, ndryshuar nga direktiva (BE) 2018/843 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 30 majit 2018.	Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (i ndryshuar).	Ligj	Jo	DPPPP/MFE	I plotë	2021	I	Jo
5	PROKURIMI PUBLIK									
5	Prokurimet klasike dhe prokurimet në sektorët utilitarë	Direktiva 2014/24/BE, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 26 shkurt 2014, mbi prokurimin publik dhe shfuqizimin e direktivës 2004/18/EC dhe direktiva 2014/25/BE, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 26 shkurt 2014, mbi prokurimin nga subjektet që vepronë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe shfuqizimin e direktivës 2004/17/EC.	VKM-ja “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.	VKM	Jo	APP	I pjesëshëm	2021	II	Po
5	Prokurimet Klasike	Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 213/2008, e 28 nëntorit 2007, që amendon rregulloren e ndryshimit (KE) nr. 2195/2002, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit (CPV) dhe direktivat 2004/17/EC dhe 2004/18/EC, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi procedurat e prokurimit publik, në lidhje me rishikimin e CPV (Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit).	VKM-ja “Për fjalorin e përbashkët të prokurimit” (CPV Kodet).	VKM	Jo	APP	I pjesëshëm	2021	III	Jo
5	Prokurimet Klasike dhe Prokurimet në Sektorët Utilitare	Direktiva 2014/24/BE, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 26 shkurtit 2014, mbi prokurimin publik dhe shfuqizimin e direktivës 2004/18/EC dhe direktiva 2014/25/BE, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 26 shkurt 2014, mbi prokurimin nga subjektet që vepronë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe shfuqizimin e direktivës 2004/17/EC.	VKM-ja “Për zhvillimin e procedurave të prokurimit për shërbimet sociale dhe shërbimet e tjera specifike”.	VKM	Jo	APP	I plotë	2021	III	Po
5	Koncesione dhe PPP	Direktiva 2014/23/BE, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 26 shkurt 2014, mbi dhënien e kontratave të koncesionit.	Ligji nr. 125/2013, “Për koncesionet/PPP”, të ndryshuar.	Ligj	Jo	MFE	I plotë	2023	I	Po
5	Prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë	2013/488/EU: Vendim i Këshillit, i 23 shtatorit 2013, mbi rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të BE-së. Aneksi 5.	“Për miratimin e rregullave për sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale”.	VKM	Jo	DSIK	I Pjesëshëm	2021	I	Po
6	LEGJISLACIONI TREGTAR									
6	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
7	E DREJTA E PRONËSISË INTELKTUALE									
7	E drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura	Rregullore (BE) 2017/1563, e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 13 shtator 2017, “Mbi shkëmbimin ndërkufitar midis Bashkimit dhe vendeve të treta, të kopjeve në format të përshtatur të veprave të caktuara dhe objekteve të tjera të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura me to në përfutim të personave të cilët janë të verbër, me shikim të dëmtuar ose ndryshe me afësi të kufizuara në leximin e materialeve të printuara.”.	Ligji nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.	Ligj	Jo	MK	I plotë	2022	III	Po
7		Direktivën nr. 2012/28, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian, datë 25 tetor 2012, “Për përdorime të caktuara të lejuara të veprave pa autor”. Direktivën 2017/1564 (BE), të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian, datë 13 shtator 2017, “Mbi disa përdorime të lejuara të veprave të caktuara dhe fusha të tjera të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to, në përfutim të personave të cilët janë të verbër, me shikim të dëmtuar ose ndryshe me afësi të kufizuara në leximin e materialeve të printuara”. Amendimin e direktivës 2001/29/KE, mbi harmonizimin e aspekteve të caktuara të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në shoqërinë e informacionit”, si dhe direktivën 2011/77/BE, e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian, datë 27 shtator 2011, “Amendimi i direktivës 2006/116/KE, mbi afatin e mbrojtjes të të drejtave të autorit dhe disa të drejtave të lidhura me to”.	Ligji nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.	Ligj	Jo	MK	I pjesëshëm	2021	I	Po



7	Pronësia industriale	1. Direktiva (BE) 2015/2436, për të përafëruar ligjet e Shteteve Anëtare, në lidhje me markat tregtare, të dhjetorit 2015; 2. Rregullorja (BE) 2017/1001, mbi markën tregtare të Bashkimit Evropian, të 14 qershorit 2017; 3. Direktiva 98/71/EC, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 13 tetorit 1998, mbi mbrojtjen ligjore të dizenjave; 4. Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 6/2002, e 12 dhjetorit 2001, mbi modelet e Komunitetit.	Mbi amendimin e ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar, me ligj nr. 17/2017, datë 16.2.2017, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, 'Për pronësinë industriale'".	Ligj	Jo	MFE/Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale	I plotë	2023	IV	Po
8	POLITIKAT E KONKURENCËS									
8	Konkurrenca	Praktikat më të mira të DG Competition për dorëzimin e dokumenteve ekonomike dhe mbledhjes së të dhënave në rastet e zbatimit të neneve 101 dhe 102, të TFEU-së dhe në rastet e përqendrimeve.	Udhëzues "Mbi praktikat më të mira për dorëzimin e dokumentacionit ekonomik dhe mbledhjes së të dhënave, si në rastet e zbatimit të neneve 4 dhe 9, të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003, 'Për mbrojtjen e konkurrencës' (të ndryshuar) edhe në rastet e përqendrimeve".	Udhëzim	Jo	AK	I plotë	2021	I	Jo
8	Konkurrenca	Praktikat më të mira për kryerjen e procedurave të kontrollit të përqendrimeve të KE-së.	Udhëzues "Mbi praktikat më të mira në rastet e zbatimit të procedurave të kontrollit të përqendrimeve".	Udhëzim	Jo	AK	I plotë	2021	II	Jo
8	Konkurrenca	Udhëzim mbi kufizimet e konkurrencës "sipas objektit" për qëllime të identifikimit të marrëveshjeve të cilat mund të përfitojnë nga rregullorja 'Për marrëveshjet me rëndësi të vogël'".	Udhëzues "Mbi kufizimet e konkurrencës 'sipas objektit' për qëllime të identifikimit të marrëveshjeve të cilat mund të përfitojnë nga rregullorja 'Për marrëveshjet me rëndësi të vogël'".	Udhëzim	Jo	AK	I plotë	2022	II	Jo
8	Konkurrenca	Praktikat më të mira për zbulimin e informacioneve në procedurat, sipas neneve 101 dhe 102, të TFEU-së dhe sipas rregullores së përqendrimeve.	Udhëzues "Mbi praktikat më të mira për zbulimin e informacioneve në procedurat e ndjekura në zbatim të neneve 4 dhe 9, të ligjit nr. 9121/2003, 'Për mbrojtjen e konkurrencës', të ndryshuar, si dhe në rastet e përqendrimeve".	Udhëzim	Jo	AK	I plotë	2023	IV	Jo
9	SHËRBI MET FINANCIARE									
9	Shërbimet jobankare	Direktiva 2016/2341/BE, të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës, e 14 dhjetor 2016, "Mbi aktivitetet dhe mbikëqyrjen e institucioneve për dhënie e pensione profesionale".	Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009, 'Për fondet e pensionit vullnetar'".	Ligj	Jo	MFA/AMF	I pjesëshëm	2021	IV	Jo
9	Shërbimet jobankare	Direktiva 2013/36/BE, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 26 qershor 2013, "Mbi aksesin në veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen prudenciale të institucioneve të kreditit dhe shoqëritë të investimit, që ndryshon direktivën 2002/87/KE dhe shfuqizon direktivat 2006/48/KE dhe 2006/49/KE".	Udhëzim "Për procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së likuiditetit (ILAAP)".	Udhëzim	Jo	BSH	I pjesëshëm	2021	IV	Po
9	Shërbimet jobankare	Rregullore (BE) nr. 575/2013, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 26 qershor 2013, "Mbi kërkesat prudenciale për institucionet e kreditit dhe shoqëritë të investimit, që ndryshon rregulloren (BE) nr. 648/2012".	Rishikimi i rregullores nr.48, datë 31.7.2013, "Për mjaftueshmërinë e kapitalit".	Rregullore	Jo	BSH	I pjesëshëm	2021	IV	Po
9	Shërbimet jobankare	Direktiva 2014/92/BE, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 23 korrik 2014, "Mbi krahasueshmërinë e tarifave që lidhen me llogaritë e pagesave, transferimin e llogarive të pagesave dhe aksesin në llogaritë e pagesave me karakteristika bazike".	Ligj	Ligj	Jo	BSH	I pjesëshëm	2022	IV	Po
9	Shërbimet jobankare	Direktiva 2014/59/BE, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 15 maj 2014, "Mbi krijimin e një kuadri për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme e institucioneve të kreditit dhe firmave të investimit".	Draft rregullore "Njohja kontraktuale e rikapitalizimit nga brenda".	Rregullore	Jo	BSH	I pjesëshëm	2021	III	Jo
9	Shërbimet jobankare	Direktiva 2014/59/BE, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 15 maj 2014, "Mbi krijimin e një kuadri për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme e institucioneve të kreditit dhe firmave të investimit".	Mbi kushtet dhe kriteret për përcaktimin e normave të konvertimit të borxhit në kapital.	Udhëzim/rregullore	Jo	BSH	I pjesëshëm	2021	IV	Po
9	Shërbimet jobankare	Direktiva 2014/59/BE, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 15 maj 2014, "Mbi krijimin e një kuadri për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme e institucioneve të kreditit dhe firmave të investimit".	Mbrojtja e kundërpalëve në transferimin e pjesëshëm.	Rregullore	Jo	BSH	I pjesëshëm	2022	IV	Po
10	SHOQËRIA E INFORMACIONIT DHE MEDIA									
10	10.1 Komunikimet elektronike	Direktiva (BE) 2018/1972, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 dhjetor 2018, mbi krijimin e Kodit të Komunikimit Elektronik Evropian	Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, 'Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë'".	Ligj	Jo	MIE	I pjesëshëm	2022	IV	Jo



10	10.2 Shërbimet e Shqërsisë së Informacionit	Direktiva e BE-së 2016/1148, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 6 korrik 2016, lidhur me masat për një nivel të lartë të sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të informacionit në gjithë Evropën.	Projektiligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 2/2017, “Për sigurinë kibernetike”.	Ligj	Jo	KM/AKCESK	I plotë	2022	IV	Jo
10	10.2 Shërbimet e Shqërsisë së Informacionit	Rregullore BE-së nr. 910/2014, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës korrik 2014, për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm.	Projektiligj “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, “Për dokumentin elektronik”.	Ligj	Jo	KM/AKCESK	I plotë	2022	IV	Jo
10	10.3 Politika Audiovizuale	Direktiva (BE) 2018/1972, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 dhjetor 2018, mbi krijimin e Kodit të Komunikimit Elektronik Evropian.	Projektregullore “Për vendosjen e detyrimit të mbartjes së programeve kombëtare nga rrjetet e komunikimeve elektronike”.	Rregullore	Jo	AMA	I plotë	2021	IV	Jo
11	BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL									
11	Organizimi i përbashkët i tregut	Rregullore e deleguar e Komisionit (BE) 2018/273, e 11 dhjetorit 2017, që plotëson rregulloren (BE) nr. 1308/2013, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me skemën e autorizimeve për mbjelljet e vreshtave, regjistrin e vreshtave, dokumentet shoqëruese dhe certifikimin, regjistrin i hyrje-daljeve, deklaratat e detyrueshme, njoftimet dhe publikimi i informacionit të njoftuar, dhe plotësimi i rregullores (BE) nr. 1306/2013, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me kontrollin dhe gjatësitë përkatëse, që ndryshon rregulloret e Komisionit (KE) nr. 555/2008, (KE) nr. 606/2009 dhe (KE) nr. 607/2009 dhe shfuqizon rregulloren e Komisionit (KE) nr. 436/2009 dhe rregulloren e deleguar të Komisionit (BE) 2015/560.	Drafturdhër “Për miratimin e formatit të aplikimit për regjistrim në regjistrin e vreshtave, formatit të ndryshimit të të dhënave dhe rregullave shtesë për funksionimin e regjistrit të vreshtave”.	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesëshëm	2021	IV	Jo
11	Organizimi i përbashkët i tregut	Rregullore e deleguar e Komisionit (BE) 2018/273, e 11 dhjetorit 2017, që plotëson rregulloren (BE) nr. 1308/2013, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me skemën e autorizimeve për mbjelljet e vreshtave, regjistrin e vreshtave, dokumentet shoqëruese dhe certifikimin, regjistrin i hyrje-daljeve, deklaratat e detyrueshme, njoftimet dhe publikimi i informacionit të njoftuar, dhe plotësimi i rregullores (BE) nr. 1306/2013, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me kontrollin dhe gjatësitë përkatëse, që ndryshon rregulloret e Komisionit (KE) nr. 555/2008, (KE) nr. 606/2009 dhe (KE) nr. 607/2009 dhe shfuqizon rregulloren e Komisionit (KE) nr. 436/2009 dhe rregulloren e deleguar të Komisionit (BE) 2015/560.	Drafturdhër “Për miratimin e rregullave për mbajtjen e deklaratave të detyrueshme, formularit që duhet të plotësohen nga operatorët dhe mënyra e grumbullimit të informacionit për prodhimin potencial”.	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesëshëm	2022	III	Jo
11	Organizimi i përbashkët i tregut	Rregullore e Deleguar e Komisionit (BE) 2018/273, e 11 dhjetorit 2017, që plotëson rregulloren (BE) nr. 1308/2013, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me skemën e autorizimeve për mbjelljet e vreshtave, regjistrin e vreshtave, dokumentet shoqëruese dhe certifikimin, regjistrin i hyrje-daljeve, deklaratat e detyrueshme, njoftimet dhe publikimi i informacionit të njoftuar, dhe plotësimi i rregullores (BE) nr. 1306/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me kontrollin dhe gjatësitë përkatëse, që ndryshon rregulloret e Komisionit (KE) nr. 555/2008, (KE) nr. 606/2009 dhe (KE) nr. 607/2009 dhe shfuqizon rregulloren e Komisionit (KE) nr. 436/2009 dhe rregulloren e deleguar të Komisionit (BE) 2015/560.	Drafturdhër ministri “Për miratimin e rregullave të detajuara për regjistrat e hyrje-daljeve”.	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesëshëm	2023	II	Jo
11	Organizimi i përbashkët i tregut	Rregullore (EU) nr. 1308/2013, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013; Rregullorja e deleguar e Komisionit (BE) 2019/934, e 12 marsit 2019, që plotëson rregulloren (BE) nr. 1308/2013, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me zonat e riutjes së verës ku forca alkooolike mund të rritet, praktikën e autorizuar enologjike dhe kufizimet e zbatueshme për prodhimin dhe konservimin e produkteve të rrushit, përcjelljen minimale të alkooolit për nënproduktet dhe agjësimitin e tyre, dhe publikimin e dosjeve OIV; Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) 2019/935, e 16 prillit 2019, që përcakton rregullat për zbatimin e rregullores (BE) nr. 1308/2013, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me metodat e analizave për përcaktimin e karakteristikave fizike, kimike dhe organoleptike të produktet të rrushit për verë dhe njoftimet e vendimeve të Shteteve Anëtare në lidhje me rritjen e forcës alkooolike natyrore.	Urdhër ministri “Rregulla të detajuara, në lidhje me praktikën enologjike, protokollet dhe metodat e analizave për produktet e rrushit për verë, duke marrë parasysh standardet ndërkombëtare (OIV) të prodhimit të verës, veçanësisht pasurim, acidifikimi dhe de-acidifikimi, si dhe kufizimet që aplikohen”.	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesëshëm	2023	III	Jo



11	Rrjeti i të dhënave të kontabilitetit të fermave (FADN)	Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1217/2009, e datës 30 nëntor 2009, për krijimin e një rrjeti për mbledhjen e të dhënave të kontabilitetit mbi të ardhurat dhe funksionimin e biznesit të fermave bujqësore në Komunitetin Evropian.	Projektligji “Për një ndryshim disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9817/2007, ‘Për bujqësinë dhe zhvillimin rural’”.	Ligj	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2022	II	Jo
11	Zhvillimi Rural: Kuadri i përgjithshëm, masat	Rregulloret e Parlamentit Evropian nr. 1303/2013 dhe e Këshillit, e 17 dhjetorit 2013, duke parashikuar dispozita të përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Evropian Social, Fondin e Kohezionit, Fondin Bujqësor Evropian për Zhvillimin Rural dhe Fondin Evropian Detar dhe të Peshkimit dhe duke parashikuar dispozita të përgjithshme për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Evropian Social, Fondin e Kohezionit dhe Fondin Evropian Detar dhe të Peshkimit, që shfaqin rregulloren e Këshillit (EC) nr. 1083/2006.	Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e Grupeve Vendore të Veprimit”.	Ligj	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2021	III	Jo
11	Rrjeti i të dhënave të kontabilitetit të fermave (FADN)	Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) nr. 2015/220, e 3 shkurtit 2015, që përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1217/2009, për krijimin e një rrjeti për mbledhjen e të dhënave të kontabilitetit mbi të ardhurat dhe funksionimin e biznesit të fermave bujqësore në Bashkimin Evropian	Draftudhëzim ministri “Për krijimin e një rrjeti për mbledhjen e të dhënave të kontabilitetit mbi të ardhurat dhe funksionimin e biznesit të fermave bujqësore në Shqipëri”.	Udhëzim	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2023	I	Jo
12	POLITIKAT E SIGURISË USHQIMORE, VETERINARISË DHE FITOSANITARE									
12	Mirëqenia e kafshëve/shpendë të mbajtur për prodhim mishi	Direktiva e Këshillit nr. 2007/43/EC, e 28 qershorit 2007, hartimi i rregullave minimale për mbrojtjen e shpendëve të mbajtura për prodhim mishi.	Draftudhëzim “Mbi rregullat minimale që zbatohen për mbrojtjen e shpendëve të mbajtur për prodhim mishi”.	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2021	III	Po
12	Identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve dhe lëvizjes së tyre/njështundrakët	Vendimi i Komisionit 2000/678/EC, i 23 tetorit 2000, që përcakton rregullat e hollësishme për regjistrimin e fermave në bazën e të dhënave kombëtare për kafshët e llojit derra, siç parashikohet nga direktiva e Këshillit 64/432/EEC.	Draftudhëzim “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e fermave në bazën e të dhënave kombëtare për kafshët e llojit derra”.	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2021	IV	Po
12	Tregtia në kafshët e gjalla, spermës, vezëve dhe embrioneve për shpendë dhe vezët për çelje	Vendimi i Komisionit 93/152/EEC, i 8 shkurtit 1993, që përcakton kriteret për vaksinat që do të përdoren kundër sëmundjes së pseudopestit në kontekstin e programeve rutine të vaksinimit.	Draftudhëzim “Mbi vendosjen e kriterëve të përdorimit të vaksinave që përdoren kundër sëmundjes së Pseudopestit në programet e vaksinimit rutinë”.	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2022	III	Po
12	Ushqimi i medikuar	Rregullorja (KE) nr. 1069/2009, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 21 tetorit 2009, që përcakton rregullat shëndetësore, në lidhje me nënproduktet e kafshëve dhe produktet e tyre që nuk janë të destinuara për konsum njerëzor dhe shfaqurimin e rregullores (KE) nr. 1774/2002.	Draftudhëzim “Mbi përcaktimin e rregullave shëndetësore të produkteve me origjinë shtazore dhe produkteve me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor”.	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2022	III	Po
12	Kontrolli i sistemit të importit	Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2019/2130, e 25 nëntorit 2019, që përcakton rregullat të hollësishme për operacionet që do të kryhen gjatë dhe pas kontrolleve dokumentare, kontrolleve të identitetit dhe kontrolleve fizike të kafshëve dhe mallrave që u nënshtrohen kontrolleve zyrtare në postat e kontrollit kufitar.	Draftudhëzim “Mbi përcaktimin e rregullave që duhet të kryhen gjatë dhe pas kontrollit të dokumentacionit, kontrollit të identitetit dhe kontrollit fizik të kafshëve dhe të mirave, që janë subjekt i kontrolleve zyrtare në PKK”.	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2022	IV	Po
12	Identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve dhe lëvizjes së tyre/njështundrakët	Vendimi i Komisionit 94/327/EC, i datës 19 maj 1994, për përcaktimin e kriterëve për testimin vijor të shpendëve për mbarështrim për sëmundjen e pseudopestit, në zbatim të nenit 12 (2), të direktivës së Këshillit 90/539/EEC.	Draftudhëzim “Për përcaktimin e kriterëve vijor të testimit të shpendëve për mbarështrim, në lidhje me sëmundjen e pseudopestit”.	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2023	III	Po
12	Rregullat specifike të kontrollit për produktet e kafshëve <i>Specific control rules for animal products</i>	Vendimi i Këshillit 2000/258/EC, i 20 marsit 2000, që përcakton një institut specifik përgjegjës për vendosjen e kriterëve të nevojshme për standardizimin e testeve serologjike, për të monitoruar efektivitetin e tërbimit.	Draftudhëzim “Mbi listën e produkteve mjekësore veterinarë që janë substanca thelbësore për trajtimin e njështundrakëve”	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2023	IV	Po
12	Public Health/Medicinal products (pharmaceuticals)	Rregullorja (BE) 2019/6, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 11 dhjetorit 2018, mbi produktet mjekësore veterinarë dhe shfaqurimin e direktivës 2001/82/EC.	Draftudhëzim “Për një ndryshim në urdhrin nr. 370, datë 29.7.2014, ‘Për produktet mjekësore veterinarë’”.	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2023	IV	Po
12	Public Health/Medicinal products (pharmaceuticals)	Direktiva e Komisionit 91/412/KEE, e 23 korrikut 1991, që përcakton parimet dhe udhëzimet e praktikave të mira të prodhimit për produktet mjekësore veterinarë.	Draftudhëzim “Për përcaktimin e principeve dhe udhëzimeve për praktikën e mira të prodhimit të produkteve mjekësore veterinarë”.	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2022	IV	Po



12	Legislacioni mbi ushqimin për përdorime të veçanta ushqyese	Rregullore (BE) nr. 609/2013, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 12 qershorit 2013, për ushqimin e destinuar për foshnjat dhe fëmijët e vegjël, ushqimin për qëllime të veçanta mjekësore, dhe zëvendësimin e plotë të dietës për kontrollin e tërë dhe shfuqizimin e direktivës së Këshillit 92/52/CEE, direktivë e Komisionit 96/8/EC, 1999/21/EC, 2006/125/EC dhe 2006/141/EC, direktiva 2009/39/EC, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit dhe rregulloret e Komisionit (KE) nr. 41/2009 dhe (EC) nr. 953/2009.	Draftudhëzim “Mbi ushqimet për bebe dhe fëmijë të vegjël, ushqime për qëllime të caktuara mjekësore dhe zëvendësimi i plotë i dietave për kontrollin e peshës”.	Udhëzim	Jo	MBZHHR	I pjesshëm	2021	IV	Jo
12	Kapitulli 1, rregullat higjienike, vendosja në treg e ushqimit, ushqimit për kafshë dhe nënprodukte të kafshëve	Rregullore (KE) nr. 2073/2005, e 15 nëntorit 2005, për kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore.	Draftudhëzim “Për kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.	Udhëzim	Jo	MBZHHR	I pjesshëm	2021	III	Po
